

ARBEN PUTO

BIBLIOTEKA
949.65
P 98



DEMOKRACIA
E RRETHUAR

REDAKTORË: ARSHIN XHEZO

FRIDA IDRIZI

RECENSUES.: STEFANAQ POLLO

KRISTO FRASHËRI

PIKTOR: SPIRO KRISTO

REDAKTOR TEKNIK: PIRRO PANDELI

KORREKTORE LETRARE: NINI IHSANI

PARATHËNIE

Revolucioni i Qershorit 1924 është ndër ngjarjet më të historisë sonë më të re. Ai përbën, pa dyshim, shprehjen më të fuqishme të rritjes së ndërgjegjes politike dhe të vetëveprimit të masave popullore në periudhën midis dy luftërave. Qeveria që doli prej fitores së lëvizjes kryengritëse zhvilloi një veprimtari cilësisht të re në jetën e shtetit të pavarur shqiptar, si në pikëpamje të politikës së brendshme, ashtu edhe të asaj të jashtme. Kjo e bëri Revolucionin e Qershorit të mos jetë vetëm një ndodhi e izoluar shqiptare, por edhe një dukuri që e pasuronte lëvizjen përparimtare demokratike në shkallë ballkanike. Kështu shpjegohet jehona e tij e jashtëzakonshme në botën e jashtme, një jehonë që i kaloi përmasat e Shqipërisë së asaj kohe.

Këtu e ka burimin edhe vëmendja e madhe që i është kushtuar kësaj teme nga ana e studiuesve. Një kontribut veçanërisht të vlefshëm ka sjellë në trajtimin e saj historiografia e re në gjuhën shqipe. Në këta katër dhjetëvjeçarë e gjysmë është bërë një punë serioze, e cila ka patur si rezultat kryesor që Qershori i vitit 1924 të mos mbetet si një episod i humbur në mugëtirën e padijes, si një deviacion i përkohshëm nga rruga e «legalitetit», por të radhitet ndër faqet më të ndritura të gjithë historisë sonë kombëtare. Vlerat e mëdha të Qershorit 1924 kanë dalë në dritë me përpjekjet e shumë autorëve nëpërmjet artikujve studimorë, referateve e kumtesave në sesione shkencore si dhe me botime të dëshmuara të pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë apo të kujtimeve të bashkëkohësve. E megjithatë ka ende një zbrazëti të ndjeshme: Qershori i 1924-s, vigjilja e tij e aq më tepër muajt vijues të mbushur me zhvillime të bujshme të brendshme e të jashtme, presin ende të jenë objekt i trajtimeve më të plota e tërësore.

Pa mohuar arritjet e deritanishme, nuk mund të mos konstatohet se ngjarja është copëzuar, është trajtuar në mënyrë fragmentare: janë kapur aspekte të saj të veçanta e të pjeshme, është ndalur vëmendja te personalitetet më të spikatura në rolin e protagonistëve. Ato patjetër kanë sjellë vazhdimisht elemente ndriçimi, tabloja ka ardhur gjithnjë duke u plotësuar, por nuk ka ende studime monografike që të bëjnë sintezën e kësaj eksperience revolucionare të pasur e origjinale.

Ky libër që po i paraqitet publikut është një përpjekje për t'iu përgjigjur kësaj kërkesë, deri në njëfarë mase. Ai nuk rrok gjithë problematikën e Revolucionit të Qershorit dhe të Qeverisë së dalë prej tij; ai e ndjek fenomenin kryesisht në raport me marrëdhëniet ndërkombëtare. Këndvështrimi është i veçantë, por informacioni që është sjellë dhe gjithë lënda e përpunuar mendohet se përbëjnë një trajtesë tërësore. Në kuptimin që hedhin dritë pak a shumë të mjaftueshme mbi komponentin e politikës së jashtme në Revolucionin e Qershorit dhe në veprimtarinë e qeverisë së dalë prej tij. Në këtë rast tema paraqet interes të dyfishtë: nga njëra anë. na njeh me inovacionet e Revolucionit të Qershorit në fushën e politikës së jashtme; nga ana tjetër, nxjerr në pah pengesat e mëdha që ai hasi në arenën ndërkombëtare, frontin unik të Fuqive të Mëdha dhe shteteve ballkanike për shuarjen e asaj që u quajt me qëllime të qarta spekulative «vatër e rrezikshme bolshevike».

Autori i këtij punimi e ka drejtuar vëmendjen e tij te kjo temë shumë herët, që në fillimet e punës së tij kërkimore-shkencore. Ajo është konkretizuar nëpërmjet botimit të një numri artikujsh studimorë kryesisht në revistën «Studime historike» në vitet 60 e 70. Artikujt e përmendur janë përqendruar në probleme të veçanta që ka qenë e detyruar të përballojë Qeveria Demokratike e Nolit në marrëdhëniet e jashtme. Por pikësynimi i autorit ka qenë, që në krye, që nëpërmjet trajtimit të «pjesëve» të mbërrihet te «e tëra». Autori shpreston ta ketë arritur këtë duke e zgjeruar dhe thelluar studimin e duke e pasuruar atë me të dhëna të reja, fryt i një pune shumëvjeçare. Rezultati është kjo monografi që mendohet se jep një pasqyrë dhe analizë të situatës së komplikuar diplomatike në të cilën u ndodh Revolucionin i Qershorit dhe një bilanc të përpjekjeve të Qeverisë së Nolit, si për t'iu dalë zot interesave shtetërore, ashtu edhe për të krijuar kushte

të favorshme për përtëritjen demokratike të shoqërisë shqipëtare. Në këtë drejtim Qeveria e Nolit bëri mjaft, por arriti pak. Në qoftë se ka një konkluzion të përgjithshëm, që mund të nxirret nga ky punim, ky do të ishte se Revolucioni i Qershorit humbjen kryesore e pati në terrenin e politikës së jashtme, një humbje që do të rezultonte fatale. Kjo shpjegon edhe vetë titullin e këtij punimi: «Demokracia e rrethuar» Pse «e rrethuar»?! Sepse gjatë atyre 6 muajve (qershor-dhjetor 1924) Qeveria e Nolit mbeti e izoluar, asaj iu mohua qëllimisht çdo lidhje zyrtare me botën e jashtme. Shqipëria u gjend si në njëllonj rrethimi. Dhe veç asaj, Qeveria e Nolit u rrëzua me forcë në dhjetor me ndërhyrje nga jashtë. Vetë Noli ka shkruar: «Ky ishte një rast i thjeshtë i ndërhyrjes së huaj... Çifligarët nuk do të kishin mundur të ktheheshin pa intervenimin e huaj».

Shikuar në distancë historike, shtypja e Revolucionit të Qershorit me pjesëmarrjen e drejtëpërdrejtë të forcave të jashtme hyn në vargun e gjatë të veprimeve arbitrare e të shkeljeve flagrante të normave elementare të marrëdhënieve ndërkombëtare, të asaj praktike të ndëshkimit brutal të të mëdhenjve kundër të vegjëlve, me të cilën ishte e mbushur sidomos periudha midis dy luftave botërore. Edhe pas Luftës II rastet nuk kanë qenë as më të pakta, as më pak të bujshme. Por vetë jeta tregoi, dhe ky fund shekulli e ka provuar më qartë se asnjëherë, se rruga e progresit është e pandalshme. Progresi çan çdo rrethim dhe jo vetëm në zhvillimin e brendshëm të vendeve por edhe në marrëdhëniet midis shteteve. Po ngushtohet gjithnjë e më shumë sfera e veprimit të forcave retrograde. Demokratizimi është një proces i pashmangshëm edhe në gjirin e bashkësisë ndërkombëtare.

Pavarësisht nga përfundimi që pati Revolucioni i Qershorit ballafaqimi i tij me botën e jashtme jo vetëm që nuk i cenon, por i ngrre më lart, i nxjerr më në pah vlerat e këtij Revolucioni, si një etapë e rëndësishme e lëvizjes revolucionare demokratike në Shqipëri. Në fund të fundit, qëllimi kryesor i këtij punimi është që të lartësohen trashëgimia e tij historike dhe figura e jashtëzakonshme e Nolit që mbizotëron në këtë ngjarje.

Në të vërtetë mesazhi i Qershorit dhe i vetë Nolit ruajnë aktualitetin edhe në kohën e sotme.

Vëllimit i është bashkëngjitur një shtojcë, që përfshin një numër dokumentesh të dala nga dora e Nolit, dokumente

që kanë vlerën e burimeve parësore. Ato, së pari, shërbejnë si plotësim e ilustrim i fakteve dhe ngjarjeve të trajtuara në punim. Por, veç asaj, ato sjellin edhe një informacion plotësues mbi pikëpamjet e Nolit dhe mbi gjykimet që ai ka dhënë, qoftë mbi veprën e qeverisë gjatë atyre 6 muajve, qoftë mbi objektivat dhe dobësitë e përvojës revolucionare demokratike pas ndërprerjes së saj me forcë në dhjetor.

HYRJE

1. Periudha fill pas mbarimit të Luftës I Botërore është e mbushur me kaq shumë ngjarje të një rëndësie të dorës së parë sa që me të drejtë mund të flitet për një valë të re të fuqishme të lëvizjes çlirimtare në vijim të drejtpërdrejtë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Vitet 20 plotësuan detyra të tilla historike të cilat vunë vulën e tyre të pashuar në gjithë zhvillimin e vendit, qoftë me afat të shkurtër, qoftë me një shtrirje më të gjatë në kohë. Ato u hapën me zgjimin e madh popullor që takoi majat kulminante në Kongresin Kombëtar të Lushnjës dhe Luftën e lavdishme të Vlorës, dy ngjarje madhore që e shprehën me një forcë të paparë shpirtin e qëndresës dhe vitalitetin e popullit shqiptar.

Jo më shumë se 3-4 vjet më vonë, më 1924, një lëvizje kryengritëse e gjerë plasi brenda vendit, një lëvizje që i shprehu në një mënyrë të re aspiratat shekullore të vegjëlisë. Pasi u kapërcye rreziku i jashtëm imediat, çështja e rendit politik-shoqëror në Shqipërinë e pavarur nuk mund të mos shtrohej me tërë mprehtësinë e saj. Lidhur me këtë forcat politike kryesore të vendit tani u ndanë. Ballafaqimi midis tyre mbush gjithë periudhën që shkon prej fundit të vitit 1920 e deri në pranverë të vitit 1924, një luftë gjithnjë më e ashpër midis së djathtës reaksionare, që synonte të ruante privilegjet e vjetra në një Shqipëri në thelb feudale, dhe krahut përparimtar, që ishte për reforma që duhej ta vinin vendin në rrugën e përparimit e të zhvillimit demokratik.

Kjo luftë u zhvillua fillimisht në kuadrin e sistemit parlamentar, i cili ashtu siç u përvijua në tiparet kryesore në Lushnjë, hodhi hapat e parë në realitetin shqiptar të asaj kohe. E gjithë kjo pati si pasojë një paqëndrueshmëri

ekstreme: krizat politike u ndërthurën me kriza qeveritare të njëpasnjëshme.

Edhe pse nëpërmjet sistemit parlamentar të vendosur në Lushnjë, i cili në kushtet shqiptare i tregoi qartë dobësitë dhe karakterin e tij gjysmak, qysh në verën e vitit 1923 ishte bërë tanimë krejt e qartë se opinioni i vendit anonte gjithnjë më shumë nga e majta përparimtare. Forcës tërheqëse të programit i shtohet pa dyshim edhe prestigji i përfaqësuesve të saj. Një plejadë e tërë udhëheqësish demokratë revolucionarë, si: Fan Noli, Luigj Gurakuqi, Avni Rustemi, Bajram Curri, veç shërbimeve të mëdha që i kishin bërë çështjes kombëtare në të kaluarën. ditën të ndiznin në zemrat e popullit të thjeshtë idealin e drejtësisë shoqërore dhe u vunë në krye të lëvizjes për një Shqipëri të vegjëlisë, kundër hyqmit të «oxhaqeve».

Të paaftë për t'i vënë fre marshimit të vrullshëm të forcave demokratike, qeveria reaksionare që ishte në fuqi, gjithë reaksioni i bejlerëve vendosën të përdornin dhunën e zhveshur si mjet për të ruajtur pozitën dhe privilegjet e moçme. Kishin edhe këta «kryetarin» e vet shpirtëror dhe veprues në personin e Ahmet Zogut, i cili e kishte treguar veten me kohë si mjeshër i intrigës dhe i kriminit politik. Pikërisht eliminimin fizik të kundërshtarëve politikë shtiu në punë Zogu për të vendosur diktaturën e tij në vend. Në gjysmën e dytë të prillit. në vargun e gjatë të krimeve të tij, ai shtoi vrasjen në Tiranë të Avni Rustemit, udhëheqësit të dashur e të nderuar të organizatës «Bashkimi» që grumbullonte elementët më të përparuar të intelektualëve të rinj, të cilët kishin si ideal përtëritjen e Shqipërisë mbi baza demokratike.

Kjo vrasje ishte një atentat kundër vetë ndërgjegjes së kombit, ndaj edhe shërbeu si kushtim i revoltës prej nga zunë fill ngjarjet e mëdha të pranverës së 1924-s që çuan në fitoren e Revolucionit Demokratik. Si hap i parë, gjithë forcat e opozitës u larguan nga kryeqyteti në shenjë proteste dhe u grumbulluan në Vlorën e epopesë së dyfishtë — asaj të vitit 1912 dhe asaj të vitit 1920. Vetë ceremonia e varrimit të heroit martir, ku mijëra veta erdhën për të marrë pjesë nga të katër anët e vendit, u shndërrua në një manifestim madhështor politik, që paralajmëronte qartë shpërthimin e afërt revolucionar. Në fillim të majit gjithë deputetët e opozitës në parlament i dërguan nga Vlora një ultimatum Këshillit të Lartë në Tiranë (që kryente funksionet e kryetarit të shtetit), duke i kërkuar që të shkarkonte

pa vonesë qeverinë që zotërohej nga kamarilja zogiste. Qeveria u përgjigj duke marrë masa raprezaljeje kundër deputetëve «rebelë», gjë që i dha shkas organizatës «Bashkimi» të bënte menjëherë thirrje për t'u hedhur në kryengritje me armë. Lëvizja triumfoi me një shpejtësi që habiti e zuri në befasi edhe përkrahës, edhe kundërshtarë. Askush nuk besonte në një rrokullisje të tillë të ngjarjeve. Kjo, në vetvete, tregonte jehonën e madhe që patën objektivat e lëvizjes demokratike në masën e gjerë.

E filluar nga malësorët nën komandën e Bajram Currit në Veri, lëvizja kryengritëse u përhap me të shpejtë në Jug ku rreth 12 mijë fshatarë rrokën armët për të goditur forcat e qeverisë. Një Komision Administrativ u formua në Vlorë nën kryesinë e Fan Nolit për drejtimin e përgjithshëm të kryengritjes. Reaksioni ndërkombëtar bëri një përpjekje të fundit për t'i ardhur në ndihmë qeverisë kur ministri anglez Aires, duke kryer një ndërhyrje brutale në punët e brendshme të vendit, propozoi «pajtimin e të dyja palëve në konflikt», por as kjo nuk qe në gjendje të ndalonte fitoren e shpejtë të Revolucionit Demokratik. Në ditët e para të qershorit mbeturinat e forcave reaksionare të shpartalluara u hodhën përtej kufijve, sidomos në Jugosllavi, ku Zogu u prit si aleat dhe u mbajt në rezervë në «vështrim të zhvillimeve të ardhshme të situatës» në Shqipëri.

Më 16 qershor u formua Qeveria Demokratike Revolucionare me Fan Nolin në krye. Ajo qëndroi në fuqi deri në fund të dhjetorit. Me gjithë kohën e shkurtër të ekzistencës së saj, ajo shënon një etapë të rëndësishme në procesin historik të shndërrimit demokratik të shoqërisë shqiptare. Ishte pa dyshim më e majta ndër të gjitha qeveritë që kishin ardhur në fuqi në Shqipëri qysh se kjo fitoi pavarësinë. Programi i saj, ashtu siç u paraqit nga Noli më 18 qershor, përbënte asokohe shprehjen më të plotë të aspiratave të shtresave të gjera të popullsisë. Pikat kryesore të tij ishin vendosja e lirive politike dhe zbatimi i një vargu reformash, ndër të cilat më e rëndësishmja ishte ajo agrare. Për nga karakteri ato sigurisht nuk i kapërcenin caqet e demokracisë klasike borgjeze, por me radikalizmin që i dallonte ato premtinin të krijonin një bazë për të ndërmarrë shndërrime të mëtejshme më të thella shoqërore.¹

1) *Dokumente e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri e demokraci (1917-1941), Tiranë, 1959, d. nr. 160.*

2. Megjithëse e zhvilluar kryesisht në plan të brendshëm, lëvizja e 1924-s pati një aspekt tjetër jo më pak të rëndësishëm, atë të politikës së jashtme. Lëvizja e vitit 1924 ishte një protestë e drejtuar jo vetëm kundër shtypjes feudale brenda vendit, por edhe kundër politikës grabitqare, që vazhdonin të ndiqnin fuqitë imperialiste ndaj Shqipërisë. Kjo lëvizje duhet parë, pra, edhe si një përpjekje e qarqeve më të ndriçuara të vendit për t'i prerë rrugën depërtimit të huaj në Shqipëri dhe për t'i siguruar sadopak shtetit shqiptar një pozitë ndërkombëtare të vetën, të lirë nga tutela mbytëse e të mëdhenjve. Me fjalë të tjera, lëvizja e vitit 1924 kishte një funksion të dyfishtë: antifeudal dhe antiimperialist.

Problemet kryesore të politikës së jashtme të lëvizjes demokratike nuk mund të sqarohen pa patur parasysh, sado shkurt, kuadrin diplomatik të çështjes shqiptare në mbarim të Luftës I Botërore. Tipari themelor i këtij kuadri përbëhet nga orvatjet e Fuqive të Mëdha e të shteteve fqinje për ta rivënë në diskutim nga e para çështjen shqiptare. Marrëveshjet e 1913-s mbi njohjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe caktimin e kufijve të saj, me gjithë cungimet që këto pësuan, në shumë qarqe u quajtën të zhvleftësuar për shkak të fillimit të armiqësive midis fuqive nënshkruese. Shqipëria u ndodh përballë rreziqeve ndoshta edhe më të mëdha sesa në kohën e luftërave ballkanike. Këto rreziqe të reja u përvijuan majft qartë si në Konferencën e Paqes të vitit 1919, ashtu edhe në vitet e mëpastajme. U zhvillua një lojë e ngatërruar diplomatike, herë në prapaskenë e herë në sipërfaqe, që mund të përfundonte ose me fshirjen e plotë të Shqipërisë nga harta politike, ose të paktën me një cungim të ri të tokave shqiptare. Marrëveshja e fshehtë Titoni-Venizellos në kuluaret e Konferencës së Paqes në korrik 1919, memorandumit anglo-francez i dhjetorit të po atij viti, me plotësimet që iu bënë në janarin e vitit vijues, projektet mbi vendosjen e Shqipërisë nën mandatin italian janë disa nga momentet kryesore në tratativat e fuqive pas lufte. Ato tregonin se diplomacia imperialiste nuk kishte ndryshuar asgjë nga metodat e saj tradicionale në trajtimin e çështjes shqiptare.

Kundërveprimi i fuqishëm i popullit shqiptar në vitin 1920 i varrosi këto plane. Pas Kongresit të Lushnjës, trupat pushtuese u detyruan të tërhiqen dhe vendi u vu në rrugën e bashkimit të tokave shqiptare nën autoritetin qendror të qeverisë kombëtare. Fitorja e armëve shqiptare në Luftën

e Vlorës dhe tërheqja e Italisë patën rëndësi vendimtare. Një gjendje e nderë u krijua në vjeshtën e 1920-s edhe në veri e verilindje ku shpërthyen kryengritje për shkak të orvatjeve jugosllave për të mbajtur tokat e asaj që Beograd vazhdonte ta quante abuzivisht «vijë strategjike».

Mbi këtë bazë, diplomacia e re shqiptare arriti një sukses të shënuar kur Shqipëria u pranua po atë vit, në dhjetor, si anëtare e Lidhjes së Kombeve. Në rrethanat menjëherë pas mbarimit të Luftës I, pranimi i Shqipërisë në Organizatën e Gjenevës ishte një fitore e rëndësishme politike. Ai ishte në thelb një ripohim i vendimeve të paraluftës mbi pavarësinë e Shqipërisë, një hedhje poshtë në të njëjtën kohë e projekteve që ishin bërë e po bëheshin për një cungim të ri të tokave shqiptare.¹ Por nuk morën fund me kaq synimet dhe kontradiktat e fuqive imperia-liste dhe shteteve fqinje rreth çështjes shqiptare: pati vetëm një trazim të kartrave në lojën diplomatike dhe rivalitetet shpërthyen përsëri me forcë edhe më të madhe duke patur si pikësynim herë cenimin e mëtejshëm të tërësisë territoriale, herë shfrytëzimin ekonomik të vendit, herë vetë pavarësinë e tij politike. Zgjatën edhe më intrigat rreth «problemeve» të mbetura pezull e të zvarritura të kufijve, ndërsa në fushën politike, me anën e një deklarate të Fuqive të Mëdha të nëntorit të vitit 1921, Italisë i njiheshin në Shqipëri «interesa të posaçme».² Kjo paralajmëronte kursin revanshist të Italisë fashiste pas disfatës së Vlorës dhe ishte një hipotekë e re mbi pavarësinë shqiptare, sado që e maskuar me «ndërmjetësinë» e Lidhjes së Kombeve.

Këto qenë rrethanat ndërkombëtare në të cilat e filloi ekzistencën e vet shteti i ri shqiptar i pasluftës, i ngritur

1) Shih A. Puto. *Problemi i statusit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe në Konferencën e Ambasadorëve*, «Studime historike» nr. 3/1965.

2) Eshhtë fjala për deklaratën që u nënshkrua në Paris më 9.11.1921 nga Britania e Madhe, Franca, Italia dhe Japonia, me anën e së cilës çështja e pavarësisë dhe e paprekshmërisë së kufijve të Shqipërisë shpallej si «çështje me rëndësi ndërkombëtare». Në rast rreziku për integritetin e saj territorial Shqipëria «mund të kërkonte ndihmën e huaj nëpërmjet Këshillit të Lidhjes së Kombeve», porse caktonte që më parë se Italia do të ngarkohej me «restaurimin e kufijve të Shqipërisë», përderisa, siç thuhej në deklaratë, «çdo modifikim i kufijve të Shqipërisë përbën një rrezik për sigurinë strategjike të Italisë». Shih A. Simonard, *Essai sur l'indépendance albanaise*, Paris 1942, pp. 366-367.

mbi themele kombëtare. Ai u ndodh përballë detyrave të një rëndësie të posaçme në fushën e politikës së jashtme. Përcaktimi i orientimeve themelore, i zgjedhjeve të mëdha politike, qoftë përsa i përket pozitës së Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare apo në lidhje me rolin e faktorit të jashtëm në çështjen e zhvillimit të burimeve ekonomike, ka qenë një nga temat kryesore të luftës politike midis grupeve dhe rrymave të ndryshme. Forcat konservatore reaksionare nuk vonuan të tregonin se ishin gati të bënin lëshime parimore në dobi të kësaj apo asaj fuqie për hir të ruajtjes së pozitave dhe interesave të ngushta klasore, se nuk kishin as vullnetin, as aftësinë për të mbrojtur me sukses pavarësinë politike dhe ekonomike. Revolucioni i 1924-s dhe qeveria e dalë prej tij duhej t'u jepnin një zgjidhje problemeve të grumbulluara prej kohe si dhe atyre të krijuara rishtas me fitoren e lëvizjes demokratike.

Në plan të parë dilnin detyrat antiimperialiste dhe ato gjetën pasqyrim në marrëdhëniet e jashtme të qeverisë demokratike. Duke shprehur aspiratat e shtresave revolucionare që morën pjesë në Lëvizje, Qeveria e 1924-s nisi një politikë të jashtme të pavarur, me një origjinalitet e individualitet që e dallonte shumë nga qeveritë që ishin formuar në vendin tonë deri atëhere. Këtë e tregojnë mjaft veprime dhe qëndrime të Qeverisë së Nolit në arenën ndërkombëtare. Megjithëse në mënyrë jo konsekuente, me zigzage e lëkundje, gjatë kohës së shkurtër të qëndrimit të saj në fuqi, ajo u mundua të ndiqte një politikë të tillë në marrëdhëniet e jashtme, e cila nga njëra anë shprehte interesat themelore kombëtare e shtetërore në atë periudhë të caktuar historike, nga ana tjetër e rreshtonte Shqipërinë në frontin e forcave përparimtare në shkallë ballkanike dhe evropiane.

Kapitulli I

ÇËSHTJA E NJOHJES NDËRKOMBËTARE TË QEVERISË

Revolucioni Demokratik u kurorëzua me fitore kur forcat kryengritëse hynë në Tiranë më 10 qershor. Jo më vonë se një javë, më 16 qershor, u formua Qeveria e re me këtë përbërje: Fan Noli, kryetar; Sulejman Delvina, ministër i Punëve të Jashtme; kol. Rexhep Shala, ministër i Punëve të Brendshme; kol. Kasëm Qafzezi, ministër i Luftës (i Mbrojtjes); Stavro Vinjau, ministër i Drejtësisë dhe Arsimit; Luigj Gurakuqi, ministër i Financave; Qazim Koculi, ministër i Punëve Botore dhe i Bujqësisë; Xhemal Bushati, ministër pa portofol.¹ Në këtë përbërje pasqyrohet karakteri heterogjen i forcave që morën pjesë në lëvizjen kryengritëse. Noli bashkë me L. Gurakuqin e S. Vinjaun ishin bërthama më progresiste, përkrahës të flaktë të shndërrimeve demokratike, por aksioni i kësaj pararoje revolucionare do të ndeshte në prirjet frenuese të elementit konservator sidomos nga radhët e ushtarakëve. Kjo do të kushtëzonte gjithë veprimtarinë e Qeverisë së re, si në fushën e politikës së brendshme, ashtu edhe në atë të politikës së jashtme.

Në programin e saj që u botua më 18 qershor ajo formuloi detyrat kryesore në këto dy drejtime. Ai iu bë i njohur edhe publikut të jashtëm nëpërmjet përkthimit që vetë Noli bëri në anglisht dhe që iu dërgua me telegram legatave shqiptare dhe agjencive të lajmeve.² Një program i tillë tërhoqi menjëherë vëmendjen e qarqeve reaksionare të shqetësuara në botën e jashtme dhe kjo paralajmëronte se Qeveria e re do të haste në probleme të shumta e të vështira në arenën ndërkombëtare.

1) *Historia e Shqipërisë, vëll. III, Tiranë, 1984, f. 287-288.*

2) Kopje e përkthimit anglisht të nënshkruar nga Noli. *AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 195, fl. 1-4.*

Përçapjet për njohjen

Problemi kryesor i politikës së jashtme të Qeverisë Demokratike të 1924-s ka qenë pa dyshim ai i njohjes ndërkombëtare, domethënë problemi i vendosjes së marrëdhënieve të plota normale me qeveritë e shteteve të tjera. Këtë problem e gjejmë vazhdimisht në qendër të veprimtarisë diplomatike të Qeverisë Demokratike. Nuk është e tepruar të themi se në zhvillimet e çështjes së njohjes gjejmë të pasqyruar, në thelbin e vet, si pozitën ndërkombëtare të Qeverisë, ashtu dhe qëndrimin e Fuqive kundrejt Revolucionit të Qershorit.

Para së gjithash, duhet patur parasysh se në qershor të vitit 1924 shtrohej çështja e njohjes së qeverisë dhe jo ajo e njohjes së shtetit shqiptar.*

Çështja e njohjes së shtetit shqiptar, ishte zgjidhur që në kohën e Shpalljes së Pavarësisë më 1912-1913. Në qershor 1924 kishim të bënim me një ndërrim qeverie, dhe ky ndërrim shtronte çështjen e njohjes ndërkombëtare, përderisa Qeveria e Nolit erdhi në fuqi në rrethana «jo të zakonshme», «revolucionare», si pasojë e një kryengritjeje popullore.

Në fund të fundit, Qeveria e Nolit ishte e vetëdijshme për pozitën e saj nga pikëpamja e praktikës ndërkombëtare; ajo e dinte se shtrohej një çështje njohjeje, prandaj mori iniciativën dhe bëri zyrtarisht përçapjet e rastit pranë qeverive të fuqive evropiane si dhe të shteteve fqinje.

Përçapjet për njohjen e Qeverisë filluan menjëherë pas formimit të saj. Më 17 qershor kryeministri i ri, Noli, njoftonte telegrafisht kryeministrat Herio (Herriot — Francë), Makdonald (Macdonald — Angli), Musolini (Itali), Pashiç (Jugosllavi) dhe Papanastasiu (Greqi) se Këshilli i lartë i Regjencës e kishte ngarkuar të formonte atë që Noli quante «qeveria e re liberale», e cila kishte për qëllim t'i jepte

* Në teorinë e së drejtës ndërkombëtare bëhet dallimi midis njohjes së shtetit që shtrohet kur ky (shteti) krijohet për herë të parë dhe njohjes së qeverisë kur një qeveri vjen në fuqi në rrugë jo kushtetuese, d.m.th si pasojë e një kryengritjeje, a grushti shteti, pra jo sipas mënyrës së parashikuar në kushtetutë.

Shqipërisë një administratë moderne e demokratike.¹ Nga ana e tij, edhe ministri i Jashtëm S. Delvina u bëri të njohur gjithë përfaqësuesve të huaj të akredituar në Shqipëri formimin e Qeverisë si dhe detyrën që i ishte ngarkuar në gjirin e saj për të kryesuar dikasterin e punëve të jashtme.²

Në kuadrin e këtyre përçapjeve hyn edhe telegrami që Noli i drejtoi më 19 qershor Drumondit (Drummond), sekretar i përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, në radhët e së cilës Shqipëria ishte pranuar që në dhjetor 1920.³

Lëkundjet italiane

Ndër të gjitha këto përçapje ajo që u bë pranë qeverisë italiane duhet të përmendet në krye, sepse ka të dhëna që tregojnë se në përpjekjet e saj për të siguruar njohjen, Qeveria e re kishte shpresa të veçanta tek Italia.

Kjo ka arsyet e veta. Qysh përpara qershorit krerët e «opozitës» në parlamentin shqiptar (Noli me shokë) duket se kanë qenë mjaft të preokupuar se mos shpërthimi i lëvizjes kryengritëse demokratike në Shqipëri u jepte shkas ndërhyrjeve të shteteve fqinje për të ndezur aty një luftë civile, në kushtet kaotike të së cilës ato mund të realizonin më lehtë planet e vjetra të cungimit të mëtejshëm të tokave shqiptare. Një mundësi të tillë, që ishte një rrezik i rëndë jo më për lëvizjen, por për vendin në tërësi, ata mendonin ta kundërbalancnin duke siguruar mbështetjen dhe përkrahjen e qeverisë italiane. Disa aspekte «populareske» të «marshimit mbi Romë» dhe përgjithësisht frazeologjia sociale

1) Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH), fondi 251, v. 1924, d. 136, 140. Tërheq vëmendjen fakti se në telegramet e mësipërme Noli përçapet ta paraqesë formimin e Qeverisë së re si një ndryshim deri diku konstitucional, përderisa përmend «mandatin e ngarkuar nga Këshilli i Regjencës». Me këtë sigurisht Noli nuk ka për qëllim të mohojë ngjarjet revolucionare që i pararendën formimit të Qeverisë, aq më tepër që Këshilli i Regjencës kishte mbetur vetëm me një anëtar, (Sotir Pecin), ndërsa parlamenti ishte shpërndarë me konë. Nuk është vështirë të merret me mend se kjo ishte një orvatje për t'u dalë përpara rezervave që nuk do të vononin të shfaqesin nga qeveritë e tjera lidhur me karakterin e vërtetë të formimit të Qeverisë.

2) *Po aty*.

3) AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 141.

prapa së cilës u fsheh fashizmi në fazën e tij fillestare, ende krijonin disa iluzione si brenda në Itali, ashtu edhe në botën e jashtme.

Të gjitha këto e shtynë Nolin t'i dërgonte nga Vlora (ku ishin tërhequr eksponentët e «opozitës» demokratike në shenjë proteste kundër vrasjes së Avni Rustemit) një letër ministrit të Italisë, markezit Duraco (Durazzo), në pragun e kryengritjes më 26 maj. Në këtë letër ai kërkonte nga Roma që t'u bënte një paralajmërim qeverive të vendeve fqinje për t'i dalë përpara çdo ndërhyrjeje të tyre në punët e brendshme të Shqipërisë në rast të fitores së lëvizjes kryengritëse, të cilën Noli e quante krejt të afërt dhe të sigurtë.¹

Nga ana e saj, edhe Italia fashiste ishte e prirur t'i shikonte me njëfarë shprese ndryshimet në skenën politike shqiptare. Synimi kryesor i politikës italiane këtu ishte që të siguronte hallka të tilla brenda vendit, që të bënin të mundur realizimin e programit të depërtimit italian në Shqipëri të vendosur prej kohësh. Qeveria fashiste ende nuk e kishte bërë zgjedhjen midis grupeve politike të ndryshme në Shqipëri. Zogun ajo nuk mund ta quante tani për tani politikisht të përshtatshëm. Ky mosbesim i saj shpjegohet, sigurisht, jo me faktin se Zogu ishte përfaqësuesi kryesor i rrymës çifligare konservatore në jetën e brendshme të vendit. Lufta politike në parlamentin shqiptar të atyre viteve kishte treguar qartë se ishte pikërisht kjo rrymë që ofronte mundësitë më të mëdha për hapje kundrejt ndikimeve dhe interesave të jashtme. Mirëpo Roma nuk ishte e interesuar për çfarëdo «hapje»; ajo synonte të siguronte në Shqipëri pozita parësore, në mos tërësore. Zogu nuk jepte garanci të mjaftueshme, dhe kjo për shkak të lëkundjeve të vazhdueshme në politikën e jashtme: herë në drejtim të jugosllavëve, e herë të anglezëve.²

Në lëvizjen kryengritëse në Shqipëri, qarqet drejtuese fashiste deshën të shquanin që në fillim shenja të një orientimi proitalian në politikën e jashtme. Në Romë filloi të bëjë rrugë mendimi se ngjarjet në Shqipëri po nxirrnin në sipërfaqe pikërisht atë forcë politike të brendshme, për të cilën kishte nevojë Italia fashiste për realizimin e planeve të saj. Këtë bindje e përforconte edhe më shumë letra e mësipërme që Noli i dërgoi Duracos në emër të «opozitës».

1) *Documenti Diplomatici Italiani*, 7a serie, vol. III, d. 222, pp. 135-136 (Më tej DDI...)

2) *DDI. vol. III, d. 243, pp. 146 dhe d. 246, pp. 148-149.*

Në këto kushte kuptohet qëndrimi krejt i favorshëm që mbajti gjithë shtypi italian kundrejt hyrjes së forcave kryengritëse në Tiranë. Legata shqiptare telegrafonte nga Roma më 11 qershor, që përpara se të formohej qeveria e re, se toni i përgjithshëm i komenteve të gazetave italiane ishte pak a shumë ky: «programi i nacionalistëve është për një politikë të jashtme kombëtare dhe të brendshme demokrate, kurse ajo e bejlerëve ka qenë jashtë—remisive (dorëlëshuar, kapitulluese) dhe brenda—orientale», prandaj «opinionit publik italian simpatizon lëvizjen kombëtare shqiptare» me shpresë se «qeveria e re shqiptare do të rrëfejë më tepër miqësi e besim ndaj Italisë...»¹

Shpresat shtoheshin aq më tepër nga vetë njoftimet që vinin nga legata italiane në Durrës.² Ministri italian në raportet e tij të ditëve të para të qershorit, mburrej haptazi se e kishte favorizuar evolucionin e situatës shqiptare në drejtimin e dëshiruar nga politika italiane me qëndrimin e tij të rezervuar dhe madje «dashamirës» kundrejt kryengritësve, që duhej të sillte si fryt, — sipas tij, — «respektin dhe besimin e posaçëm të qeveritarëve të rinj» tek Italia³. Duraco ishte aq i bindur për tendencat proitaliane të Kryengritjes së Qershorit, sa që nxitoi t'i rekomandonte qendrës që «njerëzit e ardhur në fuqi në Shqipëri si pasojë e konfliktit të fundit» jo vetëm «të liheshin të lirë të bënin eksperimentin e tyre», por edhe «mundësisht të ndihmoeshin» nga qeveria italiane.⁴

Për më tepër, pak ditë pas formimit të Qeverisë së re në Tiranë, ai i telegrafonte me 19 qershor Musolinit, duke i propozuar që qeveria italiane «të kapërcente mbi diskutimet e stërholluara të së drejtës kushtetuese», që shtronte një ndërrim i tillë qeverie dhe të merrte iniciativën «për të hyrë me të menjëherë në marrëdhënie zyrtare».⁵ Të hynë të «në marrëdhënie zyrtare», donte të thoshte praktikisht të njëjtte Qeverinë e re shqiptare.

Edhe Musolini, i shtyrë nga njoftimet optimiste të përfaqësuesit të tij në Shqipëri, anonte po ashtu nga një zgjidhje pozitive e çështjes së njohjes së Qeverisë së Nolit. Një për-

1) Qarkore e Zyrës së Shtypit, datë 12.6.1924. AQSH, fondi 803, v. 1924, d. 26.

2) Përfaqësitë e huaja e kishin qendrën kryesisht në Durrës.

3) DDI, vol. III, d. 246

4) Raport i Durazzos, datë, 15.6.1924. DDI, vol. III, d. nr. 262.

5) DDI, vol. III, p. 179.

shtypje të favorshme i bëri atij edhe vetë përmbajtja e telegramit me të cilin Noli e njoftonte me 17 qershor për formimin e Qeverisë: u çmua toni «veçanërisht miqësor», megjithëse u sqarua se edhe në telegramet dërguar qeverive të tjera Noli ishte shprehur me të njëjtën gjuhë.¹

Mirëpo Musolini nuk mori menjëherë një pozicion të qartë, ngurroi të përcaktonte aty për aty një qëndrim të prerë. Ai nuk e quante veten në gjendje të vepronte krejt vetëm në këtë çështje, nuk donte që njohja e Qeverisë së re shqiptare nga ana e tij të merrte ngjyrën e një sfide lëshuar qeverive të tjera po ashtu të interesuara në çështjen shqiptare. Në të vërtetë disponimi fillestar i Romës dhe i përfaqësuesve të saj në Shqipëri në favor të njohjes së Qeverisë Demokratike nuk u shpëtoi qarqeve diplomatike, madje diplomatët e Francës e të Jugosllavisë në Tiranë ishin gati të konkludonin se gjithë revolucioni ishte «vepër italiane»². Në këto kushte Musolini zgjodhi një rrugë të mesme, në mënyrë që edhe ndryshimet në Shqipëri të mos kalonin fare në heshtje (aq më tepër që këto ndryshime mund të ishin, siç shpresohej, edhe proitaliane), edhe të mos «futej thellë» saqë të ndahej nga të tjerët, nga «aleatët», sidomos nga qeveria jugosllave. Kështu, në njërin anë ai bëri një gjest në mos afrimi, të paktën mirësjelljeje kundrejt Qeverisë së re, duke iu përgjigjur më 21 qershor telegramit të Nolit dhe duke e përgëzuar atë «për detyrën e lartë që iu besua» etj.³ Kurse në anën tjetër, po më 21 qershor, ai nxitoi t'i theksonte Duracos se përgjigjja e tij, «nuk nënkupton aspak një njohje formale të Qeverisë së re». Kjo njohje, shtonte ai, «mund të quhet përfundimtare, në qoftë se nuk do të ketë arsye të kundërta me rëndësi nga ana e qeverive aleate»⁴.

Si konkluzion i parë, përsa i përket qëndrimit italian në çështjen e njohjes së Qeverisë Demokratike të 1924-s, e shumta që mund të thuhet është se Roma ishte në favor të saj. Ajo u bë gati ta njihte. Por nuk e bëri këtë njohje, siç menduan fillimisht në Tiranë. Në të vërtetë Ministria e Jashtme shqiptare njoftoi telegrafisht më 22 qershor gjithë

1) P. Pastorelli, *Italia e Albania, 1924-1927*, Firenze 1967, p. 34.

2) *Gjurmime albanologjike. Seria e shkencave historike. II-1972*. f. 165. Artikull i Zh. Avramovskit, «Qëndrimi i Anglisë ndaj Qeverisë së Nolit».

3) DDI, vol. III, d. nr. 306, p. 179.

4) DDI, vol. IV, d. nr. 305, p. 179.

përfaqësitë diplomatike të Shqipërisë përjashta se «Qeveria italiane e njohu zyrtarisht Qeverinë e re shqiptare»¹. Vetë Fan Noli, duke folur me përfaqësuesin e Italisë për përgjigjen e Musolinit, i dha asaj kuptimin e njohjes së Qeverisë së tij nga ana e qeverisë italiane.² Ky mendim ishte natyrisht i bazuar në një interpretim tepër të favorshëm të telegramit të mësipërm të Musolinit. Për këtë ka ndikuar edhe nxitimi me të cilin Duraco njoftoi pikërisht më 22 qershor se qeveria e tij kishte njohur Qeverinë e re shqiptare pa formuluar asnjë rezervë.³

Mirëpo dokumentet diplomatike italiane, përveç që nuk lënë shteg për asnjë dyshim në këtë çështje, na tregojnë çartë edhe shkakun e ngurrimit të qeverisë italiane: ajo nuk donte të vepronte vetëm, «pa qeveritë aleate». Për këtë prapakthim të qeverisë italiane u bindën më në fund edhe në Tiranë. Në një telegram dërguar ato ditë legatës shqiptare në Romë, Ministria e Jashtme shfaqte gjithë zhgënjimin e saj, që njoftimi i parë i Duracos mbi «njohjen *de jure* dhe *de facto* pa asnjë rezervë» ishte pasuar «vetëm pas disa orësh» nga një njoftim i dytë që e përgënjeshtronte të parin dhe theksonte se «kjo nuk ishte njohje *de jure*».⁴ Me këtë rast i kërkohej legatës që të insistonte në Ministrinë e Jashtme italiane për një njohje sa më të shpejtë të qeverisë; mendohej se njohja e plotë nga ana e Italisë do të sillte me vete edhe njohjen nga ana e Anglisë⁵, çka do t'i sheshonte përfundimisht pengesat dhe do të hapte rrugën drejt zgjidhjes së plotë të çështjes së njohjes së Qeverisë së re.⁶

1) AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 140.

2) P. Pastorelli *rep. cit.*, p. 37

3) AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 140.

4) AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 140, f. 30.

5) *Po aty.*

6) Është për të vënë në dukje edhe arsyetimi që bëhej për t'iu përgjigjur vërejtjeve që vinin nga anë të ndryshme se pengesa kryesore për njohjen e Qeverisë ishte se ajo kishte ardhur në fuqi «me revolucion» dhe si e tillë nuk mund të njihet. Përmendej grushti i shtetit në Bullgari një vit më parë (qershor, 1923), që shkaktoi mijëra viktima, ndër ta edhe kryeministrin Stamboliski. «Qeveria bullgare (e ardhur në fuqi pas grushtit të shtetit), — theksohej në telegram, — u njoh vetëm 5 ditë pas revolucionit ku pati një masakër të vërtetë, duke përfshirë edhe vrasjen e kryeministrit. Kurse këtu (në Shqipëri) nuk pati as rrëmujë, as vrasje, kështu që ajo që ndodhi mund të cilësohet si një revolucion paqësor».
Po aty.

Me gjithë lëkundjet Roma nuk e la çështjen mënjanë. Ajo nuk e humbi interesin për të ndërtuar një raport të ri, të privilegjuar, me Qeverinë e re që erdhi në fuqi në Tiranë. Kjo e shtyu atë të merrte iniciativën për zgjidhjen e çështjes së njohjes në një plan ndërkombëtar sa më të gjerë, me anë të përçarjeve që u udhëzuan të bënin përfaqësuesit diplomatikë italianë në kryeqytetet e mëdha: Londër, Paris, Uashington si dhe në Beograd.¹

Refuzimi Jugosllav

Me asnjë nga qeveritë e tjera «aleate» Italia nuk e trajtoi problemin e njohjes së Qeverisë shqiptare aq për së afërmi sa me Qeverinë jugosllave. Dhe kjo është e kuptueshme, sepse asnjë qeveri tjetër në atë kohë nuk rivalizonte me Romën në Shqipëri aq sa qeveria e Beogradit. Me gjithë përpjekjet për ta zbutur kontrastin dhe për të përruruar një fazë të re «miqësie» dhe «aleance» në marrëdhëniet midis tyre (pakti i miqësisë i janarit 1924). Italia dhe Jugosllavia u gjetën përsëri në Shqipëri në një fushë të ndeshjes së interesave të tyre ekspansioniste. Është e vërtetë se pas konsultimesh dypalëshe të dy qeveritë lëshuan me 9 qershor një deklaratë të përbashkët mbi mosndërrhyrjen në punët e brendshme të Shqipërisë.² Po kjo ishte më tepër shprehje e mosbesimit sesa e bashkëpunimit midis tyre. Gjatë traktativave rreth njohjes së Qeverisë së re shqiptare dolën prova të reja të kontraktave italo-jugosllave.

Qeveria jugosllave mbajti që në fillim një qëndrim krejt të kundërt. Kjo u duk që në ditët e para pas shkëmbimit të telegrameve midis Nolit dhe Pashiçit. Noli i njoftoi formimin e Qeverisë së re. Pashiçi iu përgjigj. Por fjalët e shtrënguara dhe toni i thatë i përgjigjes së tij³ jepnin të kuptohet se në Beograd nuk i shikonin aspak me sy të mirë ngjarjet e qershorit në Shqipëri. Qeveria jugosllave jo vetëm që nuk ishte gati të bënte njohjen e Qeverisë së re shqiptare, por ishte e vendosur ta pengonte me çdo mjet konsolidimin

1) Shih: *DDI, vol. III, d. nr. 322, p. 188, shën. 3 e d. 305, p. 179.*

2) Shih më poshtë.

3) Nga njoftimi i Zyrës së Shtypit pranë Ministrisë së Jashtme. *AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 136.*

e pozitës së saj, si brenda vendit, ashtu edhe në arenën ndër-kombëtare.

Ministri i Jashtëm jugosllav Ninçiç, në bisedimin që pati me të ngarkuarin me punë të Italisë Sola, më 22 qershor, tha se «ai e shikon me vend ta mbajë pezull njohjen derisa pozita e tanishme e Qeverisë shqiptare të jetë forcuar» dhe se, përveç kësaj, «ai pret të shikojë se cili do të jetë qëndrimi i Fan Nolit kundrejt çetave të zakonshme të cilat në të kaluarën kanë nxjerrë telashe».¹ Vërejtjes së përfaqësuesit italian se nuk do të ishte mirë sikur qeveritë e tjera ta njihnin më parë Qeverinë e Nolit, Ninçiçi iu përgjigj duke thënë se nga informatat që kishte nuk rezultonte që Franca dhe Anglia të tregonin për këtë ndonjë nxitim të madh.²

Nuk bëri efekt te Ninçiçi as paralajmërimi që i ngarkuari italian Sola i bëri nja dy ditë më vonë se Italia mund ta njihnte Qeverinë shqiptare në mënyrë të njëanshme: ai (Ninçiçi) tha se nuk kishte kundërshtim që njohja nga ana e Italisë t'i paraprinte asaj jugosllave.³ Por që qeveria e Beogradit ishte e vendosur të mos e bënte këtë njohje, një tregues i tërthortë ishte bisedimi i dytë i Ninçiçit me Solën më 25 qershor, atëherë kur ministri jugosllav tha se «sipas mendimit të tij, gjendja në Shqipëri nuk do të rregullohet shumë shpejt, prandaj nuk është e udhës të njihen qeveritë e reja që vijnë aty në fuqi njëra pas tjetrës».⁴ Kjo del edhe më qartë nga takimi që Ninçiçi pati më 9 korrik me Bodron, ministër titullar i legatës italiane në Beograd, takim gjatë të cilit ai shprehu mendimin se «fizionomia përfundimtare e Shqipërisë nuk do të përcaktohet aq shpejt».⁵

Zërat që u përhapën në këtë kohë për t'ia besuar «pro-

1) DDI, vol. III, d. nr. 316, p. 185. Është fjala për akuza që ngriheshin prej kohësh në shtypin jugosllav në adresë të Shqipërisë. Për të tilla akuza bëhej fjalë edhe në një raport të legatës shqiptare në Beograd që në prill. Njoftohej se qeveria jugosllave «me prapamendim këmbëngulte në pikëpamjen e saj» se në Shqipëri kishte çeta shqiptare që vepronin në bashkëpunim me çeta bullgare me qëllim «provokimi trubullimesh në tokën jugosllave». (Raport i legatës shqiptare datë 11.4.1924 në AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 283). Siç do të shihet ky do të bëhet lejtmotivi i fushatës së gjerë të drejtuar kundër Qeverisë së Nolit nga ana e Beogradit.

2) DDI, vol. III, d. nr. 336, p. 185.

3) DDI, vol. III, d. nr. 336, p. 185.

4) Po aty,

5) DDI, vol. III, d. 378,

blemin shqiptar». Lidhjes së Kombeve¹, i dhanë shkas Ninçit të përsëriste tezën e tij mbi gjendjen e brendshme kaotike në Shqipëri. «Problem shqiptar» në arenën ndërkombëtare në këtë kohë sigurisht nuk kishte. Ngjarjet e maj-qershorit ishin thjesht një çështje e brendshme. Por në disa atyre ngjyrën e një «problemi ndërkombëtar, me qëllimin e qartë që të rezervohej e drejta e një ndërhyrjeje eventuale për «paqëtimin» e gjendjes në Shqipëri, ndërhyrje që, siç u fol asokohe, mund të bëhej në kuadrin e Lidhjes së Kombeve. Ninçiçi bashkohej me gjithë qejf me idenë e ekzistencës së një problemi shqiptar, por për Lidhjen e Kombeve tha se ndërhyrja e saj nuk do të jepte rezultat, sepse do të haste në «rivalitetin e brendshëm të krerëve»². Ninçiçi e përshkruante Shqipërinë si një shtet të pastabilizuar, të brejtur nga kontradikta të brendshme dhe popullin shqiptar si të papjekur për një jetë politike normale. Kjo i duhej atij për të justifikuar jo vetëm mosnjohjen e Qeverisë së re shqiptare, por edhe mendimin që po fillonte të bënte rrugë në Beograd për të ndërhyrë me forca ushtarake.

Çështja e njohjes së Qeverisë Demokratike mund të konsiderohet e mbyllur përfundimisht në kontaktet diplomatike kur Beogradi e akuzoi drejtpërdrejt Qeverinë e Nolit për «nxitje të bandave të armatosura në kufi». Vetë mbreti i Jugosllavisë, Aleksandri, e shtroi këtë çështje në një takim pamjen e viktimës «që s'donte gjë tjetër veç të jetonte në paqe», Aleksandri kërkoi që Musolini të ndërmjetësonte në Tiranë «në mënyrë që t'i jepej fund politikës shterpe të ngacmimeve (colpi di spillo), që ndiqte Shqipëria kundrejt Jugosllavisë».³ Nga ana e tij, shtypi jugosllav i bënte jehonë politikës së qeverisë, duke hapur një fushatë në shkallë të

1) Është fjala për një propozim që u bë nga fundi i majit, në kohën e trazirave në vendin tonë, për të dërguar aty një komision të Lidhjes së Kombeve që «të rivendoste paqen në vend». U fol në fillim se propozimi kishte dalë nga Forein Ofisi, por ministri italian Duraco telegrafonte më 2 qershor se ky ishte një mendim personal që pati shprehur ministri amerikan «në një bisedë me të në Tiranë». Po aty, d. nr. 230, p. 140.

2) Po aty.

3) DDI, 7 serie, vol. III, d. nr, 420, p. 243

gjerë plot me akuza kundrejt Qeverisë së Nolit, e cila bëhej «përgjegjëse për veprimet e kaçakëve në Kosovë».¹

Musolini provoi të dilte në rolin e ndërmjetësit. Ai i dha menjëherë udhëzime përfaqësuesit të tij Marketi (Marchetti) që t'ia shtronte çështjen Nolit dhe t'i theksonte se po të vërtetoheshin akuzat jugosllave, kjo do ta vështirësonte së tepërmi aksionin diplomatik të Italisë në favor të njohjes së Qeverisë Demokratike.² Me dy përgjigjet e tij (të 1 dhe 4 gushtit) Marketi jo vetëm që i përgënjeshtroi këto pohime, por edhe denonconte «veprimtarinë këmbëngulëse të agjentëve jugosllavë për të minuar (scalzare) qeverinë e kë-tushme».³ Sidoqoftë, edhe pse të pathemelta, akuzat e këtij lloji nuk mund të mos kishin si rezultat që të mbyllej dera për çdo traktativë të mëtejshme rreth njohjes së Qeverisë Demokratike.

Këtu nuk duhen lënë pa përmendur edhe përpjekjet që bëri Qeveria e Nolit duke iu drejtuar ajo vetë drejtpërsë-drejti qeverisë së Beogradit për normalizimin e marrëdhë-nieve midis tyre. Një rast i volitshëm u paraqit në gjysmën e dytë të korrikut kur dha dorëheqjen qeveria e partisë ra-dikale të Pashiçit dhe në fuqi erdhi qeveria e re e partisë demokrate të Davidoviçit.

Ky ishte një episod në luftën e ashpër të partive e rry-mave të ndryshme që karakterizonte jetën politike të Shtetit Serbo-Kroato-Slloven pas Luftës I Botërore e sidomos në vi-tet 20 (deri në vendosjen e diktaturës ushtarake nga mbreti Aleksandër në vitin 1929). Po rritej gjithnjë e më shumë pa-kënaqësia dhe kundërshtimi ndaj metodave autoritare të Pa-shiçit, që kishte qenë e mbetej përfaqësuesi besnik i hegje-monisë serbe në bashkësinë e re jugosllave. Përkundrejt tij Davidoviçi konsiderohej si zëdhënës i rrymës liberale. U kri-jua përshtypja se ky nuk do të ishte thjesht një ndryshim roje, se qeveria e re do të bënte ndryshime si në politikën e brendshme, ashtu dhe në atë të jashtme.

Kjo e shtyu ministrin e Shqipërisë në Beograd, Ali Riza

1) Puna kishte mbërritur ato ditë deri në rrëmbimin e nënpre-
fektit të Gjakovës nga ana e kaçakëve, porse e gjithë kjo ishte pa-
sojë e qëndresës dhe e pakënaqësisë së popullsisë shqiptare kundrejt
politikës represive të Beogradit në Kosovë. AQSH, *fondi 251, v. 1924,*
d. 143.

2) DDI, 7^a serie, vol. III, d. nr. 420.

3) DDI, 7 serie, vol. III, d. nr. 421.

Kolonjën, që t'i drejtonte Ministrisë së Jashtme në Tiranë një raport të posaçëm mbi gjendjen e re të krijuar me formimin e qeverisë së Davidoviçit.¹ Ai nxitohej të shprehte bindjen se qeveria e re do t'i jepte fund politikës tradicionale të Pashiçit në çështjen shqiptare dhe se do të përruronte një politikë më realiste si ndaj Shqipërisë, ashtu edhe ndaj popullsisë shqiptare të Kosovës. Ndër anëtarët e qeverisë së re, Kolonja dallonte veçanërisht ministrin e jashtëm Marinkoviçin, të cilin e përshkruante si «një njeri të çiltër», që «ka simpati për ne», që «është për vendosjen e marrëdhënieve miqësore me Shqipërinë», siç dilte edhe nga kritikrat që ai kishte bërë disa herë në parlament në adresë të qeverisë së mëparshme.²

Menjëherë pas kësaj Ministria e Jashtme në Tiranë i jepte udhëzim ministrit shqiptar në Beograd që të kërkonte takim me ministrin e Jashtëm Marinkoviçin ose mundësisht edhe me vetë kryeministrin për t'u transmetuar, bashkë me urimet e Qeverisë shqiptare, edhe dëshirën e saj për «një politikë miqësore të çiltër e të hapur me Serbinë». Me këtë rast jepeshin sigurime se ishin marrë masa për mbikqyrjen e kufirit (me qëllim që t'u pritej rruga kalimeve të paligjshme) dhe se lajmet mbi strehimin dhe përkrahjen e «elementëve bullgarë» në Shqipëri ishin të pathemelta. Për këto arsye çdo ngurrim për njohjen e Qeverisë shqiptare nga ana e qeverisë së Beogradit «ishte i pajustificuar».³

Momenti duhet të jetë gjykuar mjaft oportun në Tiranë derisa vetë ministri i Jashtëm, S. Delvina, i dërgoi në të njëjtën kohë një telegram ministrit të ri Marinkoviç, me anën e të cilit shprehte besimin se me ardhjen në fuqi të qeverisë së re në Beograd, «marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Mbretërisë Serbo-Kroate do të hynin në fazën e miqësisë» dhe se Beogradi do ta njihte Qeverinë shqiptare.⁴ Mirëpo, përçapjeve që bëri disa herë ministri shqiptar në kryeqytetin jugosllav për një takim me Marinkoviçin, në Ministrinë e Jashtme jugosllave iu përgjigjën se «qeveria e re

1) Raport i ministrit Ali Kolonja nga Beogradi datë 28.7.1924. AQSH, f. 251, v. 1924, d. 283, f. 107.

2) Po aty, f. 207.

3) Tel. drejtuar Legatës shqiptare në Beograd nga fundi i korrikut-fillimi i gushtit (?) 1924, AQSH, f. 251, v. 1924, d. 283, f. 122.

4) AQSH, f. 251, v. 1924, d. 140.

sapo erdhi në fuqi», se ajo ka qenë vazhdimisht e zënë me punë në parlament dhe se, pra, «nuk ka pasur kohë të merret me çështjet e mbetura pezull në marrëdhëniet me Shqipërinë e veçanërisht me çështjen e njohjes së Qeverisë shqiptare».¹

Që asgjë nuk kishte ndryshuar në qëndrimin e Beogradit kundrejt Qeverisë së Nolit këtë e dëshmonte edhe një raport i gjatë që ministri A. R. Kolonja dërgonte në Tiranë afro tri javë më vonë, më 23 gusht. Duke përgënjeshtruar vetveten, ministri shqiptar shkruante këtë radhë haptazi se qeveria e Davidoviçit vazhdonte të ndiqte po atë politikë kundrejt Shqipërisë, karakteristike të së cilës ishin përpjekjet për destabilizimin e gjendjes së brendshme të vendit, mbështetja pa rezerva te elementi zogist, frika kundrejt të ashtuquajturit «irredentizëm» me çka autoritetet serbe justifikonin edhe shtypjen e popullsisë shqiptare në Kosovë, edhe qëndrimin armiqësor ndaj Shqipërisë.² Jo shumë kohë pas kësaj, në Beograd mbajtën një qëndrim të prerë: kur ministri shqiptar i paraqiti në fund të shtatorit Ministrisë së Jashtme të Jugosllavisë një notë proteste për veprimet armiqësore që organizoheshin në territorin jugosllav kundër kufirit shqiptar, Marinkoviçi as që e pranoi notën, duke thënë se qeveria e tij nuk mund të pranonte akte zyrtare nga një qeveri që nuk e njihte.³

Me riardhjen në fuqi të Pashiçit, në fillim të nëntorit, sigurisht, nuk mund të shpresohet që çështja të lëvizte nga pika ku kishte mbetur. Në këtë kohë në Jugosllavi ishte në zhvillim të plotë fushata antishqiptare jo vetëm në planin diplomatik, por edhe në atë të ndërhyrjes me armë.

Qëndrimi i qeverisë greke

Për qëndrimin e qeverisë greke në çështjen e njohjes së Qeverisë Demokratike të 1924-s nuk mund të flitet veçse mbi bazën e të dhënave të pakta dhe kontradiktore. E para

1) Raport i ministrit A.R. Kolonja datë 8.8.1929. AQSH, f. 251, v. 1924, d. 140.

2) Raport i ministrit A.R. Kolonja nga Beogradi datë 23.8.1924 AQSH, f. 251, v. 1924, d. 264.

3) Sipas një korrespondence nga Beogradi të gazetës greke «Elefteros Llogos» datë 30.9.1924 (në kopyrat e shtypit të huaj). AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 170.

që duhet shënuar është se, ashtu si për qeverinë italiane, edhe për qeverinë greke u tha në atë kohë se e njohu Qeverinë e Nolit në qershor. Kështu Ministria e Jashtme në Tiranë u telegrafonte me 24 qershor legatave shqiptare në Romë, Paris, Beograd e Athinë se «qeveria greke e njohu zyrtarisht Qeverinë shqiptare».¹ Dy fakte duket se e kanë shtyrë atë të arrijë në një konkluzion të tillë: së pari, përgjigjja që i dha përçapjes së S. Delvinës ministri grek në Shqipëri, Panurias, më 21 qershor, në të cilën ai shfaqte «kënaqësinë për marrëdhëniet që do të mbante» me Qeverinë e re, marrëdhënie për të cilat ai jepte sigurime se do të punonte që t'i bënte «sa më të përzemërta e të dobishme për të dy vendet fqinje e mike».² Së dyti, një telegram i hartuar pak a shumë me të njëjtën frymë, që Noli mori nga kryeministri grek Papanastasiu, i cili shprehte po ato sigurime «mbi miqësinë e përzemërt» të Greqisë.³

Shihet qartë se konkluzioni mbi njohjen nga ana e qeverisë greke u nxor në rrethana të ngjashme me ato që shërbyen si bazë në rastin e qeverisë italiane. Mirëpo të njëjtat arsye që u përmendën në atë rast shtrojnë disa pikëpyetje edhe për këtë pohim të dytë. Për hir të saktësisë duhet thënë se të dy rastet nuk janë krejt analoge. Ndryshimi është se ndërsa dokumentet e botuara italiane hedhin dritë të plotë mbi qëndrimin e Romës dhe tregojnë në mënyrë të pakundërshtueshme se ajo nuk arriti deri atje sa të vendoste njohjen e Qeverisë së Nolit, për qëndrimin e Athinës dokumentet që kemi nuk sjellin qartësi të mjaftueshme, prandaj ka vend për supozime. E vetmja gjë që mund të thuhet pa mëdyshje është se me të dhënat që kemi në dorë nuk provohet që qeveria greke «ta ketë njohur zyrtarisht» Qeverinë e Nolit në qershor. Dyshimet shtohen aq më tepër kur lexojmë në një raport që dërgonte ato ditë legata shqiptare e Athinës se «kryengritja shqiptare u komentua këtu me shumë bujë në shtyp» dhe se «gazetat u mbushën me artikuj, pa dyshim aspak dashamrësi».⁴

Ka disa fakte që mund të shtyjnë të mendohet se kjo

1) Njoftim i Zyrës së Shtypit, datë 24.6.1924. AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 140.

2) Po aty.

3) Po aty.

4) Raport i legatës së Athinës drejtuar Ministrisë së Jashtme në Tiranë datë 27.6.1924. AQSH, fondi 251, v. 1924.

njohje u bë ndoshta më vonë. P.sh. Ministria e Jashtme shqiptare edhe në gusht e quante si të siguruar jo vetëm njohjen nga ana e Italisë, por edhe njohjen nga ana e Greqisë.¹ Veç asaj, disa muaj më pas, në nëntor, në shtypin grek flitej për njohjen e Qeverisë shqiptare nga qeveria greke si për diçka të ditur.² Kështu, kur nga mesi i nëntorit u njoftua denoncimi nga ana jugosllave i traktatit të vjetër greko-serb të aleancës, të lidhur që në kohën e luftërave ballkanike, gazetat greke si një nga shkaqet që e shtynë Beogradin të bënte një hap të tillë qanin edhe atë që qeveria greke « ishte nxituar të njihte qeverinë shqiptare të Far. Nolit » pa u konsultuar më parë me qeverinë jugosllave.³ Të njëjtën gjë thoshte edhe i ngarkuari me punë i Shqipërisë në Athinë kur ia njoftonte ngjarjen Ministrisë së Jashtme në Tiranë.⁴

Megjithatë ka të ngjarë që kjo të jetë një përsëritje mekanike e konkluzionit të nxituar që u nxor qysh në qershor, atëherë kur u tha për herë të parë se « qeveria greke e njohu zyrtarisht qeverinë shqiptare ». Në të vërtetë është vështirë që njohja të jetë bërë në një fazë të dytë, e cila përkon me një acarim të ri në marrëdhëniet greko-shqiptare. Kontradiktat lidhur me një pjesë të kufirit (fshatrat e ish-kazasë së Korçës), që dalin në sipërfaqe me forcë të re, toni haptazi armiqësor i shtypit grek kundrejt Qeverisë demokratike shqiptare⁵, dhe më në fund ndihma që u dhanë autoritetet greke bandave të Mufit Libohovës për sulmin e tyre në drejtim të Gjirokastrës në dhjetor — të gjitha këto fakte nuk flasin, sigurisht, në favor të tezës se njohja mund të jetë bërë më vonë nga qeveria greke. Me fjalë të tjera pohimi mbi njohjen e Qeverisë së Nolit nga qeveria greke nuk gjen sot për sot një mbështetje të mjaftueshme as në dokumentet e kohës, as në fakte apo veprime konkrete.

1) Kjo del nga përmbajtja e telegramit që Sulejman Delvina i drejtoi me 31 korrik Marinkoviçit (shih më lart).

2) Sipas gazetës greke *Apogjevmatini* datë 19.11.1924.

3) Sipas gazetës greke « *Apogjevmatini* », datë 9.11.1924 (nga kupytrat e shtypit të huaj. AQSH, fondi 251, v. 1924).

4) Tel. i të ngarkuarit me punë datë 19.11.1924, AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 162.

5) Shih më poshtë.

Nga rezervat te refuzimi i qeverisë angleze

Siç mund të pritej, qeveria angleze mbajti gjithashtu një qëndrim negativ në çështjen e njohjes së Qeverisë së 1924-s. Është pohuar shpesh se Anglia nuk ka pasur ndonjëherë interesa të drejtpërdrejta në Shqipëri. Po qe se ai i referohet periudhës para Luftës I, ky pohim është përgjithësisht i drejtë, por për më vonë nuk është krejt i saktë. Në fillim të viteve 20 vihet re një vëmendje e shtuar e politikës angleze kundrejt Shqipërisë. Ky interesim e kishte bazën te vajguri shqiptar. Disa sondazhe të bëra në nëntokën shqiptare që në kohën e luftës, si nga austriakët ashtu edhe nga italianët, kishin nxjerrë në shesh gjurmë të shtresave vajgurore. E tërhequr nga këto zbulime Anglia nxitoi të përpunonte një politikë shqiptare të sajën, që kishte munguar përgjithësisht deri atëherë në Foreign Ofis. Përpjesëtimet e vërteta të këtyre burimeve nuk diheshin me saktësi, madje është fakt se ato u mbivlerësuan, ndaj edhe në fillim u zhvillua një garë midis shoqërive të huaja për vajgurin shqiptar, garë që u përqendrua shpejt midis dy kolosëve të vajgurit botëror: «Anglo-Persian» (angleze) dhe «Standard Oil» (amerikane). Në këto kushte Shqipëria pushoi së qeni për Londrën një gur i thjeshtë në lojën diplomatike. Tani ajo u bë edhe një sferë interesash të drejtpërdrejta e imediate.

Vajguri shqiptar ka qenë një nga problemet që u rrahën më shumë në parlamentin shqiptar të kohës. Në pragun e shpërthimit të krizës (sidomos prej vjeshtës së vitit 1923) ai mori një ashpërsi të veçantë dhe u kthye në një nga objektet kryesore të ballafaqimit midis forcave reaksionare të grumbulluara rreth qeverisë së Zogut dhe forcave përparimtare të opozitës. Prej marsit të vitit 1921 shoqëria angleze «Anglo-Persian» kishte lidhur me qeverinë shqiptare një kontratë që vinte praktikisht në dispozicion të plotë të saj gjithë sipërfaqen e vlefshme vajgurore të vendit që parashikohej në atë kohë (rreth 200 000 ha). Por kur u soll për miratim në Këshillin Kombëtar (në parlament) në shtator 1923, kontrata hasi në kundërshtimet e rrepta të opozitës, e cila kërkoi anulimin e saj dhe përfundimin e një kontrate të re më të favorshme me shoqëritë amerikane

«Standard Ojëll» («Standard Oil») dhe «Sinkler» (Sinclair).¹

Për këto arsye qëndrimi i Anglisë kundrejt Kryengritjes Demokratike në Shqipëri ishte i paracaktuar në një kuptim negativ. Kështu shpjegohet edhe që ministri anglez në Tiranë Aires (Eyres) i kapërceu caqet e statusit të tij diplomatik, duke u përzier aktivisht në punët e brendshme të vendit. Në fillim të qershorit ministri italian njoftonte se në ditët e krizës (në kohën kur ngjarjet rrokulliseshin me të shpejtë në disfavor të Zogut) Airesi kishte bërë «mjaft hap-tazi çdo përpjekje për të përkrahur qeverinë (e vjetër), duke e nxitur, së pari, për një shtypje të egër (të kryengritjes) dhe pastaj për një qëndresë deri në pikën e fundit».² Ministri britanik kishte ndikim tepër të madh në qarqet reaksionare, aq sa mori disa herë pjesë personalisht në mbledhjet e qeverisë në fillim të qershorit për të përcaktuar masat kundër lëvizjes kryengritëse.³ Në fund, duke parë rrokullisjen e ngjarjeve, ai provoi të dalë në rolin e «paj-tuesit» të palëve.

Në një bisedë me përfaqësuesin italian aty nga mesi i qershorit, ministri anglez e përshkruante gjendjen në Shqipëri me ngjyra shumë të zeza dhe nuk ngurronte ta quante Zogun si të vetmen garanci të stabilitetit politik të vendit. Pas dëbimit të tij, ai shikonte vetëm një rrugë: të zgjidhej «problemi shqiptar përsëri në një plan ndërkombëtar». Për këtë ai ftonte Fuqitë «të bëjnë një sakrificë ashtu si në 1913-1914» dhe «t'i japin një hua e cila të kontrollohet nga njerëz kompetentë e të ndershëm». Por meqenëse Shqipëria vetë, sipas Airesit, «nuk ka njerëz të tillë», shtetet e tjera «neutrale» (si p.sh. Danimarka) mund të thirreshin edhe një herë në ndihmë.⁴

Kuptohet se me paragjykime të tilla, Forein Ofisi nuk kishte si t'i përgjigjej pozitivisht kërkesës së Nolit për njohjen. Në kontaktin e parë që ministri shqiptar Mehmet Konica pati në Londër tha se «pritej mendimi i përfaqësuesit

1) Shih: «Bisedimet e Këshillit Kombëtar»: Legjislatura e parë. Sesioni IV. Mbledhje e 25 shtatorit 1923. f. 1509-1533. Për origjinën dhe zhvillimet që pati problemi i vajgurit shqiptar shih V. Toçi. «Ndërrhyrja e kapitalit të huaj në Shqipëri dhe qëndrimi i qarqeve demokratike 1921-1925», Tiranë, 1974. (Kap. I).

2) DDI, vol. III, d. nr. 243, p. 146

3) *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike II — 1972, f. 163 Artikulli i përmendur i Zh. Avramovskit.

4) DDI, vol. III, d. nr. 262.

anglez në Shqipëri» (domethënë i Airesit). Dhe aty për aty i bënë vërejtjen mbi përbërjen e qeverisë së re, duke shfaqur njëfarë moskënaqësie «për zotin Gurakuqi», për shkak të atyre që quheshin «ndjenja të tij italofile». ¹ Ndërkaq Airesi vetë u kthye në Londër dhe duket qartë se mendimet e tij patën ndikimin e tyre.

Një raport i dytë i ministrit M. Konica, i dërguar disa ditë më vonë, ndryshonte si në ton, ashtu dhe në përmbajtje. Ai thoshte se «Guverna britanike ka si princip të mos njohë menjëherë guvernat që vijnë në fuqi me violencë dhe fjalët tona nuk e ndërrojnë dot këtë princip». ² Ai shtonte se për këtë Londra ishte marrë vesh edhe me Parisin. Në fund të qershorit Forein Ofisi e njoftonte legatën angleze në Tiranë: duke qenë se «Qeveria e tanishme shqiptare kishte ardhur në fuqi me forcë», ai (Forein Ofisi) «nuk kishte ndërmend të largohej nga qëndrimi i tij tradicional». ³

Në të vërtetë Ministria e Jashtme britanike i nxirrte konkluzionet e saj nga raportet e përfaqësuesve të saj në vend. Pas largimit të përkohshëm të Airesit, i ngarkuari anglez me punë Parr (Robert Parr) nuk mbetej prapa titullarit të tij për nga fryma armiqësore e komenteve rreth Kryengritjes dhe qeverisë së re. Shpallja e programit të Qeverisë më 17 qershor i dha atij shkas t'i raportonte qendrës me një ton alarmant se «Qeveria e re kishte ndër mend të nxirrte përpara gjyqit eksponentët e regjimit të rrëzuar dhe t'i dënonte edhe me konfiskimin e pasurisë». Sidomos mundësia e konfiskimit të pasurisë u mor në Forein Ofis si një tregues shqetësues i karakterit revolucionar «ekstremist» të lëvizjes kryengritëse dhe qeverisë së dalë prej saj. ⁴ Nga kjo në Ministrinë e Jashtme britanike u përforcua qëndrimi i refuzimit kategorik për t'i akorduar njohjen Qeverisë

1) Raport i Mehmet Konicës drejtuar Sulejman Delvinës, datë 19.6.1924 në AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 136.*

2) Raport i Mehmet Konicës drejtuar Sulejman Delvinës, datë 26.6.1924 në AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 140.*

3) Sipas telegramit që legata italiane i drejtonte qendrës më 30.6.1924 (Nga arkivi sekret i ish-legatës italiane, në AQSH).

4) Tel. i të ngarkuarit me punë Parr nga Durrësi datë 23.6.1924 dhe shënimi i Mc. Even-it, *PRO/371, File n° 9639.* Autorit të këtij punimi i është dhënë mundësia të konsultojë fotokopjet e dokumenteve të Forein Ofisit në Arkivin krahinor të Kosovës në Prishtinë, në shkurt 1981. Veç asaj, një artikull mbi qëndrimin e Anglisë kundrejt Kryengritjes së 1924-s dhe Qeverisë së Nolit është botuar në revistën «*Gjurmime albanologjike*». *Seria e studimeve hi-*

së Nolit. Këtë qëndrim ajo ia bëri të ditur edhe legatës së saj në Tiranë.

Në lidhje me këtë një interes të veçantë paraqet biseda që është zhvilluar javën e parë të korrikut midis përfaqësuesit të Ministrisë së Jashtme Xhafer Vila¹ dhe të ngarkuarit me punë a.i. Parr. me kërkesë të këtij të fundit. Aty përfaqësuesi britanik shfaqti hapur pakënaqësinë e qeverisë së tij për lajmin e krijimit të një gjyqi politik, i cili do të ngarkohej me detyrë që të vinte përpara përgjegjësisë eksponentët e klikës zogiste si shkaktarë të vëllavrasjes dhe si shkelës të interesave kombëtare. Parri tha se «qeveria angleze e kishte vështirë të kuptonte nevojën e formimit të një gjyqi politik me kompetenca të gjera për të gjykuar persona të cilët janë përpjekur të mbrojnë legalitetin kundër revolucionarëve».² Duke vazhduar me të njëjtin ton mospërfillës e kërcënues ai nuk ngurroi ta quante Fan Nolin «njeri me kulturë dhe me edukatë», «vegël të elementëve ekstremistë që nuk janë në gjendje të kuptojnë rreziqet që rrethojnë Shqipërinë».³ Përballë këtyre pohimeve nuk mund të kishin asnjë kuptim fjalët se Londra «hëpërhë» nuk do ta njihte Qeverinë Demokratike, se ajo «do të priste» derisa kjo të forconte pozitën e saj e të realizonte «pajtimin, marrëveshjen (concorde) kombëtare».⁴ Shihej qartë se çështjen e njohjes, qeveria e Londrës po e përdorte dhe do ta për-

storike II/1972 na studiuesi jugosllav Zh. Avramovski. Pa mohuar anën faktike (dokumentet e përdorura janë po ato), artikulli e kalon krejt në heshtje politikën intervencioniste të qeverisë jugosllave.

1) Fakti që njerëz si Xh. Vila vazhdonin të mbeteshin në poste kyçe, megjithëse njiheshin për bindjet e tyre reaksionare dhe synimet karrieriste, ishte një shprehje e pavendosmërisë së Qeverisë së Nolit, e cila nuk mori asnjë masë për spastrimin e aparatit shtetëror pas fitores së qershorit. Ky ka qenë pa dyshim edhe një nga faktorët e brendshëm kryesorë të dobësisë të ndikimit dhe rënies së Qeverisë demokratike.

2) Raport mbi bisedën me Parr-in datë 5.7.1924. AQSH, fondi 251, v. 192, d. 140.

3) Po aty.

4) Po aty. Për mënyrën se si i konceptonin përfaqësuesit anglezë marrëdhëniet me Qeverinë shqiptare mjaft domethënëse janë edhe dy çështje që ngriti Parri gjatë bisedës së lartpërmendur. Së pari, ai u interesua për kontratën e kolonelit Sterling si: «organizator i xhandarmërisë» dhe pasi mori fjalën se qeveria e re nuk kishte ndër mend ta anulonte atë (kontratën), paraqiti aty për aty kërkesën e zonjës Sterling «e cila është e sëmurë dhe i është lutur telegrafisht që të ndërmyetesojë pranë qeverisë shqiptare për pagi-

dorte gjithnjë më fort si një mjet presioni për ta detyruar Qeverinë e Nolit që të kapitullonte. Kështu, megjithëse Foreign Ofisi nuk dha asnjëherë një refuzim të prerë, çështja e njohjes nga ana e qeverisë britanike mbeti që në korrik në një pikë të vdekur nga e cila nuk lëvizti më.

Megjithatë, kjo nuk e prapësoi Qeverinë e Nolit në përpjekjet për të siguruar njohjen nga ana e Anglisë. Kuptohet se një qëndrim pozitiv i Londrës nuk kishte vetëm rëndësi në vetvete, por edhe shpresohej se do të zhbllokonte situatën edhe në raport me qeveritë e tjera, që i përcaktounin veprimet e tyre në raste të këtij lloji në përshtatje me ato të Foreign Ofisit.

Kjo ishte arsyeja që Noli kërkoi vetë një takim me Parrin dhe ka të ngjarë që biseda të jetë bërë të nesërmen e asaj dite që i ngarkuari me punë anglez pati me Xh. Vilën. Në dokumentet e Ministrisë së Jashtme të kohës nuk u gjetën gjurmë të kësaj bisede. Disa të dhëna mbi përmbajtjen e saj mund të nxirren nga raporti që Parri i drejtoi Foreign Ofisit më 7 korrik.¹ Nga ky raport shihet se Noli bëri përpjekje për ta ndryshuar mendimin e përfaqësuesit anglez mbi qeverinë e re, me shpresë se ai mund të ndikonte pozitivisht edhe në qëndrimin e qeverisë së tij. Krijohet përshtypja që Noli kishte besim se Parri mund ta gjykonte situatën e re në Shqipëri në mënyrë më objektive sesa titullari i legatës, Airesi, i cili kishte marrë haptazi anën e forcave reaksionare. Noli provoi ta çante murin e heshtjes e të mosbesimit të qeverisë së Londrës duke dhënë disa sigurime që shkonin mjaft larg, që shmangeshin edhe nga vetë programi i porsashpallur i Qeverisë Demokratike. Ai tha se Qeveria e re do ta ratifikonte koncesionin vajguror në favor të shoqërisë «Anglo-Persian». Kurse për gjyqet politike ai u mundua ta qetësonte bashkëbiseduesin e tij, duke thënë se kjo pikë e programit kishte vetëm një kuptim deklarativ dhe nuk do të gjente zbatim në praktikë. Por nga raporti i përfaqësuesit britanik del se Noli nuk arriti asnjë rezultat. Përkundrazi. Parri dhe pas tij edhe Foreign Ofisi e përforcuan edhe më bindjen se pozita e Qeverisë së re shqiptare ishte e lëkundur dhe e pasigurt.¹

min e tri rrogave të kolonelit». Së fundi, Parri pyeti se ç'mendim kishte qeveria për librat anglisht që ndodheshin në bibliotekën e Ahmet Zogut dhe nuk ngurroi të kërkonte që t'i kishte në legatën e tij «meqë janë libra mbi literaturën angleze».

1) Raport i të ngarkuarit me punë Parr nga Durrësi, datë 7.7.1924, PRO—FO/371, File nr. 9640.

Një moment me interes në aksionin e Qeverisë Demokratike për të siguruar njohjen nga qeveria britanike është edhe përçapja që u bë pranë vetë kryeministrit Makdonald, i cili njëkohësisht kryente edhe funksionet e sekretarit për punët e jashtme. Ky ishte i pari kryeministër laburist që vinte në fuqi në historinë e Anglisë. Ai u vu në krye të qeverisë pas fitores së partisë laburiste në zgjedhjet parlamentare që u zhvilluan në janar të atij viti. Noli e quajti me vend që të bëheshin përçapje të posaçme pranë qeverisë laburiste, e cila teorikisht duhej të ishte në pozita më të majta, më përparimtare sesa qeveria e mëparshme konservatore dhe rrjedhimisht duhej të tregonte një predispozicion më të madh edhe për njohjen e qeverisë së re shqiptare, si një qeveri me orientim antifeudal. Duket qartë që Noli mendonte se mund të bënte njëfarë efekti pranë qeverisë së Londrës dhe kryeministrit të saj, duke e përshkruar qeverinë e tij si një qeveri radikale të impenjuar në një luftë të vendosur kundër elementit më retrograd të shoqërisë shqiptare.

Sidoqoftë, në fillim të korrikut, ministri shqiptar në Londër, M. Konica, mori udhëzim që të kërkonte një takim me kryeministrin Makdonald për t'i transmetuar këtij një mesazh të Nolit. Siç mund të parashikohet, Makdonaldi ishte «tepër i zënë me punë» dhe përfaqësuesit shqiptar iu kërkua që ta jepte me shkrim mesazhin.¹ Këtë M. Konica e bëri me një letër që i drejtoi kryeministrit më 14 korrik.²

Para së gjithash, në tërë letrën bie në sy toni i përmbajtur, i vendosur: qeveria e re shqiptare nuk lutej, por e kërkonte njohjen nga qeveria britanike në emër të disa objektivave e idealeve, të cilat nuk duhej të ishin të huaja për një qeveri që e quante veten «socialiste». Lidhur me këtë denoncohej qëndrimi i «përfaqësuesit të madhërisë së tij në Tiranë» (është fjala për Airesin), i cili ishte implikuar haptazi në ngjarjet e qershorit duke përkratur qeverinë e mëparshme dhe, si i tillë, nuk mund të ishte në gjendje të gjykonte objektivisht sjelljen dhe veprimet e qeverisë së re shqiptare.³ Prandaj qeveria britanike nuk mund

1) Përgjigje e Foreign Ofisit datë 10.7.1924. AQSH. *fondi 251, v. 1924, d. 140.*

2) Letër e M. Konicës drejtuar kryeministrit Makdonald. datë 14.7.1924 në AQSH. *fondi 251, v. 1924, d. 140;* i njëjti dokument në origjinal është gjetur në arkivat britanike, PRO—FO/371, *File 9640.*

3) Qëndrimi i Aires-it, sjellja e tij aspak diplomatike, para dhe gjatë kryengritjes, duhet të kenë shkaktuar një reagim të fortë në të gjithë opinionin e vendit, përderisa që të nesërmen e formimit të qeverisë së re ai u cilësua si «persona non grata» (person i padëshirueshëm), çka donte të thoshte se ai nuk mund t'i kryente

dhe nuk duhej ta trajtonte çështjen e njohjes së Qeverisë së re shqiptare duke u nisur nga vlerësimet e Airesit që nuk mund të ishin veçse negative. Në vazhdim theksohej rëndësia e posaçme që i jepej në Tiranë njohjes nga Britania e Madhe dhe, sigurisht, ajo mbivlerësohej kur thuhej se «ajo do të ndikonte drejtpërsëdrejti në zbatimin e reformave ekonomike e sociale që përbënin bazën e programit» të Qeverisë Demokratike. Shtuhej aty për aty se «mosnjohja e Qeverisë së re do të shërbente si një armë e rrezikshme në duart e feudalëve të dëbuar dhe një inkurajim për ta për t'u rikthyer në pushtet».

Të gjitha këto e shtynin kryeministrin shqiptar që t'i bënte thirrje qeverisë *socialiste* britanike t'i jepte atij përkrahje ose të paktën të mos i nxirrte pengesa në luftën kundër armiqve të popullit». ¹ Do të vihet re se Noli nuk e quante qeverinë britanike as me emrin zyrtar të partisë *laburiste*, por parapëlqente ta quante drejtpërdrejt *socialiste*, ndaj edhe e mbyllte mesazhin duke thënë se «populli shqiptar e ka vështirë të kuptojë si është e mundur që Qeveria Demokratike Shqiptare të njihet nga Italia dhe Greqia dhe të mos njihet nga qeveria socialiste britanike». ² Kuptohet, në këtë mes nuk ka aq rëndësi pasaktësia lidhur me njohjen nga ana e Italisë dhe e Greqisë, ³ sesa këmbëngulja me të cilën Noli i drejtohet «socializmit» të qeverisë *laburiste*; kjo sipas tij duhej ta detyronte këtë të fundit sadopak për njohjen e një qeverie, që i kishte vënë vetes si detyrë përtëritjen e shoqërisë shqiptare mbi baza demokratike.

Mirëpo, hesape të gabuara dhe shpresa të kota! Makdonaldi nuk u prek fare në ndërgjegjen e tij «socialiste». Ai jo vetëm që nuk e pranoi në takim përfaqësuesin shqiptar, por me përgjigjen e tij preu përfundimisht rrugën për çfarëdo përçapje të mëtejshme për njohjen e Qeverisë Demokratike.

më funksionet e përfaqësuesit diplomatik të Britanisë së Madhe në Shqipëri. Në dokumentet e Ministrisë së Jashtme të kohës është gjetur teksti i telegramit që vetë Noli shkroi me dorë të tij për t'ia dërguar më 18 qershor legatës në Londër. Telegrami, që shënon prishjen me ministrin britanik, kishte këtë përmbajtje: «Siellja e ministrit britanik Eyres gjatë revolucionit është tepër jo korekte. Ne kemi prova se ai ka nxitur qeveritë feudale së pari për t'i shtypur revolucionarët, pastaj për të rezistuar deri në fund. Me qenë se ka humbur cdo simpati, ai nuk është më personi më i përshtatshëm për zhvillimin e marrëdhënieve miqësore midis dy vendeve». AQSH, fondi 251, viti 1924. d. 198.

1) AQSH, fondi 251, d. 198, viti 1944.

2) Po aty.

3) Shih më lart.

Ai shkruante se qeveria britanike vinte si kusht paraprak «një shprehje të qartë të vullnetit kombëtar që të tregojë se Qeveria e re pëlqehet nga shumica e vendit» kurse «informatat që ajo kishte në dorë» nuk tregonin se ajo (qeveria e re) e plotësonte këtë kusht.¹ Në përputhje me këtë edhe i ngarkuari me punë Parr kishte marrë udhëzime të jepte të njëjtën përgjigje në Tiranë; kështu ai ishte i autorizuar «të trajtonte vetëm çështje korrente rutinë» me autoritetet shqiptare.² Është për të vënë në dukje se kryeministri britanik e mbyllte përgjigjen e tij me një provë force. Në Foreign Ofis duket që e gjykonin se në letrën e tij të 14 korrikut përfaqësuesi shqiptar kishte guxuar tepër kur kishte formuluar «disa vërejtje serioze në adresë të ministrit të Madhërisë së tij» në Shqipëri (Airesit). Këtë Makdonaldi e cilësonte jashtë rregullave, të papranueshme, prandaj letra i kthehej mbrapsht legatës shqiptare.³ Ky gjest, kuptohet donte të thoshte se pritej çdo urë me Qeverinë e Nolit.

Një fakt tjetër që pason vendimin tanimë të prerë të Londrës për ta mbyllur çështjen e njohjes së qeverisë «revolucionare» shqiptare është edhe afishimi nga ana e Foreign Ofisit, i «çinteresimit» të Britanisë së Madhe në punët e Shqipërisë. Kjo vihet re sidomos në rastin e disa sondazheve që bëhen nga ana italiane për të arritur sadopak në një qëndrim të koordinuar të kancelerive të mëdha në çështjen e njohjes së Qeverisë së Nolit. Më 10 korrik ambasadori italian në Londër, Torretta, i shkruante Musolinit: «Kohët e fundit duket se Foreign Ofisi interesohet shumë pak për Shqipërinë. Këtë përshtypje e kam fituar nga shkëmbimi i mendimeve me funksionarët e zyrës kompetente: kam po ashtu përshtypjen se qeveria britanike njeh pozitën tonë të veçantë dhe interesat tona të veçanta në Shqipëri».⁴

Duke e lënë për një çast mënjanë çështjen e njohjes së Qeverisë së Nolit, mund të thuhet se ka të ngjarë që njohja e «pozitës dhe interesave të veçanta» të Italisë në Shqipëri të pasqyrojë një moment të ri në politikën angleze të kësaj periudhe. Sigurisht, njohja e interesave të posaçme italiane në vendin tonë kishte një precedent fare të afërt: Deklaratën e nëntorit të vitit 1921 të Konferencës së Ambasadorëve që mbante edhe firmën e Anglisë. Mirëpo, në rrethanat e vitit

1) Përgjigje e Makdonaldit, datë 30.7.1924 në AQSH. Fondi 251, d. 198, viti 1924, origjinali në PRO—FO/371. File nr. 9640.

2) Po aty.

3) AQSH. Fondi 251, d. 198, viti 1924, origjinali ë PRO—FO/371.

4) Tel. i ambasadorit Torretta, datë 10.7.1924, DDI, 7a serie, vol. III, d. 381, p. 215.

1924, ajo ishte e destinuar të merrte një kuptim të ri. Ajo ishte një shprehje e afrimit anglo-italian në shkallë evropiane, afrim që arriti kulmin nga fundi i vitit 1925 kur Anglia e thirri Italinë si fuqi të dytë garante në Traktatin e Lokarnos.¹ Edhe ngjarjet e mëvonshme në Shqipëri do të mbajnë deri diku vulën e këtij afrimi: depërtimi i hovshëm italian pas rikthimit të Zogut dhe sanksionimi i tij me Paktin e Tiranës të vitit 1926 do të jenë arritje relativisht të lehta për Italinë fashiste pikërisht sepse do të kryhen nën hijen e diplomacisë angleze.

Qëndrimi i qeverisë amerikane

Ashtu si pritej kundërshtimi i qeverisë angleze kundrejt Qeverisë së Nolit, ashtu mund të shpresohet në një përkrahje të saj nga ana e Qeverisë amerikane.² Të paktën

1) Në Konferencën e Lokarnos, që u mbajt në tetor 1925, u përfunduan disa traktate, më i rëndësishmi i të cilëve ishte ai që parashikonte paprekshmërinë e kufijve të vendosur pas Luftës I midis Francës e Gjermanisë dhe midis Belgjikës e Gjermanisë. Pikërisht në këtë traktat doli si garante Anglia, me të cilën u bashkua edhe Italia si garante e dytë. Po ashtu, në Konferencën e Lokarnos u arrit marrëveshja për hyrjen e Gjermanisë në Lidhjen e Kombeve me të drejtën e saj për të zënë një vend të përhershëm në Këshillin e Lidhjes, gjë që e rimëkëmbte Gjermaninë në rangun e fuqisë së madhe pas disfatës në Luftën I. *Shih Istorija diplomatii (bot. rus:), t. III, Moskva 1945, ss. 326-333; J.B. Duroselle, Histoire diplomatique de 1919 à nos jours, Paris 1966, pp. 94-96.*

2) Ishte kjo e dyta herë, në më pak se dy vjet, që çështja e njohjes i dilte Departamentit të Shtetit të SHBA në raport me Shqipërinë. Të parën herë iu shtrua si çështje e njohjes së shtetit shqiptar, sepse, ndër fuqitë e mëdha kapitaliste, SHBA e trajtuan këtë problem vetëm pas mbarimit të Luftës I Botërore. Si pikënisje shërbeu një notë e Ministrisë së Jashtme shqiptare e fundit të janarit 1922. Iniciativa për këtë ishte përsëri e Fan Nolit (në atë kohë ministër i Jashtëm në kabinetin e Xhafer Ypit), i cili ia drejtoi kërkesën për njohje sekretarit të shtetit Juz (Hughes). (Notë e ministrit të Jashtëm, F. Nolit, drejtuar sekretarit të shtetit Juz (Hughes) datë 28.1.1922 në Hackworth, T. H., *Digest of International Law, Washington 1940, vol. I, f. 196*). Por kjo nuk ishte një përçapje e vecuar. Ajo bënte pjesë në vargun e përçapjeve që pati ndërmarrë atëherë Ministria e Jashtme shqiptare për të siguruar njohjen nga ana e të gjitha qeverive të huaja, në një kohë kur pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve si dhe Deklarata e nëntorit 1921 patën sheshuar përfundimisht terrenin për zgjidhjen pozitive të kësaj çështjeje. Nota kishte përmbajtje të njëjtë, me atë të notave drejtuar qeverive të tjera. (Notë e qeverisë shqiptare drejtuar qeverive të huaja dt. 28.1.1922. Kopja frëngjisht në AQSH, *fondi 251, d. 38, viti 1922*.) Në notën drejtuar sekretarit të shtetit Juz, ftohej veça-

një qëndrim afrues nga ana e saj, për arsytet që u përmendën më lart, nuk ishte për t'u përjashtuar, kurse në të vërtetë nuk ndodhi as njëra as tjetra.

nërisht qeveria amerikane që të ndiqte shembullin e katër fuqive: Britanisë së Madhe, Francës, Italisë dhe Japonisë, nënshkruese të Deklaratës së nëntorit 1921, dhe «ta njihje qeverinë shqiptare si qeveri *de jure* të shtetit shqiptar» (*Hackworth, T.H., vep. cit., p. 196*), Trajtimi që iu bë kësaj çështjeje nga Departamenti i Shtetit ia vlen të njihet, goftë edhe në vija të trasha, sepse kjo shënon fillimin e marrëdhënieve zyrtare midis Shqipërisë dhe SHBA.

Pasi mori notën e Qeverisë Shqiptare, Departamenti i Shtetit i dha rrugë procedurës së zakonshme: atij iu deshën plot 6 muaj (prej fundit të janarit e deri në fund të korrikut) «për të mbledhur informata» nëpërmjet përfaqësive të tij në shtetet e tjera, përpara se të merrte një vendim përfundimtar. Hapi i parë u bë aty nga java e fundit e prillit kur iu kërkua ambasadorit të SHBA në Itali që të njoftonte se cilat ishin ato shtete që kishin dërguar përfaqësues në Shqipëri. (Tel i Departamentit të Shtetit datë 24.4.1922. *Hackworth T. H., vep. cit., p. 196*). Në përgjigjen që ktheu pas pak ditësh ambasadori amerikan thoshte se Anglia dhe Italia kishin dërguar përfaqësues diplomatikë në rangun e ministrave fuqiplotë se Franca ishte e përfaqësuar vetëm me anë të një konsulli, ndërsa Japonia nuk kishte fare përfaqësues. Midis shteteve të tjera që i kishin akorduar njohjen *de jure* ishin edhe Finlanda, Zvicra, Belgjika dhe Jugosllavia kishte një të ngarkuar me punë (Tel. i ambasadorit të SHBA në Romë datë 27.4.1922. *Po aty*).

Pas kësaj Departamenti i Shtetit vendosi të dërgonte një njeri të vetin posaçërisht në Shqipëri «për të studiuar gjendjen në vend». Me këtë detyrë u ngarkua konsulli i përgjithshëm amerikan në Tangjer M. Blejk (M. Blake). Në udhëzimet që iu dhanë, së pari me telegraf (më 27 prill) dhe pastaj më hollësisht me letër (më 9 maj), konsullit Blejk i kërkohet që t'i kushtonte kujdes të veçantë qëndrimit të administratës shqiptare kundrejt mbrojtjes së interesave amerikane dhe veçanërisht «sa ishte e disponuar ajo për t'u akorduar SHBA trajtimin e kombit më të favorizuar» në këmbimet tregtare. (Letër e Departamentit të Shtetit konsullit Blake datë 9.5.1922. *Hackworth, vep. cit., p. 197*).

Në vijim të letrës «interesat amerikane» në Shqipëri qofshin këto aktuale, të momentit, apo më të largëta, të perspektivës, theksohen me aq forcë saqë tingëllojnë si një kusht paraprak për njohjen e Shqipërisë nga ana e qeverisë së SHBA. Për përmbajtjen e udhëzimeve të Departamentit të Shtetit mund të krijohet një ide sidomos nga këto pak rreshta me të cilat mbyllet letra: «Arsveja kryesore që është në favor të një njohjeje të shpejtë nga ana jonë. — thuhet aty. është se një gjë e tillë mund t'u vinte përdore interesave amerikane ekonomike dhe filantropike ekzistuese apo të ardhshme të shtetasve amerikanë në Shqipëri. Prandaj jeni të ngarkuar të bëni një studim të kujdesshëm të interesave që mund të ekzistojnë tani dhe t'i njoftoni Departamentit... mundësitë konkrete ekonomike ose të tjera që janë hapur përpara shtetasve amerikanë, ose që mund të hapen përpara tyre me njohjen e Shqipërisë nga Shtetet e Bashkuara» (*Po aty*).

Blejk erdhi në të vërtetë në Shqipëri dhe pati disa kontakte

Menjëherë pas shpalljes së formimit të Qeverisë së re në Tiranë, ministri i SHBA Grant-Smith¹ filloi të shtronte pro-

edhe me autoritetet shqiptare të kohës, gjurmët e të cilëve i gjejmë edhe në disa dokumente të shkëputura të korrespondencës së zhvilluar prej tij me Ministrinë e Jashtme në Tiranë. (Shih dosjen «Njohja e shtetit shqiptar dhe e qeverisë shqiptare» në AQSH, *fondi 251, d. 99, viti 1922.*)

Raportin mbi misionin e tij Blejk ia dërgoi qendrës në fund të qershorit (Raport i Blake datë 28.6.1922 drejtuar Departamentit të Shtetit, *Hackworth, vep. cit., pp. 187-188*). Pasi bënte një hyrje të vogël, në të cilën vinte në dukje konsolidimin e pozitave të shtetit shqiptar si brenda ashtu edhe jashtë, ai i rekomandonte Departamentit të Shtetit që të mos e vononte më njohjen e Shqipërisë nga ana e SHBA. Duke iu përmbajtur pikë për pikë udhëzimeve që iu dhanë përpara nisjes së tij për në Shqipëri, Blejk e mbështeste konkluzionin e tij jo vetëm në faktorë politikë, por edhe në «materiale konkrete». Vendi. — thoshte ai, — ka perspektiva tregtare të rëndësishme, si dhe burime natyrore të pasura që presin të zhvillohen. Prandaj qeveria amerikane nuk duhej të qëndronte e mënjanuar «nga pikëpamja zyrtare» (e njohjes), përndryshe «një politikë zvarritjeje apo maturie të tepruar» mund të cenonte si «iniciativat e ligjshme amerikane» (këto do të ndodheshin në disavantazh në raport me ato të tjerëve), ashtu edhe «prestigjin amerikan». Blejk rekomandonte që të veprimej sa më shpejt, aq më tepër që «Parlamenti shqiptar që duhej të mblidhej në fillim të shtatorit pritej të merrte në shqyrtim masa të rëndësishme për zhvillimin e vendit». Fjala ishte, sigurisht, për koncesionet ekonomike, e sidomos për ato vajguore. Prandaj Blejk e përfundonte raportin, duke rekomanduar që të njihej Shqipëria dhe me atë rast të hapej një legatë e SHBA me një ministër fuqplotë në krye (*Po aty, p. 188*).

Nga fundi i korrikut Departamenti i Shtetit e njoftonte Blejkun për rishikimin e qëndrimit të vet në këtë çështje në bazë të të dhënave të mësipërme (deri atëherë gjendja e shtetit shqiptar ishte konsideruar e pastabilizuar si nga pikëpamja e brendshme, ashtu edhe nga ajo e jashtme), ndaj e udhëzonte atë që t'i drejtohej me një notë Ministrisë së Jashtme shqiptare, me anën e së cilës do t'i komunikonte «njohjen *de jure* të Shqipërisë nga ana e SHBA». (Tel. i sekretarit Hughes. *Po aty.*) Njohja duhej të shtrihej edhe në qeverinë shqiptare përderisa Blejku u ngarkua të deklaronte se qeveria amerikane «merrte shënim për konsolidimin me sukses të qeverisë kombëtare shqiptare» (*Po aty*).

Njoftimi zyrtar që iu dërgua qeverisë shqiptare mbi njohjen nga ana e SHBA dhe mbi caktimin e vetë Blejkut si ministër i SHBA në Tiranë mbante datën 28 korrik 1922. (*AQSH, fondi 251, d. 38, viti 1922*). Kështu Shqipëria njihej si shtet i pavarur nga ana e SHBA 10 vjet pas Shpalljes së Pavarësisë. Kuptohet se më 1924 çështja e njohjes tanimë edhe për qeverinë amerikane, sikurse edhe për qeveritë e tjera, shtrohej në një trajtë tjetër, në trajtën e njohjes së një qeverie të ardhur në fuqi me rrugë kryengritëse, jo më të njohjes së shtetit shqiptar.

1) Nuk rezulton që M. Blejk të ketë filluar nga detyra si ministër i SHBA në Tiranë. Sidoqoftë në vitin 1924 në këtë post gjejmë

bleme me karakter juridiko-formal, nën prizmin e së drejtës kushtetuese të vendit. Ai nuk ishte i sigurt nëse formimi i qeverisë së re ishte «i ligjshëm», nëse ndryshimi i përshtatej kushtetutës. Ai thoshte në mënyrë të veçantë se i dukej «fort e dyshimtë që regjenti i vetëm që kishte mbetur, S. Peci, të kishte të drejtën ligjërisht të autorizonte formimin e një qeverie...». Bashkë me këto dyshime të tij, përfaqësuesi amerikan i njoftonte Departamentit të Shtetit më 19 qershor se ai vetë nuk do të bënte asnjë veprim që të mund të interpretohej si njohje.¹

Në një njoftim të mëvonshëm përfaqësuesi amerikan hiqte çdo rezervë dhe i sugjeronte Departamentit të Shtetit që ta zgjidhte negativisht çështjen e njohjes së qeverisë së re. Ai sillte këtu si pretekst faktin se edhe regjenti i vetëm (Sotir Peci), që kishte mbetur, ishte larguar me leje për një kohë të pacaktuar dhe se Noli kishte grumbulluar në personin e tij edhe funksionet e kryetarit të shtetit, edhe ato të kryeministrit.²

Në fillim Departamenti i Shtetit nuk krijoi dot një ide të qartë mbi natyrën e ndryshimeve në Shqipëri nga njoftimet e përfaqësuesit të tij, prandaj sekretari i shtetit Juz (Hughes) e udhëzonte më 24 qershor ministrin Grant-Smith që të hynte me qeverinë e re «në po ato marrëdhënie që kishte pasur me qeverinë e mëparshme».³ Distanca deri në njohjen e plotë të qeverisë së re nuk ishte e madhe. Por më vonë, nën ndikimin e shpjegimeve plotësuese të ministrit, Departamenti i Shtetit u tërhoq dhe e udhëzoi atë telegrafisht, «që të ndërpriste çdo veprim për të marrë një ekzekuturë»⁴, si masë paraprake për të hapur një konsullatë amerikane. Ekzekutura është një dokument që organet e një shteti i lëshojnë një konsulli të huaj, në bazë të të cilit ky (konsulli) autorizohet të fillojë zyrtarisht veprimtarinë e tij. Departamenti amerikan kishte menduar të dërgonte një konsull në Shqipëri dhe për këtë bëhej gati të kërkonte nga autoritetet shqiptare «ekzekuturën» përkatëse. Tani, në tetor, ai vendosi të ndërpriste çdo përçapje. Me këtë ai mbyllte gjithë çështjen e njohjes së Qeverisë së re shqiptare. Në të vërtetë në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare kër-

një tjetër diplomat, Grant-Smith.

1) Tel. i Grant-Smith-it datë 19.6.1924 në *Hackworth T. H.. Digest of International Law, vol. I. Washington 1940, p. 282.*

2) Tel. i Grant-Smith-it datë 2.7.1924. *Po aty.*

3) Tel. i sekretarit Hughes datë 24.7.1924 sipas *Hackworth, vep: cit., p.282.*

4) *Hackworth, vep. cit., p. 383.*

kesa për një ekzekuatorë trajtohet si një nga format «e tërthorta» të njohjes ndërkombëtare.¹ Anasjelltas «ndërprerja e çdo veprimi për të marrë ekzekuatorën» ka doemos kuptimin e refuzimit të kësaj njohjeje.

Përsa u përket shkaqeve të qëndrimit negativ të Departamentit të Shtetit të SHBA në çështjen e njohjes së Qeverisë së Nolit duhet thënë se konsideratat «juridiko-formale» nuk kanë pasur atë peshë që mund të duket në pamjen e jashtme. Është fakt se një kriter tjetër do ta shtynte Departamentin e Shtetit ta njihte pa vonesë Zogun pas rikthimit të tij. Kështu kur ministri amerikan do të raportonte në fillim të janarit 1925 se Zogu ishte pa dyshim «diktatori i Shqipërisë» porse ai kishte «përkrahjen nga jashtë» dhe prandaj «regjimi i tij dukej i qëndrueshëm», Departamenti i Shtetit do të shprehte mendimin se qeveria amerikane s'kishte për të fituar asgjë po të shtyhej njohja pa mbarim: prandaj aty për aty do të autorizonte përfaqësuesin e vet që t'i njoftonte qeverisë së Zogut njohjen *de jure* nga ana e qeverisë së SHBA.²

Pra, duket sheshit se shkaqet e mosnjohjes së Qeverisë së Nolit nga ana e qeverisë amerikane në thelb nuk kanë qenë juridike, por politike. Qeveria amerikane nuk donte t'i lidhte interesat e saj në Shqipëri me një qeveri të izoluar në arenën ndërkombëtare, Qëndrimi i qeverisë amerikane në këtë çështje nuk mund të shkëputet nga kursi i izolacionist që mbante SH.B.A. deri diku larg përzierjes aktive në punët evropiane pas mbarimit të Luftës I botërore. Krijohet përshypja se në këtë rast Departamenti i Shtetit i është përshatur më shumë pozitës së qeverisë britanike. Për këto arsye nuk është për t'u çuditur në goftë se edhe «Standard Oil» u bashkua me «Anglo-Persianin» për të ndihmuar rikthimin e Zogut, duke financuar përgatitjet e forcave të tij në Jugosllavi.³

Formula ekuivoke franceze

Duke kaluar në qëndrimin e Qeverisë franceze është vështirë të thuhet se interesat e Francës në Shqipëri kanë qënë një faktor politik më vete pas Luftës I. Pas «eksperiencës së

1) Shih L. Oppenheim, «*Mezhdunardonoe pravo*» (bot. rus.) T.1. pj. 2. Moskë, 1948, f. 366.

2) Hackworth, *vep. cit.*, p. 283.

3) Shih G. Demorgny *Danube et Adriatique (Italie et Albanie)*, Paris 1934. pp. 104-106; P. Pastorelli, *vep. cit.* p. 81.

Korçës», që e vuri politikën franceze për herë të parë në kontakt të drejtpërdrejtë me nacionalizmin shqiptar (duke ia njohur kështu tërthorazi, forcën dhe rëndësinë), interesimi i Francës gjeti shprehjen në pjesëmarrjen e saj në planet që u bënë sidomos në Konferencën e Paqes për një copëtim të ri të Shqipërisë ose për ta vënë atë nën një formë vartësie nga ndonjë fuqi e madhe. Në vitet 20 pozita e Francës këtu identifikohet gati krejt me atë të Jugosllavisë, së cilës diplomacia franceze i ngarkoi dalngadalë një rol të dorës së parë në sektorin e Ballkanit.

Po të shikohet nën këtë prizëm, edhe qëndrimi i qeverisë franceze në çështjen e njohjes së Qeverisë së Nolit nuk linte vend për shumë shpresa. Në fillim Ke d'Orse (Quai d'Orsay), nuk e përcaktoi në mënyrë të prerë pikëpamjen e vet. Kryeministri francez i kohës Herrio (Herriot) iu përgjigj Nolit me një telegram, në të cilin me terma të përgjithshme i shfaqte përgëzimet dhe i jepte sigurime për «përkrahje morale».¹ Veç asaj, kur i ngarkuari me punë i legatës shqiptare në Paris u paraqit në Ke d'Orse në qershor, ai mori si përgjigje se çështja e njohjes duhej të konsiderohej e zgjidhur në sens pozitiv me telegramin e Herrioit dërguar Nolit.² Por ndërkaq filluan të vijnë lajme se Londra ishte në kontakt me Parisin për të përcaktuar një qëndrim të bashkërenduar në këtë çështje. Kjo e shtyu titullarin e legatës M. Konicën³ të bënte ai vetë një përçapje të re pranë Ministrisë së Jashtme franceze. Në fillim të gushtit ai u takua me zëvendësdrjetorin e çështjeve politike, i cili deklaroi se «çështja e njohjes nuk është shtruar fare nga Franca, përderisa Qeveria e tanishme e kryesuar nga imzot Fan Noli e ka marrë pushtetin nga Këshilli i Regjencës dhe se, pavarësisht nga kryengritja, ajo është formuar në mënyrë të rregullt». Përfaqësuesi shqiptar dëgjoi t'i përsëritej se vetë telegrami i Herrioit drejtuar Nolit nuk kishte tjetër kuptim veçse «Qeveria franceze e njeh zyrtarisht Qeverinë tuaj».⁴ Nga kjo M. Konica shpejtonte të nxirrte përfundimin se «nuk ka më asnjë dyshim se Qeveria franceze e ka njohur Qeverinë tonë të tanishme».⁵

1) Njoftim i Zyrës së Shtypit të Ministrisë së Jashtme datë 27.6.1924 në AQSH, fondi 251, viti 1924, d. 140.

2) Letër e të ngarkuarit me punë Dino nga Parisi datë 24.6.1924. AQSH, fondi 251, f. 1924, d. 140.

3) M. Konica kryente funksionet e ministrit të Shqipërisë njëkohësisht në Londër dhe në Paris.

4) Letër e ministrit M. Konica nga Parisi datë 2.8.1924, AQSH, fondi 251, viti 1924, d. 140

5) AQSH, Fondi 251, d. 140, viti 1924.

Të njëjtën pikëpamje i shprehën në Ke d'Orsé edhe ambasadorit italian në Paris Avecana (Avezana), kur ky me udhëzim të qeverisë së tij shtroi çështjen e njohjes së Qeverisë së Tiranës. Atij iu tha se «këtu kemi të bëjmë me një ndërrim të thjeshtë ministrash».¹

Në pamje të parë duket, pra, sikur përgjegjësit e politikës franceze i cilësonin ngjarjet revolucionare të qershorit në Shqipëri si një ndryshim të thjeshtë të qeverisë, gjë që e bënte të tepërt çdo shtruarje të çështjes së njohjes. Në këtë pikë Ke d'Orseja dukej sikur pranonte arsyetimin që kishte bërë vetë Noli në telegramin dërguar Herriotit, kur thoshte se në formimin e qeverisë së re ishte treguar kujdes për t'iu përmbajtur procedurës së zakonshme konstitucionale. Mirëpo zhvillimi i mëtejshëm i ngjarjeve tregoi se ky konkluzion ishte i shpejtuar.

Po t'u hidhet një sy dokumenteve të kohës, nuk mund të mos vihet re se qeveria franceze mbante një qëndrim ekuivok. Qëllimi i saj ishte që të injoronte ndryshimet revolucionare në Shqipëri, të zvarriste çdo vendim, gjë që ishte ndoshta edhe kjo një mënyrë për të treguar interesimin e paktë për çdo çështje që kishte të bënte me ngjarjet shqiptare. Ndryshe nuk shpjegohet që, në njërin anë Ke d'Orseja deklaronte se një njohje e re ishte e tepërt, kurse, në anën tjetër përfaqësuesi zyrtar i Francës në Shqipëri, i ngarkuari me punë Begen-Bijkok (Béguin-Billecocq) me qendër në Shkodër, nuk pranonte të hynte në kurrfarë marrëdhëniesh zyrtare me qeverinë e re. Madje, edhe kur duhej të përcillte ndonjë njoftim zyrtar, ai nuk i drejtohej ministrisë, por sekretarit të përgjithshëm «në rrugë thjesht personale».² Edhe supozimi që bëri legata shqiptare e Parisit se qëndrimi i Bijkokut mund të shpjegohet ndoshta me «indisiplinimin e tij» bie poshtë, përderisa ai nuk lëvizi nga posti i tij dhe nuk ndryshoi asnjëherë qëndrim.³ Madje në javën e parë të dhjetorit e shikojmë të bëjë presion pranë autoriteteve lokale të Shkodrës që të mos merreshin masa raprezaljeje ndaj ekspo-

1) DDI, 7^a serie, vol. III, d. 374, p. 212.

2) Shih telegramet e Ministrisë së Jashtme të Tiranës dërguar legatës në Paris më 18. 9.8.1924, AQSH, fondi 251, d. 140, viti 1924.

3) Shih letrën e M. Konicës, datë 2.8.1924, Po aty.

Në letrën e tij të 2 gushtit M. Konica hidhte edhe idenë se mund të merrej shkas nga sjelljet e Bijkokut për të kërkuar largimin e tij, sepse ai tani nuk ishte «personi më i përshtatshëm për të forcuar marrëdhëniet e mira midis Francës dhe Shqipërisë». Por nuk rezultoi që Qeveria e Nolit të ketë bërë ndonjë hap në këtë

mentëve zogistë, veçanërisht ndaj pasurive të Musa Jukës në atë qytet.¹

Veç asaj, pohimi se «çështja e njohjes nuk ishte shtruar asnjëherë» nga ana franceze nuk pajtohej me faktin se në të njëjtën kohë Parisi ishte konsultuar me Londrën dhe kishin rënë dakord të mbanin një qëndrim të përbashkët në këtë çështje. Pas kësaj edhe Beogradi u këshillua bashkërisht prej të dy qeverive që të priste derisa «qeveria shqiptare të mbledhë parlamentin dhe të marrë votëbesimin e nevojshëm për të qenë në një situatë legale.»³

Është për të theksuar se qëndrimi ekuivok i Qeverisë franceze pati jehonë edhe në qarqet diplomatike italiane. Kështu, Ministria e Jashtme e Romës, i rekomandoi Qeverisë shqiptare «formulën» franceze si një zgjidhje sa të thjeshtë, aq edhe «të goditur» të çështjes së njohjes. Në një telegram që vetë Musolini i dërgonte legatës italiane në Shqipëri në fillim të korrikut, pasi cilësohej qëndrimi francez si një «fryt i iniciativës dhe veprimeve efikase» të politikës italiane, ministri italian porositej që t'i bindte qeveritarët e Tiranës se kjo ishte pikërisht ajo që u duhej atyre. Dhe Musolini përfundonte duke i sugjeruar edhe mënyrën e veprimit të mëtejshëm Qeverisë së Nolit: «Në gjendjen e tani shme të punëve. — thoshte ai. — nuk do të ishte me vend që Qeveria shqiptare, e cila është në marrëdhënie me pjesën më të madhe të shteteve të përfaqësuara atje (në Shqipëri — A.P.) si edhe me Lidhjen e Kombeve, të ngulë këmbë për ta bërë një çështje të posaçme njohjen e saj formale.»²

Por cila ishte gjendja reale? A mund të konsiderohej vazhdimi i marrëdhënieve me shtetet e tjera si dhe me Lidhjen e Kombeve si një njohje e nënkuptuar e Qeverisë së re shqiptare nga ana e këtyre shteteve? Praktika ndërkombëtare dhe fill pas saj doktrina juridike në raste të këtij lloji kanë dhënë në mënyrë përgjigje negative. Fakti që përfaqësuesit diploma-

drejtim, megjithëse Ministria e Jashtme është ankuar herë pas here se ai «mban të njëjtin qëndrim». Shih telegramin drejtuar legatës në Paris datë 26.9.1924. *Po aty.*

1) *Dokumente dhe materiale historike nga lufta e popullit shqiptar nër liri e demokraci 1917-1941, Tiranë, 1959, d. nr. 191, f. 193.*

2) Shih raportin e M. Konicës nga Londra datë 26.6.1924, si dhe raportin e tij nga Parisi datë 2.8.1924 në AQSH, *fondi 251, d. 140, viti 1924.*

3) Shih raportin e ministrit Kolonja nga Beogradi datë 8.8.1924 në AQSH, *fondi 251, d. 140, viti 1924.*

3) DDI, 7^a serie, vol. III, d. 373, p. 213.

tikë të disa shteteve kanë vazhduar të qëndrojnë në postet e tyre, madje kanë mbajtur edhe disa kontakte me pushtetin e ri, të vendosur si rezultat i një lëvizjeje kryengritëse, në vetvete nuk ka qenë barazuar asnjëherë me aktin e njohjes zyrtare.¹ Nga kjo shihet se problemi i njohjes pas Kryengritjes së Qershorit nuk ishte aspak një problem i sajuar, një «komplikacion» i kotë që mund të shpjegohej me ndonjë keqkuptim apo me skrupujt juridiko-formalë të përgjegjësve të politikës shqiptare. Ai ishte një problem real që shtruhej nga izolimi në të cilin u gjend menjëherë Qeveria e Nolit dhe nga i cili ajo nuk mund të dilte veçse duke vendosur me qeveritë e huaja po ato marrëdhënie zyrtare që kishin pasur edhe qeveritë e mëparshme.

Për të gjitha këto arsye mund të konkludohet se qëllimi i «formulës» së Ministrisë së Jashtme franceze nuk ishte që të jepte një zgjidhje të çështjes së njohjes së Qeverisë së re shqiptare, por ta linte atë mënjanë, pezull, për ta rishqyrtuar në rrethana të reja, që ajo do t'i gjykonte më oportune. Qeveria e Nolit duhet ta ketë kuptuar këtë, ndaj edhe i dha udhëzime vazhdimisht legatës shqiptare në Paris për të vazhduar përçapjet për njohjen nga qeveria franceze.

E ndodhur ballë për ballë me qëndrimin negativ të qeverive të tjera, *qeveria italiane* jo vetëm që nuk qe në gjendje të ndryshonte këtë qëndrim, por vetë u tërhoq nga pozitat e saj fillestare. Nga fundi i gushtit, në raportet e legatës italiane nuk flitet më si më parë për «gjendjen normale» në Shqipëri, për «shtrirjen e kontrollit të Qeverisë në të gjithë vendin» etj., por vihet në dukje «izolimi ndërkombëtar» i Qeverisë shqiptare dhe «pamundësia për të që të qëndrojnë në fuqi për një kohë të gjatë». Prandaj bëhen sugjerime që të përkrahet (sigurisht kur një gjë të tillë e kërkojnë interesat italiane) «Shteti shqiptar dhe jo kjo apo ajo qeveri në Shqipëri».² Qysh prej kësaj kohe njohja e Qeverisë së Nolit jo vetëm që nuk shtrohet, por edhe përjashtohet.

Do të ishte gabim të mendohej se kthesa italiane në këtë çështje është e lidhur vetëm me pengesat që dolën në marrëdhëniet me qeveritë e tjera aleate. Shkaku kryesor nuk duhet kërkuar në nivelin e politikës evropiane, por para së gjithash në kuadrin e marrëdhënieve dypalëshe midis qeverisë italiane dhe asaj shqiptare. Siç do të shihet më poshtë,

1) Shih L. Oppenheim. *E drejta ndërkombëtare*, (bot. rus). t. I. pj. e parë. Moskë 1948, f. 153.

2) DDI, 7^a serie, vol III, doc. 462. pp. 270-272.

kthesa erdhi si pasojë e një krize të re në marrëdhëniet italo-shqiptare.¹

Njohja nga qeveria sovjetike

E vetmja qeveri që e njohu Qeverinë Demokratike të 1924-s dhe që vendosi me të marrëdhënie diplomatike ishte qeveria e Bashkimit Sovjetik.

Çështja e vendosjes së marrëdhënieve normale shtetërore midis Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë shtrohet për herë të parë qysh aty nga fundi i vitit 1922. Dihet se në këtë kohë, dhe për një periudhë disavjeçare, një nga detyrat kryesore të politikës së jashtme të shtetit sovjetik ka qenë thyerja e bllokadës diplomatike nëpërmjet sigurimit të njohjes ndërkombëtare dhe vendosjes së marrëdhënieve normale me një numër sa më të madh shtetesh, pavarësisht nga sistemet e tyre shoqërore.² Një kujdes të veçantë Komisariati për Punët e Jashtme (ministra e jashtme) duket se i kushtonte vendosjes së marrëdhënieve me një varg vendesh, që sapo kishin krijuar shtetet e tyre, dhe që ishin të angazhuar në një luftë shpeshherë të vështirë e të pabarabartë, për emancipimin e tyre nga vartësia prej Fuqive të Mëdha imperialiste. Shqipëria ishte pa dyshim një ndër këto vende; ajo sapo kishte arritur të dëbonte nga toka e vet pushtuesit e huaj, kurse në vend kishte filluar një lëvizje e fuqishme për ta nxjerrë atë si nga zgjedha feudale, ashtu edhe nga «sferat e ndikimit» të Fuqive.

Kështu, duke marrë shkas nga disa përçapje që ishin bërë nga ana shqiptare për riatdhesimin e një numri shtetasish shqiptarë të mbetur në Rusi që përpara revolucionit, më 3 janar 1923 qeveria sovjetike i pati propozuar Qeverisë shqiptare që të vendoseshin marrëdhënie normale midis të dy vendeve. Në notën që i dërgonte me këtë rast Qeverisë shqiptare, zëvendëskomisari për punët e jashtme M. Litvinov thoshte, midis të tjerash: «Qeveria e Republikës Ruse, e shtyrë nga dëshira për të vendosur marrëdhënie normale e miqësore me të gjithë popujt që nuk kanë lakmi imperialiste, duke përgëzuar popullin shqiptar për luftën e tij të guximshme për pavarësinë e tij të plotë, mendon se ka ardhur

1) Shih Kapitullin II.

2) *Historia diplomatii (bot. rus.)*, vol. III, Moskva 1945, ss. 285-319.

koha për të vendosur marrëdhënie diplomatike midis popujve rus e shqiptar, gjë që do të lejonte të zgjidheshin të gjitha çështjet me karakter politik që ekzistojnë midis dy popujve». ¹ Disa muaj më vonë, në prill, qeveria shqiptare, pasi njoftonte se së shpejti mund të vendoseshin marrëdhënie diplomatike me Bashkimin Sovjetik kërkonte mendimin e kryeqyteteve të mëdha perëndimore me anën e një telegrami që u dërgoi legatave shqiptare veçanërisht në Paris e në Londër. ² Ministri i Shqipërisë në Francë u përgjigj se «kjo do ta zëmëronte Parisin, i cili tani për tani nuk është për rifillimin e marrëdhënieve me Rusinë». ³ Përgjigjja e legatës shqiptare në Londër ishte hartuar me terma edhe më të prera. Atje thuhej se vendosja e marrëdhënieve me Rusinë Sovjetike do të bënte që Shqipëria «të humbiste besimin e Fuqive», do ta kthente atë në një «fole të rrezikshme të bolshevizmes», aq sa Fuqitë mund të arrinin deri atje sa «ta push-tonin vendin fare». ⁴

Kaq u mjaftonte qarqeve reaksionare brenda vendit për ta paraqitur vendosjen e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik si një «aventurë të rrezikshme». Në këto kushte, edhe përgjigjja negative që qeveria shqiptare i dha në prill 1923 propozimit të qeverisë sovjetike nuk mund të ishte e papritur. megjithëse dera nuk mbyllej krejt dhe Qeveria shqiptare sugjeronte që «çështja të shtyhej deri në një moment më të volitshëm». ⁵

Qeveria e Bashkimit Sovjetik bëri një tentativë të re për vendosjen e marrëdhënieve me Shqipërinë në vitin 1924 në kuadrin e ofensivës së saj diplomatike që arriti pikërisht atë vit një varg suksesesh të rëndësishme me njohjen e Bashkimit Sovjetik nga shumë shtete kapitaliste. Duke marrë shkas nga një sondazh që pati bërë Qeveria shqiptare në shkurt të atij viti lidhur me rihapjen e një konsullate shqiptare në Odesë, Litvinovi, në një letër të fundit të marsit drejtuar Pandeli Evangjelit, përgjigjej pozitivisht, porse e shtrënte çështjen më gjerë, duke theksuar se ajo mund të gjente zgji-

1) AQSH, *fondi 251, viti 1923, d. 198.*

2) *Tel. datë 23.IV.1923, AQSH, fondi 251, d. 198, viti 1923.*

3) *Po aty.*

4) *Po aty.*

5) *Po aty.*

dhje «vetëm atëherë kur të vendosen marrëdhënie diploma-
tike midis dy vendeve».¹

Fitorja e kryengritjes në fillim të qershorit dhe krijimi i Qeverisë demokratike nuk mund të mos e nxirrnim përsëri në sipërfaqe çështjen e vendosjes së marrëdhënieve me Bashkrimin Sovjetik. Kështu, vetëm pak ditë pas ardhjes së saj në fuqi, më 28 qershor, Qeveria e Nolit mori një vendim të posaçëm për t'iu drejtuar ajo vetë qeverisë sovjetike me propozimin për të vendosur marrëdhënie diplomatike.²

Duke vënë në zbatim këtë vendim të Qeverisë, në fillim të korrikut, ministri i Jashtëm, S. Delvina, ngarkoi legatën shqiptare në Romë t'i dorëzonte përfaqësisë diplomatike sovjetike në atë qytet një letër për komisarin e punëve të jashtme Çiçerin, që ishte «në vazhdim të letrës së 17 prillit 1923» dhe që shprehte dëshirën e qeverisë së re shqiptare, «për të vendosur marrëdhënie diplomatike e miqësore midis popullit rus e shqiptar».³

Përfaqësuesi sovjetik Jurenjev ia njoftoi përçapjen shqiptare qendrës së tij më 13 korrik.⁴

Disa ditë më vonë Çiçerini i transmetonte përfaqësisë sovjetike «vendimin për të hyrë në marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë»,⁵ dhe mbi këtë bazë Jurenjevi i njoftoi menjëherë legatës shqiptare përgjigjen pozitive të qeverisë sovjetike.⁶

Mirëpo, ndërsa po vendoseshin këto kontakte, në Ministrinë e Jashtme në Tiranë filluan të mbërrinin raporte alarmuese nga legatat shqiptare në Londër, Paris e gjetkë. Veçanërisht legata e Londrës e njoftonte këtë Ministri më 31 korrik se në shtypin britanik kishin depërtuar lajme mbi vendosjen e marrëdhënieve midis qeverisë shqiptare dhe asaj

1) *Dokumenty vneshnjej politiki SSSR, t. VII, M. 1963, d. nr. 88, s. 169*

2) Vendim i Qeverisë së re datë 28.6.1924, «për të hyrë në marrëdhënie me qeverinë sovjetike për të mbrojtur qytetarët shqiptarë që ndodhen në Rusi». *AQSH, fondi 251, viti 1924, d. 297.*

3) Letër e S. Delvinës, datë 4.7.1924, *AQSH, fondi 251, viti 1944, d. 296.*

4) *Dokumenty vneshnjej politiki SSSR, t. VII, M. 1963, d. nr. 187, s. 398.*

5) *Po uty, s. 407.*

6) Letër e përfaqësuesit sovjetik Jurenjev drejtuar legatës shqiptare në Romë. *AQSH, fondi 251, d. 296, v. 1924.*

sovjetike dhe se ato kishin bërë «një përshtypje të keqe» në qarqet drejtuese të atjeshme. Njëkohësisht, në shtypin e Përndimit, si edhe në atë të vendeve fqinje, filloi të ngrihej një zhurmë e madhe se Shqipëria po kthehej në një «vatër bolshevike» për nxitjen e trazirave në Ballkan. Presioni i jashtëm e lëkundti Qeverinë e Nolit dhe ajo ngurroi nga frika e komplikacioneve të mundshme diplomatike.

Ministri i Jashtëm S. Delvina në një letër drejtuar legatës shqiptare në Romë më 19 gusht e thoshte hapur se «duke marrë parasysh situatën e turbullt në Ballkan, sot për sot ne nuk e shohim të arsyeshme të fillojmë marrëdhënie diplomatike me qeverinë sovjetike». Prandaj ai e udhëzonte legatën shqiptare që, në qoftë se përfaqësia sovjetike «kërkonte shpjegime për këtë çështje», asaj duhej «t'i jepej përgjigje evazive». Në letrën e ministrit pasqyrohej edhe efekti i presioneve të jashtme kur shtoej edhe kjo frazë: «Sa për qarqet politike dhe shtypin, mund t'i siguroni se qeveria shqiptare ka marrë masa për ndalimin e propagandës bolshevike në Shqipëri dhe gjer më sot asnjë agjent i sovjetëve nuk është parë në këtë vend».¹ Kështu shpjegohet që përçarjet e bëra nga përfaqësia sovjetike në Romë gjatë muajit gusht mbetën pa jehonë nga ana shqiptare.²

Duke parë lëkundjet e vazhdueshme të Qeverisë së Tiranës, Komisariati për Punët e Jashtme bëri një përpjekje të re për ta çbllokuar çështjen. Në mes të shtatorit, në legatën shqiptare në Romë u dorëzua një letër e Çiçerinit për S. Delvinën, në të cilën ai propozonte një thjeshtim të procedurës për të arritur në vendosjen e marrëdhënieve. Thelbi i arsyetimit të tij ishte se shkëmbimi i letrave midis dy ministrave (letra e S. Delvinës e fillimit të korrikut dhe kjo e tanishmja e Çiçerinit), jepnin një bazë të mjaftueshme për ta quajtur marrëveshjen të përfunduar dhe kjo mund të pasohej menjëherë me caktimin e përfaqësuesve nga ana e të dyja palëve.³

¹ Letër e S. Delvinës dt. 19.8.1924, AQSH, fondi 251, d. 296, v. 1924.

² Ingarkuari me punë njoftonte telegrafisht në fund të gushtit se përfaqësuesi sovjetik kishte pyetur tri herë. Tel. datë 30.8.1924. Po aty.

³ Dokumenti vneshnjej politiki SSSR, t. VII, d. nr. 209: kopje në AQSH, fondi 251, d. 296, v. 1924.

Pengesat sigurisht nuk ishin formale, proceduriale. Shkaqet e ngurrimeve shqiptare ishin më të thella. Megjithatë ky hap i Çicerinit duket se bëri një efekt të përkohshëm. Në të vërtetë çështja sikur lëvizi nga pika e vdekur në kohën e udhëtimit të kryeministrit Noli për në sesionin V të Asamblesë së Lidhjes së Kombeve në Gjenevë. Gjatë rrugës së kthimit në atdhe, Noli bashkë me Gurakuqin, u ndalën për disa ditë në Romë në gjysmën e parë të tetorit.¹ Në kryeqytetin italian ata patën një takim me Musolinin dhe ky sigurisht ka qenë qëllimi kryesor i qëndrimit.² Por Noli gjatë atyre ditëve pati po ashtu një takim me përfaqësuesin sovjetik në Itali, Jurenjev. Aty u fol për zbatimin praktik të marrëveshjes së arritur më parë mbi njohjen dhe vendosjen e marrëdhënieve dhe u vendos që të shkëmbeheshin përfaqësues diplomatikë. Së shpejti në Tiranë do të hapej një legatë e Bashkimit Sovjetik.³

Zhurma në shtypin perëndimor dhe në atë të vendeve fqinje filloi me forcë të dyfishuar. Gazeta e madhe e Londrës «Deili Telegraf» (Daily Telegraph) shkruante në një nga numrat e nëntorit se «Fan Noli do të pendohej që u shpejtua të vendoste marrëdhënie të plota diplomatike me qeverinë sovjetike».⁴ Qeveria e Nolit u tërhoq përsëri dhe kësaj radhe përfundimisht. Para së gjithash tërhoq vëmendjen një letër e ministrit shqiptar në Londër, M. Konicës, drejtuar pikërisht «Deili Telegrafit» më 21 nëntor. Kërcënimeve të gazetës ai u përgjigjej me një ton nënshtrues, duke thënë se «ishte i autorizuar të deklaronte se zërat që qarkullonin kohët e fundit se qeveria shqiptare është duke e njohur qeverinë sovjetike ishin krejt të pathemelta». Madje shtonte se «në Shqipëri nuk kishte agjenci bolshevike».⁵ Më 10 dhjetor Noli vetë e udhëzonte telegrafisht legatën e Romës që ta njoftonte

1. Sipas një lajmi nga Roma Noli dhe Gurakuqi mbërritën aty më 6 tetor, AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 146.*

2. Shih më poshtë.

3. Lajm nga Roma i gazetës zvicerane «Journal de Genève» datë 22.10.1924. Kopje në AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 298.*

4. Cituar sipas gazetës greke «Kathimerini», datë 27.11.1924. Kupyre shtypi në AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 225, f. 291.*

5. Letër e ministrit M. Konicës drejtorit të gazetës «Daily Telegraph» dt. 21.11.1924. *Po aty, d. 296, fl. 37.*

«në mënyrë konfidenciale» përfaqësinë sovjetike se Qeveria shqiptare e shikonte të nevojshme të shtyhej për më vonë shkëmbimi i përfaqësuesve diplomatikë midis të dy vendeve «për të mos u dhënë një armë në dorë reaksionarëve dhe partive kundërshtarë, të cilët përpiqeshin me çdo mënyrë t'i krijonin vështirësi qeverisë». ¹

Është interesante të vihet në dukje se si shkak kryesor për këtë tërheqje të re Noli përmendte «fushatën elektorale», gjë që tregon se çështja e «legalizimit të kryengritjes» e preokuponte atë tani gjithnjë e më shumë, madje e kalonte masën po të merret parasysh gjendja reale e punëve, sidomos në një kohë (në dhjetor) kur përpara revolucionit demokratik po dilnin probleme të një natyre krejt tjetër. që kishin të bënin me mbrojtjen nga ndërhyrja e jashtme.

Mirëpo ka të ngjarë që njoftimi të ketë mbërritur me vonesë në Komisarjatin Sovjetik për Punët e Jashtme, sepse ndërkaq ishte caktuar përbërja e përfaqësisë sovjetike në Tiranë me në krye Arkadi Krakovjeckin (në rangun e ministrit) dhe gjithë personeli i saj (gjithsejt 7 veta) ishte nisur për në Shqipëri. Madje diplomatët sovjetikë mbërritën në Tiranë më 16 dhjetor, pasi kishin kaluar nga Vjena ku kishin marrë rregullisht vizat e hyrjes nga konsullata shqiptare e atjeshme. ²

Kjo u bë shkak për presione të drejtpërdrejta kundër Qeverisë nga ana e përfaqësuesve diplomatikë të Perëndimit në Tiranë, sidomos nga ministri i Britanisë së Madhe. E frikësuar, Qeveria e Nolit e shqyrtoi çështjen në një nga mbledhjet e saj të fundit dhe më 20 dhjetor (pak ditë përpara se të rrëzohej) botoi një komunikatë të posaçme në të cilën njoftohej se përfaqësuesve sovjetikë u ishte kërkuar që të largoheshin nga Shqipëria. Kështu Krakovjecki dhe bashkëpunëtorët e tij u nisën nga Tirana vetëm pas nja dy ditësh

1) Tel. i Nolit datë 9.12.1924. AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 296*, Në dhjetor Noli kryen edhe funksionin e ministrit të Jashtëm *ad interim*.

2) Raport i konsullit Bushati nga Vjena, dat 12.12.1924. *Po aty*. Me atë rast konsulli shqiptar u thirr për vizitë në selinë e përfaqësisë sovjetike dhe sipas tij «pritja ishte shumë e mirë dhe familjare». *Po aty*.

qëndrimi.¹ Si pretekst formal për kërkesën e largimit, në shtypin e kohës ishte përmendur se pala sovjetike «nuk kishte bërë përcapjet e nevojshme për sigurimin e agremanit për personin e Krakovjeckit para ardhjes së tij» dhe se, veç asaj, konsullata shqiptare e Vjenës «i kishte lëshuar vizat e hyrjes në Shqipëri pa qenë e autorizuar për një gjë të tillë». Për këtë, titullari i konsullatës, Bushati, urdhërohej me telegram të linte postin dhe të kthehej menjëherë në Shqipëri.²

Prapaskena që u krijua në Tiranë të nesërmen e mbërritjes së përfaqësuesve sovjetikë del më e qartë nga një telegram që Krakovjecki i dërgonte zëvendëskomisarit Litvinov me 22 dhjetor nga Roma, ku kishte mbërritur pas largimit të tij nga Shqipëria. Telegrami kishte këtë përmbajtje: «Më 16 dhjetor mbërrita në Tiranë. Po atë ditë në mbrëmje vonë Këshilli i Ministrave vendosi të pranojë përfaqësuesin tonë. Më 17 dhjetor erdhi një protestë nga ana e Anglisë, Italisë, Serbisë. Në të njëjtën kohë sulmi i serbëve në veri mori përpjesëtime kërcënuese. Përfaqësuesit e fuqive të lartpërmendura deklaruan se në rast se përfaqësia sovjetike do të vazhdonte të qëndronte në Shqipëri, ata do ta shikonin sulmin e Ahmet Zogut si një punë të brendshme të Shqipërisë dhe do ta linin këtë të përballonte gjendjen me forcat e saj. Kurse në rast të kundërt Anglia premtojte që ta ndalonte sulmin e Ahmet Zogut me rrugë diplomatike. Nën ndikimin e këtij ultimatumit dhe të humbjeve në front, kur për më tepër mungojnë armët dhe municionet, Këshilli i Ministrave, në një mbledhje të dytë, vendosi t'i lutet përfaqësisë sonë të largohet nga Shqipëria për të shmangur pushtimin e mëtejshëm të territorit shqiptar. Kjo m'u njoftua zyrtarisht nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme, i cili e mo-

1) *Shih gazetën «Bashkimi» datë 20.12.1924.*

2) *Po aty, Tel. i konsullatës së Vjenës, datë 18.12.1924 në AQSH, fondi 251. viti 1924, d. 295. Po atë ditë u dërgohej ky telegram legatave shqiptare të Parisit, Londrës, Romës, Beogradit, Athinës, Bukureshtit: «Përfaqësuesi i Rusisë mbërriti në Tiranë. Duke parë situatën ndërkombëtare dhe rrethanat në të cilat ndodhet vendi, Qeveria i kërkoi të largohet nga Shqipëria. Ministri bashkë me suitën nisete sonë për në Itali». Po aty.*

tivoi këtë pikërisht me presionin e Fuqive dhe gjendjen në front». ¹

Hapi i Qeverisë Demokratike të 1924-s për vendosjen e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik ka qenë një akt pavarësie në politikën e saj të jashtme. Fakti që ajo u lëkund vazhdimisht dhe më në fund u tërhoq, flet për lëshën e ngushtë të veprimit të saj, për mjetet e pakta që kishte në dispozicion për të përballuar presionet e Fuqive. Por nuk mund të mohohet se edhe me aq sa bëri, ajo tregoi qartë prinjen për të dalë nga kornizat e ngurosurat që u imponoheshin «të vegjëlve» në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Është pohuar se vetë të shtruarit e problemit të njohjes dhe të lidhjes së marrëdhënieve me qeverinë sovjetike, ka qenë një hap i nxituar, jo vetëm inoportun, por edhe fatal për ekzistencën e Qeverisë Demokratike. Kjo është paraqitur edhe si një ndër arsyt kryesore që ajo tërhoqi «vëmendjen e shqetësuar» të qarqeve reaksionare ndërkombëtare dhe u gjend kështu përballë «karantinës diplomatike» të organizuar prej tyre. Qeveria e Beogradit arriti deri aty sa e denoncoi këtë hap të Qeverisë së Nolit me një notë të proteste drejtuar më 26 nëntor Fuqive, duke e paraqitur si një provë të dëpërtimit të agjentëve sovjetikë në Shqipëri. ² Mirëpo në vetvete ky hap as në sytë e këtyre qarqeve nuk mund të ishte motivi i vetëm (ose edhe kryesor) i qëndrimit armiqësor nga ana e tyre. Këtu nuk mund të mos kihet parasysh se në vitin 1924 Bashkimin Sovjetik e njohën një varg i tërë shtetesh kapitaliste, midis të cilave ishin Anglia, Italia, Greqia etj. Edhe autori anglez Suajër (Swire) e pranon se këtu nuk kishte asgjë të jashtëzakonshme; duke vendosur marrëdhëniet diplomatike me Rusinë Sovjetike, — thotë ai, — Qeveria e Nolit ndoqi një rrugë të shkelur më parë nga të tjerët, veçanërisht «shembullin e Britanisë së Madhe» dhe e bëri këtë «kur (në Londër) kishte ardhur në fuqi qeveria e re laburiste («socialiste») e Makdonaldit». ¹

1) Dokumenti vnesnjej politiki SSSR, t. VII, d. nr. 202, s. 537

2) J. Swire, Albania. The Rise of a Kingdom, London 1929, p. 143.

1) J. Swire, vep. cit., p. 146.

Kjo çështje nuk mund të merret e shkëputur kur bëhet fjalë për politikën që përcaktuan Fuqitë ndaj ngjarjeve revolucionare në Shqipëri në gjysmën e dytë të vitit 1924. Arsyeja, pra, nuk duhet kërkuar te çështja e pjeshme e vendosjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, por në përgjithësi te prirja e Qeverisë së Nolit për të ndjekur vijën e pavarësisë në politikën e saj të jashtme, shprehje e së cilës ishte në fund të fundit edhe ky hap i saj.

Kapitulli II

BOJKOTIMI NDËRKOMBËTAR

Mosnjohja e Qeverisë Demokratike nga ana e qeverive të tjera nuk ishte thjesht një mossakses diplomatik. Ajo çoi në veçimin e saj të plotë në arenën ndërkombëtare. gjë që në rrethanat e asaj kohe nuk mund të mos kishte pasoja shumë të rënda, si për veprimtarinë, ashtu edhe për vetë qëndrimin në fuqi të Qeverisë Demokratike. Ajo mori dalngadalë ngjyrën e një marrëveshjeje të realizuar në shkallë ndërkombëtare për ta mbytur në djep lëvizjen kryengritëse në Shqipëri. Në të vërtetë situata politike e përgjithshme në Evropë nuk ishte e favorshme për çfarëdo procesesh revolucionare përparimtare. Ishte koha e stabilitetit relativ të Evropës, që doli përkohësisht nga tronditjet e mëdha pas lufte dhe nuk mund të qëndronte e shkujesur përballë rishfaqjes së «vatrave të trazirave» qoftë edhe në sektorë periferikë si Shqipëria e asaj kohe.

Një nyjë e kontradiktave ndër imperialiste

Është me interes të njihet rruga plot dredha e kthesa e ndjekur në çështjen shqiptare nga diplomacia e fuqive evropiane dhe e shteteve fqinje, derisa u arrit në marrëveshjen e pashkruar për ta bllokuar lëvizjen kryengritëse në Shqipëri nëpërmjet bojkotimit të Qeverisë demokratike.

E para fuqi që hyn në këtë kënd vështrimi është Italia. Politika italiane në Shqipëri u bë veçanërisht aktive pas Luftës I Botërore. Dhe kjo është e shpjegueshme. Në

krahasim me paraluftën, situata e përgjithshme në Adriatik e në Ballkan kishte pësuar ndryshime rrënjësore. Këto ndryshime shkonin në favor të politikës ekspansioniste italiane. Rivalja kryesore dhe tradicionale e Italisë në Ballkan, përgjithësisht dhe në Shqipëri veçanërisht — Austro-Hungaria — pësoi disfatë në luftë, u shthur dhe doli nga skena politike ku kishte luajtur rolin e një fuqie të madhe. Një tjetër fuqi e madhe, tradicionalisht e interesuar në punët e Ballkanit, Rusia cariste, mbeti jashtë arenës së ndeshjes së interesave të mëdha imperialiste. Pas Revolucionit të Tetorit, Rusia për një kohë të gjatë do të vepronte në kushtet e një karantine të rreptë diplomatike nga ana e Fuqive të Mëdha Perëndimore.

Politika italiane nxitoi të nxirrte maksimumin e përfitimeve që i lejonin rrethana kaq të favorshme, ndoshta të papërsëritshme. Objektivi i parë ishte, pa dyshim, Shqipëria. «Vlora» duhej të mbetej thjesht një episod, madje një episod prej nga Musolini, që përpara ardhjes së tij në fuqi, kishte marrë shkas jo vetëm për të denoncuar dobësitë e Italisë «liberale», por edhe për të paralajmëruar me kohë kursin e revanshit të Italisë fashiste.

Në Romë kuptohej se çdo ndërmarrje ushtarake ishte e parakohshme, ndaj edhe revanshi shtrohej në rrugë diplomatike. Një themel i ri u hodh për realizimin e programit të vjetër të depërtimit italian në Shqipëri me Deklaratën e përmendur të nëntorit të vitit 1921 të katër Fuqive, që e fuste vendin në sferën e interesave të posaçme italiane. Tani detyra ishte që ky sukses i diplomacisë italiane, i arritur në kuadrin e politikës së madhe evropiane, të gjente shprehjen dhe zbatimin e vet edhe në planin e marrëdhënieve dypalëshe italo-shqiptare, duke e lidhur më fort Shqipërinë pas Italisë, mundësisht me njëfarë forme të vartësisë juridike ndërkombëtare. Me fjalë të tjera, politika e Traktatit të Fshehtë të Londrës, që synonte kontrollin e drejtpërdrejtë italian mbi Shqipërinë, duhej lënë mënjanë si inoportune dhe madje kundërproduuese. Duhej përruar një politikë e re, e hapave të vegjël dhe shtigjeve krahemarrëse me qëllim që pavarësia shqiptare, edhe pse e ruajtur në formë, të ishte në funksion të interesave ekspansioniste italiane.

Në këtë rrugë Italia ndeshi në një pengesë që ndoshta

nuk parashikohet fare para lufte: në Britaninë e Madhe. Sikurse u tha edhe më lart, pasuritë e shpresuara vajguore të nëntokës shqiptare e zgjuan më tepër se kurrë interesin e Anglisë për Shqipërinë. Foreign Ofisi tregoi se ishte gati të bënte lëshime në fushën politike, siç bëri me Deklaratën e nëntorit 1921, duke njohur pozitën e veçantë politiko-strategjike të Italisë në Shqipëri. Por ndërkaq tregohej i shtrënguar në fushën ekonomike, duke ngulur këmbë veçanërisht për monopolin e kërkimeve vajguore në favor të shoqërisë «Anglo-Persian», dhe me këtë i kundërvihej tezës së «mundësive të barabarta» të shpallur me zë të lartë nga qeveritë e SHBA, Francës dhe Italisë.¹

Një pengesë tjetër ishte Shteti Serbo-Kroato-Sllaven, ose Jugosllavia, siç do të quhej më vonë, që doli në brigjet e Adriatikut me synimin që të zinte këtu sadopak vendin e Austro-Hungarisë. Kontrasti i vjetër Romë-Vjenë do të vazhdonte, ndonëse në një përmasë tjetër, midis Romës dhe Beogradit. Një shprehje e veçantë e këtij kontrasti ishte edhe pozita e Jugosllavisë në çështjen e vajgurit shqiptar. Beogradi ishte haptazi në favor të Anglisë, për arsye të thjeshtë se një prani e saj, qoftë edhe ekonomike, në Shqipëri mendohej se mund të ndihmonte për të kundërbalancuar peshën e Italisë.

Përballë këtyre pengesave, në fillim të vitit 1924 diplomacia italiane mund ta konsideronte se kishte arritur një pikë të rëndësishme në favor të saj, kur më 20 janar u lidh e para marrëveshje tregtare italo-shqiptare pas lufte. Kjo ishte pa dyshim një «afërë» (affaire) për palën italiane, sepse përfitimet ishin krejt të njëanshme dhe reciprociteti ishte vetëm sa për sy e faqe.² Mirëpo frytet

1) Shih P. Pastorelli, *vep. cit.*, p. 19.

2) Në rast zbatimi të saj, marrëveshja e 20 janarit 1924 mund të përbënte një hap të madh në futjen e kapitalizmit italian në Shqipëri. Marrëveshja parashikonte, midis të tjerash, që shtetasit e të dyja palëve të kishin të drejtë të bënin tregti në territorin e secilës palë. Lidhur me këtë, palët detyroheshin të mos vendosnin ndalime ose kufizime për eksportimin, importimin dhe tranzitin e mallrave. Veç asaj, shoqëritë e sigurimeve mund të vepronin lirisht në territorin e secilës palë. Shoqëritë italiane të lundrimit fitonin të drejtën ekskluzive për të kryer shërbimin e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave midis porteve shqiptare. Më në fund, shtetasve italianë u njihej e drejta e peshkimit jo vetëm në ujërat

nuk po dukeshin dhe grupi i Zogut që ishte në fuqi nuk jepte garanci të mjaftueshme. Anglezët nuk po e ngadalësonin presionin për monopolin vajguror, gjë që me kohë nuk do të vononte të shprehej sigurisht edhe në fushën politike. Kurse jugosllavët nuk e fshihnin pëlqimin e tyre që Zogu dhe grupi i tij flirtonin në disa drejtime: flitej madje edhe për marrëveshje të fshehta midis Zogut dhe qeverisë jugosllave.¹

Musolini kishte patur rast ta shprehte vetë personalisht, disa javë përpara ngjarjeve të qershorit, pakënaqësinë për gjendjen e marrëdhënieve italo-shqiptare. Si shkas kishte shërbyer një raport i Duracos i fillimit të marsit, me anën e të cilit ministri italian njoftonte për zemërimin që kishte ngjallur në opinionin publik shqiptar qëndrimi projugosllav i Italisë në çështjen e Shën-Naumit, kur kjo ishte shtruar edhe një herë për shqyrtim në Konferencën e Ambasadorëve². Përgjigjja e Musolinit nxjerr në shesh jo vetëm zhgënjimin për gjendjen ekzistuese, por edhe disa synime që shkonin tepër larg nga ana e Italisë fashiste. Midis të tjerash, ai shkruante: «Nuk është pa vend të theksojmë dëmin që Shqipëria pëson nga vetveprimi i saj plot dyshime që po zhvillon prej disa vjetësh, duke luftuar me çdo mjet për të mos i lejuar Italisë që të ruajë një pozitë mbizotëruese të drejtash (una situazione prevalente di diritti), e cila do t'i jepte mundësi asaj të ndërhynte në mënyrë efikase në favor të saj (Shqipërisë). Si pasojë e këtij veprimi të zhvilluar kryesisht nga vetë Shqipëria, ne tani ndodhemi kundrejt saj, nga pikëpamja juridike ndërkombëtare, në të njëjtën pozitë sikurse fuqitë e tjera. Shqipëria nuk mundet, pra, të çuditet e as t'i vijë keq, në qoftë se ne

territoriale, por deri në ujërat e brendshme shqiptare. (Sipas *Recueil des traités*, vol. XLIV, p. 359). Karakteri i pabarabartë i kësaj marrëveshjeje del në shesh nga karakteri fiktiv i reciprocitetit, kur dihet se vetëm pala italiane mund t'i realizonte të drejtat e parashikuara në marrëveshje. Një dokumentacion i plotë lidhur me këtë marrëveshje (vetë marrëveshja bashkë me proces-verbalet e mbledhjeve) gjendet në *AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 98*.

1) Dy tel. të Duracos nga Durrësi, datë 7.7.1924 dhe 8.7.1924., *DDI, 7a serie, vol. III, d. nr. 243 dhe 246*.

2) Në fillim të marsit, në pragun e mbledhjes së Konferencës së Ambasadorëve, që do të shqyrtonte kërkesën jugosllave për të ndryshuar një vendim të mëparshëm të vetë konferencës për vijën e kufirit në zonën e Shën-Naumit e të Vermoshit, Musolini i pat telegrafuar ambasadorit italian në Paris, Avexana (Avezana), që të zhvillonte «një veprim të favorshëm për tezën jugosllave në çështjen e Shën-Naumit» *DDI, 7a serie, vol. III, d. nr. 66, p. 44*)

nuk jemi në një pozitë të tillë juridike që do të na jepte të drejtën të flisnim në emër të saj me një autoritet edhe më të madh». ¹ Pra, ky ishte pikësynimi kryesor i qeverisë italiane: të arrinte të siguronte një lloj tutele mbi Shqipërinë në marrëdhëniet ndërkombëtare, të dilte jo vetëm në fakt, por edhe *de jure* si fuqi protektore.

Ndërkaq Musolini këtë e mbante për vete. Ai ruhej veçanërisht të mos ngjallte dyshime në Beograd lidhur me synimet e vërteta italiane. Ky ka qenë pa dyshim kuptimi që i jepte diplomacia italiane «Paktit të miqësisë» që u lidh në janar 1924 në Romë me Jugosllavinë, në frymën e të cilit të dyja palët duhej të angazhoheshin për respektimin e pavarësisë dhe të integritetit territorial të Shqipërisë. Sigurisht, edhe nga ana jugosllave kishte një qëllim të fshehtë: Beogradi ushqente po ashtu shpresë të nxirrte përfitime nga loja diplomatike me Italinë si në Shqipëri ashtu edhe në një shkallë më të gjerë ballkanike. ² Skenari do të përsëritej edhe në qershor, kur të dyja qeveritë «naïke», pas konsultimesh paraprake, morën një qëndrim të përbashkët lidhur me kryengritjen shqiptare. Duke iu referuar shkurtimisht paktit të janarit, ato lëshuan më 3 qershor një deklaratë të posaçme me këtë përmbajtje: «Qeveria italiane dhe Qeveria Serbo-Kroate-Sllovene, pasi patën një shkëmbim të ngushtë pikëpamjesh rreth gjendjes në Shqipëri, konstatojnë se këto pikëpamje përputhen plotësisht e deklarojnë se qëllimi i politikës së tyre është që të mos bëjnë asgjë që të ndalojë ose të pengojë zhvillimin e një Shqipërie të pavarur. Për këtë arsye ato i quajnë trazirat në Shqipëri si punë të saj të brendshme». ³

Revolucioni i Qershorit si faktor i ri i luftës diplomatike

E tillë ishte pamja e jashtme. Ajo kishte për qëllim të mbulonte thelbin: acarimin e kontradiktave italo-jugo-

1) Tel. i Musolinit drejtuar Duracos, datë 19.3.1924. DDI, 7^a serie, vol. III, d. 88, p. 58.

2) Dy vjet e ca më vonë, Pakti i Tiranës që Musolini lidhi me Zogun e rikthyer në fuqi (nëntor 1926), do të shënonte falimentimin e bujshëm të politikës së «miqësisë italo-jugosllave», që do të shoqërohej me dorëheqjen e Ninciçit, frymëzues i kësaj politike.

3) DDI, 7^a serie, vol. III, d. nr. 244, p. 146.

sllave pikërisht tani pas fitores së lëvizjes kryengritëse. Në të vërtetë, si qeveria e Romës, ashtu edhe ajo e Beogradit i kishin përcaktuar preferencat e tyre dhe udhët që morën ish-in të ndryshme.

Qëndrimi armiqësor i Qeverisë jugosllave nuk u duk vetëm në çështjen e njohjes së Qeverisë Demokratike, por në tërësinë e marrëdhënieve midis të dy vendeve. Shenja e parë e këtij qëndrimi ishte pritja që iu bë Zogut dhe njerëzve të tij në tokë jugosllave. Ai nuk gëzoi këtu thjesht të drejtën e strehimit politik, por u trajtua si një burrë shteti i larguar vetëm përkohësisht nga skena politike.

Edhe nga burime italiane është shprehur shqetësimi lidhur me pritjen e jashtëzakonshme që i ishte bërë Zogut në kryeqytetin jugosllav. Jo vetëm ishte strehuar në një nga hotelet më të mëdha të Beogradit, por kishte me vete një suitë të konsiderueshme (250-300 veta) dhe mbante kontakte të vazhdueshme me përfaqësues të lartë të Ministrisë së Jashtme dhe të shtatmadhorisë jugosllave.¹ Kjo nuk mund të interpretohej ndryshe veçse si një tregues i qartë i angazhimit të drejtpërdrejtë të autoriteteve jugosllave në një aksion të drejtuar kundër Qeverisë së re shqiptare.

Ndoshta kjo ka qenë edhe një nga arsyet që e kanë shtyrë më shumë Musolinin të marrë anën e Qeverisë Demokratike në qershor dhe të ndërmarrë përçapjet që u përshkruan më lart për njohjen e saj. Diplomati italian i karrierës P. Kuaroni (P. Quaroni), që e njihte vendin dhe e pati vizituar vetë, shprehet kështu për gjendjen në Shqipëri pas qershorit dhe për qëndrimin e Italisë: «Më

1) Sipas raportit të Marketit, cituar në P. Pastorelli, *vep. cit.*, p. 24.

Një informacion i ardhur po ashtu në Ministrinë e Jashtme në Tiranë (pa datë, por sipas çdo gjase në fillim të shtatorit) përmend disa nga funksionarët e lartë që kanë mbajtur lidhje të rregullta me Ahmetin: Branko Lazareviç, këshilltar në Ministrinë e Jashtme, shef i sektorit për Shqipërinë, koloneli Gaiç i shtabit të përgjithshëm, zëvendës-drejtor i zbulimit, gjenerali P. Markoviç, anëtar aktiv i «Lidhjes ushtarake» serbe. Vizita te Zogu bënin edhe P. Gavrilloviç, ndihmës i Pashiçit dhe G. Todoroviç, drejtor i seksionit politik në Ministrinë e Jashtme. *AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 287.*

1924 Shqipëria kishte në krye të saj imzot F. Nolin, një personalitet mjaft piktoresk, inteligjent, i kulturuar dhe me ide politike të cilat në atë kohë duket se ishin socializante, por jo fort të qarta. Marrëdhëniet tona me të ishin shumë të kënaqshme dhe nga ana jonë i dhamë përkrahje. Situata politike në vetvete dukej e stabilizuar mjaft mirë.¹

Pra, kemi të bëjmë me një vlerësim dhe qëndrim të ndryshëm dhe, sigurisht, një nga arsytet e kësaj duhet kërkuar në rivalitetin me Jugosllavinë, në dyshimet që ngjallte politika e saj haptazi intervencioniste kundrejt Shqipërisë.

Lidhur me këtë një çështje që duhet sqaruar është ajo e rolit, e pjesës që ka patur vetë Qeveria e 1924-s në ballafaqimin e Italisë me Jugosllavinë. S'ka dyshim se shqetësimet më të mëdha në Tiranë, pas fitores së kryengritjes, i shkaktonte politika e Beogradit me të njohurat dhe të panjohurat e saj. Por, a u rreshtua Qeveria Demokratike tërësisht në anën e Italisë? A e bëri ajo çështjen kryesore të politikës së saj të jashtme përkrahjen nga ana e qeverisë italiane?

Në literaturën italiane të pasluftës, që trajton politikën e jashtme të Musolinit në dhjetëvjeçarin e parë të fashizmit italian, është shprehur pikërisht një tezë e tillë. Kështu E. di Nolfo, në një punim të vitit 1960, thotë se Qeveria e Nolit e bëri «miqësinë me Italinë një nga shtyllat (uno dei capisaldi) e programit të saj si për politikën e brendshme ashtu për politikën e jashtme».² Një autor tjetër P. Pastoreli (P. Pastorelli) shkon edhe më larg kur thotë në një punim të tij të vitit 1967, se me ardhjen në fuqi të Qeverisë Demokratike të 1924-s ndodhi «një përmbysje e plotë në qëndrimin e nacionalizmit shqiptar kundrejt Italisë pas Luftës I».³ Autori italian nuk mund ta mohojë se «nacionalizmi shqiptar» e kishte gjetur afirmimin e tij më të bujshëm pikërisht në luftën kundër imperializmit italian pas Luftës I (me Luftën e Vlorës). Por vazhdon duke thënë se, pas kësaj, Italia i dha një «impotacion të ri» politikës së saj kundrejt Shqipërisë, impotacion të cilin, — sipas

1) P. Quaroni, *Valise diplomatique*, Paris 1958, p. 82.

2) E. di Nolfo, *Mussolini e la politica estera italiana (1919-1933)*, Padova 1960, p. 175.

3) P. Pastorelli, *vep. cit.*, pp. 38-39.

tij. — Musolini nuk dha shenja se kishte ndër mend ta ndryshonte të paktën në këtë fazë fillestare. Veçanërisht i tepruar, i pathemeltë, është pohimi sipas të cilit vetëm në kohët e Kryengritjes së 1924-s u kapërcye, nën ndikimin e këtij të ashtuquajturit «impostacioni të ri» të politikës italiane, ajo frymë mosbesimi që kishte zënë vend në rrethet shqiptare ndaj Italisë. Po aq i pabazuar është edhe konkluzioni i nxjerrë së këtejmi se pikërisht Qeveria Demokratike ishte ajo që u bë interprete e këtyre prirjeve pro-italiane në qarqet e reja drejtuese. «duke i varur të gjitha shpresat te Italia». «duke u mbështetur vetëm te karta italiane» si për realizimin e reformave brenda vendit, ashtu edhe për forcimin e pavarësisë në fushën e politikës së jashtme.¹

Me sa duket, të dy autorët italianë, të vetmen mbështetje për këtë tezë duan ta gjejnë në deklaratat e Nolit, të bëra para dhe pas fitores së kryengritjes, të parat me shkronja (në letrën drejtuar Duracos), të dytat me gojë (në takimin me përfaqësuesin e Italisë). Është e vërtetë se Noli, së pari si zëdhënës i opozitës dhe pastaj si kryetar i Qeverisë, shfaqti në të dy rastet shpresën dhe gatishmërinë për marrëdhëniet më të mira midis Shqipërisë dhe Italisë, pa kursyer edhe ndonjë lavdërim për Musolinin vetë.² Por kjo është tepër pak për të arritur në konkluzionin se Qeveria e 1924-s vuri në themel të politikës së saj të jashtme miqësinë me Italinë, një «miqësi» që gati përjashtonte marrëdhëniet me

1. Po aty.

2) Nga letra që Noli i dërgonte më 26 maj ministrin italian duket se në Romë bënë përshtypje sidomos fjalët e mbylljes: «Na pëlqen të besojmë se në radhët e opozitës së tanishme, Italia ka miq të zjarrtë, singëriteti i të cilëve nuk mund të vihet në dyshim dhe kemi të bindur se, po të dalim fitimtarë në këtë luftë, jo vetëm që të gjitha problemet e mbetura pezull midis dy fuqive tona do të zgjidhen në mënyrë të kënaqshme për të dy palët, por edhe do të përfundohen marrëveshje të tjera me qëllim që marrëdhëniet tona të bëhen edhe më të ngushta» (DDI, 7a serie, vol. III, d. 117, p. 136).

3) Pas fitores së kryengritjes dhe vendosjes së Qeverisë së re në Tiranë, Noli, si kryeministër pati një bisedë me vetë Duracion më 22 qershor, gjatë së cilës përsëriti në vija të përgjithshme po ato që kishte shkruar në letër gati një muaj më parë. (Shih P. Correlli, *rep. cit.*, pp. 36-37).

shtetet e tjera e që vinte një hipotekë të rëndë mbi këto marrëdhënie.

Pas fitores së Kryengritjes Qeveria e Nolit e zhvillon veprimtarinë diplomatike në front të gjerë, duke patur parasysh si objektivin imediat (njohjen e saj), ashtu edhe një program me afat të gjatë që synonte ta vendoste shtetin shqiptar në një raport të ri me jashtë, me Fuqitë e Mëdha në mënyrë të veçantë. Në qoftë se në këtë aksion të gjerë (që nuk arriti të shtjellohet në shkallën e duhur asnjëherë), iu vu një theks Italisë — kjo është e kuptueshme; mjaft të kemi parasysh, veç të tjerave, gjeografinë. Në të vërtetë, në të njëjtën letër, të fundit të majit, që u përmend më lart, Noli na duket se nuk le shkas për asnjë ekuivok kur përcakton objektivat e lëvizjes me këto fjalë: «Qëllimi kryesor i kësaj lëvizjeje është që t'i japë Shqipërisë një qeveri shqiptare me një vijë politike të vetën, jashtë ndërhyrjeve ballkanike, duke u nisur nga fakti se politika e qeverisë aktuale është shkatërrimtare nga pikëpamja e marrëdhënieve të jashtme dhe përçarëse nga pikëpamja e jetës së brendshme».¹

Por ka edhe një aspekt tjetër të problemit që duhet nxjerrë në dritë. Aq sa është e tepruar të thuhet se Qeveria e Nolit realizoi «përmabysjen në qëndrimin e nacionalizmit shqiptar kundrejt Italisë» duke e bërë miqësinë me këtë të fundit themelin e politikës së saj të jashtme, po aq pa bazë është edhe të pretendohet se Musolini qëndroi pasiv dhe madje u tregua indiferent «ndaj thirrjeve që vinin nga Tirana».² Në fakt, ky është interpretimi që i bëjnë dy historianët e lartpërmendur italianë qëndrimin të Musolinit (i cili në këtë kohë përqendronte në duart e tij, bashkë me detyrën e kryeministrit edhe atë të ministrit të Jashtëm, pra të përgjegjësit të drejtpërdrejtë të politikës së jashtme të Italisë). Duket gjithsesi e çuditshme, edhe pra e pabesueshme, që Musolini t'i ketë kthyer krahët një mundësie të tillë, kur dihet se në Romë prej kohësh pritej veç rasti për ta vënë nën kupë qeverinë në Tiranë. Cila do të ketë qenë atëherë ajo arsye e madhe që e ka stepur Italinë kur nga ana shqiptare ka patur një disponim në këtë sens? Arsyetimi që bëhet në këtë rast, se Roma u ruhej kom-

1) DDI, 7^a serie, vol. III, d. 222, p. 135.

2) Shih E. Di Nolfo, *vep. cit.*, p. 175; P. Pastorelli, *vep. cit.*, p. 40.

plikaiconeve me Jugosllavinë e çonte t'i përmbahej besnikërisht «Paktit të miqësisë», që kishte lidhur me Beogradin vetëm 6 muaj më parë, nuk është bindës. Nuk mund të mendohet që Italia të ishte kaq e mbërthyer pas paktit në fjalë kur Jugosllavia tanimë fare haptazi po merrte kursin e ndërhyrjes në punët e brendshme të Shqipërisë.

Këtu nuk ka shumë vend as për supozime e hamendje, po të kemi parasysh zhvillimin real të ngjarjeve pak më vonë dhe evolucionin që bësoi përkatësisht politika e Italisë. Pa dyshim, mësuksesi i aksionit diplomatik të qeverisë së Romës për sigurimin e njohjes ndërkombëtare të Qeverisë së re shqiptare shënonte një etapë edhe në politikën italiane ndaj Shqipërisë. Ishte një moment refleksioni lidhur me qëndrimin dhe aksionin e mëtejshëm eventual në raport me kryengritjen shqiptare dhe Qeverinë e re të dalë nga gjiri i saj. Izolimi i plotë diplomatik i Qeverisë së Nolit nuk ishte detyruesisht krejt në disfavor të Italisë. Aq më tepër që me këtë rast duket se po rikonfirmohej edhe një herë «interesimi i paktë» i Anglisë në Shqipëri bashkë me njohjen nga ana e saj (Anglisë) të «pozitës dhe interesave të veçanta» të Italisë.¹ Mund të shfrytëzohej ky rast për t'i hedhur lakun Qeverisë Demokratike duke e shtrenguar atë, e mbërthyer siç ishte në darën e vështirësive të jashtme, të pranonte qoftë edhe tërthorazi tutelën italiane.

Kthesa italiane

Ka të ngjarë që në Romë të kenë gjykuar si moment të volitshëm për një sondazh të kësaj natyre. Ietrën që Noli i dërgoi Musolinit më 6 korrik për çështjen e kufijve. Me anën e kësaj letre ai kërkonte përkrahjen italiane me qëllim që grindjet kufitare me Jugosllavinë për shkak të Vermoshit e të Shën-Naumit, si dhe me Greqinë, për shkak të 14 fshatrave të Korçës, të gjenin zgjidhjen e drejtë në favor të palës shqiptare në mbledhjen e afërt të Konferencës së Ambasadorëve.² Qoftë për përmbajtjen e letrës së Nolit, qoftë për përgjigjen e Musolinit (të fillimit të gushtit), nga dokumentet diplomatike italiane mund të kri-

1) DDI, 7^a serie, vol. III, d. 381, p. 215.

2) Shih kapit. mbi çështjen e kufijve.

jojmë një ide pak a shumë të saktë.¹ Por nuk është vetëm kjo. Sipas burimeve italiane, nga letra e Nolit u mor shkas për një bisedë konfidenciale që vetë Musolini pati në mes të korrikut me të ngarkuarin me punë të Shqipërisë në Romë.² Gjithnjë sipas burimeve italiane, me atë rast i ngarkuari me punë i Shqipërisë pati marrë udhëzime nga Noli që të shtronte me Musolinin gjendjen e marrëdhënieve italo-shqiptare më gjerë.

Është e tepërt të theksohet se ky hap interpretohej po ashtu si një provë tjetër e dëshirës së qeverisë shqiptare për ta ngritur gjithë politikën e saj të jashtme mbi bazën e miqësisë së ngushtë me Italinë.³

Por konkluzioni është përsëri i shpejtuar, po të merret parasysh se qeveria e re shqiptare, duke e ndier izolimin në të cilin po binte, merrte iniciativa në drejtime të ndryshme me shpresë që të zhblokonte situatën e vështirë diplomatike. Mjafton të rikujtohet takimi që Noli pati në javën e parë të korrikut me të ngarkuarin me punë të Britanisë së Madhe, Parr, takim në të cilin ai jepte sigurime se «asnjë qeveri shqiptare, sikur edhe të donte, nuk mund të bënte kurrfarë politike tjetër veçse probritanike». Madje Noli bënte përpjekje për të fituar ai vetë njëfarë besimi në Forein Ofis, kur donte të merrte distancë nga politika amerikane, duke thënë se «vërtet kishte jetuar për një kohë të gjatë në Shtetet e Bashkuara», porse «kjo nuk e verbonte aq sa të mos shihte se Britania e Madhe ka një politikë të rercaktuar qartë në të gjitha çështjet evropiane, ndërsa SHBA nuk ka kurrfarë politike, përpos asaj të mospërzjerjes izolacioniste».⁴

Edhe një gjë duhet pasur parasysh për t'i gjykuar drejt në vlerën dhe kuptimin e tyre të vërtetë veprimet e Qeverisë Demokratike në fushën e politikës së jashtme: duhen dalluar objektivat që synoheshin me këto veprime dhe orvatjet që bëheshin për të shfrytëzuar kontradiktat midis fuqive. Shihet qartë se qëllimi i Nolit në këtë rast ishte që të krijonte bindjen te qarqet drejtuuese të Londrës se preferencat e tij, sidomos në fushën vaqurorë, nuk ishin meqenemos në anën e SHBA. Ato mund të ktheheshin edhe

¹ Shih DDI, 7^a serie, vol. III, d. nr. 431, 434, pp. 251, 253.
² P. Pastorelli, *vep. e cit.*, pp. 48-49.

³ P. Pastorelli, *vep. cit.*, pp. 48-49.

⁴ Raport i të ngarkuarit me punë Parr nga Durrësi datë 7.7.1924. PRO-FO/371. File nr. 9610

⁵ Po aty.

në favor të Britanisë së Madhe, po të kishte një predispozicion më të favorshëm nga ana angleze. Në fund të fundit, edhe Noli, kur erdhi në krye të Qeverisë Demokratike, që i shtrënguar «të hynte në lojë» për të çarë shtigje në murin e bojkotimit të Fuqive.¹

Por të kthehemi te bashkëbisedimi i Musolinit me të ngarkuarin me punë të Shqipërisë në mes të korrikut, për të ndjekur më tej fillin e politikës italiane. Sigurisht, nga kjo pikëpamje rëndësi më të madhe ka përmbajtja e këtyre bisedimeve. Lidhur me këtë ka dy versione. Njëri është ai që gjejmë në dokumentet diplomatike dhe në literaturën historike italiane. Sipas tij, i ngarkuari me punë i Shqipërisë, së pari, i paraqiti Musolinit kërkesën për një hua imediate prej 100 milionë lirash italiane.² Pastaj dhe kjo ka rën-

1) Interes paraqet një letër që, siç duket, Parri i ka dërguar në formë private Nikolsonit pas takimit me Nolin dhe që mban datën 15 korrik. Në këtë letër, diplomati anglez vlerëson shumë më tepër bashkëbiseduesin sesa politikanin. Ai e fillon duke thënë se biseda që pati me Peshkopin (të cilin e cilëson disa herë «the learned Bishop» «peshkopi i kulturuar») «ishte zbavitëse». Doemos nuk është vështirë të shquash te Parri edhe njëfarë ironie, si fjala vjen kur ai riprodhon fjalët e Nolit se «Anglia ka qenë mallkimi i Evropës dhe se institucionet e lira që ajo (Evropa) kopjoi nga anglezët kanë qenë një «farsë gjakësore». (Është rasti për të bërë një krahasim me atë pasazh të fjalimit që do të mbajë Noli në shtator në asamblenë e Gjenevës, pasazh në të cilin ai shpreh mendimin e tij mbi sistemin parlamentar borgjez, i cili nuk e justifikoi veten në situatën shqiptare të asaj kohe. Shih Kapitullin VI). Më tej Parri komenton me njëfarë habie faktin që «prelati i lartë nuk insiston aq në autoritetin e ungjillit dhe diskuton më shumë temat e parapëlqyera të udhëtimit dhe literaturës». Përbuzës i paragjykimeve fetare mbi «jetën në atë botë». peshkopi Noli nuk ngurron aspak t'i thotë diplomatit anglez (dhe mund të përfytyrojmë se ky hap sytë!) se «e gjithë e vërteta është te Omer Kaiami». Sigurisht, Noli do t'i pëlqente Parrit pikërisht kështu: më shumë një bashkëbisedues plot kulturë dhe «esprit», sesa kryetar i Qeverisë në Tiranë, prandaj ai e përfundon letrën e tij duke thënë se «i vjen keq që ai (Noli) nuk ka zgjedhur të mbetet peshkop në Durrës, sepse do të ishte një fqinj simpatik (pleasant)» (edhe Parri e kishte selinë në Durrës). Për ne vlerën më të madhe në këtë bisedë e kanë patjetër ato që Parri i kalon shkarazi me dy fjalë: entuziazmi me të cilin flet Noli për «frymën patriotike» të popullit shqiptar, për «shpirtin e mrekullueshëm të gjeneratës së re» në Shqipëri dhe përcimin që tregon nërsëri për «tiraninë e beiterëve». Letër e Parrit Nicolsonit, nga Durrësi, datë 15.7.1924. PRO-FO/371, File 9640.

2) Tel. i Marketit (Marchetti) nga Durrësi datë 23.7.1924, DDI, 7a serie, vol. III, d. nr. 400, p. 230; tel. i Musolinit për në Durrës, datë 9.8.1924, po aty, d. nr. 434, pp. 253-254. Shih po ashtu. P. Pastorelli, *vep. cit.*, pp. 49-50.

ndësi më të madhe, duke e shtruar problemin në kuadrin më të gjerë të marrëdhënieve politike italo-shqiptare, ai para-shtroi edhe dy propozime të tjera: një për lidhjen e një traktati politik midis dy vendeve (natyra dhe përmbajtja e të cilit nuk përcaktohet fare), dhe një tjetër për t'i dhënë Shqipërisë një sasi armësh e municionesh, që do të lejonte konsolidimin e pozitës së Qeverisë Demokratike.¹

Po si u pritën nga Musolini këto propozime të para-shtruara, siç thuhet, nga pala shqiptare? Musolini vetë jep disa sqarime në dy telegrame të njëpasnjëshme që i dërgonte të ngarkuarit italian Marketit në Durrës më 9 dhe 10 gusht.² Ai e paraqet çështjen sikur në takimin me të ngarkuarin me punë të Shqipërisë ai më shumë kishte dëgjuar sesa kishte folur; kishte mbajtur një qëndrim krejt të rezervuar përballë kërkesave dhe propozimeve shqiptare dhe se kishte treguar vetëm «një interesim të përgjithshëm»³.

Është e çuditshme, por është fakt se edhe në literaturën italiane të pasluftës nuk shfaqet dyshimi lidhur me vërtetësinë e deklaratave dhe pohimeve musoliniane, në një kohë kur vetë personazhi, tanimë i njohur e i zbuluar në sytë e të gjithëve, do të duhej të shtynte për të mbajtur sadopak rezervë për këto pohime. Kështu, jo vetëm që sigurimet e Musolinit merren për autentike, por edhe qëndrimi i tij komentohet si i frymëzuar nga një «pritmëni prudente», ndërsa rasti që iu paraqit si një okazion i humbur për «të afirmuar praninë e Italisë në Shqipëri si në pikëpamje politike, ashtu edhe ekonomike», rast të cilin ai që i detyruar ta flijonte për shkak «të konsideratave të politikës së madhe».⁴

Kjo nuk përputhet me versionin shqiptar të bisedimeve. Atë e gjejmë pjesërisht të pasqyruar në dokumentet italiane⁵, por tabloja del më e plotë edhe nga disa dokumente të Ministrisë së Jashtme shqiptare, nga raportet e të ngarkuarit me punë në Romë, që i zhvilloi këto bisedime. Rëndësi të veçantë në këtë drejtim ka një raport i tij i 20

1) *Po aty*.

2) Tel. i Musolinit, datë 9.9.1924, DDI, 7a serie, vol. III, d. nr. 434, tel. i Musolinit, datë 10.8.1924, që nuk është përshirë në DDI dhe citohet sipas P. Pastorelit, *vep. cit.*, p. 51.

3) *Po aty*.

4) *Po aty*, pp. 50-51.

5) DDI, 7a serie, vol. III

korrikut, pra vetëm 3-4 ditë pas takimit me Musolinin.¹ Ajo që bie në sy menjëherë nga ky raport është përmbysja e roleve në krahasim me burimet italiane. Në fakt del se në këtë rast iniciativën e ka patur më tepër Musolini sesa pala shqiptare. Përçapja e Qeverisë Demokratike (letra e lartpërmendur e Nolit e fillimit të korrikut), kishte një objekt të kufizuar, shtronte një çështje konkrete, atë të kufijve: kërkohej përkrahja e Italisë për t'u dhënë fund zvarritjeve. Nga ana italiane, kjo u mor si shkas për të shtruar në tërësi problemin e marrëdhënieve italo-shqiptare.

Musolini mendoi se ky ishte një moment i volitshëm për të dalë me disa propozime politike, thelbi i të cilave në fund të fundit do të ishte përgatitja e terrenit për një supremaci italiane në Shqipëri. Kështu, kërkesës së përfaqësuesit shqiptar që të bëheshin të gjitha përpjekjet për të arritur në zgjidhjen përfundimtare të çështjeve kufitare të shumtën brenda atij viti, Musolini iu përgjigj duke dhënë sigurime se Roma do të bënte çmos për të përkrahur tezën e Qeverisë Shqiptare. Por, aty për aty, përsëriti rezervën të formuluar prej kohësh nga diplomacia italiane, se në veprimet dhe qëndrimet e saj në çdo çështje që kishte të bënte me Shqipërinë, «qeveria italiane është e detyruar të mos kapërcejë disa kufij që i imponohen nga e drejta ndërkombëtare» në raport me Fuqitë e tjera të Mëdha. «Nuk mund t'ju mbrojmë fare sheshazi, — shtoi ai, — pa ngjallur dyshimet dhe mosbesimin e aleatëve». E vetmja zgjidhje ishte që «Italia të lidhej me Shqipërinë me një pakt të veçantë miqësie».² Është e qartë se po nxirrte krye edhe një herë projekti «për ta vënë Italinë në një pozitë juridike specifike për t'i përmbushur më mirë detyrat e saj si fuqi protektore»,³ pra për ta cenuar stáatusin e Shqipërisë si shtet sovran dhe për të vendosur mbi të një formë tutele jo vetëm *de facto*, por edhe *de jure*. Nga ana tjetër Musolini duket se ngurronte t'i hapte krejt kartat, prandaj sipas të ngarkuarit me punë shqiptar ai «nuk deshë ta shpjegonte mirë se cili ishte qëllimi i tij me fjalët «*patto politico*» (pakt politik)».⁴

Sipas disa burimeve të tjera shqiptare (në trajtën e

1) Raport i të ngarkuarit me punë nga Roma, datë 20.7.1924. A.Q.S.H. fondi 251. v. 1924, d. 246.

2) DDI, 7^a serie, vol. III.

3) Shih më lart.

4) Po aty.

«kujtiveve dhe shënimeve historike» që u përkasin ngjarjeve rreth kryengritjes demokratike)¹, Musolini e shoqëroi propozimin për një «pakt politik» edhe me ofertën që jo vetëm t'i jepte kredi qeverisë shqiptare, por të merrte përsipër të gjithë barrën e mbajtjes së ushtrisë shqiptare, madje të përballonte të gjitha shpenzimet e shtetit shqiptar. Kryetari i fashizmit «u interesua» po ashtu edhe për gjendjen ekonomike e financiare të vendit dhe, pasi dëgjoji prej bashkëbiseduesit të tij vështirësitë që duhej të përballonte qeveria e re, tha se «qeveria italiane ishte gati ta ndihmonte Shqipërinë me një hua prej 100 milionë a më tepër lirash», por me kusht «që iniciativa të vinte prej qeverisë shqiptare».² Edhe nga kjo mund të kuptohet se akordimi i një huaje eventuale do të lidhej me kushte politike, se kërkesës për hua nga ana shqiptare do t'i përgjigjej kërkesa për «paktin politik» nga ana italiane.

Tema e huasë vazhdon të jetë e pranishme në traktativat italo-shqiptare të atyre ditëve, siç rezulton nga një raport tjetër i të ngarkuarit me punë të Shqipërisë me dt. 1 gusht.³ Raporti i referohet një bisede me funksionarin e Ministrisë së Jashtme, Indelli, i cili ishte përgjegjës i seksionit që mbulonte Greqinë, Bullgarinë dhe Shqipërinë. Ky kishte marrë një raport të gjatë të Marketit nga Durrësi, në të cilin ai tregonte për një bashkëfjalim që kishte patur me Gurakuqin, i cili ishte pikërisht ministër i Financave. Aty Gurakuqi kishte shprehur qartë «dëshirën e qeverisë shqiptare për një hua ndërkombëtare».⁴ d.m.th. një hua me një pjesëmarrje të gjerë dhe jo prej një qeverie të vetme. Sigurisht

1) Është fjala konkretisht për «Kujtimet dhe shënimet historike» të Sejfi Vllamasit, një personalitet politik (i dorës së dytë) i viteve 20, që kishte qenë në radhët e partisë popullore dhe që, në përbërjen e saj heterogjene, kishte marrë anën e kraut konservator në debatin e madh që ishte zhvilluar në parlament rreth koncesioneve vajgurore. Ai kishte qenë edhe anëtar qeverie përpara qershorit. Në «Kujtimet dhe shënimet» e tij të depozituara në Arkivin e Institutit të Historisë pranë Akademisë së Shkencave (Fletore 7), S. Vllamasi thotë se ka riprodhuar dëshmitë personale që ia ka dhënë qysh në atë kohë i ngarkuari me punë i Shqipërisë në Romë Tefik Mborja lidhur me përmbajtjen e bisedës me Musolinin. (T. Mborja u përlye më vonë, duke u bashkuar me pushtimin fashist të Shqipërisë dhe duke u bërë një ndër hierarkët e partisë fashiste).

2) Sipas raportit të lartpërmendur të 20 korrikut.

3) Raport i legatës shqiptare nga Roma, datë 1:8.1924, AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 246.

4) Po aty.

kjo mendohej si një mënyrë për t'u shpëtuar presioneve politike. Kjo nuk i pëlqente Romës, prandaj i ngarkuari me punë prej bisedës me Indellin konkludonte se «Italia nuk dëshiron aq tepër që Shqipëria të gjejë një hua ndërkombëtare», se ajo nuk do të jepte për këtë përkrahjen e vet në Lidhjen e Kombeve. Indelli i kishte folur për vështirësitë që kishin dalë lidhur me huatë për Austrinë dhe Hungarinë dhe mbi këtë bazë kishte shprehur «pesimizmin e tij për suksesin e një huaje ndërkombëtare për Shqipërinë me anë të Lidhjes së Kombeve».¹ Dëshira e Romës, — përfundonte i ngarkuari me punë, — ishte që «Shqipëria huanë ta marrë drejtpërsëdrejti këtu (në Itali), që kjo të mundet në këtë mënyrë të ketë ndikim kryesor në jetën financiare dhe ekonomike të Shqipërisë».²

As nga burimet shqiptare nuk del me saktësi dhe me hollësi se cila ishte gjithë përmbajtja dhe deri ku shkante oferta italiane. Por ka arsye të mendohet se është fjala pikërisht për një skicë të planit italian për ta lidhur fort Shqipërinë pas Italisë, plan të cilin Mussolini do ta realizonte dy vjet më vonë me Paktin e Tiranës të nëntorit 1926, kur në Shqipëri ishte rikthyer në pushtet klika zogiste. Pakti në fjalë do të bënte një bujë të madhe jo vetëm në opinionin e vendit, por edhe në rrethet ndërkombëtare, pikërisht si një instrument diplomatik *sui generis*, që i siguronte Italisë në Shqipëri atë pozitë të privilegjuar «specifike» që diplomacia fashiste kërkonte këtu prej kohësh.³ Në literaturën historike, madje edhe në atë italiane, ky akt do të cilësohej si vendosje e një forme protektorati të kamufluar mbi Shqipërinë nga ana e Italisë fashiste.⁴ Edhe në verën e 1924-s, qoftë edhe në atë trajtë të përgjithshme e të papërcaktuar që i mbërriti Qeverisë demokratike, propozimi italian duket se tërhoqi vëmendjen e shqetësuar të rrethëve diplomatike. Zërat që u përhapën në Tiranë shkuan deri në vesh të qeverive: britanike, franceze, jugosllave dhe greke, dhe këto duket se kërkuan shpjegime në Romë për domethënien e inicativës italiane.⁵

1) Raport i legatës shqiptare nga Roma, datë. 1.8.1924. AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 246.

2) *Po aty*.

3) Shih A. Simonard. *Essai sur l'indépendance albanaise*, Paris 1942, pp. 445-455. Autori bën një analizë juridike të këtij Pakti dhe errin në konkluzionin se ai përbënte një «nasalitet» të maskuar për Shqipërinë nga Italia.

4) G. Salvemini. *Mussolini diplomatico*, Bari 1952, p. 155.

5) «Kujtimet dhe shënimet historike...», Fletore 7.

Këto janë, pra, dy versionet e bisedimeve italo-shqiptare që u zhvilluan në Romë në verë të 1924-s, duke marrë shkas nga përçapja e Qeverisë së Nolit lidhur me çështjen e kufijve. Përballë këtyre dy parashtrësive mund të ketë vend ndoshta edhe për pikëpyetje e supozime. Kurse në literaturën italiane përfaqohet tërësisht teza e Musolinit: për të ngarkuarin me punë shqiptar thuhet se «nga zelli i tepruar për të kryer porosinë e qeverisë së tij», nga e cila «kishte marrë edhe udhëzime të posaçme», «u largua së tepërmi nga konkluzionet që dilnin nga përgjigjet e Musolinit», duke ia servirur Tiranës në një formë sa më sensacionale.¹ Për vetë Qeverinë e Tiranës thuhet se raportin nga Roma me propozimet italiane ajo e priti «me entuziazëm». Por, si argument për të parën sillen përgënjeshtimet e vetë Musolinit, kurse për të dytën — dëshmitë e përgjegjësit të legatës italiane nga Durrësi, që e përshkruante Nolin «tërë kënaqësi dhe mirënjohje».²

Ka të dhëna se Noli është shprehur krejt ndryshe. Kështu, në intervistën dhënë korrespondentit të gazetës së Beogradit «Pravda» në Gjenevë më 9 shtator, kur qe pyetur «në se kishte siguruar ndihmën financiare të Italisë», Noli ishte përgjigjur me këto fjalë: «Çështja e huasë italiane ende është në hava. Mund t'ju them se kushtet e kësaj huaje janë tepër të rënda».³ Deklarata është domethënëse për gjithë qëndrimin e Nolit dhe qeverisë së tij në traktativat e korrikut me qeverinë italiane.

Pra, ka vend për dyshime. Në të vërtetë, çështja u kthye në një incident diplomatik midis dy qeverive dhe kjo vërtetohet edhe nga ana italiane. E pakënaqur nga zhurma që shkaktoi ajo, menjëherë në disa qarqe diplomatike (me shpjegimet që iu kërkuan qeverisë italiane nga ana e qeverive që i ndiqnin më nga afër punët shqiptare), Roma reagoi ashpër me «qortime» në adresë të qeverisë shqiptare. Të ngarkuarin me punë të Shqipërisë e thirrën në Ministrinë e Jashtme, ku i tërhoqën vëmendjen për «mungesën e seriozitetit nga ana e qeverisë shqiptare», e cila kishte shkelur sekretin diplomatik dhe kishte nxjerrë në shesh një propozim që i ishte bërë në rrugë konfiden-

1) P. Pastorelli, *vep. cit.*, pp. 50-51.

2) Tel. i Marchettit datë 23.7.1924.

3) «Pravda» e Beogradit datë 10.9.1924 (nga kupyra të shtypit të huaj; në AQSH, *fondi 249/1*, v. 1924. d. I-565).

cialë.¹ Kuptohet se ky fakt ishte interpretuar në Romë si një mungesë gatishmërie nga ana e palës shqiptare dhe kjo shpjegon nervozizmin me të cilin Musolini mori qëndrim në këtë çështje. Në një telegram që i dërgonte Marketit në Durrës, ai i cilësonte njoftimet e të ngarkuarit me punë të Shqipërisë në Romë si «teprime evidente të interesimit të përgjithshëm që ishte treguar nga ana italiane» dhe përfundonte me paralajmërimin se «përhapja e lajmeve të pasakta dhe të zmadhuara jashtë mase krijonte një situatë delikate, në të cilën Italia nuk mund t'i jepte përkrahjen e nevojshme qeverisë shqiptare».² Aluzioni ishte i qartë edhe për çështjen e kufijve, për të cilën siç u pa, Noli pati bërë më parë një kërkesë të posaçme.

Takimi Musolini-Noli

S'ka dyshim se ky incident shënonte një kthesë në marrëdhëniet e Qeverisë së Nolit me qeverinë italiane, dhe kjo del nga burimet e të dyja palëve. Kështu ish i ngarkuari me punë i Shqipërisë në Romë vazhdon të dëshmojë se «qysh atëhere gjithë simpatia për Tiranën u zhduk» në qarqet italiane. Si një pasojë e drejtpërdrejtë e kësaj për-

1) *Mujtimet dhe shënimet historike, Fletore 7.*

2) Tel. i Musolinit drejtuar Marketit datë 9.8.1924, *DDI, 7e série, vol. III, d. nr. 434, pp. 253-254.* Do të thoshim se paragrafi i fundit i nxjerrë nga ky telegram, po të lexohet jo vetëm drejtpërsëdrejti, por edhe midis rreshtave, duke treguar pozitën e vështirë në të cilën e pati ndier veten Musolini, është edhe një konfirmim e versionit të dalë nga burimet shqiptare. «Është fakt, — shkruante ai, — se ka mbërritur deri tek unë jehona që shkaktoi aty (në Tiranë) dhe gjetiu (pra edhe më gjerë, në qarqet ndërkombëtare — A. P.) raporti që ka dhënë z. Mborja dhe sidomos përhapja krejt e pashpjegueshme, që iu dha lajmeve që ai e ka quajtur të udhës t'i transmetojë me një pasaktësi të dukshme qeverisë së atyshme. E quaj të kotë t'ju theksoj — dhe ju vetë do të keni kujdes t'ia bëni të njohur edhe imzot Fan Nolit — se një përhapje e tillë (e lajmeve) dhe fryrja e tepruar që iu bë aty rezultateve të një bisede të përgjithshme që unë pata me të ngarkuarin me punë të Shqipërisë, nuk mund veçse të kontribuojë të krijohet një gjendje veçanërisht delikate, që sigurisht nuk do t'i shërbejë në praktikë ndihmës që do të mund të jepte qeveria italiane...». Vihet re këtu njëfarë fryme justifikimi përballë zhurmës që pati shkaktuar inisiativa italiane. Në këtë rast Musolini është vënë në pozitë mbrojtëse.

mendet refuzimi i Musolinit për t'u takuar me Nolin gjatë udhëtimit të këtij të fundit për në Gjenevë, ku në shtator do të hapej Asambleja e përgjithshme e Lidhjes së Kombeve.¹ Duket se Roma i ruhej megjithatë çdo prishjeje përfundimtare dhe donte gjithnjë të mbante një urë me situatën shqiptare, ndaj edhe në Ministrinë e Jashtme italiane u dhanë shpjegime se pritja e Nolit përpara Asamblesë së Lidhjes ishte «inoportune», por mund të realizohej gjatë rrugës së kthimit të tij prej Gjeneve.

Ky arsyetim pasqyrohet pikë për pikë edhe në dokumentet italiane.² Veç asaj, këtu gjejmë edhe disa të dhëna plotësuese mbi trajtimin «e brendshëm» paraprak të kësaj çështjeje midis qendrës dhe legatës italiane në Shqipëri. Del se përgjegjësi i legatës italiane, Marketi, jo vetëm që i pati rekomanduar Musolinit ta priste menjëherë Fan Nolin, por edhe pati kërkuar autorizimin që «me këtë rast legata italiane të hynte në marrëdhënie zyrtare me Qeverinë shqiptare», nga frika — shtonte Marketi, — se mos «Fan Noli shtrëngohej, për shkak të mosnjohjes, të merrej vesh me qeverinë britanike mbi bazën e së drejtës eskluzive për koncesionet vajguore».³

Mirëpo, Mussolini nuk i vuri veshin këtij paralajmërimi, i bindur siç ishte se qeveria britanike «nuk do të komprometohej në asnjë mënyrë me një qeveri të tillë» shqiptare. Ndaj edhe dha përgjigjen e tij negative. Këtë njoftonte së pari telegrafisht i ngarkuari me punë i Shqipërisë.⁴

Në dokumentet italiane gjejmë disa të dhëna më të hollësishme. Është fjala për telegramin që Mussolini i dërgonte Marketit më 22 gusht.⁵ Si arsye kryesore për refuzimin e takimit përmendej që në fillim se asnjë ndryshim nuk kishte ndodhur në qëndrimin e Romës për sa i përket njohjes së qeverisë shqiptare. Prandaj Mussolini nuk do të mund të shtonte asnjë element të ri në bisedën eventuale me «kryetarin e Qeverisë dhe ministrin e Financave». Më tej ai vihej në rolin e «këshilltarit» të qeverisë shqiptare (dhe këtu kemi një pikë tjetër të puqjes së dy versioneve): kishte

-
- 1) *Kujtimet dhe shënimet historike*. Fletore 7
 - 2) Tel. i Marchettit dat 18.8. dhe përgjigjia e Musolinit dt. 22.7.1924. DDI, 7a seria, vol. III, d. nr. 449. e 460.
 - 3) Tel. i mësipërm i Marketit datë 18.8.1924.
 - 4) Tel. i të ngarkuarit me punë nga Roma datë. 22.3.1924. AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 252.
 - 5) Tel. i mësipërm i Musolinit datë 22.8.1924.

të ngjarë, — thoshte ai, — që takimi, po të bëhej, mund të interpretohej keq në Gjenevë dhe të kuptohej sikur «ministrat shqiptarë kanë dashur të marrin direktiva të posaçme nga Italia para se të vinin në Lidhjen e Kombeve». Në pamjen e jashtme dukej sikur Musolini kishte kujdes të mos shkaktonte pakënaqësi të pala shqiptare, ndaj përmendte se ai kishte qenë i detyruar ta shtynte për më vonë edhe një vizitë të ministrit të jashtëm të Jugosllavisë. Veç asaj, ai siguronte se «interesimi i Italisë për Shqipërinë ishte i pandryshuar» dhe si provë për këtë tregonte «udhëzimet e posaçme» që i kishte dhënë delegacionit italian në Gjenevë «për të mbajtur kontaktet e nevojshme me delegacionin shqiptar». Nëpërmjet këtij kanali do të mund të konkordohej edhe takimi «që do të bëhej në një datë më të përshtatshme».¹ E megjithatë gjithë ky efuzion termash kortezie nuk mund të fshihte faktin se qeveria e Romës kishte bërë një hap tjetër në distancimin e saj kundrejt Qeverisë së Nolit.

Mjaft domethënëse në këtë rast është edhe kthesa në qëndrimin e Marketit, i cili në më pak se brenda një javë nga rekomandimi për të filluar «marrëdhënie zyrtare» me Qeverinë Demokratike, kthehej e propozonte braktisjen e saj totale, duke parashikuar rënien e saj të afërt. «të pashmangshme». Asnjëherë deri atëherë ai nuk e kishte përshtatur gjendjen e brendshme në Shqipëri me ngjyra kaq të zeza dhe asnjëherë më parë nuk e kishte quajtur si krejt të pashpresë pozitën e Qeverisë Demokratike. Pikërisht këtu ai shpik formulën e njohur që «të përkrahet Shteti shqiptar dhe jo kjo apo ajo qeveri shqiptare».² Është e qartë se me këtë ky nëpunës legatë nxitonte t'u përshtatej pikëpamjeve të shefit të diplomacisë italiane, që ishte vetë Musolini.³

Sa për takimin Musolini-Noli, ai u bë sipas parashikimit, aty nga mesi i tetorit, gjatë rrugës së kthimit të krye-

1) Po aty.

2) Relacioni i Marketit datë 24.8.1924, *Po aty, d. nr. 462*.

3) Autori italian P. Pastorelli pohon të njëjtën gjë kur thotë: «Me këtë analizë që i bënte gjendjes së brendshme shqiptare dhe me parashikimet që formulonte i ngarkuari me punë i Italisë i përgjigjej indirekt telegramit me të cilin Musolini e kishte ftuar dy javë më parë që «të mos u jepte trup hijeve» («non dar corpo alle ombre»), por t'i jepte Pallatit Kixhi (Chigi) një pasqyrë të qartë e të saktë për çka ndodhte në Shqipëri». *P. Pastorelli, vep. cit., p. 61*.

tarit të Qeverisë Demokratike. Në takim ishte i pranishëm edhe Gurakuqi. Por, për përmbajtjen e vetë bisedës nuk mund të jepet një ide krejt e saktë. Në arkivin e Ministrisë së Jashtme janë gjetur vetëm dy telegrame që i ngarkuari me punë në Romë i dërgonte qendrës më 12 dhe 16 tetor.¹ Prej telegramit të parë mësohet se Fan Noli bashkë me Gurakuqin, një ditë më parë (më 11 tetor), kishin patur një bisedë me Musolinin për gati dy orë. Aty përmbenden vetëm çështjet që u shtruan për diskutim, si çështja e përcaktimit përfundimtar të kufijve, ajo e huasë, e sigurimit të municioneve, dhe natyrisht çështja e njohjes së Qeverisë. Për vetë shkëmbimin e pikëpamjeve dhe qëndrimet përkatëse nuk thuhet asnjë fjalë. Telegrami i dytë i 16 tetorit është më i plotë. Veç çështjeve të ngritura gjatë takimit, aty bëhet fjalë edhe për qëndrimet italiane, për përgjigjet e Musolinit për secilën prej çështjeve të shtruara nga pala shqiptare. Nga të dy këto dokumente, një gjë del fare e qartë: se Roma e ka thelluar edhe më kthesën negative në qëndrimin e saj kundrejt Qeverisë së Nolit, se ajo është tanimë e padisponueshme në krejt linjën e politikës së jashtme. Musolini flet herë në mënyrë të hapur, herë përdor shprehje të mjegullta, evazive, por thelbi është se i hedh poshtë të gjitha kërkesat shqiptare. Në mënyrë të veçantë ai dredhon kur është fjala goftë për huanë, goftë për lëvrimin e një sasive municionesh që bëhet një nevojë aq e ngutshme përballë rrezikut gjithnjë e më real të sulmit nga veriu. Konkluzioni është se takimi i Nolit e Gurakuqit me Musolinin nuk dha asnjë rezultat. Më vonë, në dëshmitë e tij personale, i ngarkuari me punë do të shtojë se Musolini shfrytëzoi rastin për të shprehur «keqardhjen për nxjerrjen e sekretit lidhur me propozimin e aleancës» midis dy vendeve.²

Për sa u përket burimeve italiane, studiuesi P. Pastorelli na siguron se nuk gjenden gjurmë të takimit Noli-Musolini as në dokumentet e Ministrisë së Jashtme të Romës e as në shtypin e vendit.³ Megjithatë i njëjti autor shton se tema e bisedës nuk është vështirë të nxirret nga kërkesat që Qeveria Demokratike kishte shtruar më parë nëpërmjet kanaleve të zakonshme diplomatike. Kështu, sipas tij, Noli

¹ Tel. i të ngarkuarit me punë nga Roma datë. 12.10.1924, A.Q.S.H. fondi 251, v. 1924, d. 246.; tel. datë. 16.10.1924, po aty, d. 140.

² Kujtimet dhe shënimet historike... Fletore 7.

³ P. Pastorelli, *vep. cit.*, p. 69.

«kërkoj edhe një herë përkrahjen e Italisë, si në plan financiar (të huasë), ashtu edhe për çështjen e kufijve: ai kërkoi sidomos atë ndihmë ushtarake që ishte refuzuar në fillim të tetorit e që në Tiranë konsiderohej e domosdoshme... duke marrë parasysh rrezikun që po afrohej nga Zogolli dhe nga Jugosllavia».¹ Nga të gjitha këto të dhëna të tërthorta autori italian arrin në konkluzionin se «rezultati i qëndrimit të Fan Nolit në Romë qe negativ».²

Kjo vërtetohet edhe nëpërmjet dy korrespondencave prej Rome që janë botuar në shtypin grek të atyre ditëve: njera në gazetën «Elefteron Vima» dhe tjetra në gazetën «Skrip», të dyja të datës 17 tetor. Sipas këtyre shkrimeve del se të dy korrespondentët grekë të këtyre gazetave janë takuar e kanë biseduar me vetë Nolin, kanë marrë mendimin dhe përshtypjet e tij rreth takimit me Musolinin dhe pastaj kanë bërë edhe komentet e tyre.

Noli vetë e quan vizitën te Musolini «një vizitë thjesht miqësore». Meqenëse në Gjenevë (në Asarablenë e Lidhjes), ai kishte takuar kryeministrat e dy Fuqive të mëdha të Perëndimit, Makdonaldin e Britanisë së Madhe dhe Herionë e Francës, tani e «shihte të arsyeshme të takonte edhe z. Musolini si kryeministër i Fuqisë tjetër të madhe, e cila (për më tepër) ishte edhe fqinje me Shqipërinë».³ Është kuptimplotë që Noli i shmanget pyetjes mbi «mundësitë e një marrëveshjeje politike me Italinë» dhe përgjigjet se me Romën Shqipëria kishte përfunduar «një marrëveshje tregtare e cila nuk ishte ratifikuar akoma».⁴ Ai pranon se shumicën e tregtisë Shqipëria e bënte me Italinë (gati 3/4), por theksonte se «natyrisht edhe në marrëdhëniet tona tregtare mbajmë politikë të pavarur».⁵ Nga fjalët e Nolit, por edhe nga atmosfera e heshtjes që i rrethoi bisedimet italo-shqiptare, edhe korrespondentët grekë nxirrnin po atë përfundim: se nuk u arrit asgjë konkrete, se vizita e Nolit te Musolini nuk doli nga caqet e një vizite protokollare.

Të gjitha burimet, pra, qofshin të drejtpërdrejta apo të tërthorta, puqen në atë se kërkesat shqiptare hasën në

1) P. Pastorelli, *vep. e cit.*, pp. 69-70.

2) *To aty.*

3) Korrespondencë nga Roma, botuar në gazetën «Skrip» dt. 17.10.1924.

4) Është fjala për konventën tregtare të janar-shkurtit 1924. Shih më lart.

5) *To aty.* gazeta «Skrip».

refuzimin e plotë të qeverisë fashiste, të cilitin Mussolini u përpoq tani ta justifikonte «me mungesën e bazës legale» të Qeverisë së Nolit duke vënë si parakusht për çdo marrëdhënie pikërisht mbajtjen e zgjedhjeve.¹ Me këtë qeveria e Romës tregonte se po rreshtohej tanimë në pozitën e qeverisë britanike, e cila «mungesën e bazës legale» e kishte vënë që në fillim, dhe pastaj vazhdimisht, si pengesën kryesore në rrugën e njohjes së Qeverisë Demokratike.

Duke e gjykuar në tërësi çështjen e traktativave midis Qeverisë së Nolit dhe asaj të Romës, nuk mund të mos konkludohet se në literaturën italiane ajo është trajtuar në një mënyrë të njëanshme. Mjaft të dhëna të nxjerra nga vetë burimet italiane në një kuptim më të gjerë përpos dokumenteve diplomatike — DDI), vënë në dyshim interpretimin e autorëve të përmendur dhe madje bëjnë më të besueshëm versionin tjetër, sipas të cilit, çështja e «paktit politik» u bë shkak i bllokimit të marrëdhënieve italo-shqiptare dhe shënoi prishjen përfundimtare midis dy qeverive. Në të vërtetë, arsytimi i autorëve të mësipërm mbështetet, në thelb, në faktin se në dokumentet e Ministrisë së Jashtme italiane nuk është pasqyruar asgjë e kësaj natyre. Kjo, në vetvete, nuk është bindëse, sepse ka patur edhe raste të tjera bisedimesh e kontaktesh (madje edhe më të rëndësishme) për të cilat në dokumentet zyrtare italiane heshtet.

Le të përmendim bisedimet që u zhvilluan midis Mussolinit dhe Ninçicit në dhjetor 1924 në Romë² në një kohë kur makina e ndërhyrjes jugosllave në Shqipëri, në përkrahje të Zogut, për rrëzimin e Qeverisë Demokratike, ishte vënë tashmë në lëvizje. Pa hyrë hëpërhë në thelbin e këtyre bisedimeve që do të jenë objekt i një analize të posaçme³, asgjë nuk gjen të flitet në dokumentet e brendshme të Ministrisë së Jashtme në Romë. Vetë autorët italianë, që

1) Një qëndrim të tillë e paralajmëronte edhe i ngarkuari me punë Marketi, i cili, pasi ishte kthyer nga Shqipëria në ditët e para të tetorit, në bisedë me të ngarkuarin shqiptar në Romë, kishte thënë se «zhvillimi sa më shpejt i zgjedhjeve ishte «një kusht *sine qua non* për njohjen *de jure* të qeverisë». Pa nguruar rrugën e legalitetit, — shtonte ai, — është e pamundur të gjendet hua dhe (qeveria) nuk do të ketë as përkrahje politike nga Fuqitë e Mëdha. Raport i të ngarkuarit me punë nga Roma datë 2.10.1924. AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 252.

2) P. Pastorelli, *vep. cit.*, pp. 79-80.

3) Shih kapitullin VII

kanë patur mundësi të hyjnë në fshehtësitë e ministrisë së tyre të jashtme, pohojnë se në dokumentacionin e këtij dikasteri nuk ka asnjë gjurmë lidhur me zhvillimin e këtyre bisedimeve.¹

Veç asaj, këtë fakt e ilustron më së miri edhe rasti i përfundimit të Paktit të Tiranës të vitit 1926. Duke folur për prapaskenën e Paktit në fjalë, autori antifashist italian Gaetano Salvemini shpreh bindjen se Musolini e pati rrugën të sheshuar në saje të ndryshimit të qëndrimit nga ana e diplomacisë angleze, kur shefi i Foreign Ofisit i asaj kohe, Austin Chamberlen (Chamberlain), inauguroi një periudhë 10-vjeçare afrimi dhe lëshimesh në favor të synimeve italiane, veçanërisht në drejtim të Evropës juglindore, pra edhe të brigjeve shqiptare. Para se të arrihej në një marrëveshje («marrëveshje xhentelmenësh»), ka patur kontakte të vazhdueshme midis diplomatëve të të dy palëve, madje edhe të nivelit të lartë midis vetë Musolinit dhe Austin Chamberlenit, e megjithatë asgjë nuk figuron e regjistruar në dokumentet zyrtare. Lidhur me këtë, autori italian vë gishtin te një tipar karakteristik i diplomacisë imperialiste, kur thotë: «Disa shkëmbime pikëpamjesh ose disa lloj shërbimesh, sidomos kur është fjala për veprime të këqija, nuk lënë gjurmë në dokumentet e shkruara».²

Një emisar italian te Zogu

Duke u rikthyer te rasti ynë, është edhe një fakt tjetër që i jep kredi versionit shqiptar përse i përket propozimit që Musolini i bëri Nolit në muajin korrik. Është misioni i Aleksandër Lesonës. (Alessandro Lessona) (një konfident i Duçes, pranë Zogut në periudhën e qëndrimit të këtij të fundit në Jugosllavi. Çështja është fare e qartë. Zogu kishte patur gjithnjë nevojë për para për të mbajtur në këmbë regjimin e tij. Tani që ishte dëbuar jashtë vendit, atij domos i duheshin shuma edhe më të mëdha për të organizuar rikthimin e tij në fuqi.

Për këtë, sipas të dhënave, ai u vendos përkohësisht në Vjenë, duke e gjykuar atë si «pjacën» më të përshtat-

1) P. Pastorelli, *vep. cit.*, pp. 78-79.

2) G. Salvemini, *Musolini diplomatico*, Bari 1952, p. 155.

shme për të nxjerrë në pazar pasuritë e vendit. Këtu ai vendosi shumë kontakte. Ndër më të rëndësishmit duket se ka qenë pikërisht ai me emisarin e Musolinit, Aleksandër Lesona, i cili ka lënë edhe kujtimet e tij.¹ Telbi i misionit të Lesonës, sipas dëshmisë së vetë autorit, duket se ka qenë ky: Zogu ka kërkuar një ndihmë prej 200 mijë lirash², që i duheshin atij për të riorganizuar bandat e tij për aksionin ushtarak që do të ndërmernte kundër Qeverisë Demokratike, gjithmonë duke u nisur nga territori jugosllav. Po çfarë ishte gati të jepte Zogu për këtë? Lesona shkruan në kujtimet e tij se «Zogu nga ana e tij angazhohej që me t'u rikthyer në fuqi, të lidhte gjithë politikën e tij të jashtme pas asaj të Italisë, me qëllim që Italia ta kishte të garantuar zotërimin e plotë e të qetë të detit Adriatik». Zogu nuk kishte lënë pa shtuar me atë rast se propozime të këtij lloji i ishin bërë atij edhe nga anë të tjera, si p.sh. nga Britania e Madhe dhe nga Jugosllavia, porse ai parapëlqente të zgjidhte Italinë, sepse e dinte mirë se «gjithë zhvillimi i mëtejshëm i vendit të tij ishte i lidhur ngushtë me Italinë».³

Nuk rezulton që Musolini të ketë hedhur poshtë këtë transaksion që përmban në thelb pikat kryesore të projekt-

1) *Alessandro Lessona, Memorie, Roma 1963, 2 ed.*

2) Çështja ka një histori pak më të gjatë. Ajo fillon që në vitin 1923 dhe ia vlen të përmendet, goftë edhe me dy fjalë, sepse është mjaft domethënëse për konceptin që kishte Zogu dhe suita e tij për shtetin si vegël të thjeshtë të interesave private. Gjatë traktativave që u zhvilluan pikërisht në vitin 1923 midis qeverisë italiane dhe asaj shqiptare për traktatin e tregtisë e të lundrimit (sic dihet traktati u përfundua në janar 1924) Zogu përfitoi nga rasti për të hyrë në kontakt me Entin italian të Hekurudhave të Shtetit dhe i propozoi t'i shiste një pyll në Mat, të cilin Enti italian do ta përdorte për qereste për traversa të vijave hekurudhore. Për këtë ai mori edhe një paradhënie (prej 700 mijë lirash të kohës — rreth 150 milionë të sotme), kurse pjesën tjetër (shuma e përgjithshme vlerësohej deri në 3 milionë (rreth 300 milionë të sotëm), do ta merrte me kiste dora-dorës që do të tërhiqej qeresteja. Kontrata nuk u përfundua plotësisht, sepse qeveria e Romës e mbantë si mjet presioni për t'i shkëputur Zogut koncesione të tjera dhe për ta lidhur më fort pas politikës së saj.

Tani më 1924 Zogu i rikthehej propozimit të vjetër për të siguruar mjetet e nevojshme financiare për organizimin e bandave të tij kundërrevolucionare (*P. Pastorelli, vep. cit., p. 55*).

3) *Alessandro Lessona, Memorie, Roma 1963, 2 ed. pp., 81. Cituar sipas P. Pastorelli, vep. cit., p. 56.*

paktit që ai donte t'i impononte Qeverisë Demokratike të Nolit për ta lidhur atë fort pas Italisë.

Është po aq interesante dhe kuptimplote arsyeja përse allshjegjerishi Musolini-Zogu nuk pati sukses në atë kohë. Shpjegimet na i jep përsëri Lesona, i cili pasi i solli Duçes propozimin e mësipërm, mori prej tij dhe ia transmetoi Zogut pranimin italian për të marrë në shqyrtim kërkesat e tij, por me kusht që këto kërkesa ai, Zogu, «t'ia parashtronte drejtpërsëdrejti Musolinit në një letër ngushtësisht personale».¹ Kuptohet qëllimi i Duçes për ta mbërthyer Zogun pas vetes, duke siguruar që më parë garanci me shkrim, të cilat në rastin e duhur, ai të mund t'i përdorte si prova materiale të komprometimit të tij.

Po aq i kuptueshëm ishte edhe ngurrimi i Zogut për ta pranuar një shkëmbim të tillë, i cili do të rëndonte patjetër si një njollë në gjithë projektet, ambicionet dhe mund të rrezikonte gjithë karrierën e tij të mëtejshme politike. Nga ana e tij, kjo do të ishte një «paradhënie», një kapar tjetër i rrezikshëm. Prandaj ai i ktheu sytë nga anë të tjera për të shtënë në dorë ato mjete financiare e të tjera që i nevojiteshin për të organizuar nga jashtë rrëzimin e Qeverisë Demokratike. Siç do të shihet, ai iu drejtua autoriteteve jugosllave për «asistencë ushtarake», ndërsa gjeti derën e hapur te shoqëria angleze «Anglo-Persian», për mjete financiare.² Pavarësisht nga përfundimi që pati kjo çështje ajo që ka më tepër rëndësi në rastin tonë është se një plan i tillë ekzistonte në mendjen e përgjegjësve të politikës së jashtme të Italisë fashiste, pra dhe të vetë Musolinit. Pritej vetëm një rast i volitshëm për ta realizuar në praktikë dhe për t'i dhënë formën e një pakti zyrtar, pa dyshim me përmbajtje skllavëruese për palën shqiptare.

Del vetvetiu pyetja: kur një orvatje e tillë është bërë nga Musolini me Zogun në një kohë kur ky ishte jashtë vendit si emigrant, përse kjo marrëveshje të mos provohej të lidhej me qeverinë që ishte në fuqi në Shqipëri, me

1) Nga kujtimet e Lesonës, cituar sipas *P. Pastorellit, vep. cit., p. 56*. Musolini shprehej me këto fjalë: «I thoni Zogut, se unë jam gati t'i marr në shqyrtim kërkesat e tij me kusht që ai të m'i parashtrorë në një letër ngushtësisht personale, për të cilën i jap çdo garanci se do ta mbaj në fshehtësinë më të madhe». *Po aty.*

2) *P. Pastorelli, vep. cit., p. 57.*

Qeverinë Demokratike? Ky është një fakt që flet në të mirë të versionit të palës shqiptare. Vetë logjika e ngjarjeve tregon se nga ana italiane ka patur efektivisht kontakte dhe janë bërë përpjekje (doemos të druajtura e ekuivoqe në vështrim të situatës në lëvizje), përpjekje që kishin për qëllim ta kthenin Shqipërinë e dalë nga Lëvizja Demokratike e 1924-s, krejtësisht në një sferë të ndikimit italian.¹

Madje, duket se ky ka qenë boshti rreth të cilit është sjellë politika e Musolinit përkundrejt Revolucionit të 1924-s në Shqipëri, derisa u kuptua se Qeveria Demokratike e 1924-s nuk ishte përcuesja më e përshtatshme për depërtimin politik e ekonomik të Italisë në Shqipëri dhe edhe më gjerë në Ballkan. Nga veprimet dhe qëndrimet e saj, me gjithë lëkundjet dhe mangësitë, dukej se Qeveria e Nolit donte të dilte si një faktor i emancipimit të shtetit shqiptar në fushën e politikës së jashtme.

Roli i Anglisë

Qeveria e Londrës u bë strumbullari i fushatës që çoi në izolimin e plotë ndërkombëtar të Qeverisë së Nolit, Në qoftë se kishte diçka në të cilën qarqet drejtuese britanike ishin vërtet koherente, të patundura në politikën e tyre pas Luftës I, kjo ishte orientimi kundër çdo lëvizjeve përparimtare apo çlirimtare. Ajo gjeti një shprehje të qartë edhe në qëndrimin që mbajti Londra në ngjarjet shqiptare që në fillim të viteve 20. Ajo hyri në kontakte të ngushta me rrethet më reaksionare të vendit që të nesërmen e rimëkëmbjes së shtetit shqiptar pas luftime. Prapa këtyre lidhjeve fshihej, siç u theksua, dëshira e qarqeve angleze për të shkëputur koncesione të leverdishme për shoqëritë e tyre vajguore, gjë që nuk mund

1) Prandaj duken krejt jobindëse e artificiale pohimet e autorëve italianë që e shpjegojnë ofertën e Musolinit bashkë me kërkesën përkatëse si një projekt që dukej qartë që më parë se nuk do të realizohej, si një «skuzë për të refuzuar kërkesën zogolliane për ndihmë financiare». P. Pastorelli, *vep. cit.*, p. 56-57.

të mos çonte në thellimin e hendekut që ndante Britaninë e Madhe nga rrethet atdhetare shqiptare. Kjo u duk së pari në fazën e diskutimeve në parlamentin shqiptar lidhur me vajgurin, por u shfaq sidomos pas fitores së lëvizjes demokratike, kur Londra iu kundërvu Qeverisë së Nolit në gjithë frontin e politikës së jashtme.

Këtu nuk është vetëm (ose nuk është aq) qëndrimi negativ i Foreign Ofisit (gjoja duke u nisur nga konsiderata parimore) në çështjen e njohjes së Qeverisë Demokratike. Kjo ishte më tepër pasojë sesa shkak. Këtu rëndësi vendimtare kishte gjykimi që kishin formuar në kryeqytetin britanik mbi forcat që ballafaqoheshin në skenën politike shqiptare, opinioni *a priori* kundërshtues ndaj krahut më përparimtar dhe rrjedhimisht ndaj lëvizjes kryengritëse që u kurorëzua në qershor me formimin e Qeverisë Demokratike.

Sigurisht, gjithë kjo nuk mund të merret e shkëputur nga pozicioni i përgjithshëm i qeverisë angleze ndaj çdo lëvizjeje kryengritëse. Kjo vlente doemos edhe për Ballkanin. Madje në gjithë strategjinë perëndimore, gadishulli zinte një vend të veçantë. Ai duhej të ishte një hallkë e rëndësishme e «kordonit sanitar» që kishte për qëllim të ngrinte prita kundër ndikimeve revolucionare. Anglia ishte jo vetëm frymëzuesja, por edhe organizatorja kryesore e kësaj politike. Nuk mund të rrinte pa u shfaqur kjo edhe përkundërt lëvizjes demokratike në Shqipëri. Kjo politikë nuk ndryshoi as në kohën e qeverisë laburiste.

Duke shfletuar dokumentet e Foreign Ofisit, mund të krijohet përshtypja se ky qëndrim negativ i Anglisë ka qenë fryt i «opinioneve personale» të funksionarëve të veçantë të Ministrisë së Jashtme britanike. Ministri i Anglisë në Tiranë Airesi (Eyres) është cilësuar si «armiku nr. 1» i Qeverisë Demokratike, ai që ka ndikuar në mënyrë vendimtare në qëndrimin që mori qeveria e Londrës kundërt saj.

Kjo përshtypje është ushqyer pa dyshim edhe nga pakënaqësia që pati shprehur në adresë të Airesit Qeveria Demokratike në përçapjet që pati ndërmarrë pranë Foreign Ofisit. Vetë Fan Noli anonte më shumë nga mendimi se fajin kryesor në «prishjen» e tij me qeverinë e Londrës e kishte Airesi, i cili nuk e kishte feshehur kurrë «simpatinë e tij për ish-qeverinë».¹

1) Memorandumi i F. Ofisit për kryeministrin Makdonald datë 28.8.1924. PRO-FO/371. File 9640.

Nuk mund të mohohet kurrsesi roli i Airesit në këtë çështje. U fol për përzierjen e tij brutale në punët e brendshme të vendit kur ai në qershor mernte drejtpërdrejt pjesë në mbledhjet e qeverisë reaksionare, duke e nxitur atë që të merrte masa të rrepta represive për shuarjen e lëvizjes kryengritëse.¹ Pas fitores së revolucionit dhe vendosjes së Qeverisë së re në Tiranë, Airesi u largua nga Shqipëria në shenjë të qartë «disaprovimi» dhe u kthye vetëm nga fundi i gushtit², kur komploti i jashtëm për rrëzimin e kësaj qeverie ndodhej tanimë në një fazë të përparuar, pasi pati siguruar edhe përkrahjen e qarqeve angleze.

Njihën po ashtu raportet e relacionet që ai i drejton-te qendrës para dhe pas largimit të tij mbi zhvillimin e situatës në vend dhe mbi programin e Qeverisë së re. Të gjitha këto dokumente janë një provë e pakundërshtueshme e angazhimit të tij aktiv kundër lëvizjes kryengritëse dhe kundër Qeverisë së dalë prej saj.³

E megjithatë kuptohet se nuk ishte Airesi ai që e formulonte politikën e jashtme angleze; ai nuk radhitej as midis figurave kryesore të Forein Ofisit. Airesi ishte vetëm një zbatues i zellshëm i politikës së përcaktuar në qarqet drejtuese britanike edhe përsa u përket ngjarjeve shqiptare. Për këto qarqe, siç del nga një analizë përmbledhëse që bëhej në Departamentin jugor të Forein Ofisit në fund

1) Shih më lart, kap. I.

2) Nuk mund të mos tërheqë vëmendjen fakti se Airesi (Eyres) u kthye përsëri në Shqipëri, megjithëse ishte cilësuar si «person i padëshiruar» nga Qeveria Demokratike. Ky ishte një manifestim tipik i qëndrimit prej fuqie të madhe, që nuk përfillte rregullat elementare të marrëdhënieve ndërshtetërore.

3) Airesi tregojë aq «i paduruar» në armiqësinë e vet kundrejt Qeverisë Demokratike saqë, menjëherë pas rikthimit të tij në Shqipëri, në fillim të shtatorit, nxitonte t'ia raportonte qendrës situatën në vend me shprehjet më pesimiste për fatin e revolucionit, madje me një gjuhë që tregon nxitjen e tij të papërmbajtur për ndarjen e vjetër toskë-gegë dhe grindjet midis tyre. «... Përmbysja e situatës, — thoshte ai midis të tjerash, — është e pashmangshme... Zogu tani ka më tepër përkrahës sesa kishte kur ishte në fuqi... të gjithë njerëzit i kanë drejtuar sytë nga ai dhe në qoftë se ky ia mbërrin, të gjithë do të ngrihen kundër toskëve(sic!)». Raport i Airesit (Eyres) nga Durrësi, datë 2.9.1924, PRO-FO/371, File 9640.

të korrikut¹, zhvillimi i gjendjes në Shqipëri, qysh prej rimëkëmbjes së shtetit shqiptar pas Luftës I, krahasohet me gjendjen që u krijua në Turqi pas Revolucionit Xhonturk të vitit 1908, tipar kryesor i të cilit ishte degjenerimi në luftë për pushtet midis grupeve pa kurrfarë kujdesi për «interesat e përgjithshme si shtet.»

Si forcë kryesore lëvizëse këtu cilësohet «Klika» siç u quajt grupimi politik heterogjen që veproi në vitet 1921-1924, ku u ndodhën pranë si elementë reaksionarë ashtu edhe përparimtarë. Është kuptimplotë që nga gjithë kjo «klikë» në Londër bëhet dallim për A. Zogun, i cili, me gjithë «disa të meta të tij personale» (si p.sh. «paaftësinë për të gjykuar njerëzit dhe për të mbajtur fjalën»), prapëseprapë «në veten e tij ka farën e patriotizmit dhe aftësisë administrative». Për të gjitha fatkeqësitë e telashet e ndryshme fajet i ka gjithmonë «klika», e cila në vend që të mbledhet rreth «shefit», organizon komplete, revolta, atentate. Vetë lëvizja kryengritëse nuk është gjë tjetër veçse një pasojë logjike e kësaj lufte tinzare. «Klika» bëri çmos ta ngrinte vendin kundër qeverisë dhe «duke marrë shkas nga vrasja e Avni Rustemit» (të cilën në Forein Ofis e paraqesin thjesht si vrasës (assassin) i Esat Toptanit) arriti të marrë pushtetin dhe të formojë një qeveri të re.

Është me të vërtetë, domethënëse që në gjithë letërkëmbimin e brendshëm të Forein Ofisit Qeveria e Nolit identifikohet me «klikën», ajo është «klika në fuqi», ndërsa Zogu dhe pasuesit e tij brenda dhe jashtë vendit paraqiten si viktima të «dhunës revolucionare.» Kështu terreni për «triumfin e legalitetit» ishte përgatitur me kohë. As për këtë parullë Zogu nuk mund të mburrej se ishte një shpikje e tij origjinale.

Është edhe një fakt tjetër kuptimplotë që tregon se qëndrimi i qeverisë së Londrës kundrejt Qeverisë së Nolit ishte një shprehje e politikës zyrtare të Britanisë, formuluar në nivel të lartë, dhe jo rrjedhojë e ndikimit të këtij apo atij funksionari të veçantë. Është fjalla për përkujtesën që në Forein Ofis patën përgatitur posaçërisht për kryeministrin Makdonald para se ky të shkonte në Gjenevë për mbledhjen e Asamblesë së përgjithshme të Lidhjes së Kombeve

1) PRO—FO/371 Albania 1924, File n° 9641.

që hapej në shtator.¹ Përkujtesa i kushtohej kryekëput çështjes së qëndrimit kundrejt Qeverisë së re shqiptare dhe mbante firmën e njërit prej përgjegjësve kryesorë të Ministrisë së Jashtme — Nikolsonit. Përkujtesa, siç vihej në dukje nga vetë hartuesit, përfshihej në dokumentacionin që Makdonaldi merrte me vete në Gjenevë, në eventualitetin që kryeministri të ndeshej me këtë çështje, p.sh., në rast se kryetari i Qeverisë shqiptare Fan Noli (që siç ishte bërë e ditur do të shkonte vetë në Asamblenë e Lidhjes së Kombeve në krye të delegacionit shqiptar) do të kërkonte të takohej me kryeministrin «socialist» britanik për të kërkuar sqarime, që ai (F. Noli) mund të mendonte se nuk i kishte marrë plotësisht deri atëherë nëpërmjet kanaleve të zakonshme të Forein Ofisit.

Në këtë përkujtesë, ajo që bie në sy menjëherë, është pikërisht përgënjeshtrimi që i bëhet tezës së Qeverisë Demokratike dhe veçanërisht të F. Nolit, se gjëndja aktuale e marrëdhënieve anglo-shqiptare e kishte burimin te «ndjenjat e pajustificuara të simpatisë që Airesi ushqente kundrejt qeverisë së mëparshme, ndërsa qeverinë e re e shikonte me sy të disfavorshëm». F. Noli dhe kolegët e tij, lexojmë në përkujtesë, e zmadhojnë ndikimin e Airesit në marrjen e vendimeve dhe përcaktimin e qëndrimeve të qeverisë britanike. Pranohej se mendimet e diplomatëve, të Airesit në rastin konkret, nuk mund të kalonin pa u vënë re («deri në njëfarë mase kjo mund të ishte e vërtetë»). porse ato nuk mund të kishin dhe nuk kishin peshë vendimtare. Përkujtesa i kujtonte kryeministrin se Forein Ofisi kishte adoptuar kundrejt Qeverisë shqiptare një pozitë të menduar mirë, të diktuar jo nga sugjerime të shkëputura individuale, por nga konsiderata të politikës së përgjithshme britanike, politikë, së cilës i viheshin etiketa parimore: pretendohet se «legaliteti» i mungonte Qeverisë së Nolit, kurse Zogu dhe banda e tij e kishin marrë atë me vete.²

Një pikë tjetër që tërheq vëmendjen në këtë dokument është konkluzioni në të cilin mbërrijnë hartuesit e tij se gjoja Shqipëria nuk e kishte justifikuar veten si shtet më vete që prej rimëkëmbjes së saj më 1919, «me gjithë për-

1) Përkuitesë e F. Ofisit, datë 28 gusht 1924 për kryeministrin Makdonald, PRO—FO/371, File nr. 9640.

2) Po aty.

projekjet dhe madje favoret e Lidhjes së Kombeve» Njëherë Forein Ofisi e kishte pranuar idenë që Shqipëria ta gjente rrugën e saj të zhvillimit përmes një protektorati ndërkombëtar të realizuar pikërisht nëpërmjet Organizatës së Gjenevës. Tani që kishte ardhur në fuqi Qeveria e Nolit, edhe kjo ide, e pretenduar «konstruktive», duhej lënë mënjanë pasi, — siç theksohej në përkujtesë, — Forein Ofisi nuk kishte arsye t'i ofronte kurrfarë ndihme një qeverie të krijuar në rrugë revolucionare.¹

Kjo tregon se në mjedise të ndryshme ndërkombëtare, edhe pas Luftës I, vazhdonte të çarkullonte teza e «dëshimit të eksperimentit të qeverisë shqiptare» dhe mbi këtë bazë bëheshin përpjekje të herëpashershme në trajta e variante të ndryshme që kishin të gjitha si thelb vendosjen e shtetit shqiptar nën vartësinë juridiko-ndërkombëtare, vartësi që mendohej se mund të bëhej më e gëlltitshme nën mbulesën e Lidhjes së Kombeve.

Vlen po ashtu të vihet në dukje se përkujtesa e Forein Ofisit përmban dy pakënaqësi: njëra kundrejt Shqipërisë, e cila sipas shprehjes së Nikolsonit nuk duhet të mendojë më se është «fëmija e përkëdhelur e Evropës» (!) dhe të kërkojë ndihma financiare që nuk di t'i administrojë.² E dyta është në adresë të Qeverisë së Nolit, e cila me vrazhdësi perandorake cilësohej si mishërimi i së keqes, i «paafetësisë së shqiptarëve për vetqeverisje», prandaj duhet vënë në bangon e të akuzuarve në Asamblenë e Lidhjes së Kombeve.

Nga ky dokument del fare qartë se në shenjestër ishte Qeveria Demokratike, si një qeveri e dalë nga një lëvizje përparimtare. Në Forein Ofis nuk e dënonin për «dëshimet e së kaluarës», por për atë që mund të bënte në të ardhmen si në politikën e brendshme ashtu edhe në politikën e jashtme. Dhe shenjat ishin që tani «shqetësuese» për Londrën. Nga kjo mund të kuptohet se cilat ishin kriteret që e udhëhiqnin diplomacinë angleze në atë kohë: kriterë thellësisht reaksionare që duhej të përlligjnin frenimin e çdo lëvizjeje përparimtare; në rastin konkret objektivi ishte që të rikthehej në fuqi një klikë feudale-bajraktare dhe të mënja-

1) Përkujtesë e F. Office-it, datë 28 gusht 1924 për kryeministrin Makdonald; PRO-FO/371, File nr. 9640.

2) Po aty.

noheshin ato forca politike përparimtare që mund ta vinin zhvillimin e mëtejshëm të Shqipërisë mbi baza më të drejta nga ana shoqërore, por edhe më solide e më moderne nga ana shtetërore. Kuptohet, një shtet shqiptar i konsoliduar nuk do të bëhej lehtë vegël e bindur e kësaj apo asaj Fuqie.

Kapitulli III

MBYLLJA NGA ANA E SHTETEVE FQINJE

Predispozicioni i Qeverisë së Nolit

Ajo që e rëndoi edhe më tepër izolimin ndërkombëtar të Qeverisë Demokratike ishte mbyllja pothuajse e plotë që ajo hasi në marrëdhëniet me shtetet e Ballkanit, e veçanërisht me dy shtetet kufitare — Jugosllavinë dhe Greqinë. Qëndrimi i shteteve fqinje ka dalë në shesh edhe nëpërmjet çështjes së njohjes së Qeverisë së re shqiptare. Por kjo çështje, në pamje të parë çështje specifike e një natyre juridiko-ndërkombëtare, duhet plotësuar edhe me disa të dhëna të tjera, aq sa janë të disponueshme, për të formuar një ide më të saktë mbi situatën diplomatike në të cilën u ndodh Qeveria e 1924-s.

Një plotësim sjellin pa dyshim problemet kufitare si dhe ato të pakicave kombëtare,¹ që vazhdojnë të qëndrojnë në rendin e ditës edhe gjatë periudhës qershor-dhjetor 1924. Kishte pa dyshim kontradikta, divergjenca për këto probleme, jehona e të cilave kishte mbërritur deri në instancat ndërkombëtare. Kishte pasur prej kohe luftë pikëpamjesh, por Qeveria e 1924-s u kushtoi atyre vëmendje të madhe, i ktheu në një nga aspektet kryesore të veprimtarisë së saj diplomatike. Nga kjo pikëpamje mund të thuhet se problemet majisen, acarohen kur është në fuqi një qeveri demokratike, sepse kjo e ngre fort zërin, si për të kundërshtuar pretendimet e padrejta të qeverive fqinje, ashtu edhe për të kërkuar një ndjenjë përgjegjësie më të madhe nga

1) Këto dy çështje do të jenë objekt trajtimi të veçantë në kapitujt vijues të këtij punimi.

ana e fuqive evropiane në trajtimin e gjithë problemit shqiptar, pra edhe të kufijve.

Nuk është e saktë të thuhet se orvatjet e Qeverisë së Nolit për një rregullim sa më të shpejtë e përfundimtar të këtyre problemeve vinin në kundërshtim me një nga pikat e programit të Qeverisë, të shpallur që të nesërmen e fitores së Kryengritjes, mbi dëshirën për «marrëdhënie miqësore me të gjitha shtetet e veçanërisht me fqinjët». ¹ Këtë dëshirë të saj Qeveria e re e theksonte në mënyrë të veçantë edhe me telegramin që Noli i dërgoi më 19 qershor sekretarit të Lidhjes së Kombeve, Drumond. Aty fqinjësia e mirë cilësohej si një ndër pikat përparësore të qeverisë në fushën e politikës së jashtme. ²

Por kjo nuk donte të thoshte që të liheshin në hesh-tje problemet që ekzistonin me këto vende. Përkundrazi, vetëm zgjidhja e problemeve pezull, që mbanin në tension të vazhdueshëm Qeverinë shqiptare dhe që shkaktonin një gjëndje pasigurie të përgjithshme, ishte një parakusht për ndërtimin e marrëdhënieve normale të fqinjësisë së mirë. Është e sigurt se asnjëherë më parë ballafaqimi diplomatik me qeveritë fqinje për këto probleme nuk ka qenë më i hapur sesa gjatë atyre pak muajve të qëndrimit në fuqi të Qeverisë Demokratike. Por, është po aq e vërtetë se kjo nuk mund t'i vihet për faj «intransigjencës» apo «prirjeve turbulluese» të një qeverie të dalë nga një lëvizje kryengritëse. Edhe në këtë rast, Qeveria shqiptare ishte në pozita kryekëput mbrojtëse, në kuptimin që përpjekjet e saj ishin të drejtuara në mbrojtjen e disa të drejtave themelore të Shtetit shqiptar në shkallë ndërkombëtare. Nuk mund të bëhet fjalë për kurrfarë kursi politik të përcaktuar, për asnjë kundërvënie globale të Qeverisë së Nolit kundrejt fqinjëve.

Në qoftë se kihet parasysh vendosja e një bashkëpunimi të frytshëm e të fqinjësisë së mirë mbi baza me të vërtetë të drejta e të qëndrueshme, duke marrë si premisë barazimë e plotë të Shqipërisë kundrejt të gjitha shteteve ballkanike, atëherë asnjë qeveri tjetër shqiptare, në periudhën midis dy luftërave, nuk ka qenë më e prirur, më e kualifikuar për të tilla përpjekje, si për politikën e brendshme, ashtu edhe për atë të jashtme. Rëndësia e programit të

1) *Dokumente e materiale historike...*, Tiranë 1959, d. nr. 160, f. 152.

2) *Dokumente e materiale mbi veprimtarinë e Qeverisë së Nolit, «Studime historike», nr. 4/1973, f. 119.*

shpallur më 18 qershor nuk kufizohet me anën deklarative. Përmbajtja e tij ka të bëjë me gjithë fizionominë politike, madje ideologjike të qeverisë së dalë nga Revolucioni i 1924-s. Nuk e teprojmë po të themi se Qeveria e 1924-s (duke gjykuar jo vetëm nga çka arriti të bënte, por edhe nga çka u nis të bënte) ishte njësoj e frymëzuar nga parime e ideale mjaft të përparuara, si për ripërtëritjen e shoqërisë shqiptare, ashtu edhe për ndërtimin e marrëdhënieve ndërballkanike.

Domethënese në këtë drejtim janë intervistat që vetë Noli u pati dhënë në fillim të shtatorit 1924 korrespondentëve të gazetave nga dy vendet fqinje, në Gjenevë, gjatë kohës që ai (Noli) mori pjesë në punimet e Asamblesë së Lidhjes.

Në biseda me të dërguarin e gazetës greke «*Politika*», kryeministri shqiptar shprehte predispozicionin e qartë të Qeverisë së tij për t'u dhënë një hov të veçantë marrëdhënieve me Greqinë.¹ Nga biseda e Nolit del se në gjithë politikën e saj të fqinjësisë së mirë, bashkëpunimin dhe afërsimin greko-shqiptar. Qeveria Demokratike prirej ta vinte në vend të parë. Me interes është përgjigjja që i jep Noli pyetjes nëse «ekzistojnë shkaqe esenciale të ftohtësisë midis grekëve dhe shqiptarëve». «Përkundrazi, — thotë Noli, — ekzistojnë kaq lidhje race dhe historike dhe kaq bashkësi interesash midis dy popujve sa që çdo njeri i arsyeshëm dhe i çliruar nga paragjykimet është e natyrshme të presë lidhje shumë miqësore dhe bashkëpunimi të sinqertë midis të dy shteteve. Është e tepërt të flasim për origjinën e përbashkët të dy popujve, që kanë po ata stërgjyshër. Gjithnjë të dy popujt kanë dhënë e kanë marrë. Kolonitë greke, që njëherë e një kohë lulëzonin në Iliri u lanë gjakun grek shqiptarëve dhe kolonitë shqiptare të shumta në Greqi që po shkrihen përditë, e forcuan shumë kombin grek. Janë të njohura shërbimet që i bënë Greqisë dhe roli me rëndësi që luajtën në Greqi popullsitë shqiptare me luftëtarët e tyre trima gjatë Kryengritjes greke të 1821-së: shumë prej heronjve të saj ishin shqiptarë».² Nga ana tjetër, shtonte Noli, shqiptarët nuk harronin se Rilindja e tyre

1) Intervistë e Nolit me korrespondentin e gazetës greke «*Politika*» dt 9.9.1924 (Nga kupytrat e shtypit në AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 225.)

2) Po aty.

Kombëtare shumë frymëzime i kishte marrë nga kultura greke dhe madje «apostujt e parë të idesë shqiptare kanë qenë të diplomuar të gjimnazit «Zosimea» të Janinës, një nga vatrat e kësaj kulture. Sipas kryeministrit shqiptar, marrëdhëniet greko-shqiptare po hynin në një fazë të re me marrëveshjen që po arrihej për zgjidhjen e çështjes së kuifjve. «Interesi i lartë i të dy popujve, — theksonte me atë rast Noli, — imponon që t'i jepet fund kësaj çështjeje dhe të mbyllet njëherë e përgjithmonë ky defter i vjetër që na shpuri në vëllavrasje». Noli bënte thirrje për t'i kthyer sytë nga e ardhmja kur kërkonte që «të dyja palët të mendojnë më me qetësi dhe më shumë për ato çështje të panumërta që na afrojnë dhe që mund të ndriçojnë dhe të forcojnë vëllazërinë tonë, duke ia lënë së kaluarës ato që deri tani na kanë ndarë».¹

Një pengesë tjetër për zhvillimin e marrëdhënieve midis dy vendeve Noli e shikonte edhe në faktorin fetar, në paragjykimin që kishte zënë vend në disa qarqe greke, të cilat mendonin se Shqipëria, për shkak të shumicës së popullsisë së saj myslimane, nuk ishte veçse «një Turqi e vogël e maskuar».* Noli e quajti këtë si akuzën më të padrejtë e më të pathemeltë «prej gjithë akuzave, paragjykimeve e shtrembërimeve që na hedhin mbi krye», sepse, me gjithë shumicën e popullsisë myslimane, vëshirë të kishte «shtet të qytetëruar... ku të mbretëronte aq, deri në indiferentizëm, toleranca fetare sa në Shqipëri». Provë më domethënëse ishte fakti se në krye të qeverisë shqiptare ishte ai, Noli, peshkop ortodoks, «dukuri kjo e panjohur edhe në shtetet me popullsi ortodokse».²

Në një bisedë që i kushtohej tërësisht problemit të zhvillimit të marrëdhënieve shqiptaro-greke, Noli nuk mund të linte mënjanë çështjen e pakicave kombëtare në të dyja anët e kufirit. Ishte koha kur mbi kurriz të popullsisë shqiptare të Çamërisë binte pesha e rëndë e pasojave të marrëveshjes së lidhur midis Greqisë e Turqisë për shkëmbimin e popullsisë (Marrëveshja e Lozanës, janar 1923): banorët grekë të Anadollit do të shkëmbeheshin kundrejt

1) AQSH, *fondi 251, viti 1924, d. 225.*

*1) Mund të merrret me mend çfarë efekti bënin në opinionin grek këto paragjykime në një kohë kur ishte ende e freskët tronditja nga disfata e rëndë në Luftën Greko-Turke.

2) *Po aty.*

«turqve» të Greqisë, por nën etiketën e «turqve» po dëboheshin nga vatrat e tyre edhe shqiptarët e Çamërisë. Si kryetar i delegacionit shqiptar në Asamblenë e Lidhjes, Noli nuk do të ngurronte ta denonconte ai vetë, personalisht, këtë shpërngulje me dhunë të shqiptarëve, duke e marrë fjalën disa herë gjatë qëndrimit të tij në Gjenevë.¹ Por, nga ana tjetër, preokupacioni i tij ishte që të krijohet një klimë e re, të hapej një kapitull i ri në marrëdhëniet ndërbalkanike në tërësi, e veçanërisht në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë. Prandaj u bënte thirrje jo vetëm ndënjave elementare të drejtësisë, por edhe interesit të përbashkët të të dy vendeve fqinje, një interesi të kuptuar drejt. Kur thoshte se «pakicat kombëtare, si këtej, ashtu edhe aty, duhet të jenë jo si një pengim, por si një lidhje dhe si një urë për marrëveshjen midis nesh».² Sigurisht për Ballkanin e asaj kohe kjo nuk ishte reale. Megjithatë, ky fakt ka rëndësi në vetëvete, pikërisht si një tregues i konceptimit nollian të marrëdhënieve ndërbalkanike. Noli shkante edhe më tej në përfytyrimin e tij mbi të ardhmen e gadishullit kur përmendte idenë e «konfederatës ballkanike». Ai thoshte: «Me këtë rrugë (me rrugën e bashkëpunimit — A.P.) ne mund të arrinim madje, edhe në konfederatën ballkanike. Përse jo? Kjo është një gjë kaq e bukur, praktike. Përse të mos besojmë, përse të mos japim tërë besimin tonë në një ide? Nga realizimi i këtij besimi do të fitonim të gjithë».³

Është patjetër e vështirë të cilësohet «konfederata ballkanike» si e realizueshme në ato rrethana dhe çdo diskutim do të ishte i tepër nga kjo pikëpamje. Këtu kemi të bëjmë padyshim me një shprehje të idealit të Nolit. Megjithatë, del një pyetje. A thua Noli të ishte aq i rrëmbyer nga vegimet idealiste sa të besonte në mundësinë praktike të realizimit të kësaj ideje në situatën ballkanike të asaj ko-

1) Shih Kapitullin IV.

2) Gazeta «Politika», datë 9.9.1924.

3) Po aty. Gjerësia e mendimit dhe sinqeriteti i Nolit jo rrallë bënin efekt edhe te intervistuesit e tij. Kështu korrespondenti i gazetës «Politika» e përfundonte shkrimin e tij me këtë fjali plot emocion: «Në këtë pikë mori fund në mënyrë më të natyrshme e me tonin më të fortë bashkëfjalimi ynë me kryeministrin e Shqipërisë dhe atëherë i dhamë dorën njëri-tjetrit me po atë zemër të ngrohtë: dorë vëllezërisht». Po aty. Por më tej do të dilte gjithnjë më qartë se kjo frymë nuk karakterizonte gjithë shtypin grek të kësaj periudhe.

he? Të mos harrohet se parulla e «konfederatës ballkanike» nuk ishte thjesht fryt i imagjinatës noline, të orientuar si gjithmonë drejt idealeve më përparimtare. Ideja qarkullonte prej kohësh në qarqet më përparimtare të gadishullit dhe breza të tërë demokratësh revolucionarë i kishin kushtuar edhe mendime, edhe përpjekje. Nuk është e rastit që kjo ide, e pajisur doemos me një përmbajtje cilësisht të ndryshme, u çua më tej, për një kohë dhe nga Internacionalja Komuniste. Pra, Noli na del në këtë rast si përfaqësues i idealit të një Ballkani të ri, dhe aq e madhe është tek ai forca tërheqëse e çdo gjëje të re e përparimtare, sa që nuk ngurron të bëhet zëdhënës i këtij ideali edhe kur ka ardhur në krye të një qeverie, edhe kur ka përpara «murin» e përfaqësuesve të botës së vjetër të mbledhur në Lidhjen e Kombeve. Nga ana tjetër, nuk është pa rëndësi të vihet në dukje se, pavarësisht nga ndonjë rrëmbim utopist a prirje romantike, që nuk e kanë lënë Nolin as edhe kur është në postin e kryeministrit, nga këto qëndrime del një fakt i pamohueshëm: se në gjirin e Qeverisë së 1924-s kishte një korrent të fuqishëm, i cili marrëdhëniet me fqinjët i kuptonte parimisht ndryshe si nga qeveritë e mëparshme, që ishin formuar në Shqipëri, ashtu edhe nga qarqet drejtuese të vendeve të tjera ballkanike.

Ndër intervistat që Noli u pati dhënë me po atë rast gazetarëve jugosllavë, vlejné të veçohen nja dy prej tyre — ato të gazetave të Beogradit «Politika»¹ dhe «Vreme».² Çështjet e prekura janë pak a shumë po ato. Por aty nuk mund të mos pasqyrohet edhe tensioni vazhdimisht në rritje në marrëdhëniet midis dy qeverive. Megjithatë, Noli e fillon bisedën me një ton distensiv dhe shpreh dëshirën dhe gatishmërinë e qeverisë së tij «për marrëdhënie fqinjësie të mirë me shtetin jugosllav». Nuk kishte arsye përse të dy shtetet të mos jetonin në miqësi. «Si shtete fqinje, — tha Noli, ne kemi interesa të përbashkëta, [...] Kështu, — me pak vullnet të mirë nga të dyja palët, do të mund të kapërceheshin pengesat drejt një afrimi shqiptaro-jugosllav». Pen-

1) Sipas gazetës «Bashkimi» datë 26.11.1924.

2) Gazeta «Vreme», datë 13.9.1924, përkthimi shqip në AQSH fondi 251, v. 1924, d. 263.

gesën kryesore Noli e shikonte në «mungesën e besimit reciprok» dhe sidomos «në opinionin që vihej re në disa qarqe politike të Beogradit se gjoja Shqipëria punonte për llogari të shteteve të huaja». Noli i hidhte poshtë këto dhe theksonte se «qeveria e sotme shqiptare nuk do të punonte për llogari të ndokujt», porse ishte e vendosur të ndiqte një politikë të pavarur. Nuk mund të jetë e rastit që Noli ndalet posaçërisht në këtë pikë. Do të rikujtohet se jo më shumë se një muaj e ca përpara kësaj, Qeveria Demokratike kishte parë t'i mbyllej dera kur ajo provoi të bënte përçapje për normalizimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë me ardhjen në fuqi të qeverisë së re të Davidoviçit (në vend të asaj të Pashiçit).¹

Tani si dhe më parë, madje më shumë se më parë, nga ana jugosllave vazhdonte fushata e akuzave mbi të ashtuquajturën ndihmë që gjoja qeveria shqiptare u jepte «çetave maqedonase». Noli jepte sigurime se Qeveria e tij nuk kishte dorë në të tilla veprime. Për të provuar falsitetin e këtyre akuzave, ai bënte këtë arsytim të thjeshtë: «Shqipëria, si një vend i vogël që është, as mund të ketë qëllime agresive kundrejt fqinjëve të saj. Ajo është edhe moralisht (shpirtërisht), edhe materialisht, e çarmatosur. Asaj i duhet vetëm qetësi».² Kjo donte të thoshte se në Shqipëri nuk mund të kishte terren për asnjë politikë militariste agresive. Në fakt Shqipëria nuk kishte as dëshirën por as edhe mundësitë materiale për të tilla synime. Për këtë fliste edhe tradita shqiptare.

Edhe në intervistat dhënë gazetave të mësipërme të Beogradit, Noli nuk lë pa prekur, qoftë edhe kalimthi, dy çështje të rëndësishme që ndikojnë mjaft në marrëdhëniet dypalëshe: caktimi përfundimtar i kufijve dhe trajtimi i pakicave kombëtare. Për të parën dihej se zvarritja vinte nga pretendimet e reja të Beogradit për ta rivënë në diskutim kufirin e 1913-s. Në lidhje me këtë Noli ballafaqonte pozitën e Qeverisë shqiptare, e cila u nënshtrohej vendimeve të Fuqive, ndonëse ato lanë «më tepër shqiptarë jashtë sesa brenda kufijve të Shqipërisë», me atë të qeverisë jugosllave që, edhe pse kishte përvetësuar krahina të tëra të banuara «me 85-95 për qind popullsi shqiptare», vazhdonte përpjekjet për përfitime të tjera territoriale.

Përsa i përket problemit të pakicave, ky patjetër nuk

1) Shih më lart kapitullin I

2) Gazeta «Vreme» datë 13.9.1924.

kishte më pak peshës e ç'kishte në marrëdhëniet me qeverinë greke. Ishte edhe kjo një çështje që i «helmonte marrëdhëniet» si në plan dypalësh, ashtu edhe në shkallë ballkanike. Këtu Qeveria Demokratike, ndodhej po ashtu përpara akuzave për nxitje të «irredentizmit» të popullsisë së Kosovës. Ajo bëhej përgjegjëse për qëndresën që kjo popullsi bënte kundër politikës së egër shtypëse të qeverisë jugosllave. Pasi theksonte se «një shtet i vogël i dobët e i vobekët (si Shqipëria) nuk mund të përballonte luksin e irredentizmit», Noli thoshte se kishte vetëm një zgjidhje: «në qoftë se ju dëshironi që kosovarët të mos jenë shkak grindjeje dhe urrejtjeje midis dy shteteve, atëherë silluni mirë kundrejt pakicave shqiptare në Jugosllavi». Noli donte sigurisht t'i hidhte pak ujë zjarrit kur «konstatonte me kënaqësi» se qeveria e re e Davidoviçit «po jepte në këtë drejtim shenja inkurajuese», «sillej më mirë kundrejt shqiptarëve». E ka dyshim se edhe vetë Noli e dinte se fjalët e tij ishin larg gjendjes reale, pasi në Kosovë nuk kishte asnjë ndryshim. Ato duhen parë vetëm si një thirrje për një politikë më konstruktive, më humane ndaj popullsisë shqiptare.

Për Nolin ky është përsëri një argument për të dalë te çështja e parapëlqyer e tij e krijimit të një bashkësie të re në Ballkan. «Konfederata ballkanike» mbetet «një ideal për realizimin e së cilës duhej të punonin të gjithë». Këtu vizioni i Nolit për një Ballkan të ri zbret në terrenin e disa sugjerimeve konkrete. Ai propozon të shkurtohen ushtritë, gjë që do të krijonte mundësi për burime dhe për përdorimin e këtyre mjeteve për mirëqënien e përgjithshme. Por pa dyshim më interesante është ideja e Nolit për një «marrëveshje miqësore — *entente cordiale*» në Ballkan. Për të arritur aty ai propozonte si hap të parë «një mbledhje të krveministrave të shteteve ballkanike», e cila do të sheshonte gjithë mosmarrëveshjet ekzistuese dhe do të hapte këmbë rrugën për një marrëveshje panballkanike. «Lufta. — shton Noli, — është një luks edhe për shtetet e mëdha. Kurse për shtetet e vogla është një prishje». Prandaj «është një nevojë absolute që të merremi vesh e të bashkëpunojme për qetësinë dhe përparimin e gjithë shteteve ballkanike».²

1) Gazeta «Vreme», datë 13.9.1924.

2) Ideja të shtyn të bësh krahasimin qoftë me Aleancën ballkanike para lufte (1912) qoftë me *Antantën e Vogël* (Çekoslllovakë, Rumani, Jugosllavi — 1921) ose, aq më tepër, me *Antantën ballka-*

E njëjta frymë përshkon edhe një intervistë të po atyre diteve (nga mesi i shtatorit) që S. Delvina i ka dhënë korrespondentit të gazetës italiane «Il Mexoxhiorno» (Il Mezzogiorno)¹ në kohën kur ai, veç detyrës së ministrit të Jashtëm kryente edhe funksionet e kryeministrit, në mungesë të Nolit që ndodhej në Gjenevë. Ashtu si ky në intervistat e tij gazetarëve grekë e jugosllavë, edhe S. Delvina, pasi snprente shqetësimet e njonura per perkrrahjen jugosllave elementit reaksionar, për mosmarrëveshjet kufitare që prisnin ende një zgjidhje si dhe për trajtimin e pakicave shqiptare, e vinte theksin te dëshira dhe gatishmëria e qeverisë shqiptare për të patur marrëdhënie normale me të gjitha shtetet, e në mënyrë të veçantë me shtetet fqinje.²

Gjendje lufte e pashpallur

Të gjitha këto dëshmojnë një gjë: që Noli dhe Qeveria e tij kishin predispozicionin konstruktiv për t'i kapërcyer konfliktet me fqinjët dhe ishin gati të bënin përpjekje për snëndoshjen e atmosferës në Ballkan në përgjithësi. Mirëpo është fakt se çdo shfaqje e gatishmërisë, çdo përçapje e saj per bashkëpunim e marrëveshje thyhej në murin e heshtjes, të mosbesimit e madje të kundërshtimit të hapët të qeverive fqinje.³

një të viteve 30. (Greqi, Jugosllavi, Rumani, Turqi). Por dihet se këto ishin inisiativa të frymëzuara më shumë prej Fuqive të Mëdha, blloqeve të tyre, ishin — si të thuash — degëzime të tyre veçanërisht dy Antantat e pasluftës) dhe si të tilla mbanin vulën e interesave të tyre kontradiktore. Kjo ishte edhe arsyeja e dështimit të tyre. Në konceptin e Nolit ishte fjala për diçka të ndryshme. Ideja e tij, nuk mund të shkëputet nga vizioni që ai kishte për marrëdhëniet ndërkombëtare në përgjithësi e kjo nuk mund të mos reflektohej edhe në mënyrën se si ai e përfytyronte të ardhmen e Ballkanit, si një bashkësi të ngritur mbi bazën e solidaritetit të lirë nga armiqësitë «vëllavrasëse» dhe nga ndikimet përçarëse. Në përgjithësi mund të thuhet se intervistat e Nolit të kësaj periudhe janë një vazhdim e zhvillim i mëtejshëm i fjalimit që ai mbajti në 9 shtator në sesionin e Asamblesë së përgjithshme të Lidhjes së Kombeve. (Shih Kapit. VI)

1) Nga kupytrat e shtypit të huaj në AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 270.*

2) *Po aty.*

3) Konkretisht, përsa i përket jehonës që patën në Jugosllavi in-

Edhe nga sa është thënë deri tani del e qartë se për këtë në radhë të parë është dalluar qeveria jugosllave, qëndrimi i së cilës është shprehur jo vetëm në deklarata, por edhe në veprime konkrete. Që në fillim të ardhjes së saj në fuqi u pa se Qeveria Demokratike do të gjente pikërisht te fqinjët e Veriut pengesën më të madhe në marrëdhëniet e jashtme. Dhe kjo pengesë nuk ishte thjesht e natyrës diplomatike. Ndonëse përfaqësuesit e Ministrisë së Jashtme në Beograd deklarorin në qershor se «pritej që të sqarohet situata në Shqipëri para se të përcaktohet qëndrimi kundrejt qeverisë së re shqiptare», autoritetet jugosllave filluan menjëherë të tregonin hapur se në ç'anë ishin simpatitë e tyre.

Sikurse u pa, A. Zogu nuk u trajtua thjesht si emigrant politik, Legata shqiptare në Beograd në një raport të sajën, në fund të qershorit, jepte disa të dhëna më të hollësishme lidhur me pritjen që iu rezervua Zogut dhe suitës së tij me të mbërritur në kryeqytetin jugosllav. «A. Zogu — thuhet midis të tjerash, — bashkë me 10 oficerë mbërriti në Beograd më 27 qershor në mëngjes dhe u vendos në një nga hotelet më të mëdha, në Hotel «Bristol»... Në stacionin hekurudhor kishin dalë për ta pritur dy funksionarë të Ministrisë së Jashtme... Qeveria jugosllave vuri menjëherë në dispozicion të tij një automobil». «Ish-kryeministri. — theksohej më tutje, — nuk ishte parë në qytet përveç disa herëve që ka vajtur në Ministri të Jashtme, ku është pjekur me Pashçin dhe me disa nëpunës të tjerë të kësaj ministrie».¹ Kjo nuk ishte e rastit. Ishte shprehja e parë e qartë e qëndrimit të qeverisë së Beogradit kundrejt fitores së kryengritjes në Shqipëri. Me rastin e strehimit të Zogut, ajo nuk mungoi të bënte deklarata me anën e të cilave mundohet të dilte përpara opinionit publik ndërkombëtar sikur u përmbahej rregullave të strehimit politik, pa ndërhyrë në punët e brendshme të Shqipërisë. Shtypi jugosllav i vinte në ndihmë qeverisë së vet, duke botuar lajme se Zogu i ishin vënë kufizime, se qeveria jugosllave ndonëse e auto-

tervitat e Nolit, legata shqiptare në Beograd raportonte se ato kishin bërë «një përshtypje mjaft të mirë në opinionin e gjerë», porse «në qarqet qeveritare ato u morën si me ironi». Raport i Legatës shqiptare (pa datë të saktë, por nga përmbajtja del se i përket muajit shtator) në AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 283.*

1) Raport i legatës shqiptare nga Beogradi, datë 30.6.1924. AQSH *f. 251, v. 1924, d. 260.*

rizonte të qëndronte në territor jugosllav «e ndalonte atë dhe shokët e tij të kryenin çfarëdo veprimi kundër situatës së sotme në Shqipëri».¹ Ngjarjet nuk do të vononin të tregonin se deklarata të tilla kishin për qëllim të mbulonin angazhimin e Beogradit në organizimin e bandave kundërrevolucionare pikërisht në territorin jugosllav.

Një shprehje tjetër e kursit intervencionist të autoriteve jugosllave ishin masat kufizuese që ato morën si përgjigje kundrejt vendosjes së qeverisë së re në Tiranë. Ato vendosën mbylljen e kufirit dhe ndalimin e eksportit të drithit në Shqipëri. Madje në shtypin e kohës ka njoftime se Beogradi vendosi të bllokonte edhe ato kontrata të drithit që ishin lidhur njëjt kohë përpara ngjarjeve të qershorit. Si pretekst për këtë masë Beogradi shpiku «zinë e bukës» në Jugosllavi.² Burime jugosllave bëjnë fjalë për një ndërprerje të plotë të negociatave tregtare jugosllavo-shqiptare pas qershorit».³

Nga një raport i legatës shqiptare në Beograd del se qeveria e Nolit e pati shtruar disa herë çështjen pranë qeverisë jugosllave.⁴ Qëllimi ishte të arrihej në rishikimin e këtij vendimi që ishte jo vetëm «i padrejtë e i paprovokuar» nga pala shqiptare, por, siç thuhej, ishte «edhe në dëm të interesave të shtetasve jugosllavë që bënë tregtinë e drithit», sidomos me viset në afërsi të kufirit. Në raportin e legatës shtohet se ministria e tregtisë dhe ajo e financave në Beograd, i kishin kërkuar ato vetë qeverisë që vendimi të rishikohej, të rihapej kufiri dhe të autorizohet tregtia e lirë. Mirëpo vendimi shtyej vazhdimisht për më tutje. Madje, edhe për nevojat e ngutshme të popullsisë shqiptare, sidomos në viset kufitare, qeveria jugosllave i kishte refuzuar duke u përgjigjur «se do të priste edhe ca kohë për të parë se si do të

1) *Po aty*.

2) Gazeta «*Bashkimi*», datë. 15.12.1924, Lidhur me këtë kjo gazetë shkruante: «...Duket se triumfi i shkëlqyer i demokracisë shqiptare nuk i ka gëzuar edhe aq fort fqinjët tanë të Veriut. Që kur u muar fuqia nga ana e revolucionarëve, qeveria jugosllave ka ndaluar absolutisht importimin e drithit, duke vënë si pretekst se në Jugosllavi paska zi buke... E dimë fort mirë se në Jugosllavi nuk mungon drithi, por duket se këtë masë ndalimi e kanë shkaktuar ndryshimet e fundit në Shqipëri».

3) *Gjurmime albanologjike. Seria e shkencave historike I-1971. Artikull i V. Vinaver, f. 77.*

4) Raport i legatës shqiptare nga Beogradi datë 2.8.1924. AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 257.

përfundonte zhvillimi i ngjarjeve në Shqipëri». ¹ Kishte informata se Beogradi vepronte edhe në këtë rast duke qenë në kontakt me A. Zogun, i cili jepte sigurime se punët në Shqipëri po rrokulliseshin me të shpejtë drejt rrëzimit të qeverisë demokratike. ²

Në vazhden e kësaj politike duhet të përmendet edhe vrasja, në shtator, e 8 shtetasve shqiptarë «që kishin vajtur në Jugosllavi për të blerë misër». Për këtë, Ministria e Jashtme, me telegramin e saj dt. 26 shtator 1924, udhëzonte legatën shqiptare në Beograd që të protestonte kundër «sistemeve (metodave) barbare kundër elementit shqiptar» të përdorura nga autoritetet jugosllave dhe të kërkonte marrjen e masave nga qeveria e re e Davidoviçit «që t'u jepeshin fund këtyre mizorive» dhe që autoritetet lokale të zëvendësoheshin me «nëpunës me ndërgjegje dhe të frymëzuar nga parimet demokratike» të shpallura nga qeveria e re jugosllave³. Duket se në Tiranë besonin ende se ndërrimi i rojës në Beograd mund të sillte diçka të re në politikën jugosllave gjë që shpresohet të pasqyrohet edhe në qëndrimin kundrejt Qeverisë së Nolit.

Këto shpresa jo vetëm që nuk u vërtetuan, por gjendja e marrëdhënieve midis dy vendeve erdhi vazhdimisht duke u keqësuar, sa që mund të thuhet se mbërriti deri në gjendje lufte të pashpallur. Aspekti më i rrezikshëm i politikës së Beogradit ishte sigurisht fakti se, sikurse u tha, territori jugosllav u bë jo vetëm strehë për elementin reaksionar, por edhe bazë për përgatitjen e bandave kundërrevolucionare. Pak nga pak viset kufitare u bënë teatër operacionesh ushtarake. Në anën tjetër të kufirit qarkullonin lirisht njerëzit e Zogut, të cilët qysh prej korrikut kryenin herë pas here aksione kundër territorit shqiptar. Kështu gazeta «Bashkimi», në mes të korrikut, botonte përmbajtjen e një letre të kapur në kufi, me anën e së cilës krerët bashibozukë Hysni Dema, Fiqri Dine e Taf Kaziu i raportonin Zogut në Beograd mbi aksionet e dy çetave të organizuara prej tyre. Ato ishin hedhur në këtë anë të kufirit për të prerë telat telegrafikë në rajonin e Peshkopisë si dhe në rrugën Tiranë-Dibër ku ishin përpjekur edhe me forcat qeveritare. E njëjta gazetë njoftonte në po atë numër, se në krye të gjithë punës për për-

1) *Po aty.*

2) *AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 257.*

3) Letër drejtuar legatës shqiptare në Beograd datë 26.9.1924. *AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 257.*

gatitjen e bandave të Zogut në territorin jugosllav, në afërsi të kufirit, ishte vënë prefekti i Prizrenit, Stojan Dajiç.¹

Në fillim të gushtit, Ministria e Jashtme në Tiranë e udhëzonte legatën shqiptare në Beograd të bënte të parën përçapje zyrtare për të protestuar pranë qeverisë jugosllave, e cila «toleronte veprimet e refugjatëve politikë shqiptarë në viset kufitare». Përmendeshin me emër Muharrem Bajraktari, Fiqiri Dine, Hysni Dema etj., që ishin shpërndarë në pika të ndryshme të kufirit shqiptaro-jugosllav, si: Prizren, Dibër, Podgoricë etj. Kërkohej që këta elementë të largoheshin nga viset kufitare.²

Një tregues i acarimit të vazhdueshëm të gjendjes në kufirin e Veriut janë edhe dy shkresa të Ministrisë së Brendshme drejtuar Ministrisë së Jashtme aty nga mesi e fundi i muajit gusht (përkatësisht 19 dhe 26 gusht)³. Aty bëhej fjalë për lajmet që vinin «gati për ditë nga prefekurat Elbasan, Dibër, Kosovë, si dhe prej nënprefekurës së Matit» ku «aktivitetet e të arratisurve, përkundra fjalëve të dhanuna prej qeverisë jugosllave, vijnë tue u shtue». Veç asaj, informata të ardhura nga përtej kufirit tregonin se të arratisurit «shëtisnin lirisht dhe të armatosur» nëpër qytete (Prizren, Strugë, etj.) dhe ushqeheshin prej autoriteteve lokale.⁴

Prej këtyre lajmeve Ministria e Jashtme merrte shkas të ankohej përsëri, sepse «me gjithë sigurimet për miqësi që na ka dhënë kabineti i ri jugosllav përkrah dhe nxit elementët që mund të provokojnë turbullira në Shqipëri».⁵

Në fund të shtatorit ndodhi incidenti i Vermoshit, i cili lidhet me problemin e përcaktimit përfundimtar të kufijve midis dy vendeve. Si i tillë, ai trajtohet në kuadrin e kësaj teme⁶, por gjithsesi ai pasqyron edhe gjendjen e tendosur në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.

Në tetor-nëntor, gjendja hyn në një fazë të re keqësimi të dukshëm. Nga qendrat kryesore në afërsi të kufirit të Veriut dhe Lindjes, vijnë raporte e telegrame që njoftojnë

1) Gazeta «*Bashkimi*» datë, 15.7.1924.

2) Tel. i Ministrisë së Jashtme — legatës shqiptare në Beograd datë 9.8.1924, AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 257*.

3) Shkresa të Ministrisë së Brendshme datë. 19.8. dhe 26.8.1924, AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 275, 257*.

4) *Po aty*.

5) Kopje e një note frëngjisht bashkëngjitur shkresave të mësipërme.: AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 275*.

6) Shih Kapitullin IV.

për intensifikimin e përgatitjes së bandave në Jugosllavi, si dhe për shtimin e veprimtarive të tyre në drejtim të Shqipërisë. Ishte në zhvillim të plotë e në sytë e të gjithëve fuqishata për rekrutimin e mercenarëve bashibozukë për sulmin final kundër Qeverisë Demokratike. Autoritetet jugosllave vinin në dispozicion po aq haptazi pajisje, armë dhe mjete financiare të bollshme.¹ Kështu, nga mbyllja e kufirit po arrihej tani në gjendjen e jashtëzakonshme që karakterizon marrëdhëniet midis palëve ndërluftuese.

Kjo e detyroi Qeverinë e Nolit t'i drejtohej tani Lidhjes së Kombeve. Nga fundi i nëntorit, përfaqësuesi i Shqipërisë në Gjenevë i dërgonte një letër të gjatë sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes, Drumond, në të cilën pasi jepeshin të dhëna të hollësishme mbi angazhimin e autoriteve jugosllave në organizimin e bandave për një «aksion kundër rendit dhe sigurisë së shtetit shqiptar», vetëm tërhiqej vëmendja e Lidhjes. Letra vinte në dukje pikërisht një ndryshim cilësor, një fazë më të përparuar në krizën e marrëdhënieve midis dy qeverive, kur thoshte se «kohët e fundit lëvizja antishqiptare e organizuar nga autoritetet ushtarake dhe civile serbe ka marrë përpjesëtime të tilla sa që mund të mendohet se Shqipëria ndodhet në vigjilje të një intervencioni të huaj».²

Mirëpo, nga gjithë përmbajtja e letrës del se Qeveria shqiptare nuk shtronte çështjen e marrjes së masave konkrete në shkallë ndërkombëtare. Duhet thënë se kjo është karakteristike për gjithë mënyrën e veprimit të Qeverisë së Nolit, përballë rrezikut të ndërhyrjes nga veriu.

Para së gjithash, ajo nuk kundërveproi në kohën e duhur brenda territorit të vet. Kështu mbeti në letër një nga pikat e programit të shpallur në qershor për ndjekjen e krerëve të reaksionit dhe të bashkëpunëtorëve të tyre. E ashtuquajtura «gjykatë politike», e krijuar për të gjykuar «shkaktarët e vëllavrasjes» dhe bashkëpunëtorët e tyre u mor mua;

1) Në një telegram drejtuar legatës shqiptare në Beograd datë 17.10.1924 jepej një përmbledhje e të dhënave që mbërrinin nga qarqe të ndryshme. *AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 257*. Shih, po aty, një telegram datë 16.10.1924 nga prefektura e Korçës që bënte fjalë për grumbullimin e kriminelëve e të arratisurve të tjerë në Ohër dhe në Strugë.

2) Letër drejtuar sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes. Erik Drumond, datë 25.11.1924. *AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 257*.

me radhë me përgatitjen e materialeve. Në fondin e Ministrisë së Brendshme të kohës ndodhet një praktikë e gjerë e organeve qendrore e lokale që e trajton çështjen për disa muaj me radhë: që nga korriku e deri në dhjetor. Vendimin e saj për dënimin me vdekje të A. Zogut, Sh. Verlacid «gjykata politike» e dha vetëm më 12 dhjetor, në një kohë kur makina e intervencionit ishte hedhur në veprim në mënyrë frontale.¹ Baza e klikës zogiste mbeti gati e paprekur edhe pas arratisë së saj në tokën jugosllave. Nuk u mor asnjë masë serioze për spastrimin e aparatit, qoftë në hallkat e administratës, qoftë (aq më shumë) në forcat e rendit publik e në ato që kishin detyrën e mbikqyrjes së kufirit.

Në zonat kufitare, xhandarmëria, në radhët e së cilës kishte gjithnjë mjaft elementë bashibozukë zogistë, bashkëpunonte shpeshherë me kriminelët që hynin e dilnin në kufi. Asnjë regjim i veçantë, siç e kërkonte situata e krijuar, nuk u zbatua në këto vise; kufiri u la si më parë i zhveshur, sikur marrëdhëniet me Jugosllavinë të ishin normale. Ajo vërtet lëvizi disi në nëntor-dhjetor, por kjo do të ishte nga ana e saj një tjetër vonesë fatale.²

Edhe në planin diplomatik, ajo nuk e vlerësoi gjendjen si tepër serioze dhe nuk u tregua shumë aktive. Megjithatë ajo e ngriti çështjen disa herë në deklarata zyrtare dhe madje bëri përçapje edhe pranë qeverisë së Beogradit, prapëse-

1) A.QSH, *fondi i Ministrisë së Brendshme*, v. 1924, d. 905, 468, Shih G. Hysi, *Organizimi i shtetit shqiptar dhe lufta rreth tij në v. 1920-1924, Tiranë 1988*, f. 232-233.

2) Lidhur me këtë përsëri në faqet e gazetës «Bashkimi» gjejmë veç lajmeve mbi veprimtarinë e elementëve zogistë të ndihmuar drejtpërdrejtë nga Beogradi, edhe një kritikë të hapur kundrejt qeverisë. Kështu, në një artikull të mesit të tetorit pasi viheshin në dukje trazirat në vend (aktivizimi i kriminelëve me grabitjet dhe vrasjet e shumta) ajo shkruante:

«Situata bëhet aq më shumë delikate pse guverna serbe, besnike në politikën imperialiste të Pashiçit, ka vënë në punë kundrejt nesh methodat maqjavelike të çetave dhe të spiunëve. Në Kosovë Zogolli po mbledh komita me anën e autoriteteve serbe të cilat i veshin dhe i armatosin çetat që të na i lëshojnë pastaj në kufi edhe përpara opinionit publik të botës, duke pretenduar sipas zakonit se janë kryengritës shqiptarë. Këtu brënda, agjentët e Serbisë po derdhnin andej këndeje qindra e mijëra dinarë për të mbajtur spiunët... Kufiri i ruajtur keq, është bërë xhade ku agjentët e Serbisë venë e vijnë si në shtëpi të tyre». Pastaj në artikull kritikohen burrat e shtetit që përballë kësaj situatë, s'kanë tjetër kujdes vec zgjedhjeve dhe i bëhet thirrje qeverisë që të tregojë «grusht të hekurtë».. («Bashkimi», 17 tetor 1924).

prapë nuk i kushtoi ndërhyrjes jugosllave vëmendjen e duhur. Ajo nuk e çoi deri në opinionin e gjerë ndërkombëtar si një çështje vërtet preokupante, si një shkelje flagrante të rregullave elementare të marrëdhënieve midis shteteve. Në fillim të nëntorit (prapë me vonesë të madhe), ajo u dërgoi një përkujtesë qeverive të Britanisë së Madhe, Francës e Italisë, me anën e së cilës i vinte në dijeni për përgatitjen e bandave të Zogut në territorin jugosllav¹, porse me disa përçapje të vakëta e sporadike (aq më tepër kur dihej edhe qëndrimi negativ i këtyre qeverive) nuk mund të çahet muri i heshtjes e indiferencës në të cilin haste Qeveria Demokratike në qarqet zyrtare në Perëndim.

Nuk u përdor për këtë aq sa duhej as Lidhja e Kombeve, megjithëse Noli e pati zgjedhur me kohë si tribunë të mbrojtjes së kauzës shqiptare. Sigurisht, në mjaft raste, sidomos kur ishin në diskutim problemet kufitare të mbetura pezull me dy shtetet fqinje që përpara Luftës I Botërore. Noli, duke u shprehur për këto probleme, përmendi kalimthi edhe ndërhyrjen jugosllave.² Por në fjalimin kryesor që ai mbajti përpara Asamblesë së Përgjithshme të Lidhjes së Kombeve³, fjalim në të cilin ai parashtroi pikëpamjet dhe qëndrimet për një varg të tërë problemesh të politikës së jashtme, Noli nuk foli për rrezikun që vinte nga Veriu, për kursin që po kristalizohej në Beograd për veprime agresive kundër një vendi që ishte po ashtu anëtar i Lidhjes. Në gjithë sesionin e Asamblesë së Gjenevës në vjeshtën e vitit 1924, çështja e ndërhyrjes jugosllave kundër Qeverisë shqiptare nuk u ngrit si çështje më vete dhe pothuajse kaloi në heshtje. Kjo lejon të mendohet se Noli dhe ekipi i tij nuk besonin që ndërhyrja e Beogradit të merrte përmasat që mori efektisht, dhe nuk pandehnin se qarqet drejtuese të Beogradit nga fjalët do të hidheshin në veprime në stil të gjerë.

Prirja e afrimit shqiptaro-grek

Në marrëdhëniet shqiptaro-greke pas qershorit, përveç zonave të errëta ka patur edhe disa kënde drite. Është fare e kuptueshme që nga ana shqiptare, në kushtet kur politika

1) *Dokumente e materiale... 1917-1941, Tiranë, 1959, d.nr. 184.*

2) Shih Kapitullin IV

3) Shih Kapitullin VI.

jugosllave po merrte një kthesë aq agresive, të bëheshin përpjekje për të siguruar një kundërpeshë në marrëdhëniet me Greqinë. Dhe është fakt se jo vetëm në qarqet qeveritare, por edhe në opinionin më të gjerë të vendit, vihej re një rrymë që e shikonte afrimin me Greqinë si një mjet për të lehtësuar presionin që vinte nga Veriu. Në të vërtetë, nga ana e qeverisë së Athinës pati disa gjeste të cilat u interpretuan si inkurajuese. Së pari, ishte përshëndetja e kryeministrit grek drejtuar Nolit me rastin e formimit të qeverisë së re në qershor, një përshëndetje e hartuar në një frymë mjaft miqësore, aq sa, sikurse u pa, në Tiranë u mor si njohje nga ana e qeverisë greke. Fillimisht për këtë lloj disponimi të qarqeve qeveritare të Athinës do të ketë ndikuar ndoshta edhe fakti që në krye të qeverisë shqiptare vinte një «peshkop ortodoks», edhe pse dihej botërisht se Noli ishte protagonist kryesor i lëvizjes për kishën autonome shqiptare.

Duke i parë më nga afër marrëdhëniet midis dy vendeve gjatë gjithë kohës së qëndrimit në fuqi të Qeverisë Demokratike, del se, përveç çështjes së njohjes (për të cilën ekuivoku mbeti deri në fund), dy kanë qenë problemet kryesore që kanë shkaktuar mosmarrëveshje: 14 fshatrat e kazasë së Korçës dhe shpërngulja e popullsisë shqiptare të Çamërisë për në Turqi (sipas Marrëveshjes greko-turke të Lozanës të vitit 1923).¹

Nga të dyja këto çështje, ajo e fshatrave të Korçës gjeti një zgjidhje pozitive atëherë kur në fund të tetorit grekët i zbrazën ato dhe u morën në dorëzim nga autoritetet shqiptare. Në rrethet qeveritare në Tiranë, madje edhe në gjithë shtypin e vendit, kjo zgjidhje ndonëse e pjesshme, u përshëndet njëzëri si shenjë që mund të paralajmëronte një kthesë në politikën e Athinës, një sqarim të qëndrueshëm në horizontin e marrëdhënieve midis të dy vendeve. Me atë rast Ministria e Jashtme në Tiranë u dërgoi një telegram-qarkore gjithë prefekturave, me anën e të cilit, pasi njoftohej zbrazja e 14 fshatrave, shprehej besimi se «duke marrë parasysh interesat e përbashkëta midis dy vendeve, një periudhë besimi dhe miqësie të ngushtë do të inaugurohet në marrëdhëniet e dy popujve miq dhe fqinj».²

1) Shih më poshtë.

2) Telegram-qarkore e Ministrisë së Jashtme në Tiranë drejtuar gjithë prefekturave datë 31.10.1924. AQSH, fondi M.J. protokolluar C-X-3434.

Jehona që gjeti në shtypin e vendit kjo ngjarje është edhe më kuptimplote. Pothuajse në një kor ajo u cilësua si një akt «urtësie» e «mirëdashje» nga ana e qeverisë së Athinës, një ngjarje që mund të hapte një faqe të re në marrëdhëniet shqiptaro-greke; do të liheshin prapa grindjet dhe mosmarrëveshjet e së kaluarës dhe do të ecej drejt paqes e miqësisë së qëndrueshme. Gazeta «Politika» që dilte në Vlorë, nën drejtimin e Halim Xhelos, në një artikull të fundit të nëntorit, pasi shikonte aty një «provë të re» (veç asaj të njohjes) të «vullnetit mirëdashës» të qeverisë së Athinës, shfaqte shpresën se «një erë e re vëllazërore do të fryjë këtej e tutje ndërmjet dy kombeve fqinj». Gazeta shkonte edhe më tej dhe propozonte lidhjen e një traktati të «aleancës difensive» ose «të paktën të ndonjë traktati miqësie midis dy shteteve» si një mjet «për t'u bërë ballë hegjemonive të dëmshme për Shqipërinë, për Greqinë dhe për paqen në Ballkan.»¹ Është e qartë se këtu bëhej aluzion për rrezikun e hegjemonisë jugosllave që kërcënonte si Shqipërinë ashtu edhe Greqinë.

Të njëjtën ide e rimerrte në dhjetor e përjavshmja «Shekulli» që dilte në Tiranë. Në artikullin «Marrëdhëniet greko-serbe dhe Shqipëria», gazeta ndalej po ashtu tek «denoncimi. i traktatit të aleancës greko-serbe të 1912-s» (pjesë e aleancës ballkanike kundër Turqisë) dhe si shkak kryesor të keqësimit të marrëdhënieve midis Greqisë e Jugosllavisë quante synimin e Beogradit për të dalë në Mesdhe, për të vënë dorë mbi Selanikun, mbi «Maqedoninë greke». Kësaj i shtoheshin sipas gazetës edhe «faktorë psikologjikë», sepse «rrezimi i carizmës» kishte krijuar «njëfarë megalomanie në Beograd» dhe se, siç mendohej tanimë, «qendra e panslla-

1) Gazeta «Politika» (Vlorë) datë. 28.11.1924. Në artikullin e gazetës është sidomos domethënës ky pasazh: «...Na vjen tepër e ëm-bël të themi që po shohim sot me gëzim të madh se qeveria e Athinës i kuptoi gabimet e rënda të politikës së mëparshme dhe kabineti grek na dha dy prova të qarta të vullnetit mirëdashës të tij: njëra prej këtyre është njohja *de facto* e *de jure* mirëdashës të sonë. dhe tjetra, zbrazja e të 14 fshatrave të distriktit të Korçës. Këtyre dy provave të cilat nga qeveria e Beogradit u quajtën si shkaqet kryesore të prishjes së traktatit serbo-grek (është fjala për traktatin e 1912-s), po t'u shtojmë edhe paanësinë krejt miqësore që tregoi Greqia në kohë të Kryengritjes së Qershorit, mund të themi me siguri të plotë se një erë e re vëllazërore do të fryjë këtej e tutje ndërmjet dy kombeve fqinj».

vizmës ishte transferuar nga Petrogradi në Beograd». Vetëm qeveria serbe e rrezikonte ekuilibrin në Ballkan dhe ky rrezik i kanosej njëlloj si Shqipërisë, ashtu edhe Greqisë. «Durrësi dhe Selaniku pothuajse një fat kanë, — shtonte gazeta. — Atë ditë që do të pësojë gjësendi Selaniku, edhe qetësia e Durrësit do të prishet», dhe këto fjalë tingëllonin gati si një paralajmërim. Së këtejmi konkluzioni: «Këto janë shkaqet politike që komandojnë (diktojnë) medoemos bashkimin (aleancën) e Shqipërisë me Greqinë». Artikulli përfundonte duke u bërë thirrje «diplomacive të të dy palëve» të zgjidhnin problemet e mbetura pezull dhe të lidhnin pastaj ndonjë «traktat politik mbi miqësinë».¹

Që rryma e afrimit me Greqinë në ato rrethana gjente mjaft jehonë dhe po bënte me vete një pjesë të mirë të opinionit në vend, këtë e tregon edhe një artikull i personalitetit të shquar të lëvizjes kombëtare, Hasan Prishtinës, të botuar në gazetën «Dajti» të Tiranës, përsëri në dhjetor.² Vlen të theksohet se artikulli i tij H. Prishtina e shkroi fill pas një udhëtimi që pati bërë në Greqi. Nuk del që ai të ketë shkuar atje me ndonjë mision të caktuar zyrtar apo gjysmëzyrtar. Ai vetë thotë se shkoi në Greqi për «punë për vete», ndonëse vizita i dha rast të takohej e të bisedonte me mjaft personalitete të jetës politike greke, me «shumë deputetë e burra shteti». Thelbi i artikullit qëndron në këto pak rreshta: «Nga bisedimet që rodhën, — shkruante H. Prishtina, — kuptova se atje ka një kurent të fortë për me shkue mirë me Shqipërinë, bile do prej këtyneve shfaqnë mendimin për një konfederatë ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë. Kur uktheva në Shqipëri u hoqa vërejtjen do ministrave përmbi këtë kurent e privatisht iu luta me u kujdesue për këtë punë që intereson Shtetin shqiptar thellësisht».³

Nuk mund të mos bjerë në sy fakti se këto qëndrime e thirrje, goftë në nivelin qeveritar apo jozyrtar, në shtyp, bëhen më të shpeshta sa më shumë ndihet rreziku i ndërhyrjes jugosllave sidomos nga fundi i nëntorit e deri nga mesi i dhjetorit, pra në vigjilje të sulmit me armë nga Veriu. Kjo ishte një provë tjetër se në opinionin e vendit afrimit eventual midis Shqipërisë dhe Greqisë i paracaktonte një funksion thjesht mbrojtës.

1) Gazeta «Shekulli» datë 13.12.1924.

2) Gazeta «Dajti» datë 11.12.1924.

3) *Po aty*.

Mirëpo këto mbetën në letër, në sferën e dëshirave. Nga ana greke nuk u ndërmor asnjë hap që të tregonte vërtet një ndryshim në politikën tradicionale kundrejt Shqipërisë, ashtu siç u shpresua në Tiranë. Po të përjashtohet zbrazja e 14 fshatrave të Korçës, çdo gjë tjetër flet për të kundërtën. Para së gjithash shtypi grek vazhdoi të mbante po atë qëndrim kritik kundrejt Revolucionit Demokratik.

Në mënyrë të veçantë është për t'u vënë në dukje orvatja që u vu re gjerësisht në shtypin grek për të dalë përsëri me planet e njohura të copëtimit të Shqipërisë dhe të bashkimit të «Vorio-Epirit» me Greqinë ose të paktën të «autonomisë vorio-epirote». Në këtë drejtim qarqeve shoviniste greke u jepnin dorë edhe zërat që u përhapën në shtypin evropian para dhe pas Revolucionit të Qershorit mbi «nevojën e një riorganizimi të Shqipërisë». Siç u pa, u riaktivizuan prirjet për ta rivënë në diskutim «problemin shqiptar» si një problem ndërkombëtar. U rihodhën në qarkullim përsëri propozime për «zgjidhjen» e tij, propozime të cilat, pavarësisht nga nuancat, në thelb kishin një emërues të përbashkët: likuidimin e pavarësisë së Shqipërisë dhe copëtimit e saj. Do të kujtohet se si me atë rast ministri anglez në Tiranë, Aires, doli me një projekt të cilin në Forien Ofis e cilësuan si interesant.¹ Në qarqet franceze gjeti jehonë sidomos plani i «ndarjes kantonale» dhe i «decentralizimit të shtetit shqiptar». Si zëdhënëse e këtij plani doli gazeta reacionare franceze, «Lë Tan» (Le Temps) e cila në fillim të qershorit zgjidhjen e «problemit shqiptar» e shikonte në kthimin e Shqipërisë në «një konfederatë kantonesh autonome».²

Pikërisht idenë e «ndarjes kantonale» e kapi shtypi grek duke e menduar atë si një rast të ri për cungimin e mëtejshëm të Shqipërisë dhe, rrjedhimisht, për shkëputjen e «Vorio-Epirit». Vlen të përmendet në lidhje me këtë një koment i gazetës greke që dilte në Athinë në gjuhën frënge, «Lajmëtar i Athinës» (Le Messenger d'Athènes), e cila ishte e lidhur ngushtë me Ministrinë e Jashtme të Greqisë dhe dilte shpesh

1) Shih Kapitullin I.

2) Gazeta në fjalë, pasi përpiquej të provonte se shqiptarët nuk ishin të pjekur për pavarësi «si një komb i ndarë nga feja dhe nga interesat e huaja», përfundonte se «më e mira do të ishte që Shqipërisë t'i jepej një status fare i decentralizuar, në mënyrë që të bëhej një konfederatë kantonesh autonome» dhe si e tillë mund të vendosej nën mbikqyrjen e Lidhjes së Kombeve. Sipas gazetës «Bashkimi» datë 24.7.1924.

si zëdhënëse e saj. «Fuqitë e mëdha, — shkruante kjo gazete në mes të korrikut, — po konstatojnë se administrimi i Shqipërisë si një shtet i centralizuar, është një gjë e pamundur. Bëhet fjalë tani për një sistem kantonesh, i cili do të bëjë (të mundur) të jetojnë së bashku njëqind fise me njëri-tjetrin. Dhe në mes të këtij kaosi, epirotëve të veriut, të cilët kanë të tjera zakone, tjetër kulturë dhe, kryesorja, janë prej race tjetër, nuk u është dhënë autonomia që duhej t'u jepej».¹ Gazeta përfundonte me këto fjalë që tingëllonin si një kërcënim: «Nuk duhet të harrohet se ç'bëjnë epirotët kur shtyhen deri në dëshpërim». Sigurisht që këtu bëhej aluzion për mizoritë e andartëve grekë kundër popullsisë shqiptare në vitin 1914.² Nga një raport i legatës shqiptare në Athinë në fillim të gushtit, del se nuk ishte fjala për shkrime të shkëputura, porse tema «e copëtimit të Shqipërisë në tre kantone» trajtohej gjerësisht në «gazetat e Athinës» që prej mesit të korrikut.³ Kjo e shtrëngoi Zyrën e Shtypit në Tiranë t'u drejtohej agjencive kryesore të lajmeve si dhe disa gazetave në Evropë me përgënjeshttrimin «e lajmeve tendencioze të përhapura mbi gjoja ekzistencën e një lëvizjeje separatiste në Shqipëri»: gjithashtu ajo theksonte se «gjithë kombi ishte i bashkuar vendosmërisht rreth Qeverisë së re Demokratike».⁴ Gjatë muajve të verës marrëdhëniet midis dy qeverive lëkundeshin sa në një drejtim në tjetrin: herë kishte shenja ngritjeje, herë uljeje. Në fund të korrikut, ministri i Punëve

1) Citohet sipas gazetës «*Bashkimi*» datë 30.7.1924.

2) Shtypi i kohës në vendin tonë e pati kapur drejt telbin e idesë së «kantonizimit» të shtetit shqiptar dhe e pati denoncuar atë pikërisht si një shprehje të re të lakmive të vjetra të shteteve fqinje për ta copëtuar Shqipërinë. Reagimin e opinionit më të gjerë e tregonte veçanërisht gazeta «*Politika*» e Halim Xhelos, e cila në kryeartikullin e saj, në një nga numrat e muajit gusht, shkruante: «Kurdoherë, por më shumë kohët e fundit, shtypi greko-serb shfaq dëshirën për decentralizimin ose kantonizimin e Shqipërisë... Përpara nesh kemi tre shtete, të cilët kanë menduar, mendojnë e do të mendojnë që në rastin e parë të gjejnë fjalën midis tyre e të na ndajnë... Decentralizim dhe kantonizim për shtetin shqiptar do të thotë: Shqipërinë jugore ta marrë Greqia, të mesmen Italia dhe të Veriut Serbia, në mos *de facto*, me pushtime (depërtim) ekonomike, gjë që për një shtet ka po atë kuptim fatal. Pra, për të shpëtuar nga ky copëtim, të cilin e shkaktojnë gjërësisht edhe ndikime fetare e krahinore, na duhet medoemos një shtet administrativ». Gazeta «*Politika*» datë 14.8.1924.

3) Raport i legatës shqiptare nga Athina datë 1.8.1924. AQSH. *fondi 251, v. 1924, d. 218.*

4) Tel. i Zyrës së Shtypit. *Po aty.*

të Jashtme të Greqisë e siguronte legatën shqiptare, e cila ankohej për «veprimet e vorioepirotëve që minonin marrëdhëniet e mira midis dy shteteve», se «qeveria helenike kishte dëshirën e singertë të mbante marrëdhënie miqësore me Shqipërinë».¹

Por këto deklarata nuk gjenin mbështetje në qëndrime dhe veprime konkrete. Në qarqet drejtuese greke po zinte vend gjithnjë e më shumë bindja për pozitën e dobët të qeverisë së re shqiptare, dhe kjo shihej si një mundësi për të shkëputur sa më shumë koncesione.

Veç thirrjeve që dëgjoheshin në mitingje të despotëve për ringjalljen e «autonomisë vorioepirote»², autoritetet greke vepronin në po atë linjë kur nuk njihnin shtetësinë shqiptare të udhëtarëve që shkonin në Greqi. Që prej korrikut, në kundërshtim me një marrëveshje dypalëshe të mëparshme për heqjen e vizave për udhëtarët, ato linin të hynin në tokë greke pa viza shqiptarët e krishterë, kurse myslimanët i ndalonin në pikat kufitare. Legata shqiptare në Athinë ndërhynte herë pas here pranë Ministrisë së Jashtme greke për lejimin e tyre, dhe në fillim të tetorit ajo ia raportonte këtë qëndrës si një çështje serioze, si një masë diskriminuese, së cilës i duhej përgjigjur duke «mos lejuar asnjëri të vinte në Greqi pa viza të legatës helenike», pavarësisht nga përkatësia fetare.³

Siç duket kishte mbetur pa efekt edhe një notë e Ministrisë së Jashtme shqiptare drejtuar legatës greke në fund të gushtit, notë me anën e së cilës tërhiqej vëmendja kundër pengesave që u sillleshin shqiptarëve myslimanë që udhëtonin për në Greqi të pajisur me pasaporta të rregullta shqiptare, me pretekstin se mund të krijonin inkonvenience lidhur me operacionet që ishin në zhvillim e sipër për shkëmbimin e popullsive greko-turke.⁴

Një fakt tjetër që flet për një kthesë gjithnjë më negative në qëndrimin e qeverisë së Athinës karshi Qeverisë së Nolit është orvatja e saj (e qeverisë së Athinës) për të ndërhyrë

1) Tel. i legatës shqiptare nga Athina datë 28.7.1929. *AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 212.*

2) Shkresë e prefekturës së Korçës datë 21.8.1924 drejtuar Ministrisë së Jashtme. *AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 212.*

3) Raport i legatës nga Athina datë. 1.10.1924, *AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 212.*

4) Notë verbale e Ministrit të Jashtëm drejtuar legatës greke datë 31. 8. 1924, *po aty.*

në të ashtuquajturën «çështje himariote». Origjina e kësaj çështjeje e zë fillin që në mesjetë, kur Himara i shkëputi sulltanit të drejtën e njëfarë autonomie («venome») kundrejt detyrimit për të paguar një haraç («taksë bindjeje») dhe për të dërguar «kapedanët dhe bajrakët» e saj në ndihmë të sulltanit në rast lufte. Dihet se ky nuk ka qenë një rast i izoluar në Perandorinë Osmane: autonomitë e kufizuara lokale i gjejmë edhe gjatë në Shqipëri (Mirdita) sikurse edhe në vende të tjera ballkanike (kryesisht në viset malore). Me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe me krijimin e shtetit të centralizuar shqiptar, «venomet» e Himarës binin ndesh me rendin e ri shtetëror. Në të vërtetë as statuti organik i hartuar nga Komisioni Ndërkombëtar në prill 1914, madje as Protokolli i Korfuzit mbi të ashtuquajturën «autonomi vorioepirote» i qershorit të po atij viti, nuk bëjnë fjalë për ndonjë status të veçantë të Himarës.¹ Megjithatë, qarqet vorioepirote i janë kthyer çështjes herë pas here, si në kohën e trazirave të vitit 1914 ashtu edhe pas Luftës I Botërore. Nën nxitjen e këtyre qarqeve, edhe pas vitit 1920 (pas formimit të qeverisë kombëtare të dalë nga Kongresi i Lushnjës), «himariotëve» iu bënë disa lëshime në drejtim të përjashtimit nga pagimi i disa taksave, çka mund të interpretohej ende si element i njëfarë statusi të veçantë të kësaj krahine.

Qeveria e Nolit u tregua më e vendosur për t'i dhënë fund kësaj anomalie, i quajti «venomet himariote» si një cenim të sovranitetit shqiptar, dhe mori masa që të kapërcehej një situatë e tillë anakronike, duke zbatuar ligjin në mënyrë unike: Himara, si pjesë përbërëse e territorit shqiptar, duhej t'i nënshtrohej po ashtu veprimit të këtyre ligjeve, që konsakronin parimin e njësisë kombëtare.

Qarqet qeveritare në Athinë e shfrytëzuan edhe këtë rast për të ndërhyrë në punët e brendshme të Qeverisë së Nolit. Në shtypin grek nga fundi i shtatorit dhe fillimi i tetorit, u botuan shkrime mbi «Himarën që lëngonte nën thundrën e një tiranie» e cila tani pas qershorit, ishte bërë «edhe më e rëndë nën Qeverinë e Nolit», që quhej «vegël e Italisë».² Ajo që është edhe më e rëndë, qeveria greke kreu një akt që mund të interpretohej si një demonstrim force. Në fillim

1) Shih A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, vëll. II, Tiranë, 1987, d. nr. 152, 155.*

2) Kështu shprehej gazeta greke «*Eleftheros Typos*» datë 24-11-1924 në një artikull me titullin «Lufta e Himarës». Nga kupytrat e shtypit në AQSH, *fondi 251 v. 1924, d. 225.*

të tetorit, prefektura e Gjirokastrës njoftonte se «kohët e fundit» një luftanije greke ishte futur disa herë në Sarandë «pa respektuar rregullat ndërkombëtare dhe pa marrë lejen e duhur». ¹ Madje po kjo luftanije më 23 shtator kishte dalë në Spilë të Himarës. Komandanti i saj, i pyetur prej policisë «për qëllimin e ardhjes», ishte përgjigjur se «kishte dy fjalë për t'i thënë administratorit të vendit». Meqenëse nuk ishte lejuar të dilte në tokë, ai ishte kthyer në Sarandë ku në takim me përfaqësuesit lokalë, jo vetëm që kishte shfaqur pakënaqësinë «për mospranimin e tij në Himarë», por edhe kishte kërkuar «që të jepeshin urdhrat e duhura për rivajtjen e tij në Himarë, ku të qëndronte të paktën një orë». ²

Duke ia raportuar ndodhinë Ministrisë së Jashtme, Ministria e Brendshme theksonte se «qëllimi i vizitimit s'asht tjetër veçse me shtue guximin himariotëve tue i ba ata me pandehun se do të kenë përkrahjen e Greqisë në çështje të venomeve e se me dukjen (e luftanijeve) nëpër brigje do të frikësojnë qeverinë» për të penguar programin e saj në drejtim të zbatimit unik të ligjeve. ³

Ministria e Jashtme e ngriti çështjen pranë qeverisë greke, qoftë nëpërmjet legatës shqiptare në Athinë, qoftë nëpërmjet legatës greke në Durrës, duke kërkuar që «asnjë anije luftime greke të mos vizitonte limanet e Shqipërisë pa bërë lajmërimin e duhur pranë Ministrisë së Jashtme dhe pa marrë lejen e posaçme». ⁴

Mbi këtë bazë Ministria e Brendshme porosiste veçanërisht prefekturat e Vlorës e të Gjirokastrës që të mos lejohej asnjë luftanije greke t'u afrohej porteve pa pasur lejen përkatëse. Nga ky rregull i përgjithshëm mund të bëhej përjashtim vetëm për ato që pësonin aksident në det të hapur ⁵ (siç e do dhe ligji ndërkombëtar në të tilla raste).

Jehona e «çështjes himariote» u dëgjua edhe në Lidhjen e Kombeve, kur përfaqësuesi grek Politis u ankua për ato që ai quante «presione të qeverisë shqiptare kundrejt himariotëve». Vetë drejtori i seksionit të minoriteteve në Organizatën e Gjenevës Kolben (Colben), gjatë një vizite në

1) Shkresë e prefekturës së Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Brendshme datë 4-10-1924, AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 228.*

2) *Po aty.*

3) Shkresë e Ministrisë së Brendshme datë 14.10.1924, AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 228.*

4) Nga shkresa e Ministrisë së Brendshme (pa datë, por duket se është e tetorit), AQSH, *fondi 252, v. 1924, d. 77.*

5) *Po aty.*

Athinë javën e fundit të tetorit, në takimin që pati me përfaqësuesin e legatës shqiptare, u bë zëdhënës i kësaj ankese. Në përgjigjen e tij, përfaqësuesi shqiptar kundërshtoi orvatjen e qeverisë greke për ta trajtuar çështjen e Himarës në një plan me atë të pakicave kombëtare: së pari, «himariotët nuk formonin minoritet», as «nga gjuha, zakonet dhe as nga ndjenjat» nuk ndryshonin prej popullsisë shqiptare; së dyti, privilegjet (venomet) që kishin qenë në fuqi «në kohë të Turqisë» jo vetëm në Himarë, por edhe «në do vise të tjera të Shqipërisë» ishin suprimuar nga statuti i shtetit shqiptar i miratuar në Lushnjë. Në këto kushte «zelli dhe interesi që rrëfente Greqia për himariotët... ishte fare i pathemeltë» dhe, pra «një ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë».¹

Një tregues i keqësimit të marrëdhënieve greko-shqiptare është edhe jehona që filloi të gjejë gjithnjë më shumë në shtypin grek fushata e Beogradit me akuzat e njohura në adresë të Qeverisë së Nolit lidhur me të ashtuquajturat «banda» të nisura gjoja nga territori shqiptar. Gazeta greke «Elefteron Vima», në një nga numrat e saj të shtatorit, jo vetëm që e trajtonte në mënyrë më tendencioze akuzën, duke e bërë qeverinë shqiptare fajtores për «organizim bandash sulmuese kundër fqinjve të saj», por bënte edhe thirrje për një front të përbashkët të vendeve ballkanike kundër asaj që quhej «fqinjë e pakorrigjueshme».² Duket qartë se edhe në Jug, ashtu sikurse në Veri, fushata e akuzave të nevojitej qarqeve influente për të përligjur kursin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në aksionin për rrëzimin e Qeverisë Demokratike. Kështu horizonti errësohej gjithnjë më tepër edhe në marrëdhëniet me Greqinë dhe Qeveria e Nolit po binte në një karantinë të plotë diplomatike.

1) Raport i legatës shqiptare nga Athina datë 22.10.1924. AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 249.

2) Gazeta «Elefteron Vima» datë 22. 9. 1924. Nga kupytrat e shtypit të huaj AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 225. Gazeta shprehej me këto fjalë: «Nuk mjafton që Shqipëria nuk mund të vejë rregull të brendshëm të çrëruarshëm për elementet me kombësi të huaj, por është bërë edhe një vatrë organizimi bandash sulmuese kundër fqinjve të saj. Vendet ballkanike të interesuara duhet të mbajnë kundrejt kësaj fqinje të pakorrigjueshme një qëndrim të prerë. Vetëm në këtë mënyrë do të frenohen zakonet e saj keqbërëse».

Kapitulli IV

PËRBALLË PROBLEMEVE KUFITARE

Megjithëse kishin kaluar disa vjet pas mbarimit të Luftës I Botërore, Qeveria Demokratike e 1924-s në veprimtarinë e saj të jashtme u ndesh edhe me çështjen e kufijve. Mënyra si e trajtoi këtë çështje është gjithashtu një provë e angazhimit të Qeverisë Demokratike në mbrojtjen e interesave themelore kombëtare, e dëshirës dhe prirjes së saj për të ndjekur një vijë të vetën të pavarur në fushën e politikës së jashtme. Mirëpo sqarimi i tyre është i pamundur të bëhet pa një tablo sado të përgjithshme të zhvillimeve që mori çështja e kufijve pas luftimeve.

Problemi i caktimit përfundimtar të kufijve të Shqipërisë

Siç dihet, kufijtë e Shqipërisë u caktuan në vija të përgjithshme në Konferencën e Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha që në vitin 1913, në të njëjtën kohë që u mor edhe vendimi për të njohur Pavarësinë e Shqipërisë. Fuqitë e Mëdha të kohës ranë gjithashtu në marrëveshje për të krijuar dy komisione, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tyre dhe me detyrë që të vinin në Shqipëri për t'i caktuar kufijtë në vend. Njëri prej këtyre komisioneve, ai i kufirit të Jugut me Greqinë, filloi nga puna në shtator 1913 dhe mbaroi në dhjetor të po atij viti me miratimin e Protokollit të Firences.

Komisioni tjetër, ai i kufirit të veriut me Malin e Zi dhe Serbinë, e filloi gjithashtu punën në vjeshtë të vitit 1913, por e ndërpreu për shkak të dimrit të rreptë në viset veriore. Kur e rifilloi në pranverë të vitit 1914, nuk qe në gjendje ta çonte deri në fund detyrën dhe u shpërnda fare në verë të

po atij viti me shpërthimin e luftës.¹ Shqipëria u bë menjëherë shesh lufte, në kundërshtim me neutralitetin e saj të vendosur një vit më parë nga Konferenca e Ambasadorëve. Gjatë viteve të luftës, palët ndërluftuese i shkelën vazhdimisht tokat shqiptare, të cilat ndërronin zot, sa herë që ndërronte fati i armëve.

Në mbarim të luftës paraqitej kjo gjendje e shtrirjes territoriale të forcave pushtuese: trupat italiane prej shtatorit të vitit 1918, duke ndjekur trupat austro-hungareze në tërheqje, e kishin shtrirë kontrollin e tyre në të gjithë Shqipërinë e Mesme dhe në një pjesë të mirë të Shqipërisë Veriore. Korça dhe Pogradeci me rrethe mbeteshin nën pushtimin dhe administrimin e forcave franceze. Në veri e verilindje rivendosën sundimin e tyre dhe madje u dukën përkëtej kufijve të 1913-s edhe forcat serbe, të cilat patën në këtë rast përkrahjen e autoriteteve ushtarake franceze.

Pas përfundimit të armëpushimit ishte vendosur që trupat aleate të vazhdonin të qëndronin në Shqipëri derisa fati i saj të vendosej në Konferencën e Paqes. Kur trupat franceze, gjatë operacioneve të tyre të fundit, u qenë afruar tokave shqiptare që iu dhanë Serbisë më 1913, banorët vendas kishin dashur të kundërshtonin me armë, sepse shikonin aty rrezikun e rivendosjes së sundimit serb në trojet e tyre. Vetëm pasi kishin marrë disa sigurime nga komanda franceze, shqiptarët kishin pranuar të linin Pejën dhe të gjitha pikat me rëndësi strategjike. Francezët, me t'i marrë, ua kishin dorëzuar serbëve.² Jo vetëm kaq, por qeveria e Parisit, nën pretekstin e «nevojave ushtarake», e pati ndihmuar qeverinë serbe t'i fuste trupat e saj edhe në toka që i ishin lënë Shqipërisë më 1913. Gjenerali francez Desperi (Franchet d'Espéry), me autorizimin e qeverisë së tij, në nëntor 1918, caktoi një të ashtquajtur «vijë strategjike»³ mjaft përbrenda kufirit të 1913-s, e cila u la të mbahej nga trupat serbe. Në një gjendje të veçantë ishte qyteti i Shkodrës, ku hynë më parë trupat serbe dhe pastaj ato italiane. Aty, si para luftës, u rivendos, një regjim ndërkombëtar, por administrimi i qytetit dhe i periferisë së tij i qe besuar tani një garnizoni

1) Shih A. Puto. *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, vëll. II (1912-1918), Tiranë, 1987, f. 80-100.*

2) J. Suvre, *vep. cit.*, pp. 281-282.

3) Është quajtur edhe «vija e armëpushimit», si dhe vija «Franchet d'Espéry».

ndërraleat, nën komandën e gjeneralit francez Furtu (de Fourtou), të përbërë nga reparte franceze, italiane dhe angleze.¹

Një ndarje e tillë e territorit të Shqipërisë midis forcave të pushtimit të shteteve të ndryshme ishte plot me pasoja të rrezikshme. Pushtimi ushtarak, si një masë e përkohshme, që u arsyetua në kohën e vet me rrethanat e luftës botërore, tani mund të përfundonte në aneksimin e tokave shqiptare dhe fshirjen e Shqipërisë nga harta politike.

Planet që u sajuan disa herë goftë në Konferencën e Paqes, goftë jashtë saj, gjenin pikërisht një bazë faktike, në mos juridike... në ndarjen *de facto* që i ishte bërë territorit shqiptar të nesërmen e pushimit të luftimeve. Në të njëjtin vështrim është e drejtë të thuhet se qëndresa e popullit shqiptar dha frytet e saj imëdiate, sepse pas Kongresit të Lushnjës shtetet e huaja filluan të tërhiqnin trupat e tyre. Në të vërtetë rimëkëmbja e shtetit shqiptar pas lufte pati si etapë kryesore bashkimin e tokave të 1913-s nën autoritetin qendror të Qeverisë kombëtare. Ky proces u bë i pandalshëm pas Luftës së Vlorës dhe pas përfshirjes së forcave shqiptare që prej vjeshtës së vitit 1920 në aksionin për çlirimin e tokave të «vijës strategjike» në veri e verilindje.

Në pranverën e vitit 1921 mund të bëhej një bilanc i parë pozitiv; Qeveria shqiptare kotrollonte pjesën më të madhe të tokave brenda kufijve të 1913-s, por mbeteshin jashtë ende dy pjesë.

Njëra, në jug, përfshinte gjithsej nja 26 fshatra të Korçës, që mbaheshin nga trupat greke. Në kohën e sundimit turk këto fshatra administrativisht bënin pjesë në *kazanë* e Korçës, e cila në bazë të Protokollit të Firences të vitit 1913 iu dha tërësisht Shqipërisë. Mirëpo për shkak të një gabimi në hartë, kufiri i *kazasë*, pra në këtë rast edhe kufiri midis Shqipërisë dhe Greqisë në këtë sektor, kishte dalë i pasaktë, dhe nga kjo pasaktësi kishin përfituar autoritetet greke për t'i përfshirë këto fshatra brenda kufijve të Greqisë.²

Pjesa e dytë ishte një zonë ende mjaft e madhe, prej liqenit të Ohrit deri në liqenin e Shkodrës, që qeveria e Beogradit mbante në bazë të «vijës strategjike» dhe nuk donte

1) *Historia e Shqipërisë, vëll. III, Tiranë 1984, f. 186.*

2) Shih A. Simonard. *Essai sur l'indépendance albanaise, Paris 1942, pp. 405-407 dhe J. Swire, vep. cit. p. 381; League of Nations. Official Journal, March, 1922, pp. 261-265.*

ta lëshonte edhe pse detyrohej të përballonte kryengritje të vazhdueshme të popullsisë lokale, që arrinin, sipas disa vlerësimeve, në më se 150 mijë frymë.¹ Për më tepër trupat jugosllave e kapërcenin shpesh këtë vijë dhe kryenin inkursione më në theliësi, duke mbërritur herë-herë deri në afërsi të Tiranës. Një gjendje e tillë nuk mund të mos ishte burim tensioni në marrëdhëniet midis dy qeverive.

Sidoqoftë, në kushtet e rritjes së lëvizjes së qëndresës shqiptare, qarqet drejtuese të shteteve fqinje qenë të detyruara t'i rishikonin kërkesat lidhur me Shqipërinë. Të pa-fuqishme tanimë për të ndryshuar parimin e pavarësisë shqiptare (që sapo kishte gjetur një konsakrim të ri ndërkombëtar në pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve), ata kërkuan «vetëm» të shtrohej edhe një herë çështja e kufijve: këtu lanë mënjanë planet «e mëdha» të copëtimit dhe ngulën këmbë për «rektifikime». Në këtë drejtim u jepte dorë deri diku fakti se puna për caktimin e kufijve në vend, para lufte, nuk ishte çuar deri në fund.

Një mosmarrëveshje parimore ndau për disa kohë Qeverinë shqiptare dhe qeveritë e shteteve fqinje rreth instancës ndërkombëtare kompetente për t'i vendosur këto çështje. Një rol të shquar luajti këtu vetë Fan Noli, i cili, duke dalë disa herë para Lidhjes së Kombeve si përfaqësues i Qeverisë shqiptare, mbrojti me një zotësi të rrallë tezën se çdo gjë që kishte mbetur pezull në çështjen shqiptare ishte në kompetencë ekskluzive të organizatës ndërkombëtare, të cilën Noli e pati quajtur «inkarnacion i ri i koncertit të fuqive». Përkundrazi, përfaqësuesit e shteteve fqinje, të cilët në vend të publicitetit të Organizatës së Gjenevës parapëlqenin shqyrtimin dhe vendimin në një rreth më të ngushtë, patën shfaqur pikëpamjen se vetëm një konferencë e re e ambasadorëve ishte e kualifikuar ta «përkryente» punën e lënë përgjysmë, një konferencë që të ishte vazhdim i drejtpërdrejtë i asaj që u mblodh para lufte.²

«Konflikti i kompetencave», siç u quajt asokohe, gjeti një zgjidhje atëherë kur vetë Lidhja e Kombeve, duke mohuar «frymën e re» që pretendohet se ishte thirrur të sillte në marrëdhëniet ndërkombëtare, «investoi» Konferencën e Ambasadorëve të katër Fuqive me shqyrtimin e aspekteve të

1) J. Swire, *vep. cit.*, pp. 345-346.

2) Shih A. Puto, *Çështja e statusit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe në Konferencën e ambasadorëve në «Studime historike», nr. 3, 1965.*

kontestueshme që paraqiste çështja shqiptare. Në nëntor 1921 konferenca në fjalë mori në Paris vendimin e njohur, i cili ndonëse ripohonte vlerën e akteve të 1913-s, nuk linte pa gjë edhe shtetet fqinje, duke pranuar mundësinë e «rekthifikimeve» në disa sektorë të kufijve. Pas kësaj, vërtet qeveria e Beogradit u detyrua ta linte «vijën strategjike», por prapë mbeti një shteg i hapur për mosmarrëveshje të reja kufitare, të cilat krijonin doemos një ndjenjë pasigurie të vazhdueshme dhe nuk e linin Qeverinë shqiptare të përqendrohej me mendje të mbledhur në çështjet e brendshme më të ngutshme. Edhe komisionet që erdhën në Shqipëri menjëherë (qoftë ai i hetimit, i dërguar nga Lidhja e Kombeve, qoftë ai i «demarkacionit», caktimit të kufijve në vend, që vepronte në emër të Konferencës së Ambasadorëve), me gjithë raportet e tyre pak a shumë të favorshme, nuk mund të shpërndanin psikozën e dyshimeve dhe të qëndruarit në pritje, sepse vetvetiu ndihmonin për ta mbajtur të mbërthyer gjithnjë në fazën e diskutimit çështjen shqiptare, në mos në tërësi, të paktën në disa aspekte. Gjatë 2-3 vjetëve mosmarrëveshjet kufitare kaluan një cikël të gjatë shqyrtimesh në Lidhjen e Kombeve, në Konferencën e Ambasadorëve dhe madje në Gjykatën Ndërkombëtare të asaj kohe; e megjithatë në vitin 1924 mbeteshin ende tre «bishta» që kërkonin zgjidhje. Këto ishin: çëshja e fshatrave të Korçës, ajo e Vermoshit dhe ajo e Shën-Naumit. Madje për të tria këto ishin marrë edhe vendimet përkatëse, por meqë ishin në favor të rikthimit të tyre Shqipërisë, nuk viheshin në zbatim as nga qeveria greke e as nga ajo jugosllave.

Përçapjet e Qeverisë Demokratike për kufijtë

Qeveria Demokratike, pas ardhjes së saj në fuqi, nuk mund të mos i kushtonte një vëmendje të dorës së parë zgjidhjes së konflikteve kufitare me shtetet fqinje, që ishin bërë një «gangrenë» në jetën politike të brendshme dhe paralizonin çdo program veprimtarie të mirëfilltë në fushën e politikës së jashtme. Preokupacioni i Qeverisë Demokratike lidhur me çështjen e kufijve del qartë nga një përçapje që ajo bëri në fillim të korrikut pranë qeverisë italiane. Siç u tha, Fan Noli i drejtoi për këtë një letër të veçantë vetë Musolinit, që ishte edhe ministër i Punëve të Jashtme. Prej saj mund të kuptohet se në zgjidhjen përfundimtare të çështjes

shtjes së kufijve me shtetet fqinje Qeveria e re Demokratike kishte angazhuar gjithë prestigjin e saj. Ajo shqetësohej veçanërisht se mos ndoshta për antipati politike kundrejt ndryshimeve të ndodhura në Shqipëri, fuqitë mohonin edhe vendimet e tyre të mëparshme: «Një zgjidhje e disfavorshme e këtyre tri pikave shumë të rëndësishme të kufijve shqiptarë, — thuhej midis të tjerash në letrën e Nolit, — do të ishte fatale për Qeverinë e re shqiptare, sepse një dështim i tillë do t'i atribuohet nga kundërshtarët tanë paaftësisë së saj dhe antipative që ajo ka ngjallur përjashta. Asnjë shpjegim nuk do ta qetësonte më popullin e dëshpëruar nga këto humbje territoriale të njëpasnjëshme. Prestigji i Qeverisë së re do të cenohet në mënyrë të pandreqshme» përfundonte Noli, duke kërkuar përkrahjen diplomatike italiane.¹ Mirëpo Musolini, në letrën e tij të përgjigjes, që i dërgoi gau një muaj më vonë, në fillim të gushtit, për arsyet që tani dihen, u mjaftua me disa fjalë të përgjithshme.² Për Qeverinë Demokratike u bë e qartë se nuk do të dilte gjë nga përçapjet pranë kësaj apo asaj qeverie.

Ndaj edhe kjo çështje u vu në qendër të përpjekjeve që zhvilloi delegacioni shqiptar në sesionin V të Asamblesë së përgjithshme të Lidhjes së Kombeve në shtator të vitit 1924 në Gjenevë të Zvicrës. Delegacioni kryesohej nga vetë Fan Noli. Edhe kjo, ndikoi që çështja e kufijve u shtrua me forcë në Gjenevë pikërisht me inisiativën shqiptare: Fan Noli, tani në cilësinë e kryetarit të Qeverisë shqiptare, nuk mund ta linte pas dore një çështje për të cilën ai vetë 2-3 vjet më parë kishte bërë një luftë të madhe në Lidhjen e Kombeve.

Hapi i parë i delegacionit shqiptar në Gjenevë kishte të bënte pikërisht me çështjen e kufijve. Kjo ishte një letër që Fan Noli i drejtonte më 19 shtator 1924 sekretarit të përgjithshme të Lidhjes. Në fillim përmendej se tre vjet më parë, në tetor 1921, Asambleja e Lidhjes kishte marrë një vendim unanim, me anën e të cilit ngarkonte Konferencën e Ambasadorëve me rregullimin përfundimtar të kufijve të Shqipërisë, e megjithatë kjo detyrë nuk ishte çuar në krye. Mbeteshin pezull ende tre sektorë: fshatrat e Korçës, Shën-Naumi dhe Vermoshi.* Në letër theksohej se për këto ishin marrë tanimë edhe vendimet përkatëse dhe nuk mbetej veçse të viheshin në jetë.

1) Cituar sipas *P. Pastorelli, Italia e Albania (1924-1927), Firenze 1967*, pp. 48-49.

2) *DDI. 7^a serie, vol. III, d. nr. 341, p. 251.*

* Vermoshi si fshat është brenda kufirit shqiptar.

Në letrën e Nolit thuhej më tej se kjo gjendje e papërcaktuar i krijonte Qeverisë shqiptare vështirësi të brendshme dhe të jashtme: veç shpenzimeve të mëdha që shkaktonte punimet e komisionit të kufijve¹ dhe që rëndonte shumë në buxhetin e shtetit, ishte edhe rreziku që të lihej «porta e hapur për konflikte kufitare eventuale» midis Shqipërisë dhe fqinjëve.

Duke përfunduar, Noli shkruante se Qeveria shqiptare kishte marrë vesh se «në qoftë se Konferenca e Ambasadorëve nuk i vendoste menjëherë këto çështje, atëherë komisioni i kufijve do t'i shtynte punimet për verën e ardhshme». Ndaj edhe në letër kërkohej që të shqyrtohej çështja nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve dhe ky të ndërhynte pranë Fuqive, që ishin anëtare të tij dhe që përfaqësoheshin njëkohësisht në Konferencën e Ambasadorëve, për t'u vënë në dukje «vështirësitë e mëdha që rrjedhin nga shtyrjet në përcaktimin përfundimtar të kufirit midis Shqipërisë dhe shteteve fqinje».²

Më 25 shtator Fan Noli mori fjalën përpara vetë Këshillit të Lidhjes. Ai e hapi me këto fjalë proteste:

«Çështja e kufijve të Shqipërisë, që u shtrua përpara luftës botërore 11 vjet më parë, pret sot ende një zgjidhje përfundimtare, zgjidhje që shtyhet çdo dimër për verën që vjen. Dimri që pritet a thua do të na sjellë një shtyrje të re me gjithë konfliktet dhe ndërlikimet që e shoqërojnë? Kjo është pyetja që bëjnë shqiptarët me ankth gjithnjë më të madh. Mjaft zgjati kjo torturë, mjaft rëndoi kjo kllapi mbi një popull që nuk i ka merituar aspak mundimet dhe që nuk kërkon veçse paqe».³

Pastaj Noli bëri historikun e shkurtër të asaj që ai e

1) Pala shqiptare mbante barrën më të rëndë të shpenzimeve të Komisionit të kufijve sepse detyrohej të derdhte shuma të majme në favor të «komisarëve», jo vetëm për kufirin e Veriut, por edhe për atë të Jugut. Nga një dokument i kohës del se vetëm gjatë vitit 1924 janë shpenzuar 300 mijë franga ar (100 mijë për çdo trimëstër. *AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 133, fl. 482*). Qeveria e Nolit është ndodhur edhe përpara presioneve për t'i paguar në kohë shpenzimet e Komisionit të Kufijve, siç del nga një shkresë e sekretariatit të Konferencës së Ambasadorëve, drejtuar legatës shqiptare në Paris, më 11 gusht 1924. Nota e dalë nga Ke d'Orsé-ja përmbante një qortim të qartë në adresë të qeverisë shqiptare për vonesën e pagimit të shpenzimeve të trimëstrit të tretë. *Po aty, fl. 270*.

2) Letër e F. S. Nolit drejtuar sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve datë 19.2.1924 marrë nga *Proces-verbaux du Conseil tenus a Genève du 29 aout au 3 octobre 1924. Société des Nations, Journal Officiel, Octobre 1924, pp. 1335-1336*.

3) *Po aty*.

quajti «tragjedia e trishtueshme», «akti i fundit i së cilës, siç tha ai, — pret më kot një stinë më të përshtatshme».¹ Kjo pjesë e fjalimit ia vlen aq më tepër të sillet e plotë, sepse, veç që na jep një parashtrësë instruktive, është edhe një copë e zgjedhur që futet patjetër në fondin e artë të shkri-meve publicistike noline:

«Më 1913, në mbarim të luftërave ballkanike, Konferenca e Ambasadorëve në Londër, pas traktativash të gjata e të lodhshme, i caktoi në hartë kufijtë e Shtetit shqiptar, duke lënë më shumë shqiptarë jashtë sesa brenda Shqipërisë. Një komision ndërkombëtar u ngarkua të caktonte kufijtë e saj në vend. Ky e filloi punën në muajin shtator të vitit 1913. Dimri i parë solli shtyrjen e parë. Në verë të vitit vijues, më 1914, lufta botërore i ndërpreu punimet e këtij komisioni dhe prej 1914-s e deri më 1920, nuk ka qenë e mundur të numërohen as dimrat dhe as verat që vinin pas tyre. Njerëzit mezi arrinin të numëronin invadimet, kundërinvadimet dhe pushtimet ushtarake të huaja që ndiqnin njëri-tjetrin në një tokë pa zot. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe plot dhimbje, as që bëhej fjalë më për caktimin e kufijve të Shqipërisë, por flitej për zhdukjen e saj nga faqja e dheut. Çështja e caktimit të kufijve u rimor më 1921, kur Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve, një ngjarje kjo që është vështirë të mbivlerësohet.

Gjendja në vitin 1921 ishte si vijon: pothuaj i gjithë territori që iu caktua Shqipërisë më 1913 ishte në duart e shqiptarëve, me përjashtim të nja njëzet fshatrave në lindje të Korçës, që u quajtën zonë neutrale nga grekët, si dhe të një zone mjaft të gjerë prej liqenit të Ohrit deri në liqenin e Shkodrës të pushtuar prej serbëve, sipas një vije demarkacioni të hequr nga trupat aleate gjatë armëpushimit. Kjo vijë ishte tepër elastike. Ajo kishte tendencën e bezdisur që të shtrihej drejt perëndimit, duke arritur herë-herë deri në afërsitë e Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë. Shqiptarët nuk i shijonin aspak tekat e kësaj vije fluturuese. Së këtejmi rridhnin konfliktet kufitare periodike dhe ndërhyrjet e Lidhjes së Kombeve».²

Më tej Fan Noli deshi të rikujtonte vendimet që u morën për këto çështje në vitin 1921, me radhë, nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve (qershor), nga Asambleja e Përgjithshme (tetor) dhe nga Konferenca e Ambasadorëve (nëntor).

1) Po aty.

2) Po aty.

Por në këtë pikë u ndërpre nga kryetari i Këshillit, i cili e quajti këtë «jashtë teme».

Duke i rënë shkurt F. Noli nuk le pa vënë në dukje përsëri thelbin e ankesës shqiptare si dhe arsyet që e bënin të domosdoshme marrjen e masave për një zgjidhje të saj të shpejtë.

«Për shkaqet të ndryshme, — tha F. Noli në përfundim të fjalimit të tij përpara Këshillit, — që nuk është nevoja t'i shpjegojmë (aluzion i qartë për fjalën që ia prenë — A.P.), çështja nuk është zgjidhur ende sot e kësaj dite. Dimri po afron, i njëmbëdhjeti pas 1913-s, i katërti pas 1921-së dhe komisioni i caktimit të kufirit deklaroi se ai do t'i shtyjë përsëri vendimet e tij për verën që vjen, në qoftë se brenda dy javëve nuk i jepen udhëzime nga Konferenca e Ambasadorëve». Mirëpo, — vazhdoi Noli, — «një shtyrje e re do t'i shkaktonte shpenzime të tjera Shtetit Shqiptar, të cilit deri tani çështja e caktimit të kufirit i ka kushtuar gati 1 milion franga ar». Kjo si dhe rreziqet që përmbanin në vetvete mosmarrëveshjet kufitare si «për marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë», ashtu edhe «për paqen në përgjithësi», e shtynin përfaqësuesin e Shqipërisë t'i kërkonte Këshillit «të merrte masa që çështja të gjente zgjidhje të plotë përpara dimrit që po afronte».

Pasi dëgjoi fjalën e Fan Nolit, Këshilli i Lidhjes veprori në stilin që ishte karakteristik për Lidhjen e Kombeve: nuk mori asnjë masë, nuk caktoi asnjë detyrim konkret as për Konferencën e Ambasadorëve dhe as për qeveritë, të cilave u drejtohej kjo ankesë. Ai u kufizua me një formulë që nuk sillte asnjë element të ri: «u tërhiqte vëmendjen» anëtarëve të tij që bënin pjesë në Konferencën e Ambasadorëve, lidhur me çështjen e parashtruar nga përfaqësuesi i Shqipërisë.¹ Delegacioni i Qeverisë Demokratike në Lidhjen e Kombeve nuk e la me kaq: pasi e shtroi çështjen e kufijve në tërësi, e zbërtheu atë në pjesët e saj përbërëse, duke iu drejtuar përsëri Këshillit për secilën prej tyre.

Fshatrat e Korçës

Mosmarrëveshja lidhur me fshatrat e ish-kazasë së Korçës që një nga shkaqet e ndërlikimeve ndërkombëtare të rënda që ndodhën në verë-vjeshtë të vitit 1923 gjatë punime-

1) *Journal Officiel de la SdN. Octobre 1924, pp. 1335-1336.*

ve të komisionit kufitar për saktësimin e kufirit midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Komisioni në fjalë mori atëherë një vendim të parë, duke ia caktuar Shqipërisë 14 nga të 26 fshatrat që ishin objekt i grindjes.¹ Mirëpo qeveria e Athinës, jo vetëm që nuk deshë t'i nënshtrohej vendimit, por në shtypin grek të kohës u ngrit një fushatë e tërë kundër kryetarit të komisionit kufitar, gjeneralit italian Telini të cilin e akuzonin se gjoja kishte paragjykitime në favor të kërkesave shqiptare.² Në fund të gushtit autoritetet greke organizuan vrasjen e Telinit në një pikë midis Janinës dhe kufirit shqiptar. Qëllimi i tyre në këtë rast nuk ishte aq sa të zhduknin një kundërshtar të pretendimeve greke, se sa t'ua atribuonin krimin elementëve të ardhur nga «kufiri i turbullt shqiptar» dhe mbi këtë bazë të shtronin çështjen e një rishikimi të kufirit në favor të Greqisë.³ Dihet se kjo manevër u kthye kundër vetë Athinës sepse Musolini e shfrytëzoi rastin për «të treguar forcën», duke dërguar trupat italiane në ishullin e Korfuzit. Më në fund, qeveria greke u detyrua ta pranonte përgjegjësinë e saj, por kjo nuk e pengoi atë t'i mbante 14 fshatrat si dhe më parë. Për më tepër, ajo paraqiti ankesë kundër vendimit që ia jepte 14 fshatrat Shqipërisë.

Çështja mbeti pezull deri në prill të vitit 1924, kur një komision i ri kufitar erdhi në Korçë dhe ripohoi vendimin e mëparshëm. Një vendim të njëjlojtë mori edhe Konferenca e Ambasadorëve po në prill.³ Qeveria shqiptare për këtë mori njoftim zyrtar nëpërmjet një letre që Konferenca e Ambasadorëve i drejtonte legatës shqiptare në Paris më 19 prill. Në të njëjtën kohë qeveria greke u ftua të zbatonte vendimin, por as tani kjo nuk pranoi t'i lëshonte 14 fshatrat. Madje ajo i dërgoi një protestë të re Konferencës së Ambasadorëve. Në fillim të gushtit Konferenca e Ambasadorëve u mblodh posa-

1) Në raportin e komisionit të hetimit të Lidhjes së Kombeve të dt. 18.1.1922 jepet kjo listë e 26 fshatrave: Slimica (Stimnica), Pilkat, Novoselë, Kosteneç (Kostenets), Labonica e sipërme (Labanitsa), Trestenik, Kapistica (Kapishtitsa), Vrnik, Zagradec (Zagradets), Shues (Souetch), Rakicka (Rakitska), Travova, Grazhdan (Gradjan), Rahova (Rehova), Crnovcka Tsernoska), Labonica e Poshtme (Laithiza), Pustec (Poustets), Nivica (Nivitsa), Shulin, Glomboc (Glombtch), Bezmishte, Goricë (Goritsa), Konsko, Zaroshkë, Leskë, Kerje. Raport i Komisionit të hetimeve dt. 18.1.1922 në *Journal Officiel de la SdN Mars 1922*. Bashkëngjitur me raportin është edhe një hartë, në të cilën janë shënuar fshatrat e përmendura më lart, pp. 261-265.

2) *J. Swire, vep. cit., p. 419.*

3) *Po aty.*

4) *Po aty, pp. 426-427.*

çerisht për të shqyrtuar ankesën greke, por nuk e gjeti të drejtë. Prandaj e ftoi përsëri qeverinë e Athinës t'i lironte fshatrat nën mbikqyrjen e komisionit të kufirit, i cili do të caktonte edhe ditët e dorëzimit të tyre.¹ Mirëpo kishin kaluar afro dy muaj dhe qeveria greke nuk jepte shenja se do të zbrazte 14 fshatrat që duhej t'i kalonin Shqipërisë.

Qeveria Demokratike i vuri vetes si detyrë që t'u prishte rrugën këtyre zvarritjeve pa fund. Fan Noli i dërgoi për këtë një letër të veçantë sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes me 27 shtator. Pasi shpjegoheshin shkurt se si kishin rrjedhur ngjarjet që e mbanin ende të ngritur «çështjen e kufirit midis Shqipërisë dhe Greqisë» në letër theksohej se komisioni i caktimit të kufirit i kishte kërkuar dy herë qeverisë greke (të parën herë në fillim të gushtit, të dytën në mes të shtatorit), që të zbatonte vendimin e Konferencës së Ambasadorëve. E megjithatë qeveria e Athinës nuk u ishte përgjigjur se autoritetet greke jo vetëm që mbanin arbitrarisht një tokë që tanimë i njihej Shqipërisë, por edhe po i dëbonin banorët shqiptarë të këtyre fshatrave, duke i këmbyer si «turq» në bazë të marrëveshjes mbi «shkëmbimin e popullsisë» që ishte lidhur një vit më parë midis Greqisë dhe Turqisë.² Në përfundim të letrës thuhej se ky veprim i qeverisë greke «mund të prishte paqen midis dy shteteve fqinje», prandaj edhe kërkohej që çështja t'i kalonte Këshillit të Lidhjes. I cili duhej «të merrte masat e nevojshme për të siguruar zbrazjen e kësaj toke shqiptare nga ana e Greqisë».³

Letra e Fan Nolit u mor në shqyrtim nga Këshilli i Lidhjes në mbledhjen e tij të 3 tetorit të vitit 1924. Duke marrë fjalën për t'iu përgjigjur, përfaqësuesi grek Politis nuk e kundërshtoi më në thelb vendimin e Konferencës së Ambasadorëve. Ai u përpoq vetëm të justifikonte zvarritjen e zbrazjes së 14 fshatrave nga autoritetet greke, duke sjellë si pretekst atë që ai e quajti «një çështje me karakter thjesht konstitucional» dhe që e shpjegoi në këtë mënyrë: vendimi i fundit i Konferencës së Ambasadorëve që ia jepte 14 fshatrat Shqipërisë e gjeti parlamentin grek në pushim, kurse qeveria greke nuk mund t'i bënte asnjë ndryshim «territorit kombëtar» pa marrë më parë pëlqimin e tij (të parlamentit).

1) Gazeta «*Bashkimi*» datë 8.8.1924.

2) Shih më poshtë.

3) *Journal Officiel de la SdN. Octobre, 1924, Annexe 690. p. 1635*

Noli, në përgjigjen e tij, tha se ky ishte një justifikim krejt pa baza. Në të vërtetë nuk ishte aspak nevoja për miratimin e parlamentit grek për të lëshuar një territor që nuk i kishte përkitur kurrë Greqisë.

Pasi dëgjoi të dy palët, Këshilli vendosi ta ftonte qeverinë greke që të zbatonte sa më shpejt vendimet e Konferencës së Ambasadorëve.¹

Qeveria e Athinës kësaj here u detyrua të tërhiqej. Në një mbledhje të kryetarëve politikë të Greqisë, që diskutoi posaçërisht çështjen e 14 fshatrave, u vendos që t'u bëhej e ditur Fuqive të Mëdha se Greqia i bindej vendimit të Konferencës së Ambasadorëve. Në të njëjtën kohë delegati grek pranë komisionit të kufirit njoftoi se 14 fshatrat do të lëshoheshin më 23 tetor 1924². Më 30 tetor 1924 forcat shqiptare i morën në dorëzim.³ Dhe kështu përfundoi kjo çështje e mbetur pezull në caktimin e kufirit midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Vermoshi

Meqenëse, siç u tha më lart, caktimi i kufirit të Veriut nuk ishte çuar në krye para luftës, mosmarrëveshjet kufitare midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë pas luftës ngjallën diskutime më të zgjatura e më të koklavitura se ato në Jug. Pasi me vendimet e vitit 1921 u kapërcyen problemet «e mëdha» që preknin krahina të tëra me dhjetëra e mijëra frymë, mosmarrëveshjet u përqendruan pak nga pak në nja dy pika të veçanta të kufirit midis të dy vendeve.

Një pikë e tillë ishte, së pari, Vermoshi në verilindje të Shkodrës.

Historikisht, me dy fjalë, çështja paraqitej në këtë mënyrë. Zona e Vermoshit kishte qenë prej kohësh pjesë e përndarë e bajraqeve të Kelmendit. Deri në luftërat ballkanike kjo zonë shërbente si vend kullotash për kelmendasit. Këta në dimër uleshin me bagëtitë e veta në fushë, në Breg të Matit, kurse në verë ktheheshin në vendet e tyre dhe gjënë e gjallë e çonin në bjeshkët e larta të Vermoshit. Mirëpo kjo zonë ka qenë objekt grindjesh të vazhdueshme dhe përlëshjesh me armë midis shqiptarëve dhe malazezëve. Që në kohë të

1) *Société des Nations. Journal Officiel, Octobre 1924, pp. 1374.-1375.*

2) Shih gazetën «*Bashkimi*» datë 24.10.1924.

3) Nga telegrami-qarkore i Ministrisë së Jashtme, datë 31.10.1924, dërguar gjithë prefekturave në AQSH, fondi 251, Nr. Prot. C-X-343i.

Turqisë, për të mënjeluar disi ngatërresat, ishte shënuar në kufi me Malin e Zi një zonë «neutrale», ku nuk duhej të shkelnin as malazezët, as shqiptarët. «Davaja» u duk sikur mori fund kur Fuqitë ia lanë Vermoshin Shqipërisë më 1913.

Kur erdhi Komisioni Ndërkombëtar për të caktuar në vend kufirin e Veriut, që ishte vendosur më 1913 nga Konferenca e Ambasadorëve vetëm në parim, pala jugosllave doli me pretendime kundrejt Vermoshit. Ajo tha se kjo zonë kishte rëndësi të madhe ekonomike për të, sepse këtu parashikohej të kalonte një hekurudhë shumë e nevojshme për komunikacionet në pjesën jugore të Jugosllavisë. Pas kësaj çështja u mor në shqyrtim nga Konferenca e Ambasadorëve, e cila vendosi një herë më 1922 në favor të Shqipërisë. Por Jugosllavia u shpreh kundër vendimit të Konferencës dhe kërkoi rishqyrtimin e tij. Si shpjegohet kjo këmbëngulje e qeverisë së Beogradit në një çështje në dukje pa ndonjë vlerë? Veç grindjeve «tradicionale», në shtypin e huaj të asaj kohe u vunë në dukje edhe disa prapaska të ngritura mbi baza tregtie, që duket se na sjellin një sqarim më të plotë. Në një korrespondencë nga Tirana, të botuar në gazetën italiane «Xhornale d'Italia» (Giornale d'Italia) gati një vit më vonë (në gusht 1925), kishte një shpjegim të tillë:

«Vermoshi për Jugosllavinë është edhe një tregti. Ka nja dy vjet që një afarist i Beogradit, i cili në atë kryeqytet ka njëfarë emri, i ofronte një firmë franceze, të njohur për punimin e lëndës së drurit, një pyll me rëndësi afër kufirit të Shqipërisë në krahinën e Vasojeviçit (në Mal të Zi). Këtë pyll në Mal të Zi e quajnë Skotobusha. Firma franceze dërgoi teknikët e vet e këta dhanë një mendim negativ po të ishte vetëm për çka përfshihej brenda kufijve të Jugosllavisë. U vërtetua se 3/4 e pyllit ishin matanë, në territor shqiptar, e tamam në atë vend ku kalon uji i Vermoshit. E para protestë e Beogradit kundër vendimit të Konferencës së Ambasadorëve u bë pas mendimit që shprehën teknikët francezë. Shoqëria franceze u angazhua që atëherë t'i siguronte protestës jugosllave mbështetjen e qeverisë së Parisit në Konferencën e Ambasadorëve. E kështu Beogradi ngulte këmbë».¹

Ndërkaq incidentet me armë në kufi ishin bërë të shpe-

1) Korrespondenca ishte riprodhuar e plotë në gazetën e KONARE-s «Liria Kombëtare», datë. 2 shtator 1925.

shta në këtë zonë. Incidentet bëheshin me qëllimin e qartë që të shërbenin si një përforsim i kërkesës së Beogradit për t'ia shkëputur edhe këtë «copëzë» Shqipërisë. Nga mesi i gushtit, situata në skajin verior të kufirit filloi të jepte shenja acarimi. Me një shkresë të saj të 11 gushtit Ministria e Brendshme jepte sinjalin e alarmit, duke paralajmëruar një sulm kundër Vermoshit, «pasi autoritetet jugosllave ishin të vendosura ta merrnin atë medoemos, edhe sikur komisioni i kufijve të vendoste në favorin tonë». Ministria kishte të dhëna se matanë kufirit po mbledheshin forca.¹

Në ditët dhe javët që vijuan, çështja e Vermoshit mori trajtën e një konflikti për të arritur pikën kritike nga fundi i shtatorit. Për gjendjen e nderë që ekzistonte në këtë pjesë të kufirit legata shqiptare në Paris, me urdhër të Ministrisë së Jashtme, kishte tërhequr disa herë vëmendjen e Eduard Herriotit, në cilësinë e tij si kryetar i Konferencës së Ambasadorëve. Në tri nota të njëpasnjëshme, dt. 13, 23 gusht dhe 2 shtator, bëhej fjalë për disa «veprime kërcënuese e alarmante në afërsi të Vermoshit nga ana e disa klaneve malazeze të inkurajuara nga autoritetet jugosllave». Duke qenë se ndodhi të tilla «mund të turbullonin marrëdhëniet midis dy vendeve», Konferencës së Ambasadorëve i kërkohet që të përdorte «ndikimin e saj pranë qeverisë së Beogradit për të ruajtur qetësinë dhe rregullin» në këtë pjesë të kufirit.²

Mirëpo më 25 shtator pati një shkallëzim të dukshëm të këtyre veprimeve. Në orën 1 të mëngjesit «banda forcash civile të fiseve malazeze të Vasojeviçit, Triepshit. Kuçit etj., të organizuara dhe të armatosura mirë, sulmuan kufirin shqiptar me qëllimin e qartë që të shtinin në dorë Vermoshin». Duke ia njoftuar sa më sipër legatës britanike në Durrës, Ministria e Jashtme, në notën e saj të po asaj dite (25 shtator), shtonte se ky nuk ishte një episod i veçuar, se turbullirat në zonën e Vermoshit ishin një aksion i paramenduar i autoriteteve jugosllave «për të frikësuar» ose për të vënë para faktit të kryer komisionin e caktimit të kufirit, që me kërkesë të Konferencës së Ambasadorëve, do të shkonte në vend për një «anketë suplementare» lidhur me vijën kufitare në Vermosh. Duke protestuar «për këtë sulm të pajustificuar», për të cilin bëhej përgjegjëse drejtpërsëdrejti qe-

1) *Dokumente dhe materiale mbi veprimtarinë e Qeverisë së Nolit, në «Studime historike» nr. 4/1973, f. 132.*

2) Sipas notës së legatës shqiptare në Paris datë 27.9.1924 drejtuar E. Herriot-it, AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 265.

veria e Beogradit, i kërkohet qeverisë britanike «që të ndërhynte në Beograd me këshilla për moderacion», «për t'u dhënë fund këtyre veprimeve që kishin pasoja tepër të papëlqyeshme».¹

Në të njëjtën kohë ministria e Jashtme informoi telegrafisht për ngjarjen legatat shqiptare në Paris, Romë dhe Beograd.² Kjo e fundit udhëzohej që «të protestonte energjikisht pranë qeverisë serbe duke i kërkuar që të ndalonte menjëherë sulmin dhe të çarmatoste agresorët.»³

Por, kuptohet, gjendja e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave nuk jepte shumë shpresa se çështja mund të rregullohej me bisedime dypalëshe. Përkundrazi, tensioni në marrëdhëniet midis dy vendeve ishte vazhdimisht në rritje. Në të gjithë vendin, nga veriu në jug, në qendra të ndryshme, shpërthyen spontanisht demonstrata proteste. Kjo qe arsyeja që e shtyu Qeverinë Demokratike ta bënte të njohur botërisht incidentin e Vermoshit dhe të përpiqej ta shtronte çështjen në instancat ndërkombëtare.

Së pari, legata shqiptare në Paris mori urdhër t'i drejtohej përsëri E. Herriotit si kryetar i Konferencës së Ambasadorëve. Ajo e bëri këtë përcapje me një letër që i dërgoi kryeministrit francez më 27 shtator.⁴ Momenti i ri në këtë letër është shprehja e shqetësimit nga ana e qeverisë shqiptare se në këto ngjarje përziheshin edhe «refugjatë politikë shqiptarë», çka paralajmëronte rrezikun e një sulmi të gjerë jo vetëm në Vermosh, por edhe në pika të tjera të kufirit midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Letra përfundonte duke kërkuar ndërhyrjen e Konferencës së Ambasadorëve jo vetëm për ndalimin e këtij agresioni, por në përgjithësi për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve të mbetura pezull në çështjen e kufijve.⁵

Megjithatë, aksionin diplomatik kryesor Qeveria Demokratike e zhvilloi edhe në këtë rast në Lidhjen e Kombeve, aq më tepër që incidenti qëllon pikërisht kur delegacioni, me në krye Nolin, ndodhej në Gjenevë dhe ishte duke shtruar aty,

1) Notë verbale e Ministrisë së Jashtme në Tiranë drejtuar legatës britanike në Durrës datë 25.9.1924, AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 264.*

2) Tel. shifër datë 25.9.1924, AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 265.*

3) *Po aty.*

4) Letër e legatës shqiptare në Paris drejtuar E. Herriot-it datë 27.9.1924, AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 265.*

5) *Po aty.*

midis të tjerash, edhe çështjen e zvarritjeve në caktimin e kufijve me fqinjët.

Ashtu sikurse përfaqësitë shqiptare në kryeqytetet kryesore, edhe delegacioni shqiptar në Asamblenë e Lidhjes u vu në dijeni po atë ditë. Një telegram i Ministrisë së Jashtme nga Tirana (datë 25 shtator) njoftonte se në mëngjesin e asaj dite «më se 1 000 veta nga fiset malazeze të Vasojeviçit e Kuçit, së bashku me forca të tjera të organizuara nga Jugosllavia u futën në zonën e Vermoshit, Tamarës, në Grykën e Vuklit e Selcë, të cilat i plaçkitën». Në telegram bëhej fjalë për luftime që po zhvilloheshin «midis bandave jugosllave dhe postave shqiptare të kufirit», ndërsa «priteshin sulme të tjera nga ana e Tjaraboshit, e Hanit të Hotit... si dhe nga ana e Dibrës». Kjo e kishte detyruar qeverinë shqiptare «të dërgonte përforcime dhe madje të bënte një mobilizim të pjesëshëm për të prapësuar invazorët». Në fund vihej në dukje se «dora e qeverisë jugosllave në këtë çështje është e pamohueshme», sepse këto nuk ishin incidente të rastit por «një agresion i organizuar sistematikisht që prej fillimit të muajit gusht». Ky ishte edhe objekti i letrës që delegacioni shqiptar i dërgoi atë ditë sekretarit të Lidhjes.¹

Mbi bazën e këtyre njoftimeve të marra nga qendra, Fan Noli i dërgoi të nesërmen, më 26 shtator, një letër tjetër sekretarit të përgjithshëm. Pasi theksonte se fakte të reja u shtoheshin të parave për të provuar se «ç'ngatërresa të kota shkaktoheshin nga zvarritjet në zgjidhjen përfundimtare të kufijve shqiptarë», Noli kërkonte që edhe kjo çështje t'i përcillej Këshillit të Lidhjes «me qëllim që t'i jepet fund një gjendjeje që i kushton popullit shqiptar kaq gjak, shkatërrime dhe vuajtje»².

Ankesa e qeverisë shqiptare lidhur me Vermoshin dhe me incidentet në këtë pikë të kufirit u mor në shqyrtim nga Këshilli i Lidhjes, në seancën e parë të datës 3 tetor 1924.

I pari e mori fjalën Fan Noli, por vetëm sa për të shtuar se delegacioni shqiptar kishte marrë nga qeveria e tij një lajm të dytë që thoshte se sulmuesit ishin shtyrë përtej vijës

1) Tel. i Ministrisë së Jashtme nga Tirana datë 25.11.1924 AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 265.

2) *Journal Officiel de la SdN, Octobre 1924, Annexe, p. 689.*

së kufirit.¹ Mirëpo «operacioni kishte kushtuar gjak dhe shpenzime të reja», prandaj shpresohet se këshilli do të zgjidhte çështjen në mënyrë që «shkelje të tilla të kufirit të mos ndodhnin më në të ardhmen»²

Përfaqësuesi i Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene (siç quhej zyrtarisht Jugosllavia asokohe) Kumanudi, mbajti një fjalim të gjatë. Ai dha një version krejt tjetër të ngjarjes. Ai nuk ngurroi ta përshkruante atë me ngjyra të tilla që i dhanë trajtën e një tregimi në frymën romantike me motive të përziera sentimentale dhe grabitjeje bashkë. Ai tha se ajo që shkeli kufirin dhe u fut në sektorin e banuar nga fisi malazez i Kuçit ishte një bandë shqiptarësh. Këta vunë dorë mbi një kope lopësh dhe madje morën me vete edhe bareshat e reja që i ruanin. Njëra prej tyre arriti të shtjerë me pushkë dhe të japë alarmin. Dhe ndodhi ajo që ndodhi... «Meqenëse ky fis malazez, — tha përfaqësuesi jugosllav, — vazhdon të ruajë një organizim patriarkal, u formua menjëherë një grup prej 400 vetash, të cilët u sulën me të shpejtë të çlirojnë bareshat e reja dhe lopët e tyre»³ Në vrullin e tyre të papërmbajtur, ndjekësit kaluan kufirin dhe arritën deri në fshatrat shqiptare të Vermoshit e Selcës. Edhe në qoftë se u përzien në këtë mes forcat e rregullta jugosllave të ushtrisë dhe të policisë, — ato e bënë këtë jo për të sulmuar shqiptarët, — tha Kumanudi, — por vetëm për ... të qetësuar malazezët e inatosur.

Më tej përfaqësuesi i Jugosllavisë, u hodh në kundërsulm, duke përsëritur akuzat e njohura mbi të ashtuquajturat «banda shqiptare» që vepronin gjoja në pika të ndryshme të kufirit me Jugosllavinë. Kumanudi bëri përgjegjëse drejtpërsëdrejti Qeverinë e Nolit për keqësimin e gjendjes në kufi «këto muajt e fundit». «Gjatë gjithë kufirit tonë, — tha Kumanudi, — por sidomos në sektorin që shtrihet midis Gjakovës e Dibrës, sulmet e këtyre kaçakëve vrasës e grabitës nga Shqipëria, kanë qenë të panumërta. Këta banditë nuk janë kufizuar të marrin gjënë e gjallë, të vjedhin sende që janë pronë e shtetasve tanë, të përdhunojnë gra e vajza të reja, të marrin njerëz peng, por kanë djegur fshatra të tëra

1) Komanda e xhandarmarisë e qarkut të Shkodrës njoftonte më 26 shtator se sulmi kundër Vermoshit ishte prapsuar dhe se forcat shqiptare kishin rimarrë lokalitetet kufitare të Tamarës dhe Selcës. *Dokumente e materiale... në «Studime historike»* Nr. 4/1973, f. 140.

2) *Journal Officiel de la SdN* Octobre 1924, p. 1374.

3) *Po aty*. pp. 1374-1375.

dhe kanë vrarë qindra burra, gra e fëmijë».¹ Të gjitha këto duhej të shërbenin për të larguar vëmendjen e opinionit publik nga përgatitjet që po vlonin në territorin jugosllav për sulmin e ardhshëm kundër Shqipërisë. Qëndrimi thellësisht armiqësor i Beogradit kundrejt qeverisë demokratike dukej sheshit edhe në konkluzionin kryesor që nxirrte Kumanudi se «në Shqipëri nuk ekzistonte asnjë pushtet i organizuar shtetëror»,² gjë që u jepte, sipas tij, bashkatdhetarëve të vet të drejtën «të bënin drejtësi» vetë.

Noli në përgjigjen e tij të shkurtër vuri në lojë argumentet e përfaqësuesit jugosllav: «Po të dëgjojmë përfaqësuesin e Shtetit Serbo-Kroato-Slloven, — tha ai, — atëherë duhet të besojmë se këtu kemi të bëjmë me një idil bukolik të një shijeje të hollë. Ca dhën e ca lopë kullosin nën vështrimin plot dhëmshuri të dy vajzave bukuroshe dhe befaz vijnë këta bandillët shqiptarë që i grabisin me dhën e me lopë. Faresisi i këtyre vajzave të bukura bashkë me pronarët e dhënve e të lopëve vihen në ndjekje të dashnorëve grabitqarë. Mirëpo çudia më e madhe është se prindër e pronarë zgjedhin si pikë për të shkelur territorin shqiptar, tamam malin e Vermoshit, që është edhe pika për të cilën të dyja palët janë në mosmarrëveshje me kohë. Pastaj vjen edhe fundi i trishtueshëm i këtij fillimi qesharak: në Shqipëri jepet alarmi. Dërgohen përforcime. Njerëzit mobilizohen. Derdhet gjak. Sulmuesit shtyhen matanë».

«A nuk është ky, — përfundoi Noli, — një argument më shumë që Këshilli i Lidhjes t'i japë fund një gjendjeje të tillë dhe të zgjidhë menjëherë e përgjithmonë çështjet që kanë të bëjnë me kufirin midis Shqipërisë dhe Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene».³

Në mbarim të ndërhyrjes së përfaqësuesve të të dyja palëve, Këshilli i Lidhjes në një seancë të dytë, po atë ditë, më 3 tetor, miratoi një rezolutë të hartuar me terma të papërcaktuara, që ishte në të vërtetë një lëshim në favor të palës jugosllave. Në vend që të kërkonte nga qeveria e Beogradit zbatimin e menjëhershëm të vendimit të Konferencës së Ambasadorëve, në rezolutën e tij Këshilli i lutej Konferencës, si dhe fuqive që bënë pjesë në të, ta merrnin në shqyrtim edhe një herë çështjen dhe përgjithësisht të shpejtonin cak-

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

timin përfundimtar të kufirit midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë.¹

Megjithatë, problemi pësoi vonesa të tjera edhe pas kësaj. Ai u lidh me konfliktin tjetër kufitar rreth Shën-Naumit dhe gjeti zgjidhje nja një vit më vonë në kuadrin e «kompromisit» që A. Zogu pranoi të përfundonte me qeverinë jugosllave dhe që, siç do të shihet edhe më poshtë, ishte një formë e shpërbllimit të «ndihmës» që iu dha për të marrë përsëri fuqinë.

Shën-Naumi

Ndër të gjitha problemet që lindën pas Luftës I rreth caktimit të kufijve të Shqipërisë, pa dyshim ai i Shën-Naumit ngjalli më tepër diskutime dhe u zvarrit për një kohë të gjatë për të përfunduar përsëri në dëm të Shqipërisë.

Kur, pas vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të nëntorit 1921 në Shqipëri erdhi komisioni, të cilit iu ngarkua të caktonte në vend kufijtë e Veriut, ai hasi shumë shpejt në një problem interpretimi për vijën kufitare në sektorin e liqenit të Ohrit. Që më parë ai kishte udhëzime të «rektifikonte» vijën kufitare në verilindje të Shkodrës, në perëndim dhe në jug të Prizrenit, në perëndim dhe juglindje të Dibrës dhe rreth Linit. Për këtë të fundit thuhej qartë se Lini i lihej Shqipërisë «për të siguruar komunikacionin midis Elbasanit dhe Korçës».²

Për Shën-Naumin nuk bëhej fjalë, sepse mendohej se fati i tij ishte përcaktuar një herë. Në fakt, në protokollin e Konferencës së Londrës të 11 gushtit 1913, që trajtonte kryesisht kufirin e jugut, përfshihej edhe kufiri në sektorin e liqenit të Ohrit. Kjo pjesë e protokollit ishte hartuar me këto fjalë: «Krahina bregdetare deri në Ftelia, duke përfshirë edhe ishullin e Sazanit, krahina në veri të vijës greke (vijës së pretendimeve greke — A.P.) si dhe kazaja e vjetër osmane e Korçës me bregun perëndimor dhe jugor të liqenit të Ohrit, që shtrihet prej fshatit Lin deri në manastirin e Shën-Naumit,

1) *Po aty*,

2) Vendimi i 9 nëntorit 1921 i Konferencës së Ambasadorëve mbi kufijt. A. Simonard, *vep. cit.*, 392-393.

janë pjesë përbërëse të Shqipërisë».¹ Arsyeja e thjeshtë të thotë se kjo nuk mund të kishte tjetër kuptim veç që Shën-Naumi, sikurse Lini, duhej t'i përkiste Shqipërisë. Në korrespondencën diplomatike të kohës së Konferencës së Londrës u gjenden edhe elemente të tjera që e bënin këtë edhe më të qartë; p.sh. në procesverbalin e mbledhjes së 8 gushtit 1913 e njejta çështje referohej në këtë mënyrë: «... kazaja e vjetër e Korçës bashkë me bregun përendimor dhe jugor të liqenit të Ohrit, prej fshatit Lin deri në manastirin e Shën-Naumit janë *integralisht* pjesë të Shqipërisë».²

Kështu e kuptoi këtë edhe komisioni i hetimit të Lidhjes së Kombeve, i cili pas një shikimi në vend, që bëri në sektorin e liqenit të Ohrit, në fillim të janarit 1922 i telegrafoi Organizatës në Gjenevë se Shën-Naumin e kishte gjetur të pushtuar nga trupat serbe, kurse «duhej t'i kthehej përfundimisht Shqipërisë në përputhje me vendimet e protokollit të Londrës të vitit 1913».³ Në lidhje me këtë komisioni i hetimit konstatonte se pjesa e kufirit «midis malit Gramos dhe liqenit të Ohrit» ishte lënë jashtë nga komisioni i caktimit të kufirit jugor më 1913, prandaj sugjeronte që komisioni i rikufitar që do të caktonte kufirin verior të përfshinte në punimet e tij edhe këtë pjesë të kufirit në Jug.⁴ Dhe kështu u bë. Konferenca e Ambasadorëve në fillim të prillit 1922 e udhëzonte komisionin e saj kufitar që të caktonte kufirin edhe «në pjesën e kazasë së Korçës» që nuk ishte përfunduar para lufte.⁵

Kur komisioni në fjalë erdhi në vend për të caktuar vijën e kufirit, gjatë punimeve të tij në verë të vitit 1922, filluan të shprehen mendime të ndryshme për kuptimin e

1) Protokollin e 11 gushtit 1913 i Konferencës së Londrës në A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit (1912-1918)*, vol. II, Tiranë, 1987, d. nr. 42, ff. 286-287. Protokollin është botuar edhe në përmbledhjen e Dhomës së Përhershme të Drejtësisë ndërkombëtare «*Affaire du Monastère de Saint-Naoum (Frontière albanaise)*», Leyden 1924.

2) Sipas telegramit të ministrit të Jashtëm anglez Grej (E. Grey), dërguar ambasadorit sër Kartrajt (Sir. F. Cartwright) në Vjenë datë 8.8.1913, riprodhuar në botimin e lartpërmendur të Dhomës Permanente të Drejtësisë Ndërkombëtare «*Affaire de Saint-Naoum*», pp. 286-288.

3) Sipas raportit të Komisionit të hetimit nga Shqipëria datë 18.1.1922. *Po aty*, p. 260.

4) *Po aty*, pp. 286-288.

5) Letër e kryetarit të Konferencës së Ambasadorëve. Poincaré, kryetarit të delegacionit shqiptar në Paris datë 4.4.1922. *Po aty*, pp. 283-285.

Protokollit të Londrës të 11 gushtit 1913. Këto e kishin burimin te qëndrimi i qeverisë së Beogradit, e cila u vu menjëherë kundër çdo procedure që mund t'ia hiqte nga duart Shën-Naumin. Ajo, së pari, nuk pranoi t'i tërhiqte trupat nga Shën-Naumi derisa komisioni i kufirit të merrte një vendim, së dyti, ia shfaqti zyrtarisht komisionit pretendimin për ta mbajtur Shën-Naumin vetë. Pikërisht atëherë lindi nevoja e interpretimit të asaj pjese të protokollit të 11 gushtit 1913 ku thuhet: «.... prej fshatit Lin deri në manastirin e Shën-Naumit janë integralisht pjesë të Shqipërisë». U tha se shprehja «*deri në manastirin e Shën-Naumit*» nuk ishte krejt e qartë, se mund të kuptohej në dy mënyra: ose duke e përfshirë Shën-Naumin brenda Shqipërisë, ose duke e lënë jashtë.

Çështja qëndroi përpara komisionit të kufirit disa muaj me radhë. Si delegacioni shqiptar, ashtu edhe ai jugosllav pranë komisionit, sollën argumente dhe dokumente të shumta për të mbështetur secili tezën e vet. Nga ana e këtij të fundit nuk munguan orvatjet për ta ngritur «të drejtën mbi Shën-Naumin» si zakonisht edhe mbi themele historike e fetare: pala jugosllave u mundua ta bindte komisionin se Shën-Naumi tradicionalisht kishte qenë i lidhur me Serbinë, se manastiri prej kohësh kishte qenë një «vend i shenjtë» për popullsinë ortodokse serbe në këto anë.¹

Megjithatë, komisioni i kufirit, kur ia përcolli çështjen Konferencës së Ambasadorëve në fillim të nëntorit, anonte qartë nga teza shqiptare: nga të tre pjestarët e komisionit të kufirit,² vetëm ai i Anglisë shfaqti disa dyshime për kuptimin «proshqiptar» të protokollit të 11 gushtit 1913 (ndonëse edhe ai e quajti se nga pikëpamja etnike, gjeografike dhe strategjike Shën-Naumi duhej t'i jepej Shqipërisë), kurse delegatët e Francës dhe Italisë u shprehën qartë në favor të Shqipërisë.³

1) Mendimi i delegacionit jugosllav pranë Komisionit të kufirit datë 28.1.1922, *po aty* pp. 82-83; mendimi i delegatit shqiptar dt. 4.11.1922 dhe memorandumit i delegacionit shqiptar datë 30.11.1922. *Po aty*, pp. 91-100.

2) Komisioni duhej të përbëhej nga 4 përfaqësues të fuqive anëtare të Konferencës së Ambasadorëve (Angli, Francë, Itali, Japoni), por meqenëse Japonia hoqi dorë nga dërgimi i përfaqësuesit të vet, Komisioni i kufirit erdhi në Shqipëri i përbërë prej delegatëve të tri fuqive.

3) Mendimet e komisarëve të Anglisë, Italisë dhe Francës, *po aty* përkatësisht pp. 81-82; 87-89, 89-90.

Mbi këtë bazë, më 6 dhjetor 1922, Konferenca e Ambasadorëve mori vendim që Shën-Naumi t'i mbetej Shqipërisë.¹ Në këtë rast u vu në dukje se një zgjidhje e tillë diktohej sidomos nga konsiderata «me karakter etnik dhe ekonomik», që flisnin të gjitha në favor të tezës shqiptare. Vendimi në fjalë iu njoftua rregullisht dy qeverive të interesuara si dhe komisionit të caktimit të kufirit që duhej ta zbatonte në vend.

Vetëm pasi kaluan pesë muaj, në fillim të prillit të vitit 1923, qeveria e Beogradit i njoftoi Konferencës së Ambasadorëve se nuk ishte dakord me vendimin. Ajo kërkoi njëkohësisht rishqyrtimin e tij dhe për këtë i drejtoi Konferencës prej prillit në qershor të atij viti tri nota të njëpasnjëshme në të cilat shtjelloheshin çdo lloj «argumentesh» me karakter etnik, moral e juridik.² Qeveria shqiptare e kohës nuk mungoi t'u përgjigjej këtyre argumenteve me një notë të sajën, në të cilën vihej në dukje sidomos se në qoftë se rishqyrtimi i vendimeve të mëparshme nuk shtrohej për ndreqjen e padrejtësive të mëdha që i ishin bërë Shqipërisë në caktimin e kufijve, nuk kishte asnjë arsye që Konferenca e Ambasadorëve të rikthehej te një çështje si ajo e Shën-Naumit, vetëm sepse kjo ishte në disfavor të Jugosllavisë.³

Megjithatë, kundërshtimi i Beogradit bëri që Konferenca e Ambasadorëve të hapte procedurën e rishikimit të vendimit të saj të 6 dhjetorit 1922. Kjo procedurë solli si pasojë të parë ndryshimin e qëndrimit të qeverisë franceze, e cila, duke ndjekur tani vijën e përkrahjes me çdo kusht të çdo kërkesë jugosllave në çështjen e kufijve, u shpreh për anulimin e vendimit të 6 dhjetorit 1922. Komiteti i posaçëm juridik që u krijua për këtë çështje u bë selia e diskutimeve të reja që vazhduan për një periudhë gati njëvjeçare, ku u ballafaquan pikëpamja franceze, që ishte për një vendim të ri në favor të kërkesës jugosllave, dhe ajo italiane e angleze që kërkonte të mbetej në fuqi zgjidhja e mëparshme.⁴

Diskutimi u zhvillua edhe në nivelin e qeverive, kur dy fuqitë kryesore të Perëndimit, Franca dhe Anglia, e quajtën të nevojshme të paraqitnin memorandumet të veçanta për Shën-Naumin në pranverë të vitit 1924. Pohimeve franceze se kërkimet e reja në arkivat e Konferencës së vitit 1913 «provinon» gjoja saktësinë e interpretimeve projugosllave, Londra

1) Vendimi i Konferencës së Ambasadorëve, datë 6.12.1922, *po aty*, p. 268.

2) *Po aty*, pp. 102, 104, 110.

3) Notë e qeverisë shqiptare datë 20.6.1923. *Po aty*, p. 112.

4) Shih *po aty*, pp. 115, 118, 120.

u përgjigjej se çështja ishte parë në mënyrë të gjithanshme dhe se Konferenca e Ambasadorëve nuk mund të revokonte një vendim që kishte marrë në bazë të të gjitha rregullave. Qeveria angleze quante veçanërisht të papranueshëm arsyetimin francez se ishte «inoportune» dhe madje «e rrezikshme» të kërkohej zbrazja e Shën-Naumit nga forcat jugosllave që e mbanin atë që prej vitit 1913.¹ Ashtu si përkrahja franceze për tezën jugosllave, nisej nga konsiderata politike, edhe rreshtimi i Londrës në pozita proshqiptare shpjegohej me lidhjet e rëndësishme që politika angleze kishte krijuar me qarqet drejtuese shqiptare në fillim të viteve 20.

Sidoqoftë, nga ky ballafaqim memorandumesh e notash të dy qeverive përëndimore doli ideja e shprehur përsëri nga ana angleze, që çështja e ndryshimit ose jo e vendimit të 6 dhjetorit 1922 të Konferencës së Ambasadorëve t'i kalohej për shqyrtim Këshillit të Lidhjes së Kombeve ose Gjykatës Ndërkombëtare (Dhomës së Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare).²

Këtë ide e bëri të vetën edhe Konferenca e Ambasadorëve, e cila në mbledhjen e saj të 4 qershorit 1924 vendosi t'i drejtohej Këshillit të Lidhjes për t'i kërkuar që të shprehej; së pari, nëse vetë konferenca kishte vepruar brenda kompetencave të saj (*intra vires*) dhe, së dyti, në rast përgjigje negative, çfarë zgjidhje tjetër i duhej dhënë mosmarrëveshjes kufitare shqiptaro-jugosllave rreth Shën-Naumit.³

Këshilli i Lidhjes e mori në shqyrtim këtë çështje në mbledhjen e tij të 17 qershorit 1924. Duke e konsideruar pyetjen kryesore (të parën) thjesht të natyrës juridike, Këshilli me një vendim të po asaj date i kërkoi një «mendim konsultativ» Dhomës së Përhershme në Hagë, ndërsa dy qeveritë e interesuara i ftonte «të viheshin në dispozicion» të Dhomës për t'i dhënë asaj gjithë materialet plotësuese të nevojshme.⁴

Ky vendim i Këshillit të Lidhjes u mor pikërisht ato ditë kur në Shqipëri ndodhën ndryshimet e mëdha politike. Qeveria e re Demokratike, me gjithë problemet e shumta që duhej të përballonte, e ndoqi me tërë kujdesin çështjen e

1) Shih *po aty*, pp. 124, 127, 129, 132.

2) Notë e ambasadës britanike në Paris, datë 19 maj 1924. *Po aty*, p. 132.

3) *Po aty*, p. 70.

4) *Po aty*, pp. 67-68.

Shën-Naumit dhe mori çdo masë për të siguruar suksesin e tezës shqiptare në të gjitha instancat ndërkombëtare. Që në fund të qershorit ajo ngarkoi ministrin shqiptar në Paris e në Londër M. Konicën «për të mbrojtur interesat e Shqipërisë përpara Dhomës së Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare». Në të njëjtën kohë ajo i kërkoi Gjykatës që ta caktonte shqyrtimin e çështjes pas 20 korrikut, në mënyrë që të kishte kohë për të bërë të gjitha përgatitjet që shtronte një rast i tillë.¹ Në kuadrin e këtyre përgatitjeve, ajo caktoi si avokat të saj profesorin e shquar të Universitetit të Parisit, specialist i së drejtës ndërkombëtare, Zhilber Zhidel (Gilbert Gidel)² Njëkohësisht, më 9 korrik, ajo i paraqiti Dhomës një memorandum të gjatë që është, pa dyshim, në çdo aspekt, dokumenti më i plotë dhe më i argumentuar i pikëpamjes shqiptare, lidhur me Shën-Naumin.³

Në memorandumin shqiptar, pasi bëhej një vështrim i shkurtër i çështjes së kufijve prej vitit 1921 e këtej, vëmendja kryesore përqëndrohej në pikën rreth së cilës sillej gjithë argumentimi i palës kundërshtare për të kërkuar ndryshimin e vendimit të dhjetorit 1922: a kishte vepruar apo jo Konferenca e Ambasadorëve brenda kompetencave (*intra vires*) që i ishin dhënë? Lidhur me këtë, vihej në dukje, se më 1921 qenë pikërisht shtetet fqinje, sidomos Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene, ato që ngulën këmbë për Konferencën e Ambasadorëve, si i vetmi organ kompetent për të vendosur çdo çështje të mbetur pezull në caktimin e kufijve të Shqipërisë. Megjithëse që përpjekur që kjo detyrë t'i besohej Lidhjes së Kombeve, Shqipëria iu nënshtrova vendimit të Asamblesë së Lidhjes që e ftoi Konferencën e Ambasadorëve «të rregullonte kufijtë» mbi bazën e ripohimit të vendimeve të vitit 1913. Prandaj vendimi i dhjetorit të vitit 1922 ishte një vendim përfundimtar dhe nuk mund të kthehej prapë, sepse konferenca e kishte marrë «brenda caqeve të mandatit që i dhanë të gjitha palët e interesuara».⁴

1) Letër e delegatit të përhershëm të Shqipërisë pranë Lidhjes së Kombeve drejtuar Sekretariatit të Dhomës, datë 30.6.1924, *po aty*, p. 369.

2) Letër e M. Konicës Sekretariatit të Dhomës, datë 19.7.1924, *po aty*, p. 377. Vetëm shpërblimi i avokatit i kushtoi arkës së shtetit 15 mijë fr. ar ose 3 000 dollarë). *AQSH, fondi, 251, v .1924, d. 133, f. 323.*

3) Memorandum i Qeverisë Demokratike paraqitur Dhomës datë 19.7.1924, në *Affaire du Monastère de Saint-Naoum*, pp. 274-283.

4) *Po aty*.

Mirëpo, në memorandum vihet re edhe një tërheqje thelbësore nga platforma juridike që kishte shërbyer si bazë për mbrojtjen e çështjes shqiptare pas Luftës I dhe që përsëri Fan Noli kishte argumentuar me aq forcë në Lidhjen e Kombeve nja tre vjet më parë.¹ Në fakt, memorandum i tani largohej nga ai që mund të themi se kishte qenë themeli i tezës shqiptare: se vendimet e 1913-ës e ruanin plotësisht fuqinë dhe se çdo aspekt i pjesshëm i çështjes shqiptare pas lufte (si p.sh. përcaktimi përfundimtar i kufijve), nuk mund të trajtohej veçse në kuadrin e ripohimit të këtyre vendimeve. Këtë e kishte njohur shprehimisht edhe Konferenca e Ambasadorëve në vendimin e saj të nëntorit të vitit 1921. Sigurisht nën ndikimin e avokatit të saj, prof. Zhidel, në memorandum gjente vend ideja se Konferenca e Ambasadorëve pas lufte ishte e plotfuqishme të vendoste mbi kufijtë, pa qenë fare e lidhur me vendimet e konferencës pararendëse të vitit 1913.

Është po ashtu e sigurt se logjika e kundërshtimit të tezës jugosllave kishte shtyrë në një konkluzion të tillë. Në të vërtetë argumenti kryesor me të cilin qeveria e Beogradit godiste vendimin e dhjetorit të vitit 1922 ishte se kishin dalë «të dhëna të reja» që tregonin se gjoja gjatë diskutimeve në Konferencën e Londrës në pranverën e 1913-s, Austro-Hungaria dhe Italia kishin propozuar që Shën-Naumi të lihej jashtë Shqipërisë, propozim që ishte pranuar edhe nga fuqitë e tjera.² Mirëpo për të kundërshtuar këtë nuk ishte nevoja të mohohej vlera e vendimeve të vitit 1913, jo sepse këto ishin të drejta, por sepse edhe vënia e tyre në dyshim mund të përdorej, siç u përdor efektivisht, nga pala kundërshtare për të bërë padrejtësi të tjera.

Në fjalimin e tij përpara Gjykatës më 23 korrik, profesori Zhidel u ndal gjatë për të provuar zhvleftësimin (caducité) e vendimeve të 1913-s, por kjo pjesë e arsytimit të tij ka një karakter thjesht teoriko-akademik, sepse ai kishte dhe në fakt shtiu në punë argumenta më të forta.³ Ai drejt vuri në dukje, në përgjigje të tezës jugosllave, se propozimet

1) Shih A. Puto, «Problemi i statusit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe në Konferencën e ambasadorëve në vitet 1920-21», në «Studime historike» nr. 3/1965.

2) Memorandum i qeverisë serbo-kroato-sllavene datë 4.7.1924 në *Affaire du Monastère de Saint-Naoum*, pp. 269-271; shih gjithashtu notën franceze datë 12.3.1924, po aty, u. 124.

3) Fjalimi i prof. G. Gilbert i mbajtur përpara Gjykatës më 23.7.1924, po aty, pp. 16-37.

apo kompromiset në fazën e diskutimeve përbëjnë ato që quhen punime përgatitore të një vendimi dhe, — tha ai, — «në të drejtën ndërkombëtare është e pamundur t'u njihet këtyre punimeve një forcë më superiore sesa vetë vendimeve.»¹ Duke iu referuar me siguri të ashtuquajturit kompromis austro-italian të prillit të vitit 1913, Zhideli theksonte: «...në të drejtën ndërkombëtare traktati (vendimi) nuk buron nga një vullnet i veçantë; ai del nga vullneti të ndryshme, që ballafaqohen, që bashkëpunojnë, që ekuilibrohen dhe merren vesh midis tyre».² E, pra, vendimi i Konferencës së Ambasadorëve nuk është i prillit, por është i gushtit të vitit 1913 që thotë se «... prej Linit deri në Shën-Naum janë pjesë të Shqipërisë». Pas lufte, kur lindi një dyshim mbi domethënien e vërtetë të shprehjes «deri në Shën-Naum», Konferenca e re e Ambasadorëve, si organ që u ngarkua me saktësimin e kufijve të Shqipërisë, e shqyrtoi posaçërisht çështjen dhe mori vendimin e dhjetorit të vitit 1922, me anën e të cilit ai ia atribuonte përsëri Shën-Naumin Shqipërisë. Në këto kushte çështja ishte ezauruar dhe nuk kishte asnjë bazë për «një masë kaq të rëndë» si rishikimi i saj edhe një herë.³

Sa për qeverinë jugosllave, ajo provoi vetëm një gjë: se arsyetimet juridike kanë aq më tepër vlerë kur shërbejnë për t'i veshur petkun e ligjit një «të drejtë» që nuk është e drejtë. Kështu mund të shpjegohet ai kthim prapa që vëmë re më 1923-1924 në qëndrimin e saj në çështjen e kufijve. Në të vërtetë Beogradi bëri një përmbyesje të plotë të atij që kishte qenë qëndrimi i tij «parimor» në çështjen e kufijve të Shqipërisë pas Luftës I. Më 1920-1921, kur shpresonte të shkëpuste copa të tjera të rëndësishme të territorit shqiptar, ai predikoi anulimin e vendimeve të 1913-s dhe shtroi nevojën e shqyrtimit *ex novo* të çështjes shqiptare. Tani ai nuk ngurronte të pohonte të kundërtën, t'u referohej vendimeve të 1913-s vetëm sepse aty gjente një argument për t'ia shkëputur Shën-Naumin Shqipërisë. Por, a kishte arsye që Qeveria Demokratike të ndiqte po atë rrugë, duke këmbyer pozicionet që ishin përcaktuar prej qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës? Ka arsye të mendohet se një gjë e tillë nuk ishte as politikisht oportune, as juridikisht e themeltë.

Për të dhënë «mendimin konsultativ» Dhoma kishte përpara gjithë materialet e nevojshme që u paraqitën nga palët.

1) Fjalimi i prof. G. Gilbert i mbajtur përpara Gjykatës më 23.7.1924, po aty, p. 27.

2) Po aty.

3) Po aty, p. 28.

Ajo dëgjoi në seancën e saj të 23 korrikut edhe përfaqësuesit e të dyja palëve — prof. Zhidel për palën shqiptare¹ dhe ministrin jugosllav në Paris Spalaikoviçin për atë jugosllave.²

Është interesante të vihet në dukje se qeveria greke nuk deshi të rrinte mënjanë në konfliktin që ndante dy fqinjët e veriut, por i kërkoi Dhomës që të dëgjonte edhe një përfaqësues të saj, sepse e quante veten «në gjendje t'i jepte të dhëna të dobishme» që mund t'i vlenin asaj (Dhomës) për të përgatitur mendimin që i kërkohet. Kërkesa u pranua, por përfaqësuesi i Greqisë, Kapsambelis, i cili e mori fjalën pas paraqitjes së pikëpamjes nga ana e të dyja palëve, bëri një deklaratë fare të shkurtër në të cilën, pas lëvdatave në adresë të «kolegut të shquar Spalaikoviçit», theksoi se qeveria greke bashkoej plotësisht me pikëpamjen e qeverisë jugosllave.³ Mund të merren me mend arsyet që e shtynin Athinën të merrte qëndrim kundër Shqipërisë edhe në një çështje ku nuk dukej të kishte ndonjë interes të saj të drejt-përdrejtë. Pa dyshim, ajo shikonte aty një rast për të ripohuar pozitën e saj të përgjithëshme që ndiqte prej kohësh në çështjen e kufijve të Shqipërisë dhe që ishte për cungimin e mëtejshëm të tokave shqiptare. Nuk është aspak e rastit që pas lufte, të dy qeveritë (greke dhe jugosllave), bënë një front të përbashkët në Lidhjen e Kombeve dhe në Konferencën e Ambasadorëve për të «argumentuar» pretendimet e vjetra dhe të reja territoriale në dëm të Shqipërisë, edhe kështu të cinguar që përpara lufte. Me siguri qeveria e Athinës mendonte se një vendim në favor të palës jugosllave mund t'i hapte rrugën edhe realizimit të kërkesës greke për mbajtjen e fshatrave të ish-kazasë së Korçës, çështje kjo që ende mbahej pezull për shkak të ngurrimeve të autoriteve helenike.

Më 4 shtator 1924 Dhoma dha mendimin e saj konsultativ. Çështja shtrohej me terma aq të qarta edhe nga pikëpamja juridike, sa që ajo, me gjithë orvatjet e shumta jugosllave, nuk mund të mos i jepte të drejtë pikëpamjes së qeverisë shqiptare: ajo u përgjigj se Konferenca e Ambasadorëve «e kishte përsosur detyrën» lidhur me Shën-Naumin me vendimin e saj të 6 dhjetorit të vitit 1922 dhe se nuk kishte vend për t'u kthyer prapë te një çështje që ishte vendosur njëherë.

1) *Po aty*, pp. 16-37.

2) *Po aty*, pp. 38-61.

3) *Po aty*, p. 62.

Kuptohet se vendimi «i freskët» i Dhomës së Përherhme të Drejtësisë Ndërkombëtare i dha dorë delegacionit shqiptar në sesionin V të Asamblesë së Gjenevës që ta shtynte përpara çështjen e Shën-Naumit, duke kërkuar zbatimin e vendimit të Konferencës së Ambasadorëve. Në letrën e tij drejtuar Këshillit të Lidhjes më 19 shtator, Noli i referohej pikërisht mendimit konsultativ të 4 shtatorit për të kërkuar «që të merrej sa më parë një vendim përfundimtar për këtë çështje». ¹ Këshilli e shqyrtoi veçanërisht çështjen në mbledhjen e tij të 3 tetorit; aty u paraqit një projektrezolutë me anën e së cilës, pasi merrej shënim për «mendimin» e Dhomës, vendosej që ky t'i përcillej Konferencës së Ambasadorëve. Noli, në atë mbledhje, e mori fjalën vetëm për t'u bashkuar me rezolutën dhe për të shfaqur «shpresën se miratimi i saj do t'i japë fund një çështjeje fatkeqe». ² Kurse përfaqësuesi jugosllav Kumanudi mbajti edhe këtu një fjalim të gjatë për ta kundërshtuar projektin, duke treguar kështu se qeveria e tij nuk kishte ndër mend ta lëshonte Shën-Naumin nga duart. ³ Megjithatë Këshilli e miratoi rezolutën dhe më 6 tetor 1924 ia përcolli Konferencës së Ambasadorëve, duke e bërë të vetin qëndrimin e marrë nga Gjykata Ndërkombëtare. ⁴

Çështja pësoi zvarritje të reja: vetëm 7 muaj më vonë, në fund të prillit 1925, Konferenca e Ambasadorëve mori në shqyrtim «mendimin» e Dhomës dhe iu përmbajt atij, duke lënë në fuqi vendimin e dhjetorit të vitit 1922 që ia jepte Shën-Naumin Shqipërisë. ⁵ Por në atë rast u theksua se vendimi «nuk ishte i detyrueshëm». ⁶ Kjo ishte llogaritur t'i hapte rrugën «kompromisit» midis Zogut dhe qeverisë jugosllave që do të përfundohej nja dy muaj më vonë. Nuk është një gjë e rastit që lajmin e parë për këtë e dha që në fund të marsit të vitit 1925 gazeta e madhe londineze «Tajms» (The Times), e cila shkruante se Zogu do të jepte Shën-Naumin dhe Vermoshin si «shpërblim për ndihmën» që kishte marrë nga autoritetet jugosllave në dhjetor. ⁷

Marrëveshja zyrtare midis Zogut dhe qeverisë jugosllave u lidh në korrik të vitit 1925. Por Zogu u orvat t'ia fshinte

1) *Journal Officiel de la SdN, Octobre 1924, pp., 1335-1336.*

2) *Po aty, pp. 1369-1372.*

3) *Po aty, pp. 1369-1372.*

4) *Po aty, p. 1372.*

5) *Shih A. Simonard vep. cit., p. 403.*

6) *Po aty, p. 404.*

7) Sipas gazetës «Liria Kombëtare» datë 12.7.1925.

opinionit publik përmbajtjen dhe natyrën e vërtetë të kësaj marrëveshjeje; ai e paraqiti atë jo si një marrëveshje cedimi (lëshimi) territorial në favor të Jugosllavisë, por si një marrëveshje *shkëmbimi* midis dy qeverive. Në vend të Shën-Naumit, për të cilin u tha se nuk kishte «veçse katër muret e manastirit», u mor gjoja një kundërparti më e vlefshme: katundi Peshkopi dhe fusha e Çeravës, «një tokë prej 22 km²» e që «siguronte rrugën Progradec-Korçë».¹ Për Vermoshin u bënë të gjitha përpjekjet për të mos e zënë në gojë fare; u tha se qeverisë jugosllave iu la vetëm pylli i Velipojës, kurse shtypi përparimtar i mërgimit i asaj kohe vinte në dukje se ky ishte në thelb Vermoshi, të cilin «Zogu, për të mbuluar turpin, nuk e quante me emrin e vërtetë në deklaratat zyrtare».²

Kaq iu desh edhe Konferencës së Ambasadorëve për të ndryshuar në fillim të gushtit vendimin e mëparshëm «me pëlqimin e të dyja palëve».³ Pas farsës së miratimit të parlamenteve përkatëse në tetor, konferenca «konstatonte» në nëntor se «vija kufitare serbo-shqiptare ishte bërë tanimë definitive».⁴

Duke përfunduar shqyrtimin e çështjes së sgarimit përfundimtar të problemeve të mbetura pezull në caktimin e kufijve të Shqipërisë, nuk mund të mos vihet re se ajo, jo vetëm që përbëri aspektin kryesor të veprimtarisë së delegacionit të Qeverisë Demokratike në sesionin V të Asamblesë së Lidhjes së Kombeve, por ishte edhe e vetmja fushë në të cilën arriti të siguronte disa rezultate pozitive. Për këtë flet edhe jehona që patën ndërhyrjet e Fan Nolit veçanërisht përpara Këshillit të Lidhjes në mjaft organe të shtypit të vendeve perëndimore. Ndonjë prej këtyre, si fjala vjen, gazeta e madhe angleze «Times», nuk mungoi të fuste edhe ndonjë notë tallëse në korrespondencat e saj nga Gjeneva lidhur me «gjatësinë e shturur» (inordinate length) të fjalimeve të kryeministrit shqiptar, por prapë njihte se ai «formuloi një kërkesë të qartë» për zgjidhjen e problemeve kufitare të Shqipërisë deri në mbarim të vitit 1924⁵. Shumë gazeta të tjera, sidomos italiane, botuan intervista me Fan Nolin kur ky kaloi

1) Sipas shkresës së Ministrisë së Jashtme datë 12.10.1925, drejtuar Këshillit të Ministrave botuar në gazetën «Dajti» datë 21.10.1924

2) Shih gazetën «Liria Kombëtare» d. 5.8.1925.

3) Sipas A. Simonard *vep. cit. pp. 404-405.*

4) *Po aty.*

5) AQSH, *fondi 251, v. 1924.* (Kupyra gazetash «The Times» datë 26.9.1924).

përsëri nga Italia për t'u kthyer në atdhe në tetor; aksioni i tij për zgjidhjen e konflikteve kufitare zinte aty gjithnjë vend të parë. Me këtë rast vihej në dukje «suksesi i plotë i delegacionit shqiptar... që mundi të provonte se kërkesat e tij ishin të mbështetura në themelet e një drejtësie të padyshimtë».¹ Por prapë theksohej se «vendi tani priste që vendimet që ishin marrë, të viheshin në zbatim».²

1) «*Corriere del Mattino*» datë 25.10.1924.

2) *Po aty*.

Kapitulli V

NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË POPULLSISË SHQIPTARE JASHTË KUFIJVE

Problemi i minoriteteve pas Luftës I Botërore

Qysh përpara luftës, kur në Konferencën e Londrës Fuqitë e Mëdha u morën vesh për kufijtë e Shqipërisë, duke lënë jashtë saj shumë toka shqiptare, u bënë njëkohësisht disa përpjekje për të «kompensuar» disi efektin e padrejtësive flagrante me anën e një vendimi, që duhej të siguronte disa të drejta elementare për një popullsi, e cila përbënte më shumë se gjysmën e kombësisë shqiptare. Në mbarim të punimeve të saj, në fund të korrikut të vitit 1913, Konferenca e Ambasadorëve u vinte si detyrë në mënyrë të veçantë Serbisë e Malit të Zi, «të siguronin mbrojtjen efektive» të shqiptarëve që banonin në territoret që iu ceduan atyre. Njohja e përdorimit të lirë të gjuhës amtare në shkolla e botimet ishin detyrimet më konkrete që u caktoheshin të dy qeverive lidhur me popullsinë shqiptare të këtyre territoreve.¹ Por edhe këto u kundërshtuan që atëherë, duke e quajtur si një orvatje për të ndërhyrë në punët e tyre të brendshme.

Pas Luftës I, Fuqitë e Mëdha fitimtare e quajtën me vend të futnin në traktatet e paqes të sistemit të Versajës (1919-1920), disa dispozita të veçanta për «garantimin e të drejtave të pakicave kombëtare». Në bazë të këtyre traktateve,

1) *Osterreich-Ungarns Aussen Politik 1908-1914*, tel. i Mensdorffit datë 29.7.1913; *Documents diplomatiques francais (DDE)*, 3ème série, t. VI, d. nr. 54, 66, 148, 193, 497.

një varg vendesh të Evropës Qendrore dhe Juglindore, duke përfshirë Jugosllavinë dhe Greqinë, u angazhuan zyrtarisht t'u njihnin pakicave kombëtare brenda kufijve të tyre « të drejta të barabarta me kombën mbizotërues në shtetin përkatës, duke u dhënë atyre (pakicave) në mënyrë të veçantë lirinë e shtypit dhe të arsimit në gjuhën amtare».¹

Mirëpo kjo nuk e ndryshoi gjendjen e vështirë të pakicave kombëtare në shtetet e vjetra dhe të reja, të cilat mbetën si më parë në pozita pabarazie të rëndë. Edhe e ashtuquajtura «procedurë e posaçme për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare» në Lidhjen e Kombeve (e parashikuar në statutin e kësaj organizate), nuk krijoi veçse iluzione të përkohshme, sepse veç zhurmës mbi «kujdesin për fatin e pakicave kombëtare» nuk dha rezultate praktike.² Dhe as që mund të jepte, e ngarkuar siç ishte me një varg pengesash formale.³

Në vend që në këto akte të reja të pasluftës të gjendeshin lehtësi të reja juridike-ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të popullsisve shqiptare kompakte të shkëputura prej mëmëdheut, Shteti shqiptar i rimëkëmbur u vu në pozitën paradoksale që të jepte llogari për trajtimin e disa grupeve etnike të parëndësishme të përfshira brenda kufijve të tij, sidomos në jug. Kjo ishte pa dyshim një tjetër shprehje e pozitës së inferioritetit që iu imponua Shqipërisë në ma-

1) Nenet 81, 86, 87, 93 të Traktatit të Versajës, që përsëriten në traktatet e Sen-Zhermenit (me Austrinë, shtator 1919), të Nëji-së (me Bullgarinë, nëntor 1919), të Trianonit (me Hungarinë, qershor 1920). Në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare është konsideruar se kjo krijoi për herë të parë bazën juridike për përcaktimin e «të drejtave të minoriteteve», bazë që u zgjerua e u konsolidua më tej me traktatet që u lidhën po në këtë periudhë (1919-1920) midis fuqive aleate dhe Greqisë. Regjimi i minoriteteve mund të thuhet se plotësohet në kuadrin e Lidhjes së Kombeve, kur një numër vendesh, si vendet ballkanike (duke përfshirë këtu edhe Shqipërinë), pranohen në Organizatën e Gjenevës, duke bërë njëkohësisht deklarata të posaçme me anën e të cilave angazhohen të respektojnë «të drejtat e minoriteteve».

2) Shih *Mezhdunarodnoe pravo, Moskva 1947, ss. 187-188, A. Verdross, Mezhdunarodnoe pravo (bot. rus.) Moskva 1959, s. 565.*

3) Kufizimi kryesor ishte se çfarëdo ankese (peticion), që mund t'i drejtohej Lidhjes së Kombeve (nën mbrojtjen e së cilës vendosej regjimi i minoriteteve), mund të pranohet për shqyrtim (në një komision të posaçëm), vetëm në qoftë se për këtë shprehet në favor të paktën njëri prej anëtarëve të Këshillit të Lidhjes.

rrëdhëniet ndërkombëtare në krahasim me shtetet e tjera të kësaj zone. Kështu shpjegohet që Shteti shqiptar, qysh se filloi të marrë pjesë në jetën ndërkombëtare, qëndroi në pozita mbrojtjeje kundrejt shteteve fqinje edhe në çështjet e pakicave kombëtare.

Në dhjetor 1920, kur votoi për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, Asambleja e përgjithshme pati «shprehur dëshirën» që qeveria shqiptare të zotohej për mbrojtjen e pakicave në territorin e saj. Në vitin 1921, kur qeverisë shqiptare iu desh të bënte një luftë të ashpër për të shpëtuar kufijtë e 1913-s, Lidhja e Kombeve, krahas me rekomandimin që i bëri Konferencës së Ambasadorëve për të zgjidhur këtë çështje, kërkoi prej saj (qeverisë shqiptare), gati si një kusht paraprak, që të merrte zotime konkrete «për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Shqipëri». Nën këto presione më 2 tetor 1921 qeveria shqiptare u detyrua të nënshkruante përpara Këshillit të Lidhjes një deklaratë të posaçme, me anën e së cilës pranonte jo vetëm t'i paraqiste Këshillit në formë të detyrueshme brenda 6 muajve «njoftime të hollësishme mbi statusin legal të komuniteteve fetare, kishave, manastireve, shkollave, shoqatave bamirëse të pakicave» të racës, fesë dhe gjuhës së ndryshme, por edhe «të merrte parasysh çdo rekomandim që mund t'i bëhej për këtë nga Lidhja e Kombeve».¹

Me fjalë të tjera Shteti shqiptar u detyrua të vihej nën njëfarë tutele të vazhdueshme të Organizatës së Gjenezës për pakicat kombëtare brenda kufijve të tij. Këshilli i Lidhjes e futi disa herë në rendin e ditës këtë çështje gjatë vitit 1922, duke e ngarkuar madje edhe sekretarin e përgjithshëm të Organizatës të mblidhte të dhënat e nevojshme.² Shpesh qeveria shqiptare detyrohej të justifikohet përpara Këshillit për mosparaqitjen në kohë të të dhënave që i kërkoheshin.³ Ndoshta çështja nuk do të ngjalle diskutime sikur detyrimet në këtë fushë të ishin të dyanshme dhe vëmendje të tregoheshin njëlloj për të gjitha pakicat kombëtare. Mirëpo është fakt se gjendja e popullsisë shqiptare në Jugosllavi e Greqi, që ishin

1) S.d.N. Protection des minorités en Albanie. Résolution du 2 octobre 1921 et Déclaration de la Délégation albanaise (même date). Doc. A. 176. 1921, CC. 361) *Shifra: Biblioteka Kombëtare (BK) 84-B-13.*

2) Rapport à la IV Assemblée sur l'oeuvre du Conseil, sur le travail du Secrétaire et sur les mesures prises pour exécuter les décisions de l'Assemblée. *Société des Nations, Genève, 28 juin 1923 (shifra: BK 87-2.24).*

3) A. Simonard, *vep. cit.*, p. 430.

objekt i persekutimeve më të rënda, ngritur në politikë zyrtare, nuk u bë ndonjëherë problem serioz në organet e Lidhjes së Kombeve. Në mënyrë të veçantë Këshilli i Lidhjes nuk u dha asnjë vijim peticioneve të përfaqësuesve të ndryshëm të shqiptarëve të Kosovës, bllokoj ankesat me anën e të cilave, këta, përmes kaq rreziqeve, arrinin të denonconin keqbjërjet e autoriteteve të Beogradit. Opinioni zyrtar qëndroi i pandjeshëm edhe kundrejt lajmeve që gjenin ndonjëherë vend në shtypin e kohës dhe që bënin fjalë për shtypjen e egër të shqiptarëve në Jugosllavi.¹

Pasojat e shkëmbimit të popullsisë greko-turke

Prej vitit 1923 çështja merr një kthesë me plot pasoja të rënda për popullsinë shqiptare jashtë kufijve. Në radhë të parë rreziqet u kanoseshin shqiptarëve të Çamërisë në Greqi.

Pas disfatës që pësoi në luftën me Turqinë në vitin 1922, qeveria e Athinës u detyrua të largonte jo vetëm trupat e saj nga Anadulli, por edhe të pranonte tërheqjen prej këtej të një popullsie greke të vendosur aty prej kohësh, që arrinte në gati 2 milionë frymë. Operacioni u vendos të kryhej në formën e «shkëmbimit të popullsisë» midis dy shteteve. Për këtë, midis Greqisë dhe Turqisë në janar të vitit 1923, në Lozanë të Zvicrës u përfundua një marrëveshje e posaçme: grekët e Anadollit do të ktheheshin në vendin e origjinës, duke u shkëmbyer me turqit që ndodheshin në territoret greke.² Me atë rast përfaqësuesi grek në Lozanë, Kalkamanos, më 19 janar 1923, kishte deklaruar se qeveria e tij nuk kishte aspak ndër mend të fuste në shkëmbim «myslimanët me origjinë shqiptare», për të cilët ai vetë kishte pohuar se «banojnë në një krahinë të përcaktuar fare qartë — Epirin» dhe se «ndërsa janë bashkëfetarë me turqit, nuk janë aspak bashkatdhetarë të tyre».³ Ky angazhim i qeverisë

1) Shih J. Swire, *vep. cit.*, p. 414.

2) Shih L.S. Stavrianos, *The Balkans since 1453*, New York 1961, p. 590.

3) Sipas Memorandumit të sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve dërguar Këshillit, datë 29.11.1924 në *Journal Officiel de la SdN Octobre 1924. Proces-verbaux du Conseil. Annexe 689 pp. 1600-1603* (Shifra: BK 81.A.5).

greke u përtërit edhe në dy raste të tjera: me anën e një letre që Venizelloja i dërgonte sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve në gusht 1923 dhe me një notë të të ngarkuarit me punë të Greqisë në Tiranë në fillim të tetorit të po atij viti. Edhe në komisionin mikst greko-turk, që u krijua në bazë të Marrëveshjes së Lozanës për të zbatuar shkëmbimin, u vendos që të përjashtohej popullsia e Çamërisë (mars 1924)¹. Kjo në vetvete presupozonte që kundrejt popullsisë shqiptare të Çamërisë, një realitet etnik dhe historik që njihej edhe nga pala greke, të mos zbatoheshin kurrfarë procedurash apo formalitetesh në kuadrin e shkëmbimit të popullsisë greko-turke.

Megjithatë, autoritetet greke, në bashkëpunim edhe me ato turke, së pari, vendosën që komisioni mikst ta hetonte gjendjen në vend, dhe, së dyti, gjetën mënyrën ta «legalizonin» disi përfshirjen e popullsisë çame në shkëmbim, duke përcaktuar si kriter kryesor jo gjuhën amtare, por prejardhjen e lashtë (provenance) të banorëve.² Kjo u jepte dorë autoriteteve greke që ta injoronin këtë tregues themelor të kombësisë dhe të futnin në shkëmbim një numër të madh shqiptarësh myslimanë me pretekstin se kishin «prejardhje të lashtë turke». Kjo ishte natyrisht e pamundur të provohej, por këtu si provë pranohej fjala e vetë banorëve, të cilën autoritetet greke ua nxirrnin me presione dhe kërcënime.

Në shtypin shqiptar të kohës, sidomos pas Kryengritjes së Qershorit, çështja e fatit të popullsisë çame të kërcënuar nga shkëmbimi, ka patur një jehonë mjaft të madhe.

Një korrespondencë nga Çamëria, e botuar në gazetën «Dajti», në një nga numrat e shtatorit 1924 e përshkruan si shumë të rëndë gjendjen e popullsisë shqiptare, që ishte e detyruar të zgjidhte midis braktisjes dhe likuidimit fizik.³

«Grekët, — thuhej midis të tjerash në këtë korrespondencë, — jo vetëm që e realizuan dëshirën e tyre për çrrënjosjen e elementit shqiptar të Çamërisë, por me taktikën dhe metodat e tyre të zakonshme po përpiqen të kandisin botën dhe Lidhjen e Kombeve se çamët i duan vetë shkëmbimin dhe mërgimin në Anadoll. Grekët kanë prurë mijëra emigrantë prej Azisë së Vogël, viktimat të «megaliidhesë» së tyre qesharake dhe i kanë vendosur në shtëpitë e shqiptarëve të Çamërisë, duke grumbulluar 3-4 familje shqiptare në një

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

3) Gazeta «Dajti» datë 17.9.1924.

shtëpi, kurse në shtëpitë e zbrazura kanë vendosur grekët e Anadollit. Ky sistem është aplikuar në tërë Çamërinë dhe sidomos në Pargë, Margëlliç, Arpicë, Volë, Grikohuar, Gremicë, Varfanj, Filat, Vërselë, Lopës dhe Koskë.

Muhaxhirët e Anadollit për të ushqyer fëmijët e tyre u grabisin çamëve tërë produktet e arave e të vreshtave që kanë afër katundeve. Ato (arat e vreshtat) që ndodhen pak larg katundeve, nuk i punojnë fare se i vrasin nëpër ara e nëpër rrugë. Nga ana tjetër katilët gjakpirës si Cil Mastori dhe Niko Qamoja me shokë, shëtisin pa gjë të keqe nëpër katunde, duke torturuar katundarët shqiptarë të cilëve u hanë edhe kafshitën e fundit të fëmijëve të tyre. Gjindarmëria greke për të ndjekur hajdutët e lartpërmendur (që i titullojnë «komita shqiptarë») vete nëpër katunde, pasi largohen hajdutët dhe i shëmb në dru katundarët e mjerë dhe u kërkon me zor lakrora dhe mishëra në hell!...».¹

Më poshtë në këtë korrespondencë përshkruheshin veprimet e autoriteteve greke dhe të komisionit mikst greko-turk: «...Ka afro një muaj që në Çamëri ka vajtur komisioni mikst që do të studiojë origjinën e shqiptarëve të Çamërisë. Komisioni në fjalë do të qëndrojë vetëm në Margëlliç e në Filat, se shtypi grek ka shpifur se do t'i vrasin komitat shqiptarë. Edhe së andejmi do të shqyrtojë origjinën dhe dëshirën e çamërve, duke thirrur 4-5 vetë nga çdo katund (të porositur nga ana e autoriteteve të vendit e të frikësuar me vrasje në qoftë se përgjigjen kundër porosisë së tyre), edhe në bazë të dëshirës së imponuar që do të shfaqnin këta, komisioni do të veprojë për gjithë popullsinë shqiptare të Çamërisë.... Për të mbrojtur jetën e anëtarëve të komisionit (sic), qeveria greke ka dërguar në Çamëri një fuqi të madhe ushtarake nën komandën e andartit gjakpirës Kollovoit, i cili vjete me radhë e ka tmerruar popullin e mjerë të Çamërisë me veprat e tij çnjerëzore — si vrasja barbare e të ndjerit Met Duçes me shokë etj. Kollovoi përdoron çdo masë barbare për t'i shtrënguar shqiptarët e Çamërisë, dhe sidomos ata të paktë që dalin para komisionit, të thonë se janë turq dhe se duan të venë në Turqi».²

Që në dhjetor të vitit 1923, qeveria shqiptare e atëherëshme ia pati shtruar çështjen Këshillit të Lidhjes, kur mori lajmet e para mbi arbitraritetet e autoriteteve greke në dëm

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

të popullsisë shqiptare të Çamërisë. Ajo kërkoi, me atë rast, që të krijohet një komision i posaçëm për shqyrtimin e çështjes, një komision ku të bënte pjesë, veç përfaqësuesit grek dhe turk, edhe një përfaqësues i Shqipërisë. Në të vërtetë, komisioni mikst greko-turk, që ishte krijuar në bazë të Traktatit të Lozanës, nuk jepte asnjë garanci për një zgjidhje të drejtë e të paanshme. Interesat e Greqisë dhe të Turqisë puqeshin në këtë pikë. Qeveria e Athinës shfrytëzonte rastin për të hequr qafe pakicën shqiptare myslimane brenda kufijve të saj (shqiptarët e krishterë shpeshonte t'i asimilonte më lehtë). Në këtë mënyrë ajo mund të dilte me prementimin se jo vetëm nuk kishte marrë toka shqiptare më 1913, por kishte humbur toka të saj («Vorio-Epiri»). Nga ana e saj, edhe Ankaraja kishte arsye ta favorizonte një shkëmbim të tillë: së pari, donte ta rivendoste sadopak numrin e popullsisë që kishte pësuar humbje të mëdha gjatë luftës me Greqinë, dhe, veç asaj, pasuritë që linin pas të mërguarit, futeshin në llogaritë përfundimtare midis dy qeverive. Komisioni kishte vërtet një kryetar «asnjanës», por detyra e tij ishte thjesht të dilte si arbitër midis dy palëve të marrëveshjes dhe jo të mbronte interesat e një pale të tretë.¹

Këto genë arsyet për të cilat qeveria shqiptare pati kërkuar ngritjen e një komisioni të veçantë. Mirëpo Këshilli nuk e pranoi këtë, duke menduar se «procedura më e mirë në këtë rast do të ishte tërheqja e vëmendjes së komisionit mikst greko-turk», të cilit i rekomandohej «të mblidhte edhe dëshmitë që mund t'i paraqiste qeveria shqiptare».²

Kjo nuk e pengoi komisionin greko-turk ta kryente punën ashtu si u përshkrua më lart. Nën mbulesën e tij, mijëra e mijëra shqiptarë po dëboheshin me forcë për në Anadoll.

Në verë të vitit 1924 u duk qartë se për popullsinë shqiptare të Çamërisë po krijohet një gjendje tepër e rëndë. Dëbimi i saj prej vatrave shekullore po merrte përmasa masive. Qeveria shqiptare nuk mund të rrinte indiferente, aq më tepër që tragjedia çame kishte një jehonë gjithnjë më të madhe në gjithë opinionin e vendit: nga prefekturat e nënprefekturat, sidomos të Jugut, vinin vazhdimisht letra e raporte që bënin fjalë për keqtrajtimin që pësonin shqiptarët në Greqi me qëllim që të shtrëngoheshin të shkonin në Turqi.³ Ndër-

1) Sipas J. Swire, *vep. cit.*, p. 416.

2) Sipas memorandumit të sekretarit të përgjithshëm të përmendur më lart.

3) AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 212.*

kaq merreshin iniciativa të ndryshme spontane që konkretizoheshin në mbledhje ku shprehej protesta për veprimet arbitrarë të autoriteteve greke për dëbimin e popullsisë çame.¹ Duke i bërë jehonë një mitingu të studentëve të zhvilluar në Tiranë, më 1 gusht, gazeta «Dajti» botonte një artikull të posaçëm më 4 gusht, në të cilin Qeverisë Demokratike i kërkohej shprehimisht që të tregohej sa më aktive në mbrojtjen e popullsisë çame dhe kjo jo vetëm në emër të solidaritetit me vëllezërit e një gjaku, por edhe në interes të hedhjes së themeleve sa më të shëndosha për zhvillimin e marrëdhënieve midis dy vendeve.²

Përballë kësaj gjendjeje, Qeveria e Nolit ndërmori një varg hapash për të sensibilizuar opinionin ndërkombëtar, sidomos nëpërmjet Lidhjes së Kombeve.

Është për të shënuar në mënyrë të veçantë një telegram i gjatë që qeveria shqiptare i dërgoi sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve me 23 korrik 1924.³ Pasi vihejshin në dukje përpjekjet e vazhdueshme për ta bindur qeverinë e Athinës që t'i përmbahej angazhimit që kishte marrë solemnisht përpara Lidhjes së Kombeve dhe Fuqive të Mëdha për ta përjashtuar popullsinë shqiptare nga shkëmbimi, qeveria shqiptare sillte «informata autentike» mbi presione që ushtroheshin gjithandej në Greqi kundrejt shqiptarëve, por ndalej veçanërisht në «situatën e popullsisë shqiptare të Çamërisë» të cilën e përshkruante si «me të vërtetë tragjike».⁴

Kjo gjendje e zinte fillin që në muajin maj, kur komisioni mikst greko-turk, i krijuar për të zbatuar marrëveshjen e shkëmbimit, u kufizua me një vizitë që bëri në Prevezë. Këtu sigurisht, duke ndjekur sugjerimet e palës greke, «komisioni pyeti vetëm disa krerë fetarë, të cilët të korruptuar e të frikësuar me lloj-lloj mënyrash, u deklaruan në favor të shkëmbimit, duke pretenduar se banorët e krahinës së Çamërisë ishin me origjinë turke».⁵ Në vazhdim ngrihej një ta-

1) AQSH, *fondi i Ministrisë së Brendshme*, v. 1924, d. 480.

2) Gazeta «Dajti», datë 4.8.1924 (artikulli «Populli çam dhe Kabineti Noli»).

3) Tel i qeverisë shqiptare drejtuar E. Drumondit datë 23.7.1924 në AQSH; *fondi 251*, v. 1924, d. 83.

4) *Po aty*.

5) *Po aty*. Në një shkresë që i dërgonte Kryeministrisë më 21 korrik S. Delvina e quante korruptimin e disa krerëve fetarë si një fakt që i kishte dhënë dorë shumë qeverisë greke për të mbrojtur tezën e saj të njohur mbi karakterin turk të popullsisë myslimane. AQSH, *fondi 251*, v. 1924; d. 80, fl. 75-76.

blo e masave shtrënguese dhe persekutimeve të cilave u nënshtroheshin «banorët shqiptarë myslimanë» me qëllim që ta kërkonin shpërnguljen në Turqi si të vetmen rrugë të shpëtimit.

Në thelb, kjo letër është burimi i parë që ka shërbyer për korrespondencën e mësipërme, si dhe për shumë shkrime të tjera që patën dalë në shtyp në atë kohë. Bëhej fjalë për sulme të bandave që kryheshin përpara syve të xhandarmërisë greke, për shpronësimin e shtëpive dhe tokave shqiptare për t'ua dhënë refugjatëve që vinin nga Anadulli. Kjo atmosferë terrori e shtynte një pjesë të popullsisë çame, sidomos atë në afërsi të zonës kufitare, të kërkonte strehim në Shqipëri, më mirë sesa të përballonte të panjohurat e vendosjes në Turqi. Mirëpo, me këtë rast, qeveria shqiptare tërhoqte vëmendjen mbi rreziqet që përmbante një «zgjidhje» e tillë: opinionin e vendit ishte tepër i ndjeshëm kundrejt padrejtësive që u bëheshin vëllezërve të një gjaku në anën tjetër të kufirit. Duke interpretuar indinjatën e përgjithshme, shtypi i vendit kërkonte që refugjatët që do të vinin në Shqipëri të zinin vatrat dhe trojet e popullsisë grekofone të prefekturës së Gjirokastrës. Me gjithë dëshirën e mirë të saj, për të respektuar angazhimin lidhur me trajtimin e pakicës greke, Qeveria Demokratike detyrohej ta paralajmëronte Lidhjen e Kombeve se politika e qeverisë së Athinës e vinte atë në një pozitë tepër të vështirë, kështu që ajo e përjashtonte veten nga çdo pasojë e papëlqyeshme që mund të rridhte nga masat shtrënguese të autoriteteve greke në Çamëri. Qeveria shqiptare përfundonte duke i bërë thirrje Lidhjes së Kombeve që të ndërhynte pranë komisionit mikst me qëllim që ky «të përjashtonte myslimanët shqiptarë nga shkëmbimi greko-turk».¹

Në dy telegrame të tjera të atyre ditëve, nëpërmjet konsullatës në Gjenevë, ministri i Jashtëm S. Delvina tërhoqte përsëri vëmendjen e Lidhjes së Kombeve mbi rrezikun e abuzimeve nga pala greke me rastin e vizitave të ardhshme të komisionit mikst në Çamëri. Si masë që mund t'i frenonte sadopak këto veprime arbitrare, kërkohesh, së paku, që në çdo operacion hetimi që do të ndërmerrej në këto vise, të vihej si kriter gjuha e folur dhe, veç asaj, të ishte i prani-

1) *Po aty.*

shëm edhe një delegat shqiptar.¹ Është e tepërt të theksohet se këto përcapje nuk patën ndonjë efekt konkret, po të mos llogaritet përgjigjja ekuivoke e sekretarit Drumond se çështja i ishte kaluar Këshillit të Lidhjes, i cili kishte udhëzuar komisionin dhe nënkomisionet e shkëmbimit që të merrnin parasysh «kriterin e gjuhës», por edhe atë «të ndërjegjes kombëtare».²

Megjithatë Qeveria Demokratike vazhdoi interesimin e saj të gjallë për fatin e popullsisë shqiptare. Madje, në verë-vjeshtë të atij viti, ajo u bë një ndër problemet kryesore në gjithë veprimtarinë e saj diplomatike qoftë në raport me qeverinë e Athinës, me Fuqtë e Mëdha apo me Lidhjen e Kombeve.³

Një hap i ri për t'u shënuar ishte ai i 11 gushtit, kur Qeveria e Nolit kërkoi që çështja t'i shtrohej edhe një herë për shqyrtim Këshillit të Lidhjes. Në letrën që i dërgohej sekretarit të përgjithshëm⁴ thuhej se «fizionomia etnike shqiptare e krahinës së Çamërisë që ndodhet në Epir është përcaktuar në mënyrë të pakundërshtueshme, për arsye se popullsia është autoktone, ajo flet vetëm shqip, se kultura turke është krejt e panjohur aty dhe se asnjë element tjetër i huaj, nuk ndeshet në këtë krahinë». Në qoftë se pranohej kjo — dhe këtë e kishte njohur zyrtarisht edhe delegati i Greqisë në Konferencën e Lozanës në janar 1923 (shih më lart) — atëherë çdo «hetim për të përcaktuar prejardhjen e kësaj popullsie», siç kishte vendosur të bënte komisioni mikst, ishte krejt i tepërt dhe në kundërshtim me atë që ishte vendosur më parë. Një hetim ndoshta mund të bëhej, por vetëm për të përcaktuar «prejardhjen» e atyre elementëve, midis popullsisë së Çamërisë, që do ta deklaronte veten turq. Mirëpo, edhe në këtë rast, kriteri që duhej marrë për bazë ishte

1) Telegramë të ministrit të Jashtëm S. Delvina konsullatës shqiptare në Gjenevë datë 31.7. dhe 8.8.1924, AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 83.*

2) Përgjigje e sekretarit të Lidhjes së Kombeve, Drumond, dt. 26.VII.1924. AQSH, *fondi 251, v. 1924: d. 83.*

3) Këtu ka një numër dokumentesh që tregojnë se në periudhën shtator-tetor çështja ka qenë vazhdimisht e ngritur me Athinën. Lidhjen e Kombeve dhe Fuqtë e Mëdha.

4) *SdN doc. C. 339, 1924.VII. Genève 18.8.1924 kopje në AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 84.* Në të njëjtën dosje është përfshirë edhe një përkujtesë e gjatë që mban datën 12 gusht 1924 dhe firmën e S. Delvinës; aty bëhet një historik i trajtimit të çështjes në marrëdhëniet midis qeverive të interesuara si dhe në instancat përkatëse të Lidhjes së Kombeve. *Po aty, fl. 51-62).*

ai i gjuhës amtare, që duhej shqyrtuar me kujdesin më të madh për çdo rast të veçantë, për të kuptuar nëse turqishtja ishte me të vërtetë gjuha amtare e atij që e deklaronte si të tillë.

Në këtë pikë letra ndalej në mënyrë të veçantë dhe i bënte një interpretim të saktë Marrëveshjes së Lozanës së vitit 1923: «Qeveria shqiptare, — thuhej aty, — mendon se parimi i prejardhjes që ka adoptuar komisioni mikst mund të zbatohet, edhe kjo deri në njëfarë pike, vetëm për ata shqiptarë që banojnë në Maqedoni në mënyrë sporadike; kurse ai nuk mund të merret fare parasysh për një krahinë si Çamëria ku popullsia është kompakte. Ajo mendon se edhe vetë fakti që kësaj popullsie i kërkohet të shfaqë dëshirën, është në kundërshtim me frymën e Marrëveshjes së Lozanës, e cila thotë qartë se elementi shqiptar do të përjashtohet nga shkëmbimi. Sikur marrëveshja në fjalë të kishte tjetër synim atëherë ajo do të kishte parashikuar natyrisht edhe masat përkatëse të garancisë për të siguruar një shfaqje të lirë individuale. Qeveria shqiptare është e mendimit se është e pamundur të merret seriozisht një dëshirë e shprehur nga një popullsi që është nën tmerrin e masave të dhunës të autoriteteve helenike».¹ Për këtë letra shoqërohej me një varg ankesash që dëshmonin për masat e çdo lloji që i shtrëngonin shqiptarët e Çamërisë të largoheshin për në Turqi.²

Fasi theksonte se propozimi i Qeverisë shqiptare për krijimin e një komisioni të ri me pjesëmarrjen e një përfaqësuesi shqiptar nuk kishte gjetur jehonë as në Lidhjen e Kombeve dhe as pranë qeverisë së Athinës, letra përfundonte duke përsëritur edhe një herë tronditjen që kishin shkaktuar në opinionin publik në Shqipëri persekutimet që u bëheshin «vëllezërve të një race në Greqi». Në këto rrethana, «Qeveria shqiptare duhej të deklaronte se nuk mbante asnjë përgjegjësi për gjendjen që ishte krijuar për shkak të mosrespektimit të një detyrimi ndërkombëtar nga ana e autoriteteve greke».³

Shihet qartë se kjo kishte trajtën e paralajmërimit që ishte formuluar edhe në letrën e 23 korrikut, çka tregon se Qeveria e F. Nolit i bënte jehonë sadopak tendencës së disa qarqeve brenda vendit për t'iu përgjigjur dhunës së autori-

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

teteve greke në kurriz të popullsisë shqiptare të Çamërisë me masa raprezaljesh kundrejt pakicës kombëtare grekofone në jug.¹ Megjithatë, nuk ka asnjë të dhënë që të tregojë se Qeveria e Nolit ka patur sadopak ndër mend të shkonte tej këtij paralajmërimi të thjeshtë dhe të kalonte në marrjen e masave konkrete. Duket qartë se ky ishte një mjet presioni që ajo u mundua të provonte për të frenuar fushatën e qeverisë greke për shpërnguljen e popullsisë shqiptare nga Çamëria. Madje, preokupacionin e vet për fatin e popullsisë që kërcënohej nga shpërngulja, shtypi i kohës dhe qarqet zyrtare nuk e shprehën vetëm me shkresa e protesta në adresë të botës së jashtme, por edhe me një ndjenjë të thellë solidariteti, duke bërë thirrje që të merrej çdo masë për t'i pritur e sistemuar në Shqipëri të gjithë ata që nuk donin të shkonin në Anadoll. «Është mirë që çamët të merren bashkarisht e të vendosen në Shqipërinë e lirë në pasuri (toka) të shtetit, në vend që të venë në Anadoll e të humbasin fare», — shkruante gazeta «Dajti» në fillim të gushtit.² Kurse nga ana e tij, ministri i Jashtëm S. Delvina, në fund të shtatorit, duke parë se përçapjet diplomatike ishin të pafrytshme, i drejtohej Ministrisë së Brendshme me këto fjalë: «Lutemi të keni mirësinë t'u jepni me urgjencë urdhra autoriteteve kufitare të jugut që varen nga ajo Ministri, që të mos pengojnë hyrjen dhe instalimin në Shqipëri të atyre shqiptarëve që ikin prej Greqie për të shpëtuar nga shkëmbimi i popullsisë».³

Ndërkaq, në Lidhjen e Kombeve rituali vazhdonte. Ankesa e Qeverisë Demokratike iu transmetua qeverisë greke si dhe komisionit mikst greko-turk. Si përgjigje Athina e hodhi poshtë si «të pathemeltë» duke iu referuar «hetimeve të komisionit mikst». Vetë ky komision bëri çdo përpjekje për t'i siguruar qeverisë greke një mbulesë të plotë përkundrejt opinionit publik ndërkombëtar. Në ndonjë rast Qeveria e Nolit iu drejtua atij drejtpërdrejt, siç ishte p.sh. rasti i shpërnguljes me forcë të banorëve të disa fshatrave në rrethin e Janinës. Komisioni njoftonte më vonë Këshillin e Lidhjes se «kishte urdhëruar një anketë», se nënkomisioni përkatës kishte shkuar në vend dhe kishte pyetur banorët

1) Shih gazetën «Dajti», datë 17.9.1924.

2) Kupyrë e gazetës «Dajti» datë 7.7.1924, AQSH, f. 252, v. 1924, d. 80, fl. 71.

3) Shkresë e ministrit S. Delvina drejtuar Ministrisë së Brendshme datë. 30.9.1924. Po aty, fl. 38.

e fshatrave të përmendur dhe ata ishin përgjigjur se «marrëdhëniet e tyre me autoritetet ishin të kënaqshme dhe se nuk kishin pësuar asnjë presion».¹

Në pragun e hapjes së Asamblesë së Gjenevës në shtypin shqiptar u botuan fakte të reja që tregonin se dhuna e autoriteteve greke në dëm të popullsisë shqiptare të Çamërisë ishte në zhvillim të plotë. Gazeta «Bashkimi» njoftonte pikërisht se ato ditë, në shtator, ishin «*futur en bloc* në shkëmbim afro 10 mijë shqiptarë pa bërë asnjë hetim mbi origjinën e tyre».² Pasojat e kësaj praktike të paligjshme, — theksonte gazeta, — kishin filluar të ndiheshin tani edhe në Shqipëri sepse një numër gjithnjë më i madh Çamësh, për të mos shkuar në Anadoll, futeshin në territor shqiptar. Madje shumë familje që ishin dërguar me forcë në Stamboll kërkonin ndihmën e qeverisë shqiptare për t'u vendosur në Shqipëri.³

Delegacioni shqiptar që shkoi në Asamblenë V të Lidhjes së Kombeve e bëri çështjen e mbrojtjes së të drejtave të popullsisë shqiptare të Çamërisë një nga objektivat kryesorë të veprimtarisë së tij në Gjenevë. Fan Noli vuri edhe këtu gjithë prestigjin jo vetëm personal, por edhe zyrtar si kryetar i Qeverisë. Ai e mori fjalën në seancën e Këshillit të Lidhjes me 29 shtator 1924 për të denoncuar me forcë veprimet krejt të paligjshme të Greqisë.⁴

Ai e filloi fjalimin, duke lexuar përpara Këshillit një pjesë të raportit të komisionit mikst greko-turk të qershorit 1924 në të cilin thuhej në mënyrë konkluzive se «... pa asnjë dyshim shumica e madhe e myslimanëve nënshtetas grekë që banojnë në Epir e në Maqedoni e deklarojnë veten pa asnjë ngurrim me origjinë turke dhe, pra, dëshirojnë të përfshihen në shkëmbim»; «nuk ka veçse disa pakica shumë të kufizuara, — shtohet në raport, — në një numër lokalitetesh që thonë se janë me origjinë shqiptare dhe duan kështu të përjashtohen nga shkëmbimi i detyrueshëm».

Nga këto dy paragrafe të nxjerra nga raporti i komisionit greko-turk Noli nuk e kishte vështirë të dilte në përfundimin se «shumica e shqiptarëve myslimanë të Greqisë janë përfshirë në shkëmbim», sepse, — theksoi ai, —

1) *Journal Officiel de la SdN Octobre 1924*, pp. 1600-1603.

2) Gazeta «Bashkimi» datë 16.9.1924.

3) *Po aty*.

4) Fjala e Nolit përpara Këshillit të Lidhjes së Kombeve, datë 29.9.1924, *Journal Officiel de la SdN. Octobre 1924*, pp. 1353-1354.

«është një e vërtetë palisiane¹ se myslimanët e Epirit nuk janë veçse shqiptarë». Këtu Noli kritikoi veprën e komisionit, i cili, duke u mbuluar gjoja pas disa «kritereve-bazë», përfundoi në shtrembërimin e vullnetit të popullsisë shqiptare të Çamërisë dhe në dëbimin e saj me forcë.

«Si ndodhi, — tha Noli, — që komisioni mikst, i cili pati marrë si pikënisje parimin e përjashtimit të shqiptarëve myslimanë të Greqisë nga shkëmbimi, futi më në fund në shkëmbim shumicën e madhe të shqiptarëve?» Kjo ndodhi sepse gjithë puna e komisionit ishte mbështetur në themele të padrejta, të cilat Qeveria shqiptare i kishte vënë në dukje me kohë: «Për të shpjeguar këtë paradoks, — tha Noli lidhur me këtë pikë, — mjaft t'i hedhim një sy procedurës që ka ndjekur komisioni për të përcaktuar se kush duhej të përfshihej në shkëmbim. Kjo procedurë mbështetet sidomos në prejardhjen, në ndërgjegjen kombëtare dhe dëshirën e shqiptarëve për t'u futur në shkëmbim. Kjo procedurë e ndërlikuar ishte fatale për shqiptarët e Epirit, sepse ajo e la derën e hapur për lloj-lloj persekutimesh nga ana e autoriteteve greke.»

«Ishte puna më e lehtë në botë, — vazhdoi Noli, — që autoritetet greke të bindnin këta shqiptarë ta shpallnin veten me prejardhje turke, me ndërgjegje kombëtare më turke sesa turqit vetë, dhe të shfaqnin dëshirën e tyre të zjarrtë për të braktisur vatrat e tyre shekullore dhe për të mërguar në tokën e premtuar (promise) të Azisë së Vogël, të cilën të gjithë e dinë se është shkretuar krejt nga luftimet e ashpra e të përgjakshme që çuan në Traktatin e Lozanës».²

Dëbimi i kësaj shumice shqiptarësh prej Çamërie, — theksoi Noli më tutje, — nuk mund të mos krijonte probleme si në shkallë ndërkombëtare, ashtu edhe të brendshme për Qeverinë shqiptare. Paqja dhe marrëdhëniet normale midis dy shteteve fqinje, sigurisht, nuk kishin asnjë të mirë kur tronditja e opinionit publik në Shqipëri u kishte dhënë shkas zërave për raprezalje, gjë që mund të çonte në pasoja të pakëndshme. Veç asaj, qeveria shqiptare ndodhej përpara vërshimit të një mase refugjatësh shqiptarë, të cilët ose vinin nga Greqia për t'i shpëtuar shkëmbimit, ose donin të kthehe-

1) «E vërtetë palisiane» — nga frengjishtja «vérité de la Palisse», që do të thotë: e vërtetë që bie në sy vetë, që duket sheshit.

2) Fjala e mësipërme e Nolit përpara Këshillit të Lidhjes datë 29.9.1924.

shin nga Anadulli kur shikonin në vend se qeveria turke nuk kishte fondet e nevojshme për t'i sistemuar.

«Është e tepërt të thuhet, — tha Noli, — se në qoftë se Turqia nuk i ka fondet e nevojshme për t'u gjetur një vend këtyre të mërguarve, Shqipëria që është shumë herë më e varfër, i ka edhe më pak». Për të gjitha keto arsye, kryetari i delegacionit shqiptar i bëri thirrje Këshillit të Lidhjes që të ndërhynte pranë qeverisë greke «për t'i përjashtuar nga shkëmbimi i detyrueshëm shqiptarët e Epirit, pa i shtrënguar të kalojnë në furkat kaudine¹ të një inkuzicioni (poshtrus) mbi prejardhjen e ndërgjegjen e tyre». Këtë qeveria e Athinës mund ta bënte fare lehtë «duke lënë jashtë shkëmbimit gjithë Epirin... me përjashtim të Janinës dhe Prevezës ku kishte edhe disa myslimanë jo shqipofonë». Në fund të ndërhyrjes së tij, Noli theksoi se Greqisë nuk i kërkohet më shumë se sa të mbante fjalën që vetë delegati i Greqisë Kaklamanos kishte shprehur zyrtarisht një vit e gjysmë më parë në janar 1923 që në çastin e lidhjes së marrëveshjes greko-turke mbi shkëmbimin e popullsisë.²

Në përgjigje të kësaj, përfaqësuesi i Greqisë, Politis, mbajti një fjalim të gjatë. Ai nuk pranoi të diskutonte për thelbin e çështjes, por u kap vetëm pas disa anëve juridike formale për të provuar se ankesa e qeverisë shqiptare ishte një ndërhyrje në punët e brendshme të Greqisë. Lidhur me këtë, ai bëri dhe një vërejtje që tingëlloi si një qortim në adresë të sekretariatit të Lidhjes së Kombeve, i cili kishte përgatitur për mbledhjen e Këshillit një memorandum që, sipas tij, i bënte jehonë ankesës së Qeverisë shqiptare, edhe pse nuk përmbante asgjë më tepër sesa një historik të shkurtër të çështjes në stilin e ftohtë të dokumentave të Organizatës së Gjenevës. Në vazhdim të fjalimit të tij Politis bëri një eksibicion të vërtetë në fushën e doktrinës juridike për të dalë te teza se Qeveria shqiptare nuk kishte asnjë «titull juridik» për të ngritur zërin në mbrojtje të të drejtave të popullsisë shqiptare të Çamërisë. Me një pamje superioriteti të pafshehur, por edhe me mjaft mospërfillje, ai tha se qeveria e tij mund t'i jepte llogari eventalisht qeverisë turke, me të cilën kishte lidhur një marrëveshje, ajo mund t'i përgjigjej Lidhjes së Kombeve, e cila kishte marrë përsipër rolin e mbikqyrjes, ajo mund të pranonte të dëgjonte edhe

1) Furkat kaudine — qafë e ngushtë që romakët e mundur u detyruan të kalonin nën zgjedhë pranë *Kaudium* më 321 para e.r.

2) *Po aty*.

ankesat e shqiptarëve, të cilëve u kishte dhënë fjalën se nuk do të përfshiheshin në shkëmbim (fjalë me gojë, — shtoi Politis, — por jo me shkrim), kurse sipas tij qeveria shqiptare këtu nuk hynte fare, sepse nuk ishte palë.¹

Duke marrë fjalën për së dyti herë, Noli konstatoi se përfaqësuesi i Greqisë jo vetëm që nuk e mohoi, por e justifikoi përfshirjen e shqiptarëve në shkëmbimin e popullsisë. Ai hodhi poshtë gjithashtu akuzën për ndërhyrje në punët e brendshme të Greqisë: qeveria shqiptare nuk bënte gjë tjetër veçse i drejtohej Lidhjes së Kombeve për të ndërmjetësuar për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje që kishte lindur me shkeljen e të drejtave të popullsisë shqiptare të Çamërisë.²

Përfaqësuesi grek përsëriti edhe një herë se qeveria e tij do të pranonte ta trajtonte çështjen vetëm me Këshillin e Lidhjes së Kombeve, kurse çdo përçapje të qeverisë shqiptare ajo e quante ndërhyrje në punët e brendshme të Greqisë.

Në përfundim të këtij debati, Këshilli i Lidhjes nuk u shpreh, por e la shqyrtimin e çështjes për seancën tjetër. Kjo seancë u mbajt të nesërmen, më 30 shtator. Aty, raportuesi i ngakuar nga këshilli, spanjoli De Leon, paraqiti një ekspozé të pikëpamjeve të qeverisë shqiptare dhe asaj greke, si dhe të ecurisë së çështjes që prej përfundimit të Marrëveshjes së Lozanës në janar 1923. Konkluzioni kryesor që dilte nga arsyetimi juridik anonte nga teza e qeverisë së Athinës përderisa ia rezervonte Këshillit të Lidhjes së Kombeve të drejtën e mbikqyrjes mbi zbatimin e Marrëveshjes së Lozanës në përputhje me Traktatin e Minoriteteve.³

Nga kjo dilte se qeveria shqiptare mund të kishte të drejtën të sinjalizonte, por jo të dilte si palë në çfarëdo mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e shkëmbimit të popullsisë greko-turke. Në përfundim të kësaj analize raportuesi propozonte që çështja të mbahej në rendin e ditës të këshillit, por në adresë të qeverisë greke nuk formulohej veçse ndonjë kërkesë tepër e papërcaktuar dhe e përgjithshme si p.sh. «të merrte masa për të evituar çdo fakt të kryer që mund të

1) *Journal Officiel de la SdN, Octobre 1924, p. 1355.*

2) *Po aty.*

3) Traktati i Minoriteteve ishte nënshkruar nga qeveria greke në Sèvres në gusht 1920, në një kohë me Traktatin e Paqes me Turqinë. Por, ndërsa Traktati i Paqes u zhvleftësua për shkak të disfatës greke në luftë me Turqinë dhe u zëvendësua me Traktatin e Lozanës, Traktati i Minoriteteve hyri në fuqi me ratifikimin e tij nga qeveria greke në gusht 1924. Sipas këtij traktati dispozitat e tij viheshin nën garancinë e Këshillit të Lidhjes së Kombeve.

paragjykonte zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje).¹

Është e qartë se një formulim i tillë nuk jepte ndonjë garanci për përmirësimin e gjendjes së popullsisë çame, aq më tepër që nuk bëhej fjalë për asnjë ndryshim në procedurat e ndjekura deri atëhere. E megjithatë, kur mori fjalën për t'u shprehur rreth raportit të paraqitur, Fan Noli e quajti të udhës «të bashkohej me propozimet e ambasadorit De Leon».² «Shpresoj, — tha Noli midis të tjerash — se adoptimi i kësaj rezolute do t'i japë fund gjendjes së vështirë midis dy shteteve fqinje dhe do të ndihmojë për përmirësimin e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Greqisë, për forcimin e lidhjeve të miqësisë që bashkojnë të dy popujt».³

Nga kjo kuptohet se kryeministri shqiptar del nga caqet e problemit të veçantë (të shkëmbimit të popullsisë çame) dhe shtron problemin e përgjithshëm të gjendjes së marrëdhënieve greko-shqiptare. Edhe në këtë rast ai shpreh shqetësimin e vazhdueshëm të Qeverisë shqiptare për të sheshuar çdo mosmarrëveshje me qeverinë e Athinës dhe për të vendosur marrëdhënie sa më të afërta bashkëpunimi e miqësie midis të dy vendeve. Konsiderata të tjera, objektiva më të përgjithshme në fushën e politikës së jashtme, e shtojnë Nolin ta mbyllë fjalën e tij me një digresion në të kaluarën historike, duke ekzaltuar «afinitetin e racës» midis dy popujve, kontributin dhe rolin e «qindra mijëra pasardhësve të të mërguarve shqiptarë të shek. XIX» në historinë moderne greke dhe veçanërisht në lëvizjen e madhe kryengritëse për çlirimin nga zgjedha turke. Në këtë kontekst duken krejt pa vend grindjet midis dy vendeve, prandaj edhe dëshira e popullit shqiptar «për të patur marrëdhënie intime me popullin vëlla helenik» është «krejt e natyrshme»; edhe delegati grek duhet falenderuar për «frymën e pajtimit që tregoi» si dhe për «bashkëpunimin e përzemërt që dha për të arritur në një zgjidhje».⁴

Nga ana e tij edhe përfaqësuesi grek, Politis, ndërroi ton dhe në përgjigjen e tij nuk i kurseu fjalët lavdëruese në adresë të «ndjenjave të imzot Nolit lidhur me marrëdhëniet midis dy vendeve», «vështirësitë e vogla» që mund të dalin

1) Protokoll i seancës së 18 të sesionit XXX të Këshillit të Lidhjes së Kombeve datë 30.9.1924 kopje në frengjishte, AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 86.

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

4) *Po aty.*

herë pas here ai i cilësoi si «grindje në familje», të cilat mund të zgjidheshin lehtë «nën egjidën amtare të Lidhjes së Kombeve».¹

Mirëpo fjalët e këmbÿera përpara Këshillit të Lidhjes nuk shërbyen as për zgjidhjen konkrete të çështjes së popullsisë çame dhe as për ndonjë kthesë pozitive në marrëdhëniet midis dy qeverive. Një sesion i ri i Këshillit të Lidhjes, i mbajtur në Bruksel në fund të tetorit, tregoi qartë jo vetëm se drama çame vazhdonte, por edhe se Organizata e Gjenevës ishte gati t'u jepte dorë autoriteteve greke për të mbuluar masat shtrënguese për dëbimin e popullsisë shqiptare nga trojet e veta shekullore.² Ajo që bie në sy në këtë rast është mungesa e plotë e Qeverisë shqiptare: edhe aq sa trajtohej, çështja mbetej në kuadrin e Lidhjes së Kombeve e cila do të kishte të bënte vetëm me qeverinë greke. Edhe dy takime të njëpasnjëshme që i ngarkuari me punë i Shqipërisë në Athinë pati disa ditë përpara kësaj mbledhjeje me drejtorin e Seksionit të Minoriteteve pranë Lidhjes, Kolben (Colben), i cili ishte ndalur në kryeqytetin grek, duke ardhur nga Beograd, nuk shërbyen për t'i bërë jehonë pikëpamjes shqiptare. «Shënimet» që ai mori mbi shkeljen e rregullave të shkëmbimit në dëm të popullsisë çame, nuk tërhoqën asnjë vëmendje.³ E dyta, qeveria e Athinës i drejtohej Këshillit të Lidhjes jo për t'iu përgjigjur ankesave që ishin bërë për marrjen e masave shtrënguese kundrejt popullsisë shqiptare, por për të veshur me njëfarë petku legal veprimet e saj arbitrare: i kërkohej Këshillit (në mbledhjen e tij të 28 tetorit) që të jepte pëlqimin për shpërnguljen për në Anadoll të një grupi të ri prej 1500 çamësh. Athina e paraqiste çështjen si tepër urgjente, që duhej vendosur pa pritur mbledhjen e Këshillit të Lidhjes, planifikuar për në dhjetor, ku do të merrrej në shqyrtim «çështja e përgjithshme e myslimanëve me origjinë shqiptare në Greqi».⁴ Njëpërmjet raportuesit De Leon, Këshilli, jo vetëm që nuk bëri asnjë vërejtje për shpërnguljen e 1500 shqiptarëve, por edhe lavdëroi «mënyrën skrupuloze

1) *Po aty.*

2) Procesverbal i seancës së 28 tetorit 1924 të Këshillit të Lidhjes. Kopje frëngjisht në AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 85, fl. 170-190.*

3) Raport i të ngarkuarit me punë nga Athina datë 22.10.1924, AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 149, fl. 9-11, raport i të njëjtit dt. 26.12.1924. Po aty, d. 212, fl. 142-144.* Në këtë raport të dytë i ngarkuari me punë vinte në dukje se gjatë bisedës Kolbeni «dukej i ndikuar nga qarqet greke».

4) *Po aty.*

me të cilën qeveria greke po përmbushte angazhimin që kishte marrë kundrejt Këshillit»¹ në mbledhjen e mëparshme.

Kuptohet se qëndrime të tilla nuk mund veçse ta inkurajonin qeverinë e Athinës për vazhdimin e politikës së saj për të përfshirë një numër sa më të madh popullsie shqiptare në shkëmbimin e popullsisë në bazë të marrëveshjes greko-turke. Është po ashtu e natyrshme që kjo çështje të ketë mbetur si një problem i pazgjidhur që ka vazhduar të jetë një shkak acarimi në marrëdhëniet greko-shqiptare. Këtë e dëshmojnë përçapjet e reja të Qeverisë Demokratike, qoftë në adresë të Lidhjes së Kombeve, qoftë në atë të qeverisë së Athinës. Një varg dokumentesh të Ministrisë së Jashtme të kohës tregojnë se çështja është ngritur disa herë gjatë muajve tetor-nëntor², duke patur parasysht pikërisht mbledhjen e afërt të Këshillit të Lidhjes që do të mbahej në Romë në fillim të dhjetorit. Lidhur me këtë, konsulli i përgjithshëm i Shqipërisë në Gjenevë u paraqit në Sekretariatit e Lidhjes aty nga fundi i nëntorit për të shfaqur protestën e qeverisë shqiptare; përçapja e tij u prit me këto fjalë: «Sa gjëra të paligjshme bëhen në botë, nuk mund t'i ndreqë të gjitha Lidhja e Kombeve, në qoftë se nuk do që të thyejë kokën ajo vetë».³ Një formalitet i thjeshtë ishte edhe mbledhja e Këshillit të Lidhjes në dhjetor, As këtu nuk u dëgjua pikëpamja e Qeverisë shqiptare. U mbajt si zakonisht raporti i rastit nga përfaqësuesi spanjoll, i cili propozoi që kontrolli mbi shkëmbimin e shqiptarëve t'i lihej anëtarit asnjës të komisionit mikst turko-grek. Por kjo nuk sillte asgjë të re. Në fakt prania e anëtarit «asnjanës» në komision nuk e kishte penguar as përfaqësuesin grek, as atë turk të merreshin vesh për t'i përfshirë myslimanët e Çamërisë në shkëmbimin e popullsisë.⁴

S'ka dyshim se ngritja e zërit nga ana e Qeverisë Demokratike për të denoncuar botërisht padrejtësitë që bëheshin në kurriz të popullsisë shqiptare të Çamërisë, ishte një pengesë për qeverinë greke. Veçanërisht veprimtaria e delega-

1) *Po aty*.

2) AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 212*. Është për të shënuar në mënyrë të veçantë një përkujdesje «mbi gjendjen e myslimanëve shqiptarë në Greqi» që është përgatitur nga fundi i tetorit për Seksionin e Minoriteteve pranë Lidhjes së Kombeve. *Po aty, d. 83, fl. 166-168*.

3) AQSH, *fondi 251, kutia 4, dosja 48*.

4) Procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Lidhjes, dhjetor 1924 në kopje frengjisht, AQSH, *fondi 251, d. 183, fl. 122-143*.

cionit shqiptar në Gjenevë, duke e shtruar çështjen përpara opinionit publik ndërkombëtar e kufizoi sadopak Athinën në lirinë e veprimit për të realizuar gjithë programin e saj fillestar për të shpërngulur mundësisht gjithë popullsinë shqiptare myslimane që ndodhej brenda kufijve të Greqisë.

Megjithatë, nuk mund të mohohet se qarqet drejtuese greke e shfrytëzuan rastin që iu dha me Traktatin e Lozanës të vitit 1923 për të realizuar një nga objektivat që i kishin vënë vetes me shkëmbimin e popullsisë; të largonin pjesën më të rëndësishme të popullsisë shqiptare kompakte të Çamërisë për të siguruar «homogjenitetin etnik» të popullsisë së kësaj ane. Kur u bënë bilancet përfundimtare, u llogarit se një gjysëm milion vetë qenë ata që hynë në sferën e veprimit të marrëveshjes greko-turke mbi shkëmbimin e detyrueshëm të popullsisë. Nga këta 384 000 qenë «myslimanët e Epirit e të Maqedonisë», që u detyruan të merrnin rrugën e Turqisë, kurse grekët e Anadollit që u kthyen në atdheun e tyre në bazë të kësaj marrëveshjeje, ishin 150 000¹. Nuk është vështirë të kuptohet se midis «myslimanëve të Epirit» ishin me dhjetëra mijëra shqiptarë të Çamërisë. Pikërisht kësaj kohe i përket shpërndarja e pjesës kryesore të pakicës shqiptare që u la brenda kufijve të Greqisë në bazë të vendimeve të vitit 1913. Kjo solli një shtim të ri të radhëve të diasporës shqiptare që kishte ndodhur disa shekuj me radhë, por që nuk pritej të ndodhte në shekullin XX. Autorë grekë të kohës e kanë karakterizuar si të padrejtë e madje «çnjerëzore» marrëveshjen greko-turke mbi shkëmbimin e detyrueshëm të popullsisë që nuk parashikonte «shfaqjen e lirë të vullnetit» të saj. Por ky lloj arsytimi bëhej vetëm në lidhje me grekët e Anadollit, të cilët në fund të fundit ktheheshin në vendin e vet të origjinës, midis njerëzve të një gjuhe e të një kombësie. Për tragjedinë e vërtetë që pësuan shqiptarët e Greqisë, nuk bëhej fjalë.²

1) Më se 1 milion grekë ishin larguar valë-valë që në kohën e luftërave ballkanike, por sidomos pas disfatës së trupave greke në Anadoll ende pa u lidhur Traktati i Lozanës. Sipas S. Seferiades, *L'Echange des populations. Recueil des Cours de la Haye, 1928, t. IV*, p. 386.

2) *Po aty*, pp. 329-331. Një dramë tjetër e rëndë e popullsisë çame u konsumua pas Luftës II, kur mijëra banorë shqiptarë të atyre anëve u detyruan të linin vatrën e tyre të ndjekur nga forcat reaksionare të gjeneralit profashist grek. Zervas. Të shpërngulurit gjetën gjithë kujdesin e pushtetit të ri popullor dhe u vendosën në pjesë të ndryshme të Shqipërisë, sidomos në jug.

Denoncimi i politikës shtypëse në Kosovë

Në anën tjetër të kufirit të veriut gjendja e popullsisë shqiptare të Kosovës nuk ishte më pak e rëndë. Qarqet drejtuese të Beogradit, të udhëhequra nga një frymë shovinizmi të shfrenuar serbomadhe, kanë pasur gjithmonë si një nga objektivat kryesore të politikës së tyre të brendshme «neqjen qafe» të masës së madhe të shqiptarëve (gati një milion trymë) që u lanë brenda kufijve të Serbisë e Malit të Zi në bazë të vendimeve të vitit 1913. Për shumë arsye, ndër të cilat nuk ishte e fundit ajo e numrit të madh të kësaj «pakice», problemi që shumë «më i mprehtë» për qeverinë jugosllave sesa për atë të Greqisë. Në këtë drejtim autoritetet jugosllave vepruan sipas një programi «të studiuar», të ndjekur sistematikisht për një kohë të gjatë, thelbi i të cilit ishte thyerja e homogjenitetit të kësaj popullsie kompakte dhe eliminimi i saj fizik.¹ Është tanimë e pranuar prej të gjithëve, se në qoftë se nuk u arritën të gjitha objektivat e caktuara në fillim, kjo nuk shpjegohet me përpjekjet e pakta të qarqeve drejtuese të Jugosllavisë. 20 vjet me radhë — para dhe pas Luftës I — ato nuk lanë mjete pa përdorur «për ta ndryshuar në themel strukturën kombëtare të popullsisë në Kosovë e në Maqedoninë Perëndimore në dëm të shqiptarëve»: herë më shumë e herë më pak, u zbatua gjenocidi (vrasja me grupe), diskriminimi i hapur politik, presioni ekonomik, kolonizimi, asimilimi dhe shkrirja në masën sllave të popullsisë.²

Një vend të veçantë në të gjitha këto masa zinte që në fillim shpërngulja e popullsisë. Dhe meqenëse zhvendosja në viset e tjera të Jugosllavisë nuk u tregua një masë mjaft e «frytshme», atëherë u vendos të përdroreshin masa radikale si shpërngulja në masë për në Turqi. Shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi pati filluar më parë në Jugosllavi sesa në Greqi. Grupet e para u shpërngulën që në vitin 1913. kurse ritmet e «nxjerrjes jashtë» erdhën duke u shtuar pas Luftës I.

Por e gjithë kjo fushatë e qeverisë së Beogradit, ndonëse e ndjekur me këmbëngulje, bëhej në rrugë të tërthorta,

1) H. Hoxha, «Politika e eliminimit të shqiptarëve nga trualli i Jugosllavisë së vjetër» në revistën «Përparimi» (Prishtinë), nr. 5 — 1970, ff. 430-445.

2) Po aty

jozyrtare, dhe qëllimet e saj fshiheshin me kujdes nga opinionioni publik. Ajo nuk kishte në bazën e vet një marrëveshje qeveritare midis Jugosllavisë dhe Turqisë, sikurse ishte ajo që u lidh më 1923 midis Greqisë dhe Turqisë. Një marrëveshje të kësaj natyre, ndonëse jo krejt të njëjlojtë, qeveria e Beogradit do ta lidhte vetëm më 1938.¹ Por veprimet e saj në këtë drejtim ajo nuk i ndërpreu asnjëherë. Sipas disa të dhënave, deri në vitin 1937 u shpërngulën për në Turqi rreth 100 mijë shqiptarë.²

Në kohën që në Shqipëri erdhi në fuqi Qeveria Demokratike, tabloja e keqbërjeve të autoriteteve jugosllave në dëm të popullsisë shqiptare të Kosovës ishte e plotë dhe njihej përgjithësisht. E megjithatë, qeveria e re, gjatë periudhës që qëndroi në fuqi, nuk e bëri çështjen e të drejtave të popullsisë shqiptare të Kosovës objekt të përçapjeve të saj zyrtare as pranë qeverisë jugosllave e as pranë Lidhjes së Kombeve, kompetencat e së cilës në mbrojtjen e pakicave kombëtare përgjithësisht ishin caktuar në statutin e saj. Mund të duket paradoksale që, ndërsa opozita e pat ngritur fort zërin e vet në Këshillin Kombëtar (Parlament) kundër gjenocidit në Kosovë, Qeveria e dalë prej saj mbante një pozicion të tërhequr në këtë çështje. Kjo nuk shpjegohet me ndonjë shkujdesje të Qeverisë së 1924-s për fatin e shqiptarëve të Jugosllavisë, ndryshe nga ç'bënte në çastin e shqiptarëve të Çamërisë. Bindjet dhe shqetësimet që kishin qenë dje të opozitës, ishin tani pa dyshim edhe të Qeverisë që kishte ardhur në fuqi. Por rrethanat ishin të ndryshme: qëndrimi i Qeverisë së Nolit përcaktohej nga konsiderata koniunkturore. Së pari, këtu mungonte një marrëveshje zyrtare, gjithë operacionet lidhur me shpërnguljen kryheshin në lloj-lloj mënyrash të tërthorta e të nëndheshme dhe kjo ia kufizonte doemos mundësinë e veprimit Qeverisë Demokratike përsa i përket denoncimit të këtyre veprimeve në rrugën zyrtare.

Një arsye tjetër që e ka detyruar Qeverinë Demokratike të ishte e rezervuar, ishte acarimi i dukshëm i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave pas ardhjes së saj në fuqi. Po të kemi parasysh se Beogradi mbante në dorë një mjet

1) Kjo ishte një marrëveshje që parashikonte jo shkëmbimin e popullsisë midis dy palëve, por shpërnguljen e 250-400 mijë shqiptarëve nga Jugosllavia për në Turqi; një nga shkaqet që ajo nuk u realizua dot ishte afrimi i luftës në Evropë (shih *H. Hoxha, po aty*).

2) *H. Kokalari, Kosova — djepi i shqiptarizmit, Tiranë, 1943, f. 53.*

presioni si A. Zogu dhe mercenarët e tij, po t'i shtohet kësaj edhe fushata e egër që zhvillohej qoftë në nivelin zyrtar, qoftë në shtypin jugosllav me akuzat e njohura kundër Shqipërisë, atëherë kuptojmë shqetësimin e Qeverisë së re për të mos i çuar kontradiktat deri në krizë, aq më tepër kur nuk ishte sqaruar edhe pozita ndërkombëtare e saj.

E megjithatë në opinionin publik të Shqipërisë pas fitores së Kryengritjes së Qershorit, vihet re një ringjallje e theksuar e ndjeshmërisë kundrejt fatit të vëllezërve të një gjaku në Jugosllavi. Në fund të fundit kjo ishte e natyrshme në kushtet e një lëvizjeje që kishte një karakter të gjerë popullor dhe që gjente frymëzim në idealet përparimtare demokratike. Nuk është një gjë e rastit që në situatën e re shqiptare pas qershorit, disa nga udhëheqësit kryesorë veteranë të lëvizjes kombëtare në Kosovë, si: Bajram Curri, Hasan Prishtina etj., gjetën fushë më të lirë për veprimtarinë e tyre. Gjatë gjithë periudhës së qëndrimit në fuqi të Qeverisë Demokratike, ata e thanë lirisht fjalën e tyre në mbrojtje të të drejtave të popullsisë së Kosovës në sytë e një opinionit që i ndante këto shqetësime nga formulimi i kërkesave territoriale.

Atë që Qeveria Demokratike nuk e bënte dot zyrtarisht, e zëvendësonte deri diku aksioni i opinionit publik, i cili gjente jehonë në të gjithë vendin. Në dokumentet e kohës, veçanërisht në fondet e Ministrisë së Brendshme, ka të dhëna për një numër mitingjesh që janë zhvilluar në shumë qendra, si në veri ashtu edhe në jug, për të protestuar «kundër mizorive serbe në Kosovë».¹ Një përshtypje veçanërisht tronditëse pati bërë lajmi mbi vrasjen, në mes të korrikut, të Azem Galicës, heroit popullor të qëndresës kosovare kundër shtypjes serbe. Në raportin që i dërgonte qendrës ministri A. R. Kolonja informonte se në fshatrat afër Shkupit më 15 korrik ishte bërë një luftë e vërtetë midis Azemit me nja 100 shokë dhe forcave të mëdha të përbëra prej qindra xhandarësh dhe ushtarësh serbë, që hynë në veprim edhe me artileri. Nga të dyja anët kishte patur shumë të vrarë e të plagosur. Azemi vetë kishte carë rrethimin, por për shkak të plagëve të rënda kishte vdekur disa ditë më vonë. Ky operacion i autoriteteve serbe inter-

1) Tel. nga mitingu i protestës në Fier datë 17.8.1924 A.Q.S.H. fondi 251. v. 1924, d. 280. telegrame proteste nga disa qarqe në *Fondi i Min. Brend. d. 193. 916.*

pretohej si një shenjë se politika represive në Kosovë do të zbatohej në një shkallë më të gjerë për të thyer çdo shfaqje të qëndresës.¹ Nga kjo ngjarje, të cilën e trumbetoi me bujë të madhe, Beogradi mori përsëri shkas për të lëshuar akuza kundër Qeverisë së Nolit për gjoja «organizimin e kaçakëve në territorin shqiptar». Në vazhden e orvatjeve të tyre për të spekuluar me «rrezikun bolshevik», autoritetet jugosllave, në deklarata zyrtare bënë fjalë për ndihmën që gjoja Qeveria Demokratike merrte «nga qeveria bolshevike, e cila kishte filluar të përhapte lidhjet e saj në tokë shqiptare», duke bërë për vete «me të paguara, krerë shqiptarë si Bajram Currin dhe Hasan Prishtinën».² Kështu nga njëra anë kërkohesh të diskreditohej Qeveria e Nolit, duke e paraqitur si një agjenturë të Internacionales Komuniste, nga ana tjetër kërkohesh t'i dilej përpara çdo përpjekjeje që mund të bëhej për të denoncuar shtypjen e egër që po zbatohej kundër popullsisë shqiptare në Kosovë.

Që ngjarjet tragjike të Galicës shkaktuan emocion të thellë në të gjithë vendin, këtë e tregon fakti se edhe Qeveria e Nolit e pa veten të shtrënguar të dilte deri diku nga pozita e saj e rezervuar. Në një telegram që ministri i Jashtëm i dërgonte përfaqësuesit shqiptar në Gjenevë, pasi vihej në dukje se «mizoritë jugosllave kundër shqiptarëve kishin ngjallur një indinjatë të njëjlojtë në të gjithë vendin», kërkohesh që çështja t'i bëhej e njohur Sekretariatit të Lidhjes, ndonëse «në formë jozyrtare».³ Nuk ka dyshim se Qeveria e Nolit e ndiente veten të ngushtuar brenda disa caqeve kur ishte fjala për gjendjen e popullsisë shqiptare në Jugosllavi. Por është po aq e qartë se ajo nuk ishte aspak indiferente. Ajo përpiqej t'i përmbahej aspektit juridik specifik të rastit konkret, duke kërkuar edhe mënyrat më të përshtatshme për të sensibilizuar opinionin ndërkombëtar dhe për të ushtruar presion kundrejt qeverisë serbe për një trajtim më human të popullsisë shqiptare.

Në këtë kuptim nuk është aspak e rastit që në mbledhjen e Asamblesë së V të Lidhjes në shtator, krahas Nolit e Gurakuqit, që shkuan atje si delegacion i qeverisë shqiptare,

1) Raport i legatës nga Beogradi datë 17.7.1924 AQSH, *fondi* 251, v. 1924, d. 288, fl. 10-11.

2) *Po aty*.

3) Tel. i ministrit të jashtëm drejtuar përfaqësuesit shqiptar në Gjenevë datë 22.8.1924. AQSH, *fondi* 251, v. 1924, d. 280, fl. 5

në Gjenevë mbërritën edhe Bajram Curri e Hasan Prishtina. Dhe në të njëjtën kohë që delegacioni zyrtar i Qeverisë shqiptare shtronte në instancat e ndryshme të Organizatës së Gjenevës problemet e njohura lidhur me kufijtë apo me shpërnguljen e shqiptarëve nga Çamëria, Bajram Curri, Hasan Prishtina etj. i drejtoheshin Lidhjes për t'i tërhequr vëmendjen rreth tragjedisë kosovare. Kështu më 26 shtator 1924 ata i dërguan kryetarit të Këshillit të Lidhjes një përkujtesë (peticion) të gjatë dhe të dokumentuar hollësisht mbi gjendjen e rëndë të shqiptarëve të Jugosllavisë.¹

Në përkujtesë theksohej që në fillim se «që në ditët e para të rikthimit të regjimit serb në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi (15-30 tetor 1919) u qenë drejtuar disa instancave ndërkombëtare të kohës Konferencës së Paqes në Paris, Konferencës së Ambasadorëve, vetë Lidhjes së Kombeve — si dhe opinionit publik botëror një varg i tërë protestash kundër regjimit të terrorit që rëndonte mbi popullsinë shqiptare të këtyre krahinave. Mirëpo kjo nuk e kishte penguar Shtetin Serbo-Kroato-Slloven të vazhdonte të merrte nëpër këmbë të drejtat më elementare deri edhe të drejtën e jetës së popullsisë shqiptare, në kundërshtim të hapur me detyrimet që kishte marrë ai vetë për respektimin e regjimit të pakicave kombëtare si në bazë të Traktatit të Sen-Zhermenit (Saint-Germain), ashtu edhe në bazë të statutit të Lidhjes së Kombeve.

Më tej, në përkujtesë, bëhej një pasqyrë rrëqethëse e metodave të përdorura nga autoritetet jugosllave për t'ia arritur qëllimit të tyre kundrejt popullsisë shqiptare. Një praktikë e zakonshme ishte bërë organizimi i bandave të armatosura nën emrin «organizata kombëtare», që masakronin fshatarët shqiptarë dhe digjinin e plaçkitnin trojet e tyre. Nën maskën e luftës kundër «kaçakëve» njësi të ushtrisë së rregullt kishin shkatërruar shumë fshatra të rretheve të Prishtinës, Vuçiternit, Mitrovicës dhe Pejës, duke vrarë me mijëra vetë pa kursyer as gratë, fëmijët e pleqtë. Kolonizimi ishte një hallkë tjetër e sistemit të persekutimeve. «Çdo aksion shkatërrimi në dëm të shqiptarëve, — thuhej në përkujtesën e mësipërme, — pasohet nga një

1) Përkujtesa është botuar në përkthimin shqip në gazetën e Vlorës «Politika» të dt. 23.10.1924. Një kopje e versionit origjinal në frengjisht bashkë me anekset ndodhet në AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 289, fl. 1-14.

operacion instalimi të kolonëve rusë (të bardhë), malazezë e serbë» në fshatrat e shkretuara dhe në vatrat e braktisura. Vrasjet vazhdonin zinxhir sepse këta kolonë, pasi vendoseshin «terrorizonin fshatrat përreth duke i shtrënguar banorët t'i linin vatrat e trojet, të cilat konfiskoheshin he kolonizoheshin menjëherë». Ishin pikërisht viktimat e kësaj «manevre tragjike», që endeshin rreth e rrotull vatrave të rrënuara, të cilët pastaj quheshin «kaçakë» dhe ndiqeshin nga forcat e ushtrisë. Deri edhe «reforma agrare», për të cilën flitej shumë në atë kohë, përdorej për të shpronësuar bujqit shqiptarë. Kjo gjendje edhe këtu u tregonte shqiptarëve si të vetmen rrugëdalje mërgimin për në Turqi. Ata detyroheshin ta bënin këtë «në kushte të tmerrshme», që u kushtonin jetën qindra familjeve, kurse të tjerët i zhytnin në një mjerim të pashpresë.¹

Sa për garancitë kushtetore, në përkujtesë thuhej se «për shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, kushtetuta serbe ka vetëm vlerën e shkronjave të arta që kanë për qëllim të mashtrojnë opinionin publik të botës së qytetëruar». Edhe drejtësia serbe (gjyqet) luante rolin e spektatorit përballë këtyre shkeljeve: «Është i vetmi vend në botë, — theksonte përkujtesa, — ku vrasin përpara syve të gjyqtarëve, të cilët mbajnë heshtje».²

Përkujtesa përfundonte duke i kërkuar Lidhjes së Kombeve që të ndërmeretonte pranë qeverisë së Beogradit «për të siguruar një zbatim efektiv të dispozitave lidhur me pakicat kombëtare» që përmbaheshin veçanërisht në traktatin e Sen-Zhermenit (Saint-Germain) të vitit 1912.³ Përkujtesa kishte të bashkangjitura një varg dokumentesh, të nxjerra nga vetë burimet jugosllave, dokumente që përmbanin të dhëna konkrete mbi vrasje të shqiptarëve (lista me emrat e viktimave), mbi shpërnguljen me dhunë dhe mbi lloj-lloj arbitraritetesh të autoriteteve serbe.⁴

Përkujtesa kosovare ndoqi procedurën e vendosur nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve mbi shqyrtimin e peticioneve të minoriteteve. Fillimisht ajo iu dërgua qeverisë së Beogradit. Pastaj kjo e fundit iu drejtua sekretarit të për-

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

4) Anekset 1, 2, 3, 4, 5 të përkujtesës së mësipërme. *Po aty*, fl. 5-13.

gjithshëm me një letër të datës 29 nëntor 1924.¹ Letra ishte një përgjigje e gjatë kundrejt ankesave të parashtruara në përkujtesën e tre personaliteteve kosovare. Në këtë letër, pavarësisht nga përgënjeshtimet formale, gjejmë një shprehje të qartë të politikës shtypëse të autoriteteve serbe, një vërtetim të paragjykimeve raciste që e udhëhiqnin Beogradin në trajtimin që i bëhej popullsisë shqiptare brenda kufijve të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene.

Një pasazh i nxjerrë prej letrës së qeverisë jugosllave vlen në këtë drejtim më tepër se sa çdo provë materiale. Ja se ç'shkruante ajo duke iu përgjigjur ankesës kosovare: «Sipas ankesës, del sikur ekzistenca, siguria materiale dhe veprimtaria kulturore e popullsisë shqiptare, paqësore dhe e qytetëruar, qenkan cenuar nga mënyra e veprimit të autoriteteve mbretërore (jugosllave). Mirëpo, kjo popullsi nuk është as paqësore, as e qytetëruar. Ajo ndodhej në kohën e çlirimit (sic) në një shkallë tepër të ulët qytetërimi; ajo jetonte e shpërndarë në fise, pa ligje, pa njohur asnjë pushtet të përgjithshëm (qëndror), pa asnjë ide të rendit dhe të legalitetit. I vetmi ligj dhe i vetmi sanksion, ka qenë zakoni i egër i hakmarrjes, që vetëm sa e komplikonte dhe e thellonte gjendjen e anarkisë kriminale që mbretëron në këtë mjedis primitiv. Mënyra normale e përvetësimit është vjedhja dhe grabitja. Është një popullsi pa asnjë traditë kombëtare; ajo u thur lavde vetëm heronjve të ditës, kujtimi i të cilëve nuk do të jetojë në brezat që do të vijnë. Ajo nuk ka ndërgjegje kombëtare, dhe pra, nuk është e aftë dhe e gatshme veçse për një punë mercenarësh».²

Një logjikë e tillë sugjeronte se çdo ankesë ishte e tepërt, se përkundrazi kjo popullsi duhej të quhej fatlume që i nënshtrohej tani «veprës qytetëruese» të autoriteteve serbe. Dy pengesa dilnin në këtë rrugë: lëvizja e kaçakëve, që përshkruhej si lëvizje banditësh, kriminelësh ordinerë, dhe qeveria shqiptare që u jepte strehë e përkrahje kaçakëve. Kështu Beogradi gjente rastin të përsëriste akuzat në adresë të Qeverisë së Nolit për gjoja organizim bandash në territorin shqiptar që hidheshin pastaj përtej kufirit në territor

1) Dokument i Lidhjes së Kombeve për anëtarët e Këshillit datë 11.12.1924, që përmban edhe përkujtesën kosovare edhe përgjigjen e qeverisë së Beogradit AQSH, f. 251, v. 1924, d 289, fl. 1-27.

2) *Po aty*.

jugosllav për të kryer vrasje, vjedhje dhe grabitje.¹ Edhe nga sa më lart, kuptohet se letra e qeverisë së Beogradit ishte hartuar në po atë frymë të zakonshme cinike e denigruese që ka karakterizuar çdo dokument që ka dalë nga arsenali i propagandës shoviniste serbomadhe lidhur me shqiptarët dhe të drejtat e tyre kombëtare.

Për sa i përket Lidhjes së Kombeve, edhe në këtë rast nuk rezultoi që ajo të ketë kryer ndonjë veprim konkret. Veç shpërndarjes së dokumenteve të mësipërme anëtarëve të Këshillit të Lidhjes, në dhjetor, asnjë gjurmë tjetër nuk është pasqyruar në analet e Lidhjes së Kombeve. Fundi që pati ankesa kosovare është domethënëse jo vetëm në vetvete, por edhe për gjithë fatin që gjente procedura e peticioneve të pakicave kombëtare. e përpunuar nga Organizata e Gjenevës, një procedurë e cila, duke u njohur formalisht pakicave kombëtare të drejtën e «ngritjes së zërit», kamufllonte arbitraritetin e Fuqive përderisa në Këshillin e Lidhjes që përbëhej prej tyre, u ngriheshin prita e u mbyllej rruga peticioneve.

Megjithatë publiciteti që karakterizonte veprimtarinë e Lidhjes kishte një efekt në opinionin e gjerë dhe kjo shpjegon përse qeveritë që paditeshin për shkelje detyroheshin qoftë edhe formalisht të jepnin shpjegime. Në përgjigjen e saj të fundit të nëntorit, qeveria e Beogradit i bënte vërejtje sekretariatit të Lidhjes që e kishte pranuar ankesën kosovare, një ankesë që sipas saj nuk meritonte asnjë vëmendje, qoftë edhe për faktin se autorët e saj cilësoheshin jo si politikanë, por si «organizatorë bandash e veprimtarish kriminale».²

Mirëpo jo vetëm qeveria e Beogradit u vu në lëvizje, por edhe shtypi jugosllav kundërveproi me po atë egërsi për të neutralizuar jehonën negative që shkaktonin në opinionin e jashtëm njoftimet e herëpashershme mbi keqbesimet e autoriteteve serbe në Kosovë. Edhe pse Qeveria e Nolit, siç u pa, nuk u angazhua vetë drejtpërdrejt në përçapjet që u bënë pranë Lidhjes së Kombeve. prapë shtypi i Beogradit e ngriti tonin në fushatën e përhershme kundër saj, duke e akuzuar se lejonte veprimtarinë e organizatave të tilla si «Komiteti kosovar i Bajram Currit», i cili pretendonte

1) *Po aty.*

2) Përgjigjja e lartpërmendur e qeverisë së Beogradit datë 29.11.1924.

se «merrej me organizimin e bandave kriminale në Kosovë, duke pasur edhe ndihmën e xhandarmërisë shqiptare».¹

Shtypi shqiptar reagoi duke marrë në mbrojtje Komitetin dhe kryetarin e tij. Vihej në dukje karakteri paqësor i veprimtarisë së këtij Komiteti, ndërsa për Bajram Currin thuhej se «ai nuk ka bërë gjë tjetër veçse i është lutur Lidhjes së Kombeve që marrëveshja mbi minoritetet të zbatohet edhe në krahinën e Kosovës».² Në të njëjtën kohë bëhej fjalë për karakterin spekulativ të akuzave që bëheshin qoftë në adresë të Komitetit të Kosovës, qoftë të Qeverisë Demokratike. Kështu, gazeta «Bashkimi», duke iu referuar luftës politike që zhvillohej në këtë kohë midis partive politike në Jugosllavi, përmendte faktin se ato (partitë) akuzonin njëra-tjetrën për organizimin e bandave në Kosovë me qëllim që të destabilizonin situatën dhe të diskreditonin forcat kundërshtarë.³

Në fillim të dhjetorit, në pragun e fillimit të sulmit nga veriu, gazeta «Bashkimi», në një koment mbi politikën «e imperializmës serbe» kundrejt Shqipërisë, e interpretonte në këtë mënyrë atë që duket se ishte opinioni mbizotërues në qarqet politike shqiptare të asaj kohe si mbi fatin e shqiptarëve të Kosovës, ashtu dhe në lidhje të ngushtë me gjendjen e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. «Një milion shqiptarë po shtypen e po vriten dita-ditës në Kosovë dhe, për çudi, në vend që të qahemi ne, në vend që ne të bëjmë një politikë irredentiste, e cila mund t'ia sillte mendjen vërdallë klikës ushtëriake të Belgradit, po shohim se Serbia kërkon të na copëtojë».⁴ Me këtë rast denoncohej edhe politika në dukje asnjëse në fakt proserbe e fuqive evropiane: «Fuqitë e mëdha, të cilat mburren se shtypën militarizmën dhe imperializmën gjermane, mbyllin sytë përpara tragjedisë ballkanike, pse Serbia është një myshteri i mirë për të shitur topat dhe

1) Sipas gazetës «Bashkimi» datë 18.12.1924.

2) Gazeta «Dajti» datë 27.11.1924.

3) Në një intervistë dhënë shtypit jugosllav nënministri i punëve të brendshme të Beogradit pati deklaruar se «partizanët demokratë (që ishin në qeveri) janë të bindur se këtë lëvizje kaçakësh e bënë radikalët (partia në opozitë) të cilët armatosin shqiptarët e krijojnë çeta». Sipas gazetës «Bashkimi» datë 24.10.1924.

4) Gazeta «Bashkimi», datë 9.12.1924.

xhepanetë edhe nuk i bën konkurrencë industrialëve të Francës dhe të Anglisë». «Politika e botës është në duar të financierëve, — përfundonte komenti, — dhe të gjitha çështjet e botës rregullohen në bazë të interesave të tyre e jo me principet e bukura që shpallin vetëm për t'u hedhur hi syve popujve të vegjël».¹

1) Gazeta «*Bashkimi*» datë 9.12.1924.

Kapitulli VI

QEVERIA E 1924-s DHE LIDHJA E KOMBEVE

Përvoja e viteve 1920-1921 dhe ndikimi i Nolit

Më lart u fol gjerësisht për përpjekjet e Qeverisë së Nolit për të sqaruar pozitën e saj ndërkombëtare dhe për të arritur normalizimin e marrëdhënieve qoftë me Fuqitë e Mëdha, qoftë me shtetet fqinje. Duke qenë se këto përpjekje qenë të pafrytshme, aksioni kryesor i Qeverisë Demokratike në fushën e politikës së jashtme u përqendrua në Lidhjen e Kombeve. U mendua veçanërisht që sesioni i zakonshëm i Asamblesë së Lidhjes, që do të hapej në shtator, mund të ishte një rast i mirë për të shtruar problemet kryesore që kishin ndeshur në pengesa të ndryshme e që prisnin ende një zgjidhje. Kështu, atë që nuk po e arrinte dot në planin e marrëdhënieve të drejtpërdrejta dypalëshe, Qeveria e Nolit shpresonte ta realizonte nëpërmjet Organizatës së Gjenevës.

Kjo është pa dyshim e lidhur me përvojën e parë që pati Qeveria shqiptare e dalë nga Kongresi i Lushnjës në vitet 1920-1921, atëherë kur në Organizatën e Gjenevës u shtruan për shqyrtim çështja e pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe ajo e ripohimit të pavarësisë, lidhur kjo ngushtë me çështjen e kufijve.

Në atë moment të caktuar, diskutimi i këtyre çështjeve kishte rëndësi vendimtare për vetë vazhdimin e genies së shtetit shqiptar si shtet i pavarur. Këtu duhet patur parasysh ajo që u theksua që në Hyrje se Fuqitë e Mëdha që dolën fitimtare nga lufta si dhe shtetet fqinje shfaqën prirjen për t'iu rikthyer vendimeve të 1913-s për t'i rishikuar ato qoftë në drejtim të vendosjes së Shqipërisë

në ndonjë formë të vartësisë juridike-ndërkombëtare (mandat, protektorat), qoftë në drejtim të cungimit të mëtejshëm të kufijve të saj. Nuk përjashtohet që kjo të çonte deri në zhdukjen e plotë të Shqipërisë nga harta politike e Ballkanit.

Në këto kushte dy ngjarjet e mëdha të 1920-s, Kongresi i Lushnjës, me shprehjen e qartë të vullnetit politik të popullit shqiptar, dhe Lufta e Vlorës, me fitoren ushtarake mbi trupat pushtuese italiane, nuk do të mjaftonin po të mos zhvillohej njëkohësisht një aksion i zgjuar e këmbëngulës edhe në planin ndërkombëtar. Ishte kjo arsyeja që Qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës zgjodhi Lidhjen e Kombeve si qendër kryesore të veprimtarisë së saj diplomatike.

Në të vërtetë, Organizata e Gjenevës, e krijuar rishtazi si një organizatë universale, me gjithë të metat e saj, prapë-prapë paraqiste disa avantazhe në krahasim me forumet e tjera ndërkombëtare të ashtuquajtura «klasike», si p.sh. Konferenca e Paqes e Versajës ose një konferencë e re e ambasadorëve që u mor me diskutimin e çështjes shqiptare pas Luftës I¹. Kështu, ndërsa konferencat e mësipërme ishin drejtpërsëdrejti organe të Fuqive që punonin me metodat e mbyllura tradicionale të diplomacisë borgjeze, Lidhja e Kombeve paraqitej si diçka e re, si një organizëm ndërkombëtar i krijuar mbi një bazë të gjerë, punimet e të cilit do të zhvilloheshin duke iu përmbajtur parimit të publicitetit, pra në sytë e opinionit publik.

Qeveria shqiptare e atëhershme caktoi pikërisht Fan Nolin si kryetar të delegacionit të saj, që mori pjesë në punimet e Lidhjes së Kombeve, si në fund të vitit 1920, kur u shqyrtua kërkesa e Shqipërisë për t'u pranuar si anëtare e barabartë në këtë organizatë, ashtu edhe në vitin 1921, kur u diskutua çështja e kufijve. Për Nolin këto ishin debutimet e tij të para si diplomat në ballafaqim të drejtpërdrejtë me ata që donin të merrnin nëpër këmbë të drejtat e Shqipërisë, ndonëse dihet se ai nuk e fillonte tani veprimtarinë në të mirë të çështjes kombëtare. Ai i bëri një mbrojtje të shkëlqyer, të argumentuar e plot pasion të drejtave të popullit shqiptar, gjë që pa dyshim pati peshën e vet në

1) Shih A. Puto, *Problemi i statusit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe në Konferencën e Ambasadorëve në vitet 1920-1921*, «Studime Historike», nr. 3/1965.

gastin e marrjes së vendimeve. Noli nxori në shesh gjithë pathemelësinë e padrejtësinë e tezave të atyre që synonin ta rishtronin nga e para çështjen shqiptare. Në përgjithësi ishte një sukses diplomatik i një rëndësie të madhe që, si rezultat i këtyre debateve, Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve (dhjetor 1920) dhe u ripohua vlefshmëria e vendimeve të 1913-s mbi pavarësinë shqiptare. Në opinionin e vendit ky sukses ka qenë lidhur në një shkallë të konsiderueshme me emrin e Nolit dhe është quajtur si një nga shërbimet kryesore të tij në dobi të kombit. Vetë Noli e ka quajtur atë «një sukses të shkëlqyer», «suksesin më të madh që ka patur në karrierën e tij diplomatike».¹ Fjalimet që ai mbajti me atë rast patën jehonë edhe në qarqet e jashtme. Që atëherë ai pati bërë emër sidomos në Lidhjen e Kombeve. Fjala e tij bëri përshtypje (dhe jo vetëm ndër dashamirët e Shqipërisë) si shprehje e një erudicioni dhe oratorie të jashtëzakonshme, që shkrihej me guximin politik dhe pavarësinë e mendimit, me origjinalitetin e trajtimit, me ndjenjën e spikatur të dinjitetit që frymëzon një kauzë e drejtë. Nuk ishin të paktë ata që njohën epërsinë e madhe të Nolit në krahasim me përfaqësuesit e shteteve fqinje gjatë debatit në Lidhjen e Kombeve. Kështu, delegati britanik, lordi Sesil (Cecil), deklaronte në mbledhjen e Asamblesë së përgjithshme të Lidhjes së Kombeve në fillim të tetorit 1921 se «delegacioni shqiptar kishte fituar simpatinë e të gjithëve» dhe se kjo i kushtojë sidomos shefit të delegacionit (Nolit), «i cili në të gjithë platformën dhe në çdo rast ka treguar vazhdimisht moderacion dhe çiltërsi (fairness) përkundrejt kundërshtarëve të tij. Kjo është pikërisht cilësia që është çmuar më tepër nga Asambleja». Duke iu drejtuar delegatit grek, i cili nuk i kishte kursyer shprehjet fyese në adresë të Shqipërisë, delegati britanik e ftonte të ndiqte shembullin e fqinjit të vet.²

Përvoja e atyre dy vjetëve (1920-1921) la mbresa të

1) *50th Anniversary Book of Albanian Orthodox Church in America, Boston Mass 1960.*

2) Cituar sipas J. Swire, «*Albania. The rise of a Kingdom*», p. 360. Me interes në lidhje me këtë është edhe një shkrim i botuar në gazetën e njohur angleze «*Manchester Guardian*» («*Manchester Guardian*») të datës 27 qershor 1924, pra vetëm disa ditë pas ardhjes në fuqi të Qeverisë Demokratike dhe caktimit të Nolit si kryetar të saj. Artikullshkruesi, korrespondent i gazetës në Gjenevë, jep aty

forta te vetë Noli dhe ai do të merrte me vete jo vetëm kënaqësinë e natyrshme për suksesin e arritur, por edhe ndonjë iluzion mbi natyrën e vërtetë të Organizatës së Gjenevës. Ai formoi bindjen se Lidhja mund të ishte një dukuri e re, element novator i jetës ndërkombëtare, se ajo mund të mishëronte aspiratat më të mira të popujve për paqe e bashkëpunim dhe si e tillë mund t'u kundërvihej interesave të ngushta e egoiste të Fuqive të mëdha.

Kjo do të shfaqej sidomos atëherë kur Noli erdhi në krye të Qeverisë Demokratike. Në njëfarë kuptimi ai donte të përsëriste atë që bëri 3-4 vjet më parë, ndonëse ato 3-4 vjet që kishin kaluar kishin ngjallur edhe mjaft dyshime.

Në fund të fundit, këtu nuk mund të mos merret parasysh vetë personaliteti i Nolit, botëkuptimi i tij, evolucioni i tij dora-dorës që vihej si përballë problemeve konkrete të vendit të tij, ashtu edhe përballë realitetit ndërkombëtar të kohës në përgjithësi. Dhe ai tregoi se dinte të shprehej

përshtypjet e tij nga përvoja personale në Lidhjen e Kombeve, nga kontaktet e drejtpërdrejta që ka patur me Nolin në këtë Organizatë, që në fillimet e veprimtarisë së saj. Artikulli ka si veçori, që bën një karakteristikë të Nolit si personalitet të staturës ndërkombëtare, pa lënë mënjanë doemos rolin që ka luajtur ai në mbrojtjen e interesave të Shqipërisë. Vështirë të gjendet në shtypin politik të kohës një rast tjetër ku Noli të jetë vlerësuar aq lart, ndaj edhe ia vlen të jepën disa pjesë nga shkrimi në fjalë.

Autori e fillon pikërisht me mbledhjet e para të Lidhjes së Kombeve (sigurisht të viteve 1920-1921) dhe thotë: «Fan Noli ishte një nga delegatët më popullorë dhe të respektuar përgjithësisht. «Kam patur rastin. — thekson ai, — të takohem me të dhe formova opinionin më të lartë për karakterin dhe cilësitë e tij.» Nga krahasimi që i bëhet me përfaqësuesit e shteteve të Ballkanit. Noli del përsëri në vendin e parë: «Noli është një njeri, që do të ishte i shënuar në çdo vend: ndër delegatët e ardhur në Lidhjen e Kombeve nga shtetet e Ballkanit, ai ishte fare lehtë i pari. Një diplomat i mbaruar, plot takt, me dijeni të gjëra mbi botën dhe politikën ndërkombëtare, një bisedues i gatshëm dhe i shquar, ai bëri që në fillim një përshtypje të madhe në Gjenevë.» Në artikull përmendet vecanërisht rasti «kur një komision i Asamblesë së Lidhjes së Kombeve bisedonte mosmarrëveshjet midis Shqipërisë dhe shteteve fqinje». Atëherë Fan Noli «i mundi delegatët kundërshtarë të Ballkanit në një mënyrë mjeshtërore dhe kurdoherë me buzëqeshje të mbaruar. Çështja që bisedohej i jepte hak me të vërtetë, por mënyra se si e shtroi bëri, pa fjalë, që komisioni të merrte një vendim të favorshëm për Shqipërinë...». Nuk mund të mos bjerë në sy të çdo bashkëbiseduesi të Nolit bagazhi i tij kulturor, «kultura e gjerë», ndaj edhe gazetari anglez shton «M'u

me të njëjtën qartësi dhe me të njëjtin përkushtim qoftë për politikën e brendshme, qoftë për atë të jashtme. Idetë e tij mbi marrëdhëniet ndërkombëtare janë një pasqyrim i padyshimtë i idealit të tij social: një shoqërie me të drejtë brendapërbrenda shteteve duhej t'i përgjigjej një rend i ri edhe në shkallë ndërkombëtare. Por nga ana tjetër nuk duhet harruar se Noli ishte një figurë komplekse, një natyrë jo gjithmonë koherente, shpesh kontradiktore. Vizioni politik e social i Nolit pati ndikimin e vet jo vetëm në programin e Qeverisë së 1924-s, por edhe më tej gjatë veprimtarisë së saj konkrete. Në jetën politike shqiptare ai nuk hynte për herë të parë, vetëm pasi u bë kryetar i qeverisë pas fitores së lëvizjes kryengritëse. Mund të thuhet se ai konsiderohej që në fillim të viteve 20 si udhëheqës shpirtëror tanimë i afirmuar, i njo-

duk se ka lexuar çdo gjë që vlen të lexohet në anglisht e frengjisht». Aq më tepër vlerë merr në këtë shkrim konfrontimi që bëhet midis Nolit si fetar dhe Nolit si personalitet publik, burrë shteti, midis predikuesit kristian dhe atdhetarit që i përkushtohet me mish e me shpirt bashkimit të kombit, duke kapërcyer çdo dasi të çfarëdo natyre qoftë. Njëfarë habie që shpreh autori shoqëruar me një ndjenjë admirimi të padyshimtë është patjetër e kuptueshme po të kihet parasysh roli që kanë pasur luftërat fetare në historinë e gjithë Evropës, e veçanërisht të Anglisë. «S'kam parë kurrë në jetën time një prelat fetar, i cili të shëmbëllejë aq pak me dhespotlerët e tjerë ortodoksë, si Fan Noli» dhe shton: «As kam parë kurrë në jetën time një njeri tjetër, laik ose klerik, i cili të jetë aq pak klerikalist. F. Noli është liberal që në krye e gjer në fund — aq liberal në teologji sa edhe në politikë dhe si liberal i vërtetë është krejt tolerant dhe asfaren fanatik. Ka një dashuri të madhe për njëkombasit e tij myslimanë, të cilët e duan gjithashtu dhe madje më tepër se njëkombasit e tij të krishterë». Sigurisht në këtë shkrim, ndonëse portreti ka dalë në tërësi i goditur dhe me vërtetësi, ka dhe nota që stonojnë, si p.sh. kur thotë për Nolin se «Anglia është vendi i Evropës që simpatizon personalisht më tepër». Kjo mund të jetë e vërtetë për letërsinë e Anglisë (disa kryevepra të së cilës ai do t'i shqipëronte me aq mjeshtëri), por lufta politike që ka bërë kur ka qenë në opozitë dhe qëndrimi i qeverisë angleze para dhe pas fitores së Revolucionit të Qershorit nuk i japin arsye të ushqejë një simpati të tillë. (Pjesët e artikullit janë marrë nga gazeta «Politika» datë 3.7.1924).

Të dy rastet e lartpërmendura, si fjalët e lordit Sesil (Cecil) në Asamblenë e përgjithshme të Lidhjes, ashtu edhe shkrimi i botuar në gazetën angleze «Manchester Guardian», i gjejmë të cituara edhe në «Autobiografinë e Nolit», por aty Noli sjell vetëm disa radhë (50th Anniversary Book..., pp. 118-119).

hur botërisht në lëvizjen përparimtare demokratike në Shqipëri. Noli kishte shkëndija kryengritëse me një shkëlqim të veçantë, shkëndija që i ndeshim njësoj edhe në krijimtarinë e tij letrare artistike, edhe në veprën e tij politike. Me idetë apo me veprimet e tij ai dha një kontribut të shquar në jetën politike shqiptare të periudhës pararendëse dhe kjo në dy fronte: kundër reaksionit feudal brenda vendit dhe kundër imperializmit ndërkombëtar, kundër shovinizmit të fqinjëve në politikën e jashtme. Nuk është e tepruar të thuhet se Noli ka qenë frymëzuesi kryesor i ndërtimit të një shteti shqiptar modern pas Luftës I Botërore, të ngritur mbi baza më të drejta sociale dhe të emancipuar nga intrigat e ndikimet mbytëse të jashtme.

Mirëpo elementi ëndërrimtar dhe iluminist ishte tepër i dukshëm në botëkuptimin e tij. Drita e arsimit dhe e kulturës, përhapja e dijeve mbivlerësoheshin jashtë mase. Aty ai shikonte çelsin e zgjidhjes për problemet aq të ndërlikuara që qëndronin përballë shoqërisë shqiptare. Rexhep Qosja mendojmë se e karakterizon drejt Nolin si veprimtar politik. «Në bindjet politike dhe në humanizmin e Nolit ka diçka nga filozofia e iluministëve të shekullit të tetëmbëdhjetë».¹

Është domethënëse që edhe atëherë kur erdhi në krye të Qeverisë si rezultat i fitores demokratike, pra në rrugën revolucionare. Noli nuk u çlirua krejt nga iluzionet reformiste, madje pacifiste. Në vizionin e tij politik mjetet paqësore zinin vendin e parë, para dhunës, para metodave violente, ndonëse në veprën e tij letrare të hershme e të mëvonshme kushtrimi i luftës për liri dhe drejtësi sociale merr herë-herë disa trajta veçanërisht kumbuese. Sidomos kur u ndodh në vendin e kryetarit të Qeverisë Demokratike, u pa më qartë se çdo herë tjetër që nevoja imperative e një aksioni energjik, e përdorimit të dhunës (të dhunës revolucionare kundër dhunës së shtypësve e shfrytëzuesve), nuk u kthye te Noli në një bindje të thellë të brendshme. Vargu nolian, gjithë vepra e tij letrare, dallohet pa dyshim nga një forcë shprehëse mobilizuese jo e zakonshme. Ajo ruan dhe do të ruajë

1) R. Qosja, «Shkrimtarë dhe periudha», Prishtinë 1975, f. 139, 141.

vlerën e saj. Por nga një pikëpamje dhe deri në njëfarë mase fitorja e Revolucionit të 1924-s dhe qenia e tij në krye të Qeverisë Demokratike, ishin një gur prove për Nolin si njeri i aksionit. Është fakt se ai nuk u tregua gjithmonë edhe me aksion revolucionar në lartësinë e frymëzimeve të tij demokratike. Kështu p.sh. «skrupujt» legalistë konstitucionalë pas qershorit (lidhur me plotësimin e përbërjes së Këshillit të Regjencës apo me zgjedhjet e reja që duheshin t'i jepnin «bazën ligjore» regjimit të ri), ishin në radhë të parë të Nolit. Ata nuk shpjegohen vetëm me presionet nga jashtë (u pa se qeveria e Londrës nguli këmbë dhe gjeti aty një pretekst «të mirë»), por edhe me kufizimet e botëkuptimit nolian. Sepse, ndonëse kërkesa për «bazën ligjore» të Qeverisë ishte krejt e arsyeshme (çdo shndërrim revolucionar duhet të vendoset tek e fundit në themele kushtetuese të qëndrueshme), rruga e zgjedhjeve të nxituara çonte në vetëlikuidimin në kushtet e rrethimit të dyfish-të të forcave reaksionare të brendshme e të jashtme, Është e vërtetë se ideja e një «qeverie paternaliste» (pa parlament, jo konstitucionale) është po ashtu e Nolit; me të ai kuptonte një periudhë tranzicioni të nevojshëm për ta pastruar «me metoda autoritare» shoqërinë shqiptare nga mbeturinat feudale. Por ai nuk i qëndroi konsekuent as kësaj ideje. Qeveria e tij tregoi se nuk ishte e aftë të përdorte «dorën e fortë» as kundërsht armiqve të brendshëm, të cilët fajëve të së kaluarës u shtonin tani edhe veprimtarinë e hapur minuese për përgatitjen e kthesës kundërrevolucionare.

Praktikisht Qeveria u paralizua në veprimin e saj shndërrues, përtëritës dhe kjo nuk mund të mos krijonte hapësira për forcat kundërrevolucionare që nxiteshin nga jashtë.

Noli do ta pranonte vetë gjendjen e vështirë që u krijua në gjirin e Qeverisë së tij. Në një letër që do t'i drejtonte disa vjet më vonë historianit anglez Xh. Suajer (J. Swire), ai do të shprehej me këto fjalë: «Duke ngulur këmbë për reformën agrare, unë ngjalla zemërimin e aristokracisë së tokës, kurse duke mos e zbatuar atë, unë humba përkrahjen e masës së fshatarësisë. Kolegët e mi të Qeverisë si dhe shumica e oficerëve të ushtrisë ishin ose kundër ose në rastin më të mirë, indiferentë ndaj këtyre reformave, ndonëse ishin shprehur në favor të tyre në fillim. Z. Sotir Peci, si regjent, i kundërshtoi ato haptazi dhe rreptësisht. Z. Aires arriti të

bindë të gjithë ç'ishin rreth meje se reformat agrare ishin një inovacion i rrezikshëm bolshevik». ¹

Në «Autobiografinë» Noli ka thënë edhe kështu: «Fan Noli ishte një nxënës i zellshëm i cili mësoi mësimet gjatë gjithë jetës së tij». Në të vërtetë ai nxori mësimet edhe nga përvoja e hidhur e Revolucionit të Qershorit pas dështimit të tij. Publicistika dhe krijimtaria artistike e mëtejshme e Nolit, sidomos ajo e fundit të viteve 20 dhe fillimit të viteve 30, janë një dëshmi e qartë. Radikalizmi në mendime dhe qëndrime është më i theksuar se kurdoherë. Por në natyrën e karakterin e Nolit, vazhdimësia dhe këmbëngulja revolucionare nuk ishin pika më e fortë. Nuk është e rastit që mërgimi i tij i dytë në SHBA, pas shtegtimeve si emigrant kryengritës nëpër Evropë në fillim të viteve 30, shënon në fakt largimin e tij përfundimtar nga jeta politike aktive. Krijohet përshtypja, pikërisht duke lexuar «Autobiografinë», se vetë Noli pranon në formë autokritike se nuk ishte njeri i aksionit aq sa ishte mjeshtër i fjalës.

Po këto luhatje, inkonsekuenca, i vëmë re doemos edhe në fushën e politikës së jashtme të Qeverisë Demokratike. S'ka asnjë dyshim se karakteri demokratik përparimtar i Revolucionit të 1924-s dhe i Qeverisë së dalë prej tij gjeti aty, në politikën e jashtme, një manifestim të veçantë. Edhe këtu, sidomos këtu, Noli me idetë e tij vuri një vulë të fortë. Në të vërtetë Noli u kushtoi mjaft kohë e vëmendje problemeve të politikës së jashtme që dilnin vazhdimisht në atë situatë delikate. Edhe pse në krye të dikasterit të tij të jashtëm ishte një figurë e respektueshme si Sulejman Delvina, (kryeministri i Qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës), Noli mori pjesë drejtpërsëdrejti qoftë në formulimin e vijave kryesore që do të ndiqte zhvillimi i marrëdhënieve të jashtme, qoftë edhe në përcaktimin e masave konkrete diplomatike që duhej të merreshin në zbatim të kësaj politike. Qëndrimet për çështjet më të rëndësishme sikurse edhe iniciativat më të bujshme, qenë të frymëzuara prej atij vetë. Edhe aty bie në sy njëfarë stili i veçantë, stil i mirënjohur nolian që njeh kulme të paarritshme, që rrëmben, entuziazmon me forcën krijuese dhe ngarkesën emocionale, por që jo gjithmonë ka sensin e realitetit në situatën konkrete.

1) J. Swire, vep. cit., p. 444

Në Asamblenë e Lidhjes

Të gjitha këto u shfaqën me qartësinë më të madhe gjatë veprimtarisë së delegacionit shqiptar në sesionin e rregullt të Asamblesë së përgjithshme të Lidhjes, që i fillonte punimet në shtator të atij viti. Në krye të delegacionit u vu vetë Noli dhe kjo është një shenjë se Qeveria Demokratike e ndiente pozitën e saj të jashtme të vështirë dhe shpresonte të gjente një rrugëdalje nga bllokada diplomatike pikërisht nëpërmjet Lidhjes së Kombeve. Mendohej se rasti ishte aq më i volitshëm sepse në Asamblenë e Gjenevës do të merrnin pjesë disa nga figurat kryesore të politikës ndërkombëtare, si kryeministri i Francës Herrio (Herriot) dhe ai i Britanisë së Madhe Makdonald (Macdonald).. Noli duket se varte mjaft shpresa te takimet që mund të kishte me këto personalitete.

Për rëndësinë që i jepej misionit të delegacionit flet edhe vendimi i posaçëm i Këshillit të Ministrave me 20 gusht, edhe përbërja e tij. Noli mori me vete Luigj Gurakuqin, me të cilin e lidhte tanimë një miqësi e fortë personale që do të shprehej me aq ndjenjë e dhimbje në elegjinë e njohur pak më vonë, kur «vigani liberator» do të binte nën plumbat e klikës zogiste. Në vendimin e lartpërmendur, sikurse në aktet zyrtare të Lidhjes, në përbërje të delegacionit shqiptar figuron edhe Mehmet Konica, ministër fuqiplotë në Londër, që ishte akredituar njëkohësisht edhe në Paris¹, dhe kjo tregonte se në ç'drejtim mendohej të zhvillohej veprimtaria e delegacionit për të çarë izolimin në të cilin po binte Qeveria Demokratike.

Fan Noli bashkë me Luigj Gurakuqin qëndruan në Gjenevë për më se 1 muaj e gjysmë. Ata u nisën nga fundi i gushtit² dhe u kthyen nga mesi i tetorit.³ Për kontaktet që kanë patur gjatë qëndrimit të tyre në selinë e Lidhjes, nuk kemi shumë të dhëna. Dihet me siguri se Noli pati takim edhe me Makdonaldin, edhe me Herrionë, por nuk dimë shumë gjëra për përmbajtjen e bisedimeve. Vetëm burime të tërthorta

1) Vendim i Këshillit të Ministrave datë 20.9.1924 në AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 146, fl. 3; Société des Nations. Actes de la V Assemblée 1.9.1924, p. 11. në Bibliotekën Kombëtare me shifrën 81.A.8.*

2) *Shqipëria më 1927, f. 138.*

3) *Gazeta «Bashkimi» datë 14.10.1924.*

na japin mundësi të bëjmë një ide të përgjithshme dhe, sipas këtyre burimeve, del se veç çështjes së njohjes është shtruar edhe kërkesa për akordimin e një huaje qeverisë shqiptare.

Në lidhje me këtë shërben disi një informacion që ambasadori britanik në Romë, Graham, i dërgonte Foreign Ofisit mbi qëndrimin e Nolit e të Gurakuqit në Romë gjatë rrugës së kthimit të tyre nga Gjeneva.¹ Në bisedën që ai (Graham) kishte patur me të ngarkuarin me punë të legatës shqiptare në kryeqytetin italian pikërisht ato ditë, ky i kishte folur për kontaktet e Nolit në selinë e Lidhjes së Kombeve, konkretisht mbi takimet e tij me Makdonaldin e me Herrionë. Për përmbajtjen e bisedës, në njoftimin e ambasadorit britanik, gjejmë formulën e përgjithshme, ashtu siç i ishte dhënë nga i ngarkuari me punë i Shqipërisë se «Noli ishte i kënaqur nga vizita e tij në Gjenevë», se «në këtë rast ishin biseduar çështje të rëndësishme politike dhe ekonomike». Mirëpo kryesorja ishte refuzimi kategorik i dy qeverive perëndimore për t'i dhënë çfarëdo ndihme financiare qeverisë shqiptare. Siç del edhe nga njoftimi i ambasadorit britanik, Noli përpqej ta zbuste disi efektin e një qëndrimi të tillë, duke dhënë ai njëfarë justifikimi të qëndrimit të dy fuqive perëndimore se «ai e kuptonte se nuk mund të siguronte një hua nga jashtë, përderisa Qeveria e tij nuk njihej *de jure* nga Fuqitë e Mëdha» dhe se prandaj «ai kishte ndërmend të zhvillonte sa më parë zgjedhjet e përgjithshme me qëllim që të provonte se Qeveria e tij kishte mbështetjen e gjithë vendit».²

Përgjithësisht mund të thuhet se atmosfera që gjeti delegacioni shqiptar në Gjenevë ishte që në fillim krejt negative. Veprimtaria e tij ishte e kushtëzuar nga dy pengesa kryesore, njëra më e madhe se tjetra: Jugosllavia, me ndikimin që kishte te vendet e pellgut danubian (sistemi i Antantës së Vogël) dhe sidomos Anglia, fuqia që rëndonte me të gjithë peshën e saj në gjithë punën e Lidhjes. Në këto kushte edhe vetë kontaktet e delegacionit nuk mund të ishin veçse të kufizuara, ndërsa rezultatet të parëndësishme. Në të vërtetë udhëtimi në Gjenevë nuk shërbeu as për

1) Raport i ambasadorit Graham nga Roma datë 14.10.1924. PRO-FO/371 Albania, File 9640.

2) Po aty.

njohjen e Qeverisë Demokratike, as për lidhjen e ndonjë huaje (ndërkohë që Zogu merrte nën dorë shumën të majme si nga qeveritë, ashtu edhe nga shoqëritë private).

Fjalimi i Nolit

Megjithatë, bilanci i veprimtarisë së delegacionit nuk matet vetëm me këto dy çështje. Akti më domethënës është pa dyshim fjalimi që mbajti Noli përpara Asamblesë së Përgjithshme më 10 shtator.¹ Pa lënë mënjanë çështjet e veçanta që ishin burim preokupimi për vendin që përfaqësonte, fjalimi i Nolit ishte një ekspozë e pikëpamjeve dhe qëndrimeve të Qeverisë Demokratike mbi problemet e mëdha të politikës ndërkombëtare, si dhe në mënyrë të veçantë mbi gjendjen dhe perspektivën e vetë Lidhjes së Kombeve. Për të shprehur me dy fjalë thelbin e këtij fjalimi duhet thënë se ai ka qenë një denoncim i rreptë, pa doreza, i spekulimeve pacifiste të Fuqive të Mëdha, të cilat po e kthenin Lidhjen në arenë e tribunë të këtyre spekulimeve. Asnjëherë nuk ishte dëgjuar brenda mureve të Asamblesë së Gjenevës një zë kaq i fortë proteste kundër mashtrimit të popujve me opiumin e propagandës pacifiste. Qëndrimin mospërfillës, madje haptazi armiqësor të qeverive perëndimore, Noli iu përgjigj jo me lutje, as me përlutje, por me një aktakuzë të fuqishme, që i godiste fuqitë kryesore në të gjithë frontin e politikës së jashtme dhe jo vetëm në çështjen shqiptare.

A ishte ky një gjest hakmarrjeje për murin e heshtjes në të cilin ndeshi delegacioni shqiptar në Asamblenë e Gjenevës?² Një mendim i tillë mund të ketë marrë shkas sidomos nga fjalët që Noli përsërit disa herë gjatë fjalimit për huanë që i është refuzuar Qeverisë së tij. Të shqiptuara me njëfarë kadence, ato tingëllojnë si një refren sidomos në atë pjesë ku kërkesa për akordimin e huasë i drejtohet tani jo fuqive, por

1) *Société des Nations. Journal Officiel. Actes de la V Assemblée. Séances plénières. Compte-rendu des débats. Genève 1924, pp. 105-106.*

2) Kështu, p.sh., autori italian P. Pastorelli e quan fjalimin e Nolit me «tonin e tij të hidhur e ironik» si një provë «të dështimit të misionit të tij në Lidhjen e Kombeve». P. Pastorelli, *vep. cit.*, p. 53.

Lidhjes së Kombeve. Delegacioni shqiptar duhet të ketë bërë disa sondazhe në këtë drejtim (për të marrë një hua nëpërmjet Lidhjes) përpara 10 shtatorit, dita kur Noli mori fjalën në Asamblenë e Përgjithshme. Dhe përgjigjja ka qenë me siguri një jo ndoshta e shoqëruar me fraza më të stërholluara, por në thelb jo më pak kategorike. Prandaj Noli i rikthehet kësaj çështjeje në fjalimin e tij dhe kjo pjesë pa dyshim nxjerr në pah një tjetër zhgënjim të tij përsa i përket «Organizatës universale». Një hua e lidhur nëpërmjet Lidhjes së Kombeve në teori mund të paraqiste avantazhin që Qeveria Demokratike të mënjanonte çfarëdo kushtëzimi politik kundrejt kësaj apo asaj qeverie, dhe të kishte të bënte vetëm me këtë Organizatë «supernacionale».¹ Noli dhe rrethi i tij mund të jenë nisur me këto mendime, por realiteti në Gjenevë i fshiu edhe këto iluzione. Dhe atëherë Noli zhvesh shpatën e ironisë së tij therëse. Ai i drejtohet sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes, anglezit Drumond (Drummond) me këto fjalë: «Po ju lutem, z. sekretar i përgjithshëm, përse refuzoni t'i jepni Shqipërisë një hua që do t'i lejonte të ecte vetë? Ne nuk na duhen më tepër se 300 milionë franga ar. Apo është shumë? Atëherë po bëj gjestin elegant të zbres në shumën modeste prej 200 milionësh. Ju tundni kokën. E po jam gati të hyj në bisedime për një shumë më të vogël, p.sh., për 100 milionë. Më falni, mos pretendoni se nuk më keni takuar kurrë dhe, pra, nuk jeni i disponuar të më jepni asnjë dhjetësh? Atëherë merreni këtë kërkesën time dhe varroseni në dosjet e vdekura të Sekretariatit, kyçeni mirë dhe mbylleni fort përpara se ta futni në nekropolin tuaj, sepse mund t'ju dalë nga varri».²

1) Që Qeveria e Nolit kishte ndër mend ta kërkonte këtë ndihmë nga Lidhja e Kombeve, kjo duket edhe nga lajmet që u dhanë që përpara në faqet e shtypit evropian. Kështu, gazeta e madhe angleze «*Taims*» («*The Times*») njoftonte prej Tirane në fillim të shtatorit se Qeveria e Nolit do t'i drejtohej Lidhjes së Kombeve «për një hua prej 100 milionë fr. ar» dhe se ajo do të kërkonte që ndihma t'i jepet Shqipërisë ashtu siç ishte dhënë në dy raste të mëparshme në favor të Austrisë e Hungarisë. Sipas gazetës «*Dajti*» datë 24.9.1924.

2) *SdN. Actes de la V Assemblée. Séances plénières. Compte-rendu des débats. Genève 1924, pp. 105-106.* Citatet nga fjalimi i Nolit janë përkthyer prej autorit të këtij punimi nga varianti frëngjisht, krahasuar me atë në anglisht (gjuha me të cilën u mbajt fjalimi) ashtu edhe me tekstin shqip që është botuar në *L. Dilo, «Ligjëron Fan Noli»* dhe është gjetur po ashtu në *Arkivin Qendror të Shtetit, Fondi 14. d. 86, fl. 1-5.*

Noli nuk ngurroi të zbulonte lakuriq arsytet që fshiheshin pas një qëndrimi kaq indiferent ndaj kërkesës shqiptare, Ai e tha hapur se kjo ndodhte, sepse Qeveria e tij nuk ishte njo-hur, se ishte një «guvernë kryengritëse pa parlament». Kjo i dha rast kryeministrit shqiptar t'i bënte një kritikë të rreptë vetë demokracisë parlamentare, dhe me siguri, këto fjalë ua kanë vrarë veshin fort gjithë të pranishmëve. «Po a e dini ju se ç'është parlamenti?» — pyeti Noli, duke iu drejtuar përsëri sekretarit të përgjithshëm. «Pa dyshim e dini. Por do të kenë një ide më të qartë kur t'ju them ç'mendoj për të. E, pra, parlamenti është një sallë ku mbliidhen politikanë pa shpirt, që bëjnë prova operate në trupin e gjallë të racës së tyre, një sallë plot me gazra helmuese, gazra mbytës, gazra që shkaktojnë lot dhe të qeshura dhe gjithë gazrat që u përdorën gjatë luftës së fundit...».¹ Aty për aty Noli tregohej i gatshëm për të bërë një lëshim, për t'u kthyer te kanunet e demokracisë bor-gjeze tradicionale, duke premtuar organizimin e zgjedhjeve të reja për të thirrur «atë fatkeqësi të madhe, atë bestytini të shëmtuar që është parlamenti», por vetëm pas 2-3 vjet «qeverie paternaliste» («qeverim atëror»), një regjim jo parlamentar që duhej të shërbente, sipas tij, për konsolidimin e pushtetit të ri kundër forcave reaksionare.² Siç mund të pritej, Lidhja u tërhoq mënjanë edhe në çështjen e huasë, dhe nuk mund të ndodhte ndryshe sepse Organizata e Gjenevës dhe politika e Fuqive të Mëdha nuk ishin krejt të shkëputura. Ato plotësonin njëra-tjetrën, duke vepruar në vija paralele.³ Megjithëse edhe kaq mjaftonte për të kritikuar Lidhjen, kishte plot fakte të tjera që justifikonin dhënien e një gjykimi global negativ mbi veprimtarinë e saj gjatë atyre 4-5 vjetëve. Dhe pikërisht ky është aspekti më i rëndësishëm i fjalimit të Nolit.

Po të merret në tërësinë e vet, ai nuk është thjesht një ankesë apo një shprehje e pakënaqësisë për shkak të qëndri-

1) *Po aty.*

2) Megjithatë, pas kthimit të delegacionit nga Gjeneva, Qeveria Demokratike shkoi edhe më tej duke nxjerrë dekretin e 13 nëntorit mbi zgjedhjet. Sipas gazetës «*Bashkimi*» zgjedhjet do të bëheshin në 2 turne: të parat më 20 dhjetor të po atij viti, të dytat më 20 janar 1925. «*Bashkimi*» datë 14.9.1924.

3) Vetë huaja për Austrinë e Hungarinë, ndonëse jepej në emër të Lidhjes së Kombeve, ishte siguruar me kontribute të shteteve si Anglia, SHBA, Franca, Italia, Belgjika, Holanda etj. Sipas raportit të konsullit shqiptar nga Vjena, janar 1924, *AQSH, fondi 251, v. 1924; d. 155, fl. 1-4.*

mit që ishte mbajtur e po mbahej kundrejt Shqipërisë. Ai përmban një analizë të mprehtë të marrëdhënieve ndërkombëtare nga një këndvështrim krejt origjinal. Noli parashtronte aty një kredo politike. Nuk është e rastit që fjalimin ai e hapi me këto fjalë që janë një vlerësim i përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve: «Kam frikë se më i nxehti paqedashës, po t'i hedhë një sy veprës së kryer nga Lidhja e Kombeve gjatë këtyre 5 vjetëve, do t'i ngrejë duart drejt qiellit nga dëshpërimi dhe do të bërtasë: «Oh! më mirë luftë sesa gjithë këto llomotitje të mërzitshme për paqen!» Çkemi bërë për paqen? Çfarë bëjmë ne tani në këtë çast në këtë Asamble?» — pyet pastaj Noli. Për pyetjen e parë përgjigjet vetë: «Ajo që është bërë këta pesë vjet të shkuar pushon qetë-qetë në paqen e përjetshme, mbyllur fort, varrosur në dosjet e vdekura të Sekretariatit...».¹ Për pyetjen e dytë i fton asamblistët ta gjejnë përgjigjen te Shekspiri: «Fjalë, fjalë, fjalë, d.m.th. erë dhe asgjë më tepër».

Në këtë pikë Noli prek çështjen kryesore që qëndron në rendin e ditës të sesionit të 5-të të Asamblesë së Gjenevës, atë të «sigurimit kolektiv» nëpërmjet çarmatimit dhe «rregullimit paqësor të konflikteve ndërkombëtare». Që në sesionin e saj të parë, në vitin 1920, Lidhja pati krijuar një «komision permanent konsultativ» dhe vit për vit në Asamble ose në organet e saj përcilleshin projekte të ndryshme që u jepnin shkas diskutimeve të zgjatura, por gjithmonë shterpe. Tani, në shtator 1924, jemi në kulmin e «erës së pacifizmit» dhe jo më kot në Asamblenë e Gjenevës shkuan dy eksponentët kryesorë të pacifizmit borgjez, Makdonaldi i Anglisë dhe Herrioi i Francës.² Sesioni i 5-të pati përpara projektin përfundimtar që u pagëzua «Protokolli i Gjenevës», por që mbeti po ashtu si një dëshmi tjetër e shterpësisë pacifiste, me gjithë zhurmën e madhe që u bë brenda dhe jashtë Lidhjes së Kombeve.

Dhe pikërisht këtu Noli qëllon në shenjë me kritikën e tij thumbuese: «Cili është përfundimi i gjithë këtyre bisedi-

1) *SdN. Actes de la V Assemblée. pp. 105-106.*

2) Makdonaldi që erdhi në krye të qeverisë laburiste më 1924 dhe Herrioi që fitoi në zgjedhjet parlamentare të majit në krye të «bllokut të majtë», patën bërë takime paraprake për të bashkërenduar planet pacifiste. Shih. *Istoria diplomatit, t. III Moskva 1945 ss. 273-278; J.B. Duroselle, Histoire diplomatique de 1919 à nos jours, Paris 1966, pp. 85-88.*

meve të mençme e të thella mbi çarmatimin dhe traktatet e arbitrazhit?

Këto çështje iu dhanë për shqyrtim një komisioni, që do t'ia kalojë një nënkomisioni, i cili do t'ia parashtrijë konkluzionet e tij një konference që do të mbledhet së shpejti, dhe kjo konference do t'ia dërgojë përsëri këto çështje një komisioni, pastaj një nënkomisioni i cili do t'ia referojë komisionit që do t'i dërgojë një raport konferencës. Konferenca do të votojë njëzëri një rezolutë dhe kjo e fundit do t'i jepet për shqyrtim Këshillit të Lidhjes së Kombeve. Këshilli, nga ana e tij, do t'ia kalojë këtë rezolutë Asamblesë së ardhshme të Lidhjes, e cila do t'i drejtojë njëzëri një lutje zotit të plotfuqishëm atje lart në qiell. Dhe kur këto çështje të kenë bërë këtë cikël poetik zvarritjesh e kundërzvarritjesh, raportesh e kundërraportesh dhe mendimesh konsultative, atëherë ato do t'i dërgohen së fundi sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, i cili do t'i mbyllë me kyç mirë e mirë dhe do t'i varrosë në dosjet e vdekura të Sekretariatit, ku ato do të mbahen brez pas brezi. Dhe kjo do të thotë natyrisht se ka mbaruar siç mbarojnë flluskat e sapunit».¹

Në vazhdim të fjalimit Noli ve në dukje aspiratat për paqe të njerëzve të thjeshtë në të gjithë botën, që e duan me gjithë shpirt paqen ndërsa dënon hipokrizinë, manevrat demagogjike të politikanëve të Fuqive që spekulojnë me këto aspirata. «Aspiratat për paqe, — thotë Noli, — i kemi kudo, dhe kjo s'ka asnjë dyshim. Përndryshe ne nuk do të kishim as komedinë e flluskave dhe superflluskave të paqes që po na mbulojnë. Dhe pikërisht sepse popujt duan paqe, burrat e shtetit, politikanët u servirin atyre kohë pas kohe flluska arbitrazhi², flluska çarmatimi, flluska sigurimi dhe superflluska reparacionesh».³

1) *SdN, Actes de la V Assemblée, pp. 105-106.*

2) «Arbitrazhi» është një nga mjetet e diplomacisë klasike për zgjidhjen «paqësore» të konflikteve ndërkombëtare, që parashikohet në «Protokollin e Gjenevës».

3) «Superflluskë reparacionesh» Noli quajti «planin Dawes». Ky ishte një projekt i përpunuar nga një komision ekspertësh me në krye amerikanin Dawes (Dawes), që kishte për qëllim të zgjidhte problemin e reparacioneve që duhej të jepte Gjermania pas Luftës I. Problemi acaroi në kulm sidomos marrëdhëniet franko-gjermane (sepse ajo që përfitonte më shumë nga reparacionet ishte pikërisht Franca). Si një mjet «garancie», qeveria e Parisit shkoi deri aty sa vendosi pushtimin e Rurit. Në vitin 1924 kjo u bë një nga temat kryesore të

Nuk ka dyshim se një oratori e tillë, sidomos në përmbajtje, ishte e pazakontë në praktikën e Lidhjes. Ajo tingëllonte si një herezi e vërtetë në ato mjedise. «Politikanët pa shpirt» sigurisht që nuk u tutën në planet e në lodrat e tyre. Por kjo nuk e ul, përkundrazi e thekson edhe më vlerën e fjalimit të Nolit si një pasqyrë e gjendjes reale të krijuar në Lidhjen e Kombeve.

Por në fjalimin e Nolit duhen dalluar dy linja: njëra - e kritikës së thellë, tjetra - e ekzaltimit të organizatës ndërkombëtare si një paralajmëtare të «botës së re», të paqes e vëllazërimit midis popujve. Pasioni që vë Noli në himnizimin e kësaj «perëndeshe» të së ardhmes njerëzore ia kalon edhe zjarrit me të cilin ai godet Lidhjen që ka përpara syve. Noli nuk është aspak për «shkurorëzimin» e Lidhjes. Fjalët e tij ishin më shumë fjalë dëshpërimi. Ato shprehnin zhgënjimin e shumë njerëzve që kishin besuar sinqerisht se Lidhja e Kombeve do të eliminonte diplomacinë e «prapakrahëve», se do të krijonte hapësirë për parime të reja në marrëdhëniet ndërkombëtare, se ajo do të merrte sidomos në mbrojtje më të veçjëlit e më të dobët kundrejt më të mëdhenjve e më të fortëve. Ky ishte një zhgënjim për atë që Lidhja e Kombeve duhej të bënte e që nuk po e bënte.

Nga ana tjetër, Noli afirmon; pjesa mohuese në fjalimin e tij i lë vendin asaj pohuese. Ai nuk hedh aspak poshtë idenë e një organizate të tillë ndërkombëtare. Jo vetëm kaq, por ai priret ta idealizojë dhe madje, duke rënë në kundërshtim me vetveten, ta shkëpusë Lidhjen nga kushtet konkrete, nga realiteti i kohës, nga politika e Fuqive të Mëdha. Kështu, ai nuk ngurron të himnizojë një Lidhje të Kombeve që nuk ekziston në të vërtetë, që është pjellë e imagjinatës së tij, e dëshirës së tij të zjarrtë për triumfin e paqes e të drejtësisë, të cilat nga vetë fjalët e tij duken tepër të mjegullta, të largëta e të pakapshme.

politikës evropiane. Anglia, besnike e politikës tradicionale të ekuilibrit në kontinent nuk mund të lejonte një forcim jashtë mase të Francës, ndaj kërkoi edhe ndihmën e SHBA për t'i dhënë dorë Gjermanisë. «Plani Daues» parashikonte dhënien e një huaje të madhe Gjermanisë (sidomos nga bankat amerikane) gjoja për ta bërë atë «solvable» për pagimin e reparacioneve, por në thelb për ta rimëkëmbur si një kundërpeshtë ndaj kapitalit francez. Noli, ndonëse nuk e kapi dot këtë aspekt të dytë, e pikasë natyrën demagogjike të «planit Daues», duke thënë se «ai (plani) mund t'i jepte nënpresidencën e SHBA autorit të tij» por nuk do të sillte «miliardat e reparacioneve», që prisnin Franca me Belgjikën. *Po aty.*

Ja se si shprehet Noli për këtë Lidhje të Kombeve imagjinare:

«Edhe sikur Lidhja e Kombeve të jetë një ëndërr, një utopi që i bën skeptikët të tallen e të shtrembërojnë buzët, ajo duhet të qëndrojë aty si një ideal që interpreton aspiratat më fisnike të njerëzimit; ajo duhet të qëndrojë aty si një sfida kundër lavdive groteske militariste. Ajo duhet të qëndrojë aty si një afirmativë solemne e vullnetit universal për paqe, ajo duhet të qëndrojë aty derisa bukuria e saj, fisnikëria e saj, shpirta njerëzore e saj, nevoja e domosdoshme e qënies së saj të kuptohen nga e gjithë bota. Sepse, fundi i fundit, me gjithë të metat që ka sot, ajo meriton të pritët me këto fjalë:

«Verweile doch, Du bist so schön!

«Oh, megjithatë qëndro, ti je kaq e bukur».¹

E gjithë kjo pjesë përshkohet nga një ndjenjë e theksuar euforie, megjithëse nuk mungojnë aty as konstatimet me vend. P.sh. drejt e kishte Noli kur thoshte se «paqja nuk do të vijë prej traktateve», se këto «janë të destinuara të hidhen shpejt a vonë në shportë»; për këtë kishte prova të mjaftueshme në praktikën e asaj kohe. Por ai nuk ruante më masën e gjërave, humbiste sensin e realitetit, kur si rrugë për të arritur aty tregonte arsimin «Paqja do të vijë nga edukimi shkollor» thoshte Noli, duke injoruar kështu rrënjët e thella sociale të shpërthimit të luftërave. Mund të bashkohemi me të kur ai bën thirrje «për t'u mësuar fëmijëve tanë se vrasjet me shumicë janë po aq krim sa dhe vrasjet me pakicë», se «burimi i të gjitha të këqijave që mendojnë njerëzimin prej shekujsh janë hyjnitë e tribuve» ose «perënditë tona të bajrakëve» (një aluzion, ky i qartë për interesat e ngushta të klasave drejtuese). Mund të ndajmë me të dufin që ai shpreh aq fuqishëm kundër «këtyre hyjnive barbare e antropofage që e kanë mbushur historinë njerëzore me aq vuajtje, urrejtje, me aq shumë gjak, me shkatërrime e tmerr». Por zgjidhja është iluzore, himerike kur Noli propozon që njerëzve t'u mësohet që në moshë të re «të bëhen anëtarë të ndershëm të supershtetit që do të përmbledhë të gjitha tributë, të bëhen qytetarë fisnikë të federatës së për-

1) *Po aty*. Nga «Fausti» i Gëtes. Janë fjalët me të cilat Fausti, në fund të jetës, përcjell ëndrrën e tij për krijimin e një «qyteti» (bashkësie) të lirë, me banorë (qytetarë) të lirë, të bashkuar vëllazërisht.

botshme», e cila, sipas tij, «është në realizim e sipër» dhe «do të realizohet me siguri». Është e tepërt të theksohet se si parashembëlltë të kësaj «bashkësie të harmonishme» Noli quan pikërisht dhe vetëm Lidhjen e Kombeve. Kështu e përfytyron ai misionin e kësaj organizate, si parapërgatitje të «supershtetit», të «federatës së përbotshme».

Prandaj edhe në fund të fjalimit, i rrëmbyer nga patosi i njohur, ai djeg etapat dhe u drejtohet me një thirrje të zjarhtë «shokëve të tij» që të rreshtoheshin nën flamurin e Lidhjes: «Përpara, o shokët e mij! Bota është gati për Ungjillin e ri. Flamuri i Lidhjes së Kombeve është më fisniku që është ngritur deri më sot. Ushtarët e saj janë më trimat që ka nxjerrë bota ndonjëherë. Qëllimi i saj është maja e përparimit të njerëzimit. Vështirësitë janë të mëdha, por shtrini kurajën tuaj deri në pikën e fundit dhe mundimet nuk do t'ju venë kot». ¹ Noli ka parasysh edhe mesian, profetin prandaj, konsekuent në përfytyrimet e tij, thotë se në këtë marshim «drejt shpëtimit» «Shpirti i Vilsonit, ati dhe profeti i saj (i Lidhjes), na udhëheq».

Mirëpo as vetë Noli nuk e ka të qartë se kujt ia drejton këtë thirrje, se kush janë «shokët e tij», të cilët ai i fton të shtrëngojnë radhët nën flamurin e Lidhjes së Kombeve. Janë njerëzit e thjeshtë nëpër botë, janë popujt e etur për paqe, apo janë politikanët e regjur që ai ka aty përpara syve në sallën e Asamblesë së Përgjithshme? Mesazhi është i qartë, plot frymëzim. Por aty mungon koncepti i luftës aktive të masave popullore për përmbysjen e rendit të vjetër dhe ndërtimin e së resë.

Noli e idealizon Lidhjen e Kombeve jo vetëm kur është fjala për probleme të mëdha të së ardhmes së botës e të perspektivës historike, por në mënyrë të veçantë edhe lidhur me Shqipërinë. Atij i duket p.sh. me vend të deklarojë se Lidhja është «shpëtimtarja» e Shqipërisë; ai thotë se ndër ato pak gjëra pozitive që ka bërë Lidhja është se «ajo ka shpëtuar Shqipërinë nga copëtimi» ² pas Luftës I. Ky pohim është i tepruar. Në qoftë se Shqipëria i shpëtoi copëtimin të

1) *Po aty.*

2) Ky pasazh i fjalimit ka këtë përmbajtje: «Si e dini, — tha Noli duke iu drejtuar gjithë Asamblesë. — Shqipëria pas lufte — A.P.) ishte një kaçkë e fortë për t'u thyer dhe më e rëndë për të ndarë, kështu që Lidhja e Kombeve me mençuri vendosi ta lejë Shqipërinë të qetë, të lirë, të lagur nga valët e Adriatikut». *Po aty.*

ri pas Luftës I, madje likuidimit të pavarësisë së saj, kjo i detyrohet jo Lidhjes së Kombeve që nuk kishte gjë në dorë, që nuk kishte asnjë peshë në politikën ndërkombëtare sidomos në fazën fillestare të ekzistencës së saj. Këtu rolin kryesor e luajtën dy faktorë, të radhitur sipas rëndësisë: së pari, lufta për rimëkëmbje kombëtare e popullit shqiptar që pati dy momente kulmore në Lushnjë e Vlorë më 1920; së dyti, kontradiktat ndërimperaliste që nuk u lejuan Fuqive të merreshin vesh për coptimin e Shqipërisë.

Me siguri Noli e ka fjalën te pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve në dhjetor të po atij viti, dhe kjo ishte vërtet një fitore politike e që shënonte daljen e parë në arenën ndërkombëtare të Shqipërisë pas Luftës I si shtet i pavarur e sovran. Por, në fund të fundit, nuk ishte pranimi i Shqipërisë në Lidhje që përcaktoi qëndrimin e Fuqive në çështjen shqiptare. Përkundrazi, ishte politika e Fuqive ajo që i hapi rrugën pranimit të saj. Nuk mund të mohohet se Lidhja e Kombeve veçanërisht në këtë periudhë ka shërbyer si një tribunë prej nga është ngritur zëri kundër planeve të ndryshme për zhdukjen e shtetit shqiptar, kundër shkeljes së të drejtave elementare të popullit tonë. Por, më tej se kaq ajo nuk shkoi. Lidhja e Kombeve nuk do të vononte ta zhgënjente Nolin dhe Qeverinë Demokratike, drejtpërsëdrejti në dëm të Shqipërisë, me qëndrimin që do të mbante kundrejt ndërhyrjes jugosllave në dhjetor (shih më poshtë). Në njëfarë mënyre ky mund të quhet prologu i trajtimit që do t'i bëhej agresionit të Italisë fashiste kundër Shqipërisë në prill 1939, kur një kazus i ri i shkeljes flagrante të normave ndërkombëtare u palos si shumë të tjerë, në «dosjet e vdekura» të Organizatës së Gjenevës.

Megjithatë fjalimi i Nolit para Asamblesë së Lidhjes duhet të gjykohet në tërësinë e vet dhe atëherë del se pjesa racionale, konkrete, mbizotëron gjerësisht mbi idilin. Lajtmotivi i fjalimit është shqetësimi për gjendjen e krijuar, protesta kundër manipulimeve të Lidhjes nga fuqitë imperialiste, kërkesa për një rend më të drejtë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Nga ana tjetër, vetë formulimi i «dëshirave të mira» për të ardhmen e njerëzimit, ndonëse do kritikuar si i mangët nga pikëpamja e mjeteve dhe rrugëve të realizimit praktik të tyre, nuk mund të mos shërbejë si një dëshmi për konceptet më të përparuara që elementët më të ndriçuar të Qeverisë së 1924-s, të mbledhur rreth Nolit, kishin rreth problemeve të politikës ndërkombëtare. Mundet që Noli ndërton

disa kështjella në erë për kohën, por kryesorja është se ai sulmon kështjellën e frikshme të politikës imperialiste me të gjitha të këqijat që ajo sjell për pagën dhe bashkëpunimin e vërtetë midis popujve.

Jehona

Fjalimi i Nolit në Asamblenë e Gjenevës mbetet një dokumnt të cilit edhe koha që ka kaluar ia ka shtuar rëndësinë. Nuk është pa vlerë që në analet e Lidhjes së Kombeve një fjalim i tillë të figurojë i mbajtur në emër të përfaqësuesit të Shqipërisë, në një kohë kur vala e lëvizjeve përparimtare ishte në rënie dhe kur kudo në Ballkan ishin në fuqi qarqet më reaksionare. Noli dilte aty si zëdhënës i rrymës më të përparuar të demokracisë së rrethuar në Shqipëri, por edhe si interpret i një opinioni më të gjerë, i «aspiratave për paqe që ishin kudo».

Kjo është arsyeja që fjalimi i Nolit pati jehonë jo vetëm në Gjenevë në rrethet e Lidhjes, por edhe më tej. Në dokumentet e Lidhjes së Kombeve lexojmë se në mbarim të tij, në sallë, pati «duartrokitje të gjalla» (vifs applaudissements). Nuk ka dyshim se kjo duhet marrë me rezervë në kuptimin që diplomatët e ndryshëm, ndonëse ishin gati t'i jepnin një tribut në majë të gishtave oratorisë dhe erudicionit të Nolit, në thelb nuk mund të ishin të kënaqur. Nuk ishin mësuar që në Lidhje të flitej me atë gjuhë në adresë të politikës së Fuqive të Mëdha dhe që nga tribuna e saj të bëheshin thirrje që thyenin kanunet e diplomacisë klasike. Kuptohet, pra, pse fjalimi i Nolit nuk ngjalli shumë simpati. Shumë diskutantë në ndërhyrjet e tyre gjatë punimeve të Asamblesë e hodhën fjalën të «bolshevizmi» i delegatit shqiptar dhe qeverisë së përfaqësuar prej tij.

Përsa i përket jehonës që pati në shtypin perëndimor, nuk disponojmë veçse disa grimca të dhënash nga burime të tërthorta, ndonëse çështja do të duhej të bëhej objekt i një vëmendjeje të posaçme. Përgjithësisht vihet re njëfarë pozite kontradiktore, sepse nga njëra anë e vërteta ishte me Nolin dhe dobësitë e Lidhjes ishin përpara syve, kurse nga ana tjetër përgjegjësia për këtë u vishej Fuqive të Mëdha, diplomacisë së tyre. Mirëpo për gazetatat perëndimore kjo do të thoshte

të vihej në pikëpyetje gjithë sistemi i marrëdhënieve ndër-kombëtare. Duket se gazeta e dëgjuar zvicerane «Gazeta e Lozanës», («Gazette de Lausanne»), në një koment të sajën e karakterizonte mjaft drejt atmosferën në të cilën u ndoq fjala e Nolit në Asamble. Pasi theksonte se «kryedelegati i Shqipërisë, imzot Noli, mbajti një fjalë të zhveshur në Shoqërinë e Kombeve», gazeta shtonte se «gjithë fjala tepër spiritoze e imzot Nolit vazhdoi në këtë mënyrë (frymë) dhe Asambleja e dëgjoi me një kënaqësi keqdashëse (malicieux plaisir)». ¹

Janë për t'u përmendur veçanërisht dy gazeta angleze me emër, si «Deili Telegraf» («Daily Telegraph») dhe «Deili Ekspres» («Daily Express»). E para botoi një pjesë të fjalimit që e kishte komentin në titull: «Fjalë të drejta për Ligën. Bomba e peshkopit shqiptar». Kurse e dyta botonte një «lajm» që ishte më tepër se një koment dhe që e pasqyronte më saktë opinionin zyrtar britanik. Prej Gjeneve, një korrespondent anonim dërgonte më 10 shtator këto pak rreshta: «Ku është e mira e Lidhjes së Kombeve kur ajo s'mund t'i japë Shqipërisë një hua prej 600 milionash?» (sic), — tha delegati shqiptar, z. Fan Noli. «Lidhja, — shtoi ai, — s'ka bërë gjë tjetër veçse fjalë». Kur z. Fan Noli foli për huanë një delegat ia priti: «Po pse nuk provoni t'i fitoni paratë në dhomën e bakarasë në «Kursal*»?». ²

Nga ana e saj gazeta më e madhe amerikane «Nju-Jork Taims» («New York Times») fjalimin e Nolit e quante si një nga fjalimet që bënë më tepër bujë dhe «më piktoreske në këtë sesion». ³ Nga një raport i konsullatës shqiptare në Nju-Jork del se në përgjithësi fjala e Nolit pati mjaft jehonë në shtypin amerikan, ndonëse me njëfarë vonese. Duke iu përgjigjur një kërkesë të posaçme të qendrës, konsullata në fjalë, me shkresën e saj të datës 18 nëntor 1924 (pra, pas më se dy muajsh prej fjalimit), përpiqej të jepte një ide përmbledhëse të shkrimeve që ishin botuar në gazetatat më të njohura në SHBA. Pasi theksonte se «nuk mbeti asnjë fletore në Shtetet e Bashkuara, që nuk e botoi fjalën e kryeministrit Noli», konsullata dallonte tre raste: rastin e «shumicës së gazetave, që e botuan pa koment», atë të një pakice që e shqëruan

1) Sipas gazetës «Drita» (Gjirokastër) 25.9.1924.

2) Tekst i përkthyer në AQSH, *fondi 251, v. 11924, d. 146, fl. 28*. Kursal — lokal ku luhej kumari në Montekarlo.

3) Sipas gazetës «Shqiptari i Amerikës» datë 15.11.1924.

edhe me komente dhe, së fundi, një numër tjetër gazetash të cilat, duke marrë shkas nga fjalimi, botuan «një sërë artikujsh mbi Shqipërinë dhe kryeministër Nolin». Nga të gjithë artikujt e botuar veçohej ai i gazetarit të mirënjohur të «Nju-Jork Taimsit», Uollter Litëllfeld, (Walter Littlefield), i cili «botoi një kritikë të bukur lëvdonjëse».¹

Ky ton i shtypit amerikan, që siç duket ndryshon nga ai i shtypit evropian, mund të shpjegohet me faktin se SHBA, ndonëse qenë ndër iniciatorët e krijimit të Lidhjes së Kombeve, nuk morën pjesë në të, dhe ndiqnin nga larg e shpesh me sy kritik veprimtarinë e saj.

Në shtypin e vendeve fqinje Noli filloi të mbiquhej «peshkopi i kuq», megjithëse askush nuk besonte në këtë. Kjo shërbeu si shkas për një valë të re të fushatës kundër Revolucionit Demokratik në Shqipëri në përkrahje të përgatitjeve që po bëheshin sidomos në territorin jugosllav për të ndërhyrë me forcë. Marrëveshja që u arrit në tetor për shkëmbimin e përfaqësuesve diplomatikë me qeverinë sovjetike² u paraqit si një provë e «bolshevizmit» të Nolit dhe të Qeverisë së tij, si një konfirmim e angazhimit të kësaj të fundit në «veprimtari subversive për destabilizimin e gjendjes në Ballkan».

Kjo duhet të ketë sugjeruar edhe orvatjen e ministrit të Jashtëm jugosllav Ninçiç për të përlegjur kursin intervencionist të Beogradit, duke iu referuar së ashtuquajturës marrëveshje të fshehtë që «Qeveria e Nolit kishte lidhur me qeverinë e Moskës». Aty nga fundi i nëntorit, pyetjes së përfaqësuesit italian Sola, rreth ndihmës që vetë shtatmadhoria jugosllave po jepte haptazi në përgatitjen e bandave në kufirin shqiptar, Ninçiçi, pas njëfarë ngurrimi fillestar, iu përgjigj duke e pranuar këtë fakt, por shtoi se «qeveria e tij kishte në dorë prova se Qeveria e Fan Nolit kishte rënë në ujdi me qeverinë e Moskës dhe se para bolshevikëve po derdhehin për të financuar fiset antiserbe që mbaheshin gjallë në Maqedoni nëpërmjet Komitetit të Kosovës».³

1) Shkresë e konsullatës shqiptare nga Nju-Jorku datë 18.11.1924 AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 144, fl. 29-31.

2) Shih Kapitullin I.

3) Tel. i Solas datë 26.11.1924, DDI, 7^a serie, vol. III, d. nr. 588. Kjo akuzë u përhap edhe publikisht nëpërmjet shtypit të Beogradit. Kështu gazeta «Vreme» shkruante po ato ditë se «F. Noli e mori pushtetin falë arit bolshevik» dhe se «al punonte bashkë me Komitetin e Kosovës si një agjent i thjeshtë i Moskës», «Vreme» datë 24.11.1924, kupyre në AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 262, f. 1.

Është me interes të vihen në dukje përshtypjet që pati ngjallur fjalimi i Nolit në rrethet e diplomatëve sovjetikë të kohës. Ato janë të një toni krejt tjetër në krahasim me ato të diplomatëve të shteteve perëndimore, Përfaqësuesit sovjetikë nuk merrnin pjesë në punimet e Lidhjes së Kombeve. sepse Bashkimi Sovjetik atëherë nuk ishte ende anëtar i Organizatës së Gjenevës.¹ Megjithatë, për këto përshtypje mund të gjykojmë nga fjalët që patën shprehur anëtarët e personelit të përfaqësimit sovjetikë që ishte caktuar të vinte në Tiranë, gjatë bisedës që ata kishin patur në konsullatën shqiptare të Vjenës (ku ishin ndalur për të marrë vizën e hyrjes në Shqipëri). Në raportin që i dërgonte Ministrisë së Jashtme në Tiranë më 12 dhjetor, konsulli shqiptar, pasi theksonte «tendencën e qartë të miqësisë për Shqipërinë» që kishte vënë re te bashkëbiseduesit e tij, shtonte se ata «treguan një nderim e një simpati të madhe për kryeministrin tonë Fan Noli» veçanërisht «për fjalimin e tij në Gjenevë». «Diplomatët tanë — kishin thënë të dërguarit sovjetikë, — e mbajnë atë për një kryevepër».²

Një çështje tjetër që do të duhej sqaruar është edhe ajo e jehonës që pati fjalimi i Nolit në opinionin e vendit. Shtypi i kohës brenda vendit e ka përcjellë atë me komentet e rastit, por nuk na rezulton që ta ketë botuar tekstin e plotë të fjalimit. Gazeta «Bashkimi» në një nga numrat e saj të fillimit të tetorit boton vetëm një pjesë, atë të mbylljes dhe në një përkthim që le shumë për të dëshiruar, si nga pikëpamja e saktësisë së përmbajtjes ashtu edhe nga ajo e gjuhës, që stonon veçanërisht kur i atribuohet Nolit³. «Bashkimi» e thotë shprehimisht (ndonëse nuk e tregon arsyen përse nuk e jep integralisht) se po boton vetëm pjesën e fundit «në të cilën, — shton ajo, — kryeministri i Shqipërisë mikroskopike ngre lart flamurin e paqes së përbotshme». Dhe përfundon: «Diplomati i hollë dhe i dëgjuar i vitit 1921, këtë radhë i lëshoi vendin idealistit literat, që në emër të popujve

1) Bashkimi Sovjetik do të hynte në Lidhjen e Kombeve vetëm më 1934.

2) AQSH, *fondi 251, v. 1924.*

3) Gazeta «Bashkimi» datë 7.10.1924.

të vegjël dhe të idealeve njerëzore, gjëmoi me zë apostulli në mbledhjen e lartë të Gjenevës». ¹

Megjithatë, «Bashkimi» nuk qe kufizuar me kaq; gazeta e pati prezantuar dhe komentuar fjalimin që disa ditë më parë, në numrin e saj të 3 tetorit, në një artikull me titull «Ëndrra ...e fjalë». Autori nuk zgjatet në përmbajtjen konkrete të ndërhyrjes së Nolit, por mjaftohet ta karakterizojë atë si një akt të pashembullt të përfaqësuesit të një shteti të vogël, që nuk ngurron të lëshojë një sfidë në adresë të Fuqive të Mëdha duke «çjerrë maskat» e diplomacisë e duke nxjerrë në shesh «të vërtetën» e hidhur. Në artikull thuhej: «Dua të besoj se Shoqëria (Lidhja) e Kombeve, edhe sikur të mos bëjë gjë në mbledhjen e sotme (e tanishme), dhe s'ka dyshim për këtë gjë, pati një fitim të rrallë. Desh s'desh, pa fytyrën e saj të vërtetë në pasqyrën e hidhur që i shpuri peshqesh kryeministri i një shteti mikroskopik». Në këtë pikë artikullshkruesi e sheh mbledhjen e Gjenevës gati si një arenë të ndeshjes së Davidit me Goliathin dhe vijon: «Më duket se nuk triumfoi as Makdonaldi as Herrioi, as ku ta di unë se kush tjetër. Fjalët e tyre ishin me të vërtetë të bukura, por vetëm fjalë. Triumfoi me të vërtetë përfaqësuesi i shtetit të vogël. Ky tha disa gjëra, disa të vërteta nga ato që presin kot popujt e gënjyer». Na duket se autori i bën edhe një saktësim krejt me vend pritjes që iu bë fjalimit të Nolit në Gjenevë. Ai thotë se fjalimi «nuk u duartrokoi», duke e marrë këtë sigurisht në një kuptim më të thellë sesa regjistrimi i thatë i bërë në dokumentet e Asamblesë. «Dhe natyrisht, — shton autori, — nuk mund të duartrokites nga njerëz që punojnë me maskë dhe nuk u jep dorë të përballin të vërtetën lakuriq». Megjithatë, «fjalët e tij bënë efektin e duhur në mendjen e tyre, në mendimin (opinionin) e përbotshëm». ²

Gazeta që e ka botuar më gjerësisht (jo tërësisht) tekstin e fjalimit të Nolit duket se është «Shqiptari i Amerikës» që dilte në Korçë, madje edhe kjo gazetë e pati nxjerrë pjesë-pjesë në dy numra (më 18 tetor dhe 15 nëntor). Ky përkthim është shumë më i saktë në krahasim me atë të «Bashkimit» dhe kjo është pa dyshim arsyeja që në

1) Gazeta «Bashkimi» datë 7.10.1924

2) *Po aty.*

botimet e mëvonshme ai është huajtur pikërisht nga gazeta e Korçës.¹ Por është për t'u vënë fort në dyshim që përkthimi të jetë bërë nga vetë Noli², sepse Noli dinte përse fliste (atje ku prekte problemet e mëdha të politikës botërore, si arbitrazhi, reparacionet, plani Daues etj.), ndërsa përkthyesi nuk tregon se ka dijeni për thelbin e çështjeve, kështu që pasazhe të tëra të tekstit kanë mbetur të errëta, të pakuptueshme, madje ka mjaft kundërsense, që nuk mund të jenë thjesht gabime shtypi.

Me gjithë jehonën në përgjithësi pozitive, vlerësimi nuk ka qenë unanim dhe kjo është pasqyruar në radhë të parë në faqet e shtypit. Kështu gazeta «Politika» e Vlorës polemizonte me «fletoren e shenjtë» të mitropolisë së Durrësit (Visar Xhuvanin), ku Noli kritikojë për «fjalën e zhveshur që mbajti në Asamblenë e Shoqërisë së Kombeve». «Kryeministri ynë, — përgjigjej «Politika», — ka një të shkuar të pastër e patriotike, është një burrë shteti, që këtë cilësi e ka treguar në disa raste, e veçanërisht në dy herët që është ndodhur në Lidhjen e Kombeve ku ka tërhequr admirimin e simpatinë e përfaqësuesve të çdo shteti pjestar». Dhe përfundonte: «Kjo simpathi e zotësi gjuhe e truri të imzot Nolit, i kanë vlyer shumë Shqipërisë dhe këto vlera s'i çmojnë dot trutharët ose ata që në shpirtin e tyre të errët tip Eshref Frashëri (Rasputin i Zogolloviçit), kanë cmir e nakar».³ Përgjithësisht gazeta shprehte bindjen se me veprimtarinë e tyre në Asamblenë e Gjenevës, Noli së bashku me Gurakuqin «e nderuan shtetin tonë të vocërr e të përkrahës të sinqertë».⁴

Veç kësaj vihet re edhe fakti tjetër se ka gazeta si «Dajti» i Tiranës që nuk i kanë bërë vend fjalimit të Nolit dhe as e kanë komentuar. Duke e parë problemin në tërësi, të krijohet përshtypja se fjalimi i Nolit nuk pati gjetur në vend njohjen që do të mund të pritej. Kjo pa dyshim është përsëri një shenjë se në qarqe të caktuara, madje edhe në

1) Tekstet e botuara në L. Dilo, «Ligjëron Fan Noli», Tiranë, 1944 dhe P. Tako, «Rron or rron dhe nuk vdes shqiptari», Tiranë, 1976, janë të njëjta.

2) Shih P. Tako, «Rron or rron...» f. 188-189, shënimi 1.

3) «Politika», datë 23.10.1924.

4) Po aty.

gjirin e vetë lëvizjes demokratike, mendimet kanë qenë të ndara përsa i përket oportunitetit të asaj që mund të quhej aktakuza e Nolit në mbledhjen e Gjenevës.

Mund të përmendet këtu, së pari, gjykimi i qarqeve hap-tazi kundërshtarë të revolucionit që e cilësuan fjalimin e Nolit si «jo oportun dhe jo prej politikani».¹ Nga ana tjetër, tërheq vëmendjen një koment i Faik Konicës i cili, duke qenë në krye të «Vatrës» që prej largimit të Nolit, po e shmangte atë në një drejtim që ishte në kundërshtim me traditën e saj, drejt pajtimit dhe kompromisit me elementin çifligar reaksionar në Shqipëri. Në çastin për të cilin po bëhet fjalë Konica nuk e kishte përfunduar ende ujdinë, derisa Qeveria e Nolit ishte ende në fuqi, ndërsa Zogu vazhdonte të ishte i arratisur në Jugosllavi. Kujdes i tij duket se ishte që të mbante hëpërhë të paktën një ekuidistancë. Kështu në «Shqiptarin e Amerikës» lexojmë se Konica e komentoi «me hidhërim të thellë» versionin e fjalës së Nolit të botuar në «Dielli». «Po ashtu siç janë lajmet, — tha ai, — na japin të kuptojmë se fjala, nga pikëpamja letrare, ish e bukur dhe nga pikëpamja e së vërtetës, me vend. Nëse edhe nga pikëpamja e taktit diplomatik ka qenë një fjalë e mirë, është një çështje tjetër...».² S'ka dyshim se në fjalën e Nolit mungonte ai që në gjuhën e zakonshme quhej «takti diplomatik». Por Noli duhej të zgjidhte: ose të binte në konformizëm, madje në një servilizëm pa princip («takti diplomatik»), ose të thoshte të vërtetën aq, qoftë edhe duke lënduar demiurgët e diplomacisë. Ai zgjodhi të dytën dhe pikërisht këtu qëndron vlera origjinale e aktit të tij; përndryshe ai nuk do të regjistruhej veçse si një ushtrim oratorie ceremoniale dhe do të humbiste pa lënë gjurmë në rutinën e Organizatës së Gjenevës.

Më vonë, në distancë historike, janë shprehur gjykime po aq të rrepta për Lidhjen e Kombeve. Do të përmendim veçanërisht autorin e njohur antifashist italian G. Salvemini. Në një libër të botuar pas Luftës II Botërore ai bën një analizë të situatës së krijuar në gjirin e Lidhjes, që tingëllon gati si një jehonë e drejtpërdrejtë e kritikës noline. Ai shkruan, midis së tjerash, se «Lidhja nuk ishte veçse një pallat në Gjenevë, ku diplomatë dhe politikanë

1) Shih «Kujtimet dhe shënimet historike...», Fletore 7.

2) Gazeta «Shqiptari i Amerikës», datë 18.10.1924.

mblidheshin për të zgjidhur probleme ose për të mos i zgjidhur fare» dhe atëherë, pasi kishin vendosur çfarë do të bënin ose nuk do të bënin, ata mblidheshin zyrtarisht në salla që quheshin «Salla e Këshillit të Lidhjes» ose «Salla e Asamblesë së Lidhjes» dhe atje i shpallnin vendimet e tyre. I kur këto vendime të ishin marrë nga Lidhja. Gjithçka përgatitej prej Fuqive jashtë Lidhjes, pastaj sillej brenda Lidhjes dhe paraqitej sikur çdo gjë bëhej prej Lidhjes.¹ Një karakterizim i tillë i Organizatës së Gjenevës përkon plotësisht me idetë e Nolit, por merita e Nolit është se ai e denoncoi instrumentalizimin e Lidhjes që në fillimet e veprimtarisë së saj dhe përpara syve të diplomatëve dhe politikarëve të Fuqive. I njëjti studiues italian vëren se «një kritikë konstruktive e manevrave nëpërmjet të cilave diplomatët e shmangnin Lidhjen nga detyrat që ajo mund të kryente ndoshta do t'u kishte prerë rrugën këtyre devijimeve».² Pikërisht këtë u përpoq të bënte Noli, dhe nën këtë prizëm duhet gjykuar edhe oportuniteti i fjalimit të tij.

Ajo që tërheq më tepër vëmendjen është se edhe nga rrethet më të afërta me Qeverinë, madje nga vetë Noli nuk janë bërë bërë përpjekjet e duhura për ta bërë të njohur sa më gjerë përmbajtjen e fjalimit në opinionin e vendit. Veçanërisht domethënëse në këtë drejtim është intervista që Noli i dha gazetës «Bashkimi» disa ditë pas kthimit të tij nga Gjeneva.³ Intervista u kushtohej përshtypjeve nga Asambleja e Lidhjes, por nga krahasimi, bie në sy se mungon tani fryma e kritikës së rreptë që përshkonte fjalimin e 10 shtatorit. Duket qartë se, ndonëse i ruan bindjet e tij, si për politikën e Fuqive të Mëdha, ashtu dhe për një Lidhje të Kombeve që po kthehej haptazi në një instrument të tyre, Noli nuk e quan të nevojshme t'i ndajë këto bindje edhe me opinionin e vendit. Përkundrazi, ai le në heshtje atë që ka thënë në Gjenevë dhe jep një tablo gati optimiste të gjendjes së Lidhjes dhe sidomos të rezultateve të veprimtarisë së delegacionit të kryesuar prej tij. Ai e fillon intervistën me këto fjalë lavdëruese: «Nënshtypja ime nga Mbledhja e Gjenevës është nga më të mirat; delegacioni shqiptar u prit shumë mirë dhe të gjitha çështjet që u biseduan... u zgjidhën

1) G. Salvemini, *Mussolini diplomatico*, Bari 1952, p. 77.

2) *Po aty*, p. 77.

3) Gazeta «Bashkimi» datë 24.10.1924.

në favor të Shqipërisë». ¹ Në vazhdim ai rreshton çështjet kryesore me të cilat u mor delegacioni shqiptar gjatë kohës së qëndrimit të tij në Gjenevë. Ndër to ai vë çështjen e përcaktimit përfundimtar të kufijve në veri dhe në jug, atë të mbrojtjes së të drejtave të popullsisë shqiptare sidomos në Greqi («Çështja e Çamërisë») ², çështjen e huasë. Për të gjitha këto Noli jep një vlerësim global pozitiv, duke thënë se ato, ose janë zgjidhur, ose janë vënë në rrugën e zgjidhjes «në saje të Lidhjes së Kombeve». Nuk mund të mos shkaktojë habi një deklaratë e tillë, po të kihet parasysh pakënaqësia që pati shprehur Noli, si për trajtimin e këtyre çështjeve prej Fuqive, ashtu edhe për qëndrimin pasiv të Lidhjes së Kombeve.

Veçanërisht pa baza dhe i pakuptueshëm duket mendimi që shfaq ai në intervistën e tij lidhur me paktin e arbitrazhit, ose siç u quajt, «Protokolli i Gjenevës». Pas «ciklit poetik të zvarritjeve e kundërzvarritjeve», që e zinte fillin që me debatet e Lidhjes së Kombeve në vitin 1920, më 2 tetor 1924, me përpjekjet e Makdonaltit e të Herrioit që patën vënë me atë rast në lojë prestigjin e vet personal, Asambleja e Gjenevës e miratoi më në fund protokollin, në bazë të të cilit shtetet anëtare angazhoheshin t'i zgjidhnin konfliktet e tyre eventuale me mjete paqësore. veçanërisht me anë të arbitrazhit. Krejt papritur, Noli injoron tiradën e tij në adresë të «flluskave e superflluskave të arbitrazhit» dhe e quan miratimin e këtij pakti si një faktor të dorës së parë për konsolidimin e pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë. Ai thotë se, si rezultat i kësaj, «situata e jashtme e Shqipërisë u mirësua shumë» dhe se «pas këtij pakti, një invazie e huaj, për çfarëdo shkak, është e pamundur». ³ Në të njëjtën frymë ai flet edhe për marrëdhëniet me shtetet fqinje; le mënjanë problemet dhe vështirësitë, nuk bën fjalë fare për përgatitjen e ndërhyrjes nga jashtë dhe, nisur, siç duket, nga pakti i arbitrazhit që «përrjashton çdo invazie të huaj», përpiqet të qetësojë opinionin e vendit, duke thënë se «marrëdhëniet tona me shtetet fqinje janë normale dhe miqësore». ⁴

1) Gazeta «*Bashkimi*» datë 24.10.1924.

2) *Po aty*.

3) Shih më poshtë.

4) *Po aty*.

Është krejt e sigurt se Noli nuk ndërroi mendje me sot me nesër, as përsa i përket Lidhjes së Kombeve, as për problemet e mëdha të politikës botërore, as në lidhje me vështirësitë e mëdha në marrëdhëniet me shtetet fqinje. Por, a është i justifikuar një qëndrim i tillë, një paraqitje e tillë «për përdorim të brendshëm»? Opinioni më i gjerë i vendit jo vetëm duhej vënë në dijeni, por duhej mobilizuar për të përballuar rreziqet që i kërcënoheshin vendit, revolucionit. Kjo është një shfaqje tjetër e ndarjes së fjalës nga vepra në politikën e Qeverisë Demokratike. Mosmarrja e masave konkrete mbrojtëse në kohën e duhur shpjegohet edhe me këto qëndrime pasive. Shqetësimet ishin, por rreziqet nuk vlerësoheshin në shkallën që e kërkonte situata e krijuar.

Kapitulli VII

PËRGATITJA E INTERVENCIONIT

Shqipëria «fole e trazirave» në Ballkan?

Një çështje që duhet parë e sqaruar veçmas është ajo e pohimeve të njohura tanimë e që vinin nga anë të ndryshme se Shqipëria gjatë periudhës së Revolucionit Demokratik u kthye në një «fole të trazirave» në Ballkan, në një faktor turbullues për marrëdhëniet me shtetet fqinje. Do të ketë rënë në sy edhe nga sa u tha më lart se pikësynimi kryesor i propagandës antishqiptare të kësaj periudhe, të nxitur sidomos nga ana jugosllave, ka qenë që Qeveria Demokratike të paraqitej si një element destabilizues dhe të vihej në «bankën e të akuzuarit» gati si një filiale e Internacionales Komuniste. Pikërisht në këtë vështrim çështja meriton një vëmendje të posaçme për t'i dhënë një përgjigje pyetjes: a ishte vërtet Shqipëria një «bazë revolucionare» gjatë atyre gjashtë muajve, një qendër e «eksportimit të revolucionit në Ballkan»?

Lidhur me këtë duhet vënë në dukje jehona pozitive që pati fitorja e Revolucionit Demokratik në Shqipëri në qarqet revolucionare e sidomos në rrethet e Federatës komuniste Ballkanike. Një dëshmi e vëmendjes dhe simpatisë së tyre ka qenë patjetër thirrja që Presidiumi i Federatës Komuniste Ballkanike së bashku me KQ të Partisë Komuniste Italiane i drejtuan popullit punonjës të Shqipërisë për të përshëndetur fitoren e qershorit.¹ Aty theksohej rëndësia që kishte kjo fitore për popullin shqiptar, si në jetën e tij të brendshme

1) Mbi influencën e Revolucionit të madh Socialist të Tetorit në Shqipëri (1917-1924)», Tiranë, 1957, f. 110-111. Botuar edhe në E. Atanasova «Georgi Dimitrovi allbanskoje demokraticheskoje i komunisticheskoje dvizhenie», Sofia 1979, ss. 10-11.

për zhdukjen e feudalizmit dhe hyrjen në rrugën e përparimit, ashtu edhe në fushën e politikës së jashtme për sigurimin e pavarësisë së plotë kundër orvatjeve e presioneve të shteteve fqinje: Italisë, Jugosllavisë dhe Greqisë. Në përputhje me detyrat që qëndronin përpara forcave revolucionare të vendit, tërhiqej vëmendja, si në rrezikun e jashtëm që përbëhej sidomos nga ndërhyrja e qeverive të vendeve fqinje ashtu edhe në rrezikun e brendshëm që paraqitnin forcat reaksionare vendase.¹ Vlen të theksohet, veç asaj, se thirrja u drejtohej me po atë rast edhe «punëtorëve e fshatarëve të vendeve ballkanike dhe të Italisë».² Dhe kjo për dy arsye: e para — për të nënvizuar rëndësinë ndërkombëtare të fitores së qershorit në Shqipëri si një shembull frymëzues për të gjitha forcat përparimtare të këtij rajoni; e dyta — për t'i mobilizuar këto forca kundër tentativave për ndërhyrje që do të kryenin (dhe që në fakt kryen) qeveritë reaksionare të këtyre vendeve.

Përveç thirrjes së mësipërme, është për t'u përmendur edhe vlerësimi që u ka bërë ngjarjeve në Shqipëri Gjergj Dimitrovi, personalitet i shquar i Internacionales Komuniste, që ndiqte nga afër veçanërisht zhvillimin e situatës në Gadhullin Ballkanik. Gjykimin e vet Dimitrovi do ta jepte disa muaj pas përmbysjes së Qeverisë Demokratike. Në korrik 1925 ai do të shkruante: «Kthesa kundërrevolucionare e A. Zogut në Shqipëri, e kryer me ndihmën e Jugosllavisë e të forcave të saj të armatosura, zgjeroi frontin e reaksionit ballkanik deri në detin Adriatik, privoi popullin maqedonas nga një bazë e luftës çlirimtare, dhe lëvizjen revolucionare në Ballkan nga njëra prej bazave të saj».³

Një gjykim kaq i përparuar është pa dyshim në të mirë të Revolucionit të Qershorit dhe të Qeverisë Demokratike të dalë prej tij. Është me të vërtetë kuptimplote që në panoramën e zymtë të Ballkanit të asaj kohe, ngjarjet në Shqipëri shikoheshin si një rreze drite nga qarqet më përparimtare. Kjo është e domosdoshme të kihet parasysh për të zbërthyer drejt kuptimin që i jepej në rastin konkret «bazës së revolucionit». Këtu kyçin na e jep teoria leniniste mbi imperializmin, që e merr revolucionin në kuptimin më të gjerë, duke përfshirë çdo lëvizje që atakon qoftë strukturat kapi-

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

3) *G. Dimitrov. Soçinena, t. VIII, Sofja 1953 s. 197*

taliste, qoftë mbeturinat feudale, çdo proces shndërrues e përtëritës në zhvillimin e shoqërisë. Është e njohur teza leniniste se në epokën e imperializmit edhe lufta çlirimtare e popujve, revolucionet nacional-demokratike, antiimperialiste, antikoloniale, lëvizjet për çlirim kombëtar, janë hallka të një zinxhiri, janë pjesë përbërëse të një procesi të vetëm revolucionar.

Internacionalja komuniste e pati bërë të vetën tezën leniniste, duke e marrë revolucionin në kuptimin më të gjerë, dhe këtu e ka burimin përkrahja që ajo i jepte çdo lëvizjeje antiimperialiste. Kështu shpjegohet edhe vëmendja që u tregua dhe simpatia që u shfaq në rrethet e saj për Revolucionin e Qershorit në Shqipëri. Por kjo nuk e ndryshon aspak karakterin e tij si një revolucion demokratik. Duke qenë një hap në zhvillimin e shoqërisë shqiptare, ai ishte njëkohësisht një hallkë e procesit revolucionar unik. Në këtë frymë do të shprehej edhe vetë Gjergj Dimitrovi në një analizë të situatës në Ballkan më 1927, me rastin e 10-vjetorit të Revolucionit të Tetorit. Duke iu rikthyer ngjarjeve të vitit 1924 në Shqipëri, ai shkruante: «Përmbysja e qeverisë popullore të Fan Nolit në Shqipëri në vitin 1924 nga ana e Ahmet Zogut, me ndihmën e drejtpërdrejtë të Italisë e Jugosllavisë dhe përkrahjen e fuqishme të Anglisë, ishte një nga hapat e rëndësishëm të reaksionit ballkanik».¹

Në dritën e atyre që u thanë, del e qartë se pohimet mbi «bolshevizmin» e Qeverisë Shqiptare, mbi «folenë e trazirave» në Ballkan, kanë qenë një spekulim i thjeshtë.² Veç traktativave mbi njohjen dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me qeverinë sovjetike (çështje që, siç dihet, në fund të fundit, nuk gjeti zgjidhje) asnjë fakt tjetër i njëfarë rëndësie nuk regjistrohet në marrëdhëniet shqiptaro-sovje-

1) G. Dimitrov, *Soçinena t. VIII, Sofia 1953, s. 291.*

2) Noli vetë do të shprehej për këtë nja një vit më vonë, duke vënë në dukje karakterin thjesht instrumental antishqiptar të fushatës që e bënte «bolshevike» Qeverinë e tij. Në polemikë me Faik Konicën, ai shkruante në shkurt 1926: «Në Shqipëri s'ka asnjë lëvizje bolshevike a probolshevike... Por armiqve të Shqipërisë u jep dorë të thonë që ka, dhe kështu me ndihmën e gogolit të bolshevizmës të arrijnë qëllimin e tyre satanik për të copëtuar Shqipërinë, gjoja për të shiguar paqen në Ballkan. Faik Konica, duke shpifur që ka shqiptarë bolshevikë a probolshevikë, i bën Pashiçit shërbimin më të madh dhe forcon thezën e armiqve tanë për copëtimin e Shqipërisë». (*Fan S. Noli, Veprat, vëll. 3, Tiranë, 1987 f. 43-44.*)

tike të kësaj periudhe. Është, pra, krejt i pathemeltë dhe tendencioz pretendimi i qeverisë së Beogradit mbi një të ashtu-quajtur «marrëveshje të fshehtë», që gjoja «Qeveria e Nolit kishte lidhur me qeverinë e Moskës», për veprimtari të bashkërenduar kundër Jugosllavisë.¹

Është gjithnjë po ajo orvatje për të përligjur kursin intervencionist kundrejt Qeverisë shqiptare. Akuza nuk qëndronte, jo vetëm sepse ishte në kundërshtim me vetë arsyen e shëndoshë; mjaft të kujtohet këtu deklarata e Nolit se Shqipëria ishte «edhe materialisht, edhe shpirtërisht e çarmatosur» dhe, pra, nuk mund të ndiqte veçse një politikë mbrojtëse. Por, veç kësaj, edhe në historiografinë e huaj janë vënë në dyshim pretendimet jugosllave. Kështu P. Pastorelli shkruan se gjatë punës së tij kërkimore lidhur me këtë temë «nuk ka ndeshur në prova bindëse»², që të vërtetojnë sadopak pohimet jugosllave. Nga ana e tyre, edhe autorët anglezë Makartnei dhe Palmer e thonë shprehimisht se akuzat e mësipërme në adresë të qeverisë shqiptare «nuk kanë qenë provuar asnjëherë».³

I njëjti arsyetim vlen për ta vënë në një raport të drejtë Revolucionin e Qershorit dhe Qeverinë Demokratike edhe kundrejt lëvizjes çlirimtare maqedonase. Këtu nuk kemi vetëm fjalët e Dimitrovit se «populli maqedonas u privua nga një bazë e luftës çlirimtare», fjalë që duhen marrë në kuptimin që u tregua më lart. Veç këtyre është përmendur edhe ndonjë fakt, si, p.sh., zbritja në tokë shqiptare e disa elementëve të lëvizjes maqedonase të asaj kohe. Kështu, aty nga mesi i nëntorit, legatat e Jugosllavisë, Greqisë dhe Anglisë i patën tërhequr vëmendjen Ministrisë së Jashtme në Tiranë, sepse ishin pranuar në tokë shqiptare njerëz si Çaulev, një nga përfaqësuesit e lëvizjes maqedonase të asaj kohe.⁴ Një telegram zyrtar sekret prej Shkodrës i datës 8 nëntor e konfirmonte këtë dhe shtonte se Çaulevi kishte dalë vërtet në Shëngjin së bashku me Bajram Currin e Hasan Prishtinën.⁵

Por akuza të tilla nuk bëheshin për herë të parë. Ato ishin bërë edhe përpara qershorit, përpara se të vinte në fuqi Qeveria e Nolit. Që në muajin janar të vitit 1924, i

1) Tel. i Solas datë 26.11.1924 në DDI, 7^a serie vol. III, d. nr. 588.

2) P. Pastorelli, *vep. cit.*, p. 85.

3) C. A. Macarthey. A. W. Palmer, *Independent Eastern Europe: A history*, London 1962, cituar sipas P. Pastorelli, po aty.

4) «Shqipëria më 1927», f. 139.

5) Po aty.

ngarkuari me punë i Jugosllavisë ishte paraqitur në Ministrinë e Jashtme shqiptare për t'u ankuar se «në Shqipëri po vazhdonin veprimet e bandave bullgare kundër Jugosllavisë», se «komita bullgarë ishin përhapur në tërë Shqipërinë».¹ Vetë ministri i Jashtëm, Ninçiq e pati ngritur këtë çështje në fjalimin e mbajtur në parlament në muajin mars. Në pjesën kushtuar marrëdhënieve me Shqipërinë, ai kishte thënë se «aksioni i komitetit promaqedon ishte përqëndruar sidomos në Shqipërinë e Jugut» (bëhej fjalë për qarkun e Korçës)².

Në dokumentet e kohës, qoftë të organeve qendrore apo të atyre lokale, këto lajme cilësoheshin ose si të trilluara, ose si të zmadhuara, ose të bëra me prapamendim. Në një raport të legatës shqiptare prej Beogradi në muajin prill, theksohej pikërisht «prapamendimi i akuzave të tilla»: duke insistuar se me «çetat bullgaro-maqedonase» ishin bashkuar «edhe shqiptarë (si B. Curri e H. Prishtina), që kishin si program provokimin e turbullirave në tokë jugosllave», kërkohesh një shpjegim për lëvizjen e kaçakëve në Kosovë e të komitave në Maqedoni.³ Në korrespondencën e prefekturave me qendrën, përpara qershorit, këto lajme përgënjeshtroheshin dhe njëkohësisht theksohej se «trillimet e Beogradit» kishin një qëllim: «të bënin presion për çështjen e Shën-Naumit» për të cilën instancat ndërkombëtare kishin marrë vendim në favor të Shqipërisë.⁴

Megjithatë, duket se pas qershorit, disa kontakte janë vendosur, disa vajtje-ardhje mund të ketë pasur. Por, pikë së pari, ato kanë qenë raste të izoluara dhe, madje, edhe kur kanë ndodhur, jo gjithmonë janë bërë me dijeninë dhe pëlqimin e autoriteteve. Ato janë zmadhuar qëllimisht për t'i dhënë një bazë propagandës jugosllave. Në disa raste Zyra e shtypit në Tiranë ishte detyruar të bënte përgënjeshtime. P.sh. kështu veproi ajo dy herë radhazi gjatë muajit korrik, kur lëshoi deklaratë zyrtare për të hedhur poshtë thëniet e shtypit të huaj e «sidomos atij të Jugosllavisë» se gjoja vetë

1) Shkresë e Ministrisë së Jashtme drejtuar Ministrisë së Brendshme datë 18.1.1924 në AQSH, f. 251, v. 1924, d. 75.

2) Buletini i agjensisë jugosllave *Avala* datë 18.3.1924, *Po aty*.

3) Raport i legatës shqiptare nga Beogradi datë 11.4.1924. AQSH, *fondi* 251, v. 1924, d. 253.

4) Shih veçanërisht shkresën e prefekturës së Korçës datë 26.1.1924. *Po aty*.

Fan Noli kishte ftuar Todor Aleksandrovin, kryetar i komitetit maqedono-bullgar, «për të biseduar në kryeqytet e për të hartuar një plan të kryengritjes», ose se gjoja në Shqipëri «po formoheshin nën drejtimin e Bajram Currit banda komitësh për të bashkëpunuar me komita bullgarë në luftën kundër Jugosllavisë». ¹ Përsa i përket rastit të Çaulevit. Ministria e Jashtme i drejtohej Ministrisë së Brendshme me kërkesën që të bënte hetime dhe «në rast se i përmenduri ndodhej në Shqipëri», të merreshin masa «për ekspulsimin e tij». ²

Edhe sikur të pranohet si fakt vendosja e disa lidhjeve (sigurisht në masën që kanë qenë realisht dhe duke i bërë zbritjet përkatëse propagandës jugosllave), a mund të nxirret së këtejmi konkluzioni se Qeveria Demokratike e ktheu territorin shqiptar në një kryeurë të veprimeve revolucionare të drejtuara kundër vendeve fqinje e në mënyrë të veçantë kundër Jugosllavisë? Faktet flasin ndryshe: Më e shumta që mund të thuhet, është se kishte një ndjenjë solidariteti midis elementësh që i afronte ideali i përbashkët i luftës kundër shtypjes kombëtare e sociale të monarkive reaksionare të Ballkanit, për ndërtimin e marrëdhënieve të reja ndërballkanike. Pikërisht, duke marrë parasysh karakterin demokratik të Revolucionit të Qershorit dhe të Qeverisë së dalë prej tij, në kontrast me natyrën e regjimeve në fuqi në vendet e gadishullit, elementi përparimtar e shikonte Shqipërinë e atyre muajve me një ndjenjë simpatie.

Elementë të tillë nuk mungonin as në Jugosllavi. Kuptimplotë në këtë drejtim është një shkrim i personalitetit të shquar kroat, M. Kërlezha, i botuar në një revistë të Zagrebit në gusht të vitit 1924. Duke e cilësuar Revolucionin e Qershorit në Shqipëri si «kryengritje të vegjëlisë», Kërlezha merrte haptazi anën e saj, e përshëndeste fitoren e saj si një fitore të popullit kundër tiranisë së bejlerëve e çifligarëve, ndërsa denonconte me forcë politikën e Beogradit («kryeqendër e një shteti katundar ballkanik»), që vepronte me «klisheetë e vjetra», duke i konsideruar shqiptarët si një «ra-

1) Shkresë e Ministrisë së Jashtme drejtuar Ministrisë së Brendshme datë 18.1.1924, në AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 75.*

2) Shkresë e Ministrisë së Jashtme drejtuar Ministrisë së Brendshme datë 11.11.1924 në AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 201.*

cë inferiore», që duhej mbytur «me darën e bllokadës dhe të robërisë feudale».¹

Kjo shtonte aq më shumë mosbesimin dhe shqetësimin e reaksionit ndërkombëtar, sidomos kur elementi demokrat i persekutuar në vendin e vet, e shikonte Shqipërinë pas kthesës revolucionare të qershorit, si një bazë të përshtatshme për kuvend në mos për veprim. Me fjalë të tjera, Shqipëria mund të ishte vend strehimi politik dhe, siç dihet, njohja e dhënia e kësaj të drejte shtetasve të huaj të ndjekur në vendet përkatëse për bindjet e tyre politike, ka qenë praktikuar gjë-rësisht sidomos qysh prej shekullit XIX nga shtetet perëndimore në valën e revolucioneve borgjeze. Pra, edhe këtu thelbi i çështjes nuk ishte shkelja e pretenduar e parimit të mosndërhyrjes nga ana e Qeverisë Shqiptare, ishte situata e saj e vështirë e brendshme dhe e jashtme që jepte shkas për presione dhe akuza nga ana e forcave reaksionare.

Madje edhe në këtë drejtim, marzhi i veprimit të Qeverisë së Nolit ishte tepër i kufizuar. Qeveria Demokratike nuk guxoi asnjëherë që ta zbatonte këtë të drejtë në një shkallë të konsiderueshme. Kjo del qartë sidomos nga intervista që u përmend më lart e që Noli i dha korrespondentit të gazetës së Beogradit «Politika» në Gjenevë. Duke iu përgjigjur akuzave se gjoja fitorja e Kryengritjes së Qershorit e kishte kthyer Shqipërinë në një bazë të veprimtarisë antijugosllave, sidomos nga ana e «komitëve maqedonas», që luftonin për shkëputjen e Maqedonisë nga Jugosllavia, Noli theksonte se Qeveria e tij asnjëherë nuk kishte lejuar që territori shqiptar të përdorej si bazë për të shkaktuar trazira në vendet fqinje. Madje Qeveria kishte marrë masa kufizuese për hyrjen në Shqipëri të disa të huajve, pikërisht për t'u hequr qarqeve reaksionare ballkanike çdo argument për të përligjur veprimtarinë kundër Qeverisë Demokratike.²

«Zbulimet» e Radiçit

Nga sa u tha më lart, del e qartë se, me vetë qënien e saj, me parimet mbi të cilat përpiqej të ndërtonte qoftë politikën e brendshme, qoftë atë të jashtme, Qeveria e Nolit

1) Artikulli i M. Kërlezhës në «Književna Republika» Zagreb, gusht 1924 (Përkthimi shqip në AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 257, ff. 80-82*)

2) Sipas gazetës «Bashkimi» datë 26.9.1924.

ngjallte dyshime e shqetësime e njëherazi jepte rast për spekulime si të Fuqitë e Mëdha, ashtu dhe te shtetet ballkanike. Edhe pse nuk arriti asnjëherë të konsolidohej për të vënë në jetë programin e saj brenda vendit e as të zhvillonte çfarëdo veprimtarie, që të rrezikonte sadopak rendin ekzistues në vendet fqinje, prapëseprapë ajo shikohej si një «shembull i keq», si një sfidë që i bëhej statu kuosë në Ballkan. Ringjallja dhe aktivizimi i forcave të majta pas Luftës I, me rritjen e ndikimit të partive socialiste, komuniste dhe agrare (një dukuri kjo që ishte jo vetëm ballkanike por edhe mbarevropiane), quheshin një etapë e kapërcyer dhe në të gjitha vendet e gadishullit ishin vendosur tanimë regjime diktatoriale. Duke spekuluar me «rrezikun e bolshevizmit» qarqet drejtuese ishin të vendosura të bllokoni çdo proces emancipimi nacional apo social. Veç asaj, ishin në lojë disa interesa e synime të caktuara të qarqeve të jashtme në Shqipëri, për të cilat një qeveri «radikale» si ajo e Nolit, e ardhur në fuqi si pasojë e një kryengritjeje popullore, nuk mund të jepte garanci të mjaftueshme.

Kjo bëri që ndaj Qeverisë së 1924-s të kristalizohej gradualisht një qëndrim i përbashkët i qeverive të huaja, qëndrim që u shpreh së pari në mohimin e njohjes, por edhe në kundërshtimin e tyre sistematik për një varg problemesh të politikës së jashtme.

Shkallëzimi i kësaj politike çoi deri në intervencionin me armë për përmbysjen e gjendjes në Shqipëri dhe mbyrtjen e lëvizjes demokratike. Nuk mund të thuhet me siguri se kur dhe ku pikërisht u arrit në vendimin për të vepruar me forcë për rrëzimin e Qeverisë së Nolit. Megjithatë, nga shuma e të dhënave, nuk është vështirë të konkludohet se ideja filloi të qarkullonte menjëherë pas fitores së lëvizjes në qershor dhe ato që e ushqyen dhe e përpunuan ishin në radhë të parë qarqet drejtuese jugosllave. Mund të thuhet po ashtu se ajo që e nxiti më shumë këtë politikë, ndër të gjitha qeveritë e Fuqive të Mëdha, ishte qeveria britanike.

Ndonëse qeveria e Beogradit e pati përcaktuar kursin intervencionist që në fillim (një kurs që shprehej sidomos me nxitjen e veprimeve të vazhdueshme të bandave reaksionare kundër territorit shqiptar), duket se plani për të vepruar me forcë, për të përmbysur gjendjen në Shqipëri ka marrë formë pak a shumë konkrete në të hyrë të vjeshtës, më saktë në tetor.

Si shenjë paralajmëruese mund të konsiderohen ato që u

quajtën në atë kohë «zbulimet e Radiçit». Radiçi ishte kryetar i partisë fshatare (republikane) kroate. Jeta politike e Jugosllavisë gjatë gjithë periudhës midis dy luftërave, e veçanërisht në vitet 20 karakterizohej nga kontradikta të brendshme, ndër të cilat më të ashprat ishin ato serbo-kroate. Partia fshatare e Radiçit kishte përkrahjen e shumicës në Kroaci, jo aq si përfaqësuese e interesave të fshatarësisë sesa si forcë udhëheqëse e nacionalizmit kroat kundër hegjemonisë serbe.¹

Në vjeshtën e 1924-s, kontrasti serbo-kroat arrin një ndër pikat kulmore, kur Radiçi në mbledhjen e partisë së tij në Varazhdin, kreu një akt të bujshëm duke «zbuluar» se po përgatitej një komplot për copëtimin e Shqipërisë midis Italisë, Serbisë dhe Greqisë. Në fjalimin që mbajti më 5 tetor, Radiçi deklaroi midis së tjerash: «Shqipërisë po i kryhet një fatkeqësi e madhe. Italia, Serbia dhe Greqia do të deshnin ta pushtonin Shqipërinë: Italia nga deti, Serbia do të merrte Shkodrën dhe Greqia do të hynte në Epir».² Në vazhdim, pasi vuri në dukje se Shqipëria «ishte njohur» prej Lidhjes së Kombeve, Radiçi u shpreh me fjalët më të mira për ndryshimet në Shqipëri pas qershorit. «Shqipëria, — tha ai, — po mban një politikë lojale (korrekte), se ka për kryeministër një burrë të mënçur, Fan Nolin...» Duke marrë një qën-

1) Partia fshatare kroate ishte kundërshtarja më e vendosur e Partisë radikale të Pashiçit. Ndërsa kjo e fundit ishte partia më e vjetër e më me prestigj në Serbi (e themeluar që më 1881), Partia fshatare kroate ishte organizuar më 1905 nga vëllezërit Radiç, dy intelektualë me origjinë fshatare. Vëllai më i madh Antuni kishte qenë ideologu, ndërsa më i vogli, Stepani, organizator dhe mobilizues i masave. Që prej vdekjes së të parit, më 1919, Stepan Radiçi ka qenë gjatë një dhjetëvjeçari, deri në vrasjen e tij (në mes të parlamentit më 1928), lideri i padiskutueshëm i partisë. Duke qenë në thelb në opozitë me tendencat unitariste të Pashiçit, ai ra disa herë në kompromis të papritura me udhëheqjen serbe, si p.sh. në korrik 1925, kur u lirua nga burgu për t'u bërë ministër në qeverinë qendrore. Kjo i krijoi atij imazhin e një njeriu të lëkundur, të një politikani pa shumë kredi politike. Në kohën për të cilën po flitet (vjeshtë 1924), në fuqi, siç dihet, ishte Partia demokrate e Davidoviçit, e cila ishte shkëputur nga partia radikale që në fillim të shekullit, si një parti e re («radikalët independentë»), që e distancohte veten nga pozitat tepër konservatore të Pashiçit. Megjithatë, Radiçi nuk kishte arsye të bënte shumë dallim midis Pashiçit dhe Davidoviçit, sepse të dy këto grupime mbanin vulën e idesë serbomadhe.

2) Nga kupytrat e shtypit të Beogradit, shtator 1924, në AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 287.*

drim të hapur kritik kundrejt politikës zyrtare të qeverisë qendrore, lideri kroat i quajti «shqiptarët (nënkupto Qeverinë e Nolit) më të përparuar... e shumë më liberalë se qeveritarët e Beogradit».¹ Radiçi bëri edhe një paralajmërim lidhur me planet eventuale për «ndarjen e Shqipërisë». «Populli kroat, — tha ai, — nuk do luftë me Shqipërinë dhe asnjë kroat nuk do të kalojë kufijtë e Shqipërisë për t'i rrëmbyer asaj lirinë».² Këtë deklaratë që ai ia kishte bërë personalisht kryeministrit Davidoviç, tani e bënte edhe publikisht nga tribuna e partisë së tij.³

Fjalimi i Radiçit shkaktoi një pështjellim të madh në Beograd. Para së gjithash, ministri i Luftës, gjenerali Haxhiç dha dorëheqjen në shenjë proteste kundër asaj që ai quajti «disfatizëm» dhe frymë mosbindjeje, që dëmtonin në radhë të parë ushtrinë.⁴ Nga ana e saj, gazeta «Samouprava», organ zyrtar i Partisë radikale të Pashiçit, i kushtonte një artikull të veçantë fjalimit të Radiçit, duke e cilësuar atë si «më të madhin skandal nën qeverinë e Davidoviçit.»⁵ Artikulli i likuidonte me pak fjalë «zbulimet mbi ndarjen e Shqipërisë», ndërsa gjithë vëmendjen e përqendronte në të ashtuquajturën «aleancë të Stepan Radiçit me Fan Nolin», e cila sipas gazetës, drejtohej kundër Serbisë.⁶ Për ta bërë më të besueshëm këtë version, shtypi i Beogradit e ngriti tonin në sulmet e tij kundër Shqipërisë. Nga fundi i tetorit gazetat «Politika» dhe «Vreme» përpiqeshin t'i atribuonin qëllime agresive Shqipërisë duke përhapur lajme se atje madje gjoja «po mblidhen legjione kaçakësh për të na goditur», «pas kthimit të Nolit. Gurakuqit dhe Bajram Currit nga Gjeneva po bëhet mobilizim» dhe «një ushtri e përgatitur mirë po dërgohet në kufirin tonë».⁷

Nga ana shqiptare fjalimi i Radiçit pati reagime edhe në nivel zyrtar, edhe në shtyp. Së pari, duhet përmendur një telegram që Zyra e Shtypit në Tiranë u drejtonte më 19

1) Nga kupytrat e shtypit të Beogradit, shtator 1924, në AQSH, fondi 251, 1924, d. 287.

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

4) Teksti i dorëheqjes së gjeneralit Haxhiç datë 8.8.1924. *Po aty.*

5) Gazeta «Samouprava» datë 14.10.1924. Artikulli «Stjepan Radiçi dhe Fan Noli». (Përkthimi shqip në AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 287.)

6) *Po aty.*

7) Gazetat «Politika» dhe «Vreme» datë 30-31.10.1924, Nga kupytrat e shtypit të huaj në AQSH, f. 251, v. 1924, d. 287.

tetor legatave shqiptare në Londër, Paris, Romë, Beograd, Athinë, si dhe gazetave «Journal de Genève» në Gjenevë dhe «Vatra» në Boston.¹ Pasi vihej në dukje se deklaratat e Radiçit kishin shkaktuar «një emocion të madh» në Shqipëri, aq më tepër që Radiçi i pati përsëritur ato në një mbledhje tjetër në Kroaci, në telegram tërhiqej vëmendja në faktin se «deri tani nuk është bërë asnjë përgënjeshtim». Kjo lodër e re «e montuar nga personazhet e diplomacisë së vjetër», — përfundonte telegrami, — nuk mund të mos shkaktonte shqetësim.²

Gazeta «Politika» (e Vlorës) në një koment të saj të datës 23 tetor, e quante fjalimin e Radiçit një akt guximi politik dhe njëkohësisht një gjest dashamirësie kundrejt Shqipërisë, për çka shprehej simpatia për Kroacinë dhe popullin kroat, «një popull zemërmadh, kurajoz dhe i qytetëruar», që i kundërvihej politikës agresive të Pashiçit me shokë.³ Por me këtë rast tërhiqej vëmendja e Qeverisë dhe kërkohet që ajo të vepronte në dy drejtime: së pari, të gjykonte vlerën e vërtetë të «zbulimeve» të Radiçit dhe «të siguronte përkrahje të reja në Ballkan dhe më gjerë» «kundër ëndrrave të zotit Pashiç»; së dyti, të «përgatitej populli që t'i priste ngjarjet me armë në dorë». Nga gjithë përmbajtja e këtij shkrimi krijohet përshtypja se qëllimi i gazetës së Halim Xhelos ishte të bënte thirrje për ta ndjekur me kujdes zhvillimin e situatës, për të kuptuar se cilat ishin qëllimet e vërteta të shteteve fqinjë kundrejt Shqipërisë, për të mos u zënë në befasi.

Me gjithë bujën që bëri (dhe pikërisht për këtë shkak), fjalimi i Radiçit shtroi që atëherë çështjen e shkallës së vërtetësisë së tij. A mund të bëhej fjalë vërtet në ato rrethana, në vitin 1924, për një marrëveshje midis Italisë, Jugosllavisë dhe Greqisë që rikthehej te planet e vjetra të copëtimit të Shqipërisë?

Përgënjeshtimet në Beograd, pas konfuzionit fillestar, nuk vonuan shumë. Kurse në dy kryeqytetet e tjera nuk ka të dhëna që «zbulimet» e Radiçit të kenë patur ndonjë je-

1) Tel. i Zyrës së Shtypit datë 19.10.1924 në AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 287.

2) Po aty.

3) Gazeta «Politika» e Vlorës datë 23.10.1924.

honë të veçantë (po të mos llogaritet një telegram i konsullit italian në Zagreb që i cilësonte si «absurde»¹).

Lidhur me këtë paraqet interes një letër e ministrit shqiptar Mehmet Konicës nga Londra, e datës 25 tetor.² Letra trajtonte në përgjithësi problemin e një propagande më të efektshme në botën e jashtme «për t'i bërë ballë propagandës së shteteve fqinjë». Aty prekej edhe çështja e «zbulimeve» të Radiçit, të cilat, — theksohej, — ishin pritur me mosbesim në shtyp. Përmendej në mënyrë të veçantë një koment i korrespondentit në Romë të gazetës së njohur britanike «Manchester Guardian», koment që «nuk pajtohej as nga forma e as nga përmbajtja» me versionin e përmendur të Zyrës së Shtypit në Tiranë. Duke shprehur mendimin e tij, M. Konica e quante, së pari, «inoportune» deklaratën e Zyrës së Shtypit («në një kohë kur ne po merrim vesh me një grup të huaj për një hua dhe për formimin e bankës»); së dyti, vetë personaliteti i Radiçit nxiste për mosbesim («në qarqet politike dhe diplomatike të këtuishme ai është i njohur si shpifarak dhe gënjeshtar me famë»³).

Pra, një pikëpyetje shtrohet lidhur me «zbulimet» e Radiçit, madje mund të jemi skeptikë dhe të anojmë në tepër nga mendimi i shprehur nga M. Konica në letrën e lartpërmendur: «Që Serbia do copëtimin e Shqipërisë këtë e di gjithë bota, po nuk është gjë e besuar që Italia do këtë copëtim».⁴ Për diplomacinë italiane, në kushtet e reja, objektivi kryesor ishte që Shqipëria të bëhej një «sferë ekskluzive e ndikimit italian» dhe kjo përjashtonte çdo ortakëri, qoftë me Jugosllavinë, qoftë me çdo shtet tjetër në Ballkan.

Por, edhe pse për versionin e Radiçit në tërësi mund të shprehim çdo rezervë, «zbulimet» e tij një pjesë të së vërtetës e kanë. Po të kihet parasysh zhvillimi i mëtejshëm i ngjarjeve, mund të mendohet se ndoshta nuk ishte fjala për një marrëveshje për copëtimin e Shqipërisë, por për disa kontakte për një aksion të kombinuar për rrëzimin e Qeverisë Demokratike jo vetëm me nxitjen e elementit

1) DDI, 7^a serie, vol. III, d. 535.

2) Letër e M. Konicës drejtuar S. Delvinës datë 25.10.1924. AQS, fondi - 251, v. 1924, d. 287.

3) Po aty.

4) DDI, 7^a serie, vol. III, d. 535.

reaksionar brenda vendit, por edhe me angazhimin e forcave ushtarake nga jashtë. Në të vërtetë, në dokumentet e kohës. nuk është gjetur asnjë gjurmë e ndonjë marrëveshjeje zyrtare të Beogradit me Romën e Athinën lidhur me Shqipërinë. Por disa të dhëna të tërthorta sjellin elemente që e plotësojnë dhe e sqarojnë tablonë. Së pari, në pikëpamje ushtarake, vjeshta shënoi kapërcimin në një fazë të re të veprimtarisë së fqinjëve të Veriut, të cilët nga aksionet e izoluarra «ngacmuese» në pika të ndryshme të kufirit kaluan në një ndërhyrje gjithnjë më të hapur e në stil të gjerë. Incidenti i Vermoshit, për të cilin u fol më lart, ishte domethënëse, midis të tjerash, edhe si një paralajmërim se Beogradi nuk do të mjaftohej me organizimin e bandave zogiste, porse ishte i vendosur të vepronte edhe drejtpërsëdrejti me forcat e tij.

Intensifikimi i kontakteve italo -jugosllave

Ajo që ka më tepër rëndësi është se kjo është edhe periudha kur kontaktet italo-jugosllave intensifikohen vazhdimisht duke patur në qendër të vëmendjes pikërisht situatën në Shqipëri. Është koha kur, siç u pa, Roma ka hequr dorë nga çdo përpjekje në favor të njohjes së Qeverisë së Nolit dhe kur, për arsytet që tanimë dihen, ajo ka përcaktuar edhe një qëndrim të prerë kundër saj. Orvatjet e Musolinit për të krijuar një raport të privilegjuar me Qeverinë e Nolit nuk patën sukses, kështu që ai vendosi braktisjen e saj. Por kjo nuk donte të thoshte edhe braktisje e Shqipërisë.

Për këtë qeveria e Romës ndjek me kujdes çdo hap të qeverisë jugosllave. Me sa duket, qëllimi i saj nuk është më të pengojë makinën e intervencionit, që tanimë është vënë në lëvizje, por ta ketë nën kontroll atë dhe të arrijë që ndryshimet, që do të ndodhin në Shqipëri, të mos i presin rrugën politikës së depërtimit italian. Bisedimet që zhvillohen gati pa ndërprerje ndërmjet dy qeverive, nuk i sheshojnë kontradiktat midis tyre në çështjen shqiptare, porse në mënyrë paradoksale nëpërmjet tyre del se rivaliteti zbret në plan të dytë për t'i hapur shtegun një marrëveshjeje të heshtur: secilës palë i lihet dorë e lirë të veprojë me riskun e saj, kurse larja e hesapeve do të bëhet në fund. Dhe

megjithëse barrën kryesore të intervencionit e marr për-sipër Beogradi, Roma është e bindur dhe e vendosur që situatën ta kthejë në fundit në favor të saj. Ky është konkluzioni që mund të nxirret nga gjithë kronika e kontakteve italo-jugosllave në nëntor-dhjetor.

Në literaturën e huaj është shprehur mendimi se ngjarja që shënon hopin cilësor në aksionin kundër Qeverisë Demokratike është dekreti i Këshillit të Lartë i nxjerrë më 14 nëntor për zhvillimin e zgjedhjeve në periudhën prej 20 dhjetorit 1924 (për zgjedhësit e dytë) deri më 20 janar 1925 (për deputetë). Autori italian P. Pastorelli thotë se një vendim i tillë «i marrë me kaq vonesë» «vulosi përfundimisht fatin e Qeverisë së Nolit».¹ Në vend që të hapte rrugë për «legalizimin» e Qeverisë, dekreti që një sinjal alarmi për kundërshtarët e saj, të cilët menduan se erdhi çasti për t'u hedhur në sulm për ta rimarrë pushtetin me forcë. Qarqet drejtuese jugosllave dhe Zogu vendosën që të mos lejonin zhvillimin e zgjedhjeve, të cilat mund të rezervonin edhe ndonjë të papritur.²

Nuk përjashtohet që ky moment të ketë luajtur rol. Por, në të vërtetë, vetë logjika e politikës jugosllave çonte detyrimsht në një përfundim të tillë, aq më tepër kur edhe fuqitë e tjera nuk tregonin se kishin ndër mend t'i ngrinin ndonjë pengesë. Sidoqoftë është fakt se prej gjysmës së dytë të nëntorit gjendja në kufirin shqiptaro-jugosllav keqësohet në mënyrë të dukshme, ndërsa në vetë territorin jugosllav përgatitjet bëhen me ritëm të shpejtuar.

Ky shkallëzim i veprimtarisë kundër Qeverisë së Nolit pasqyrohet jo vetëm në burimet e brendshme shqiptare, por edhe në dokumentet diplomatike italiane. Përgjithësisht këto të fundit paraqesin një interes të veçantë, përderisa janë burimi kryesor që lejon të ndiqen ngjarjet në aspektin diplomatik deri në rrëzimin e Qeverisë Demokratike në fund të dhjetorit. Nga këto dokumente del e qartë se problemi trajtohet kryesisht në plan dypalësh, si një problem italo-jugosllav.

Javën e fundit të nëntorit, ministri italian Duraco, i

1) P. Pastorelli, «Italia e Albania», Firenze, 1967, p. 72. Më hollësisht për dekretin mbi zgjedhjet shih G. Hysi, «Organizimi i shtetit shqiptar dhe lufta politike rreth tij në v. 1920-1924», Tiranë, 1988, f. 248-249.

2) P. Pastorelli, *po aty*.

bënte dy telegrame të njëpasnjëshme Musolinit, me anën e të cilave njoftonte për një rritje të theksuar të «veprimtarive subversive» në Veri, që bashkërendohej me përgatitjet në përmasa të gjëra në territor jugosllav. Ministri italian shtonte se puna intensive që po zhvillohej nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore jugosllave ishte në akord të plotë me autoritetet ushtarake në zonat kufitare dhe, pra, nuk mund të kryhej veçse në zbatim të një programi të paracaktuar e të direktivave të Qeverisë së Beogradit.¹ Natyrisht, këto zhvillime ishin shqetësuese për interesat italiane, aq më tepër që, siç thoshte Duraco, «vepra propagandistike e korruptuese e autoriteteve jugosllave kishte rrezik të minonte disa pozita që Italia mendonte se i kishte siguruar prej kohe sidomos në Shkodër ku, deri kleri katolik, ndonëse i subvencionuar nga Roma, dukej se flirtonte me agjunkturën jugosllave».²

Gjatë nëntorit në Ministrinë e Jashtme të Romës kishin mbërritur edhe sinjalizime të tjera të kësaj natyre dhe sekretari i përgjithshëm Kontarini (Contarini) e pa të nevojshme t'i bënte të ditur legatës italiane në Beograd «për t'i kujtuar qeverisë së atjeshme deklaratat e bëra në qershor» lidhur me mosndërrhyrjen në punët e brendshme të Shqipërisë.³

Me këto udhëzime në dorë, i ngarkuari me punë italian Sola kërkoi dhe mori një takim me vetë ministrin e Jashtëm Ninçiq. Takimi që u bë më 26 nëntor është raportuar prej tij në dy telegrame të po asaj date⁴ Ato janë veçanërisht interesante jo vetëm për informacionin që sjellin, por edhe për interpretimin e fakteve. Para së gjithash, Sola njoftonte se lajmi i përhapur nga autoritetet jugosllave për largimin gjoja të Zogut nga Beogradi për në Paris, ishte një manovër e qarqeve qeveritare për të krijuar përshtypjen se qëndrimi ndaj aksionit që po përgatitej kundër Qeverisë Shqiptare po ndryshonte. Së dyti, ishte një alibi që shtabi i përgjithshëm i ushtrisë jugosllave donte ta kishte në dorë për të dalë «sa më pak i komprometuar në çastin që do të fillonte

1) Dy telegrame të Duracos drejtuar Musolinit datë 23.11.1924, DDI 7^a serie, v. III, d. 579-580.

2) *Po aty*.

3) P. Pastorelli, *vep. cit.*, p. 73.

4) Dy tel. të të ngarkuarit me punë Sola datë 26.11.1924, DDI, 7^a serie, vol. III, d. nr. 588, 589.

sulmi», ku pritej të merrnin pjesë aktive edhe reparte të rregullta të ushtrisë jugosllave.¹

Tërheq veçanërisht vëmendjen fakti që, nga njëra anë, përfaqësuesi italian i deklaroi ministrit jugosllav se çdo angazhim i drejtpërdrejtë i qeverisë së tij në përgatitjet e «partizanëve të Zogut» ishte në kundërshtim me zotimet që ai vetë kishte marrë në qershor (deklarata italo-jugosllave për mosndërhyrje në ngjarjet e brendshme në Shqipëri); nga ana tjetër, ai e shikonte me vend të theksonte se Italia nuk kishte aspak ndër mend «të dilte si protektore e kësaj apo asaj qeverie shqiptare».²

Qysh përpara kësaj Beogradi duhet të ketë patur të dhëna për ftohjen e marrëdhënieve të Romës me Qeverinë e Nolit, por prej deklaratës së Solas, Ninçici kuptoi se aksioni i planifikuar për përmbysjen e gjendjes në Shqipëri nuk do të gjente ndonjë pengesë të madhe në Romë. Kjo e nxiti atë t'i hapë letrat dhe të pranojë se «partizanët e A. Zogut subvencionohen nga qeveria jugosllave» dhe se «të gjithë refugjatët (zogistë) janë përqendruar në njësi (të organizuara) në afërsi të kufirit shqiptar».³

Në një orvatje evidente për të gjetur një gjuhë të përbashkët me Romën, Ninçici i tha përfaqësuesit italian se ai kishte prova që Qeveria e Fan Nolit kishte hyrë në marrëveshje me qeverinë e Moskës.⁴ Ai e përshkroi gjendjen me tone alarmante kur shtoi se «ishte fjala për një plan të tërë me pikësynim rrethimin e Jugosllavisë, të cilin qeveria e Moskës po përpiquej ta realizonte me nxitjen e Radiçit për të shkaktuar turbullira në kufirin shqiptar e bullgar dhe madje rumun».⁵ Një orvatje për ta sensibilizuar Romën rreth «rrezikut bolshevik» që vinte nga Lindja, ka qenë edhe informacioni «konfidencial» që ministri i Jashtëm jugosllav i serviri përfaqësuesit italian se «10 mijë pushkë ishin blerë tani së fundi nga Shqipëria në Itali me paratë e Moskës».⁶

Interes edhe më të madh paraqet telegrami i dytë i Solas i po asaj date, që është vazhdim i të parit. Nuk është

1) Tel. i Solas 26.11.1924, *Po aty. d. n° 588.*

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

4) *Po aty.*

5) *Po aty.*

6) *Po aty.*

e rastit që ky telegram është veçuar dhe i është drejtuar «kabinetit sekret» të Musolinit.¹ Aty bëhet fjalë për disa sigurime që ka dhënë Ninçiçi. Veç deklaratave të zakonshme se Jugosllavia do t'i përmbahej marrëveshjes së arritur me Italinë për mosndërrhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë, vjen gati e papritur rezerva se «në rast se ndonjë aksion do të bëhej i domosdoshëm në të ardhmen, qeveria (jugosllave) nuk do ta ndërmerre atë pa u konsultuar më parë me qeverinë italiane dhe pa një shkëmbim të plotë mendimesh me të».² Pra, Ninçiçi, nuk mund ta shprehte më qartë dëshirën dhe gatishmërinë e tij për një marrëveshje të re midis dy qeverive, një marrëveshje që do të konsakronte ndryshimin e kursit: nga mosndërrhyrja në një «aksion» eventual të bashkërenduar. Nuk mund të kishte tjetër kuptim veç atij të ofertës që i bëhej Romës edhe deklarata e Ninçiçit se «qeveria jugosllave është e mendimit se çdo gjë që ka të bëjë me Shqipërinë u përket vetëm dy vendeve: Italisë dhe Jugosllavisë».³ Kjo ishte edhe arsyeja që Beogradi, ndërsa kishte patur gjithnjë kujdes që të mbante kontakt të ngushtë me Italinë lidhur me çështjen shqiptare nuk e shihte të nevojshme të bënte të njëjtën gjë me qeverinë greke.⁴ Përfaqësuesi italian e kapi drejt idenë e ministrit jugosllav dhe u bë interpret i saj pranë Musolinit, duke hedhur fjalën pikërisht për një marrëveshje të re midis dy qeverive në trajtën e shkëmbimit të notave.⁵

Takimi Musolini-Ninçiç

Diplomacia italiane, që deri atëherë kishte qenë disi në pozita pritjeje, mendoi se ishte momenti për t'u hedhur në veprim. Pikërisht këtu e zë fillin inisiativa e Romës për një takim Musolini-Ninçiç. Në historiografinë italiane kjo është paraqitur si një reagim i shqetësuar i Musolinit përballë aksionit të autoriteteve jugosllave, që tanimë po merrte

1) Tel. 1 Solas datë 26.11.1924. *Po aty*, d. n° 589.

2) *Po aty*.

3) *Po aty*.

4) *Po aty*.

5) *Po aty*, P. Pastorelli, *vep. cit.*, *p. 75.

forma konkrete.¹ Tani shtypi zyrtar jugosllav bënte thirrje në kor për «futje në Shqipëri».² Pa dyshim shqetësimi ishte, vecse jo për fatin e Qeverisë Demokratike e as për shkeljen flagrante të normave ndërkombëtare, por vetëm për të mos lejuar që të komprometoheshin interesat italiane.

Kështu Musolini në udhëzimet që i jepte të ngarkuarit me punë, Sola, më 28 nëntor, ndërsa e quante «të parakohshëm» «çdo vendim lidhur me oportunitetin e shkëmbimit të notave», shtronte drejtpërdrejt nevojën e bisedimeve midis tij dhe Ninçicit, në rast se ky do të vinte në kryeqytetin italian për të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të Lidhjes së Kombeve të caktuar për më 8 dhjetor. Ky, — theksonte Musolini, — mund të ishte një rast i mirë «për një shqyrtim paraprak të kësaj çështjeje komplekse».³

Ninçici e pranoi ftesën dhe mbërriti në Romë më 10 dhjetor.⁴ Qëllimi i shpallur zyrtarisht ishte pjesëmarrja në punimet e Këshillit të Lidhjes së Kombeve, por të gjitha të dhënat tregojnë se thelbi i misionit të tij në Romë ishin bisedimet me Musolinin rreth operacionit që po përgatitej kundër Shqipërisë.

Është një gjë krejt e papritur që, sikurse është thënë edhe në një rast tjetër, dokumentet italiane, që zakonisht i pasqyrojnë gjerësisht kontaktet italo-jugosllave, për takimin e Musolinit me Ninçicin mbajnë heshtje të plotë, ndonëse bisedimet midis tyre u zhvilluan jo një herë, por disa herë (deri në largimin e Ninçicit më 13 dhjetor).⁵ Historiani italian P. Pastorelli, thotë se «për fat të keq, rreth zhvillimit të bisedimeve në dokumentacion nuk ka asnjë gjurmë».⁶

Sigurisht fakti në vetvete është kuptimplotë. Ai lejon të mendohet se ka patur një prapaskenë. Duhet konsideruar pak i besueshëm mendimi se, me gjithë zbrazëtirën në burimet e drejtpërdrejta, deklaratat e lëshuara në mbarim të takimit ose «zhvillimet e mëtejshme të çështjes shqiptare»

1) P. Pastorelli, *vep. cit.*, p. 76

2) *Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike I-1971*. Artikull i V. Vinaverit, f. 77. Gazetat «Politika». «Samouprava», «Rëç» ishin veçanërisht aktive në nëntor-dhjetor në fushatën për nxirjen e kursit agresiv kundrejt Qeverisë së Nolit. *Po aty*.

3) Tel. i Musolinit datë 28.11.1924, DDI 7^a serie, vol. III, d. nr. 593.

4) P. Pastorelli, *vep. cit.*, p. 76.

5) P. Pastorelli, *vep. cit.*, p. 79.

6) *Po aty*.

jamin «elemente të mjaftueshme» për të nxjerrë të vërtetën e plotë.¹

Në të vërtetë komunikata që u lëshua në Romë më 13 dhjetor, në përfundim të takimit, nuk bën gjë tjetër veçse përsërit me fjalë të përgjithshme angazhimin e dy qeverive për të mos ndërhyrë në punët e brendshme të Shqipërisë, angazhim të cilin ato e kishin marrë me deklaratën e përbashkët të qershorit.² Komunikata krijon përshtypjen e rreme se asgjë nuk kishte ndryshuar në qëndrimin e Romës e të Beogradit në çështjen shqiptare.

Mirëpo, në fondet e Ministrisë së Jashtme shqiptare të kohës gjenden dokumente që tregojnë jo vetëm se Roma i ka kthyer krahët Qeverisë së Nolit, por se ajo ka arritur në njëloj ujdie të heshtur me Beogradin: ujdia është pikërisht ajo e Ninçicit me Musolinin në takimin e Romës, prej nga Ministri i Jashtëm jugosllav, sipas çdo gjase, u largua me bindjen se intervencioni nuk do të gjente ndonjë pengesë të drejtëpërdrejtë nga ana e Italisë.³

Ky është konkluzioni i vetëm që mund të nxirret nga telegramet që i ngarkuari me punë shqiptar i ka dërguar qendrës gjatë ditëve ose menjëherë pas takimit të Musolinin me Ninçicin.

Në telegramin e parë të datës 15 dhjetor, ai njoftonte për bisedën që kishte patur në Pallatin Kixhi (Palazzo Chiggi, selia e Ministrisë së Jashtme në atë kohë) me sekretarin e përgjithshëm Kontarini, të cilit i kishte folur për përgatitjet e sulmit nga ana e Zogut me përkrahjen e autoriteteve jugosllave. Kërkesës së tij për t'ia shtruar çështjen Ninçicit duke i tërhequr vëmendjen «për një aksion të tillë subversiv që synon përmbysjen e Qeverisë së tanishme shqiptare», funksionari i lartë italian i dha një përgjigje krejt të vakët. Madje, ai duket se merrte anën e Beogradit, kur përsëriste tezën se «ndoshta qeveria jugosllave

1) *Po aty*, p. 80.

2) *Po aty*, p. 81.

3) Autori i këtyre radhëve në një artikull studimor të viteve 60 ka shprehur mendimin se kontradiktat italo-jugosllave në çështjen shqiptare kanë qenë kaq të thella saqë çfarëdo marrëveshjeje midis tyre duhej përjashtuar a priori lidhur me intervencionin në dhjetor. Por thellimi i mëtejshëm në materiale e sidomos dokumentet në fondin e Ministrisë së Jashtme shqiptare të kohës, e kanë shtyrë autorin ta rishikojë pikëpamjen e tij në këtë çështje. A. Puto, *Çështja e njohjes ndërkombëtare të qeverisë demokratike të 1924-s*. «Studime historike», 1964, nr. 1.

dc ta justifikonte përkrahjen që i jep Zogut duke përmendur veprimtarinë e Komitetit të Kosovës, i cili në marrëveshje me Sovjetët ndihmon qeverinë shqiptare të përgatitë një sulm kundër Jugosllavisë». ¹ I ngarkuari me punë e mbyllte këtë telegram të parë me këto fjalë: «Sipas informatave që kemi, Ninciçi është përpjekur ta bindë Musolinin që të sigurojë neutralitetin e Italisë gjatë aksionit që po përgatitet për ta risjellë Zogun në fuqi». ²

Në telegramin e dytë të datës 17 dhjetor, përfaqësuesi shqiptar raportonte mbi shpjegimet që i ishin dhënë rreth takimit të Musolinit me Ninciçin. Arsyetimi ndjek po atë linjë: Musolini i tërheq vëmendjen Ninciçit mbi bandat e organizuara në territorin jugosllav, kurse ministri jugosllav, së pari, përpiqet ta minimizojë çështjen, së dyti, vë në dukje «tendencën e favorshme për komunizmin të Qeverisë së Fan Nolit që kërcënon paqen në Ballkan». ³ Nga ana e tij, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme italiane i dha të kuptonte përfaqësuesit shqiptar se «qeveria italiane po bën ç'është e mundur për ta bindur qeverinë jugosllave që të heqë dorë nga synimet e saj armiqësore kundrejt Shqipërisë», porse... «megjithatë nuk mund të marrë armët për të mbrojtur kufijtë e saj». ⁴ Nga kjo bisedë, i ngarkuari me punë i Shqipërisë dilte me «përshtypjen se Italia nuk dëshiron në asnjë mënyrë që ta prishë me serbët, duke ndërhyrë energjikisht në favorin tonë». ⁵

Telegramet nga Roma mbërrinin njëri pas tjetrit, aq më tepër që lajmet që vinin nga kufiri shqiptaro-jugosllav flisnin për një sulm në stil të gjerë përballë të cilit Italia tani duhej të përcaktonte një qëndrim më të qartë. Më 18 dhjetor, i ngarkuari me punë, telegrafonte nga Roma për kritikën që i bëhej qeverisë nga gazeta e rëndësishme e kohës «Mondo» lidhur me atë që ajo quante «apatia italiane që favorizonte synimet imperialiste të Serbisë». ⁶ Gazeta shkonte edhe më tej në komentin e saj kur thoshte

1) Tel. i të ngarkuarit me punë nga Roma datë 15.12.1924. AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 225.

2) Po aty.

3) Tel. i të ngarkuarit me punë nga Roma datë 17.12.1924. AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 225.

4) Po aty.

5) Po aty.

6) Tel. i të ngarkuarit me punë nga Roma datë 18.12.1924. AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 225.

se ajo që po ndodhte në kufirin shqiptar, hidhte një dritë të re edhe mbi zërat që ishin përhapur (në tetor) mbi «një marrëveshje të fshehtë në dëm të Shqipërisë». «Mondo» e ftonte qeverinë e Romës «të provonte të kundërtën, duke zhvilluar një aksion diplomatik të ngjeshur në Beograd»¹

Një sqarim më të plotë të qëndrimit të Italisë na jep telegrami i fundit që i ngarkuari me punë dërgoi nga Roma më 20 dhjetor. Në Ministrinë e Jashtme në Tiranë e kanë cilësuar atë si «telegram me rëndësi të veçantë». Në të vërtetë ai është një raport përmbledhës i «bisedës së gjatë» që përfaqësuesi shqiptar pati me Kontarinin, gjatë së cilës nuk mund të mos dilte në plan të parë agresioni jugosllav kundër territorit shqiptar. Kërkesës së të ngarkuarit me punë që qeveria italiane «të ndërhynte në Beograd për ta pushuar aksionin e armatosur serb», Kontarini iu përgjigj me këto fjalë: «Duke na dëbuar nga Vlora, ju na hoqët mundësinë për t'ju ndihmuar në mënyrë efikase. Në situatën e tanishme ne nuk mund të bëjmë për ju asgjë më tepër se ç'mund të bënim për çfarëdo vendi tjetër, si p.sh. për Belgjikën, Holandën».² A mund të thuhej më qartë se Italia nuk kishte ndër mend të ndërmernte asgjë, dhe a nuk mund të shikohet kjo si një provë e tërthortë se duhej të ishte arritur në një lloj marrëveshjeje verbale midis qeverisë italiane dhe asaj jugosllave. Ky mendim përforcohet edhe më shumë kur lexojmë në telegramin e përmendur, se Kontarini u përpoq haptazi të justifikonte veprimet e Beogradit, madje me një arsyetim që kapërcente çdo logjikë se «bandat ishin organizuar gjatë kohës që ishte në fuqi qeveria e Davidoviçit»³ (në nëntor erdhi përsëri në fuqi Pashiçi — A.P.), kështu që «Ninçiçi u ndodh përpara faktit të kryer».⁴ Së këtejmi rridhte se përgjegjësia për çka ndodhte tani në kufirin shqiptar binte mbi qeverinë e mëparshme dhe jo mbi atë që tani ishte në fuqi në Beograd. Kurse është krejt e qartë se në politikën jugosllave kundrejt Shqipërisë ka patur një vazhdimësi që nuk është prekur nga asnjë ndryshim qeverie. Për qëndrimin e rezervuar të Romës flet edhe vërejtja e Kontarinit se «ndoshta njoftimet (e palës shqiptare) janë të ekzagje-

1) *Po aty.*

2) Tel. i të ngarkuarit me punë nga Roma datë 20.12.1924, në AQSH, f, 251. v. 1924, d. 225.

3) *Po aty.*

4) *Po aty.*

ruara ashtu si në rastin e ngjarjes së Vermoshit» në shtator.¹

Nga kjo bisedë, i ngarkuari me punë ripohonte mendimin e dhënë edhe më parë se qeveria italiane nuk donte «ta prishte me serbët të cilët i konsideronte si aleatët e saj të sigurtë».² Por edhe më interesant ishte supozimi i tij se «ndoshta duke e lënë gjendjen në Shqipëri vazhdimisht të turbullt, qeveria italiane shpresonte të merrte një mandat mbi të nga ana e Lidhjes së Kombeve»³, gjë që siç dihet, Italia nuk arriti ta merrte në Konferencën e Paqes pas Luftës I. Sigurisht, duke patur në mend vendimin e Kongresit të Lushnjës për të mos pranuar asnjë formë vartësie të Shqipërisë kundrejt kujtdoqoftë, duke marrë parasysh edhe kundërshtimin e Qeverisë së Nolit për të hyrë në «një raport të privilegjuar» me Italinë, një nga funksionarët e Pallatit Kixhi i dha të kuptonte të ngarkuarit me punë se «Shqipëria i kishte vetë në duart e saj mjetet për të shpëtuar përgjithmonë nga lakmitë e të huajve», mjaftonte «të kërkonte zbatimin e vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1921», pra të pranonte një formë sado të kamufluar të protektoratit italian.⁴

Faktet e mësipërme vërtetojnë mendimin e të ngarkuarit me punë «se më tepër se sa një ndarje (të Shqipërisë) në marrëveshje me Jugosllavinë», qeveria italiane ka synuar që t'i lerë ngjarjet të rrukullisen, të përfitojë nga një situatë e turbullt për të vepruar më aktivisht në çastin e duhur dhe për ta kthyer më në fund zhvillimin e ngjarjeve në favor të saj.

Nuk është e tepërt të thuhet se edhe vetë dokumentet italiane, ndonëse nuk shprehen drejtpërsëdrejti, megjithatë japin disa elemente të mjaftueshme që e konfirmojnë versionin që u përshkrua më lart. Në radhë të parë, duhet përmendur telegrami që Musolini i dërgonte ministrit italian në Durrës më 10 dhjetor, pikërisht ditën e parë të takimit me Ninçin në Romë.⁵ Arsyetimi ishte po ai: Shqi-

1) Tel. i të ngarkuarit me punë nga Roma, datë 20.12.1924 në AQSH, f. 251, v. 1924, d. 225.

2) Po aty.

3) Po aty.

4) Po aty.

5) Tel. i Musolinit drejtuar Duracos datë 10.12.1924, DDI, 7^a serie vol. III, d. nr. 609.

përia po korrite atë që kishte mbjellë, po provonte rezultatet e kundërshtimit të saj ndaj synimeve të Italisë. Kryetari i fashizmit italian shkruante, midis të tjerash, edhe këto: «Që Shqipëria do të arrinte një ditë në një gjendje kritike, kjo duhej pritur përderisa ky shtet për hir të një ndjeshmërie të tepëruar (aluzioni është për aspiratën për pavarësi — A.P.) deshi të sakrifikonte mbështetjen efektive që në një situatë të veçantë (si kjo), do të ishte në gjendje t'i jepte Italia».¹ Musolini nuk përjashtonte mundësinë që në bisedimet me Ninçin të flitej edhe për Shqipërinë. Por vinte në dukje se rrethanat në krahasim me qershorin e kaluar (kur të dy qeveritë kishin lëshuar deklaratën për mosndërrhyrje në punët e brendshme shqiptare), kishin ndryshuar, «gjendja në atë vend ishte keqësuar në mënyrë të dukshme», kështu që ishte tepër vështirë që nga ana italiane, çështja të shtrohej në të njëjtat terma sikur atëherë.² Këtu tërheqin vëmendjen këto dy momente: së pari, Musolini «nuk përjashtonte mundësinë» që ta bisedonte çështjen në takimin me Ninçin, çka tregonte se nuk do të kishte ndonjë impenjim të veçantë nga ana italiane; së dyti, nuk mund të përsëritej skenari i qershorit, se Roma, edhe pse mund të lëshoheshin si më parë deklarata dypalëshe, bënte një tërheqje, nuk kishte ndër mend të ndërmernte asgjë konkrete, do t'i linte punët të ndiqnin rrugën e tyre (sigurisht derisa të arrihej në një pikë kritike për interesat italiane).

I njëjti konkluzion del edhe nga dokumente të tjera të atyre ditëve, qoftë nga burime shqiptare, qoftë nga ato italiane.

Në parlamentin italian ishin bërë disa interpelanca lidhur me ngjarjet në kufirin shqiptaro-jugosllav, por qeveria nuk kishte dhënë asnjë përgjigje.³ Kuptimplotë është edhe refuzimi kategorik nga ana e Italisë, i kërkesës që Qeveria Demokratike i drejtoi Romës për blerje municionesh aty nga mesi i dhjetorit.⁴ Në shkresën që i ishte paraqitur për këtë qëllim (ku thuhej se «qeveria shqiptare kishte nevojë

1) *Po aty*.

2) *Po aty*.

3) Tel. i të ngarkuarit me punë nga Roma datë 20.12.1924 në AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 225*.

4) AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 251*. Në të vërtetë kërkesa për municione ishte bërë edhe më parë, sidomos nga fundi i shtatorit dhe fillimi i tetorit, por ishte lënë në heshtje. Shih DDI, 7^a, *serie*, vol. III, d. nr. 521, 524.

urgjente për municione për të prapsur agresionin jugosllav»), Musolini, me dorën e tij, shënonte: «të arkivohet kjo letër që përmban një kërkesë të papranueshme dhe të pamundur». ¹ I indinjuar, Noli ngarkoi të ngarkuarin me punë në Romë të paraqitej në Ministrinë e Jashtme dhe të deklaronte se «një akt i tillë mund të konsiderohet si jo miqësor kundrejt Shqipërisë, përderisa qeveria serbe furnizon me municione të të gjitha llojeve (forcat reaksionare: A.P.) dhe vetë po kryen veprime dhune kundër Shqipërisë». ²

Dokumentet që u sollën, burimet e dyanshme plotësojnë njëri-tjetrin dhe japin një ide pak a shumë të saktë të përmbajtjes së bisedimeve Musolini-Ninçiq dhe të rezultatit të tyre. Sikurse u tha që në fillim ato nxjerrin në shesh një fakt të padyshimtë se ndonëse nuk mund të flitet për një pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të Italisë në aksionin për rrëzimin e Qeverisë së Nolit, Jugosllavia arriti të siguronte një pëlqim në heshtje, një «visto» nga ana italiane. Por mosveprimi dhe pasiviteti i Romës në këto ngjarje nuk donte të thoshte aspak dorëheqje. Diplomacia italiane bëhej gati të merrte përsëri iniciativën në Shqipëri pas rrëzimit të Qeverisë Demokratike.

1) Shënim i Musolinit anash shkresës datë 19.12.1924, DDI, 7a serie, vol. III, d. nr. 525.

2) Tel. i Nolit drejtuar legatës në Romë. AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 251.

Kapitulli VIII

DEMOKRACIA E RRETHUAR

Fillimi i agresionit

Në të hyrë të muajit dhjetor Revolucioni Demokratik kishte arritur në një gjendje rrethimi të plotë. Nuk mbetej veç të fillohej operacioni që do të çonte në rrëzimin e Qeverisë së Nolit. Ky ishte përfundimi logjik i një veprimtarie komplekse politike, ushtarake, diplomatike, që zgjati disa muaj me radhë.

Siç u tha edhe më sipër, është vështirë të përcaktohet me saktësi një datë që të shënojë pikënisjen e intervenionit të armatosur kundër Shqipërisë. Goditjet e bandave në pika të ndryshme të kufirit nuk kishin pushuar asnjëherë, por prapëseprapë ishin veprime të shkëputura me karakter sporadik që kishin si qëllim imediat të mos lejohej konsolidimi i pushtetit të ri demokratik.

Do të thoshim se shenjat paralajmëruese të operacionit në stil të gjerë i kemi në javën e dytë të nëntorit, atëherë kur nga Beogradi u përhapën zëra mbi largimin e Zogut për në Paris. Lajmi u transmetua menjëherë edhe në Tiranë¹, edhe në Romë.² Atij iu dha publicitet i gjerë në shtyp. Gazetat shkruan një herë se Zogu u largua për në Francë bashkë me familjen. Pastaj u njoftua se gjatë rrugës për në Paris, kishte ndalur në Davos të Zvicrës, duke qenë i shoqëruar nga katër oficerë, kurse familjen e kishte lënë në Beograd te Ceno beg Kryeziu (kunati i tij). Gazeta «Politika» dha këtë version: para se të nisej, Zogu u takua edhe me kryeministrin Pashiç, edhe me mbretin Aleksandër. Pastaj i bëri këtë deklaratë «Politikës»: «Nisem për në Paris

1) Tel. i legatës shqiptare datë 18.11.1924 në AQSH, f. 251, v. 1924, d. 260.

2) Tel. i ministrit Bodrero datë 18.11.1924 sipas P. Pastorelli, *vep. cit.*, p. 74.

që të kaloj atje dimrin. Falenderoj qeverinë jugosllave, e cila mundi të kuptojë dhe të çmojë patriotizmin tonë të singertë».¹ Pastaj Zogu sikur humbi në zbrazëtitirë: nuk u bë fjalë as për nisjen e tij nga Beogradi, as për mbërritjen në Paris. Deri në fund të nëntorit u mbajt heshtje e plotë.

Sidoqoftë, që në lajmin e parë që u përhap mbi udhëtimin e Zogut në Francë, e shtyrë nga dëshira për të marrë vesh qëllimet e tij, Ministria e Jashtme shqiptare kërkoi menjëherë informata nga legata e saj në kryeqytetin francez. Në përgjigjen që jepte me më se dy javë vonesë, (në fillim të dhjetorit), i ngarkuari me punë Xhemil Dino thoshte se jo vetëm që nuk kishte asnjë të dhënë për mbërritjen e Zogut atje, por edhe i bënte vërejtje ministrit të Jashtëm S. Delvinës se përse duhej të shqetësohej nga një udhëtim i tillë.²

Në të vërtetë doli se largimi i Zogut nga Beogradi ishte vetëm një montaturë. Ishte një orvatje e llogaritur për të krijuar përshtypjen se Zogu, si lider i kundërrevolucionit, po tërhiqej nga «vija e parë», po hiqte dorë nga aksioni në të cilin ai ishte angazhuar me kohë. Shpresohet kështu që Qeveria shqiptare dhe gjithë opinioni publik të viheshin në gjumë pikërisht në çastin kur plani pritej të vihej në zbatim në stil të gjerë.

Mirëpo legata shqiptare e Beogradit arriti të siguronte informata të sakta. Burimi i tyre ishte «një damë», emri i së cilës nuk është përmendur asnjëherë, por që, — siç thuhej, — «kishte marrëdhënie intime me Ahmetin».³ Në telegramin e parë ministri Kolonja e paraqiste «damën» e panjohur si një femër e cila, nëpërmjet «marrëdhënieve intime», kishte mundur të hynte deri në sekretet e planit të operacionit që po fillonte kundër Shqipërisë. Para së gjithash, ishte ajo që dha informatën se largimi i Zogut ishte një bllof dhe se ai që prej 1 dhjetorit «ndodhej i fshehur

1) Sipas gazetës «*Bashkimi*» datë 2.12.1924.

2) Letër e të ngarkuarit me punë Xh. Dino ministrit të Jashtëm S. Delvinës datë 4.12.1924. AQSH, *fondi 25, v. 1924, d. 131*. Xh. Dino nuk i kishte fshehur asnjëherë ndjenjat e tij kundër Qeverisë Demokratike, por vendimi për shkarkimin e tij nga detyra u mor vetëm në dhjetor. Sipas gazetës «*Bashkimi*» datë 2.12.1924, «Thonë, — shtonte gazeta, — se Xh. Dino ka qenë në marrëveshje me Ahmetin».

3) Tel. i legatës nga Beogradi datë 3.12.1924. AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 257*.

në Beograd». ¹ Pastaj ajo tregoi disa hollësi të planit të veprimit të Zogut: më 5 dhjetor do të nisej për në Prizren, kurse më 10 dhjetor do të fillonte operacionin në pika të ndryshme të kufirit. Dama pa emër premtoi se do të jepte një informacion të plotë lidhur me operacionin e forcave ushtarake dhe se do ta mbante legatën shqiptare në korrent për çdo gjë që do të ndodhte. Kuptohet se një element i tillë nuk mund të shtyhej veçse nga motive fitimi, prandaj ajo kërkoi si paradhënie shumë e majme prej 20 mijë dinarësh. ² Si këst të parë legata i dha 12 mijë dinarë, por ministri Kolonja shtronte çështjen që të kishte në dispozicion një fond të posaçëm «për të kënaqur damën», jo vetëm për t'i paguar restin, por edhe për t'iu përgjigjur me shpërblimin përkatës çdo shërbimi të mëtejshëm. Çdo përçapje pranë qeverisë jugosllave ishte e tepërt, «e padobishme», «përderisa ajo fshihte prezencën e Ahmetit në Beograd», prandaj ky mbetej kanali i vetëm nëpërmjet të cilit mund të siguroheshin informatat e nevojshme. ³

Një telegram i dytë i po asaj date ishte plotësim i të parit: i njëjti burim informonte se në operacionin kundër Shqipërisë, përveç «mercenarëve shqiptarë të rekrutuar» në të dyja anët e kufirit, do të përdreshin «edhe ushtarë dhe oficerë rusë» (të bardhë) si dhe «forca ushtarake serbe». ⁴ Jepeshin po ashtu edhe drejtimit kryesore të zhvillimit të operacionit: nga Prizreni në drejtim të Kukësit, nga kufiri malazez në drejtim të Shkodrës, dhe nga ana e Ohrit në drejtim të Shqipërisë së Mesme. Këto nuk përkojnë plotësisht me planin e veprimit që u zbatua efektivisht (shih më poshtë), porse si indikacione paraprake ishin më se të mjaftueshme. Veç asaj, shtohet se do të bëheshin përpjekje që, përpara fillimit të operacionit, të shpërthente «një kryengritje në Tiranë, Shkodër dhe Krujë». Përsëritej edhe një herë se si datë e fillimit të operacionit mbetej 10 dhjetori. ⁵

Në ditët e mëpastajme, në Ministrinë e Jashtme në Tiranë, vijnë edhe nja dy telegrame të tjera që tregojnë se legata e Beogradit vazhdoi të mbante lidhje edhe për disa

1) *Po aty*, Gazeta «*Bashkimi*» e datës 9 dhjetor njoftonte po ashtu se «udhëtimi i Zogut për në Zvicër ka qenë vetëm një manevër».

2) *Po aty*.

3) *Po aty*.

4) Tel. i dytë i legatës nga Beogradi datë 3.12.1924. *Po aty*, f. 115.

5) Tel. i legatës nga Beogradi datë 3.12.1924, *AQSH*, f. 251. v. 1924, d. 257.

ditë me damën e panjohur. Prej saj merrej vesh se Ahmeti nuk ishte nisur në datën 5 dhjetor, se do «të qëndronte ende i fshehur», se më 4 dhjetor ishte nisur për në Gjakovë Ceno beg Kryeziu «me një shumicë të madhe parash» për rekrutim mercenarësh. Ahmeti po qëndronte në Beograd «për të kompletuar detajet» e operacionit dhe do të nisej për në Prizren sapo të merrte lajm prej Ceno beg Kryeziut se çdo gjë ishte gati. Vetë sulmi duhej të fillonte midis 10 dhe 15 dhjetorit.¹

Në të vërtetë goditjet e para në kufirin e veriut ndodhën pas 10 dhjetorit dhe pikërisht atëherë erdhën në Tiranë edhe njoftimet e legatës shqiptare se Zogu ishte nisur më në fund për në Prizren pasi «të gjitha përgatitjet ishin bërë».²

Luftimet në Veri

Në prag të sulmit gjendja nga pikëpamja ushtarake paraqitej pak a shumë si vijon. Legata shqiptare e Beogradit i pati dhënë informata të mjaftueshme qeverisë në Tiranë, informata nga të cilat nuk ishte vështirë të kuptohej se përgatitjet që po bëheshin në Jugosllavi kishin hyrë në një fazë të re, atë të një sulmi në shkallë të gjerë për rrëzimin e qeverisë. Qeveria e Beogradit, edhe pse nuk kishte asnjë vështirësi të përsëriste deklaratat për asnjëherësi dhe mosndërhyrje, lejonte që përgatitjet tani të zhvilloheshin hapur, përpara syve të të gjithëve. Prandaj në Beograd ishin çelur një numër qendrash rekrutimi, në të cilat shkonin për t'u regjistruar gjithë ata që dëshironin të merrnin pjesë si mercenarë (për 4 napolona) në ekspeditën që po organizohej kundër Qeverisë shqiptare. Në radhët e këtij tabori futeshin, veç bashibozukëve të ikur bashkë me Zogun, fundërrina nga popullsia shqiptare e Kosovës, aventurierë pa atdhe të tipit të «Legjionit të huaj».³

Të shqetësuar nga lajmet që vinin nga Beogradi, një

1) Tel. i legatës nga Beogradi datë 5.12.1924. *Po aty, d. 257, f. 164.*

2) Dy tel. të legatës nga Beogradi datë 10.12.1924. *Po aty, d. 257.*

3) Për përgatitjen e sulmit dhe vetë zhvillimin e luftimeve kanë të dhëna të vlefshme mjaft shkrime të veteranëve të Lëvizjes së 1924-s. Shih «Revolucioni i qershorit 1924 në kuftimet e bashkë-

grup oficerësh patriotë, që në fund të nëntorit, i patën propozuar Qeverisë që të merrte disa masa ushtarake urgjente: të përqendrohej një forcë prej 3000 vetash në Peshkopi, një tjetër prej 5000 vetash të qëndronte në gatishmëri në zonën e Tiranës, të dërgohej një repart në rrethin e Matit, të formoheshin disa reparte rezervë që të ishin gati për veprim në çdo moment.

Mirëpo dobësitë më të mëdha të Qeverisë së Nolit u dukën në fushën e mbrojtjes. Udhëheqja ushtarake nuk ishte në lartësinë e detyrave që duhej të përballonte: Ministria e Luftës dhe Shtatmadhoria¹ nuk morën asnjë masë, as u caktua një komandant i përgjithshëm i operacionit ashtu siç e kërkonte një situatë e tillë emergjence². Qeveria, duke e nënvleftësuar edhe në këtë rast rrezikun, dukej e përqendruar më shumë në organizimin e fushatës së zgjedhjeve. Ajo nuk mori qoftë edhe disa masa administrative elementare: nuk zëvendësoi prefektët e pazotë dhe jo besnikë në zonat kufitare të kërcënuara, nuk çarmatosi elementët që ndodheshin afër kufirit dhe që dihej se ishin me Zogun, nuk i preku fare krerët bajraktarë që mbanin gjithnjë lidhje me të. Me vonesë të madhe nga qendra u dhanë udhëzime për thirrjen e rezervistëve dhe të vullnetarëve.³

Organizatorët e sulmit përfituan nga mosveprimi e ngathtësia e Qeverisë në Tiranë. Ata merrnin plot informata nga përfaqësuesit diplomatikë e konsullorë si dhe nga agjentët e fshehtë jugosllavë në Shqipëri, që thoshin se në anën shqiptare të kufirit vazhdonte po ajo gjendje konfuze dhe po ajo frymë shkujdesjeje. Kjo, sigurisht, u jepte dorë nxitësve të sulmit që ta hartonin planin e veprimit dhe ta kryenin me lehtësi.

Llogaritej që numri i përgjithshëm i mercenarëve të

*kohësve,» Tiranë, 1974; S. Shpuza, «Revolucioni demokratiko-borgjez i qershorit 1924 në Shqipëri», Tiranë, 1959 etj. Megjithatë një tablo më e plotë e intervencionit, e forcave pjesëmarrëse dhe e situatës ushtarake gjendet në një shkrim të gjatë të botuar në gazetën e KONARES «Liria kombëtare» datë 5.12.19 gusht 1925. Mjaft të dhëna ndonëse jo të plota, gjenden në AQSH, *fondi i Ministrisë së Brendshme, v. 1924, d. 98.**

1) Shef i shtatmadhorisë vazhdonte të ishte edhe pas qershorit majori Bajram Fevziu, i njohur për tendencat zogiste (S. Shpuza, *vep. cit. f. 30.*)

2) AQSH, *Fondi i Ministrisë së Brendshme, v. 1924, d. 95.*

3) «Liria Kombëtare» datë 5.8.1925.

grumbulluar të ketë qenë 7-8000 veta, pa futur këtu forcat e bajraktarëve të Veriut, që u bashkuan me Zogun menjëherë pasi ky kaloi kufirin. Nuk hyjnë në këtë numër as trupat e rregullta jugosllave të Prizrenit e të Dibrës, të cilat kaluan kufirin duke shpërndarë trupat shqiptare të kufirit dhe u hapën rrugën forcave vrangeliste, ushtarëve dhe rezervistëve të veshur me petka kombëtare. Kur dilte nevoja, kamionët e ushtrisë jugosllave transportin me shpejtësi njësi të këtyre forcave nga një vend në tjetrin në anën jugosllave të kufirit. Forcat sulmuese, përveç armëve të zakonshme, mitralozave të lehtë e të rëndë, u pajisën edhe me bateri të artilerisë malore.¹ Edhe nga kjo pikëpamje forcat shqiptare ishin krejt inferiore për shkak të mbylljes së çdo burimi të jashtëm për të siguruar armë e municione.

Dy kanë qenë bazat e nisjes së forcave intervencioniste: Prizreni dhe Dibra. Në përputhje me këtë, edhe operacioni i tyre u zhvillua nëpërmjet dy goditjeve kryesore: njëra në drejtim të Krumës me objektiv Shkodrën dhe tjetra në drejtim të Peshkopisë me objektiv Tiranën.

Më 10 dhjetor një pjesë e forcave që ishin përqendruar në Prizren, nja 1500 veta, kaluan kufirin dhe u përpoqën me forcat shqiptare nën komandën e Bajram Currit. Në kufi ishin nja 500 veta, kryesisht xhandarë, të cilët u detyruan të tërhiqeshin në Vaspas, duke lënë Kukësin dhe Krumën. Pas disa ditësh Bajram Curri, që u përforcua edhe me nja 800 malësorë të armatosur nga Kruma dhe nga viset në veri të Drinit, u hodh në kundërsulm. Armiku u tërhoq, Kruma u çlirua përsëri. Në këtë luftim (në të cilin morën pjesë edhe fshatrat përreth, duke ndjekur armikun në tërheqje), armiku pati nja 25 të vvarë, 60 të plagosur dhe 40 robër. Midis robërve qenë edhe 3 topçinj me uniformë të forcave të garnizonit të Prizrenit. Atyre iu gjetën dokumente identifikimi si dhe urdhra me shkrim të oficerëve komandues në Prizren, me anën e të cilëve ata urdhëroheshin të kalonin kufirin shqiptar. Pas Krumës, në duart e forcave të Bajram Currit, ranë përsëri Kukësi dhe Qafa e Bicajt. Por objektivi kryesor i kundërsulmit, që ishte bashkimi me forcat që mbronin Peshkopinë, nuk u arrit, sepse ishte tepër

1) Lidhur me numrin e forcave që morën pjesë në operacion dhe armatimet me të cilat u pajisën, autori anglez *J. Swire* jep disa të dhëna për të cilat thotë se janë marrë «nga një burim britanik krejt i sigurt», *vep. cit.*, p. 445.

vonë dhe armiku këtu kishte siguruar një sukses vendimtar që i lejonte të përparonte me të shpejtë në drejtim të Tiranës.

Sulmin në sektorin e Peshkopisë intervencionistët e filluan më 16 e 17 dhjetor. Sulmi u bë në tri pika: a) nga ana e rrugës për në Qenok ku u hodhën në veprim dy batalione të rregullta jugosllave, të pajisura me topa e mitroloza; b) nga ana e Homeshit dhe c) në drejtim të malit që shtrihet nga Dibra në Korab, përmbi Peshkopi. Në këto dy pikat e fundit u hodhën në veprim kryesisht banda merce-narësh. Forcat shqiptare këtu ishin të pakta: një batalion me qendër në Peshkopi, një repart ruante urën e Topojanit dhe një kompani ruante kufirin në drejtim të Dibrës.

Luftime mjaft të ashpra u zhvilluan rreth karakollit të Qenokut. Këtu në ndihmë të forcave shqiptare të kufirit shkuan edhe 2 kompani të tjera si dhe 200 vullnetarë të komanduar nga Jusuf Xhelili, i nipi i Elez Jusufit. Pas një përleshjeje të përgjakshme, në të cilën gjeti vdekjen vetë Jusufi, forcat shqiptare u detyruan të tërhiqeshin në Peshkopi. Këtu ndodhej Elez Jusufi me 500 burra të tij. Në luftimet që u bënë për Peshkopinë, Elezi u vra bashkë me një numër njerëzish të tij. Pas rënies së Peshkopisë, rruga për në Tiranë ishte e hapur.

Nga ana e Homeshit, kompania e trupave qeveritare, që ndodhej në të majtë të Drinit, pas një përpjekjeje të vogël, u rrethua dhe hodhi armët në mbrëmjen e 17 dhjetorit. Vetëm nja 50 veta mundën të shpëtonin dhe të arrinin në Bulqizë ku ishte një kompani tjetër. Këtyre forcave iu dha urdhër që të tërhiqeshin e të zinin vend në qafën e Murrizës, mbi Gurbardhë.

Në një telegram që i dërgohej Ministrisë së Brendshme, më 20 dhjetor nga Bicaj, situata përshkruhej me ngjyra të zeza që tregonin nga njëra anë se Zogu gjente fushë të lirë veprimi dhe nga ana tjetër, se forcat qeveritare nuk ishin më në gjendje të organizonin asnjë qëndresë për të ndalur vërshimin e intervencionit. «Zogolli ka dalë në Peshkopi, — njoftonte zëvendësprefekti R. Drini, — ...Në Lumë e në Dibër po armatoset populli me shpejti kundër Tiranës e Shkodrës. Secili njeri që merr pushkë, merr dhe tre napolona. Shumë pare e shumë pushkë janë tuj përnda. Automobilat e Jugosllavisë bajnë material luftet rregullisht prej Prizrenit e në Kukës. Lëvizja ka marrë një rrjedhë serioze në Lumë e në Dibër». Zëvendësprefekti në fund kë-

konte të pamundurën: «të dërgohet një fuqi e madhe me të shpejtë për mospërhapjen e lëvizjes edhe ndër viset (që janë) në kufi me Dibër e me Lumë (sidhe) për shpëtimin e këtyne dy krahinave».¹

Mbrojtja e Tiranës ishte bërë mjaft e vështirë. Kjo jo vetëm për arsye se invazorët sulmonin në shumë drejtime, por edhe se Qeveria e Nolit nuk ishte më në gjendje ta kontrollonte situatën. Më 19 dhjetor forcat qeveritare prej jo më shumë se 1000 vetash, që kishin zënë vend në Gurbardhë, u sulmuan nga 4000-5000 veta që kishin kaluar nga Bulqiza. Forcat qeveritare u detyruan të tërhiqeshin te Shkalla e Tujanit. Rrugës nja 250 ushtarë u shpërndanë e humbën. Në të njëjtën kohë një grup malësorësh, mercenarë të Zogut, pasi kaluan malin e Turcetës, duke e lënë kështu prapa Gurbardhën, filluan të përparonin në drejtim të kryeqytetit. Ata evituan edhe qëndresën e kompanisë shqiptare, që kishte zënë qafën e Murrizës, dhe përmes shtigjesh të vështira zbritën në fushë.

Më 20 dhjetor forcat e ardhura nga Jugosllavia bënë sulmin e parë në Shkallën e Tujanit. Ky ishte një pozicion mjaft i fortë për forcat mbrojtëse. Prandaj komanda e tyre vari aty shpresat e fundit. Për t'i dalë përpara rrethimit u dërgua një kompani me detyrë që të zinte rrugën e Martaneshit dhe një batalion me detyrë që të mbronte Qafën e Priskës. Përpjekja këtu ishte e ashpër. Luftimet vazhduan gjithë ditën dhe natën e 20-21 dhjetorit.. Më së fundi, më 22 dhjetor, batalionit që ndodhej në Qafë të Priskës iu morën krahët dhe vetëm nja 3 oficerë dhe 60 ushtarë mundën të shpëtonin.

Meqenëse bandat e ardhura nga Jugosllavia nuk po sulmonin nga Qafa e Thanës, kishte mundësi që nja 1800 ushtarë të vendosur në Elbasan të vinin në Qafën e Kërrabës për t'i bërë ballë sulmit nga Priska. Mirëpo për ta nuk kishte municion, për arsyen e njohur se autoritetet italiane nuk linin që të transportohej për në Durrës një sasi municioni që ishte blerë në Trieste qysh më parë. Kështu, më 23 dhjetor trupave qeveritare iu dha urdhër të tërhiqeshin nga Shkalla e Tujanit, të zbraznin Tiranën dhe të zinin vend në Kavajë e Lushnjë. Por vetëm nja 300 veta arritën deri në Lushnjë.

1) Tel-shifër nga Bicaj — Zyrës sekrete të Ministrisë së Brendshme datë 20.12.1924 në AQSH, fondi 252, v. 1924, d. 98, f. 34.

Luftimet në Jug

Për intervencionin e huaj kundër Shqipërisë shërbeu si bazë edhe territori grek. Autoritetet greke nuk e përqa-fuan menjëherë kursin e ndërhyrjes dhe nuk u treguan po aq aktivë në organizimin e bandave kundërrevolucionare sikurse qeveritarët e Beogradit. Por duke parë dobësimin e pozitës së Qeverisë së Nolit, tendencat intervencioniste fituan epërsinë edhe në Athinë. Filluan të dalin në skenë banda emigrantësh të reaksionit vendas dhe elementësh vorio-epirotë, të cilët niseshin nga territori grek në afërsi të kufirit, ose nga ishulli i Korfuzit për të kryer sulme kundër lokaliteteve në anën shqiptare të kufirit. Pikërisht në kohën kur shpresohej për një afrim me Greqinë (pas zgjidhjes së çështjes së 14 fshatrave) nga Athina po vinin sinjale se edhe ajo po shkiste në pozitë të pozitat e intervencionit.

Qysh në fund të tetorit, Ministria e Brendshme në Tiranë merrte një telegram nga Delvina në të cilin «inspektori administrativ» në atë qytet e cilësonte gjendjen mjaft «kritike» për shkak të «përgatitjes së një lëvizjeje kundër qeverisë» dhe tërhiqte vëmendjen sidomos për veprimtarinë që zhvillonin elementë kundërrevolucionarë matanë kufirit, në territor grek.¹ Në telegram jepeshin disa të dhëna konkrete: «Agjentët e kësaj gjoja lëvizjeje (kundër qeverisë — A.P.) janë nga të arratisur që kanë qenë në Korfuz, të cilët e kanë lënë këtë qytet dhe janë ndarë në dy grupe. Mbas informatave të sigurta që kam, prej (dy) grupeve, njëri i përbërë prej (Koço) Kotës (një ndër eksponentët e klikës së Zogut — A.P.) e Skëndo Pojanit gjendet në kufi të qarkut të Korçës dhe tjetri, i përbërë prej Xhemal Aranitasit... dhe major Veiz Sevrani (ndodhet) në kufi të qarkut të Gjirokastrës. Qëllimi është të sjellin turbullime në kufi dhe të bashkohen me oficerë për rrëzimin e kabinetit...».²

Një interes të veçantë paraqet një raport që legata italiane i dërgonte qendrës së vet në fillim të nëntorit. «...Para një jave, — thuhej midis të tjerash në këtë raport, — dy oficerë shqiptarë të arratisur, besnikë të Ahmet Zogut, shkuan në Korfuz të shoqëruar nga dy oficerë jugosllavë (majori Knezeviç dhe kapiteni Juro Ristiç) për t'u marrë vesh me të arratisurit shqiptarë në Korfuz. Në të vërtetë po marrim

1) *Dokumente e materiale historike, 1917-1941, Tiranë 1959, d. nr. 183.*

2) *Po aty, f. 183-184.*

lajme se këto ditët e fundit këta janë shpërndarë në vende të ndryshme... afër kufirit shqiptar juglindor».¹

Një marrëveshje duhet të jetë arritur, përderisa rezultatet nuk vonuan të dukeshin. Edhe legata shqiptare filloi të dërgonte prej Athine njoftime mbi grumbullime e lëvizje të elementëve zogistë në afërsi të kufirit. Nga mesi i nëntorit në tre raporte të njëpasnjëshme ajo bënte fjalë jo vetëm për «partizanë të ish-qeveritarëve të mbledhur pranë vijës kufitare me qëllim që t'i ndihmojnë lëvizjes që përgatit Ahmet Zogu nga Veriu»², por edhe për implikimin e qeverisë greke, për të cilën në vetë shtypin grek depërtonin lajme mbi bandat që ajo (qeveria) «organizonte dhe mbante në Epir për qëllime politike».³

Po të shikohet çështja në tërësi, del qartë se jo vetëm në fazën përgatitore, por edhe në atë të zbatimit konkret, sulmi i kryer nga ana e jugut, si nga pikëpamja e forcave që morën pjesë në të ashtu edhe të veprimeve luftarake që u zhvilluan, nuk mori ato përpjesëtime sikurse në veri. Sidoqoftë, pavarësisht nga vonesa dhe nga shkalla e angazhimit, mbetet fakt se edhe Greqia u implikua në aksionin për rrëzimin e Qeverisë së Nolit. Kjo shtyn të mendohet se ka patur një prapaskenë. Dhe kemi arsye të kthehemi edhe një herë te «zbulimet» e Radiçit për të theksuar përsëri se, ndonëse nuk mund të bëhej fjalë për një marrëveshje për copëtimin e Shqipërisë, midis tri qeverive duhet të ketë patur konsultime të cilat kanë lejuar të arrihet në një emërues të përbashkët dhe të sheshohet rruga e intervencionit për rrëzimin me forcë të Qeverisë shqiptare. Në lidhje me këtë është mjaft domethënës informacioni që jepte legata shqiptare nga Athina në mes të tetorit se, siç «mësonte nga një burim i mirë (Koço) Kota kishte shkuar dy herë në Ministri të Jashtme dhe madje ishte pritur dy herë nga vetë ministri Russos»⁴. Edhe vlerësimi që jepet në shkrimin e përmendur të «Lirisë Kombëtare», le të kuptohet se në qëndrimin e qeverisë greke pas tetorit ka patur një kthesë drejt një qëndrimi më të angazhuar në aksionin që përgatitej kundër Shqipërisë. Aty lexojmë se, përpara se të fillonte sulmi në kufirin jugor, komandanti grek në Janinë

1) Po aty, d. nr. 184.

2) Dy raporte të legatës nga Athina datë. 16.11. dhe 21.11.1924 në AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 149, ff. 13, 14.

3) Raport i legatës nga Athina datë 15.11.1924. Po aty, f. 12.

4) Po aty, f. 7.

kishte dhënë urdhër që të kapeshin e të çarmatoseshin të gjithë ata që ishin mbledhur aty dhe bëheshin gati për të vepruar kundër territorit shqiptar. Mirëpo, një ditë më pas, ai kishte marrë udhër nga Athina që të mos përzihej, pra t'u linte fushë të lirë veprimi elementëve zogistë.¹

Duke siguruar pjesëmarrjen sado të kufizuar të qeverisë greke, intervencioni arriti një objektiv të rëndësishëm: Qeveria e Nolit u gjend e mbërthyer si në një darë, forcat shqiptare u goditën nga të dyja anët, jo vetëm në veri por edhe në jug. Ky rrezik ishte paralajmëruar që në nëntor kur Ministria e Brendshme i ishte drejtuar me shkresë të posaçme Ministrisë së Luftës me kërkesën që «të hiqeshin nga Jugu disa oficerë të njohur si mufidistë». «Të merren masa me kohë, — theksohej në shkresën e përmendur, — se është e qartë se përgatitjet që po bëhen në Jugosllavi presin kompletimin e tyre me përgatitjet e jugut për ta sulmuar Qeverinë nga të katër anët».²

Baza e operacionit në jug ka qenë Janina: këtu u mblodhën forcat kryesore zogiste. Bandat në krye të të cilave ishte Myfit Libohova kishin si detyrë të sulmonin në pikën kufitare të Kakavijes për të shtënë në dorë Gjirokastrën. Vetë Mufiti kishte mbërritur në Janinë më 9 dhjetor dhe kishte qenë për dy orë në komandën ushtarake greke për bisedime. Në telegramin e prefekturës së Gjirokastrës të datës 12 dhjetor, përveç kësaj informate, shtohet edhe se në anën greke të kufirit, autoritetet vendase «po bënin disa lëvizje ushtarake që tërhiqnin vëmendjen».³ Nja dy ditë më vonë po kjo prefekturë njoftonte se në mëngjesin e 14 dhjetorit «Veis Sevrani, i ndihmuar prej çetave greke, kishte sulmuar e pushtuar Kakavijen».⁴ Ishte e para goditje në kufirin e jugut që shënonte fillimin e intervencionit edhe nga territori grek. Tani nuk kishte asnjë dyshim se edhe «incidentet» në kufirin jugor bëheshin jo vetëm me pëlqimin, por edhe me pjesëmarrjen e autoriteteve greke. Zëvendësprefekti Hilë Mosi, i telegrafonte Ministrisë së Brendshme në Tiranë më 17 dhjetor se «lëvizja në Kakavijë bëhej sheshit me përkrahjen morale e materiale të qeverisë greke». Kjo provohej me faktin se bandat liheshin të lëviz-

1) «Liria Kombëtare» datë 12.8.1925.

2) *Dokumente e materiale mbi veprimtarinë e Qeverisë së Nolit, «Studime historike» 1973, nr. 4, f. 148-149.*

3) Tel. i zëv.prefektit Hilë Mosi nga Gjirokastra datë 12.12.1924 në AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 264, f. 91.*

4) Tel. i zëv.prefektit Hilë Mosi datë 14.12.1924. *Po aty, f. 95.*

nin lirisht në zonën kufitare.¹ Duket se forcat shqiptare të kufirit ishin krejt të pamjaftueshme. Ndonëse Kakavija ishte ripushtuar pas një kundërsulmi të forcave qeveritare², prapëseprapë prefektura e Gjirokastrës nuk ishte optimiste. «Përpara ndihmave që u jep këtyre (bandave) qeveria greke, — thuhej në telegramin e mësipërm, — nuk kujtojmë të bëjnë efektin e duhur masat ushtarake». Duheshin bërë sa më parë përçapje diplomatike pranë qeverisë greke, duke i bërë thirrje që ajo t'u përmbahej deklaratave të saj të përsëritura mbi mospërzjerjen në punët shqiptare.³

Në të vërtetë në ditët e pastajme sulmet erdhën duke u shtuar edhe në jug. Nga kufiri vinin vazhdimisht lajme për incidente të reja («mësymje të rebelëve në stacionin e Katunës dhe në Jergucat») ose për «oficerë të arratisur» si Xhemal Aranitasi që shëtisnin rreth kufirit të përkrahur prej autoriteteve ushtarake greke dhe bëheshin gati për sulm.⁴ Më 22 dhjetor në Ministrinë e Jashtme mbërrinte njoftimi prej Gjirokastrë se një ditë më parë «grekët mbyllën kufirin e nuk lanë njeri të kalojë n'atë anë», ndërsa të arratisurit «i ka vendosë nëpër çadra në Han t'Aristës, pasi i ka pajisë me armë e municion».⁵

Për pjesëmarrjen greke në përkrahje të forcave rebele mund të krijohet një ide edhe më e qartë nga telegrami që konsulli italian në Janinë i dërgonte Musolinit më 20 dhjetor: Lajmet e gazetave të sotme, — thoshte konsulli, — thonë se gjendja në Shqipërinë Jugore është rënduar për shkak të revolucionit (sic) të Ahmet bej Zogollit». «Marr vesh, — vazhdonte i njëjti burim, — se Mufit beu dhe të tjerë oficerë shqiptarë, të cilët prej disa ditësh ndodhen në Delvinaq, (në afërsi të kufirit shqiptar AP), përgatiten të hyjnë në Shqipërinë e Jugut». Ndërhyrja e auto-

1) Tel. i Hilë Mosit nga Gjirokastra datë 17.12.1924. *Po aty*, f. 103.

2) Zyra e shtypit në një telegram që u dërgonte më 15 dhjetor përfaqësive të huaja në Shqipëri dhe përfaqësive shqiptare në kryeqytetet kryesore njoftonte: «Një bandë prej 70 vetash, e përbërë prej komitash grekë e shqiptarë, që pati pushtuar lokalitetin e Kakavijes u prapësua nga trupat shqiptare dhe u hodh përtej kufirit». *Po aty*, f. 98.

3) *Po aty*.

4) Tel. nga Gjirokastra datë 21.11.1924 dhe tel. nga Leskoviku datë 20.12.1924. *Po aty*, fi. 119, 120.

5) Tel. i zëvendësministrit të brendshëm drejtuar Ministrisë së Jashtme, 22.12.1924.

riteteve ushtarake greke ishte flagrante: bandat ishin furnizuar «me të gjitha mjetet e nevojshme, duke përfshirë pushkë, bomba dore e automjete». Madje «nuk përjashtohej edhe ndërhyrja e drejtpërdrejtë e trupave të rregullta greke».¹

Duke u hedhur një vështrim përmbledhës veprimeve luftarake në kufirin e Jugut, nuk mund veçse të rikthehemi te krahasimi me intervencionin në Veri: ndërsa këtu konfrontimi mori deri diku trajtën e një lufte frontale, në jug veprimet ushtarake patën karakterin e ndeshjeve të kufizuara lokale, që përfunduan me tërheqjen e rrëmbyer të forcave qeveritare, të cilat ishin krejt të çorganizuara e të pamjaftueshme për t'i bërë ballë valës kundërrevolucionare. Me gjithë paralajmërimet, kufiri i jugut u la gati i zhveshur. Aty u dërguan vetëm 3 kompani ushtarësh, që nuk qenë në gjendje të bënë asnjë qëndresë serioze. Një efekt duket se kanë patur edhe thirrjet që vinin nga matanë kufirit në adresë të oficerëve komandues të ushtrisë qeveritare, të cilët ftoheshin për bashkëpunim, «përndryshe kanë humbë gjithë të pritmen e tyne».² Nga ana e tij, Mufit Libohova, me të mbërritur në Kakavijen e ripushtuar prej forcave rebele, lëshoi një shpallje, në të cilën thoshte se Anglia ishte në favor të kthimit të Zogut në fuqi, prandaj shqiptarët nuk duhej të kundërshtonin një njeri që kishte përkrahjen e Fuqive të Mëdha.³

Populli i Gjirokastrës ishte i prirur jo vetëm kundër personit të Mufit beut (që në atë rreth kishte një famë veçanërisht të keqe), por shikonte me dyshim të madh dhe ishte gati të kundërshtonte një lëvizje që vinte prej Greqie. Megjithatë, shpejt u gjend pa kurrfarë udhëheqjeje, qoftë politike, qoftë ushtarake dhe situata u kthye edhe këtu në favor të forcave kundërrevolucionare.

Kështu, brenda më pak se dy javësh, gjendja në Shqipëri u përmbys. Më 24 dhjetor Tirana ra në duart e bandave të Zogut dhe të forcave intervencioniste. Anëtarët e Qeverisë dhe vetë Fan Noli, bashkë me mbeturinat e forcave qeveritare, u tërhoqën në Vlorë. Prej këtej rreth 300-350 veta ikën në Itali (ndër ta F. Noli, L. Gurakuqi, S. Vinjau), ndërsa po aq u larguan për në Greqi. Një pjesë vendosën

1) Tel. i konsullit italian nga Janina datë 20.12.1924 në DDI, 7^a serie, vol. III, d. nr. 626.

2) Tel. i lartpërmendur nga Leskoviku datë 20.12.1924.

3) «Liria Kombëtare» datë 12.8.1925.

të qëndronin në vend për të vazhduar qëndresën kundër regjimit zogist. Këtu shquhet edhe një herë figura e Bajram Currit, i cili do të vritej në përpjekje me bashibozukët e Zogut në bjeshkët e Veriut më 1925. I njëjti fat e priste L. Gurakuqin i cili do të binte nën plumbat e sikarëve të Zogut po më 1925 në Bari të Italisë.

Veprimet diplomatike rreth intervencionit

Përpara se të mbërrihej në këtë epilog fatkeq, ishte zhvilluar një veprimtari e caktuar diplomatike, ndriçimi i së cilës lejon të bëhet një tablo më e plotë e rrethanave që çuan në disfatën e Revolucionit Demokratik dhe në rrëzimin e Qeverisë së dalë prej tij.

Siç del edhe nga faktet e rreshtuara më lart, sidomos nga fundi i nëntorit e fillimi i dhjetorit, rreziku i ndërhyrjes së jashtme, në radhë të parë nga ana e Veriut, kaloi në një fazë të re.

Për këtë ka qenë e ndërgjegjshme edhe vetë Qeveria e Nolit, gjë që e tregon letra që i është dërguar javën e fundit të nëntorit sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë. Aty tërheq vëmendjen veçanërisht kjo frazë: «Lëvizja antishqiptare e organizuar nga autoritetet ushtarake dhe civile serbe ka marrë këto kohët e fundit përpjesëtime të tilla sa që mund të mendohet, pa kurrfarë teprimi, se Shqipëria ndodhet në pragun e një invazioni të huaj».¹ Përgjithësisht në letër jepej një pasqyrë e hollësishme e përgatitjeve që po bëheshin në territorin jugosllav për sulmin kundër Shqipërisë. Mund të thuhet se ky është dokumenti më i plotë që është hartuar nga Qeveria Demokratike lidhur me veprimtaritë subversive që po organizoheshin nga autoritetet jugosllave në kuadrin e intervencionit. Siç mund të pritej, përçapja e qeverisë shqiptare nuk gjeti jehonë në Gjenevë.

Më 6 dhjetor, pas njoftimeve alarmante që erdhën nga legata shqiptare në Beograd mbi fillimin e afërt të intervencionit, Ministria e Jashtme iu drejtua legatës shqiptare në Londër, duke kërkuar prej ministrit M. Konica që ai të paraqitej vetë në Foreign Ofis dhe të dorëzonte atje një për-

1) Letër drejtuar Sekretarit të Lidhjes së Kombeve sir. E Drummond datë 25.11.1924. AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 257, f. 156-159.

kujtesë me të dhënat e fundit «mbi aksionin që autoritetet serbe përgatisnin kundër rendit dhe sigurisë së Shqipërisë». Ministri shqiptar e kreu porosinë më 8 dhjetor dhe në përkujtesën e dorëzuar, përveç të dhënave që kishte marrë nga Tirana, i kërkonte qeverisë së Londrës «që t'i tërhiqte vërejtjen qeverisë së Beogradit mbi rrezikshmërinë e veprimeve të saj».¹ Përgjigjja që M. Konica i jepte Ministrisë së Jashtme në Tiranë ishte hartuar në një frymë të tillë që dukej sikur i vetmi synim i autorit të saj ishte të siguronte qendrën se çdo shqetësim i tepruar ishte pa vend. Ai njoftonte se në Forein Ofis kishte marrë plot premtime për një ndërhyrje të shpejtë. Përkujtesa shqiptare «i që dërguar urgjentisht ministrit britanik në Beograd për t'ia komunikuar qeverisë së atjeshme» dhe njëkohësisht i që transmetuar edhe sekretarit të Forein Ofisit Austin Çemberlenit që ndodhej ato ditë për vizitë në Romë. «Guverna britanike, — shkruante M. Konica, — i heq vërejtjen Guvernës jugosllave mbi lajmet tona dhe e fton të mos prishë paqen». Dhe përfundonte: «S'kam dyshim se ndërhyrja e Guvernës britanike do të bëjë efektin e duhur».²

Në të vërtetë gjithë qëndrimi i Anglisë kundrejt Qeverisë Demokratike gjatë gjithë atyre muajve fliste për të kundërtën: se nuk mund të shpresohet as në ndërhyrjen e qeverisë së Londrës, as në efektet e kësaj ndërhyrjeje. Është edhe kjo një shenjë e çorientimit të Qeverisë së Nolit, e cila e kërkonte përkrahjen atje ku ishte e qartë se nuk do ta gjente. Drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, qeveria britanike ishte e implikuar në përgatitjet që bëheshin për rrëzimin e Qeverisë shqiptare (dihet se shoqëria angleze «Anglo-Persian» kishte vënë mjete financiare në dispozicion të forcave të intervencionit). Një raport i ministrit italian Duraco, dërguar qendrës në dhjetëditëshin e parë të nëntorit, ripohonte qëndrimin e prerë britanik kundrejt Qeverisë së Nolit. Ministri italian informonte për bisedën që kishte patur me kolegun e tij anglez Aires pas memorandumit që Ministria e Jashtme shqiptare u kishte dërguar disa ditë përpara përfaqësuesve të Italisë, Anglisë dhe Francës lidhur me përgatitjen e sulmit në territor jugosllav. «Ky (Airesi), — thuhej në raport, — më tha se përpara se të transmetonte

1) Raporti i ministrit M. Konica nga Londra datë 10.12.1924 bashkë me kopjen e përkujtesës dorëzuar Forein Ofisit në AQS, fondt 251, v. 1924 d. 252, ff, 1-3.

2) Raport i mësipërm i M. Konicës nga Londra datë 10.12.1924.

memorandumin në Londër, kishte ndër mend t'i kërkonte Ministrisë së Jashtme të këtushme (shqiptare) se në çfarë provash efektive janë bazuar akuzat e bëra në memorandum... kundër qeverisë së Beogradit».¹ Kjo donte të thoshte se ministri anglez merrte apriori anën e qeverisë jugosllave. Këtë e theksonite edhe Duracoja kur shkruante në komentin e tij: «...Ministri anglez e di shumë mirë si qëndrojnë punët. Ky qëndrim i tij evaziv dhe i errët shpjegohet më tepër me dëshirën e tij të fshehur keq për ta parë A. Zogun të marrë sa më parë dhe me çdo mënyrë frenat e pushtetit në Shqipëri. Megjithëse Z. Aires (Eyres) thotë se edhe A. Zogu është njeri që mund t'i besohet pak, por prapë ai mendon se qeveria e tanishme nuk ka as fuqi, as autoritet dhe në rrethanat e tanishme A. Zogu është i vetmi njeri i aftë që t'i bëjë shqiptarët t'i binden e t'ia kenë frikën, të paktën deri në njëfarë pike...».²

Pra, nuk është e lehtë të kuptohet përse Qeveria e Nolit përçapjen e parë diplomatike në dhjetor e bëri pranë qeverisë britanike. Sigurisht, duhet të ketë ndikuar këtu pesha e madhe e Londrës në politikën botërore, por një rol ka luajtur edhe ideja iluzore që ka mbizotëruar në qarqet drejtuese të Qeverisë Demokratike e sidomos te vetë Noli se Anglia, ndër gjithë fuqitë e tjera evropiane, ishte ajo që i përmbahej ligjit në marrëdhëniet midis shteteve dhe se, pavarësisht nga rezervat që mund të kishte ndaj kësaj apo asaj shtate të brendshme, nuk do të rrinte pa reaguari kundrejt shkeljeve të normave ndërkombëtare. Me këtë shpjegohet edhe fakti se vetë Noli (pasi kishte marrë në dhjetor edhe detyrën e ministrit të jashtëm a.i.) i jepte porosi legatës shqiptare të Beogradit që t'ua bënte të ditur përmbajtjen e informatave konfidenciale mbi përgatitjet e Zogut përfaqësuesve të Francës e të Italisë, por të përpiqej «të interesonte veçanërisht përfaqësuesin e Britanisë së Madhe».³

Pas këtyre përçapjeve fillestare vijon njëlloj pauze që vazhdon disa ditë. Ndoshta lajmet mbi sulmin e afërt kanë ndikuar në frontin e brendshëm, duke e shtyrë Gjyqin Politik (të formuar që në qershor) të japë më 12 dhjetor ven-

1) Raport i ministrit Duraco (Durazzo) datë 9.11.1924 në «*Dokumente e materiale... 1917-1941*», Tiranë 1959, d. nr. 184.

2) *Po aty*.

3) Tel. i Nolit drejtuar legatës shqiptare në Beograd (javë e parë dhjetorit). *AQSH, fondi 251, v. 124, d. 257, f. 152*.

dimin e tij mbi dënimin me vdekje dhe konfiskimin e pasurisë së A. Zogut, Sh. Verlacid e «shkaktarëve të tjerë të vëllavrasjes».¹ Nga çdo anë tjetër qeveria është në pritje të ngjarjeve. Më 13 dhjetor vijnë lajmet mbi goditjet e para në pika të ndryshme të kufirit verior. Atëherë u dërgohen telegrame me njoftimet përkatëse legatave shqiptare në Romë, Paris, Athinë, Londër dhe përfaqësisë në Gjenevë. Në çastin e fundit në tekstin e telegramit shtohet me dorë edhe lajmi i porsambërritur se «një bandë greke nën komandën e Veis Sevranit ka zënë Kakavijen».² Përsëri bie në sy se këto përçapje bëhen me qëllim informimi dhe nuk ngrenë çështjen e përgjegjësisë së qeverisë jugosllave apo të qeverisë greke për veprime agresive kundër një shteti anëtar të Lidhjes së Kombeve.

Përmasat e operacionit në Veri, të cilit fillojnë e i shtohen tani edhe sulmet në Jug, nuk lënë më asnjë dyshim se situata është tepër serioze. Kjo ishte arsyeja që Noli vetë kërkoi urgjentisht një takim sy për sy me ministrin italian Duraco. Takimi u bë më 16 dhjetor në prani edhe të L. Gurakuqit e S. Vinjaut.³ Në bisedën e gjatë që u zhvillua Noli me fakte në dorë vuri në dukje se ajo që po ndodhte në kufirin verior ishte krejt në kundërshtim me deklaratat dhe sigurimet që Ninçiçi kishte dhënë disa ditë më parë në Romë. Në këto kushte asnjëherë nuk mund të kishte kuptim tjetër veçse tolerim i sulmit që po kryhej kundër Shqipërisë. Dhe vërtet, kishte një ndryshim thelbësor midis ngjarjeve të qershorit, të cilat kishin të gjitha tiparet e «një lufte të brendshme», dhe atyre të dhjetorit që përbënin «as më shumë e as më pak një orvatje me paramendim e me dhunë nga ana e një fqinji që ka zgjedhur si vegël Ahmet bej Zogollin për të penguar zhvillimin e lirë të brendshëm të Shqipërisë».⁴ Edhe zgjedhja e momentit të sulmit nuk ishte e rastit: qëllimi ishte po ai, që t'u dilej përpara zgjedhjeve që ishte vendosur të bëheshin në dhjetor-janar dhe që «do ta konsolidonin përfundi-

1) AQSH, *fondi i Ministrisë së Brendshme v. 1924, d. 905, f. 12-15.*

2) Tel. i Ministrisë së Jashtme datë 14.12.1924, AQSH, *fondi 251. v. 1924, d. 257, f. 175.*

3) Tel. i ministrit Duraco drejtuar Musolinit datë 18.12.1924. DDI, *7^a serie, vol. III, d. nr. 623.*

4) *Po aty.*

misht regjimin që ishte në fuqi».¹ «Për Shqipërinë, — shtoi Noli, — kjo ishte një luftë e vërtetë dhe nuk kuptohej se si, përballë kësaj gjendjeje, Italia (njësoj si fuqitë e tjera) mund të rrinte e shkujdesur dhe indiferente».²

Përgjigjja e ministrit italian paraqet interes sepse mund të merret si një jehonë e ujdisë që ishte arritur në takimin Musolini-Ninçiq për «t'i lënë punët të ecin në rrugën që kanë zënë», për të mos i penguar proceset dezintegruese të Qeverisë së Nolit, që gjenin një pikë të fortë pikërisht në ndërhyrjen nga jashtë. Së pari, ministri italian i quajti «të ekzagjeruara informatat që dispononte qeveria shqiptare». Pastaj ai nuk ngurroi të merrte anën e A. Zogut dhe, pra, të protektorëve të tij jugosllavë, duke thënë se «nuk mund të mohohet se lufta aktuale kishte edhe karakter partizan (e një lufte midis partish)», përdherisa shumë përkrahës të Zogut brenda dhe jashtë ishin solidarë me të dhe përpiqeshin të rifitonin pozitat e humbura, madje edhe interesat e kërcënuara nga masat e dënimit dhe konfiskimit (një aluzion ky i qartë për vendimin e Gjyqit Politik).³ Ministri italian e bëri fare të qartë politikën e «larjes së duarve» të qeverisë së tij kur tha se «këto konflikte të vazhdueshme midis personash dhe partish në Shqipëri dekurajonin dhe neutralizonin edhe miqtë e saj më të mirë».⁴ Gjatë gjithë takimit ai nuk shqiptoi asnjë fjalë dënimi për intervencionin e huaj kundër Shqipërisë të nisur nga territori jugosllav.

Po aq domethënëse është edhe një deklaratë e ministrit të Jashtëm britanik A. Çemberlenit në Dhomën e Komuneve më 17 dhjetor. I pyetur «për gjendjen shqetësuese të Shqipërisë» ai tha se «qeveria britanike e kuptonte plotësisht rrezikun e prishjes sado të vogël të qetësisë së përgjithshme në Ballkan» dhe se «ajo do të bënte çdo përpjekje për lokalizimin e turbullirave». Madje ai shtoi se gjatë qëndrimit të tij në Romë (ku mori pjesë në punimet e Këshillit të Lidhjes së Kombeve) «ai mori sigurime nga ana e qeverisë italiane dhe asaj serbe se edhe ato frymëzoheshin prej po asaj dëshire»⁵

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

4) *Po aty.*

5) Sipas gazetës greke «*Nea Imera*» datë 19.12.1924. Kupyre shtypi në *AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 225, f. 298.*

Një zë në shkretëtirë

Nga biseda me ministrin italian, po edhe nga lajmet që mbërrinin prej Londre, Noli duhet të jetë bindur përfundimisht se nuk mund të pritej asgjë e veçantë as nga qeveria britanike dhe as nga ajo italiane. Dy sondazhet paraprake në kanale konfidenciale pranë këtyre dy Fuqive qenë të pafrytshme.

Atëherë Noli iu drejtua botërisht më 18 dhjetor me telegram tri Fuqive: Italisë, Anglisë dhe Francës. Kjo ishte edhe përçapja e fundit diplomatike e Qeverisë së Nolit. Një telegram me të njëjtën përmbajtje iu dërgua po nga Noli në të njëjtën datë sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, E. Drumond.¹ Në fillim aty përshkruhej shkurtimisht gjendja e krijuar nga sulmet në pika të ndryshme të kufirit të veriut. Pasi theksohej se «prej shumë kohe Qeveria shqiptare, e informuar mbi përgatitje bandash në tokën serbe me qëllime armiqësore kundrejt Shqipërisë, i kishte tërhequr vëmendjen kabinetit të Beogradit mbi këto fakte që mund të prishin marrëdhëniet e mira midis dy vendeve», në notë shtohej se këto «organizata (banda) në vend që të ndaloheshin, përkundrazi janë nxitur dhe armatosur». Madje prej më se 10 ditësh ato po kryenin sulme në pika të ndryshme të kufirit duke qenë «të paraprirë nga trupa të rregullta serbe» ose «të udhëhequra në shumë raste nga oficerë serbë». Bandat ndiqnin taktikën e njohur të rikthimit: përballë qëndresës së forcave qeveritare shqiptare ato tërhiqeshin «në tokë serbe» për t'u rihedhur në aksion me përforcime. Në këtë mënyrë «autoritetet ushtarake serbe vazhdonin të kryenin një varg aktesh lufte që ishin krejt në kundërshtim me deklaratat zyrtare të qeverisë së Beogradit». Përballë «këtij invazioni... qeveria shqiptare që e detyruar të dekretonte mobilizimin e përgjithshëm dhe të shpallte shtetërrethimin në të gjitha prefekturat në rrezik».² Nota përfundonte me thirrjen që u bëhej tri Fuqive si dhe Lidhjes së Kombeve «për të ndërhyrë pranë qeverisë serbe në më-

1) Tel. i Nolit drejtuar qeverive të Italisë, Francës dhe Anglisë, dt. 18.12.1924 botuar në «*Bashkimi*» datë 20.12.1924. Teksti frengjisht i telegramit drejtuar Musolinit botuar në *DDI, 7^a serie, vol. III, d. nr. 622*. I njëjti telegram frengjisht drejtuar Sekretarit të Lidhjes së Kombeve në *AQSH, Fondi 251, v. 1924, d. 258, f. 11-12*.

2) *Po aty*.

nyrë që kjo t'i jepte fund një gjendjeje të tillë që kërcë-
nonte seriozisht paqen në Ballkan». ¹

Nuk ka të dhëna të drejtpërdrejta që kjo përçapje e
fundit e Qeverisë së Nolit të ketë gjetur aty për aty ndonjë
jehonë, qoftë pranë qeverisë franceze, qoftë pranë asaj bri-
tanike. Por heshtja që u mbajt nuk le asnjë dyshim për qën-
drimin e tyre.

Nga ana tjetër, një numër dokumentesh të botuara ose
arkivore hedhin dritë të mjaftueshme mbi mënyrën se si u
trajtua kjo çështje nga qeveria italiane dhe nga Lidhja e
Kombeve.

Për qeverinë e Romës bëhet edhe një herë e qartë se
preokupacioni i saj këtej e tutje ishte që situata e re në
Shqipëri të mos dëmtonte synimet e afërta e të largëta të
politikës italiane. Këtë e tregon sidomos toni krejt i mo-
deruar i përçapjes së Musolinit pranë qeverisë jugosllave.
Pasi mori telegramin e Nolit, ai i dha udhëzime të ngar-
kuarit me punë Sola në Beograd që të tërhiqte vëmendjen
e qeverisë jugosllave «në mënyrë miqësore» për «konse-
kuencat serioze», që mund të rridhnin nga një përzierje e
saj kaq e hapët e flagrante. Musolini gati i lutej qeverisë së
Beogradit që të tregojë kujdesshme e të kuptonte «po-
zitën shumë të vështirë në të cilën po vihej qeveria (italiane)
karshi gjithë fuqive, të cilat ndjekin me vëmendje të madhe
fatin e Shqipërisë në kuadrin e interesit të përgjithshëm të
ruajtjes së paqes». ² Shihet qartë se deklarata të tilla mund
të kishin si efekt që të ripohonin praninë e faktorit italian
në çështjen shqiptare, por nuk synonin aspak që ta kthe-
nin nga rruga makinën e intervencionit që po i afrohej me
të shpejtë fazës përfundimtare.

Një përçapje e dytë e Musolinit në Beograd është edhe
më domethënëse. Më 23 dhjetor ai i dërgonte një telegram
ministrit italian në atë qytet, Bodrero, telegram që i zbu-
lon krejt kartrat e diplomacisë italiane. ³ Vihet re një ton
krejt tjetër, i prerë, kategorik. Pasi konstatonte se «lajmet
që mbërrinin nga Shqipëria shtynin të mendohej se situata
do të përfundonte pa dyshim në favor të Ahmet Zogut»,
Musolini i bënte një paralajmërim qeverisë jugosllave. Bo-

1) Po aty.

2) Tel. i Musolinit drejtuar Solas datë 19.12.1924. DDI, 7^a serie,
vol III, d nr 624

3) Tel. i Musolinit drejtuar Bodreros datë 23.12.1924. DDI, 7^a serie,
vol III, d nr. 634.

dreroja duhej t'u thoshte Pashiçit dhe Ninçiçit se ata do të dilnin përpara gjyqit të opinionit publik italian, «sepse ishte e pamohueshme... se aksioni i Zogollit u përgatit në territor jugosllav dhe me pëlqimin e ndihmat e autoriteteve jugosllave».¹ A do të inspirohej politika e Beogradit edhe më tutje nga ndërhyrja në punët e brendshme shqiptare? Kjo do të krijonte «një situatë delikate për të cilën qeveria italiane nuk kishte asnjë përgjegjësi». Kishte vetëm një zgjidhje dhe Musolini e mbyllte telegramin me një kërkesë gati ultimative. «Për të evituar pasojat e rënda që mund të rridhnin, do të ishte e domosdoshme që t'i jepeshin opinionit publik italian fakte konkrete që të tregonin se ngjarjet që kanë ndodhur në Jugosllavi dhe në Shqipëri nuk janë të drejtuara kundër pozitës politike të Italisë në Shqipëri».²

S'ka dyshim se me këtë Musolini donte të vinte një kufi, përtej të cilit ndërhyrja jugosllave në Shqipëri nuk do të mund të shkonte. Deri këtu duket se mbërrinte edhe vetë marrëveshja e heshtur e arritur në bisedimet Musolini-Ninçiç të para disa ditëve.

Një ripohim i saj vinte edhe nga përgjigjja e qeverisë së Beogradit. Në takim me Bodronon, po atë ditë, më 23 dhjetor, Ninçiçi nxitoi të jepte sigurime «se aksioni politik i qeverisë jugosllave përkundrejt qeverisë shqiptare do të rregullohej e do të zhvillohej vetëm e vetëm dhe pa kushte në marrëveshje me Italinë».³ «Asnjë qeveri shqiptare nuk do të përkrahej po të mos shprehej qartë për një marrëveshje të plotë me Italinë».⁴ Ninçiçi pranoi edhe kërkesën tjetër të ministrit italian që një angazhim i tillë të mos mbetej thjesht brenda kuadrit të bisedimeve konfidenciale, por të bëhej objekt i një deklarate të posaçme nga ana e qeverisë jugosllave.⁵ Deklarata u botua në Beograd më 24 dhjetor: aty ripohohej marrëveshja dhe miqësia me Italinë si bazë e politikës në çështjen shqiptare si për të kaluarën ashtu edhe për të ardhmen. Porse nga gjithë përmbajtja e saj krijohet përshtypja se Beogradi e përfytyronte të ardhmen e Shqipërisë si një lloj protektorati të dyfishtë italo-jugosllav.⁶ Kurse Roma nuk kishte aspak ndërmend ta pranonte Beogradin si një partner të barabartë në Shqipëri, dhe ngjarjet nuk do të vononin ta tregonin: rikthimi i Zogut në fuqi do të hapte

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

3) Tel. i Bodronos Musolinit datë 24.11.1924. *Po aty, d. nr. 638.*

4) *Po aty.*

5) Tel. i Bodronos Musolinit datë 24.12.1924. *Po aty, d. nr. 639.*

6) *Po aty.*

një fazë të re, atë të acarimit të dukshëm të marrëdhënieve midis Italisë dhe Jugosllavisë.

Përsa i përket Lidhjes së Kombeve, është me vend të ritheksohet se në fakt ishte krijuar një gjendje lufte midis dy qeverive që ishin anëtare të kësaj organizate. Ishte, pra, krejt e natyrshme që në këto kushte të shtrohej çështja e ndërhyrjes së Lidhjes, e cila në statutin e saj parashikonte marrjen e masave në rast agresioni kundër shteteve anëtare. Për këtë Qeveria shqiptare më në fund i dha udhër delegacionit të saj në Gjenevë që, krahas dorëzimit të telegramit të 18 dhjetorit, t'i drejtohej sekretarit të përgjithshëm me kërkesën që çështja e intervencionit jugosllav kundër Shqipërisë të shtrohej «sa më shpejt në Këshillin e Lidhjes në bazë të neneve 12 e 15 të Paktit të Lidhjes së Kombeve».¹

Mirëpo Lidhja qëndroi krejt pasive dhe ishte vështirë të jepte një provë më bindëse jo vetëm të pafuqisë, por edhe të manipulimit të saj nga ana e Fuqive të Mëdha që bënë ligjin në atë organizatë. Me siguri as Noli vetë nuk e priste që Lidhja të dilte aq e zbuluar ashtu siç e pati karakterizuar ai vetë në fjalimin e tij të 10 shtatorit.

Procedura e ndjekur me këtë rast në organet e Lidhjes ia vlen të vihet në dukje si një parodi e misionit të saj të vërtetë. Si hap të parë Sekretariati ia përcolli telegramin e Qeverisë shqiptare ministrit të Jugosllavisë në kryeqytetin e Zvicrës, Bernë. Ky nuk u nxitua të jepte përgjigje: kaluan 6 ditë dhe ai i solli sekretarit të përgjithshëm një letër të giatë të ministrit të Jashtëm Ninciç, më datë 24 dhjetor, letër në të cilën ai nuk ngurronte të sfidonte gjithë opinionin ndërkombëtar, duke mohuar faktet. Ai e cilësonte ankesën shqiptare si një provokacion që nuk kishte tjetër qëllim veçse të njolloste Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene përpara Këshillit të Lidhjes së Kombeve». Sipas Ninciçit, «tmerret e një invazioni të huaj nuk ekzistonin veçse në imagjinatën e Qeverisë shqiptare», ndërsa «trazirat e tanishme nuk kishin tjetër burim veçse pakënaqësinë e popullsisë», prandaj Qeveria e Tiranës përpiqej ta fshihte gjendjen reale, duke «ngritur akuza sa të rënda, aq edhe të paqena kundër një shteti fqinj». Për të bërë sa më shumë efekt Ninciçi nuk

1) Letër e delegacionit shqiptar në Gjenevë drejtuar sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes datë. 20.12.1924. Kopja në AQSH, *fondi* 251, v. 1924, d. 258, fl. 10.

gjente «argument» më të fortë se insinuata që «qeveria e Tiranës ishte e lidhur me Internacionalen III».¹

Ndërkaq, Qeveria e Nolit kishte rënë dhe Zogu kishte hyrë në Tiranë. Kurse në Gjenevë jepej përshtypja se procedura do të ndiqte kanalet «normale». Më 22 dhjetor përfaqësuesi shqiptar telegrafonte se kishte njoftime se «Sekretariati së afërmi do të vepronte sipas kërkesës (së Qeverisë shqiptare)», se «çështja do të shtrohej përpara Këshillit në bazë të neneve 12 dhe 15 të paktit që parashikonin një procedurë më të shpejtë».²

Në të vërtetë Lidhja nuk ndërmoi asgjë, çështja u la zvarrë. Kjo zvarritje ishte e llogaritur, sepse më 27 dhjetor Zogu u drejtohej me telegram gjithë përfaqësive shqiptare në kryeqytetet kryesore, pra edhe në Gjenevë, për t'iu njoftuar rrëzimin e «Qeverisë revolucionare të Fan Nolit» dhe marrjen e fuqisë nga ana e tij si «komandant i përgjithshëm i operacionit» në pritje të rivendosjes së «qeverisë legale».³ Në mes të shkurtit 1925 përfaqësuesi shqiptar në Gjenevë mori urdhër nga qeveria «e re» (që ishte formuar një muaj më parë, më 15 janar) se tërhiqte ankesën e qeverisë së mëparshme. Siç shkruan historiani anglez J. Suajër (J. Swire), «Jugosllavia është mbështetur gjithmonë në politikën e faktit të kryer dhe kjo u duk qartë se i shkoi edhe në Lidhjen e Kombeve», sepse «po që se Lidhja do të ndihmonte Shqipërinë, ajo duhej ta trajtonte çështjen me metoda më ekspeditive».⁴

Por kjo tanimë nuk habiste njeri, opinioni i përgjithshëm, përkrahës e kundërshtarë, e kuptonin se Organizata e Gjenevës përdorej si një dekor, një paravent i politikës së më të mëdhenjve e më të fortëve. Mjafton të përmendet një koment i gazetës së madhe të Londrës «Taims» (The Times) të

1) Letër e Ninçicit drejtuar sekretarit të përgjithshëm Drumond datë. 24.12.1924. Kopja në AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 132, fl. 62-64, J. Swire, vep. cit., p. 449*. Ky autor i krahason këto pohime të Ninçicit me deklaratat që ai do të bënte disa vjet më vonë pas Paktit të Tiranës të vitit 1926, kur do të shpallte botërisht se Zogu kishte pasur përkrahjen vendimtare të Jugosllavisë. *Po aty*. Me këtë gjest Ninçici do të pranonte dështimin e politikës së tij të mbështetur në miqësinë me Italinë.

2) Tel. nga Gjeneva datë 22.12.1924. AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 257, fl. 204*.

3) Tel. drejtuar përfaqësive shqiptare në kryeqytetet kryesore datë 27.12.1924. AQSH, *fondi 251, v. 1924, d. 264, fl. 136*.

4) J. Swire, *vep. cit., p. 450*.

atyre ditëve, që veç të tjerave, dallohet edhe për një frymë denigruese antishqiptare. «Pak përpara se të binte, — shkruante gazeta, — Qeveria e Nolit bëri një demarsh pranë Lidhjes së Kombeve kundër Jugosllavisë se gjoja kjo ka qenë e përzier në lëvizje. Lidhja e Kombeve është marrë edhe tjetër herë me punët e Shqipërisë dhe e pranoi më 1920 Shqipërinë si anëtare të Lidhjes, pranim për të cilin mund të thuhet se u nxitua. Ky demarsh mund të shkaktonte interesimin e Lidhjes së Kombeve sikur A. Zogu të mos kishte fituar, por tani që fitoi, Ahmet beu do ta tërheqë nga Lidhja e Kombeve këtë kërkesë të F. Nolit. Më e mira punë për të gjitha shtetet është ta pranojnë se kjo çështje u mbyll dhe fatbardhësisht duket se të gjithë këtë dëshirojnë».¹

Nga sa më sipër, shihet se aksionin e saj diplomatik rreth intervencionit, Qeveria e Nolit e ka përqendruar kryesisht pranë tri Fuqive perëndimore dhe Lidhjes së Kombeve. Ajo nuk la pa bërë ndonjë përçapje edhe pranë qeverive të Beogradit e të Athinës.

Po atë ditë që iu drejtua tri Fuqive dhe Lidhjes më 18 dhjetor, Noli hartoi me dorën e tij një telegram për legatën shqiptare në Beograd. Ministrit Kolonja i kërkohej që të paraqitej pa vonesë në Ministrinë e Jashtme për të protestuar kundër «pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të trupave të rregullta serbe në operacionet» kundër Shqipërisë; ajo kishte të gjitha tiparet e «një shpalljeje lufte të maskuar nga ana e Serbisë».² Zëvendësministri i jashtëm Markoviç i quajti «akuzat të pambështetura në dokumente», prandaj jo vetëm e hodhi poshtë notën shqiptare, por edhe refuzoi ta merrte në dorëzim, duke e cilësuar si «të pavlefshme e të paqenë».³ Ky ishte kontakti i fundit i Qeverisë së Nolit me atë të Beogradit.

Nën presionin e lajmeve që mbërrinin gjithnjë më shumë nga Jugu e që linin të kuptohej se po hapej një front i dytë në anën e kufirit me Greqinë, Qeveria e Nolit nuk mund të rrinte pa ndër marrë disa hapa edhe pranë autoriteteve greke. Sidomos në raportet e telegramet që vinin ato ditë nga Gjirokastra jo vetëm që viheshin në dyshim deklaratat e

1) Koment i gazetës «The Times» datë 30.12.1924, cituar sipas gazetës «Dajti» datë 15.1.1925.

2) Tel. i Nolit legatës shqiptare në Beograd datë. 18.12.1924. AQSH fondi 251, v. 1924, d. 257, fl. 192.

3) Lajm gazete nga Beogradi datë. 21.12.1924. AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 170, fl. 108, 130.

qeverisë greke mbi asnjësinë dhe mospërzjerjen në punët e brendshme të Shqipërisë, por kërkohej me insistim që të bëheshin përçapjet diplomatike të rastit në Athinë.¹ Kufiri i Jugut ishte lënë pothuajse i zhveshur, forcat e mbrojtjes ishin minimale, sepse aq më pak pritej një sulm nga kjo anë. Në pamundësi për të organizuar një qëndresë serioze, shpresohej të gjendej zgjidhja në rrugën e diplomacisë.

Kështu legatës shqiptare në kryeqytetin grek iu kërkua që ta shtronte çështjen në Ministrinë e Jashtme. Më 16 dhjetor i ngarkuari me punë pati një takim me drejtorin e përgjithshëm të kësaj ministrie, takim gjatë të cilit ai i tërhoqi vëmendjen rreth incidentit të Kakavijës. Në Athinë tani kishin përcaktuar taktikën e «hedhjes së gurit e fshehjes së dorës». Në të vërtetë, drejtori në fjalë, krahas sigurimeve të përsëritura «mbi qëllimin e Greqisë për të mbajtur asnjësinë», premtoi se «do t'u jepeshin urdhra menjëherë autoriteteve të Epirit për t'i larguar nga kufiri elementët turbullues».²

Më 17 dhjetor i ngarkuari me punë i Shqipërisë mori të njëjtat sigurime e premtime edhe nga goja e vetë ministrit të Jashtëm Rusos.³ Tërheq veçanërisht vëmendjen ajo pjesë e deklaratës së ministrit Rusos, në të cilën ai dukej sikur i bën jehonë asaj prirje që vihej re në rrethet politike si dhe në opinionin shqiptar për një afrim me Greqinë, afrim që mund të çonte deri në lidhjen e një marrëveshjeje politike. Rusos u shpreh me këto fjalë: «Ju lutem të siguroni qeverinë tuaj që nga ana jonë të jetë e qetë se Greqia ushqen dispozitat (ndjenjat) më të mira kundrejt Shqipërisë dhe nuk ka aspak ndër mend të përzihet në punët tuaja, (ajo) do t'i lejë shqiptarët të rregullojnë vetë punët e tyre si ta shohin më mirë». Ai (Rusos) uronte «që kriza e tanishme të kalojë sa më shpejt, të stabilizohet gjendja, që të mundemi kështu të lidhim ato marrëveshje që do të na lejojnë të zgjidhim çështjet e mbetura pezull dhe të shtrëngojmë më tepër relatat midis dy shteteve».⁴

1) Shih një numër telegramesh nga Gjirokastra datë 15. 16, 17, 19 21. 12.1924 në AQSH, *fondi 252, v. 1924, d. 77.*

2) Tel. i legatës shqiptare nga Athina datë 16.12.1924. AQSH, f. 251, v. 1924, d. 209, f. 23.

3) Tel. i legatës shqiptare nga Athina datë. 17.12.1924. *Po aty, fl. 24.*

4) Raport i legatës shqiptare nga Athina datë. 20.12.1924. AQSH, f. 251, v. 1924, d. 149, fl. 16-17.

Edhe komenti që i ngarkuari me punë i Shqipërisë i bënte deklaratës së ministrit grek është kuptimplotë, sepse tregon se sa e mirëpritur ishte në qarqet shqiptare çdo shenjë, çdo fjalë në favor të afrimit greko-shqiptar si një kundërpeshë ndaj politikës jugosllave. «Politika antishqiptare e Jugosllavisë, — thuhej në raportin e mësipërm, — frika e një marrëveshjeje italo-serbe për copëtimin e Shqipërisë si dhe lajmet lidhur me një marrëveshje midis Jugosllavisë e Bullgarisë në kurriz të Greqisë, kanë shkaktuar një kthesë në opinionin publik në favor tonë dhe shumë gazeta kanë ndërruar taktikë (ton), kanë filluar të shkruajnë me simpati për luftimet midis ushtrisë nacionale dhe rebelëve të organizuar prej një Fuqie të huaj».¹ Më e pakta që mund të thuhet është se një arsyetim i tillë bëhej me vonesë. Shqetësimet dhe dyshimet e qarqeve zyrtare e jozyrtare në Greqi mund të ishin reale përballë zhvillimit që po merrnin ngjarjet në dhjetor. Mirëpo faktet tregojnë se preokupacioni më i madh i qeverisë së Athinës ishte që të mos mbetej jashtë loje. Me gjithë sigurimet e përbetimet e përgjegjësve të politikës së jashtme greke, bazë e dytë e intervencionit ishte territori grek. Në të vërtetë, forcat mercenare të Mufit Libohovës u futën nga Greqia, si pjesë e një operacioni të kombinuar, ndërkohë që bandat zogiste dhe forcat jugosllave po vepronin tanimë në Veri. Është e qartë se pjesëmarrja greke në intervencion nuk barazohet me atë jugosllave. Siç u tha, as nga ana ushtarake, as nga ajo diplomatike, konflikti me Greqinë nuk mori asnjëherë atë karakter dhe ato përmasa që pati me Jugosllavinë. Qeveria e Nolit e bëri deri në fund këtë diferencim. Është kuptimplotë fakti se ankesën e saj në Lidhjen e Kombeve për agresion, ajo e formuloi në adresë të qeverisë jugosllave, por jo dhe në atë të qeverisë greke. Madje, gjatë ditëve të «nxehta» të luftimeve, në mes të dhjetorit, kur në qytete të ndryshme zhvilloheshin mitingje popullore proteste kundër intervencionit.² Kryeministria u jepte udhëzim prefekturave, që telegramet e protestës t'u dërgoheshin qeverive të Fuqive dhe Lidhjes së Kombeve, por vetëm kundër Jugosllavisë.³

Lajmet që vinin nga Jugu flisnin edhe për sulme të përsëritura, edhe për përkrahjen e bandave kundërrevolucionare nga ana e autoriteteve greke, e megjithatë, në Ti-

1) *Po aty.*

2) A.Q.S.H. fondi 251, v. 1924, d. 209, 210.

3) A.Q.S.H. fondi i Kryeministrisë, v. 1924, d. 99 (Min. Brend).

ranë ishin të prirur t'u besonin justifikimeve që vinin drejtpërdrejt nga Athina ose nga legata greke në Durrës se autoritetet greke as nuk ishin në dijeni të këtyre ngjarjeve e as kishin mundësi t'i kontrollonin, sepse «relievi i terrenit në zonat kufitare nuk lejonte një mbikqyrje rigoroze».¹

Pa dyshim, kur shtrohet çështja që të jepet një gjykim më i përgjithshëm mbi marrëdhëniet shqiptaro-greke gjatë gjithë kohës së qëndrimit në fuqi të Qeverisë Demokratike, politika e Athinës nuk mund të vihet në një plan me atë të Beogradit. Kursi haptazi armiqësor dhe agresiv i qeverisë jugosllave është unikal, nuk gjen përsëritje në asnjërën prej qeverive fqinje. Athina në qëndrimin e saj pati disa zigzage, politika e saj ruajti disa aspekte ekuivoke. E, megjithatë, kur ndodhesh përballë fakteve konkrete si ato të dhjetorit, nuk mund të mos arrish në përfundimin se qeveria greke u rreshtua po ashtu (ndonëse jo në vijën e parë) në frontin e përbashkët të reaksionit ndërkombëtar për mbytjen e Revolucionit Demokratik në Shqipëri.

1) Tel. i ministrit të Greqisë Panurias datë. 22.12.1924. AQSH, *fondi* 251, v. 1924, d. 264, fl. 121-122.

M B Y L L J E

Në përfundim të këtij studimi, duke i hedhur një vështrim tërësor veprimtarisë së Qeverisë Demokratike të dalë nga Revolucioni i Qershorit të vitit 1924, mund të jepen disa gjykime të përgjithshme për të karakterizuar tiparet e momentet kryesore në marrëdhëniet e saj të jashtme.

1) Në politikën e saj të jashtme Qeveria Demokratike e Noli ndoqi *vijën e pavarësisë*. Qysh prej krijimit të Shtetit të ri shqiptar më 1912-1913, asnjë qeveri e vendit nuk kishte treguar kaq mëvetësi dhe vetëveprim, nuk kishte ngritur me kaq guxim zërin në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të kombit. Për herë të parë pavarësia e Shqipërisë, që prej shpalljes së saj, po vihej në rrugën e realizimit në praktikë: ajo nuk duhej të ishte vetëm një pavarësi në formë, por edhe një pavarësi e cila të gjente shprehje në qëndrime e veprime konkrete në plan ndërkombëtar. Shqipëria mbeti kështu, për një kohë, jashtë sferës së ndikimit të Fuqive të Mëdha. Për një vend të vogël si Shqipëria, kjo ishte një arritje dhe një meritë me rëndësi të veçantë.

Viti 1924 dhe sidomos gjashtë muajt e qëndrimit të Qeverisë së Nolit në fuqi, qenë prova më e mirë se populli shqiptar ishte i përgatitur dhe i aftë jo vetëm për të qeverisur vetë, pa ndërhyrje e «asistencë» nga jashtë, por edhe për të ecur me pjekuri e vetëdije në rrugën e zhvillimit të pavarur demokratik. Në gjirin e shoqërisë shqiptare kishte forca, që mund ta orientonin atë drejt objektivave të emancipimit social e kulturor.

2) Në marrëdhëniet e jashtme Qeveria e Nolit është udhëhequr nga koncepte të përparuara (për kohën dhe vendin) *demokratike dhe progresiste*. Kjo mund të thuhet në radhë të parë për marrëdhëniet me shtetet fqinje, por edhe për problemet më të përgjithshme të zhvillimit botëror të kohës. Me shtetet kufitare ajo gjeti mjaft probleme të cilat i përballoi me një angazhim të thellë për mbrojtjen e të drejtave të Shqipërisë, të popullsisë shqiptare jashtë kufijve të saj. Por ajo kërkoi me ngulm fqinjë-

sinë e mirë përballë mbylljes hermetike që gjeti në Ballkan. Praktikave shoviniste intervencioniste, që u manifestuan në forma aq të vrazhdëta sidomos nga ana jugosllave, ajo iu përgjigj me qëndrimin e moderuar dhe fjalën e matur, duke hedhur (ndoshta me druajtje të kuptueshme, por edhe me sinqeritet të pamohueshëm), idetë e bashkëveprimet dhe solidaritetit ballkanik. Ajo ishte për forma të reja të marrëdhënieve ndërballkanike që mund të hapnin perspektivën e një bashkimi mbi baza federative, ëndërr e vjetër kjo, e prekursorëve të idesë socialiste në gadishull, një ëndërr që kishte një dozë të theksuar utopie, por që, megjithatë, ruante forcën e saj tërheqëse dhe ishte treguese e një pozicioni të caktuar të Qeverisë Demokratike lidhur me marrëdhëniet me shtetet fqinje.

Qeveria e Nolit e tha fjalën e saj edhe për problemet e mëdha të politikës botërore të kohës. Fjalimi i Nolit në Asamblenë e Lidhjes së Kombeve në shtator ishte manifesti i qeverisë së re për këto probleme. Edhe këtu ajo u bëri jehonë ideve më të përparuara, duke treguar një guxim të madh politik. Ajo denoncoi botërisht demagogjinë dhe hipokrizinë e krerëve të Fuqive të Mëdha në një varg çështjesh që përbënin repertorin e politikës botërore si çarmatimi, reparacionet. «procedura e pajtimit» për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Përballë parullave pacifiste, ajo vuri aspiratat e popujve për paqe, vëllazërim, arsim, thirrjen për bashkimin e të gjithë popujve kundër luftës («vrasjeve me shumicë»), kundër qarqeve luftënxitëse («hyjnive antropofage»).

3) Qeveria e Nolit ra në një *izolim diplomatik* gati të plotë. Kjo ishte përgjigjja e reaksionit ndërkombëtar kundrejt programit të Qeverisë së re, që i frikësoi Fuqitë me «radikalizmin» e tij. Qeveria e Nolit bëri përpjekje të dëshpëruara për të dalë nga kjo situatë, por ndeshi gjithmonë në murin e heshtjes e të armiqësisë së hapët në Evropë dhe në Ballkan. Një pasqyrë e pozitës së saj të vështirë ishte bilanci përgjithësisht negativ i delegacionit të kryesuar nga Noli në Asamblenë e Lidhjes së Kombeve në Gjenevë. Qeverisë Demokratike nuk i mbeti mjaft hapësirë për të vepruar në fushën e politikës së jashtme, por nga ana tjetër, ajo nuk e pati vetëdijen e plotë të rrezikut të intervencionit nga jashtë, nuk e sensibilizoi opinionin ndërkombëtar në kohën e duhur, diplomacia e saj nuk i shfrytëzoi të gjitha mundësitë dhe veproi me ngath-

tësi e vonesë. Revolucioni i Qershorit u gjend në një rrethim të dyfishtë: brenda dhe jashtë. Bllokada e jashtme e kushtëzoi në një shkallë të konsiderueshme veprimtarinë e Qeverisë brenda vendit: ajo nuk qe në gjendje t'i kush-tonte energji dhe vëmendje të mjaftueshme realizimit të programit të shpallur në qershor.

4) Në gjithë veprimtarinë e jashtme të Qeverisë së Nolit Lidhja e Kombeve zë një vend të veçantë. E ndodhur përballë izolimit ndërkombëtar, si kundërpeshë, ajo vendosi ta përqëndronte aksionin e saj në Lidhjen e Kombeve. Përvoja e viteve 1920-21 pati ndikimin e vet. Me gjithë kritikën e forta që shqiptoi në adresë të Lidhjes nga tribuna e Asamblesë, Noli dhe Qeveria e tij nuk i lanë asnjëherë shpresat për të vendosur një raport të privilegjuar me Organizatën e Gjenevës. Mbizotëronte mendimi se Lidhja ishte e vetmja alternativë kundrejt omnipotencës së Fuqive të Mëdha, e vetmja «strehë» e vendeve të vogla dhe, pra, ajo do të ishte «edhe një herë» shpëtimtarja e Shqipërisë. Pa dyshim prirja e Qeverisë Demokratike për të kërkuar mbështetjen kryesore të Lidhjes ishte një dëshmi tjetër e kursit të pavarësisë, përderisa mendohej si një mënyrë për t'i patur «duart e lira» në politikën e jashtme dhe për t'i dalë përpara hegjemonisë së kësaj apo asaj fuqie të veçantë. Nuk mund të mohohet se këtu kishte një logjikë, por ishte një gabim i rëndë që Qeveria e Nolit e mbivlerësoi Lidhjen, duke e parë gati si një faktor parësor në marrëdhëniet ndërkombëtare të kohës, si krejt të shkëputur nga politika e Fuqive të Mëdha. Ky gabim pati pasojat fatale, sepse besimi i tepruar në Organizatën e Gjenevës ishte një ndër arsyet që e lanë të shkujdesur Qeverinë e Nolit përballë përgatitjeve të sulmit, që bëheshin sidomos në territor jugosllav. Epilogu ishte i trishtueshëm: në dhjetor 1924 qeveria e Nolit u la në fatin e saj dhe në analet e Lidhjes u regjistrua kështu shkëlja e parë e rëndë e statutit lidhur me mbrojtjen nga agresioni të çdo shteti anëtar.

5) Rrëzimi i qeverisë demokratike dhe shtypja e Revolucionit të Qershorit në Shqipëri ishte rezultat i drejt-përdrejtë i intervencionit të huaj, i një aksioni të kombinuar që mori trajtën e një komploti ndërkombëtar. Vësh-tirësitë që hasi qeveria brenda vendit, nuk ishin të pakta. Forcat reaksionare nuk u pajtuan me disfatën e Qershorit dhe nuk qëndruan duarkryq. Asnjë veprimtari poli-

tike nuk mund të kryhet në tërë gjerësinë pa një prapavijë të sigurtë e të qetë. Në qoftë se politika e jashtme është vazhdimi i politikës së brendshme, duhet thënë se Qeveria Demokratike nuk e siguroi dot tabanin brenda për të vepruar me sukses jashtë. Mangësitë e theksuara në politikën e brendshme (premtimet që nuk u mbajtën, masat gjysmake dhe pavendosmëria në luftën kundër elementit reaksionar), i komprometuan shanset për konsolidimin e fitores së lëvizjes popullore. Pa zvogëluar rëndësinë e këtyre mangësive, pa mohuar efektin e tyre shkatërrues në nivelin e gjithë veprimtarisë së Qeverisë Demokratike, gjithsesi procesi demokratik-revolucionar i filluar në Shqipëri u ndërpre brutalisht me ndërhyrjen e jashtme. Pikërisht intervencioni i huaj ishte faktori kryesor i kthesës kundërrevolucionare në dhjetor. Komploti ndërkombëtar kundër Revolucionit të Qershorit u zhvillua në dy etapa kryesore: së pari, me sulmin diplomatik kundër Qeverisë së Nolit, me mosnjohjen e saj dhe prerjen e marrëdhënieve zyrtare me të; së dyti, kur kjo doli e pamjaftueshme, me sulmin ushtarak të forcave të huaja që shënoi fundin e saj. Baza e organizimit të komplotit ndërkombëtar ishte territori jugosllav, por në të një rol të dorës së parë patën shtetet dhe shoqëritë kapitaliste, në mënyrë të veçantë qeveria britanike.

6) Revolucioni i Qershorit duhet të zërë një vend tepër të rëndësishëm në historinë e popullit shqiptar. Qeveria e dalë prej tij përbën një nga shfaqjet më interesante të demokracisë shqiptare. Qoftë nga përbërja, apo nga programi, ajo ngjalli po aq shpresa brenda vendit, sa shkaktoi shqetësime jashtë. Në periudhën e shkurtër qershor-dhjetor 1924 ajo qe e detyruar të luftonte në dy fronte: kundër atyre që Noli do t'i quante më vonë «dy sëmundjet kryesore të Shqipërisë» — feudalizmit në jetën e brendshme dhe imperializmit në arenën ndërkombëtare. Rrethanat e jashtëzakonshme të brendshme dhe të jashtme nuk mund të lihen mënjanë kur shtrohet çështja e vlerësimit të saj historik.

Është kreyt me vend që të vihen në dukje e të analizohen shkaqet e dështimit të revolucionit; është po ashtu e drejtë të sqarohen lëkundjet, inkonsekuencat dhe gjysmëmasat e Qeverisë së Nolit, në zbatimin e programit të saj. Është fakt se, e ndodhur midis dy zjarreve, ajo shkau nga pozitat e qershorit dhe u tërhoq në të gjithë linjën. Por asnjëherë nuk duhet shkëputur vepra e saj nga konteksti

ndërkombëtar ballkanik, madje më gjerë — evropian. Për më tepër mund të konkludohet se e papritura nuk është që revolucioni u shtyp e që Qeveria e Nolit u rrëzua, e jashtëzakonshmja dhe kryesorja është që në ato kushte revolucioni arriti të fitojë, që një qeveri e tillë «kryengritëse radikale» mundi të vijë në fuqi e të qëndrojë në krye të Shqipërisë, duke sfiduar frontin unik të reaksionit ndërkombëtar.

7) Ndonëse jetëshkurtër dhe i papërfunduar, Revolucioni i Qershorit la pas një trashëgimi me vlerë historike të padyshimtë. Nëpërmjet qeverisë së dalë prej tij ai i dha trup e shpirt, në mjedisin shqiptar, idealit të emancipimit social. Është e qartë se fillimet e luftës kundër shtypjes feudale shkonin thellë në historinë shqiptare, por kjo luftë nuk ishte bërë me shkallën e duhur të vetëdijes së intereseve klasore dhe të mundësive të mëdha që jepte aktivizimi i masave të gjëra të popullit të thjeshtë. Në këtë kuptim mund të thuhet se Revolucioni i Qershorit tregoi se jo vetëm mund të luftohej në frontet e betejave klasore, por edhe të fitohej në këtë luftë.

Në mënyrë të veçantë fshatarësia shqiptare nxori një mësim të madh për t'u shkundur nga kompleksi shekullor dhe për të kuptuar pak nga pak rolin aktiv dhe vendin që do t'i takonte në një Shqipëri që nuk do të ishte doemos një çiflig i «oxhaqeve të mëdha».

Nuk është gjithashtu një gjë e rastit që pikërisht të nesërmen pas Revolucionit të Qershorit, edhe pse në kushtet e reaksionit më të zi, lëvizja punëtore në vendin tonë merr një hov të ri dhe, duke u mbështetur në këtë përvojë revolucionare të vyer, fiton gjithnjë më shumë tiparet e një lëvizjeje klasore në kuptimin e mirëfilltë.

Veç asaj, në Revolucionin e 1924-s mori pagëzimin e zjarrit gjenerata e revolucionarëve shqiptarë që do të çonin përmes errësirës zogiste pishtarin e lirisë dhe të drejtësisë. Mbi supet e tyre do të binte më tej barra për t'u hapur rrugën ideve dhe lëvizjes komuniste që do të afirmoheshin në Shqipëri në vitet 30.

Pa premisën sado të largët të Revolucionit të 1924-s nuk do të mund të kuptohej evolucioni i mëtejshëm i Shqipërisë bashkëkohore ku Lufta e Madhe Nacionalçlirimtare dhe Revolucioni Popullor bënë sintezën e përpjekjeve shekullore dhe hapën një epokë të re në historinë shqiptare — epokën e shoqërisë socialiste.

8) Çdo vlerësim sado global i Revolucionit të Qershorit

dhe i qeverisë së dalë prej tij kërkon një gjykim edhe të figurës e të rolit të vetë Nolit. Qysh përpara qershorit ai zuri një vend qendror në skenën politike shqiptare, kurse pas fitores së kryengritjes ai u vu përpara misionit më të lartë që kishte patur ndonjëherë. Duke u vënë në krye të qeverisë, ai duhej të udhëhiqte veprën e realizimit në praktikë të idealeve të Rilindjes për krijimin e një shteti shqiptar modern të orientuar drejt një modeli të përparuar të demokracisë politike e sociale. Në vetëvete ai përmbledh edhe meritat, edhe dobësitë e Qeverisë Demokratike, edhe kufizimet e Revolucionit të Qershorit. Revolucioni i Qershorit dështoi, por jo pa lënë gjurmë në historinë shqiptare. Shqipëria nuk do të kthehej më në gjendjen e mëparshme. Edhe pse u shtyp, përvoja revolucionare e 1924-s, do të përgatiste terrenin për përshpejtimin e lëvizjes demokratike antif feudale dhe antiimperialiste derisa në Shqipëri do të hidhnin rrënjë idetë marksiste. Në shumë fusha, por edhe si politikan e diplomat, Noli i ka sjellë kombit shërbime të paçmueshme. Për këtë aspekt të veprimtarisë së tij Noli është shprehur me një ndjenjë të theksuar modestie. Pas revolucionit, ai do të shkruante: «S'kam patur, as kam ambicie për fushën politike, në të cilën jam zvarnisur gjithnjë me pahir e me gjysmë zemër, i shtrënguar prej «Vatrës», prej shokëve dhe nga ndjenja e detyrës. Në Lidhjen e Kombeve kam vajtur gjithnjë i shtyrë pothuaj me një zë prej shokëve dhe kundërshtarëve. Kam akseptuar (pranuar) kryeministrinë (në qershor 1924 — A.P.) se s'muntja të hiqesha nga vallja me nder e pa dezertuar shokët...»¹. Kjo duhet kuptuar si një shfaqje tjetër e vetëzhgënjimit të tij, ndoshta edhe e vetëpranimit për mjetet e kufizuara «në fushën politike». Por shprehja është e tepëruar, «hakëngrënëse», sepse edhe me aq sa bëri, Noli radhitet me të drejtë ndër personalitetet më të shquara të lëvizjes për çlirimin kombëtar dhe social të shqiptarëve. Veçanërisht veprimtaria e Nolit pas Luftës I ka patur rëndësi vendimtare jo vetëm për pranimin e Shqipërisë në bashkësinë ndërkombëtare, por edhe për ato procese demokratike që u dukën në jetën e vendit dhe që përgatitën etapën e re të zhvillimit të tij.

Së fundi, me gjithë epilogun fatkeq që pati Revoluci-

1) Nga «Përgjigje» «Diellit», shkurt 1926, në *Fan S. Noli, Veprat, vëll. 3. Tiranë, 1987, f. 40.*


oni i Qershorit, Noli mbetet si protagonist kryesor i një ndërmarrjeje historike, e cila, edhe pse nuk i arriti objektivat imediate, paralajmëroi falimentin e një rendi me mbeturina të forta mesjetare dhe hapi horizonte për përëritjen demokratike të shoqërisë shqiptare. Kudo, pra edhe në fushën politike, emri i Nolit ka qenë dhe mbetet i lidhur me idealet më përparimtare. Në Revolucionin e Qershorit Noli zbriti nga sfera e predikimit dhe frymëzimit të këtyre idealeve në terrenin e një veprimtarie konkrete e të përkushtuar për realizimin e tyre. Duke qenë në krye të Qeverisë Demokratike ai tregoi se ishte pikërisht forca e idealit dhe jo etja për pushtet që e shtynte në veprën e tij politike. Mund të themi, përsëri bashkë me R. Qosen, se Noli ishte një «Moisi modern». Ndonëse nuk e çoi dot popullin e vet në «tokën e premtuar», megjithatë «Moisiu» i qershorit ushtroi një ndikim të fuqishëm në mendjet dhe zemrat e shqiptarëve, duke qenë një pikë referimi e përherëshme dhe një udhëheqës shpirtëror i njohur përgjithësisht i qarqeve përparimtare në gjithë botën shqiptare.



Në zyrën e përfaqësisë shqiptare në Gjenevë: F. Noli, L. Gurakuqi, B. Blinishti. (Shtator 1924).

Fan Noli duke hyrë në sallën e Asamblesë së Përgjithshme të Lidhjes së Kombeve.





Salla ku zhvilloi punimet Asambleja e Përgjithshme e Lidhjes së Kombeve.

Delegacioni shqiptar i përbërë nga Fan Noli, Luigj Gurakuqi dhe Mehmet Konica në sallën e Lidhjes së Kombeve.



Vete - kritike

1) Jo mungese energjie per t'
imponuar njerës — se kam
imponuar Hasanin ne Forçe —
po negligjence absolute
per te ritur "leaders"
per shtabin tim qentral
si dhe per shtabet lo-
kale te pakten ne qar-
kum e Forçes, makar
sa n' Amerike.

~~1000000~~ Mekat Mortal.
qe s' lehet n' usnje Ferr.

Dorëshkrimi i Fan Nolit.

e Shqipërisë.

~~Që t'a sipëtonim duhej~~
pavarësisht

Që t'a sipëtonim duhej
luftë e brenda e luftë jashtë.
Therapia pra mori formën
e një perate double, se-
nuk ish e mundur të ndahet se-
mundja e brendshme nga
semundja e jashtme. Kokudhi
^{imperialist} Italian i duhet krimbi i fe-
odalizmes, ^{armate} se ky e kalpë trupin
e shqipërisë dhe s' i le fuqi
qe të nprohet kundër koku-
dit. Gjithashtu u duhet edhe
këmbave serbe dhe greke, se ky
krimp ua shtron në sofrë ku-
tonin: si gjelle të jetëshme.

Dorëshkrimi i Fan Nollit.

SHTOJCË

Kjo shtojcë, sikurse është theksuar edhe në parathënie, përmban një numër të kufizuar dokumentesh që kanë vlerë të veçantë si shprehje e mendimit të Nolit mbi Revolucionin e Qershorit, qoftë kur ishte në krye të Qeverisë Demokratike, qoftë edhe më pas, me një shkëputje kohore disavjeçare.

Këto dokumente mund të ndahen në dy kategori.

Në kategorinë e parë futen fjalimi i Nolit në Asamblenë e Lidhjes së Kombeve dhe intervistat e bisedat e tij me korrespondentë të organeve të shtypit të huaj, sidomos të vendeve fqinje. Këto materiale janë bërë objekt shqyrtimi të hollësishëm në faqet e këtij punimi, prandaj nuk shihet nevoja për komente të mëtejshme. Me përjashtim të fjalimit dhe «Proklamës» së dhjetorit që kanë gjetur vend në disa botime, të tjerat botohen për herë të parë.

Në kategorinë e dytë hyjnë tre dorëshkrimet e Nolit që i përkasin periudhës pas revolucionit, kur krahas gjykimeve që jep mbi gjendjen në Shqipëri dhe pozitën e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare, Noli bën edhe një analizë kritike të vendit dhe rolit të tij në zhvillimin e ngjarjeve shqiptare që prej fillimeve të veprimtarisë së tij politike.

Nuk ka qenë e mundur të përcaktohet me saktësi data e këtyre dorëshkrimeve, por duke u nisur nga përmbajtja ato mund të vendosen nga fundi i viteve 20 e fillimi i viteve 30 (më konkretisht vitet 1929-1932), kur Noli është në mërgim, por ende në Evropë, para largimit të tij përfundimtar për në Amerikë (1932).

Ndoshta do të ishte e udhës që këto tre dorëshkrime të analizoheshin një për një dhe në mënyrë të hollësishme. Por një trajtim i tillë do të dilte jashtë temës së kësaj monografie. Prandaj mendojmë të mjaftohemi me disa konsiderata të përgjithshme.

Ai që shkakton më pak vërejtje është pa dyshim dorëshkrimi në frengjisht. Veç dorës së Nolit aty nuk ka asnjë indikacion as për datën dhe vendin, as për destinacionin e shkrimit. Por nga vetë përmbajtja e tij del e qartë se

ai është destinuar për opinionin e huaj në radhë të parë për t'i dhënë atij një informacion përmbledhës e konçiz dhe kryesisht mbi gjendjen e fshatarësisë shqiptare, por edhe për të nënvizuar me atë rast pozitën e vartësisë së Shqipërisë kundrejt Italisë fashiste. Në fakt hetimi që bëri autori i këtij punimi nxori në shesh se ky është teksti i fjalimit që Noli pati mbajtur në Kongresin fshatar evropian të organizuar nga Internacionalja fshatare (degë e Internacionales Komuniste) në mars 1930 në Berlin. Sipas disa të dhënave rezulton që ai të jetë botuar po atë vit në revistën «La Fédération Balkanique» (Federata Ballkanike).

Dy dorëshkrimet e tjera paraqesin interes më të madh. Aty shtrohen disa nga problemet më të mprehta të jetës politike shqiptare, probleme që kanë të bëjnë si me momentin aktual ashtu edhe me të ardhmen e vendit.

Nuk mund të mohohet se aty janë hedhur disa mendime të sakta e objektive qoftë për sa u përket ngjarjeve, qoftë për sa u përket njerëzve.

Veçanërisht të goditura duken gjykimet mbi dobësitë e mangësitë në veprimtarinë politike të Nolit para dhe pas Qershorit. Në «Vetëkritikën» ai është sa i rreptë për të tjerët, aq edhe i pamëshirshëm për vete. Por shkrimin e përshkon një frymë fatalizmi, një ndjenjë zhgënjimi e dëshpërimi për disfatën që ka pësuar demokracia shqiptare. Këtu Noli bie jo një herë në teprime, madje me shprehje që çenojnë ndërgjegjen popullore. Është quajtur me vend që ky dokument të shoqërohet me disa shënime plotësuese, për arsye se ai pasqyron qartë vendimin e Nolit për ta mbyllur angazhimin e tij në jetën politike aktive.

Po ashtu rezerva ngjall edhe dorëshkrimi më i gjatë që është aq i ngjeshur në fakte e në mendime. Aty bëhet një pasqyrë besnike e situatës së brendshme dhe ndërkombëtare të Shqipërisë të një periudhe veçanërisht të vështirë, siç duket të jetë (sipas përmbajtjes) ajo pas shpërthimit të krizës ekonomike botërore (1929-1930).

Noli përdor gjithë forcën e fjalës së tij mjeshtërore për të denoncuar politikën e nënshtimit të Shqipërisë ndaj Italisë fashiste, si dhe synimet grabitqare të qarqeve shoviniste të vendeve fqinj. Është po aq rrëzqethëse tabloja që ai ngre me po ato nota dramatike mbi gjendjen e një populli të zhytur në mjerim e në errësi, të lënë në mëshirën

e klikës zogiste, shprehje e pushtetit të pakufizuar të bejlerëve e të forcave më retrograde.

«Diagnoza» është me të vërtetë tronditëse, por «terapia» shkaktonte mjaft pikëpyetje dhe ngjall dyshime. Noli na del më i vendosur se kurrë për ta vazhduar veprimtarinë e tij si përfaqësues i qarqeve më përparimtare, madje me një objektiv të qartë, e do të thoshim, të shtruar në rend të ditës: shërimin e Shqipërisë nga «dy sëmundjet e mëdha, e brendshme dhe e jashtme». Por a nuk hyjnë projektet e tij në atë «defekt të virtyteve» të tij, të cilin ai vetë në «Vetëkritikën» e quan «yrryshe duke mbyllur sytë»? Vlerësimet dhe zgjidhjet e propozuara prej Nolit nuk janë gjithmonë realiste. Ai flet vërtet për nevojën e vendosjes së lidhjeve me forcat brenda vendit, por krijohet përshtypja se shpëtimin ai e shikon në aksionin e «kolonive» revolucionare në botën e jashtme.

Edhe në këtë pikë shkrimi i Nolit të shtie në mendime. Tabloja që ai ngre mbi gjendjen në radhët e emigracionit është gjithashtu e dhimbshme. Përçarje njëra pas tjetrës e kanë copëzuar opozitën antizogiste jashtë kufijve dhe në këto kushte është vështirë të kuptohet se si ajo mund të luajë rolin që i atribuohet në përmbysjen e situatës shqiptare. Dyshime ngjallin edhe gjykimet mbi disa personalitete të mërguara dhe prirjet e tyre politike. Ndërsa për disa prej tyre historia e shqiptoi verdiktin, duke u vënë damkën kapitulluese antikombëtare (M.Kruja, A.Këlcyra, etj.) për disa të tjerë ajo nuk u dha hakë parashikimeve të Nolit. Janë të njohura kritikët e tij në ndonjë moment në adresë të Hasan Prishtinës, e të Komitetit të Kosovës, por vlerësimet e tij dolën të nxituara, të njëanshme e subjektive. Shikuar në tërë harkun kohor të veprimtarisë së tij patriotike Hasan Prishtina mbetet një nga personalitetet e shquara të Lëvizjes sonë Kombëtare, kurse Komiteti i Kosovës, pavarësisht nga disa inkonsekuenca e lëkundje. zhvilloj gjithnjë një veprimtari të dobishme për denoncimin e politikës shtypëse të Beogradit kundër popullsisë kosovare.

Dorëshkrimi, sipas çdo gjase, përcjell dhe shtjellon «Deklaratën» e prillit të vitit 1927, një dokument programatik në luftën «për të mbaruar misionin historik të çlirimit të kombit», të nënshkruar nga vetë Noli si dhe nga një numër aktivistësh të KONARE-së. Sigurisht kemi të bëjmë këtu me një nga dëshmitë më të pasionuara të Nolit kur ai përjeton fazën e ngritjes së veprimtarisë revolucionare progresiste.

Kështu shpjegohet që pjesa mbyllëse e dorëshkimeve është hartuar në një frymë të fortë mobilizuese, në formën e një thirrjeje për t'u hedhur në veprime konkrete për fitoren finale. Por gjithë kjo tingëllon tepër e largët, e parakohshme, iluzore kur dimë se në vetë radhët e emigracionit sundonte grindja dhe përçarja, kur idetë programatike nuk arrinin të hynin në realitetin brenda vendit, kur këta kalorës të shquar të idealeve kombëtare e demokratike niseshin në betejë të vetmuar e pa pasndjekje popullore. Nuk është e rastit që me «Vetëkritikën» grafiku i veprimtarisë së Nolit shënon rënie.

FJALIMI I FAN NOLIT NË ASAMBLENË V TË LIDHJES SË KOMBEVE

10 shtator 1924

Kam frikë se më i nxehti pagedashës, po t'i hedhë një sy veprës së kryer nga Lidhja e Kombeve gjatë këtyre 5 vjetëve, do t'i ngrejë duart drejt qiellit nga dëshpërimi dhe do të bërtasë: «Oh! Më mirë luftë sesa të gjitha këto llomotitje të mërzitshme për paqen!». Ç'kemi bërë për paqen? Çfarë bëjmë tani në këtë çast në këtë Asamble? Ajo që është bërë këta 5 vjet të shkuar pushon qetë-qetë në paqen e përrjetshme, mbyllur fort, varrosur në dosjet e vdekura të Sekretariatit, të ruajtura me kujdes prej atij fort të ndershmit e të shquarit xhentelmen, që është Sekretari i përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve. Është e vërtetë që Lidhja e Kombeve ka bërë disa shërbime të vogla për paqen në përgjithësi dhe në veçanti nuk lejoi copëtimin e Shqipërisë, duke siguruar kështu paqen dhe rendin në Ballkan.

Siç e dini, Shqipëria ishte një kaçkë e fortë për t'u thyer dhe më e rëndë për të ndarë, kështu që Lidhja e Kombeve me mençuri vendosi ta lejë Shqipërinë të qetë, të lirë, të lagur nga valët e Adriatikut.

Por, ju lutem, zoti Sekretar i përgjithshëm, përse refuzoni t'i jepni Shqipërisë një hua që do t'i lejonte të ecte vetë? Ne nuk na duhen më tepër se 300 milionë fr. ar. Apo është shumë? Atëherë po bëj gjestin elegant të zbres në shumën modeste prej 200 milionësh. Ju tundni kokën. E po jam gati të hyj në bisedime për një shumë më të vogël, p.sh. për 100 milionë. Më falni, mos pretendoni se nuk më keni takuar kurrë dhe, pra, nuk jeni i disponuar të më jepni asnjë dhjetësh? Atëherë merreni këtë kërkesën time dhe varroseni në dosjet e vdekura të Sekretariatit, kyçeni mirë dhe mbyteni fort përpara se ta futni në nekropolin tuaj, sepse mund t'ju dalë nga varri.

Ndoshta Sekretari i përgjithshëm ka dashur të thotë se ai nuk dëshiron që të hyjë në bisedime për një hua me një qeveri kryengritëse, që nuk ka parlament, një qeveri si ajo që kryeson i përunjuri prift që po ju flet. Po a e dini ju se ç'është parlamenti? Pa dyshim e dini. Por do

të keni një ide më të qartë kur t'ju them ç'mendoj për të. E, pra, parlamenti është një sallë ku mblidhen politikanë pa shpirt për të bërë prova operate (vivisectionner) në trupin e gjallë të racës së tyre, një sallë plot me gazra helmues, gazra mbytës, gazra që shkaktojnë lot dhe të qeshura dhe gjithë gazrat e tjerë që u përdorën gjatë luftës së fundit për t'u dhënë fund gjithë luftërave e për të vendosur paqen, atë paqe për të cilën po flasim.

Por, pasi ngulni këmbë, ne nuk refuzojmë të bëjmë zgjedhje të reja e të thërrësim atë plagë, atë fatkeqësi të madhe, atë bestytini të shëmtuar që është parlamenti, pasi të kemi bërë dy ose tre vjet qeverimi atëror. A do të pranoni atëherë, z. Sekretar i përgjithshëm, të më jepni pas tre vietësh atë luanë prej 400 milionë fr.ar për të cilën ramë dakord para disa minutash? Ju përgjigjeni prapë «jo». E dija.

Mirë, pra, le të flasim për paqen. Më duket se nuk ka gjë tjetër më të keqe se sa të bëjmë këtë. Them «më duket» — *I guess* — sepse dua që ju të gjithë të dini se unë kam banuar shumë vjet në Amerikë, në Boston, një qytet që ndodhet diku në Irlandë dhe që është i mbushur me O'Connors, O'Connells dhe Fitzgeralds,* të gjithë folës të mirë, folës fort të shquar, të cilët, bashkë me irlandezë të tjerë të ardhur nga qytete të tjera irlandeze, marrin përsipër gjithë barrën e të folurit në fushatat elektorale amerikane. Do të doja që kolegët tanë të nderuar, përfaqësuesit e Republikës së Irlandës, të sillnin këtu disa nga këta oratorë të mbaruar për të na mbytur me fjalime për paqen.

Nuk është aspak për t'u çuditur që amerikanët, gjermanët dhe rusët nuk kanë fort dëshirë të hyjnë në Lidhjen e Kombeve. Duket se nuk e çmojnë elokuencën tonë, punojnë me mend. Për emërin e perëndisë, z.kryetar, pse nuk u jepni fund këtyre llomotitjeve dhe pse nuk më jepni atë hua prej 500 milionë fr. ar që më premtuat para se të merrja fjalën?

Dhe tani që iu përgjigja pyetjes së parë: «Ç'ka bërë Lidhja e Kombeve këta 5 vjetët e fundit?», më lejoni të vij te pyetja e dytë dhe e fundit: «Ç'bëjmë ne tani në këtë Asamble.» Përgjigjja është shumë e lehtë. Do ta gjeni te Shekspiri: «Fjalë, fjalë, fjalë!», d.m.th. erë e asgjë më

*) Mbiemra karakteristikë irlandezë.

tepër. «Është një përrallë e thënë prej një idioti plot me bujë e tërbim, pa kurrfarë kuptimi».

Cili është përfundimi i gjithë këtyre bisedimeve të mençme e të thella mbi çarmatimin dhe traktatet e arbitrazhit?

Këto çështje iu dhanë për shqyrtim një komisioni, i cili do t'ia kalojë një nënkomisioni, i cili do t'ia parashtrojë konkluzionet e tij një konference që do të mbledhet së shpejti, dhe kjo konferencë do t'ia dërgojë përsëri këto çështje një komisioni, pastaj një nënkomisioni, i cili do t'ia referojë komisionit, i cili do t'i dërgojë një raport konferencës. Konferenca do të votojë njëzëri një rezolutë dhe kjo e fundit do t'i jepet për shqyrtim Këshillit të Lidhjes së Kombeve. Këshilli, nga ana e tij, do t'ia kalojë këtë rezolutë Asamblesë së ardhshme të Lidhjes, e cila do t'i drejtojë njëzëri një lutje zotit të plotfuqishëm atje lart në qiell. Dhe kur këto çështje të kenë bërë këtë cikël poetik zvarritjesh e kundërzvarritjesh, raportesh e kundërraportesh dhe mendimesh konsultative, atëherë ato do t'i dërgohen së fundi sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, i cili do t'i mbyllë me kyç mirë e mirë dhe do t'i varrosë në dosjet e vdekura të Sekretariatit, ku do të mbahen brez pas brezi.

Dhe kjo do të thotë, natyrisht, se e gjithë kjo histori ka mbaruar siç mbarojnë fluskat e sapunit. Por ç'fjalime, ç'fjalime të bukura të fryra e të stërfryra do të shoqërojnë këto rezoluta e këto dëshira! Sa fort i dua! I dua «me atë erën e keqe të moçaleve të fëlliqur, si kërma të pambulurara që helmojnë ajrin ku marr frymë». Por ja përse ju drejtova fjalën sot.

Dhe meqënëse po flasim për fluska sapuni, a mund të bëj disa vërejtje lidhur me fluskën më kolosale që ka nxjerrë historia moderne, dua të them — për planin Dawes (Dawes). Por a është vërtet një fluskë. Jo, është një kombinacion fluskash, kombinacion hipokrit, i ndërlikuar, djallëzor, infernal. Nuk është një fluskë ordinere, është një superfluskë. Por është e kotë të trembemi. Do të mbarojë edhe kjo fatalisht si të gjitha fluskat e vogla që ne lëshojmë këtu. Është tepër e ndërlikuar që të mund të ketë sukses; ajo mund t'i sigurojë ndonjë post nën-presidenti autorit të saj të shquar; por kam frikë se nuk do të dalin prej andej veçse shumë pak miliarda reparacionesh për Francën dhe Belgjikën. Këto dy vende presin

të nxjerrin ku ta di unë sa miliarda e miliarda. Uroj që vërtet t'i marrin. Nuk është aspak qëllimi im që t'i mërzis, por ky është fati. Kjo superfluskë e gjeneralit Daues do t'i përcillet në fund të fundit Lidhjes së Kombeve.

I dashur Sekretar i përgjithshëm, përgatitni, ju lutem, një kënd të thatë, një kënd shumë të thatë në varrin e dosjeve tuaja të vdekura, sepse ju e dini se z. Daues është amerikan dhe se Amerika është një vend i thatë*, megjithëse nga koha në kohë, me rrugë të nëndheshme, ajo njohet vetëm sa për t'u zbavitur, falë përpjekjeve fisnike të kontrabandistëve.

Duke folur për fluska përsëri më vjen në mend ajo huaja e bekuar prej 600 milionësh, të cilën i nderuari Kryetar i kësaj Asambleje, si dhe i dashuri Sekretar i përgjithshëm, më premtuan për Shqipërinë disa minuta më parë. Kjo hua është një fluskë paqeje, një fluskë paqeje fort konsistente. Por jo, nuk është aspak një fluskë; ajo që doja të thoshja është se kjo hua mund të përgatitë paqen në Ballkan, ajo mund të lehtësojë realizimin e konfederatës ballkanike; por a ia vlen të flitet për të? Z. Sekretar i përgjithshëm, mërrreni edhe atë dhe futeni në varrin e dosjeve tuaja të vdekura, futeni në nekropolin tuaj.

Pasi iu përgjigja dy pyetjeve që shtrova, më mbetet tani të nxjerr konkluzionin të cilin do ta diskutoj në trajtën e dy pyetjeve të tjera. Para së gjithash, në dritën e fakteve që u përmendën, a e vlen barra qiranë që të kemi një Lidhje të Kombeve? Së dyti, në rast se e vlen, cila duhet të jetë metoda për t'ia arrirë qëllimit që është paqja universale?

Pyetjes së parë do t'i përgjigjem në mënyrë pohuese. Edhe sikur Lidhja e Kombeve të jetë një ëndërr, një utopi që i bën skeptikët të tallen e të shtrembërojnë buzët, ajo duhet të qëndrojë aty si një ideal që interpreton aspiratat më fisnike të njerëzimit, ajo duhet të qëndrojë aty si një sfidë kundër lavdive groteske militariste. Ajo duhet të qëndrojë aty si një afirmativë solemne e vullnetit universal për paqe, ajo duhet të qëndrojë aty derisa bukuria e saj, fisnikëria e saj, shpirta njerëzore e saj, nevoja e domosdoshme e qenies së saj të kuptohen nga e gjithë bo-

* Ishte koha kur në SHBA ishin ndaluar pijet alkolike.

ta. Sepse, fundi i fundit, me gjithë të metat që ka sot, ajo meriton të pritët me këto fjalë:

*«Verweile doch, Du bist so schön!
(Oh, megjithatë qëndro, ti je kaq e bukur!).*

Përse të jemi kaq pesimistë? Aspiratat për paqe i kemi kudo dhe për këtë s'ka asnjë dyshim. Përndryshe ne nuk do të kishim as komedinë e flluskave e superflluskave, që po na mbulojnë. Dhe pikërisht sepse popujt duan paqe, burrat e shtetit, politikanët u servirin atyre kohë pas kohe flluska arbitrazhi, flluska çarmatimi, flluska sigurimi dhe superflluska reparacionesh.

Por paqja nuk do të vijë prej traktateve; këto janë të destinuara të hidhen shpejt a vonë në shportë. Paqja do të vijë nga edukimi shkollor. Duhet t'u mësojmë fëmijëve tanë se vrasjet me shumicë janë po aq krim sa edhe vrasjet me pakicë. Duhet t'u mësojmë se burimi i të gjitha të këqijave që mendojnë njerëzimin prej shekujsh janë hyjnitë e tribuve (perënditë e bajraqeve). Duhet t'u mësojmë se ka vetëm një perëndi që duhet t'i shërbejnë, perëndia e njerëzimit, e njëjtë për të gjitha tributë. Duhet t'u mësojmë të bëhen anëtarë të ndershëm të supershtetit që do të përmbledhë të gjitha tributë, të bëhen qytetarë fisnikë të federatës së përbotshme që është në realizim e sipër dhe që do të realizohet me siguri. Kur fëmijët tanë të kenë mësuar këto të vërteta të thjeshta, atëherë nuk do të kemi vetëm çarmatimin moral që do t'i paraprijë çarmatimit material, do të kemi gjithashtu bashkëpunimin e vërtetë të të gjitha racave të botës për sigurimin e paqes, progresit dhe prosperitetit ndërkombëtar. Të gjitha të tjerat sillen rreth kësaj. Këtu qëndron thelbi i çështjes.

Por përpara se të vijmë aty, duhet të pranojmë njëherë se jemi të gjithë tribu të egra, derisa i bëjmë kurbane njerëzish Molohut* të tribusë. Oh, vriji, varini, ndiqini, në të katër anët e botës këto hyjni barbare e antropofage që e kanë mbushur historinë e njerëzimit me kaq vujtje, me kaq urrejtje, me kaq rrënime, me kaq gjak, me kaq tmerr! Ah, do t'i shtiem në dorë kordhëtarët e vjetër! Vështroni sytë e njerëzimit që vuan pas shkatërrimeve të luftës bo-

*) Perëndi e egër.

tërore. Nuk ka dhembje që të mund të krahasohet me dhembjen e tij, asnjë sakrificë nuk do të ishte tepër e madhe për t'i shpëtuar fëmijët tanë nga luftëra të reja dhe lot të tjerë.

Përpara o shokët e mi! Bota është gati për Ungjillin e ri. Flamuri i Lidhjes së Kombeve është më fisniku që është ngritur deri më sot. Ushtarët e saj janë më trimat që ka nxjerrë bota ndonjëherë. Qëllimi i saj është maja e përparimit të njerëzimit. Shpirti i Vilsonit, ati dhe profeti i saj, na udhëheq. Vështirësitë janë tepër të mëdha, por shtrini kurajen tuaj deri në pikën e fundit dhe mundimet nuk do t'ju venë kot.

Société des Nations. Journal Officiel. Actes de la V Assemblée. Séances plénières. Compte-rendu des débats, Genève 1924, pp. 105-106.

INTERVISTË E FAN NOLIT KORRESPONDENTIT TË GAZETËS SË BEOGRADIT «VREME»

13 shtator 1924

— Nga ana jonë, ne dëshirojmë marrëdhënie fqinjësie të mirë me shtetin jugosllav se kemi nevojë për qetësi që të mbledhim tërë vëmendjen tonë në organizimin e shtetit dhe zhvillimin e ekonomisë. Sa për mua, unë nuk shikoj ndonjë arsye, përse të dy shtetet tanë të mos rojnë në miqësi. Si shtete fqinje, kemi interesa të përbashkëta [...]

— Sa për pyetjen tuaj se çetat komite bullgare dhe çetat e «Komitetit të Kosovës», që kalojnë nga Shqipëria në tokën tuaj, pengojnë vendosjen e marrëdhënieve të mira, mund t'ju them se qeveria e re posa mori fuqinë, largoi bullgarët e dyshimtë që ishin futur në Shqipëri, [...]. U ësh-të dhënë urdhër tërë prefekturave të marrin masa të rrepta kundër gjithë atyre që duan ta përdorin Shqipërinë si bazë për të provokuar turbullira në shtetet fqinje, qofshin ata shqiptarë ose të huaj. Tani para pak kohe qeveria ndaloi gjashtë bullgarë me pasaporta të rregullta për të ardhur në Shqipëri, se autoritetet nuk ishin të kënaqura me qëllimin e udhëtimit të tyre. Po ne bëmë edhe më tepër: asnjë bullgar nuk mund të marrë vizë për Shqipëri pa lejen e posaçme të Ministrisë sonë të Punëve të Jashtme.

Lidhur me kosovarët, qeveria mori masat që ata të qëndrojnë urtë dhe ju siguroj se kanë për të ndënjur urtë. [...] Në qoftë se ju dëshironi që kosovarët të mos jenë shkak i grindjeve dhe urrejtjeve midis të dy shteteve, atëherë ju silluni mirë kundrejt popullsisë shqiptare në Jugosllavi. Konstatoj me kënaqësi që në kohën e fundit... autoritetet tuaja lokale sillen më mirë kundrejt shqiptarëve të Kosovës. Shpresoj që edhe qeveria e re juaj, gjithë këtë politikë do të ndjekë në interesin e të dy shteteve.

— Sa për Bajram Currin që më pyetni, ai tani është plak dhe ka nevojë për çlodhje [...].

— Çështja e kufirit të 1913-ës helmon marrëdhëniet tona. S'ka lezet që kjo të zgjatet më tepër, dhe duhet mbaruar një herë e mirë, për të shmangur pengimet në marrëdhëniet tona të mira. Çështjet e Shën-Naumit dhe të Vermoshit, që janë objekt mosmarrëveshjes, kanë për të për-

funduar shpejt ose vonë, dhe pastaj mund të fillojë një kapitull i ri. Ne nuk jemi të kënaqur me kufirin absurd që na dhanë Fuqitë e Mëdha. Kemi humbur mjaft toka, dhe toka ku banojnë me shumicë shqiptarët. Të flasim vetëm për krahinën e Gjakovës, ju e dini që e morët atë vetëm sepse kishit atje manastirin e Deçanit, përkundër faktit që tërë popullsia atje është shqiptare, përveç tridhjetë familjeve brenda në qytet. Të tjera krahina të Kosovës që keni marrë kanë 85 gjer 95 për qind popullsi shqiptare. Po ne iu bindëm kësaj, ndonëse dimë se jashtë Shqipërisë mbetën më tepër shqiptarë sesa ka brenda në kufijtë e saj. Aq më tepër ju që jeni 16 herë më të mëdhenj se ne dhe 50 herë më të pasur, duhet të bindeni që Shën-Naumi dhe Vermoshi të na mbeten neve sipas vendimeve të Fuqive të Mëdha. Sipas mendimit tim do të ishte absurde dhe për të qeshur që Mbretëria e Jugosllavisë të jetë në konflikt me të voglën Shqipëri për një mal të thatë si Vermoshi dhe për një manastir të vobektë si Shën-Naumi.

— Ne do ishim të lumtur po të shtonim marrëdhëniet tregtare me Jugosllavinë. Kjo është më tepër në interesin tonë sesa në tuajin sepse, sikundër e dini, malësorët tanë, nga lindja dhe verilindja, janë të shkëputur nga tregjet e tyre të natyrshme: Struga, Dibra, Prizreni, Gjakova dhe Peja. Një malësor nga prefektura e Kosovës sonë, tashti, që kur është mbyllur kufiri, është i detyruar të udhëtojë ditë gjer në Shkodër për të blerë kripë dhe misër.

— Konfederata ballkanike është një ideal për realizimin e së cilës duhet të punojmë të gjithë. Me këtë do të mundnin tërë shtetet ballkanike të pakësonin ushtëritë dhe të përdornin të hollat e kursyera për mirëqenien. E di fort mirë që ka shumë pengesa, të cilat duhen kapërcyer, dhe e vlen që të punohet për këtë. Do të mund të fillohej me një mbledhje të kryeministrave të shteteve ballkanike, ku mund të sheshoheshin mosmarrëveshjet dhe mund të përgatitej terreni për një marrëveshje miqësore — *entente cordiale*. Të tjerat do të vinin vetvetiu me pak durim dhe me pak vullnet të mirë. Sikundër e dini, lufta është një luks dhe për shtetet e mëdha, kurse për shtetet e vogla lufta është një prishje. Është, pra, nevojë absolute që të merremi vesh dhe të bashkëpunojmë për qetësinë dhe përpazimin e shteteve ballkanike.

— Situata e brendshme e Shqipërisë përpara kryengritjes ishte kjo. Bejlerët që ishin pronarë të mëdhenj dhe

zotër feudale në krahinat e tyre, që nga mesjeta kishin arritur të shtinin fuqinë në dorë dhe të sundonin me një parlament, që përbëhej prej (një shumice) partizanësh të tyre e pasanikësh. Ata donin që me anën e atij parlamenti shërbëtor, të forconin privilegjet dhe sundimin e klasës së tyre mbi Shqipërinë. Të gjitha këto i rrëzoi kryengritja. Bejlerët u larguan jashtë shtetit dhe Qeveria e sotme për të mbaruar këtë çështje një herë e mirë, ka për t'i ndarë tokat e tyre nëpër katundarët. Ky është fillimi i emancipimit politik, ekonomik dhe social të Shqipërisë. Parlamenti u shpërnda dy ditë pas hyrjes së forcave kryengritëse në Tiranë dhe nuk është për t'u mbledhur. Tani për tani, ne qeverisim pa parlament, dhe më mirë. Për shembull: tre vjet me radhë sa kishte parlament, kishim dashur të balancojmë buxhetin, duke pakësuar numrin e madh të nëpunësve dhe rrogat e tyre në franga ar kaq të larta për një shtet të vogël si yni. Parlamenti nuk votonte për kursimet. Në katër javë e sipër pa parlament, ne e mbaruam këtë punë dhe shpresojmë se me të tjera kurtime radikale do ta balancojmë buxhetin gjer në fund të motit. Për të kuptuar rëndësinë e kësaj pune, duhet ditur se trashëguam nga qeveritë e mëparshme një deficit prej 7 milionë frangash ar dhe rroga të papaguara prej 7 muajsh. Ne po vazhdojmë kujdesjen tonë. Reforma agrare ka për t'u zbatuar me anën e një dekret-ligji më parë se të mblidhet parlamenti, po kështu dhe reformat e tjera. Si të mbarojmë reformat krejt të nevojshme për ta bërë Shqipërinë një shtet modern, atëherë do të bëjmë zgjedhjet dhe do të mbledhim parlamentin e ri, po jo më parë. Pra, kjo edhe mund të zgjatet ca.

Gazeta e Beogradit «Vreme», datë 13 shtator 1924.

Përkthimi shqip në AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 263, ff. 5-8

INTERVISTË E FAN NOLIT KORRESPONDENTIT TË GAZETËS GREKE «POLITIA»

Shtator 1924

Fan Noli i flet gazetës «Politia». Rekomandon bashkëpunim të Greqisë me Shqipërinë. Prirja jonë duhet të jetë për atë që na bashkon, jo për atë që na ndan. Nevoja e një konfederate ballkanike.

Paris, shtator. Na lidh miqësi e vjetër veçanërisht e vyer me kryeministrin e sotëm të Shqipërisë z. Theofan Nolin [...]

Z.Theofan Noli lindi në Ibrik-Tepe të Trakës Lindore. Ka mbaruar gjimnazin greqisht të Adrianopojës dhe ka marrë diplomën në Universitetin e madh të Harvardit në Amerikë. Metropolit i Durrësit që prej 1923-së, e përfaqësoi dy herë si deputet krahinën e tij në Parlamentin Shqiptar. Në Lidhjen e Kombeve, ai jo vetëm tërhoqi simpatinë e përfaqësuesve evropianë, por pati dhe suksese të vërteta për vendin e tij. Më 1922 iu ngarkua Ministria e Punëve të Jashtme të Atdheut të tij, dhe që prej qershorit të 1924-s është kryetar i Qeverisë shqiptare.

Për 15 vjet rrojti duke studiuar në Amerikë, përktheu në gjuhën shqip vepra të Shekspirit, midis të cilave «Hamletin» dhe «Otellon» dhe vjersha të Edgar Poes; dhe ai vetë është poet dhe autor i veprave dramatike. Prej studimeve të tij historike rrodhi punimi i tij kritik mbi jetën e Gërgj Kastriotit—Skënderbeut, Heroit Kombëtar të epokës mesjetare të Shqipërisë. Ka udhëtuar shumë, dhe midis qyteteve që ka njohur është dhe Athina. Sot, ndodhet në Gjenevë, përfaqësues i Shqipërisë në sesionin e 5-të të Asamblesë së Lidhjes së Kombeve. Dëshëm të përfitojmë nga takimi ynë i shkurtër që t'i transmetojmë publikut grek idetë e tij mbi problemet që u interesojnë aktualisht të dy vendeve mike (...). Me këtë mendim i drejtuar z.Theofan Noli pyetjen tonë të parë.

— *Elkzistojnë shkaqe thelbësore të ftohtësisë midis grekëve dhe shqiptarëve?*

— Jam i mendimit se jo, — filloi të thotë kryeministri

i Shqipërisë. Përkundrazi, ekzistojnë kaq lidhje race dhe historike dhe aq bashkime interesash midis të dy popujve, saqë çdo njeri i arsyeshëm dhe i çliruar nga paragjykimet, është e natyrshme të presë lidhje shumë miqësore dhe bashkëpunimi të sigurtë midis të dy shteteve. Është e tepërt të flasim për origjinën e përbashkët të dy popujve, që kanë po ata stërgjyshër. Gjithnjë të dy popujt kanë patur komunikim. Kolonitë greke, që njëherë e një kohë lulëzoi në Iliri, u lanë gjakun grek shqiptarëve dhe kolonitë shqiptare të shumta në Greqi, që po shkrihen për ditë, e përforcuan shumë kombin grek. Janë të njohura shërbimet që i ofruan Greqisë dhe roli me rëndësi që luajtën në Greqi popullsitë shqiptare me luftërat e tyre trime gjatë Kryengritjes Greke të 1821-së. Shumë prej heronjve të saj ishin shqiptarë dhe pasardhës i tyre është dhe presidenti i tashëm i Republikës greke... Nga ana tjetër, shqiptarët nuk harrojnë se në sajë të kulturës greke lulëzoi ndjenja e tyre kombëtare. Apostujt e parë të idesë shqiptare kanë qenë të diplomuar të gjimnazit grek të Janinës.

Një afri e tillë dhe shërbime reciproke duhej të kontrahonin për bashkëjetesë vëllazërore dhe për bashkëpunim të sigurtë. Por edhe ca më shumë, interesat e përbashkëta i detyrojnë të dy shtetet të ndihmojnë njëri-tjetrin. Dëshojmë të besojmë se Greqia preferon në veriperëndim të ketë kufi një tjetër shtet në vend të Shtetit shqiptar.

— *Po si e shpjegoni ju sot ftohtësinë që ekziston midis të dy popujve fqinj?*

— Kjo ftohtësi është pasojë e çështjes së kufijve, e cila tani u zgjidh. Zgjidhja nuk i la të kënaqur as grekët, as shqiptarët dhe është e natyrshme: disa mijëra albanonë mbetën brenda kufijve grekë, disa mijëra grekofonë brenda kufijve shqiptarë. Duhet të pranojmë se albanonët janë më të shumtë se grekofonët. Por edhe të shtojmë se sakrificat ka qenë shumë më e vështirë për Shqipërinë e vogël se për Greqinë, që është tetë herë më e madhe dhe njëzet herë më e pasur se Shqipëria. Megjithatë interesi më i lartë i të dy popujve, që kanë aq shumë nevojë për paqe, imponon t'i jepet fund kësaj çështjeje dhe ta mbyllin një herë e përgjithmonë këtë defter të vjetër që na shpuri në vëllavrasje. Duhet që të dyja anët të mendojnë më me qetësi dhe më shumë për ato çështje të panumërta që na afrojnë me njëri-tjetrin dhe që janë në gjendje të ndriçojnë dhe të përforcojnë vëllazërinë tonë,

duke ia lënë së kaluarës ato që gjer tani na kanë ndarë.

Një shkak tjetër i ftohtësisë, për të cilën më pyetët, është mendimi i çuditshëm, sa edhe i gabuar, që është në Greqi, sipas të cilit Shqipëria nuk është veçse një Turqi e vogël, e maskuar. Prej gjithë akuzave, paragjykimeve dhe gabimeve, me të cilat kërkojnë të rëndojnë supet tona, kjo është më e padrejta dhe më pa bazë. Megjithëqë elementi mysliman ka shumicën në Shqipëri, nuk besoj të ketë një shtet të qytetëruar, ku të mbretërojë aq, gjer në indiferentizëm, tolerancë feje, sa në Shqipëri. Provë e faktit për të cilin me të drejtë krenohen të gjithë shqiptarët është që në krye të Qeverisë së sotme jam unë, një peshkop ortodoks, dukuri e panjohur edhe për shtete ortodokse.

— *Si do të bëhet e mundur, shkëlqesë, të zhduken këto mosmarrëveshje dhe të vendoset një politikë afrimi dhe bashkëpunimi?*

— Me respektimin reciprok të të drejtave reciproke. Të drejtat e minoriteteve do të jenë guri ku do të provohet ky respekt. Minoritetet tej e këtej duhet të shërbejnë jo si një pengesë, por si një lidhje dhe urë marrëveshjeje midis nesh. Ne, të paktën, jam i mendimit se kemi bërë detyrën tonë dhe ju deklaroj se do të vazhdojmë dhe në të ardhmen po atë rrugë. Arka e shtetit tonë mban shkolla greke, bashkëqytetarët tanë grekofonë gëzojnë po ato të drejta me të shqiptarëve dhe për ta janë të hapura, rrugët e posteve më të larta të Shtetit shqiptar. Në qoftë se një qëndrim të tillë do të mbajë dhe shteti grek kundrejt shqiptarëve që rrojnë në Greqi, do të zhduket çdo shkak ftohtësie.

— *Mos harroni, — thamë duke nënqeshur, — zoti kryeministër, se kemi tani z.Kundurioti në krye të shtetit grek!...*

— Me të vërtetë dhe jam kryelartë për këtë... Por që të vijmë në temë, Greqia nuk rrezikon asgjë me një politikë të tillë. Në Shqipëri «irredentizëm» serioz nuk ekziston dhe do të zhdukej krejt në qoftë se bashkatdhetarët tanë jashtë kufijve tanë do të gëzonin po ato të drejta që gëzojnë të huajtë në vendin tonë. Pastaj jemi kaq të vegjël, sa veç dispozicionit tonë të mirë dhe të sigurtë, jemi fatalisht të parrezikshëm.

— *Dhe si e kuptoni punën e afimit?*

— Përfundim marrëveshjesh tregtare, konsullore, marrëve-

shje botimesh etj., do të përbënin bazën e afrimit tonë dhe do të përforconin punën e paqësimit.

Dhe duke folur më vonë me zë më të thellë, sikur i drejtohej së ardhmes, kryeministri shqiptar përfundoi duke thënë.

— Një politikë e tillë me kohë do të sjellë marrëveshjen e dëshiruar dhe çastin e madh të pajtimit dhe të miqësisë vëllazërore. Përgjithësimi i kësaj politike në Ballkan, sigurisht do të mund të përfundojë në bashkëpunim panballkanik dhe ka shumë mundësi dhe në konfederatë. Pse jo? Është aq e bukur dhe aq praktike një gjë e tillë. Pse të mos besojmë? Pse të mos japim besimin tonë, të gjithë besimin tonë në këtë ide? Nga realizimi i këtij bashkëpunimi do të fitonin të gjithë, do të përfitonte sidomos një komb i qytetëruar si Greqia — dhe kemi tani një shembull që na e jep historia të papërgënjeshtuar, shembullin e zotërimit paqësor të qytetërimit grek mbi Perandorinë Romake. Nuk kujtoni se duhet të shohim popujt jo si të vuajnë nga mosmarrëveshjet, por me vullnetet e tyre të ndritur, si drejtohen ose duhet të drejtohen nga një e ardhme më e bukur?

Në këtë pikë mori fund, me mënyrën me të natyrshme, në tonin më fisnik, bashkëfjalimi ynë me kryeministrin e Shqipërisë dhe atëherë dhamë me po atë zemër të ngrohtë që të dy dorën: dorë vëllazërisht.

A. Monastiriotis.

Gazeta greke «Politika», datë 9.9.1924.

Përkthimi shqip në AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 225, f. 95-97/1

INTERVISTË E FAN NOLIT KORRESPONDENTIT TË GAZETËS BULLGARE «SVOBODNA REÇ»

Pas revolucionit të fundit në Shqipëri, — Qëllimet e qeverisë së re. — Marrëdhëniet me fqinjët. — Bullgarë dhe shqiptarë. — Mosmarrëveshja lidhur me Shën-Naumin.

18 shtator 1924

Dje më priti shkëlqesia e tij Fan Noli, kryeministri shqiptar, i cili kryeson delegacionin e vendit të tij në sesionin e V-të të Lidhjes së Kombeve (Noli ka mbaruar Universitetin e Harvardit në Amerikë; zotëron shkëlqyeshëm gjuhën angleze, gjithashtu flet lirshëm edhe frengjishten).

— Si është gjendja e përgjithshme politike në Shqipëri pas revolucionit të fundit — e pyeta unë — dhe a do ta mbli-dhni parlamentin tani shpejt?

— Regjimi i sotëm u prit nga populli me dashamirësi dhe me mbështetje të plotë. Nuk ka asnjë pengesë për zhvillimin e zgjedhjeve të reja dhe thirrjen e parlamentit. Por vetë populli nuk ka dëshirë që të shpejtohet për këtë tani, sepse do që ta lerë qeverinë të punojë qetë për rimëkëmbjen ekonomike dhe financiare të vendit. Qeveria e sotme brenda një kohe të shkurtër vetëm prej 3 muajsh arriti të zgjidhë në mënyrë të kënaqshme problemin e balancimit të buxhetit, detyrë të cilën parlamenti nuk mundi ta zgjidhte për 3 vjet.

— I pyetur për marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet ballkanike dhe me Italinë, Fan Noli u përgjigj:

— Qeveria shqiptare frymëzohet nga qëllimet më të mira dhe dëshiron të mbajë marrëdhënie të mira me shtetet fqinje. Ajo i përmbahet një politike të hapët dhe lojale ndaj këtyre shteteve dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet që të përmirësojë gjithnjë e më shumë marrëdhëniet me ta.

— Zoti Noli më foli bile edhe për një konfederatë ballkanike. kuptohet në një atë ardhme të largët. ,

— Kjo është e pashmangshme — tha ai. — Unë e di që do të shfaqen shumë vështirësi, por këto vështirësi janë të

parëndësishme në krahasim me dobitë që shtetet ballkanike do të kenë nga një konfederatë të tillë. Mjafton të përmend se të gjitha qeveritë ballkanike, të cilat shpenzojnë një pjesë të madhe të të ardhurave të tyre për mbajtjen e ushtrive të mëdha, do të mundën të pakësojnë armatimet e tyre dhe t'i përdorin mjetet, të cilat tani i ndajnë për ushtritë, për forcimin ekonomik të vendeve të tyre. Kjo, kuptohet, nuk mund të bëhet me sot e me nesër. Por me vullnet të mirë mund të bëhet diçka edhe tani. Për shembull, mund të fillohet me një konferencë të kryeministrave ballkanikë ku të shkëmbehen mendime midis tyre. Ç'humbje mund të kishim nga një takim i tillë? Në çdo rast ata do të hyjnë në kontakt personal dhe do të mund, të paktën, të mënjanojnë ato pengesa që nuk i lejojnë të jetojnë si fqinj të mirë.

— *Në mënyrë të veçantë për marrëdhëniet midis bullgareve dhe shqiptarëve, zoti Fan Noli më deklaroi:*

— Ato janë të mira e të përzemërta, Asnjëherë gjatë shekujve nuk ka patur konflikte midis dy popujve. Nuk do të ketë të tilla as në të ardhmen.

Ne i jemi mirënjohës Bullgarisë. Gjatë regjimit turk shumë shqiptarë gjetën tek ajo mikëpritje. Në Sofje ekzistonte një vatër e kulturës shqiptare, atje shtypeshin nga shoqëritë tona patriotike shumë libra dhe i shpërndareshin popullit shqiptar. Rol historik ka luajtur shtypshkronja, të cilën ne shqiptarët prej andej e sollëm në Tiranë,

— *Duke kaluar pastaj në marrëdhëniet me Italinë, kryeministri shqiptar deklaroi:*

— Në kthim për në Shqipëri kam ndërmend të ndalem në Romë dhe t'i bëj një vizitë zotit Musolini. Këtu pata rastin të takohem me zotin Makdonald dhe zotin Errio, dhe e konsideroj si detyrë timen t'i bëj një vizitë kortezie — *une visite de courtoisie* — edhe kryeministrit italian. Unë do të shfrytëzoj rastin që të falenderoj zotin Musolini për neutralitetin e plotë që qeveria italiane mbajti ndaj Shqipërisë gjatë revolucionit dhe për deklaratën që zoti Musolini dha për marrëveshjen me qeverinë e Beogradit për mosndërrhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë.

— *E pyeta pastaj Fan Nolin të më thotë si e kupton problemin e pakicave kombëtare dhe fetare në Ballkan.*

— Ne, nga ana jonë, — tha ai — mbajmë parasysh të gjitha detyrimet që kemi në këtë drejtim. Do t'u lejojmë pakicave të kenë shkollat dhe kishat që dëshirojnë. Por ne

duam të shpresojmë se edhe qeveria greke e ajo jugosllave do të sillen në të njëjtën mënyrë ndaj pakicave shqiptare që përfshihen në kufijtë e këtyre dy shteteve.

— *Po për mosmarrëveshjen lidhur me Shën-Naumin, që na intereson edhe ne bullgarëve, a mendoni se do të zgjidhet, kur nga Beogradi vazhdojnë të deklarojnë se janë të mendimit të kundërt?*

— Me vendimin e fundit Gjykata Ndërkombëtare konfirmoi vendimin e Konferencës së Ambasadorëve për t'ia dhënë manastirin Shqipërisë; ne e konsiderojmë këtë çështje të përfunduar. Shpresojmë se qeveria jugosllave, e cila ka në kufijtë e saj më tepër se 800 mijë shqiptarë, nuk do të ngrejë kundërshtime të tjera dhe do të pranojë vendimin e Gjykatës së Hagës.

— *Si janë kushtet sociale, fetare dhe kulturore në Shqipërinë e sotme?*

— Si rezultat i menjëhershëm i revolucionit të fundit, qeveria e tanishme është vënë në rrugën e zgjidhjes së çështjes agrare mbi bazën e pronës së vogël.

Për sa u përket besimeve, të gjitha njihen tek ne, dhe ushtrimi fetar është i lirë. Në shtetin tonë nuk ka fe zyrtare dhe fanatizmi fetar nuk ekziston.

Për përhapjen e arësimit dhe kulturës ne bëjmë të gjitha përpjekjet. Kemi më tepër se 400 shkolla fillore, kemi edhe 2 lice në të cilët mësimi jepet në frengjisht, njëri në Korçë, tjetri në Gjirokastrë, një lice shqiptaro-frëng dhe 2 të tjerë privatë në Shkodër. Kemi edhe në Elbasan, që prej 3 vjetësh, një shkollë pedagogjike për përgatitjen e mësuesve. Një shkollë teknike shqiptaro-amerikane është krijuar në Tiranë më 1920.

Në zonat malore, ku hapja e shkollave fillore është e vështirë për shkak të shpërndarjes së madhe të fshatrave, janë krijuar tre konvikte: në Shkodër, Dibër dhe Kurvelesh (në krahinën e Gjirokastrës), në të cilat janë mbledhur dhe mësojnë shumë nxënës nga zonat malore.

Për formën e qeverisjes që duhet të ketë Shqipëria. Fan Noli mendon se duhet të ruhet regjimi i sotëm mbi bazën republikane.

Zoti Fan Noli nuk do të qëndrojë në Gjenevë deri në mbarim të sesionit të V. Ai ka ndërmend të nisët të hënën e ardhshme për t'u kthyer në Shqipëri nëpërmjet Romës.

G. Kulishëv

Kjo intervistë e nxjerrë nga koleksioni i gazetës «Svobodna Reç», iu dërgua autorit nga bashkëpuntorja e Institutit të Studimeve Ballkanike të Sofjes, Greta Delçeva, të cilën autori e falenderon për zemërsisht.

DEKLARATA TË FAN NOLIT KORRESPONDENTIT TË GAZETËS GREKE «NEA IMERA»

*Marrëdhëniet midis Shqipërisë e Greqisë.
Nevoja të pushojnë zëniet e vogla.
Vetëm një marrëzi do të na shpjerë në përpjekje.*

10 tetor 1924

Romë, 10 tetor. Kryeministri i Shqipërisë z.Fan Noli, me të cilin pata sot takim, iu përgjigj pyetjeve të mia të bëra me shkrim:

Çështja e vetme e mbetur pezull midis Greqisë dhe Shqipërisë, janë fshatrat e zonës së Korçës, se prej të 22 fshatrave, 8 iu dhanë Greqisë dhe 14 Shqipërisë me shtatë mijë banorë, prej të cilëve 600 grekofonë. Z.Politis më deklaroi në Gjenevë se Greqia e pranon vendimin e Konferencës së Ambasadorëve dhe se (parlamenti grek) do të votojë një ligj për lëshimin e këtyre fshatrave.

Z.Fan Noli është i mendimit se nuk ka nevojë për një ligj, se këto kufij kurrë nuk i kanë takuar përfundimisht Greqisë; ai parashikon mundësinë e forcimit të marrëdhënieve greko-shqiptare.

— Ka më deklaroi, shumë gjak shqiptar në Greqi dhe gjithashtu shumë gjak grek në Shqipëri. Vetëm një marrëzi nga të dyja anët mund të na shpjerë në përpjekje. Lidhja e Kombeve e karakterizoi çështjen e shqiptarëve të shkëmbyer si çështje që hyn në kuadrin e minoriteteve dhe mori përsipër ta rregullojë ajo vetë drejtpërdrejt me Greqinë. Qeveria e sotme shqiptare është më e fortë se të gjitha të parat. E shpërndau parlamentin. Për të bërë ekonomi pakësoi 25 për qind të nëpunësve dhe rrogat e tyre i zbriti në 40 për qind. Shpresoj të bëjmë zgjedhje në mars. Regjimi i sotëm është për republikën, që do të shpallet pa vështirësi, se në Shqipëri nuk ka, si në Greqi, dinasti me parti të fortë kombëtare.

Z.Fan Noli përfundoi duke shprehur dëshirën për marrëdhënie më të mira me Greqinë. Është nevoja, theksoi, të zhduken «zënit e vogla» midis nesh. Jemi *shtete* të vogla dhe kemi nevojë për paqe.

Gazeta greke «Nea Imera» datë 11.10.1924

Përkthimi shqip në AQSH, fondi 251. v. 1924; d, 225 f. 147

NGA BISEDA E FAN NOLIT ME KORRESPONDENTIN E GAZETËS GREKE «ELEFTHON VIMA»

17 tetor 1924

Romë, tetor 1924. Pasi për tre muaj tani është paralajmëruar herë pas here një vizitë zyrtare e qeveritarëve të sotëm të Shqipërisë në Romë, pardje, më së fundi, arritën edhe ata vetë: arhimandriti dhe kryeministri Fan Noli dhe ministri i Financave Gurakuqi. Besoj se nuk kanë nevojë për paraqitjen në publikun grek. Janë që të dy nga burrat e shtetit më të mirë të Shqipërisë, me kulturë, poliglotë, njohës të nevojave të atdheut të tyre, të pajisur me dispozicion të mirë dhe me shumë takt. Aq sa të ngjallin fatalisht dyshimin se mishërojnë me të vërtetë Shqipërinë. Por nuk është fjala për këtë gjë. Gjëja që na intereson në këtë rast është të shohim cili është pikërisht shkaku për të cilin dy ministrat shqiptarë, pas kaq zvarritjesh dhe aq aventurash, më së fundi morën një nga rrugët që shpie në Romë dhe sot pas një qëndrimi të shqetësuar në hotelin «Uindsor» (Windsor), shkuan më së fundi për një vizitë të gjatë në «Palaco Kixhi» (Palazzo Chigi). Ata vetë, në deklaratat e tyre në shtyp, shpjeguan në këtë mënyrë qëllimin e vizitës së tyre:

Duke kaluar nga Roma, thanë, e quajtëm për detyrë të qëndrojmë që t'i japim nderimet tona zotit Musolini dhe të falënderojmë në emër të popullit shqiptar për deklaratën për mosndërhyrjen në punët e brendshme të vendit tonë, me rastin e kryengritjes së fundit.

— Por është fjala për kryengritje të vërtetë. — pyeti dikush?

— Ishte më shumë një «coup d'état» politik bashkë me një «pronunciamento» ushtarake. Kishim një qeveri tiranike dhe shkatërrimtare për interesin e përbashkët: qeverinë e Ahmet Zogut. Bëmë çdo gjë që të vijmë në një marrëveshje paqësore me të dhe ta sjellim në rrugën e drejtë. Qe e pamundur Qeveria iu përgjigj propozimeve tona, duke ndjekur shokët tanë politikë, duke arritur edhe gjer në krim. Atëherë edhe ne bëmë lëvizjen, që në Itali u quajt «marshim për në Tiranë» [...] Kishim frikë se mos shpërthimi i një lufte civile

do të provokonte ndërhyrje të jashtme. Kështu gjetëm shpëtim në një «pronunciamento» ushtarake me të cilën u derdh pak gjak. Por u shpërblyem me faktin që Fuqitë e huaja nuk ndërhyjnë. Kemi ndër mend të ndjekim një politikë të jashtme të pastër, të përpiktë dhe të bazuar në respektin e pavarësisë dhe të integritetit tonë. Këtë politikë do të ndjekim kundrejt të gjithëve, edhe fqinjëve tanë, d.m.th. Jugosllavisë dhe Greqisë, me të cilët kemi që tani marrëdhënie që besojmë se do të bëhen gjithnjë e më shumë miqësore.

...

Gazeta greke «Eleftheron Vima» datë 17.10.1924
Përkthimi shqip në AQSH. fondi 251, v. 1924, d. 225
ff. 202-204.

INTERVISTË E FAN NOLIT KORRESPONDENTIT TË GAZETËS GREKE «SKRIP»

17 tetor 1924

Romë, tetor. Kryeministri i Shqipërisë z. Fan Noli, duke u kthyer nga Gjeneva, pas mbarimit të punimeve të Lidhjes së Kombeve, qëndroi për gjashtë ditë në Romë për t'u takuar me zotin Musolini.

Me këtë rast e pashë të arsyeshme ta vizitoj në hotelin «Windsor», ku kishte qëndruar, dhe të bisedoj me të për sa u përket çështjeve të Greqisë dhe Shqipërisë.

Z. Fan Noli e ka origjinën nga një fshat shqiptar i Trakës. — siç më tha, — dhe mori mësimet e para në shkollën greke të Adrianopojës. Pastaj shkoi në Amerikë, ku studioi në Universitetin Harvard pranë Bostonit dhe u diplomua në teologji e në shkencat politike.

Është i shkurtër, i beshëm, brun dhe mban një mjekër të zeze të gjatë. Megjithëqë nuk vesh rasë, të jep menjëherë pamjen e një kleriku. I sjellshëm, me fjalë të ëmbël, me zë të ulët, pothuaj i turpshëm, ngjan më shumë me çdo tjetër sesa me një shqiptar. Por vështrimi i tij që lëshon shkëndija dhe sytë e tij që lëvizin dhe zbijojnë vazhdimisht, dëshmojnë shumë. Shmanget të të vështrojë në fytyrë dhe kur flet luan vazhdimisht me gishtërinjtë e tij, që parreshtur lëvizin dhe vazhdimisht vështron pa ngritur kokën.

Menjëherë më tha se është lidhur me miqësi të vjetër me ministrin tonë në Durrës, z. Panurias, të cilin e viziton dendur edhe për biseda politike edhe për konjakun e admirueshëm dhe duhanet me erë të mirë, që i gjen gjithnjë në sallonin e tij të mbushur me vepra pikturore.

Pas një bisedimi të gjatë në gjuhën greqisht, bëra këto dhjetë pyetje me shkrim për të cilat pati mirësinë të mi japë përgjigjet po greqisht.

— *A ekzistojnë çështje të varura midis Greqisë dhe Shqipërisë dhe cilat janë?*

— E vetmja çështje e varur midis Greqisë dhe Shqipërisë është ajo e fshatrave të zonës së Korçës. Këto fshatra janë 22. Prej këtyre 8 iu lanë Greqisë dhe 14 iu dhanë përfundimisht Shqipërisë, prej Konferencës së Ambasadorë-

ve. Këto 14 fshatra kanë një popullsi prej 6-7 mijë frymësh prej të cilëve vetëm nja 500 janë grekofonë. Z.Politis në Gjenevë më komunikoi se Greqia e pranon vendimin e Konferencës së Ambasadorëve dhe se qeveria greke do t'i sugjerojë Parlamentit për të votuar ligjin përkatës për lëshimin e fshatrave në fjalë. Unë jam i mendimit se nuk është nevoja për një ligj të tillë, se këto fshatra kanë qenë gjithnjë në kontestim dhe nuk i takonin përfundimisht as Shqipërisë, as Greqisë.

— *A e shihni mundësinë e një marrëveshjeje të përgjithshme midis Greqisë dhe Shqipërisë dhe a ekzistojnë rreziqe të përbashkëta?*

— Nuk shoh asnjë arsye që të ndalojë një marrëveshje të përgjithshme midis dy vendeve. Të dy popujt janë të një fisi, jo sllavë. Shumë gjak grek ka në Shqipëri dhe shumë (gjak) shqiptar në Greqi. Keni rreth 300 mijë shqiptarofonë. Dhe vetë presidenti i Republikës suaj është shqiptarofon. Nga ana tjetër, edhe ne kemi shumë mijë grekofonë. Interesat tonë janë të përbashkëta dhe jam shumë optimist për marrëdhëniet e të dy shteteve, veçse në qoftë se do të çmenden dhe tanët dhe tuajt nga «çështjet e vogla» dhe punët e vogla që ekzistojnë midis nesh.

— *Cilat janë konceptet tuaja mbi çështjen e Çamërisë?*

— Shqiptarët e Çamërisë janë gjer 40 000. Duke shkuar në Turqi si të shkëmbyeshëm shtrëngohen të vijnë në Shqipëri, ku ne nuk kemi mundësi t'i vendosim. Çështja për ne është e dyanshme: e para ekonomike dhe e dyta çështje qetësie. Çamët duke ardhur në Shqipëri i krijojnë probleme popullit shqiptar dhe ne jemi vazhdimisht të detyruar të ndërhyjmë që ta ndalojmë acarimin e çështjeve. Ne nuk duam të ndërhyjmë në punët e brendshme të Greqisë, se çështja është e brendshme greke, por do të ishte mirë të rregullohet miqësisht që të mos bëhet shkak rreziqesh për marrëdhëniet e të dy vendeve. Dyzet mijë shqiptarë në Çamëri nuk është çështje e madhe për Greqinë. Ne minoritarët grekë i mbajmë dhe kujdesemi për ta më shumë se për shqiptarët. Mjaft t'ju shënoj se në Prefekturën e Shkodrës, me 110 000 shqiptarë janë vetëm 24 shkolla shqipe, ndërsa në Prefekturën e Gjirokastrës me 33 000 grekofonë janë 28 shkolla greke, për të cilat paguan shteti shqiptar.

— *Ç'mendoni për çështjen e privilegjeve të vjetra të Himarës?*

Në kohën e pushtimit turk të gjithë shqiptarët e Veriut kishin privilegje. Pra, privilegjet (venomet) e himariotë-

ve nuk janë të vetme. Sikur t'u lëmë himariotëve ato privilegje, atëherë do të kërkojnë edhe të tjerët të tyret dhe në këtë mënyrë një e treta e Shqipërisë do të vetëqeveriset në trajtën e privilegjeve. Gjatë pushtimit turk privilegjet e himariotëve konsistonin në pagesën e 25 000 fr.ari. Me ligjet e qeverisë së sotme shqiptare himariotët do të paguajnë vetëm 5-7 mijë fr.ari. Çështja e detyrimit të shërbimit ushtarak nuk ekziston, se himariotët kurrë nuk kanë mohuar ta plotësojnë këtë detyrë.

— *Cilat janë çështjet që Shqipëria shtroi në Lidhjen e Kombeve dhe cilat janë vendimet e sakta dhe të plota mbi këto?*

— Këto çështje qenë: a) e Çamërisë, b) e kufijve të 14 fshatrave të Korçës, c) e Manastirit të Shën-Naumit ç) e Malit të Vermoshit në verilindje të Shkodrës. Për çështjet e kufijve, Lidhja e Kombeve vendosi t'i lutet me urgjencë Konferencës së Ambasadorëve që të zgjidhen përpara këtij dimri. Për Çamërinë Lidhja e Kombeve vendosi ta mbajë çështjen në rendin e ditës si çështje minoritetesh dhe ta rregullojë drejtpërdrejt Lidhja e Kombeve me Greqinë. Ky vendim u pranua me shumë kënaqësi dhe nga Greqia dhe nga Shqipëria dhe shpresoj të rregullohet në mënyrë që të mos zihemi më.

— *Pas vendimit të Lidhjes së Kombeve që thotë se çështja e mbrojtjes së minoriteteve përbën çështje të shtetit përkatës dhe të Lidhjes së Kombeve, duke përjashtuar përzierjen e të tretëve, Shqipëria do të pushojë të përzihet në çështjen e shkëmbimit të popullsive, duke lënë që kjo të rregullohet midis Greqisë dhe Lidhjes së Kombeve?*

— Sigurisht nuk kemi më asnjë arsye për t'u përzier.

— *A është e vërtetë se marrëdhëniet e Shqipërisë dhe Jugosllavisë janë të ndera dhe cilat janë çështjet e varura me Jugosllavinë?*

— Marrëdhëniet tona me Jugosllavinë nuk janë të ndera. Madje me qeverinë e tanishme*), ia shpiem më mirë. Çështjet e varura me Jugosllavinë janë ajo e Shën-Naumit, të cilin e ka Jugosllavia dhe që është zgjidhur në favor tonë, dhe e malit Vermosh, që e kemi ne dhe që nuk ka marrë ende zgjidhje të prerë.

— *Cili është qëllimi i vizitës suaj te z.Musolini?*

— Vizitë thjesht miqësore. Në Gjenevë pata rastin të

*) Është fjala për qeverinë e Davidoviçit.

takoj të dy kryeministrat e tjerë të dy Fuqive të Mëdha, z.Makdonald dhe z.Herrio. E pashë të arsyeshme të shoh edhe z.Musolini si kryeministër të Fuqisë tjetër të Madhe, e cila na është edhe më fqinje. Edhe qeveria e sotme edhe qeveria e vjetër shqiptare, edhe të mirat edhe të këqijat, kanë mbajtur gjithnjë politikë të pavarur ndaj fqinjëve, duke dëshiruar një bashkëjetesë miqësore dhe paqësore me të gjithë.

— *Cilat janë mundësitë e një marrëveshjeje politike me Italinë?*

Me Italinë kemi përfunduar një marrëveshje tregtare vjet, që nuk është ratifikuar ende. Pothuaj tri të katërtat e tregtisë sonë bëhen me Italinë. Natyrisht, edhe në marrëveshjet tona tregtare mbajmë politikë të pavarur. Nuk kemi asnjë pengesë që t'i akordojmë dhe Greqisë çdo lehtësi që i kemi dhënë Italisë.

— *Cila është gjendja e sotme politike në Shqipëri? Kur do të shpallen zgjedhje të reja? Cila është forma e regjimit që përfundimisht parashikohet për vendin? Qeveria e tanishme shprehet për republikën apo për mbretërinë?*

— Qeveria e sotme shqiptare është më e fortë dhe më e qëndrueshmja nga të gjitha qeveritë që ka pasur gjer më sot Shqipëria. Nuk ngutemi për zgjedhje. E shpërndamë parlamentin, që të bëjmë disa ekonomi të nevojshme. Dhe e dini që me parlamentet ka njeriu bisedime të pafund, pa vendime të shpejta. Atë që nuk mundën ta bëjnë parlamentet në tre vjet, ne e bëmë në tri javë. E pakësuam numrin e nëpunësve në 25%. Po ashtu ulëm rrogat nga 10-40%. Gjer në fund të vitit shpresojmë të ballancojmë buxhetin. Nga marsi do të bëjmë zgjedhje, pasi më parë të plotësojmë punën e spastrimit. Regjimi i ardhshëm i Shqipërisë do të jetë republika. Të gjithë ministrat e sotëm janë republikanë. Shpresojmë të mos hasim në pengesa, sepse në Shqipëri, nuk ka, siç ka patur në Greqi, dinasti me ngjyrë të fortë kombëtare.

Më së fundi z.Fan Noli m'u lut t'i transmetoj popullit grek dëshirën për marrëdhënie më të mira me Greqinë.

Manos Vatalas

Gazeta greke «Skrip» datë 17.10.1924
Përkthimi shqip në AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 225,
ff. 206-209.

ARTIKULL I FAN NOLIT NË NJË GAZETË GJERMANE

(Ribotuar nga gazeta greke «Dhimokratia»)

dhjetor 1924

Ç'është Shqipëria sot, çfarë korente idesh e drejtojnë, si po formohet nga pikëpamja shoqërore dhe ekonomike, prej ç'qëllimesh frymëzohen qeveritarët e sotëm — mbi këto pika përgjigjet në një artikull, të botuar në «Gazetën gjermane të Fos» Fan Noli, kryeministri i Shqipërisë. E ribotojmë artikullin më poshtë: Fan Noli përfaqëson botën përparimtare të vendit fqinj dhe sa shkruan janë jehonë e tendencave të tij.*

Katër shekuj robërie nën zgjedhën turke — vite me të vërtetë të ashpra. Më së fundi, ra ora e lirisë, kur populli shqiptar e zbriti pushkën prej kasolleve dhe u hodh në luftë, për të fituar lirinë e tij kombëtare. Më 28 Nëntor 1912 Shqipëria i shpalli botës se është përsëri e lirë, Më 1913 kjo liri e re u njoh prej Konferencës, e cila pas Luftës Ballkanike u mbledh në Londër.

Kombi ishte tani i lirë, si dhe baballarët e tij në kohën e Skënderbeut. Por kufijtë u shënuan pa u marrë parasysh kërkesat e drejta të popullit shqiptar. Shqipëria shpejt e kuptoi se kjo nuk ka qenë triumf në jetën politike. Më shumë se gjysma e vendit e banuar prej shqiptarëve, u nda midis Serbisë, Greqisë dhe Malit të Zi dhe më shumë se 800 000 shqiptarë mbetën në këto shtete.

Pastaj erdhi lufta e përbotshme, toka shqiptare u pushtua me radhë prej të gjithëve, ushtritë luftuese dhe ushtarë të huaj gjetën strehë në vatrën tona. Ky pushtim mbajti gjer më 1921. Ndërkohë më 1920 Shqipëria ishte bërë anëtare e Lidhjes së Kombeve. Gjatë asaj kohe kufijtë tanë nuk ishin përcaktuar ende. Lidhja e Kombeve në mbledhjen plenare më 1921 vendosi që t'ia lërë vendimin Konferencës së Ambasadorëve. Kanë kaluar tani tre vjet dhe kufijtë e Shqipërisë nuk janë përcaktuar ende. Kuptohet vetvetiu se këto rrethana nuk mund veçse t'u ha-

*) Nuk ka qenë e mundur të përcaktohet me saktësi emëri i gazetës gjermane.

pin rrugën grindjeve të shumëllojta. Minutën që shkruaj këtë artikull po marr prej Ministrisë sime telegram të autoriteteve lokale për goditje të përgjakshme në veri të Shkodrës. Fjala është për një inkursion të fiseve malësore malazeze të Kuçëve dhe të Vasojeviçëve, që zaptuan Vermoshin, një pikë me rëndësi në kufirin verior me Jugosllavinë dhe veç atij plaçkitën edhe fshatin Selcë.

Vetëm kur populli dhe qeveria e Shqipërisë të çlirohen prej ankthit të kufijve, që prej vjetësh e mban vendin në gjendje shqetësimi të vazhdueshëm, do të mund të japin të gjitha fuqitë dhe shpirtin e tyre në veprën e rindërtimit.

Nga pikëpamja e qytetërimit, vendi im është shumë më prapa nga popujt e Veriut dhe të Perëndimit. Por ekzistojnë në Shqipëri mundësi të mira për një evolucion të shëndoshë, i cili do të përgatiste një të ardhme të lumtur për vendin.

Shqipëria mundi të zgjidhë çështjen fetare një herë e përgjithmonë. Shqipëria është si Amerika dhe Franca, pa fe zyrtare. Shteti dhe nëpunësit e tij nuk kanë të drejtë të përzihen në çështjet fetare. Në këtë fushë, individi është zot i vetes dhe feja është çështje ndërgjegjeje. Kushtetuta jonë e siguron plotësisht lirinë fetare. [...]

Liria është thesari më i vyer i shqiptarit [...]. Asgjëkundi nuk takon njeriu krenarinë e racës (kombësisë) dhe të familjes sa në Shqipëri. Por filizat e atdheut tonë edhe kasollet më të varfra janë vetëqeverim i shtetit. Shqipëria formohet shumë më shumë nëpër fshatra se sa në bisedime politike ose me anë bisedimesh akademike.

Toka jonë është aq e begatë sa mund të dëshirojë njeriu. Por përta u përket metodave bujqësore, nuk di fjalë tjetër të përdor veç «elementare». Sa ndryshim kundrejt bujqësisë që kam parë në Gjermani përpara disa vjetëve dhe në Danimarkë! Atje forcat e individëve përmbledhen... në një vend për punë të përbashkët. Te ne asgjë nuk është e organizuar. Këtu çdo fermë, çdo ekonomi agrare është... një tërësi ekonomike. Dhe megjithatë jam i mendimit se edhe në këtë pikë mund të ndiejmë përparim. Populli shqiptar nuk i pret keq idetë e të tjerëve dhe mëson shpejt dhe me gatishmëri.

Qeveria ime ushqen shpresën e justifikuar se me importimin e makinave bujqësore dhe me organizimin e ferma-ve model, do të kontribuojë në ngritjen e bujqësisë shqipta-

re në pikën në të cilën bujqësia është ngritur sot. Është bërë që tani një punë e madhe nga kjo anë dhe besoj me bindje të patundur, se do të vazhdojmë të punojmë me sukses në këtë fushë.

Për shumë vjet kujdesi kryesor i politikës së brendshme do të jetë të krijohet një bazë për veprimtari të përbashkët. Gjer më sot gjendeshin përballë dy grupe, ai i nacionaldemokratëve dhe partia e bejlerëve feudalë, ndikimi i të cilëve u përqendrua në krahinat qendrore të Shqipërisë. Kryengritja e fundit, të cilën pata nderin ta kryesoj, përfaqësonte shpërthimin me dhunë të forcave demokratike kundër përzierjes së rrezikshme të bejlerëve në punët e shtetit. Nuk është nevoja, natyrisht, të shtohet se bejlerët u mundën.

Politika jonë nuk konsiston aq në bisedime dhe fjalë se sa në punë të vërtetë për ngritjen e shtetit. Prandaj është e zorshme të shprehet me fraza parlamentare. Ai që do të kuptojë, duhet të vijë personalisht në Shqipëri, që të shohë në vend rezultatet. Sa për politikën e jashtme, asnjë shtet s'mund të ketë dispozicione më të kulluara se Shqipëria. Vendi e ndjen se ka nevojë për paqe, aq brenda sa edhe jashtë, që të mund t'ia kushtojë në qetësi fuqitë e tij punës dhe një komb i ri ka shumë fuqi për punë. Që në minutën e parë të qenies së saj si shtet i lirë Shqipëria ka bërë çmos që të ruajë simpatinë dhe përkrahjen nga ana e Fuqive të Mëdha, të bëjë miq të rinj midis kombeve evropjanë dhe të vendosë marrëdhënie të mira me fqinjët e saj.

Paqe brenda e jashtë është parulla e jonë. Që prej pak muajsh jam kryeministër i Shqipërisë. Mund të siguroj se këta muaj nuk kanë qenë «ditë pushimi» por pune. Gjithashtu mund të pohoj se janë arritur suksese të vërteta.

Gazeta greke «Dhimokratia» datë 4.12.1924.

Përkthimi shqip në AQSH, fondi 251, v. 1924, d. 225 ff. 239-240.

PROKLAMA E KRYEMINISTRIT

Shqiptarë,

Në një kohë kur po përgatiteni të shfaqni vullnetin tuaj sovran, disa tradhtarë të dalë nga pusi të huaja, krah për krah me të huaj, me pushkë me fishekë të huaj, duan të prishin atë Shqipëri që me kaq luftëra, me kaq mjerime, me kaq sakrifica, e keni bërë të lirë dhe më vete. Në një kohë kur populli shqiptar ka vendosur të konsakrojë me anën e legalitetit idealet e larta të revolucionit të fundmë, dora e armikut ju ka zgjatur mbi kurriz thikën tradhtare.

Lufta që po bëni sot, o shqiptarë, është luftë lirie dhe indipendence; topat, mitralozat dhe ushtarët e Serbisë e dëshmojnë; e dëshmon tërë kombi i bashkuar, që ka rrëmbyer armët, prej plakut të thënjur të maleve gjer te shkollari i njomë. Ushtria heroike e kombit, ajo ushtri që verën e shkuar e dëboi tradhtarin nga Shqipëria, edhe sot do ta thyejë guximin tradhtar të Belgradit.

Shqiptarë,

Kurdoherë dhe sidomos që më 1920 e tëhu, keni lëftuar dhe keni fituar kundër armikut të jashtëm dhe veglave të tij me disfatistët e brendshëm. Edhe këtë radhë dhe për herën e fundit po luftoni kundër të huajit të bashkuar me bashibozukët tradhtarë; dhe këtë radhë suksesi i armëve kombëtare është i siguar, posa që e tërë Shqipëria pa ndryshim feje, partie, krahine ose klase, është ngritur më këmbë për të dëbuar armikun dhe për të shtypur tradhtarët.

Shpirti i kombit, si më parë dhe tani, do të triumfojë.

Rroftë Shqipëria!

Kryeministri
F.S.Noli

Dhjetor, 1924

Kopje e Shpalljes në AQSH, fondi 14 v. 1924. d. 89 f. 2.

MBI GJENDJEN NË RADHËT E EMIGRACIONIT DHE DETYRAT AKTUALE

Me deklaratën kemi bërë diagnozën e sëmundjeve politike të Shqipërisë dhe kemi caktuar therapin e tyre.

Sëmundjet kryesore janë dy: një e brendshme dhe një e jashtme. E brendshmeja është, feodalizma, kalbësi asiatiche, medievale. E jashtmeja është imperializma e fqinjve, thëthitje moderne nga ana e Italisë, çfarosje barbare nga ana e Serbisë dhe e Greqisë. Krimbi i feodalizmit brenda në trupin e shtetit, kokudhi vampir italian që i ni gjakun. Korbave serbe dhe greke që duan via hapë kufomën. Ja piklura e bërë me gëzime dhe duan via hapë kufomën. Ja piklura e Shqipërisë.

Që të shpëtonim duhet luftë brenda e luftë jashtë. Thërrapa pra, mori formën e një operate double, se nuk ish e mundur të ndahet sëmundja e brendshme nga sëmundja e jashtme. Kokudhit imperialist italian i duhet krimbi i feodalizmit arnaute, se ky e kalp trupin e Shqipërisë dhe s'i le fuqi që të mbrohet kundër kokudhit. Gjithashtu u duhet edhe korbave serbe dhe greke, se ky krimp ua shtron në sofrë kufomën, si gjellë të gatishme.

Si die, ashtu edhe sot, feodalizma dhe borgjezia arnaute janë të lidhura me armikun e jashtëm. Gënjejnë pra veten a gënjejnë shoqi-shoqin ata që kujtojnë se munt të ndahet njera luftë prej tjetrës, ajo kundër armikut të brendshëm nga ajo kundër armikut të jashtëm. Ndaji sa të duash, ato nuk ndahen. Janë binjake, siameze. Se armiqtë e brendshëm janë të lidhur me armiqtë e jashtëm, i pamë si na u sulë nga të gjitha anët e na dbuan nga Shqipëria në Dhjetor më 1924.

Pra, duke i patur të gjitha këto përpara sysh, caktuam si bazë të programit tonë këto pika kryesore:

- 1) Çlirimin ekonomik e politik të popullit punëtor të Shqipërisë nga feodalitet brenda e nga imperialistët jashtë.
- 2) Lidhje me mirëdashësit për të përballur armiqtë e brendshëm e të jashtëm të lidhur.
- 3) Bashkimin e kombit në një republikë përbrënda ku-fijve etnografikë.
- 4) Hyrjen e republikës nacionale shqiptare në një federatë republikash ballkanike.

* Titulli është yni.

Këtë program e quanim si të yetmen udhë shpëtimi. Dhe kishim të drejtë, se të tjerat i pamë. Ku na shpunë die, i shohim ku po na shpien sot, i parashikojmë ku do të na shpien nesër.

Po programi i çkoqur nuk u pëlqeu oportunistëve dhe disfatistëve. Kështu pra, që më 1924 gjer sot, kemi patur dy shkëputje dhe një përçarje të brendshme:

- 1) Shkëputjen e Koculit me shokë.
- 2) Shkëputjen e K.K.¹.
- 3) Përçarjen e De.

E para ngjau që kur u shtrua programi për bisedim. Koculi me shokët refuzuan ta nënshkruajnë, u çkëputnë prej grupit tonë dhe u lidhë me grupin serbofil. Një pakicë shpjegoi në çkoqur përse u çkëputnë prej grupit tonë. Këna zo-
terinj janë të mendjes që munda të shpëtojas Shqipërisë
dyka u lidhur me njerën e me tjetrën imperializim faj-
tija:

Përçarja e dytë ngjau më pastaj. Në një sikundër e dini, e nënshkroi programin, po kjo ishte hera e parë dhe e fundme që grupi ynë dhe K.K. u çfaqnë përpara botës si dy grupe të lidhur. Pastaj dalëngadalë K.K., u nda krejt prej nesh ideologjikisht dhe ka refuzuar të solidarizohet me ne kundër regjimit zogollian. P.sh. K.K., ndonëse e ftuam disa herë, s'ka bërë asnjë deklaratë mbi çpalljen e monarkisë, s'ka çkoqur kurrë qëndrimin kundërshtues kosovarëve italo-filë ... dhe ka refuzuar kategorikisht të bashkëpunojë me L.K. Ka edhe më keq: K.K. është tani kundër programit antifeodal të çfaqur në programin tonë të cilin e kanë nënshkruar edhe ata vetë. K.K. na dezertuan se janë të mendjes që Kosova mund të shpëtonjë duke bërë dallavere dhe oportunizma të vëngëra me Italinë, me Zogollin, ... e përgjithsisht me bejlerët e me agallarët.

Vijmë tani në përçarjen e brendshme, të shkaktuar prej Dev*¹
Memoranda që ju dërgoi pa dijen e shokëve të tjerë nuk ish-

1) Komiteti i Kosovës që u shkëput nga KONARE-ja nuk duhet ngatërruar me Komitetin «Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës» që veproi në v. 1918-24.

* Në dorëshkrimin e Nolit prej 44 faqesh, mungon një faqe (faqja 11) dhe kjo e ndërpret fillin e mendimit. Tabloja del e cun-guar. Ka të ngjarë që të jetë fjala për shkëputjen e grupit që formoi «Bashkimin Kombëtar», organizatë politike reaksionare që iu kundërvu KONARE-s.

te veç hallka e një zinxhiri, dhe zinxhiri me pak fjalë ishte ky: të hyjmë në marrëveshje me Ahmedin, shokët të gjithë ose përveç n'ja dysh të venë në Shqipëri, të bashkëpunojnë me Ahmedin dhe t'i luftojnë bejlerët aqë sa të jet' e mundur nën regjimin e sotëm, dhe në këtë mes gazeta të pushojë se natyrisht nuk mund edhe të luftojmë Ahmedin përjashta edhe të bashkëpunojmë me të përbrenda, me fjalë të tjera, kapitullatë përpara Ahmed Zogut dhe imperializmës italiane nënë maskën e një lufte gjoja më efektive, po në praktikë krejt imagjinare brënda në Shqipëri. Dhe përse kjo kapitullatë? Se s'paskemi më mjete për të lëftuar, gjë që s'është e vërtetë, dhe se brënda në Shqipëri paskemi rasjen të punojmë, në lidhje me Ahmedin, më tepër se jashtë, gjë që është groteske dhe absurde. Këto pika do t'i shoshitim më vonë.

Po më parë diç duhet thënë për thezën e disidentëve nr. 1, të Koculit me shokë, të Bashkimit Kombëtar e të Koço Tasit. Kjo thezë, pas së cilës militaristët serbë dhe grekë, që na thërrnin kur na kishin në dorë e po na thërrnin sot, aqë sa na kanë në dorë, do të na shpëtojnë nesër, është aq e çmendur sa nuk mund të hyjë veçse në një kokë të çkallmuar nga dëshpërimi a mjegulla, nga budallallëku, po malum disave kjo thezë nuk u ka hyrë nga koka po nga xhepi dhe këta të xhepit janë të vetmit me pesë para ment në grupet serbofile dhe grekofile. Bukuria është që theza e tyre bëhet ca më e çmendur sikur ta pranojmë si një thezë të mençur. Se në qoftë vepër patriotike të hipin në fuqi me ndihmën e serbëve dhe të grekëve, përse e shajnë Ahmedin, i cili e bëri këtë vepër patriotike më përpara dhe u tregoi mënyrën me të cilën bëhet? Apo mos një vepër që është tradhëti kur e bën Ahmedin, u ktheka në vepër patriotike kur e bëjnë ata? Ka dhe më: hipja e Ahmedit në fuqi me ndihmën e armiqve rezultoi në një katastrofë për Shqipërinë, po hipja e Ali be Këlcyrës dhe e Koço Tasit me ndihmën e armiqve e shpëtuaka Shqipërinë nga kjo katastrofë, sepse murtaja në dorë të Ahmedit sjell vdekjen, po murtaja në dorë të Ali beut dhe të Koco Tasit sjellka selametin! Kaqë sa për thezën e disidentëve serbofile dhe grekofile.

Tani, për të kuptuar sa të humbura janë thezat e disidentëve të tjerë, të cilët e presin shpëtimin nga një lidhje me imperializmën italiane, me feodalizmën arnautë e me Ahmedin personalisht, le të hedhim një sy mi gje-

ndjen e Shqipërisë, se kjo gjendje na tregon ç'duhet të presim nga Musolini, nga bejlerët e nga Ahmedit.

Shituata ekonomike është e dëshpëruar dhe katranoset dita me ditë, se populli punëtor plaçketet me një mënyrë mediavale nga tri çeta hajdutësh, nga çeta imperialiste italiane, nga çeta e bejlerëve, agallarëve dhe fajdexhinjve vendas dhe nga çeta qeveritare. Rezultati i këtyre plaçkitjeve, është një krizë financiare, një krizë tregërie dhe një zi për bukë. Njerëzia vdesin literalisht nga uria. Arka e shtetit është e zbrazët. Buxheti është i çkallmuar nga deficitet. Vergjitë po shtohen për të mbyllur vrimat e buxhetit. Populli s'ka para të paguanjë vergjit' e rënda, pra ia konfiskojnë mallin dhe e lënë çiplak rrugëve. Po me që as kështu nuk mbulohen harxhet e Pallatit e t'ushtërisë mercenare që përbëjnë më tepër se gjysmat e të ardhurave të Shtetit. afro 65 për qind, qeveria tani negocion për një hua të re prej 50 milionash nga Italia, d.m.th. një borxh i ri mi borxhin e vjetër.

Shituata politike: Diktatura fashiste feodale bëhet më e rreptë, se ndryshe nukë qëndron dot në fuqi. Administrata, bashkitë, ushtëria, djalëria, të gjitha janë organizuar pas mënyrës fashiste për të shtypur çdo kundërshtim të popullit t' egërsuar.

Për të forcuar pozitën e tij, Ahmedit po na bën tani edhe reforma agrare. Qëllimi i tij është të zgjeronjë bazën e diktaturës feodale, dyke hequr me anën e tij edhe një pjesë të katundarëve, përveç bejlerëve, agallarëve dhe fajdexhinjve që i ka patur për vete që në krye.

Pas reklamave që bënin larot e Ahmedit që nga Koço Kotta gjer te Zoi Xoxja, këto reforma do t'ishin radikale, po kundërshtimi i bejlerëve nga njëra anë dhe presioni i Italisë nga ana tjetër, e shtërnguan qeverinë arnautë të bënë një kompromisë dhe reformat agrare janë aqë konservative dhe illuzore, sa edhe larove t'Ahmedit u vjen turp t'i quajnë serioze.

Për të plotësuar pikturën e gjendjes, arrin të shtojmë që Shqipëria futet dita me ditë, thell'e më thellë nënë skllavërimin ekonomik, politik dhe ushtëriak t'Italisë fashiste, jo vetëm de facto edhe de jure; bile mund të thuhet që s'ka se si të hyjë më thellë, se e ka arrirë fundin, se u mbarua një etapë dhe tani po nis një etapë e re, transformata e plotë e Shqipërisë indipendente në një kollo-ni italiane si Somalia dhe Giuba.

Nga të sipërmet merret vesh lehtë se ata që thonë se po

e shpëtojnë Shqipërinë me lidhjen italiane lozin me fjalët e tallen me popullin. Shqipëria vdes dale nga dale në thundrën e fashizmës, vdes nga shpirti e nga trupi, çduket që t'u lëshojë vendin kollonizatorëve italianë.

Gjithashtu lozin me fjalë e tallen me popullin ata që thonë se me ndihmën e Ahmedit do t'i thyejnë bejlerët. Ahmedit nuk i thyen bejlerët, e para se është bej vetë, e dyta se mbështetet kryesisht mi bejlerët, e treta e vërteta, se edhe sikur të deshte nuk e lë patroni i tij Musolini; shkurt Ahmedit nuk i thyen bejlerët se ashtu vret vetë veten. Përkundër, përpiqet t'i shpëtonjë bejlerët. dyke i lidhur e dyke i forcuar me të gjitha elementat konservative të vendit, me agallarët, me fajdexhinjtë, me pseudonacionalistët, me pseudo-intelektualët, me fanatikët e të gjitha ngjyrave, me kalbësirat dhe gërmadhat e të gjitha barbarive ballkanike.

Të gjitha faktet e të gjithë faktorët bërtasin që vetëm grupi ynë flet gjuhën e logjikës dhe tregon udhën e lirisë pa frikë e pa hatër. Për këtë jemi të bindur jo vetëm ne, jo vetëm populli që diç kupton, po edhe kundërshtarët tanë t'emigratës, të cilët na japin të drejtë me heshtjen e tyre. Grupi italoofil nxori një gazetë në Vjenë, lehu pak kohë, hëngri dru e heshti. Grupi serbofil nxori një tjetër gazetë në Vjenë, lehu ca më gjatë, hëngri dru më tepër dhe heshti edhe ai. Se s'kanë si të na përgjigjen. U ka mbetur vetëm një argument: që gjer sa të vijë dita t'a shpëtojmë Shqipërinë ashtu si themi ne, do të zhduken të gjithë shqiptarët; pra, u dashka shpejtuar, u dashka bërë derri serb dai për të kapërcyer lumën, e qepazëlleke e më-the-të-thashë, për të vënë veten e shokët në gjumë, për të krijuar illuzione të kota, e ca më keq për të provokuar me anë të ndonjë aventure okupatën e Shqipërisë prej italianëve. Rezik 1.

Grupi ynë nukë ndjek as aventura, as utopira. Do të vepërojmë kur të vinjë dita për të vepëruar dhe ashtu si e do puna për të zbatuar një program çlirimi të vërtetë të popullit punëtor. Kjo ditë nuk është lark. Po afrohet me cape të shpejtme, dhe të shigurta.

Një sy mi gjendjen ndërkombëtare arrin për të marrë vesh që shpresat tona do të realizohen më shpejt se ç'e besonim. Nga njera anë kemi valën çlirimtare që rritet, nga ana tjetër, botën reaksionare që lëkundet. Nga ana tjetër, shohim një krizë të madhe që po e trondit botën që

nga themelia. Natyrisht, nga kjo krizë, nga ky tërmet, do të rrëzohen më parë karakatinat, si fqinjët tanë, si Italia, si Jugosllavia. Më gjendjen financiare kritike të Italisë është e lehtë të zgjatet; se na e shpjegonte Nitti me një artikull të përkthyer në L.K, me një mënyrë magjistrale. Sa për gjendjen e Jugosllavisë, arrin të them që kjo është më e keqe se ajo e Italisë nga financat, se Jugosllavia s'gjen dot hua, m'e keqe nga popujt e shtypur që përbëjnë dy të tretat e popullatës e që presin me qiri ditën e orën që të ngrihen kundër tiranisë militariste serbe. Ja ku do t'a gjejmë rasjen: kur të rrëzohet njera prej të dyja diktaturave, a ajo që na e solli Ahmedin, a ajo që na e përmban, a të dyja, kur të hapet njera derë a kur të na hapen që të dyja dyert, nga Lindja e nga Perëndimi, a nga të dyja anët, që të mos themi nga të gjitha anët.

Po, pas fjalës popullore, sikur deti kos të bëhet, ne nuk do të mundim të përfitojmë në mos paçim lugë, dua të them që edhe sikur të na vinjë rasja, ne s'kemi për të bërë dot gjë, në mos qofshim të gatitur të përballim shituatën. Për të fituar luftën, duhen dy gjëra:

E para, duhet të dimë ç'duam.

E dyta, duhet të jemi gati për ditën e vepërimit.

Kurrë në histori të botës s'është dëgjuar të jetë fituar lufta nga ata që s'dinë ç'duan. Pikërisht për këto arsye e kemi humbur luftën me 1924. Pësimet duhet të na bëhen mësim. Syrgjyni duhet të jetë për ne një shkollë për yryshin e dytë, për triumfin final.

Duhet, e para, të jemi besnikë të patronditur në programin tonë dhe në taktikën tonë pa oportunizma.

E dyta, duhet të jemi gati si e do qëllimi i lartë që kemi shkruar në flamurin tonë.

Për fat të keq, jemi shumë prapa: shokët s'kanë tre-guar shumë gjallëri: gazeta ka dalë pa rregull e pa sistem: kollonit' e jashtme s'i kemi aktivizuar dot, brënda në Shqipëri s'kemi bërë pothuaj asnjë punë.

Duhet t'i mbushim këto mungesa dhe t'a nisim punën me një sulm të ri, me një shpirt të gjallë e me një metodë të saktë. E tërë çështja jonë varet nga bazat dhe direktivat që kemi për të caktuar. Jam shigur se këtë vepër do t'a mbarojmë si patriotë të vërtetë.

Kështu do të jemi të gatitur e të armatosur për të mbaruar misionin historik të çlirimit të kombit.

Parullat tona duhen të jenë këto:

Dita jonë vjen!

Le të gatitemi me mish e me shpirt!
Propagandë kundër Ahmedit, kundër feodalëve, kundër
dër fajdexhinjve!
Propagandë kundër fashistëve italianë e ballkanikë.
Për çlirimin e Shqipërisë ethnografike!
Për Federatën Ballkanike.

AQSH, fondi Fan S.NOLI (14), d.19, fl. 1-44.

MBI GJENDJEN E FSHATARËSISË NË SHQIPËRI*

Fshatarët shqiptarë pësojnë një shfrytëzim të dyfishtë, atë të imperializmit italian, që është duke e shndërruar Shqipërinë në një koloni italiane, dhe atë të bejlerëve feudale (çifligarëve) vendas, pronarë tokash mesjetarë.

Gati të gjitha tokat pjellore të Shqipërisë u përkasin disa familjeve të mëdha feudale dhe një pakicë të vogël fshatarësh të pasur. Sa për masat fshatare në përgjithësi, ato vegjetojnë ose thjesht vdesin urie. Ato janë vetëm për të punuar me qëllim që të pasurohen pronarët e mëdhenj.

Gati 30% të fshatarëve nuk kanë fare tokë.

50% të fshatarëve nuk kanë tokë aq sa u duhet për të përmbushur nevojat e tyre modeste.

15% janë fshatarë të varfër dhe fshatarë të mesëm, që mezi nxjerrin bukën e gojës.

Numri i fshatarëve proletarë është në rritje të vazhdueshme për arsyt e mëposhtme:

Shteti me taksat e rënda, bejlerët feudale me terrorin e tyre, dhe fajdexhinjtë me pangopësinë e tyre, s'lenë gjë pa bërë për t'u marrë tokat fshatarëve dhe për t'i proletarizuar plotësisht.

Në Shqipëri nuk ka banka bujqësore që të japin kredi në kushte të arsyeshme. Kur një fshatar ka nevojë për para, ai shkon te fajdexhinjtë që ia japin me 100-200% kamatë. Kur bie në dorë të fajdexhiut, në përgjithësi fshatari detyrohet në fund të fundit të shesë tokën për të paguar borxhet.

Për sa u takon bejlerëve feudale, ata përdorin lloj-lloj mënyrash për t'i shtrënguar fshatarët që t'ua shesin tokat e lakmuara me çmime qesharake. Ata i vrasin ose i dënojnë të vuajnë urie fshatarët që kundërshtojnë. Mjeti më efikas për t'u hequr bukën e gojës është prerja e ujit ose përmbytja e tokave të tyre, sepse vijat e ujit janë pronë e bejlerëve.

*) Fjalë e mbajtur në Kongresin fshatar evropian në mars 1930 në Berlin. Titulli është yni.

Vrasja dhe uria janë mjete direkte që përdorin bejlerët feudale për të shtënë në dorë tokat e fshatarëve. Por ka edhe mjete indirekte për të arritur po ato rezultate. Mjafton të përmendim taksën për ndërtimin e rrugëve që është në thelb një barrë (angari) tepër e rëndë për fshatarët. Sipas ligjit, çdo fshatar duhet të paguajë një taksë progresive për ndërtimin e rrugëve. Në qoftë se fshatari nuk është në gjendje ta paguajë këtë taksë në të holla, atëherë ai është i detyruar të punojë angari dy ose tri javë. Kjo punë angari mund të zgjatet në mënyrë arbitrare deri në pambarim nga nëpunësit e shtetit, që janë agjentë të bejlerëve feudale, derisa fshatarët të shtrëngohen t'i shesin tokat e tyre dhe të bëhen skllever në bujqësi (bujkrobër).

Është folur shumë kohët e fundit për reformat agrare që qeveria feudale fashiste shqiptare ka ndërmend të bëjë në favor të fshatarëve. Ky është vetëm një bllof. Pasi bëri zhurmë për këto reforma dy vjet me radhë, qeveria shqiptare sapo ka deklaruar zyrtarisht me gojën e kryeministrit të tanishëm se bejlerët feudale nuk kanë asnjë arsye që të alarmohen nga këto reforma. Këto do të bëhen në favor të pronarëve të tokave dhe jo në favor të fshatarëve. Ky është kulmi i cinizmit. Nga ana tjetër, edhe Italia fashiste nuk do ta lejojë kurrë qeverinë shqiptare të bëjë reforma në dëm të bejlerëve feudale, të cilët janë të mbrojturit dhe veglat e Musolinit.

Rezultati i kësaj gjendjeje është një zi buke kronike, emigrimi në masë dhe kryengritjet fshatare.

Është relativisht e lehtë për fshatarët shqiptarë që ta përmbysin qeverinë feudale fashiste. Por, bejlerët feudale do t'ia arrinin ta merrnin përsëri pushtetin në sajë të ndërhyrjes me armë të Musolinit.

Ç'është më e keqja, militaristët serbë dhe grekë, i përkrahin bejlerët feudale shqiptarë, po aq sa Musolini. Është një fakt i njohur botërisht, se mbreti i tanishëm i Shqipërisë, i cili sot është një vasal i Musolinit, në të kaluarën ka qenë një protégé (i mbrojtur) i militaristëve serbë dhe pikërisht në sajë të bajonetave serbe e mori pushtetin në dhjetor 1924.

Fshatarët shqiptarë të shtypur kanë nxjerrë konkluzionin që diktohet nga kjo situatë. Konkluzioni është: krijimi i një

federate të republikave fshatare të të gjithë popujve të çliruar të Ballkanit.

Përkthim nga dorëshkrimi frëngjisht në
AQSH, *fondi Fan S.Noli* (14), d. 20.

Autori bullgar Ilko Tatarliev në një artikull «Mbi luftën e emigracionit shqiptar progresist në periudhën 1924-1939». citon pjesë të fjalës së Nolit të botuar në revistën «La Fédération Balkanique» (Federata Ballkanike) në qershor 1930. Shih *Iunskata Burzhvaznodemokratiçna Revolucija v Albanija 1924 g., Sofia 1989* (përmbledhje artikujsh, botim i Akademisë së Shkencave të Bullgarisë).

VETË-KRITIKË*

1) Jo mungesë energjie për t'imponuar njerës — se kam imponuar Hasanin¹ në Korçë po neglizhencë absolute për të rritur «leaders» (udhëheqës) për shtabin tim qentral si dhe për shtabet lokale të pakën në qarkun e Korçës, makar sa n'Amerikë.

Mëkat Mortal, që s'lahet n'asnjë ferr.

2) Posa s'kishte shtab, as krijonja dot, as lëviza gishtin për të krijuar, duhej të lidhesha me Klikën, ose të hiqesha nga politika. Argumentat që Peci me Vasillaq Avramin² do të më nxirnin nga Klika, që brënda në Klikën do t'isha jesir e pa influencë, nukë më duken mjaft të forta për të justifikuar izolatatën time. As dola dot nga izolata, as u hoqa nga politika.

Mëkate

që munt të lahen në Ferr.

3) *Défauts de mes vertus*.³

a) Pazotësi për intriga. Fanatizmë pedante në program.
b) Lojaltet absurd për njerëz të pabesë dhe korruptë si Faiku e Mehmedi, a punë-prishës, parasitë e të humbur që i kisha si gjyle nën këmbë si Kol Rodhja, Loni Kristo, Andonaqi, etj.⁴

c) Tepër mistik në një vend pa fé.

d) Tepër letrar në një vend që s'këndon.

e) Yryshe duke mbyllur sytë.

*) Botohet sipas radhitjes që ka në dorëshkrim.

1) Hasan Bitincka, drejtor i gazetës së përjavshme «*Shqiptari i Amerikës*» që dilte në Korçë (1922-1924). Në një artikull të botuar në «*Republika*» në dhjetor 1930, me rastin e vdekjes së H. Bitinckës, Noli e ka vlerësuar lart punën e tij si «shok e bashkëluftar në vijën e parë të zjarrit... gjer më 1924». (*Fan S. Noli, Vepra, vëll. 3, Tiranë, 1987, f. 201-203*).

2) S. Peci, V. Avrami (avokat në Korçë)

3) Frëngj: Të metat e virtyteve të mia.

4) Anëtarë të «*Vatrës*» që u kthyen në Atdhe në vitet 20 dhe qëndruan afër Nolit. Andonaqi (Andon Frashëri) punoi edhe si sekretar i Nolit.

Mëkate

që lahen në Purgator.

4) Mëkat i Ambientit.

Tepër nën' influencën e vegjëlisë korçare.

S'lahet
n'asnjë pus
të Korçës

Absollvoj (shkarkoj) veten nga akuza
që kam qenë dislojal për shokët, që bënja pas kokës pa
pyetur shokët.

Observata (vërejtje)
nga L. dhe P.¹

1) Kaptina 1925-1931

*La fin est triste, la milieu ne vaut pas grand' chose et
le commencement est ridicule.* Voltaire.²

2) Preteza që s'jam luftëtar, ekzagjeratë hakë-ngrënëse.
Afro 30 vjet luftë, s'jam hequr akoma.

3) Preteza që s'jam *Menschenkennner*³ — një ekzagjeratë më
hakë-ngrënëse se ajo që s'jam luftëtar: S'kam shumë rimorse.
Pas një bashkëpunimi të shkurtër me Ahmedin dhe Co, i
njoha ç'njerës janë, u shkëputa prej syresh dhe nisa t'i luftoj.
Në Parlament u parathashë deputetëve ahmedofilë me një
diskurs me të vërtetë profetik se qysh do t'u dilte heroj i
tyre: *Till Eulenspiegel*.⁴

Në Vienë, pasi dualmë nga Shqipëria, s'kam patur asnjë
illuzion për një organizim t'elementave dispartate t'emigra-
tës, gjë që provon se i njihja mjaft. Ashtu doli. Bënë sikur a
organizuan dhe pastaj u shpërndanë si zoqt' e korbit.

Për njerëzit që kam patur rreth, as për këta s'kam patur
illuzione, po mbyllja sytë, se ndryshe duhej të hiqesha nga
fusha e luftës. Tërë luftën e kam bërë me tabore të prishur,
shef bashibozuk, me ushtarë bashibozukë, dhe me oficerë ba-
shibozukë, ose pa oficerë fare.

1) Nuk ka qenë e mundur të sqarohet.

2) Frengj: Fundi është i trishtueshëm, mesi nuk vlen kushedi
çfarë dhe fillimi është qesharak, Volter.

3) Gjerm: — Njohës i njerëzve.

4) Personazh komik i një legjende mesjetare gjermane.

Sikur të mos mbyllja sytë e sikur t'i shikonja me sy të pamëshirtë ushtarët dhe oficerët që më ofroheshin në shërbim do të isha hequr nga lufta, për Shqipërinë, që ahëre që'kur u bëra zyrtarisht chief (kryetar) i indianëve të bardhë, siç i quante shqiptarët Hasani, dmth që më 1907. Shyqyr zotit që s'i çelja sytë! Kështu kam thyer kokën në shumë hen'ekë, po vetëm kështu kam mundur të kapërcenja disa e të i tonj disa beteja!

Kjo hyn në pikën e vetë-kritikës për yryshet me sy të mbyllur.

4) Bëra lajthim që dola nga ritirata dhe nisa të shkruaj në L.K.¹ më 1928. Kjo zgjoi illuzione të kotta. Duhej të kisha ndenjur mënjanë.

5) Shum' e vërtetë që m'u bë pak zakon të jap urdhër me katundarët e Amerikës, po as kjo nuk duhet eksagjeruar. Se korçarët e Amerikës s'dëgjonin urdhëra. Përkundër, më jepnin mua.

6) Preteza që s'jam konsekuent dyke qëndruar në krye të shqiptarëve të Amerikës më duket fare e pajustificuar.

7) Konkurenca midis R.² dhe L.K. mund të pushonjë me vdekjen e R-së. Po kam frikë se ahëre do t'a gëzojmë shumë Gurazezin³ dhe Faikun. Këtyre nuk u bën e nuk u bënte tër veshi nga L.K., po janë tërbuar nga R. dhe s'ka numër ku të mos polemizojnë me R. e me mua.

8) Përse s'hiqem nga lufta? Kësaj i përgjigjem edhe unë me një pyetje: Qysh munt të hiqem? That is the question.⁴

1) P.S. «Nuk i njeh njerëzit»: Boshnjaku.⁵

2) P.S. N'Amerikë!

Sipas vjershës

Atje nisi, atje mbaroj

etc.

AQSH, fondi Fan S. Noli (14), d. 18.


1) «Liria Kombëtare» — gazetë e përdyjavshme, organ i opozitës demokratike antizogiste që dilte në Gjenevë të Zvicrës prej v. 1925.

2) «Republika» — gazetë e përdyjavshme e drejtuar nga Noli që dilte në Boston (SHBA) prej 1930 deri më 1933.

3) Kryeredaktor i «Diellit», ndërsa drejtor ishte Faik Konica.

4) Dilema e famshme e Hamletit të Shekspirit: *To be or not to be? That is the question.* Të jesh a të mos jesh? Kjo është çështja.

5) Konstandin Boshnjaku, një ndër veprimtarët e KONARE-s.



Siç do të shihet nga të tre dorëshkrimet e Nolit, ky është ai që shkakton më shumë pikëpyetje e ngjall më tepër dyshime. «Vetëkritika» ka trajtën e konspektit dhe nuk përjashtohet që Noli të ketë hedhur aty disa shënime të shkurtëra, që do të shërbenin si bazë ose për ndonjë letër ose për ndonjë artikull. Por nuk ka të dhëna që të provojnë se Noli e ka bërë këtë me një mënyrë ose një tjetër. Mbetet kjo skicë e shkurtër, e thatë në të cilën lexuesi disa gjëra nuk do t'i deshifrojë, ndonjë gjë mund ta marrë me mend duke e lidhur me etapat e ndryshme të veprimtarisë së Nolit para dhe pas qershorit. Edhe kështu ajo jep një mundësi për t'i ballafaquar ato që janë thënë për Nolin me ato që thotë ai vetë. Në çdo rast ky dorëshkrim e ka një vlerë, jo vetëm sepse botohet për herë të parë, por edhe sepse është një shprehje e qartë e gjendjes shpirtërore të rëndë në të cilën ka rënë Noli jo vetëm nga disfata e dhjetorit por edhe për shkak të përçarjes në radhët e grupeve të emigrantëve shqiptarë. Megjithëse nuk mungojnë aty disa elementë për të gjykuar për jetën politike shqiptare të viteve 20, thelbi i shkrimit përqëndrohet në frazën e famshme të Volterit: «Fundi është i trishtueshëm, mesi nuk vlen kushedi çfarë dhe fillimi është qesharak». Kjo vlen si etiketë për periudhën 1925-1931, pra për vitet e endjes së Nolit nëpër Evropë. Konkluzioni është i qartë: ai tanimë ka vendosur të hiqet mënjandë dhe të rikthehet në Amerikë.

Nga kjo pikëpamje një letër e Nolit e marsit 1934 nga Bostoni është edhe një zbrëthim i mëtejshëm, edhe një konfermë. Pyetjes se «përse u hoq nga politika» ai i përgjigjet me këto fjalë:

«Çështje e gjatë, po me fjalë të shkurtëra shkakët janë këto: mungesa e shokëve dhe e mjeteve, varfëria dhe lodhja. Ca fakte: në korrik 1932 u mbyll «Republika» (gazetë e nxjerrë nga Noli) me një deficit prej 1 600 dollarësh, borxhet më mbetnë në kurrist. Gjithatë vit, i shtrënguar të pres tetë muaj në Gjermani për vizën amerikane, bëra 1500 dollarë të tjera borxhe. Më 1933 u përpoqa ta ndreq shituatën financiare me një fushatë për Don Kishotin. Ndonse bëra konferenca në të gjitha kollonit' e mërgimit dhe s'lashë vend pa dërguar qarqetore dhe thirrje, përfundimi ishte një fiasko i kulluar. U

shkruan gjithsej nja 140 pajtimtarë dhe puna mori fund me një deficit prej 800 dollarësh. Mi këtë e sipër u sëmura me 2 dollarë në xhep, dhe i mbytur në borxhe më të djathtë' e më të mengjër kishët më neveritmë në mëshirë të fatit dhe s'u kujdesnë të më ndihnin as kur kisha njerën këmbë në varr. Ahere i bëra një thirrje Vatanit për imdà. Më dërguan 150 napolona. Bereqat vers. Siç ka thënë Voltaire-i, perëndia e ndjeftë: «*La fin est triste, le milieu, ne vaut pas grand'chose et le commencement est ridicule.*» Kjo qenka jeta e njeriut, edhe jona ca më keq se e gjithë të tjerëve!».

Kopje e letrës në dorëshkrim në AQSH, *fondi Fani S. Noli*
(14) d. 102, fl. 26.

TREGUESI I EMRAVE

- Adriatik, 55, 189, 202.
Aires (Eyres H.C.) min. i Britanisë në Shqipëri, 9, 29, 30, 32-34, 81-82, 84, 106, 178, 239, 240.
Aleksandër, mbret i Jugosllavisë, 22-23, 225.
Aleksandrov, T., 206.
Anadoll, 90, 145-148, 150, 153-154, 159.
Ankara, 148.
Aranitasi, Xh. 233, 236.
Arpicë, 147.
Atanasova, E., 201.
Athinë, 26-27, 51, 106-108, 110-111, 121-122, 159, 211, 234-235, 241, 249, 251.
Austri, 143.
Austro-Hungari, 55-56, 69, 113, 136, 183-184.
Avecana, baron (Avezzana), ambas. i Italisë në Paris, 41, 57.
Avramovski, Zh. 18, 29, 31.
Azi e Vogël, 146, 155.
Ballkan, 48, 55, 80-81, 87, 91-92, 94-95, 164-105, 173, 175, 191, 193, 201-203, 206, 208, 211, 220, 242, 244, 253.
Bari, 69, 198, 238.
Bashkimi Sovjetik, Vendosja e marrëdhënieve me qeverinë e Nolit, 45-53, 193, 194, 204, 216.
Bajraktari, M. 99.
Beograd, 20-26, 51, 59, 70, 92, 93, 96-100, 105, 116, 124, 126, 159, 165, 170, 193, 205, 207, 209-211, 215, 221, 225-228, 238-240, 244-245.
Bernë, 246.
Begen-Bijkok (Beguin-Billecocq), i ngarkuar me punë i Francës në Shqipëri, 42.
Belgjikë, 36-37, 184, 187, 221.
Bezmishte, 121.
Bicaj, 231-232.
Blejk, M. (Blake, M) 37, 38.
Bodrero, min i Italisë në Beograd, 22-23, 225, 231-232, 234, 245.
Boston, 211.
Britania e Madhe (Angli), 11, 35-37, 51, 52, 56-57, 64, 72, 75, 78, 81, 83, 85, 132. Çështja e njohjes së qeverisë së Nolit 21, 28-35, 43, 76, 171, 176, 180, 181, 184-186. Bojkotimi i qeverisë së Nolit, 80, 204, 239, 243, Çështja e kufijve, 133-134., Roli në intervencionin e dhjetorit, 79, 102, 203, 237, 239, 240.

Bruksel, 159.
 Bulqizë, 231, 232.
 Bullgari, 19, 68, 143, 250.
 Bukuresht, 51.
 Bushati, N., 50, 51.
 Bushati, Xh., 13.
 Crnovska (Tsernoska), 121.
 Curri, B., 8-9, 164-166, 169, 170, 204-206, 210, 230, 238.
 Çamëri, 90, 91, 145-157, 160-161, 163, 166.
 Çaulev, 204, 206.
 Çekosllovakia, 95.
 Çemberlen, A. (Chamberlain, A.) min. i jashtëm i Britanisë së Madhe,
 77, 239, 242.
 Çiçerin, komisar për punët e jashtme i B.S., 47, 49.
 Danimarkë, 29.
 Daç, S., 99.
 Daues (Dawes), 186, 187, 196.
 Davidoviç, kryeministër i Jugosllavisë, 24-25, 93-94, 98, 209-210,
 221.
 Davos, 225.
 De Leon, 157-159.
 Delvina, S., 13, 16, 26-27, 30, 47-49, 95, 149-151, 153, 179, 212, 226.
 Delvinë, 233, 236.
 Dema, H., 98-99.
 Dermorgny, G., 40.
 Desperi, F. (D'Espery, F.), gjën. 113.
 Dibër, 99, 127-128, 130, 230-232.
 Dilo, L., 183, 196.
 Dimitrov, G., 201-204.
 Dine, F., 98, 99.
 Dino, Xh., 226.
 Drini, 230-231.
 Drini, R., 231.
 Drumond, E. (Drummond, E.) sekretar i përgjithshëm i Lidhjes së
 Kombeve, 16, 88, 100, 151, 183, 238, 243, 247.
 Duraco (Durazzo), markez, min. i Italisë në Shqipëri, 16-19, 57, 61,
 214-215, 239-241.
 Duroselle, J.B. 36, 185.
 Durrës, 17, 30, 32, 57, 65-66, 68, 70-71, 105, 110, 125-126, 196, 222,
 232, 251.
 Elbasan, 99, 130, 232.
 Epir, 145, 151, 154-156, 161, 209, 234, 249.
 Evangjeli, P., 46.
 Even, Mc., 30.
 Evropë, 54, 65, 77, 85, 176, 179, 253, 259.
 Fevziu, B., 229.
 Fier, 164.
 Filat, 147.
 Finlandë, 37.
 Firenze, 112, 114, 117, 214.
 Francë, 11, 36-37, 40, 46, 58, 75, 102, 113, 124, 171, 180, 184-187,
 225, 226, 239-240, 243. Çështja e njohjes së qeverisë së Nolit,
 21, 41-43, Çështja e kufijve, 132-134.
 Frashëri, E., 196.
 Ftelia, 130.

Furtu (Fourtou de), gjen. 114.
 Gaïç, kol., 59.
 Galica, A., 164.
 Galicë, 165.
 Gavrilloviç, P., 59.
 Glomboc (Glomotch), 121.
 Goricë (Goritsa), 121.
 Graham, ambasador britanik në Romë. 181.
 Grant-Smith, min. i SHBA në Shqipëri, 38-39.
 Grazhdan (Gradjan), 121.
 Grei, E., (Grey. E), min. i jashtëm i Britanisë, 131.
 Gremica, 147.
 Greqi, 52, 68, 87, 89, 95, 104-110, 112, 121, 123, 142-144, 146, 151, 159, 202, 209, 237, 250. Çështja e njohjes së qeverisë së Nolit, 26-27, 34. Shpërngulja e popullsisë çame, 90-91, 103, 108, 145-146, 148-163, 199. Prirja e afrimit shqiptaro-grek, 89, 91, 103-105, 249. Çështja e kufijve, 63, 122, 138, 161. Pjesmarrja në intervencionin e dhjetorit, 204, 211, 213, 232, 234, 237, 247-251.
 Grikohuar, 147.
 Gurabardhë, 131-132.
 Gurakuqi, L., 8, 13, 30, 49, 68, 74, 180-181, 196, 210, 237-238, 241.
 Gjakovë, 23, 128, 228.
 Gjenevë, 11, 49, 65, 70, 72-73, 75, 83-85, 89, 91, 95, 115, 117-118, 126, 131, 139, 150-151, 160-161, 165-166, 172-175, 180-186, 190-199, 207, 210-211, 241, 246-247, 253.
 Gjermani, 36, 186-187.
 Gjirokastër, 27, 110, 192, 233, 235-237, 248-249.
 Hackworth, T.H. 36-40.
 Hagë, 134.
 Hani i Aristës, 236.
 Hani i Hotit, 127.
 Haxhiç, gjen. 210.
 Herio, E. (Herriot, E.), kryemin. i Francës, 15, 41-42, 75, 125-126, 180, 181, 185, 195, 199.
 Himarë, 109-111.
 Hollandë, 184, 221.
 Homash, 231.
 Hoxha, H., 162-163.
 Hungari, 143.
 Hysi, G., 101, 214.
 Iliri, 89.
 Indelli, 68-69.
 Itali, 16-18, 35-37, 49, 51-52, 59-60, 62-64, 78, 80, 107, 109, 113, 141, 184, 190, 201-202, 209, 215, 222, 239-240, 243, 245-246, 260. Politika italiane para qershorit, 55, 57-57, 60. Çështja e njohjes së qeverisë së Nolit, 16-23, 26-27, 34, 43, 72, 76, 213. Çështja e Paktit italo-shqiptar, 66-67, 69, 76, 79. Çështja e kufijve, 63, 70, 73, 75, 132, 136. Marrëveshja e heshtur Italo-Jugosllave për intervencionin, 102, 203, 212-214, 216-217, 219-224, 244-247.
 Janinë, 90, 121, 153, 156, 235-237.
 Japoni, 11, 36-37, 132.
 Jergucat, 236.
 Jugosllavi, (Shteti Serbo-Kroato-Slloven) 9, 37, 40, 52, 56, 60, 63, 73, 75, 77, 79, 87, 95, 98, 104, 111, 124, 128, 142, 144, 202, 205-207, 209, 216, 246, 250. Çështja e njohjes së qeverisë së Nolit, 20-22,

23, 27, 43, 181. Bazë për organizimin e intervencionit: 59, 79, 96-102, 197, 202-204, 206, 208, 211-217, 219, 222, 224. Çështja e kufijve, 63, 93, 124-130, 132-138. Çështja e popullsisë shqiptare të Kosovës. 94, 145, 162-170. Pjesmarrja drejtpërdrejt në intervencion, 228, 231-233, 235, 239-240, 243, 245, 247-248, 251.

Juka, M., 43.

Jurenjev, përfaq. sovjetik në Romë, 47, 49.

Jusufi, E., 231.

Juz (Hughes), sekretar i shtetit i SHBA, 36, 38-39.

Kakavijë, 235-237, 241, 249.

Kaklamanos, 145-146.

Kapsambelis, 138.

Katunës, 236.

Kavajë, 232.

Kaziu, T., 98.

Kelmendi, 123.

Kerje, 121.

Këlcyra, A., 261.

Kërlezha, M., 206-207.

Knezeviç, major, 233.

Koculi, Q., 13.

Kolben (Colben), 110, 159.

Kolonja, A.R., 24-25, 164, 226-227, 248.

Kolovoç, 147.

Kokalari, H., 163.

Konsko, 121.

Korabi, 231.

Kontarini (Contarini), 215, 219, 221.

Konica, M., 30, 33, 41-43, 135, 180, 197, 203, 212, 238-239.

Korçë. 27, 100, 103-104, 106, 108, 113-114, 116-117, 120, 130-131, 138, 195-196, 205, 233.

Korfuz, 109, 121, 233.

Koska, 147.

Kosovë. 23-25, 30, 94, 99, 101, 145, 162-167, 169, 170, 193, 205, 220, 228, 261.

Kostenec (Kostenets), 121.

Kota, K., 233-234.

Krakovjecki, A., përfaq. sovjetik në Tiranë, 50-51.

Kroaci, 209, 211.

Kruja, M., 261.

Krujë, 227.

Krumë, 230.

Kryeziu, C., 225, 228.

Kuaroni, P. (Quaroni, P), 60.

Kuçi, 125, 127.

Kukës, 227, 230-231.

Kulishev, G., 279.

Kumanudi, përfaqësues i Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, 128-129, 139.

Labonica, (Labonitsa), 121.

Labonica e Poshtme (Lajthiza), 121.

Lazareviç, B., 59.

Leskë, 121.

Leskovik, 236-237.

Lesona, A. (Lessona, A.), 77-79.
 Libohova, M., 27, 235-237, 250.
 Lidhja e Kombeve, 11, 36, 43, 69, 72, 84-85, 106, 110, 116, 121, 134-135, 142-148, 150-154, 156, 158-160, 166-168, 170, 172-173, 175, 218, 222, 247, 254, 257. Rëndësia e pranimit të Shqipërisë, 11, 16, 115, 119, 174, 209. Pjesmarrja e delegacionit shqiptar në Asamblenë e V, 49, 89, 91-92, 100, 117-119, 122, 126-127, 129, 136, 139, 154-157, 165, 169, 175, 180. Fjalimi i Nolit, 74, 182-190, 192, 200, 253, 259. Qëndrimi kundrejt intervencionit, 102, 241-244, 246, 248, 250.
 Lini, 130-132, 137.
 Littlefield, U. (Littlefield, W.), gazetar, 193.
 Litvinov, zv. komisar për punët e jashtëme i BS, 45-46, 51.
 Lokarno, 36.
 Londër. 20, 33, 35, 41, 43, 45-46, 49-51, 53, 64, 119, 130-132, 142, 178-180, 204, 211-212, 238-241, 243.
 Lopësi 147.
 Lushnje, 7, 8, 10, 109, 111, 114, 119, 137, 172-173, 179, 222, 232.
 Lozanë, 90, 103, 145-146, 148, 151, 152, 155, 157, 161, 192.
 Lumë, 231-232.
 Mali Gramos, 131.
 Mali i Turcëtës, 232.
 Mali i Zi, 112, 124, 142, 162, 166-167.
 Makartnei H.A. (Macarthey, C.A.), 204.
 Makdonald (Macdonald) kryeministër i Anglisë, 15, 33-35, 53, 75, 82-84, 180-181, 185, 195, 199.
 Maqedoni, 152, 154, 161, 166-167, 205, 207.
 Margëlliçi, 147.
 Marinkoviç, min. i jashtëm në qev. e Davidoviçit, 24-25, 27.
 Marketi (Marchetti), përfaqësues i Musolinit në Shqipëri, 23, 59, 65-66, 68, 70-73, 76.
 Markoviç, P, gjen., 59.
 Markoviç, zv/ministër i jashtëm, 248.
 Martanesh, 232.
 Mastori Cil, 147.
 Mati. 78, 99, 123, 229.
 Mborja, T., 68.
 Mensdorf. 142.
 Mesdhe. 104.
 Mirditë, 109.
 Mitrovicë, 166.
 Montekarlo, 192.
 Mosi, H., 235-236.
 Moskë (Moskva), 185.
 Musolini. 14, 18-19, 23, 35, 43, 57-58, 60-70, 72-80, 116-117, 121, 198, 213, 215, 217-220, 222-224, 236, 241-245.
 Nëji, (Neuilly), 143.
 Nikolson. 65, 84-85.
 Ninqiç, min. i jashtëm jugosllav, 21-22, 76, 193, 205, 215-224, 241-242, 245-247.
 Nivica (Nivitsa), 121.
 Noli, F., Roli i tij para rev. të qershorit, 5, 8-9, 16, 36, 177, 179. Në krye të qeverisë demokratike, 2, 4-5, 9, 12-16, 18-21, 23, 25-29, 31-35, 39-40, 43-44, 46, 48-52, 54, 60-65, 67, 70-71, 73,

- 77, 81, 83, 85, 87-88, 90-95, 97-98, 100, 103, 108, 109, 111, 115-118, 122-123, 129, 136, 139, 148, 151-154, 165, 169, 172-180, 204-205, 207, 210, 214, 216, 218-220, 222, 224-225, 229, 232-235, 237-239, 247-248, 250, 252-256: Noli në Lidhjen e Kombeve, 91-92, 102, 118-120, 154-158, 174-175, 180-200, 253-254, 257-259. Takimi me Musolinin, 49, 71-75, 213. Përçapjet pranë fuqive për denoncimin e intervencionit, 102, 240-244, 246. Vendi dhe roli i tij në Revolucionin e 1924-s, 179, 203, 208-209, 255. 257-258, Pas dështimit të Revolucionit, 237, 259-262.
- Novoselë, 121.
- Nju Jork, 192-193.
- Odesa, 46.
- Ohri, 100, 114, 130-131, 227.
- Oppenheim, L., 40, 44.
- Palmer, A.W., 204.
- Panurias, min. grek në Shqipëri, 26, 251.
- Papanastasiu, kryeministër grek, 14, 26.
- Parga, 147.
- Paris, 11, 20, 26, 30, 40, 43, 51, 57, 114, 116, 118, 121, 124-126, 131, 134-135, 166, 180, 185--186, 211, 215, 225-226, 241.
- Parr, i ngarkuar me punë i Anglisë në Shqipëri, 30-32, 35, 64-65.
- Pastorelli, P., 18-19, 56, 59-61, 64-66, 70, 73-76, 78-80, 117, 182, 264, 214-215, 217-218, 225.
- Pashic, N., Kryemin. juosllav, 14, 20, 24, 25, 59, 93, 96, 101, 203, 209-211, 221, 225, 245.
- Peci, S., 15, 39, 178.
- Pejë, 113, 166.
- Peshkopi, 98, 229,-231.
- Petrograd, 105.
- Pilkat, 121.
- Podgoricë, 99.
- Pogradec, 113.
- Pojani, S., 233.
- Politis, përfaqësues grek në Lidhjen e Kombeve, 110, 222, 156, 158.
- Prevezë, 149, 156.
- Prishtina, H., 105, 164-166, 204-205, 261.
- Prishtinë, 30, 166, 177.
- Prizren, 99, 227-228, 230-231.
- Pustec (Poustets), 121.
- Puto, A., 11, 109, 113, 115, 120, 131, 136, 173, 219.
- Qafa e Bicajt, 230.
- Qafa e Krrabës, 232.
- Qafa e Murrizës, 231-232.
- Qafa e Priskës, 232.
- Qafa e Thanës, 232.
- Qafëzezi, K., 13.
- Qamo, N., 147.
- Qenok, 231.
- Qosja, R., 177, 258.
- Radiç, A., 209.
- Radiç, S., 207, 209-212, 216, 234.
- Rahova (Rehova), 121.
- Rakicka (Rakitska), 121.
- Ristiç, J., kapiten, 233.

Romë, 16, 26, 47-49, 51, 61, 64, 66-68, 70-72, 74-76, 78, 126, 160,
 181, 211-212, 215, 218-222, 224-225, 239, 241-242.
 Rumani, 95.
 Ruri, 186.
 Rusi, 45-47, 55.
 Rusos (Russos), min. i jashtëm i Greqisë, 234, 249.
 Rustemi, A., 8, 83.
 Salvemini, G., 69, 77, 197-198.
 Sarandë, 110.
 Sazan, 130.
 Selanik, 104-105.
 Selcë, 127-128, 132, 142.
 Sen-Zhermen (Saint-Germain), 143, 166-167.
 Serbi, 24, 51, 107, 112-113, 162, 170, 209, 212, 220, 248.
 Sesil (Cecil), deleg. britanik, në Lidhjen e Kombeve, 174, 176.
 Sevrani, V., major, 233, 235, 241.
 Sevrë (Sèvres), 157.
 Simonard, A., 11, 69, 114, 130, 139.
 Slimica (Slimnica), 121.
 Sofje, 201-203.
 Sola, i ngarkuar me punë italian në Beograd, 21, 193, 204, 215-
 218, 244.
 Spalajkoviç, përf. jugosllav në Lidhjen e Kombeve, 138.
 Spile, 110.
 Stamboll, 154.
 Stavrianos, L.S., 145.
 Sterling, kol., 31.
 Strugë, 99-100.
 Suajër, J. (Swire, J.), 52-53, 115, 121, 145, 148, 174, 178-179, 230, 247.
 Shala, R., 13.
 SHBA. Çështja e njohjes së qeverisë së Nolit, 36-40. Jeta e Nolit
 në Amerikë 37-38, 40, 56, 64, 179, 184, 187, 192-193, 259.
 Shekspir, V. (Shakespeare, W.) 185.
 Shkodra, 113-114, 123, 128, 130, 204, 209, 215, 227, 230, 231.
 Shëngjin, 204.
 Shën-Naum, 57, 63, 116, 117, 130-139, 205.
 Shkalla e Tujanit, 232.
 Shpuza, S., 229.
 Shues (Souetch), 121.
 Shulin, 221.
 Tako, P., 196.
 Tamarë, 127-128.
 Tangjer, 37.
 Tarabosh, 127.
 Telini. (Tellini) gjen., 121.
 Tiranë, 13, 17-20, 22-27, 29, 31, 33-34, 49-51, 59, 61, 65, 69-71, 77,
 113, 115, 124, 127, 194, 196, 201, 203, 205, 210, 212, 214, 221, 225,
 227-235, 237, 239.
 Tittoni, 10.
 Toçi, V., 29.
 Todoroviç, G., 59.
 Topojani, 231.
 Toptani, E., 83.
 Torretta, ambasador italian në Londër, 35.

Travova, 121.
 Trianon, 143.
 Triepsh, 125, 127.
 Trieste, 232.
 Turqi, 83, 90, 95, 103-104, 111, 122-123, 145-147, 148, 150, 156-157, 161-163, 167.
 Uashington, 20.
 Varazhdin, 209.
 Varfanji, 147.
 Vasojevic, 124-125, 127.
 Vaspas, 230.
 Venizellos, E., kryemin. i Greqisë, 10, 145.
 Verdross, A., 143.
 Verlaci, Sh., 241.
 Vermosh, 57, 99, 116-117, 123-129, 139, 213, 222.
 Versajë, 142-143, 173.
 Vërsela, 147.
 Vila, Xh., 31-32.
 Vilson, (Wilson, W.), president i SHBA, 189.
 Vinaver, 218.
 Vinjau, S., 13, 237, 241.
 Vjenë, 50-51, 77, 184, 194.
 Vlorë, 7-9, 11, 61, 104, 110, 114, 173, 190, 196, 211, 221, 237.
 Vllamasi, S., 68.
 Volë, 147.
 Vorio-Epir, 106, 148.
 Vrnik, 121.
 Vuçiternë, 166.
 Vukli, 127.
 Xhelili, J., 231.
 Xhelc, H., 104, 107, 211.
 Xhuvani, V., 196.
 Zagradec (Zagradets), 121.
 Zagreb, 206-207, 212.
 Zaroshkë, 121.
 Zervas, gjen. 161.
 Zogu, A., 8-9, 28-29, 36, 40, 51, 57, 59, 75-79, 82-84, 96, 98-99, 161-102, 130, 139, 164, 182, 197, 202-203, 214-216, 219-220, 225, 234, 236, 238, 240-242, 244-245, 247-248.
 Zvicër, 37, 117, 145, 225, 227, 246.
 Zhidel, Zh. (Gidel, G.), 135-138.
 Ypi, Xh., 36.

PASQYRA E LËNDES

PARATHËNIE	3
HYRJE	7

Kapitulli I

ÇËSHTJA E NJOHJES NDËRKOMBËTARE TË QEVERISË	13
Përçapjet për njohjen	14
Lëkundjet italiane	15
Refuzimi jugosllav	20
Qëndrimi i qeverisë greke	25
Nga rezervat te refuzimi i qeverisë angleze	28
Qëndrimi i qeverisë amerikane	36
Formula ekuivoke franceze	40
Njohja nga qeveria sovjetike	45

Kapitulli II

BOJKOTIMI NDËRKOMBËTAR

Një nyjë e kontradiktave ndër imperialiste	54
Revolucioni i Qershorit si faktor i ri i luftës diplomatike	58
Kthesa italiane	63
Takimi Musolini-Noli	71
Një emisar italian te Zogu	77
Roli i Anglisë	80

Kapitulli III

MBYLLJA NGA ANA E SHTETEVE FQINJE

Predispozicioni i Qeverisë së Nolit	87
Gjendje lufte e pashpallur	95
Prirja e afrimit shqiptaro-grek	102

Kapitulli IV

PËRBALLË PROBLEMEVE KUFITARE

Problemi i caktimit përfundimtar të kufijve të Shqipërisë	112
Përçapjet e Qeverisë Demokratike për kufijtë	116
Fshatrat e Korçës	120
Vermoshi	123
Shën-Naumi	130

Kapitulli V

NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË POPULLSISË SHQIPTARE JASHTË KUFIJVE

Problemi i minoriteteve pas Luftës I Botërore	142
Pasojat e shkëmbimit të popullsive greko-turke	145
Denoncimi i politikës shtypëse në Kosovë	162

Kapitulli VI

QEVERIA E 1924-s DHE LIDHJA E KOMBEVE

Përvoja e viteve 1920-1921 dhe ndikimi i Nolit	172
Në Asamblenë e Lidhjes	180
Fjalimi i Nolit	182
Jehona	191

Kapitulli VII

PËRGATITJA E INTERVENCIONIT

Shqipëria «fole e trazirave» në Ballkan?	201
«Zbulimet» e Radiçit	207
Intensifikimi i kontakteve italo-jugosllave	213
Takimi Musolini-Ninçiq	217

Kapitulli VIII

DEMOKRACIA E RRETHUAR


Fillimi i agresionit	225
Luftimet në Veri	228
Luftimet në Jug	233
Veprimet diplomatike rreth intervencionit	238
Një zë në shkretëtirë	243

MBYLLJE	252
---------------	-----

SHTOJÇË

Fjalimi i Fan Nolit në Asamblenë V të Lidhjes së Kombeve	263
Intervistë e Fan Nolit korrespondentit të gazetës së Beogradit «Vreme»	269
Intervistë e Fan Nolit korrespondentit të gazetës greke «Politia»	272
Intervistë e Fan Nolit korrespondentit të gazetës bullgare «Svobodna Reç»	278
Deklarata të Fan Nolit korrespondentit të gazetës greke «Nea Imera»	280
Nga biseda e Fan Nolit me korrespondentin e gazetës greke «Eleftheron Vima»	282
Intervistë e Fan Nolit korrespondentit të gazetës greke «Skrip»	284
Artikulli i Fan Nolit në një gazetë gjermane	288
Proklama e Kryeministrit	291
Mbi gjendjen në radhët e emigracionit dhe detyrat aktuale	292
Mbi gjendjen e fshatarësisë në Shqipëri	299
Vetë-kritikë	302

TREGUESI I EMRAVE	307
-------------------------	-----



Puto, Arben

Demokracia e rrethuar: (Qeveria e Fan Nolit në marrëdhëniet e jashtme, qershor-dhjetor 1924) /Arben Puto; Red. A. Xhezo, F. Idrizi, — T., 8 Nëntori, 1990 — 320 f.; cm.

949.65.086.37
327(496.5)«1924»

P 98

U dorëzua në shtyp Prill 1990

Doli nga shtypi Gusht 1990

11 Lek

